Republika e Shqipërisë
Ministria e Integrimit

Support to the Albanian
Ministry of European Integration

VERSIONI I KONSOLIDUAR I

TRAKTATEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN

DHE

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE E BASHKIMIT EUROPIAN

Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development

Projekt i financuar nga
Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane

giz

Projekt i zbatuar nga
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

VERSIONI I KONSOLIDUAR

I TRAKTATIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

DHE

TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN

* * *

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE E BASHKIMIT EUROPIAN

Botim i:
Ministrisë së Integrimit Europian

Ky botim u mbështet nga:
Projekti: “Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)”.
Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Përgatiti për shtyp:
Blerina Raça

Përktheu:
Ilir Baçi
Mira Zgjani
Rudina Vuksani Nervaj

Rishikimi ligjor:
Prof. Dr Xhezair Zaganjori
Prof. Dr Arta Mandro
Dr Kathleen Imholz

Rishikimi gjuhësor:
Gazmend Krasniqi
Denata Mesi

Ky botim është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe Qeverisë Gjermane. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e projektit “Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)” dhe në asnjë mënyre nuk mund të interpretohet si opinion i Bashkimit Europian.

This publication has been produced with the assistance of the European Union and the German Government. The contents of this publication are the sole responsibility of the project “Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)” and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.”

SHËNIM PËR LEXUESIN

Ky botim përmban versionet e konsoliduara të Traktatit të Bashkimit Europian dhe të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, së bashku me shtojcat dhe protokollet respektive, pas shtesave dhe ndryshimeve që u janë bërë atyre nga Traktati i Lisbonës, i cili u nënshkrua më 13 dhjetor 2007 në Lisbonë dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Botimi gjithashtu përmban deklaratat bashkëlidhur Aktit Final të Konferencës Ndërqeveritare që miratoi Traktatin e Lisbonës.

Ky botim përmban edhe Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, e cila është shpallur në Strasburg, më 12 dhjetor 2007 nga Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni (GZ C 303, 14.12.2007, fq. 1).

Ky tekst përsërit dhe përshtat Kartën e shpallur më 7 dhjetor 2000, duke e zëvendësuar atë që prej datës 1 dhjetor 2009, datë e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

Në bazë të nenit 6(1) nënparagrafi i parë, të Traktatit të Bashkimit Europian, Karta e shpallur në 2007 ka të njëjtën fuqi ligjore ashtu si edhe Traktatet.

Ky tekst nxirret me qëllim dokumentar dhe nuk i ngarkon me përgjegjësi institucionet e Bashkimit Europian.

HYRJE

Traktati i Lisbonës shënon një hap të rëndësishëm të rrugës së Bashkimit Europian drejt konsolidimit të mëtjeshëm të vlerave të përbashkëta mbi të cilat është krijuar ai. Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009, reformimi dhe modernizimi i institucioneve europiane bën të mundur promovimin e plotë të objektivave të BE-së në shërbim të qytetarëve dhe shteteve anëtare si dhe konsolidon urën lidhëse mes qytetarëve dhe projektit europian, të nisur në fillim të vitevë 50 drejt "pajtimit" dhe "unifikimit" të kontinentit europian.

Nëpërmjet ripërtëritjes së vendimmarrjes në institucionet europiane, ky Traktat përforcon kapacitetin e Bashkimit për një funksionim sa më efiçent dhe demokratik në një bashkësi prej 27 vendësh anëtare.

Ardhja në shqip e versionit të konsoliduar të "Traktatit të Bashkimit Europian", "Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian", si dhe përgatitja e terminologjisë përkatëse në shqip, përbën një hap të rëndësishëm dhe një burim parësor në mbështetje të administratës shqiptare në procesin e përafrimit të legjislacioint shqiptar me atë europian. Përvec kësaj, ky botim është një burim informacioni i rëndësishëm për publikun e interesuar mbi bazën ligjore dhe funksionimin e Bashkimit Europian, vlerat, ovjektivat, parimet dhe politikat e tij.

Ky botim është fryt i një pune profesionale të bashkëpunimit ndërmjet stafit të Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit Europian në Ministrinë e Integrimit Europian, stafit të Projektit SMEI II si dhe grupit të përkthyesve dhe rishikuesve që u përfshinë në këtë nismë.

Përkthimi dhe botimi i Traktateve të Bashkimit Europian në shqip u bë i mundur në kuadër të Projektit "Support to the Albanian Ministry of European Integration – SMEI II", i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nën kujdesin e veçantë të Jan Reckmann, Drejtor i Projektit.

PËRMBAJTJA

TRAKTATI I BASHKIMIT EUROPIAN 17

PREAMBULA 18

TITULLI I DISPOZITA TË PËRBASHKËTA 19

TITULLI II DISPOZITAT PËR PARIMET DEMOKRATIKE 23

TITULLI III DISPOZITA PËR INSTITUCIONET 25

TITULLI IV DISPOZITA PËR BASHKËPUNIMIN E PËRFORCUAR 30

TITULLI V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR VEPRIMIN E JASHTËM TË BASHKIMIT DHE DISPOZITA TË VEÇANTA PËR POLITIKËN E PËRBASHKËT TË JASHTME DHE TË SIGURIMIT 31

KREU 1 Dispozita të përgjithshme për veprimin e jashtëm të Bashkimit 31

KREU 2 Dispozita të veçanta për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit 33

Seksioni 1 Dispozita të përbashkëta 33

Seksioni 2 Dispozita për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit 40

TITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT 44

TRAKTATI PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN 49

PREAMBULA 50

PJESA E PARË PARIMET 51

TITULLI I KATEGORITË DHE FUSHAT E KOMPETENCËS SË BASHKIMIT 51

TITULLI II DISPOZITA ME ZBATIM TË PËRGJITHSHËM 54

PJESA E DYTË MOSDISKRIMINIMI DHE QYTETARIA E BASHKIMIT 56

PJESA E TRETË POLITIKAT DHE VEPRIMET E BRENDSHME TË BASHKIMIT 59

TITULLI I TREGU I BRENDSHËM 59

TITULLI II LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE 60

KREU 1 Bashkimi doganor 60

KREU 2 Bashkëpunimi doganor 61

KREU 3 Ndalimi i kufizimeve sasiore midis Shteteve Anëtare 61

TITULLI III BUJQËSIA DHE PESHKIMI 62

TITULLI IV LËVIZJA E LIRË E PERSONAVE, SHËRBIMEVE DHE KAPITALEVE 66

KREU 1 Punonjësit 66

KREU 2 E drejta e vendosjes 68

KREU 3 Shërbimet 70

KREU 4 Kapitali dhe pagesat 72

TITULLI V ZONA E LIRISË, SIGURISË DHE DREJTËSISË 73

KREU 1 Dispozita të përgjithshme 73

KREU 2 Politikat për kontrollet kufitare, azilin dhe imigrimin 76

KREU 3 Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile 78

KREU 4 Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale 79

KREU 5 Bashkëpunimi policor 82

TITULLI VI TRANSPORTI 84

TITULLI VII RREGULLAT E PËRBASHKËTA PËR KONKURRENCËN, TATIMET DHE PËRAFRIMIN E LEGJISLACIONIT 87

KREU 1 Rregullat për konkurrencën 87

Seksioni 1 Rregullat që zbatohen për ndërmarrjet 87

Seksioni 2 Ndihmat që japin Shtetet 90

KREU 2 Dispozitat tatimore 92

KREU 3 Përafrimi i legjislacionit 93

TITULLI VIII POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE 95

KREU 1 Politika ekonomike 95

KREU 2 Politika monetare 100

KREU 3 Dispozita institucionale 103

KREU 4 Dispozita të veçanta për Shtetet Anëtare monedha e të cilave është euro 104

KREU 5 Dispozita kalimtare 105

TITULLI IX PUNËSIMI 108

TITULLI X POLITIKA SOCIALE 110

TITULLI XI FONDI SOCIAL EUROPIAN 115
TITULLI XII ARSIMI, FORMIMI PROFESIONAL, RINIA DHE SPORTI 116
TITULLI XIII KULTURA 118
TITULLI XIV SHËNDETI PUBLIK 118
TITULLI XV MBROJTJA E KONSUMATORIT 120
TITULLI XVI RRJETET TRANS-EUROPIANE 120
TITULLI XVII INDUSTRIA 122
TITULLI XVIII KOHEZIONI EKONOMIK, SOCIAL DHE TERRITORIAL 123
TITULLI XIX KËRKIMI DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK DHE HAPËSIRA 124
TITULLI XX MJEDISI 128
TITULLI XXI ENERGJETIKA 130
TITULLI XXII TURIZMI 130
TITULLI XXIII MBROJTJA CIVILE 131
TITULLI XXIV BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV 131
PJESA E KATËRT ASOCIIMI I VENDEVE DHE TERRITOREVE JASHTË EUROPËS 132
PJESA E PESTË VEPRIMI I JASHTËM I BASHKIMIT 134
TITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR VEPRIMIN E JASHTËM TË BASHKIMIT 134
TITULLI II POLITIKA E PËRBASHKËT TREGTARE 134
TITULLI III BASHKËPUNIMI ME VENDET E TRETA DHE NDIHMA HUMANITARE 136
KREU 1 Bashkëpunimi për zhvillim 136
KREU 2 Bashkëpunimi ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta 137
KREU 3 Ndihma humanitare 138
TITULLI IV MASAT KUFIZUESE 138
TITULLI V MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE 139
TITULLI VI MARRËDHËNIET E BASHKIMIT ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE VENDET E TRETA DHE DELEGACIONET E BASHKIMIT 142
TITULLI VII KLAUZOLA E SOLIDARITETIT 142
PJESA E GJASHTË DISPOZITA INSTITUCIONALE DHE FINANCIARE 143

TITULLI I DISPOZITA INSTITUCIONALE 143
KREU 1 Institucionet 143
Seksioni 1 Parlamenti Europian 143
Seksioni 2 Këshilli Europian 147
Seksioni 3 Këshilli 147
Seksioni 4 Komisioni 149
Seksioni 5 Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian 151
Seksioni 6 Banka Qendrore Europiane 160
Seksioni 7 Gjykata e Audituesve 162
KREU 2 Aktet juridike të Bashkimit, procedurat e miratimit dhe dispozita të tjera 164
Seksioni 1 Aktet juridike të Bashkimit 164
Seksioni 2 Procedura për miratimin e akteve dhe dispozitave të tjera 166
KREU 3 Organet këshillimore të Bashkimit 170
Seksioni 1 Komiteti Ekonomik dhe Social 170
Seksioni 2 Komiteti i Rajoneve 171
KREU 4 Banka Europiane e Investimeve 172
TITULLI II DISPOZITA FINANCIARE 173
KREU 1 Burimet e veta të Bashkimit 174
KREU 2 Kuadri financiar shumëvjeçar 174
KREU 3 Buxheti vjetor i Bashkimit 175
KREU 4 Zbatimi i buxhetit dhe aprovimi i realizimit 178
KREU 5 Dispozita të përbashkëta 179
KREU 6 Lufta kundër krimit ekonomik 180
TITULLI III BASHKËPUNIMI I PËRFORCUAR 181
PJESA E SHTATË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE TË FUNDIT 184

PROTOKOLLET 191
Protokolli (nr. 1) për rolin e parlamenteve kombëtare në Bashkimin Europian 192
Protokolli (nr. 2) për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit 195

Protokolli (nr. 3)	për statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian	198
Protokolli (nr. 4)	për statutin e sistemit europian të bankave qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane	219
Protokolli (nr. 5)	për statutin e Bankës Europiane të Investimeve	239
Protokolli (nr. 6)	për vendndodhjen e selive të institucioneve dhe disa organizmave, zyrave, agjencive dhe departamenteve të Bashkimit Europian	252
Protokolli (nr. 7)	për privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Europian	253
Protokolli (nr. 8)	në lidhje me neni 6 pika 2 të Traktatit për Bashkimin Europian për aderimin e Bashkimit Europian në Konventën Europiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut	260
Protokolli (nr. 9)	për vendimin e këshillit në lidhje me zbatimin e nenit 16 pika 4 të traktatit për bashkimin europian dhe nenin 238 pika 2 të traktatit për funksionimin e bashkimit europian ndërmjet 1 nëntorit 2014 dhe 31 marsit 2017 nga njëra anë dhe që nga 1 prilli 2017 nga ana tjetër	261
Protokolli (nr. 10)	për bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar krijuar me nenin 42 të Traktatit për Bashkimin Europian	262
Protokolli (nr. 11)	për nenin 42 të Traktatit për Bashkimin Europian	265
Protokolli (nr. 12)	për procedurën e deficitit të tepërt	266
Protokolli (nr. 13)	për kriteret e konvergjencës	267
Protokolli (nr. 14)	për Euro Grupin	269
Protokolli (nr. 15)	për disa dispozita në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	270
Protokolli (nr. 16)	për disa dispozita në lidhje me Danimarkën	272
Protokolli (nr. 17)	për Danimarkën	273
Protokolli (nr. 18)	për Francën	274
Protokolli (nr. 19)	për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian	275
Protokolli (nr. 20)	për zbatimin e disa aspekteve të nenit 26 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Irlandë	278
Protokolli (nr. 21)	për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë	280
Protokolli (nr. 22)	për qëndrimin e Danimarkës	283
Protokolli (nr. 23)	për marrëdhëniet e jashtme të shteteve anëtare në lidhje me kalimin e kufijve të jashtëm	289
Protokolli (nr. 24)	për azilin për shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Europian	290

Protokolli (nr. 25) për ushtrimin e kompetencave të përbashkëta 292

Protokolli (nr. 26) për shërbimet me interes të përgjithshëm 293

Protokolli (nr. 27) për tregun e brendshëm dhe konkurrencën 294

Protokolli (nr. 28) për kohezionin ekonomik, social dhe territorial 295

Protokolli (nr. 29) për sistemin e transmetimit publik në shtetet anëtare 297

Protokolli (nr. 30) për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian në Poloni dhe në Mbretërinë e Bashkuar 298

Protokolli (nr. 31) në lidhje me importin në Bashkimin Europian të produkteve të naftës së rafinuar në Antilet Holandeze 300

Protokolli (nr. 32) për blerjen e pronave në Danimarkë 303

Protokolli (nr. 33) në lidhje me nenin 157 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 304

Protokolli (nr. 34) për masa të veçanta për Groenlandën 305

Protokolli (nr. 35) për nenin 40.3.3 të kushtetutës së Irlandës 306

Protokolli (nr. 36) për dispozitat kalimtare 307

Protokolli (nr. 37) për pasojat financiare të mbarimit të Traktatit të KEQÇ-së dhe për Fondin e Kërkimeve për Qymyrgurin dhe Çelikun 313

SHTOJCA 315

SHTOJCA I LISTA E PËRMENDUR NË NENIN 38 TË TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN 316

SHTOJCA II VENDET DHE TERRITORET JASHTË EUROPËS PËR TË CILAT ZBATOHEN DISPOZITAT E PJESËS SË KATËRT TË TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN 319

DEKLARATA 321
bashkëlidhur Aktit Final të Konferencës Ndërqeveritare që miratoi Traktatin e Lisbonës, nënshkruar më 13 dhjetor 2007

A. DEKLARATA NË LIDHJE ME DISPOZITAT E TRAKTATEVE 322

1. Deklaratë në lidhje me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian 322

2. Deklaratë për nenin 6 pika 2 të Traktatit për Bashkimin Europian 322

3. Deklaratë për nenin 8 të Traktatit për Bashkimin Europian 322

4. Deklaratë për përbërjen e Parlamentit Europian 322

5. Deklaratë për miratimin politik nga Këshilli Europian në lidhje me projekt-Vendimin për përbërjen e Parlamentit Europian 322

6. Deklaratë për nenin 15 pika 5 dhe 6, nenin 17 pika 6 dhe 7 dhe nenin 18 të Traktatit për Bashkimin Europian 322

7. Deklaratë për nenin 16 pika 4 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 238 pika 2 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 323

8. Deklaratë për masat praktike që duhet të merren me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës në lidhje me Presidencën e Këshillit Europian dhe Këshillin e Punëve të Jashtme 325

9. Deklaratë për nenin 16 pika 9 të Traktatit për Bashkimin Europian në lidhje me vendimin e Këshillit Europian për ushtrimin e Presidencës së Këshillit 325

10. Deklaratë për nenin 17 të Traktatit për Bashkimin Europian 326

11. Deklaratë për nenin 17 pika 6 dhe 7 të Traktatit për Bashkimin Europian 326

12. Deklaratë për nenin 18 të Traktatit për Bashkimin Europian 327

13. Deklaratë në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë 327

14. Deklaratë në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë 327

15. Deklaratë për nenin 27 të Traktatit për Bashkimin Europian 328

16. Deklaratë për nenin 55 pika 2 të Traktatit për Bashkimin Europian 328

17. Deklaratë në lidhje me epërsinë 328

18. Deklaratë në lidhje me ndarjen e kompetencave 329

19. Deklaratë për nenin 8 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 329

20. Deklaratë për nenin 16 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 329

21. Deklaratë për mbrojtjen e të dhënave personale në fushat e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale dhe bashkëpunimit policor 329

22. Deklaratë për nenin 48 dhe 79 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 330

23. Deklaratë për paragrafin e dytë të nenit 48 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 330

24. Deklaratë në lidhje me personalitetin juridik të Bashkimit Europian 330

25. Deklaratë për nenin 75 dhe 215 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 330

26. Deklaratë për mospjesëmarrjen e një Shteti Anëtar në një masë bazuar në Titullin V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 330

27. Deklaratë për nenin 85 pika 1, paragrafi i dytë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 331

28. Deklaratë për nenin 98 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 331

29. Deklaratë për nenin 107 pika 2 germa (c) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 331

30. Deklaratë për nenin 126 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 331

31. Deklaratë për nenin 156 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 332

32. Deklaratë për nenin 168 pika 4 germa (c) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 332

33. Deklaratë për nenin 174 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 332

34. Deklaratë për nenin 179 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 333

35. Deklaratë për nenin 194 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 333

36. Deklaratë për nenin 218 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në lidhje me negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare nga Shtetet Anëtare në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë 333

37. Deklaratë për nenin 222 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 333

38. Deklaratë për nenin 252 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit në lidhje me numrin e Avokatëve të Përgjithshëm në Gjykatën e Drejtësisë 333

39. Deklaratë për nenin 290 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 334

40. Deklaratë për nenin 329 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 334

41. Deklaratë për nenin 352 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 334

42. Deklaratë për nenin 352 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 334

43. Deklaratë për nenin 355 pika 6 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 334

B. DEKLARATA NË LIDHJE ME PROTOKOLLET BASHKËLIDHUR TRAKTATEVE 335

44. Deklaratë për nenin 5 të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian 335

45. Deklaratë për nenin 5 pika 2 të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian 335

46. Deklaratë për nenin 5 pika 3 të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian 335

47. Deklaratë për nenin 5 pika 3, 4 dhe 5 të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian 335

48. Deklaratë në lidhje me Protokollin për qëndrimin e Danimarkës 335

49. Deklaratë në lidhje me Italinë 336

50. Deklaratë për nenin 10 të Protokollit për dispozitat kalimtare 336

C. DEKLARATA NGA SHTETET ANËTARE 337

51. Deklaratë nga Mbretëria e Belgjikës për parlamentet kombëtare 337

52. Deklaratë nga Mbretëria e Belgjikës, Republika e Bullgarisë, Republika Federale e Gjermanisë, Republika Greke, Mbretëria e Spanjës, Republika Italiane, Republika e Qipros, Republika e Lituanisë, Dukati i Madh i Luksemburgut, Republika e Hungarisë, Republika e Maltës, Republika e Austrisë, Republika Portugeze, Rumania, Republika e Sllovenisë dhe Republika Sllovake për simbolet e Bashkimit Europian 337

53. Deklaratë nga Republika Çeke për Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian 337

54. Deklaratë nga Republika Federale e Gjermanisë Irlanda, Republika e Hungarisë Republika e Austrisë dhe Mbretëria e Suedisë 338

55. Deklaratë nga Mbretëria e Spanjës dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut 338

56. Deklaratë nga Irlanda për nenin 3 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë 338

57. Deklaratë nga Republika Italiane për përbërjen e Parlamentit Europian 338

58. Deklaratë nga Republika e Letonisë, Republika e Hungarisë Republika e Maltës për mënyrën se si shkruhet emri i monedhës së vetme në Traktate 339

59. Deklaratë nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta për nenin 312 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 339

60. Deklaratë nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta për nenin 355 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 339

61. Deklaratë nga Republika e Polonisë për Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian 339

62. Deklaratë nga Republika e Polonisë në lidhje me Protokollin për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian në lidhje me Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar 340

63. Deklaratë nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për përkufizimin e termit „shtetas“ 340

64. Deklaratë nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për të drejtën e votës për zgjedhjet në Parlamentin Europian 340

65. Deklaratë nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për nenin 75 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian 340

Tabelat e barasvlershmërisë 343

Traktati për Bashkimin Europian 343

Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian 348

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE E BASHKIMIT EUROPIAN 371

PREAMBULA 372

TITULLI I DINJITETI 373

TITULLI II LIRITË 374

TITULLI III BARAZIA 377

TITULLI IV SOLIDARITETI 378

TITULLI V TË DREJTAT E SHTETASVE 381

TITULLI VI DREJTËSIA 383

TITULLI VII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË INTERPRETIMIN DHE ZBATIMIN E KARTËS 384

T
B
E

VERSIONI I KONSOLIDUAR

I

TRAKTATIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

PREAMBULA

MADHËRIA E TIJ MBRETI I BELGËVE, MADHËRIA E SAJ MBRETËRESHA E DANIMARKËS, PRESIDENTI I REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PRESIDENTI I IRLANDËS, PRESIDENTI I REPUBLIKËS GREKE, MADHËRIA E TIJ MBRETI I SPANJËS, PRESIDENTI I REPUBLIKËS FRANCEZE, PRESIDENTI I REPUBLIKËS ITALIANE, LARTMADHËRIA E TIJ MBRETËRORE DUKA I MADH I LUKSEMBURGUT, MADHËRIA E SAJ MBRETËRESHA E VENDEVE TË ULËTA, PRESIDENTI I REPUBLIKËS PORTUGEZE, MADHËRIA E SAJ MBRETËRESHA E MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT, [1]

TË VENDOSUR për të shënuar një fazë të re në procesin e integrimit Europian të filluar me themelimin e Komuniteteve Europiane,

TË FRYMËZUAR nga trashëgimia kulturore, fetare dhe humaniste e Europës, nga e cila janë zhvilluar vlerat universale të të drejtave të padhunueshme dhe të patjetërsueshme të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës.

DUKE KUJTUAR rëndësinë historike të dhënies fund të ndarjes së kontinentit të Europës dhe nevojën për të krijuar baza të forta për ndërtimin e Europës së të ardhmes,

DUKE KONFIRMUAR respektimin prej tyre të parimeve të lirisë, demokracisë dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të shtetit të së drejtës.

DUKE KONFIRMUAR respektimin prej tyre të të drejtave themelore sociale të parashikuara në Kartën Sociale Europiane në Torino, më 18 tetor 1961 dhe në Kartën e Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale të Punonjësve e vitit 1989,

DUKE DËSHIRUAR forcimin e solidaritetit midis popujve të tyre, duke respektuar ndërkohë historinë, kulturën dhe traditat e tyre,

DUKE DËSHIRUAR përmirësimin e mëtejshëm të funksionimit demokratik dhe efektiv të institucioneve, në mënyrë që atyre tu jepet mundësia për të kryer më mirë dhe brenda një kuadri të vetëm institucional, detyrat që u janë besuar,

TË VENDOSUR për të arritur fuqizimin dhe konvergimin e ekonomive të tyre dhe për të krijuar një bashkim ekonomik dhe monetar, duke përfshirë, në përputhje me dispozitat e këtij Traktati dhe të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian edhe një monedhë të vetme dhe të qëndrueshme,
TË VENDOSUR për të nxitur përparimin ekonomik dhe shoqëror për popujt e tyre, duke mbajtur parasysh parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe brenda kuadrit të arritjes së tregut të brendshëmtë kohezionit të përforcuar dhe mbrojtjes së mjedisit, dhe për të vënë në jetë politika që sigurojnë që përparimet në fushën e integrimit ekonomik të shoqërohen me përparim të njëkohshëm edhe në fushat e tjera,

---

[1] Prej atëherë, në Bashkimin Europian janë anëtarësuar edhe Republika e Bullgarisë, Republika Çeke, Republika e Estonisë, Irlanda, Republika e Greqisë, Mbretëria e Spanjës, Republika e Qipros, Republika e Letonisë, Republika e Lituanisë, Republika e Hungarisë, Republika e Maltës, Republika e Austrisë, Republika e Polonisë, Republika Portugeze, Rumania, Republika e Sllovenisë, Republika Sllovake, Republika e Finlandës, Mbretëria e Suedisë dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

TË VENDOSUR për të krijuar një qytetari të përbashkët për shtetasit e vendeve të tyre,

TË VENDOSUR për të zbatuar një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, përfshirë edhe përcaktimin progresiv të një politike të përbashkët për mbrojtjen, e cila mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët, sipas dispozitave të nenit 42, me të cilin përforcohet identiteti europian dhe pavarësia e saj në mënyrë që të nxitet paqja, siguria dhe progresi në Europë dhe në botë,

TË VENDOSUR për të mundësuar lëvizjen e lirë të njerëzve, duke siguruar në të njëjtën kohë, sigurinë e popujve të tyre, përmes krijimit të një zone lirie, sigurie dhe drejtësie, sipas dispozitave të këtij Traktati dhe të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian,

TË VENDOSUR për të vijuar procesin e krijimit të një bashkimi gjithnjë e më të afërt mes popujve të Europës, në të cilin vendimet merren sa më pranë qytetarit, sipas parimit të subsidiaritetit,

DUKE PASUR PARASYSH hapat e mëtejshëm që duhen bërë për ta çuar përpara integrimin europian,

VENDOSËN të themelojnë një Bashkim Europian dhe, për këtë qëllim, kanë emëruar si të plotfuqishmit e tyre:

(Lista e të plotfuqishmëve nuk jepet këtu)

TË CILËT, pasi shkëmbyen plotfuqitë, që u konstatuan si të vlefshme dhe të rregullta, ranë dakord si vijon:

TITULLI I

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 1
(ish-neni 1 TBE)[2]

Me anë të këtij Traktati, Palët e Larta Kontraktuese, themelojnë ndërmjet tyre një BASHKIM EUROPIAN, i quajtur më poshtë "Bashkimi", të cilit Shtetet Anëtare i japin kompetenca për të arritur objektivat e tyre të përbashkëta.

Ky Traktat shënon një fazë të re në procesin e krijimit të një bashkimi gjithnjë e më të afërt mes popujve të Europës, në të cilin vendimet merren sa më hapur dhe sa më pranë qytetarit.

Bashkimi themelohet mbi këtë Traktat dhe mbi Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian (të quajtura më poshtë "Traktatet"). Këto dy Traktate kanë të njëjtën fuqi ligjore. Bashkimi zëvendëson dhe vijon Komunitetin Europian.

---

[2] Këto referenca janë thjesht orientuese. Për informacion më të plotë, ju lutemi shihni tabelat e barasvlefshmërisë ndërmjet numërtimit të vjetër dhe të ri të Traktateve.

Neni 2

Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën mbisundon pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave.

Neni 3
(ish-neni 2 TBE)

1. Bashkimi ka për qëllim nxitjen e paqes, vlerave të tij dhe mirëqenies së popujve të tij.

2. Bashkimi u ofron qytetarëve të tij një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie pa kufij të brendshëm, në të cilën sigurohet lëvizja e lirë e njerëzve së bashku me masat e duhura sa i takon kontrollit të kufijve, azilit, imigracionit dhe parandalimit e luftës kundër krimit.

3. Bashkimi krijon një treg të brendshëm. Ai punon për zhvillimin e qëndrueshëm të Europës, mbështetur në rritjen e drejtpeshuar ekonomike dhe qëndrueshmërinë e çmimeve, një ekonomi tregu sociale tejet konkurruese, duke synuar punësimin e plotë dhe përparimin shoqëror si dhe një nivel të lartë mbrojtjeje dhe përmirësimi të cilësisë së mjedisit. Ai nxit përparimin shkencor dhe teknologjik.

Bashkimi lufton përjashtimin social dhe diskriminimin, nxit drejtësinë dhe mbrojtjen sociale, barazinë midis grave dhe burrave, solidaritetin midis brezave si dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ai nxit kohezionin ekonomik, social dhe territorial si dhe solidaritetin mes Shteteve Anëtare.

Ai respekton larminë e pasur kulturore dhe gjuhësore dhe siguron mbrojtjen dhe rritjen e trashëgimisë kulturore të Europës.

4. Bashkimi krijon një bashkim ekonomik dhe monetar, monedha e të cilit është euro.

5. Në marrëdhëniet me botën, Bashkimi mban dhe nxit vlerat dhe interesat e veta si dhe jep kontribut në mbrojtjen e qytetarëve të tij. Ai kontribuon për paqen, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Tokës, solidaritetin dhe respektin e ndërsjellë midis popujve, tregtinë e lirë dhe të ndershme, zhdukjen e varfërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të të drejtave të fëmijëve, si edhe zbatimin rigoroz dhe zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe respektimin e parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

6. Bashkimi i arrin objektivat e tij përmes mjeteve të duhura, brenda kompetencave që i japin Traktatet.

Neni 4

1. Në përputhje me nenin 5, kompetencat që Traktatet nuk ia japin Bashkimit, u mbeten Shteteve Anëtare.

2. Bashkimi respekton barazinë e Shteteve Anëtare përpara Traktateve si edhe identitetet e tyre kombëtare, që janë të pandara nga strukturat e tyre themelore, politike dhe kushtetuese, duke përfshirë edhe vetëqeverisjen rajonale dhe vendore. Ai respekton funksionet shtetërore themelore të tyre, duke përfshirë integritetin territorial të Shtetit, ruajtjen e ligjit dhe rendit dhe mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Në veçanti, siguria kombëtare mbetet përgjegjësi e vetme e secilit Shtet Anëtar.

3. Në bazë të parimit të bashkëpunimit të sinqertë, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, bazuar në respektin e ndërsjellë, e mbështetin njëri-tjetrin në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga Traktatet.

Shtetet Anëtare marrin masat e duhura, të përgjithshme ose të posaçme, për të siguruar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet ose nga aktet e institucioneve të Bashkimit.

Shtetet Anëtare ia lehtësojnë Bashkimit arritjen e detyrave të tij dhe heqin dorë nga çdo masë e cila do të vinte në rrezik arritjen e objektivave të Bashkimit.

Neni 5
(ish-neni 5 TKE)

1. Kufijtë e kompetencave të Bashkimit rregullohen përmes parimit të delegimit. Ushtrimi i kompetencave të Bashkimit rregullohet nga parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

2. Sipas parimit të delegimit, Bashkimi vepron vetëm brenda kufijve të kompetencave, që ia kanë deleguar atij Shtetet Anëtare përmes Traktateve, për arritjen e objektivave të parashikuar në to. Kompetencat që Traktatet nuk ia japin Bashkimit, u mbeten Shteteve Anëtare.

3. Sipas parimit të subsidiaritetit, për fushat që nuk bien në kompetencën ekskluzive të tij, Bashkimi vepron vetëm nëse dhe për aq sa objektivat e veprimit të propozuar nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare në nivel qendror ose në nivel rajonal dhe vendor, por mund të arrihen më mirë në nivel Bashkimi duke pasur parasysh shkallën apo efektet e veprimit të propozuar.

Institucionet e Bashkimit e zbatojnë parimin e subsidiaritetit, siç parashikohet në Protokollin për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Parlamentet Kombëtare garantojnë respektimin e parimit të subsidiaritetit, në përputhje me procedurën e parashikuar në atë Protokoll.

4. Sipas parimit të proporcionalitetit, përmbajtja dhe forma e veprimit të Bashkimit nuk tejkalojnë kufijtë e asaj që është e nevojshme për arritjen e objektivave të Traktateve.

Institucionet e Bashkimit e zbatojnë parimin e proporcionalitetit, siç parashikohet në Protokollin për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

Neni 6
(ish-neni 6 TBE)

1. Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, datë 7 dhjetor 2000, siç u përshtat në Strasburg , më 12 dhjetor 2007, e cila ka të njëjtën fuqi ligjore me Traktatet.

Dispozitat e Kartës nuk i zgjerojnë në asnjë mënyrë kompetencat e Bashkimit, që parashikohen në Traktatet.

Të drejtat, liritë dhe parimet e Kartës interpretohen në përputhje me dispozitat e përgjithshme të Titullit VII të Kartës, që rregullojnë interpretimin dhe zbatimin e saj dhe duke pasur në konsideratë shpjegimet e përmendura në Kartë, të cilat përcaktojnë burimet e dispozitave të saj.

2. Bashkimi anëtarësohet në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Ky anëtarësim nuk i prek kompetencat e Bashkimit që përcaktohen në Traktatet.

3. Të drejtat themelore, siç garantohen nga Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe siç rrjedhin nga traditat kushtetuese që janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare, përbëjnë parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit.

Neni 7
(ish-neni 7 TBE)

1. Me propozimin e arsyetuar të një të tretës së Shteteve Anëtare, të Parlamentit Europian ose të Komisionit Europian, Këshilli me shumicë prej katër të pestave të anëtarëve të tij, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, mund të konstatojë se ekziston një rrezik i qartë i shkeljes së vlerave të përmendura në nenin 2 nga një Shtet Anëtar. Përpara se të konstatohet ky fakt, Këshilli e dëgjon Shtetin Anëtar në fjalë dhe mund t'i japë atij rekomandime, duke vepruar në përputhje me të njëjtën procedurë.

Këshilli verifikon rregullisht nëse vazhdojnë të mbeten arsyet e një konstatimi të tillë.

2. Këshilli Europian, duke vepruar unanimisht me propozim të një të tretës së Shteteve Anëtare ose të Komisionit dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, mund të konstatojë praninë e një shkeljeje të rëndë dhe të vazhdueshme të vlerave të përmendura në nenin 2 nga një Shtet Anëtar, pasi i kërkon Shtetit Anëtar në fjalë të paraqesë vërejtjet e tij.

3. Kur bëhet konstatimi sipas paragrafit 2, Këshilli, me shumicë të cilësuar, mund të vendosë të pezullojë disa të drejta të caktuara që rrjedhin nga zbatimi i traktateve për Shtetin Anëtar në fjalë, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e votës së përfaqësuesit të qeverisë të këtij Shteti Anëtar në Këshill. Kur vepron kështu, Këshilli merr në konsideratë pasojat e mundshme të një pezullimi të tillë mbi të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë.

Detyrimet e Shtetit Anëtar në fjalë, në kuadër të këtij Traktati, në çdo rast vazhdojnë të jenë detyruese për këtë Shtet.

4. Këshilli, me shumicë të cilësuar, mund të vendosë më pas t'i ndryshojë ose anulojë masat e marra në bazë të paragrafit 3, në përgjigje të ndryshimeve të situatës e cila çoi në vendosjen e tyre.

5. Rregullat e votimit që zbatohen për Parlamentin Europian, Këshillin Europian dhe Këshillin, për qëllimet e këtij neni, parashikohen në nenin 354 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 8

1. Bashkimi ndërton marrëdhënie të veçanta me vendet fqinje, me qëllim krijimin e një zone begatie e fqinjësie të mirë, të bazuar në vlerat e Bashkimit dhe të karakterizuar nga marrëdhënie të ngushta dhe paqësore bashkëpunimi.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, Bashkimi mund të lidhë marrëveshje të veçanta me vendet përkatëse. Këto marrëveshje mund të përmbajnë të drejta dhe detyrime të ndërsjella si dhe mundësinë e ndërmarrjes së aktiviteteve të përbashkëta. Zbatimi i tyre i nënshtrohet konsultimit periodik.

TITULLI II

DISPOZITAT PËR PARIMET DEMOKRATIKE

Neni 9

Në të gjitha veprimtaritë e veta, Bashkimi respekton parimin e barazisë së qytetarëve të tij, të cilët marrin vëmendje të barabartë nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e tij. Çdo shtetas i një Shteti Anëtar është qytetar i Bashkimit. Qytetaria e Bashkimit i shtohet dhe nuk e zëvendëson nënshtetësinë.

Neni 10

1. Funksionimi i Bashkimit i ka themelet te demokracia përfaqësuese.

2. Shtetasit përfaqësohen drejtpërdrejt në nivel të Bashkimit, në Parlamentin Europian.

Shtetet Anëtare përfaqësohen në Këshillin Europian nga Kreu i Shtetit ose i Qeverisë dhe në Këshill nga qeveritë e tyre, të cilat në vetvete përgjigjen në mënyrë demokratike përpara parlamenteve të tyre ose përpara qytetarëve të tyre.

3. Çdo qytetar ka të drejtën e pjesëmarrjes në jetën demokratike të Bashkimit. Vendimet merren sa më hapur dhe sa më pranë qytetarit.

4. Partitë politike në nivel europian kontribuojnë në formimin e ndërgjegjësimit politik europian dhe në shprehjen e vullnetit të qytetarëve të Bashkimit.

Neni 11

1. Institucionet, përmes mjeteve të duhura, u japin qytetarëve dhe shoqatave përfaqësuese mundësinë për t'i bërë të ditura dhe për t'i shprehur publikisht pikëpamjet e tyre në të gjitha fushat e veprimit të Bashkimit.

2. Institucionet mbajnë një dialog të hapur, transparent dhe të rregullt me shoqatat përfaqësuese dhe shoqërinë civile.

3. Komisioni Europian bën konsultime të gjera me palët e interesuara, për të siguruar që veprimet e Bashkimit të jenë koherente dhe transparente.

4. Jo më pak se një milion qytetarë, të cilët janë shtetas të një numri të konsiderueshëm të Shteteve Anëtare mund të marrin nismën për t'i kërkuar Komisionit Europian, brenda kuadrit të kompetencave të tij, të paraqesë një propozim të caktuar për çështje për të cilat shtetasit mendojnë se është i nevojshëm një akt ligjor i Bashkimit, me qëllim zbatimin e Traktateve.

Procedurat dhe kushtet, që kërkohen për një nismë të tillë të qytetarëve, vendosen në përputhje me nenin 24, paragrafi i parë, të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 12

Parlamentet kombëtare kontribuojnë aktivisht në funksionimin e mirë të Bashkimit:

(a) duke u informuar nga institucionet e Bashkimit dhe duke marrë projektaktet legjislative të Bashkimit në zbatim të Protokollit për rolin e Parlamenteve kombëtare në Bashkimin Europian;

(b) duke u kujdesur që parimi i subsidiaritetit respektohet në përputhje me procedurat e parashikuara në Protokollin për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit;

(c) brenda kuadrit të zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, duke marrë pjesë në mekanizmat vlerësuese për vënien në zbatim të politikave të Bashkimit në këtë zonë, në përputhje me nenin 70 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, dhe duke u përfshirë në monitorimin politik të Europol-it si dhe vlerësimin e veprimtarive të Eurojust-it, në zbatim të neneve 88 dhe 85 të këtij Traktati;

(d) duke marrë pjesë në procedurat e rishikimit të traktateve, në zbatim të nenit 48 të këtij Traktati;

(e) duke marrë njoftim mbi kërkesat për anëtarësim në Bashkimin, në zbatim të nenit 49 të këtij Traktati;

(f) duke marrë pjesë në bashkëpunimin ndërparlamentar midis parlamenteve kombëtare dhe me Parlamentin Europian, në përputhje me Protokollin për rolin e Parlamenteve kombëtare në Bashkimin Europian.

TITULLI III

DISPOZITA PËR INSTITUCIONET

Neni 13

1. Bashkimi ka një kuadër institucional që ka si qëllim të promovojë vlerat e tij, të çojë përpara objektivat e tij, t'u shërbejë interesave të tij, të qytetarëve të tij dhe të Shteteve Anëtare dhe të sigurojë njëtrajtshmërinë, efektshmërinë dhe vijimësinë e politikave dhe masave të tij.
Institucionet e Bashkimit janë:

- Parlamenti Europian,

- Këshilli Europian,

- Këshilli,

- Komisioni Europian (i quajtur më poshtë "Komisioni"),

- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian,

- Banka Qendrore Europiane,

- Gjykata e Audituesve.

2. Secili institucion vepron brenda kufijve të kompetencave që u japin Traktatet dhe në përputhje me procedurat, kushtet dhe objektivat që përcaktohen në to. Institucionet praktikojnë bashkëpunim të sinqertë të ndërsjellë.

3. Dispozita të lidhura me Bankën Qendrore Europiane dhe Gjykatën e Audituesve si dhe dispozita të hollësishme për institucionet e tjera parashikohen në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian.

4. Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni mbështeten nga Komiteti Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve, të cilët veprojnë me cilësi këshillimore.

Neni 14

1. Parlamenti Europian ushtron bashkërisht me Këshillin funksione legjislative dhe buxhetore. Parlamenti ushtron funksione të kontrollit politik dhe të konsultimit, sikurse parashikohet në Traktatet. Ai zgjedh Presidentin e Komisionit.

2. Parlamenti Europian përbëhet nga përfaqësuesit e qytetarëve të Bashkimit. Numri i tyre nuk është më i madh se shtatëqind e pesëdhjetë, plus Kryetarin. Numri i përfaqësuesve të qytetarëve është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin e popullsisë së Shtetit Anëtar, por pa rënë asnjëherë nën gjashtë deputetë për Shtet Anëtar. Asnjë Shtet Anëtar nuk merr më shumë se nëntëdhjetë e gjashtë vende.

Këshilli Europian miraton unanimisht, me nismë të Parlamentit Europian dhe me pëlqimin e tij, një vendim për përbërjen e Parlamentit Europian, duke respektuar parimet e përmendura në nënparagrafin e parë.

3. Deputetët e Parlamentit Europian zgjidhen për një mandat prej pesë vjetësh, me votim të drejtpërdrejtë, të përgjithshëm, të lirë dhe të fshehtë.

4. Parlamenti Europian zgjedh Presidentin dhe zyrtarët e vet mes deputetëve të tij.

Neni 15

1. Këshilli Europian i siguron Bashkimit forcën shtytëse për zhvillim dhe përcakton drejtimet e përgjithshme politike dhe përparësitë e tyre. Këshilli Europian nuk ushtron funksione legjislative.

2. Këshilli Europian përbëhet nga Kryetarët e Shtetit ose Qeverisë së Shteteve Anëtare, së bashku me Presidentin e tij dhe Presidentin e Komisionit. Në punimet e tij merr pjesë Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit.

3. Këshilli Europian i thirrur nga Presidenti i tij, mblidhet dy herë çdo gjashtë muaj. Kur e kërkon rendi i ditës, anëtarët e Këshillit Europian mund të vendosin që të mbështeten secili prej tyre nga një ministër dhe, në rastin e Presidentit të Komisionit, nga një anëtar i Komisionit. Kur e kërkon situata, Presidenti thërret një mbledhje të posaçme të Këshillit Europian.

4. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga Traktatet, vendimet e Këshillit Europian merren me konsensus.

5. Këshilli Europian e zgjedh Presidentin e tij me shumicë të cilësuar, për një mandat prej dy vjet e gjysmë, me të drejtë rizgjedhjeje një herë. Në rast të një pengese apo shkeljeje të rëndë, Këshilli Europian mund t'i japë fund mandatit të Presidentit duke ndjekur të njëjtën procedurë.

6. Presidenti i Këshillit Europian:

(a) e drejton dhe e çon përpara punën e tij;

(b) kujdeset për përgatitjen dhe vijimësinë e punës së Këshillit Europian në bashkëpunim me Presidentin e Komisionit dhe duke u mbështetur në punën e Këshillit për Çështje të Përgjithshme;

(c) bën përpjekje për të mundësuar kohezionin dhe konsensusin brenda Këshillit Europian;

(d) i paraqet një raport Parlamentit Europian pas çdo mbledhje të Këshillit Europian.

Presidenti i Këshillit Europian, në nivelin dhe me cilësinë e tij, siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit për çështje që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, pa cenuar kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit.

Presidenti i Këshillit Europian nuk mban post në nivel kombëtar.

Neni 16

1. Këshilli ushtron bashkërisht me Parlamentin Europian funksione legjislative dhe buxhetore. Këshilli kryen funksione të politikëbërjes dhe bashkërendimit, sikurse parashikohen në Traktatet.

2. Këshilli përbëhet nga një përfaqësues i çdo Shteti Anëtar në nivel ministror, i cili mund ta angazhojë qeverinë e Shtetit Anëtar përkatës dhe të votojë për të.

3. Këshilli vepron me shumicë të cilësuar, nëse nuk parashikohet ndryshe nga Traktatet.

4. Duke filluar nga data 1 nëntor 2014, shumica e cilësuar është të paktën 55% e anëtarëve të Këshillit, me përbërjen e të paktën pesëmbëdhjetë prej tyre dhe me përfaqësimin e Shteteve Anëtare që përbëjnë të paktën 65% të popullsisë së Bashkimit.

Pakica bllokuese duhet të përfshijë të paktën katër anëtarë të Këshillit, dhe nëse nuk arrihet kjo atëherë konsiderohet se është arritur shumica e cilësuar.

Masat e tjera organizative që rregullojnë shumicën e cilësuar parashikohen në nenin 238(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

5. Dispozitat kalimtare në lidhje me përkufizimin e shumicës së cilësuar të cilat janë të zbatueshme deri më 31 tetor 2014 dhe ato të cilat janë të zbatueshme duke filluar më 1 nëntor 2014 deri më 31 mars 2017 parashikohen në Protokollin për dispozitat kalimtare.

6. Këshilli mblidhet në disa konfigurime të ndryshme, lista e të cilave miratohet në përputhje me nenin 236 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Këshilli për Çështje të Përgjithshme siguron qëndrueshmërinë e punës së përbërjeve të ndryshme të Këshillit. Ai përgatit dhe siguron ndjekjen e çështjeve të mbledhjeve të Këshillit Europian, në komunikim me Presidentin e Këshillit Europian dhe Komisionin.

Këshilli për Punët e Jashtme përpunon veprimin e jashtëm të Bashkimit, mbështetur në udhëzimet strategjike të parashikuara nga Këshilli Europian, dhe siguron qëndrueshmërinë e veprimit të Bashkimit.

7. Një Komitet i Përfaqësuesve të Përhershëm të Qeverive të Shteteve Anëtare është përgjegjës për përgatitjen e punës së Këshillit.

8. Mbledhjet e Këshillit janë publike kur ai diskuton dhe voton për një projektakt legjislativ. Për këtë qëllim, çdo mbledhje e Këshillit ndahet në dy pjesë në të cilat trajtohen respektivisht çështjet e miratimit të akteve legjislative të Bashkimit dhe veprimtaritë jolegjislative të tij.

9. Kryesia e konfigurimeve të ndryshme të Këshillit, përveç atij të Punëve të Jashtme, mbahet nga përfaqësuesit e Shteteve Anëtare në Këshill, në bazë të një rotacioni të barabartë, në përputhje me kushtet e vendosura në zbatim të nenit 236 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 17

1. Komisioni promovon interesin e përgjithshëm të Bashkimit dhe, për këtë qëllim, merr nismat e duhura. Ai siguron zbatimin e Traktateve dhe të masave të miratuara nga institucionet në zbatim të tyre. Ai mbikëqyr zbatimin e së drejtës së Bashkimit nën kontrollin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian. Ai zbaton buxhetin dhe administron programet. Ai ushtron funksione bashkërenduese, ekzekutuese dhe administruese, që parashikohen në Traktatet. Me përjashtim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, dhe të rasteve të tjera të parashikuara nga Traktatet, ai siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit. Ai çel programimin vjetor dhe shumëvjeçar të Bashkimit, me qëllim arritjen e marrëveshjeve ndërinstitucionale.

2. Aktet legjislative të Bashkimit mund të miratohen vetëm me propozim të Komisionit, nëse nuk parashikohet ndryshe nga Traktatet. Aktet e tjera miratohen me propozim të Komisionit, kur këtë e parashikojnë Traktatet.

3. Mandati i Komisionit është pesë vjet.

Anëtarët e Komisionit zgjidhen në bazë të kompetencave të tyre të përgjithshme dhe angazhimit për Europën, dhe janë persona për pavarësinë e të cilëve nuk ka asnjë dyshim.

Gjatë përmbushjes së përgjegjësive, Komisioni është tërësisht i pavarur. Pa cenuar nenin 18(2), anëtarët e Komisionit nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga asnjë qeveri apo institucion, organ, zyrë a subjekt tjetër. Ata shmangin çdo veprim që nuk përputhet me funksionet e tyre apo me realizimin e detyrave të tyre.

4. Komisioni i emëruar nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës deri më 31 tetor 2014, përbëhet nga një shtetas i secilit Shtet Anëtar, duke përfshirë edhe Presidentin e tij dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, i cili është njëri prej Zëvendëspresidentëve të tij.

5. Duke filluar nga data 1 nëntor 2014, Komisioni do të përbëhet nga një numër anëtarësh, duke përfshirë Presidentin e tij dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, që përkon me dy të tretat e numrit të Shteteve Anëtare, nëse Këshilli Europian, me unanimitet, nuk vendos ta ndryshojë këtë numër.

Anëtarët e Komisionit zgjidhen mes shtetasve të Shteteve Anëtare, në bazë të një sistemi i cili respekton rotacionin e barabartë të Shteteve Anëtare, duke pasqyruar gamën demografike dhe gjeografike të gjithë Shteteve Anëtare. Ky sistem krijohet me unanimitet nga Këshilli Europian, në përputhje me nenin 244 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

6. Presidenti i Komisionit:

(a) jep udhëzimet në bazë të të cilave duhet të punojë Komisioni;

(b) vendos për organizimin e brendshëm të Komisionit, duke siguruar që vepron me qëndrueshmëri, me efikasitet dhe si organ kolegjial;

(c) emëron Zëvendëspresidentët mes anëtarëve të Komisionit, me përjashtim të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit.

Nëse ia kërkon Presidenti, anëtari i Komisionit jep dorëheqjen. Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit jep dorëheqjen në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 18(1), nëse ia kërkon Presidenti.

7. Duke marrë në konsideratë zgjedhjet për Parlamentin Europian dhe pasi zhvillon konsultimet e duhura, Këshilli Europian, duke vepruar me shumicë të cilësuar, i propozon Parlamentit Europian një kandidat për Presidentin e Komisionit. Këtë kandidat e zgjedh Parlamenti Europian me shumicën e deputetëve që e përbëjnë. Nëse nuk merr shumicën e nevojshme, Këshilli Europian, duke vepruar me shumicë të cilësuar, brenda një muaji propozon një kandidat të ri, të cilin e zgjedh Parlamenti Europian duke ndjekur të njëjtën procedurë.

Këshilli, në marrëveshje me Presidentin e zgjedhur, miraton listën e personave të tjerë të cilët i propozon për emërim si anëtarë të Komisionit. Ata përzgjidhen në bazë të propozimeve që bëjnë Shtetet Anëtare, në përputhje me kriteret e parashtruara në paragrafin 3, nënparagrafi i dytë dhe paragrafin 5, nënparagrafi i dytë.

Presidenti, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit dhe anëtarët e tjerë të Komisionit i nënshtrohen si organ votëpëlqimit nga Parlamenti Europian. Pasi merret ky votëpëlqim, Komisioni emërohet me shumicë të cilësuar nga Këshilli Europian.

8. Komisioni si organ jep llogari përpara Parlamentit Europian. Në përputhje me nenin 234 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Parlamenti Europian mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Komisionit. Nëse mocioni miratohet, anëtarët e Komisionit japin dorëheqjen si organ dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit jep dorëheqjen nga detyrat që kryen në Komision.

Neni 18

1. Këshilli Europian, me shumicë të cilësuar, me miratimin e Presidentit të Komisionit, emëron Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit. Këshilli Europian mund t'i japë fund mandatit të tij duke ndjekur të njëjtën procedurë.

2. Përfaqësuesi i Lartë drejton politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit. Përmes propozimeve që bën, ai kontribuon për zhvillimin e kësaj politike, të cilën e realizon siç ia kërkon Këshilli. Kjo vlen edhe për politikën e përbashkët për sigurimin dhe mbrojtjen.
3. Përfaqësuesi i Lartë drejton Këshillin për Punët e Jashtme.

4. Përfaqësuesi i Lartë është njëri prej Zëvendëspresidentëve të Komisionit. Ai siguron qëndrueshmërinë e veprimit të jashtëm të Bashkimit. Brenda Komisionit, ai mban përgjegjësitë që i takojnë nga marrëdhëniet e jashtme si dhe për bashkërendimin e aspekteve të tjera të veprimit të jashtëm të Bashkimit. Gjatë ushtrimit të këtyre përgjegjësive brenda Komisionit, dhe vetëm për to, Përfaqësuesi i Lartë respekton procedurat e Komisionit, për aq sa kjo përputhet me paragrafët 2 dhe 3.

Neni 19

1. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian përfshin Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Përgjithshme dhe gjykatat e specializuara. Ajo garanton respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve.

Shtetet Anëtare sigurojnë rrugë ligjore të mjaftueshme për të siguruar mbrojtjen e efektshme juridike në fushat që mbulon e drejta e Bashkimit.

2. Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga një gjyqtar nga secili Shtet Anëtar. Ajo mbështetet nga Avokatët e Përgjithshëm.

Gjykata e Përgjithshme përfshin të paktën një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar.

Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime dhe që përmbushin kushtet e vendosura në nenet 253 dhe 254 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Ata emërohen për gjashtë vjet, me pëlqimin e përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare. Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm, të cilëve u ka mbaruar mandati, mund të riemërohen.

3. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian në përputhje me Traktatet:

(a) vendos për çështjet e ngritura nga një Shtet Anëtar, një institucion ose një person fizik apo juridik.

(b) jep vendime paragjykimore, me kërkesë të gjykatave të Shteteve Anëtare, për interpretimin e së drejtës së Bashkimit ose vlefshmërinë e akteve të miratuara nga institucionet;

(c) vendos në çështje të tjera të parashikuara nga Traktatet.

TITULLI IV

DISPOZITA PËR BASHKËPUNIMIN E PËRFORCUAR

Neni 20
(ish-nenet nga 27a deri në 27e, nga 40 deri në 40b dhe nga 43 deri në 45 TKE
dhe ish-nenet 11 dhe 11a TKE)

1. Shtetet Anëtare, të cilat dëshirojnë një bashkëpunim të përforcuar mes tyre brenda kuadrit të kompetencave jo ekskluzive të Bashkimit, mund të shfrytëzojnë institucionet dhe t'i ushtrojnë këto kompetenca duke zbatuar dispozitat përkatëse të traktateve, në varësi të caqeve dhe në përputhje me masat e hollësishme të parashikuara në këtë nen dhe në nenet nga 326 deri në 334 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Bashkëpunimi i përforcuar ka si qëllim çuarjen përpara të objektivave të Bashkimit, mbrojtjen e interesave të tij dhe përforcimin e procesit të integrimit të tij. Një bashkëpunim i tillë është i hapur në çdo kohë për të gjitha Shtetet Anëtare, në përputhje me nenin 328 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

2. Vendimi që lejon bashkëpunimin e përforcuar miratohet nga Këshilli, si rrugë e fundit, kur ka konstatuar se objektivat e një bashkëpunimi të tillë nuk mund të arrihen brenda një periudhe të arsyeshme nga Bashkimi si i tërë dhe me kusht që në të të marrin pjesë të paktën nëntë Shtete Anëtare. Këshilli vepron në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 329 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

3. Të gjithë anëtarët e Këshillit mund të marrin pjesë në diskutimet e tij, por në votim marrin pjesë vetëm ata anëtarë të Këshillit të cilët përfaqësojnë Shtetet Anëtare që marrin pjesë në këtë bashkëpunim të përforcuar. Rregullat e votimit parashikohen në nenin 330 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

4. Aktet e miratuara në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar janë të detyrueshme vetëm për Shtetet Anëtare që marrin pjesë në të. Ato nuk konsiderohen pjesë e acquis, që duhet të pranohet nga Shtetet kandidate për anëtarësim në Bashkim.

TITULLI V

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR VEPRIMIN E JASHTËM TË BASHKIMIT DHE DISPOZITA TË VEÇANTA PËR POLITIKËN E PËRBASHKËT TË JASHTME DHE TË SIGURIMIT

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR VEPRIMIN E JASHTËM TË BASHKIMIT

Neni 21

1. Veprimi i Bashkimit në arenën ndërkombëtare orientohet nga parimet që kanë frymëzuar krijimin, zhvillimin dhe zgjerimin e tij dhe të cilat ai kërkon t'i çojë përpara në mbarë botën: demokracia, shteti i së drejtës, të drejta dhe liri themelore të njeriut për të gjithë dhe në mënyrë të pandarë, respektimi i dinjitetit njerëzor, parimet e barazisë dhe solidaritetit dhe respektimi i parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe i së drejtës ndërkombëtare.

Bashkimi kërkon zhvillimin e marrëdhënieve dhe arritjen e partneriteteve me vendet e treta dhe me organizatat ndërkombëtare, rajonale ose botërore, të cilat kanë të përbashkëta parimet e përmendura në nënparagrafin e parë. Ai nxit zgjidhjet shumëpalëshe për problemet e përbashkëta, në veçanti në kuadër të Kombeve të Bashkuara.

2. Bashkimi përcakton dhe ndjek politika dhe veprime të përbashkëta dhe punon për një shkallë të lartë bashkëpunimi në të gjitha fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare, në mënyrë që:

(a) të mbrojë vlerat, interesat themelore, sigurinë, pavarësinë dhe integritetin e tij;

(b) të konsolidojë dhe mbështesë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare;

(c) të ruajë paqen, të parandalojë konfliktet dhe të fuqizojë sigurinë ndërkombëtare, në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, me parimet e Aktit Përfundimtar të Helsinkit dhe me qëllimet e Kartës së Parisit, duke përfshirë edhe ato që lidhen me kufijtë e jashtëm;

(d) të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të vendeve në zhvillim, me qëllim kryesor zhdukjen e varfërisë;

(e) të nxisë integrimin e të gjitha vendeve në ekonominë botërore, duke përfshirë edhe përmes heqjes progresive të kufizimeve mbi tregtinë ndërkombëtare;

(f) të ndihmojë përgatitjen e masave ndërkombëtare për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore botërore, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm;

(g) të mbështetë popujt, vendet dhe rajonet të cilat përballen me fatkeqësi të shkaktuara nga natyra ose njeriu; dhe

(h) të promovojë një sistem ndërkombëtar të mbështetur mbi një bashkëpunim shumëpalësh më të fuqishëm dhe qeverisje globale të mirë.

3. Bashkimi respekton parimet dhe ndjek objektivat e parashtruara në paragrafët 1 dhe 2 gjatë hartimit dhe zbatimit të fushave të ndryshme të veprimit të jashtëm të Bashkimit që mbulohen në këtë Titull dhe në Pjesën V të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, dhe të aspekteve të jashtme të politikave të tjera të tij.

Bashkimi siguron qëndrueshmërinë midis fushave të ndryshme të veprimit të tij të jashtëm dhe midis këtyre fushave dhe politikave të tjera të tij. Këshilli dhe Komisioni, të asistuar nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, garantojnë këtë qëndrueshmëri dhe bashkëpunojnë për këtë qëllim.

Neni 22

1. Mbështetur në parimet dhe objektivat e parashtruara në nenin 21, Këshilli Europian identifikon interesat dhe objektivat strategjike të Bashkimit.

Vendimet e Këshillit Europian për interesat dhe objektivat strategjikë të Bashkimit lidhen me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe me fushat e tjera të veprimit të jashtëm të Bashkimit. Vendime të tilla mund të prekin marrëdhëniet e Bashkimit me një vend ose rajon të veçantë ose mund të ndjekin edhe një qasje tematike. Ato përcaktojnë kohëzgjatjen e tyre dhe mjetet që vendos në dispozicion Bashkimi dhe Shtetet Anëtare.

Këshilli Europian vepron me unanimitet për një rekomandim që vjen nga Këshilli, i miratuar nga ky i fundit sipas masave organizative të parashikuara për secilën fushë. Vendimet e Këshillit Europian zbatohen në përputhje me procedurat e parashikuara nga Traktatet.

2. Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, për fushën e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, dhe Komisioni, për fushat e tjera të veprimit të jashtëm, mund t'i paraqesin Këshillit propozime të përbashkëta.

KREU 2

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR POLITIKËN E PËRBASHKËT TË JASHTME DHE TË SIGURIMIT

SEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 23

Veprimi i Bashkimit në arenën ndërkombëtare, sipas kuptimit të këtij Kreu, bazohet tek parimet, ndjek objektivat dhe realizohet në përputhje me dispozitat e përgjithshme të Kreut 1.

Neni 24
(ish-neni 11 TBE)

1. Kompetenca e Bashkimit në çështjet e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit i mbulon të gjitha fushat e politikës së jashtme dhe të gjitha çështjet e lidhura me sigurinë e Bashkimit, duke përfshirë krijimin progresiv të një politike të përbashkët për mbrojtjen, e cila mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët.

Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurimit u nënshtrohet rregullave dhe procedurave të caktuara. Ajo përcaktohet dhe zbatohet nga Këshilli Europian dhe Këshilli, duke vepruar unanimisht, nëse nuk parashikohet ndryshe nga Traktatet. Përjashtohet miratimi i akteve legjislative. Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurimit vihet në jetë nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit dhe nga Shtetet Anëtare, në përputhje me Traktatet. Roli i veçantë i Parlamentit Europian dhe i Komisionit në këtë fushë përcaktohet nga Traktatet. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian nuk ka juridiksion në lidhje me këto dispozita, me përjashtim të juridiksionit për të vëzhguar respektimin e nenit 40 të këtij Traktati dhe për të shqyrtuar ligjshmërinë e disa vendimeve të caktuara, siç e parashikon paragrafi i dytë i nenit 275 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

2. Brenda kuadrit të parimeve dhe objektivave të veprimit të tij të jashtëm, Bashkimi realizon, përcakton dhe zbaton një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, mbështetur në zhvillimin e solidaritetit të ndërsjellë politik mes Shteteve Anëtare, identifikimin e çështjeve me interes të përgjithshëm dhe arritjen e një shkalle gjithnjë e më të madhe konvergjence të veprimeve të Shteteve Anëtare.

3. Shtetet Anëtare e mbështetin aktivisht dhe pa rezerva politikën e jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit, me frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë dhe e respektojnë veprimin e Bashkimit në këtë fushë.

Shtetet Anëtare punojnë së bashku për ta rritur dhe zhvilluar solidaritetin e tyre të ndërsjellë politik. Ato nuk kryejnë asnjë veprim që bie ndesh me interesat e Bashkimit ose që ka të ngjarë ta ulë efektshmërinë e tij si një forcë kohezive në marrëdhëniet ndërkombëtare.
Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë sigurojnë respektimin e këtyre parimeve.

Neni 25
(ish-neni 12 TBE)

Bashkimi e realizon politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit:

(a) duke përcaktuar orientimet e përgjithshme;

(b) duke miratuar vendime ku përcaktohen:

(i) veprimet që duhet të ndërmarrë Bashkimi;

(ii) qëndrimet që duhet të mbajë Bashkimi;

(iii) masat për zbatimin e vendimeve të përmendura në pikat "i" dhe "ii";

dhe

(c) duke fuqizuar bashkëpunimin e rregullt midis Shteteve Anëtare në realizimin e politikës.

Neni 26
(ish-neni 13 TBE)

1. Këshilli Europian identifikon interesat strategjikë të Bashkimit, vendos objektivat dhe jep orientimet e përgjithshme të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, duke përfshirë çështjet që kanë rrjedhoja për mbrojtjen. Ai miraton vendimet e nevojshme.

Nëse e kërkojnë zhvillimet ndërkombëtare, Presidenti i Këshillit Europian thërret një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit Europian për të caktuar drejtimet strategjike të politikës së Bashkimit përballë zhvillimeve të tilla.

2. Këshilli harton politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe merr vendimet e nevojshme për përcaktimin dhe zbatimin e saj mbështetur në orientimet e përgjithshme dhe drejtimet strategjike që ka përcaktuar Këshilli Europian.

Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit garantojnë unitetin, qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë e veprimit të Bashkimit.

3. Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurimit vihet në jetë nga Përfaqësuesi i Lartë dhe nga Shtetet Anëtare, duke përdorur burimet kombëtare dhe ato të Bashkimit.

Neni 27

1. Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, i cili drejton Këshillin për Punët e Jashtme, kontribuon me propozimet e tij për hartimin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe garanton zbatimin e vendimeve që miraton Këshilli Europian dhe Këshilli.

2. Përfaqësuesi i Lartë e përfaqëson Bashkimin për çështjet që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit. Ai zhvillon dialog politik me të tretët në emër të Bashkimit dhe shpreh qëndrimin e Bashkimit në organizatat ndërkombëtare dhe konferencat ndërkombëtare.

3. Në përmbushjen e mandatit të tij, Përfaqësuesi i Lartë mbështetet nga Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Europian. Ky shërbim punon në bashkëpunim me shërbimet diplomatike të Shteteve Anëtare i cili përbëhet nga zyrtarë të drejtorive përkatëse të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit dhe të Komisionit, si dhe nga punonjës të caktuar nga shërbimet diplomatike kombëtare të Shteteve Anëtare. Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Europian miratohet me vendim të Këshillit. Këshilli vepron me propozim të Përfaqësuesit të Lartë, pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe pasi merr pëlqimin e Komisionit.

Neni 28
(ish-neni 14 TBE)

1. Kur situata ndërkombëtare kërkon veprim operativ nga ana e Bashkimit, Këshilli miraton vendimet e nevojshme. Në to përcaktohen objektivat, fusha e veprimit, mjetet që i vihen në dispozicion Bashkimit, nëse është nevoja kohëzgjatjen e tyre, si dhe kushtet për zbatimin e tyre.

Nëse ka ndryshim në rrethanat që kanë ndikim të ndjeshëm në çështjen objekt i një vendimi të tillë, Këshilli i shqyrton parimet dhe objektivat e këtij vendimi, si dhe merr vendimet e nevojshme.

2. Vendimet e përmendura në paragrafin 1 i angazhojnë Shtetet Anëtare në qëndrimet që miratojnë dhe në zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

3. Sa herë që ka një plan për miratimin e një qëndrimi kombëtar ose merret një qëndrim kombëtar sipas një vendimi të përmendur në paragrafin 1, Shteti Anëtar në fjalë jep informacion në kohë për të mundësuar, nëse është nevoja, konsultime paraprake brenda Këshillit. Detyrimi për të dhënë informacion paraprak nuk zbatohet për masat të cilat janë thjesht transpozim kombëtar i vendimeve të Këshillit.

4. Në rast se lind një nevojë e ngutshme nga ndryshimet e situatës dhe nëse nuk arrihet një shqyrtim i vendimit të Këshillit siç kërkohet në paragrafin 1, Shtetet Anëtare marrin masat e duhura për shkak të nevojës urgjente, duke mbajtur në konsideratë objektivat e përgjithshme të këtij vendimi. Shteti Anëtar në fjalë e informon menjëherë Këshillin për masa të tilla.

5. Nëse ka vështirësi madhore në zbatimin e një vendimi të parashikuar në këtë nen, një Shtet Anëtar ia raporton ato Këshillit, i cili diskuton për to dhe kërkon zgjidhjet e duhura. Zgjidhje të tilla nuk duhet të bien ndesh me objektivat e vendimit të parashikuar në paragrafin 1 apo nuk duhet t'ia ulë efektshmërinë një vendimi të tillë.

Neni 29
(ish-neni 15 TBE)

Këshilli miraton vendime ku përcaktohet qasja e Bashkimit për një çështje të veçantë me natyrë gjeografike ose tematike. Shtetet Anëtare kujdesen që politikat e tyre kombëtare të përputhen me qëndrimet e Bashkimit.

Neni 30
(ish-neni 22 TBE)

1. Çdo Shtet Anëtar, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, ose Përfaqësuesi i Lartë me mbështetjen e Komisionit, mund të përcjellin çështje që lidhen me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit në Këshill dhe mund t'i paraqesin këtij të fundit, respektivisht, nisma ose propozime.

2. Në rastet kur duhet një vendim i shpejtë, Përfaqësuesi i Lartë mbledh kryesisht ose me mocion të një Shteti Anëtar një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit brenda 48 orëve ose, në rast urgjent, brenda një periudhe më të shkurtër.

Neni 31
(ish-neni 23 TBE)

1. Vendimet e parashikuara në këtë Krye merren nga Këshilli Europian dhe Këshilli duke vepruar unanimisht, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Krye. Përjashtohet miratimi i akteve legjislative.

Kur abstenon nga votimi, çdo anëtar i Këshillit mund ta cilësojë abstenimin duke dhënë një deklaratë formale siç parashikohet në këtë nënparagraf. Në këtë rast, nuk është i detyruar ta zbatojë vendimin, por pranon që vendimi angazhon Bashkimin. Në frymën e solidaritetit të ndërsjellë, Shteti Anëtar në fjalë nuk bën asnjë veprim që mund të bjerë ndesh ose të pengojë veprimin e Bashkimit mbështetur në këtë vendim, dhe Shtetet Anëtare e respektojnë qëndrimin e tij. Nëse anëtarët e Këshillit, që e cilësojnë në këtë mënyrë abstenimin e tyre, përbëjnë të paktën një të tretën e Shteteve Anëtare që kanë të paktën një të tretën e popullsisë së Bashkimit, vendimi nuk miratohet.

2. Si përjashtim nga dispozitat e paragrafit 1, Këshilli vepron me shumicë të cilësuar:

– kur miraton një vendim në të cilin përcaktohet veprimi ose qëndrimi i Bashkimit mbi bazën e një vendimi të Këshillit Europian në lidhje me interesat dhe objektivat strategjikë të Bashkimit, sikurse thuhet në nenin 22(1),

– kur miraton një vendim në të cilin përcaktohet veprimi ose qëndrimi i Bashkimit, nisur nga propozimi që ka paraqitur Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, pas një kërkese të caktuar nga Këshilli Europian, me nismën e tij ose të Përfaqësuesit të Lartë,

– kur miraton çdo vendim që zbaton një vendim në të cilin përcaktohet veprimi ose qëndrimi i Bashkimit,

– Kur emëron një përfaqësues të posaçëm në përputhje me nenin 33.

Nëse një anëtar i Këshillit deklaron se, për arsye jetike ose të shprehura të politikës kombëtare, ka ndër mend ta kundërshtojë miratimin e një vendimi që duhet marrë me shumicë të cilësuar, votimi nuk bëhet. Përfaqësuesi i Lartë, në konsultim të ngushtë me Shtetin Anëtar në fjalë, kërkon gjetjen e një zgjidhje të pranueshme për të. Nëse nuk e arrin këtë, Këshilli, me shumicë të cilësuar, mund të kërkojë që çështja t'i përcillet Këshillit Europian për vendim unanim.

3. Këshilli Europian mund ta miratojë unanimisht një vendim ku të thuhet se Këshilli vepron me shumicë të cilësuar në raste të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 2.

4. Paragrafët 2 dhe 3 nuk zbatohen për vendimet që kanë rrjedhoja ushtarake ose të mbrojtjes.

5. Për çështje procedurale, Këshilli vepron me shumicën e anëtarëve.

Neni 32
(ish-neni 16 TBE)

Shtetet Anëtare konsultohen me njëri tjetrin brenda Këshillit Europian dhe Këshillit për çdo çështje të politikës së jashtme dhe të sigurimit, me interes të përgjithshëm, në mënyrë që të vendosin një qasje të përbashkët. Përpara se të ndërmarrin një veprim në arenën ndërkombëtare ose përpara se të hyjnë në një angazhim i cili mund të prekë interesat e Bashkimit, çdo Shtet Anëtar konsultohet me të tjerët brenda Këshillit Europian ose brenda Këshillit. Shtetet Anëtare kujdesen, përmes konvergjencës së veprimeve të tyre, që Bashkimi të jetë në gjendje të mbështesë interesat dhe vlerat e tyre në arenën ndërkombëtare. Shtetet Anëtare tregojnë solidaritet të ndërsjellë.

Kur Këshilli Europian ose Këshilli ka përcaktuar një qasje të përbashkët të Bashkimit, sipas kuptimit të paragrafit 1, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit dhe Ministrat e Punëve të Jashtme të Shteteve Anëtare i bashkërendojnë veprimtaritë e tyre brenda Këshillit.

Misionet diplomatike të Shteteve Anëtare dhe delegacionet e Bashkimit në vendet e treta dhe në organizatat ndërkombëtare bashkëpunojnë dhe kontribuojnë në shprehjen dhe zbatimin e qasjes së përbashkët.

Neni 33
(ish-neni 18 TBE)

Këshilli, me propozim të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, mund të emërojë një përfaqësues të posaçëm me mandat për çështje të veçanta të politikave. Përfaqësuesi i posaçëm e realizon mandatin e tij nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë.

Neni 34
(ish-neni 19 TBE)

1. Shtetet Anëtare e bashkërendojnë veprimin e tyre në organizatat dhe konferencat ndërkombëtare. Ato i mbështesin qëndrimet e Bashkimit në këto forume. Këtë bashkërendim e organizon Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit.

Në organizatat dhe konferencat ndërkombëtare ku nuk marrin pjesë të gjitha Shtetet Anëtare, qëndrimet e Bashkimit i mbështesin ato Shtete Anëtare që marrin pjesë.

2. Në përputhje me nenin 24(3), Shtetet Anëtare, të përfaqësuara në organizatat ose konferencat ndërkombëtare ku nuk marrin pjesë të gjitha Shtetet Anëtare, i mbajnë të informuara Shtetet e tjera Anëtare dhe Përfaqësuesin e Lartë për çdo çështje me interes të përbashkët.

Shtetet Anëtare, të cilat janë edhe anëtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, bashkëpunojnë dhe i mbajnë Shtetet e tjera Anëtare dhe Përfaqësuesin e Lartë tërësisht të informuar. Shtetet Anëtare, të cilat janë anëtare të Këshillit të Sigurimit gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, mbrojnë qëndrimet dhe interesat e Bashkimit pa cenuar përgjegjësitë që u ngarkojnë dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Shtetet Anëtare të cilat marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit, kur Bashkimi ka përcaktuar një qëndrim për një temë që është në rendin e ditës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kërkojnë që, në të, të ftohet Përfaqësuesi i Lartë për të paraqitur qëndrimin e Bashkimit.

Neni 35
(ish-neni 20 TBE)

Misionet diplomatike dhe konsullore të Shteteve Anëtare dhe delegacionet e Bashkimit në vendet e treta dhe konferencat ndërkombëtare si dhe përfaqësitë e tyre në organizatat ndërkombëtare bashkëpunojnë për të siguruar respektimin dhe zbatimin e vendimeve ku përcaktohen qëndrimet dhe veprimet e Bashkimit, të miratuara sipas këtij Kreu.

Ato e thellojnë bashkëpunimin përmes shkëmbimit të informacionit dhe kryerjes së vlerësimeve të përbashkëta.

Ato kontribuojnë në vënien në jetë të së drejtës së qytetarëve të Bashkimit për të qenë të mbrojtur në territorin e vendeve të treta, sikurse parashikohet në nenin 20(2)(c) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe të masave të miratuara në zbatim të nenit 23 të atij Traktati.

Neni 36
(ish-neni 21 TBE)

Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit konsultohet rregullisht me Parlamentin Europian për aspektet kryesore dhe alternativat bazë të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe politikës së përbashkët të sigurimit dhe mbrojtjes, dhe e informon atë se si zhvillohen këto politika. Ai kujdeset që të merren si duhet në konsideratë pikëpamjet e Parlamentit Europian. Në informimin e Parlamentit Europian mund të përfshihen edhe përfaqësuesit e posaçëm.

Parlamenti Europian mund t'i drejtojë pyetje ose t'i bëjë rekomandime Këshillit ose Përfaqësuesit të Lartë. Dy herë në vit, Parlamenti zhvillon një debat mbi ecurinë e zbatimit të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, duke përfshirë edhe politikën e përbashkët për sigurimin dhe mbrojtjen.

Neni 37
(ish-neni 24 TBE)

Bashkimi mund të lidhë marrëveshje me një ose më shumë Shtete ose organizata ndërkombëtare në fushat që mbulon ky Krye.

Neni 38
(ish-neni 25 TBE)

Pa cenuar nenin 240 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, një Komitet Politik dhe i Sigurimit ndjek situatën ndërkombëtare në fushat që mbulon politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurimit dhe kontribuon në përcaktimin e politikave, duke i dhënë opinione Këshillit me kërkesë të Këshillit ose të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, ose me nismën e vet. Ky Komitet ndjek edhe vënien në zbatim të politikave të miratuara, pa cenuar kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë.

Brenda fushës së veprimit të këtij Kreu, Komiteti Politik dhe i Sigurimit ushtron, nën përgjegjësinë e Këshillit dhe të Përfaqësuesit të Lartë, kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të operacioneve për trajtimin e krizave që përmenden në nenin 43.
Këshilli mund ta autorizojë Komitetin, për qëllimin dhe kohëzgjatjen e operacionit të trajtimit të krizës, sipas vendimit të Këshillit, që të marrë vendimet përkatëse në lidhje me kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të operacionit.

Neni 39

Në përputhje me nenin 16 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe si përjashtim nga paragrafi 2 i atij neni, Këshilli miraton një vendim ku parashikohen rregullat për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare, gjatë realizimit të veprimtarive të tyre që janë brenda fushës së veprimit të këtij Kreu, dhe rregullat për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Respektimi i këtyre rregullave kontrollohet nga autoritete të pavarura.

Neni 40
(ish-neni 47 TBE)

Zbatimi i politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit nuk e prek zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve të parashikuara nga Traktatet për ushtrimin e kompetencave të Bashkimit, të përmendura në nenet nga 3 deri në 6 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Në mënyrë të ngjashme, zbatimi i politikave të parashikuara në nenet e lartpërmendura nuk e prek zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve të parashikuara nga Traktatet për ushtrimin e kompetencave të Bashkimit sipas këtij Kreu.

Neni 41
(ish-neni 28 TBE)

1. Shpenzimet administrative që u lindin institucioneve nga vënia në zbatim e këtij Kreu i ngarkohen buxhetit të Bashkimit.

2. Edhe shpenzimet operative që lindin nga vënia në zbatim e këtij Kreu i ngarkohen buxhetit të Bashkimit, me përjashtim të atyre shpenzimeve që lindin nga operacionet me rrjedhoja ushtarake ose të mbrojtjes si dhe me përjashtim të rasteve kur Këshilli vendos unanimisht ndryshe.

Në ato raste kur shpenzimi nuk i ngarkohet buxhetit të Bashkimit, ai i ngarkohet Shtetit Anëtar në përputhje me shkallën e produktit kombëtar bruto nëse Këshilli nuk vendos unanimisht ndryshe. Sa u takon shpenzimeve që lindin nga operacionet me rrjedhoja ushtarake ose të mbrojtjes, Shtetet Anëtare përfaqësuesit e të cilave në Këshill kanë bërë një deklaratë zyrtare sipas nenit 31(1) nënparagrafi i dytë, nuk janë të detyruara të kontribuojnë në financimin e tyre.

3. Këshilli miraton një vendim ku vendosen procedurat e caktuara për të garantuar marrje të shpejtë të fondeve të miratuara në buxhetin e Bashkimit për financimin e ngutshëm të nismave, në kuadër të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, dhe sidomos për veprimtaritë përgatitore për detyrat e përmendura në nenin 42(1) dhe nenin 43. Ai vepron pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Veprimtaritë përgatitore për detyrat e përmendura në nenin 42(1) dhe nenin 43, të cilat nuk i ngarkohen buxhetit të Bashkimit, financohen nga një fond fillestar i ngritur me kontributet e Shteteve Anëtare.

Këshilli miraton, me shumicë të cilësuar, me propozim të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe për Politikën e Sigurimit, vendime ku përcaktohen:

(a) procedurat për ngritjen dhe financimin e fondit fillestar, sidomos shumat që i kalojnë fondit;

(b) procedurat për përdorimin e fondit fillestar;

(c) procedurat e kontrollit financiar.

Kur detyra e planifikuar në përputhje me nenin 42(1) dhe nenin 43 nuk mund t'i ngarkohet buxhetit të Bashkimit, Këshilli mund të autorizojë Përfaqësuesin e Lartë ta përdorë fondin. Përfaqësuesi i Lartë i raporton Këshillit për zbatimin e kësaj kompetence.

SEKSIONI 2

DISPOZITA PËR POLITIKËN E PËRBASHKËT PËR SIGURIMIN DHE MBROJTJEN

Neni 42
(ish-neni 17 TBE)

1. Politika e përbashkët për sigurim dhe mbrojtjen është pjesë integrale e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit. Ajo i ofron Bashkimit kapacitetin veprues duke u mbështetur në mjetet civile dhe ushtarake. Bashkimi mund t'i përdorë ato për misionet jashtë Bashkimit për ruajtjen e paqes për parandalimin e konflikteve dhe fuqizimin e sigurisë ndërkombëtare në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Realizimi i këtyre detyrave bëhet duke përdorur kapacitetet e siguruara nga Shtetet Anëtare.

2. Politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes përfshin shprehjen e vazhdueshme të një politike të përbashkët të mbrojtjes së Bashkimit. Kjo do të çojë në një mbrojtje të përbashkët, kur ta vendosë unanimisht Këshilli Europian. Në këtë rast, ky i fundit u rekomandon Shteteve Anëtare miratimin e një vendimi të tillë në përputhje me kërkesat kushtetuese respektive të tyre.

Politika e Bashkimit, në përputhje me këtë seksion, nuk e cenon karakterin e veçantë të politikës për sigurimin dhe mbrojtjen që kanë Shtete të caktuara Anëtare dhe, i respekton detyrimet e Shteteve të caktuara Anëtare, të cilat mbrojtjen e tyre të përbashkët e shohin të realizuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), që rrjedhin nga Traktati i Atlantikut të Veriut dhe përputhen me politikën e përbashkët të sigurimit dhe mbrojtjes të vendosur brenda atij kuadri.

3. Shtetet Anëtare vendosin në dispozicion të Bashkimit kapacitete civile dhe ushtarake për vënien në zbatim të politikës së përbashkët të sigurimit dhe mbrojtjes, për të kontribuar në objektivat e përcaktuara nga Këshilli. Ato Shtete Anëtare të cilat krijojnë bashkërisht forca shumëkombëshe mund t'i vendosin edhe këto forca në dispozicion të politikës së përbashkët të sigurimit dhe mbrojtjes.

Shtetet Anëtare marrin përsipër vazhdimisht t'i përmirësojnë kapacitetet e tyre ushtarake. Agjencia në fushën e zhvillimit, kërkimit, marrjes dhe armatimit të kapaciteteve të mbrojtjes (e quajtur më poshtë "Agjencia Europiane për Mbrojtjen") identifikon kërkesat operative, promovon masat për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontribuon në identifikimin dhe, sipas rastit, zbatimin e masave të nevojshme për fuqizimin e bazës industriale dhe teknologjike të sektorit të mbrojtjes, merr pjesë në përcaktimin e një politike europiane për kapacitetet dhe armatimin dhe mbështet Këshillin për vlerësimin e përmirësimit të kapaciteteve ushtarake.

4. Vendimet që lidhen me politikën e përbashkët të sigurimit dhe mbrojtjes, duke përfshirë edhe ato për nisjen e një misioni sipas parashikimeve të këtij neni, miratohen unanimisht nga Këshilli me propozim të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit ose me nismë të një Shteti Anëtar. Përfaqësuesi i Lartë mund të propozojë përdorimin e burimeve kombëtare dhe të instrumenteve të Bashkimit, së bashku me Komisionin, sipas rastit.

5. Këshilli mund t'ia besojë realizimin e një detyre, brenda kuadrit të Bashkimit, një grupi Shtetesh Anëtare në mënyrë që të mbrohen vlerat e Bashkimit dhe t'u shërbehet interesave të tij. Realizimi i një detyre të tillë rregullohet nga neni 44.

6. Ato Shtete Anëtare kapacitetet ushtarake të të cilave arrijnë kritere më të larta dhe të cilat kanë angazhime më detyruese me njëri-tjetrin në këtë fushë, lidhur me misionet më të vështira, vendosin një bashkëpunim të përhershëm të strukturuar brenda kuadrit të Bashkimit. Një bashkëpunim i tillë rregullohet nga neni 46. Ai nuk ndikon në rregullimet e nenit 43.

7. Nëse një Shtet Anëtar është viktimë e një agresioni të armatosur në territorin e tij, Shtetet e tjera Anëtare kanë për detyrim ta ndihmojnë dhe mbështetin me të gjitha mjetet që kanë në dorë, në përputhje me nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Kjo nuk cenon karakterin e veçantë të politikës për sigurim dhe mbrojtje të Shteteve të ndryshme Anëtare.

Angazhimet dhe bashkëpunimi në këtë fushë duhet të pajtohen me angazhimet që rrjedhin nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, e cila, për ata Shtete që janë anëtare të saj, mbetet baza e mbrojtjes së përbashkët të tyre dhe forumi për zbatimin e saj.

Neni 43

1. Detyrat e përmendura në nenin 42(1), në rrjedhën e të cilave Bashkimi mund të përdorë mjete civile dhe ushtarake, përfshijnë operacionet e përbashkëta të çarmatimit, detyrat humanitare dhe

të shpëtimit, detyrat e këshillimit dhe asistencës ushtarake, detyrat e parandalimit të konflikteve dhe ruajtjes së paqes, detyrat e forcave luftuese në trajtimin e krizave, duke përfshirë arritjen e paqes dhe stabilizimin në periudhën pas konfliktit. Të gjitha këto detyra mund të kontribuojnë në luftën kundër terrorizmit, duke përfshirë mbështetjen e vendeve të treta në luftën kundër terrorizmit në territoret e tyre.

2. Këshilli miraton vendime lidhur me detyrat e përmendura në pikën 1, ku përcaktohen objektivat dhe fusha e veprimit e tyre si dhe kushtet e përgjithshme për zbatimin e tyre. Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, duke vepruar nën autoritetin e Këshillit dhe në kontakt të afërt dhe të vazhdueshëm me Komitetin Politik dhe të Sigurisë, siguron bashkërendimin e aspekteve civile dhe ushtarake të detyrave të tilla.

Neni 44

1. Brenda kuadrit të vendimeve të miratuara në përputhje me nenin 43, Këshilli mund t'ia besojë zbatimin e një detyre një grupi Shtetesh Anëtare, të cilat kanë vullnetin dhe kapacitetin e nevojshëm për një detyrë të tillë. Këto Shtete Anëtare, së bashku me Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, bien dakord mes tyre lidhur me administrimin e detyrës.

2. Me nismën e tyre ose me kërkesën e një Shteti tjetër Anëtar, Shtetet Anëtare, që marrin pjesë në detyrë, e mbajnë të informuar rregullisht Këshillin lidhur me progresin e tij. Këto Shtete e informojnë menjëherë Këshillin, nëse përfundimi i detyrës sjell pasoja madhore ose kërkon ndryshimin e objektivit, fushës së veprimit dhe kushteve të përcaktuara për detyrën në vendimet e përmendura në paragrafin 1. Në raste të tilla, Këshilli miraton vendimet e nevojshme.

Neni 45

1. Agjencia Europiane për Mbrojtjen, e cila përmendet në nenin 42(3), në varësi të autoritetit të Këshillit ka si detyrë të vetën:

(a) të kontribuojë në identifikimin e objektivave të mundshme ushtarake dhe në vlerësimin e respektimit të angazhimeve me kapacitete që kanë dhënë Shtetet Anëtare;

(b) të promovojë harmonizimin e nevojave operative dhe përqafimin e metodave të efektshme dhe të përputhshme të prokurimit;

(c) të propozojë projekte shumëpalëshe për përmbushjen e objektivave në lidhje me kapacitetet ushtarake, të sigurojë bashkërendimin e programeve që zbatojnë Shtetet Anëtare dhe administrimin e programeve të veçanta të bashkëpunimit;

(d) të mbështesë kërkimin në fushën e teknologjisë së mbrojtjes dhe të bashkërendojë e planifikojë veprimtari të përbashkëta kërkimore dhe të studimeve të zgjidhjeve teknike që përmbushin nevojat operative për të ardhmen;

(e) të kontribuojë në identifikimi dhe, nëse është nevoja, në zbatimin e masave të dobishme për fuqizimin e bazës industriale dhe teknologjike të sektorit të mbrojtjes dhe në përmirësimin e efektshmërisë së shpenzimeve ushtarake.

2. Agjencia Europiane për Mbrojtjen është e hapur për të gjitha Shtetet Anëtare që dëshirojnë të jenë pjesë e saj. Këshilli miraton me shumicë të cilësuar një vendim në të cilin caktohet statuti, selia dhe rregullorja e punës së Agjencisë. Ky vendim duhet të marrë në konsideratë nivelin e pjesëmarrjes efektive në veprimtaritë e Agjencisë. Brenda Agjencisë ngrihen grupe të veçanta, ku marrin pjesë Shtetet Anëtare të angazhuara në projekte të përbashkëta. Kur është nevoja, Agjencia i kryen detyrat duke qenë në kontakt me Komisionin.

Neni 46

1. Ato Shtete Anëtare të cilat dëshirojnë të marrin pjesë në bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar të përmendur në nenin 42(6) dhe që i përmbushin kriteret si dhe kanë marrë angazhime sa u takon kapaciteteve ushtarake të parashikuara në Protokollin për bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar, e njoftojnë Këshillin dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit lidhur me qëllimin e tyre.

2. Brenda tre muajve pas njoftimit të përmendur në paragrafin 1, Këshilli miraton një vendim përmes të cilit krijohet bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar dhe përcaktohet lista e Shteteve Anëtare pjesëmarrëse. Këshilli vendos me shumicë të cilësuar, pasi konsultohet me Përfaqësuesin i Lartë.

3. Çdo Shtet Anëtar i cili dëshiron, në një fazë të mëvonshme, të marrë pjesë në bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar, njofton Këshillin dhe Përfaqësuesin e Lartë për qëllimin e tij.

Këshilli miraton një vendim, ku konfirmohet pjesëmarrja e Shtetit Anëtar në fjalë, i cili i përmbush kriteret dhe merr angazhimet e përmendura në nenet 1 dhe 2 të Protokollit për bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar. Këshilli vepron me shumicë të cilësuar, pasi konsultohet me Përfaqësuesin e Lartë. Në votim marrin pjesë vetëm ata anëtarë të Këshillit që përfaqësojnë Shtetet Anëtare pjesëmarrëse.

Shumica e cilësuar përcaktohet në përputhje me nenin 238(3)(a) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

4. Nëse një Shtet Anëtar nuk i përmbush më kriteret ose nuk është më në gjendje t'i përmbushë angazhimet e përmendura në nenet 1 dhe 2 të Protokollit për bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar, Këshilli mund të miratojë një vendim me të cilin pezullohet pjesëmarrja e Shtetit Anëtar në fjalë.

Këshilli vepron me shumicë të cilësuar. Në votim marrin pjesë vetëm ata anëtarë të Këshillit që përfaqësojnë Shtetet Anëtare pjesëmarrëse, me përjashtim të Shtetit Anëtar në fjalë.

Shumica e cilësuar përcaktohet në përputhje me nenin 238(3)(a) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

5. Çdo Shtet Anëtar pjesëmarrës i cili dëshiron të tërhiqet nga bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar e njofton për këtë Këshillin, i cili konstaton në këtë rast se Shteti Anëtar në fjalë ka pushuar së marri pjesë.

6. Vendimet dhe rekomandimet e Këshillit brenda kuadrit të bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar, përveç atyre që parashikohen në paragrafët nga 2 deri në 5, miratohen unanimisht. Në kuptim të këtij paragrafi, unanimiteti përbëhet vetëm nga votat e përfaqësuesve të Shteteve Anëtare pjesëmarrëse

TITULLI VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 47

Bashkimi ka personalitet juridik.

Neni 48
(ish-neni 48 TBE)

1. Traktateve mund t'u bëhen shtesa dhe ndryshime në përputhje me procedurën e zakonshme të rishikimit. Atyre mund t'u bëhen shtesa dhe ndryshime edhe në përputhje me procedurat e thjeshtuara të rishikimit.

Procedura e zakonshme e rishikimit

2. Qeveria e një Shteti Anëtar, Parlamenti Europian ose Komisioni mund t'i paraqesë Këshillit propozime për shtesa dhe ndryshime në Traktate. Ndër të tjera, këto propozime mund të shërbejnë për t'i rritur ose për t'i zvogëluar kompetencat që i janë dhënë Bashkimit nga Traktatet. Këto propozime Këshilli ia paraqet Këshillit Europian ndërsa njoftohen edhe Parlamentet kombëtare.

3. Nëse Këshilli Europian, pas konsultimit me Parlamentin Europian dhe Komisionin, miraton me shumicë të thjeshtë një vendim pro shqyrtimit të shtesave dhe ndryshimeve të propozuara, Presidenti i Këshillit Europian thërret një Konventë të përbërë nga përfaqësues të Parlamenteve kombëtare, Krerëve të Shteteve ose Qeverive të Shteteve Anëtare, Parlamentit Europian dhe Komisionit. Konsultohet edhe Banka Qendrore Europiane, në rast të ndryshimeve institucionale në fushën monetare. Konventa shqyrton propozimet për shtesat dhe ndryshimet dhe miraton me konsensus një rekomandim që i drejtohet një konference të përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare, siç parashikohet në paragrafin 4.

Këshilli Europian mund të vendosë me shumicë të thjeshtë, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, për të mos thirrur një Konventë, nëse nuk e justifikon shkalla e ndryshimeve të propozuara. Në këtë rast, Këshilli Europian përcakton termat e referencës për një konferencë të përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare.

4. Presidenti i Këshillit mbledh një konferencë të përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare me qëllim vendosjen, me marrëveshje të përbashkët, të ndryshimeve që i duhen bërë Traktateve.
Ndryshimet hyjnë në fuqi pasi ratifikohen nga të gjitha Shtetet Anëtare, në përputhje me kërkesat kushtetuese respektive të tyre.

5. Nëse dy vjet pas nënshkrimit të një traktati ndryshues të Traktateve e kanë ratifikuar katër të pestat e Shteteve Anëtare ose, nëse një apo më shumë Shtete Anëtare kanë pasur vështirësi lidhur me procesin e ratifikimit, çështja i përcillet Këshillit Europian.

Procedurat e thjeshtuara të rishikimit

6. Qeveria e çdo Shteti Anëtar, Parlamenti Europian ose Komisioni mund t'i paraqesin Këshillit Europian propozime për rishikimin e të gjithave ose një pjese të dispozitave të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian lidhur me politikat dhe veprimin e brendshëm të Bashkimit.

Këshilli Europian mund të miratojë një vendim me ndryshime në të gjitha ose një pjesë të dispozitave të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Këshilli Europian vepron unanimisht, pasi konsultohet me Parlamentit Europian, Komisionin dhe me Bankën Qendrore Europiane, në rast të ndryshimeve institucionale në fushën monetare. Ky vendim nuk hyn në fuqi pa u miratuar më parë nga Shtetet Anëtare, në përputhje me kërkesat kushtetuese përkatëse të tyre.

Vendimi i përmendur në paragrafin e dytë nuk i rrit kompetencat që i janë dhënë Bashkimit nga Traktatet.

7. Kur Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian ose Titulli V i këtij Traktati parashikon që Këshilli duhet të veprojë unanimisht në një fushë a rast të caktuar, Këshilli Europian mund të miratojë një vendim që e autorizon Këshillin të veprojë me shumicë të cilësuar në fushën apo rastin në fjalë. Ky paragraf nuk zbatohet për vendimet me rrjedhoja ushtarake ose për vendimet në fushën e mbrojtjes.

Kur Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian parashikon miratimin e akteve legjislative nga Këshilli në përputhje me një procedurë të posaçme legjislative, Këshilli Europian mund të miratojë një vendim që lejon miratimin e akteve të tilla në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative.

Parlamentet kombëtare njoftohen për çdo nismë që merr Këshilli Europian në bazë të paragrafit të parë ose të dytë. Nëse një Parlament kombëtar bën të ditur kundërshtimin e vet brenda gjashtë muajve nga data e një njoftimi të tillë, vendimi i përmendur në paragrafin e parë ose të dytë nuk miratohet. Nëse nuk ka kundërshtim, Këshilli Europian mund ta miratojë vendimin.

Për miratimin e vendimeve të përmendura në nënparagrafin e parë dhe të dytë, Këshilli Europian vepron unanimisht, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, i cili jepet me shumicën e deputetëve që e përbëjnë atë.

Neni 49
(ish-neni 49 TBE)

Çdo Shtet Europian, i cili respekton vlerat e përmendura në nenin 2 dhe është i angazhuar për nxitjen e tyre, mund të kërkojë të bëhet anëtar i Bashkimit. Parlamenti Europian dhe Parlamentet kombëtare njoftohen për këtë kërkesë. Shteti kërkues ia drejton kërkesën Këshillit, i cili vepron unanimisht, pasi konsultohet me Komisionin dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, i cili vepron me shumicën e deputetëve që e përbëjnë. Merren në konsideratë kushtet e pranueshmërisë të miratuara nga Këshilli Europian.

Kushtet e anëtarësimit dhe përshtatjet me Traktatet mbi të cilat është themeluar Bashkimi, që kërkon një anëtarësim i tillë, i nënshtrohen marrëveshjes midis Shteteve Anëtare dhe Shtetit kërkues. Kjo marrëveshje paraqitet për ratifikim në të gjitha Shtetet kontraktuese, në përputhje me kërkesat kushtetuese respektive të tyre.

Neni 50

1. Çdo Shtet Anëtar mund të vendosë të dalë nga Bashkimi, në përputhje me kërkesat kushtetuese të veta.

2. Shteti Anëtar që vendos të dalë nga Bashkimi njofton Këshillin Europian për këtë qëllim. Në dritën e orientimeve të dhëna nga Këshilli Europian, Bashkimi negocion dhe arrin një marrëveshje me këtë Shtet, në të cilën përcaktohen masat organizative të daljes, duke pasur parasysh kuadrin për marrëdhënien e tij të ardhshme me Bashkimin. Kjo marrëveshje negociohet në përputhje me nenin 218 (3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Marrëveshja lidhet në emër të Bashkimit nga Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, pasi merret pëlqimi i Parlamentit Europian.

3. Traktatet pushojnë së zbatuari për Shtetin në fjalë duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e marrëveshjes së daljes ose, nëse nuk arrihet një marrëveshje e tillë, dy vjet pas njoftimit të përmendur në paragrafin 2, nëse Këshilli Europian në marrëveshje me Shtetin Anëtar në fjalë nuk vendos unanimisht ta zgjasë këtë afat.

4. Për qëllimet e paragrafëve 2 dhe 3, anëtari i Këshillit Europian ose i Këshillit, i cili përfaqëson Shtetin Anëtar që del nga Bashkimi, nuk merr pjesë në diskutimet e Këshillit Europian ose të Këshillit që kanë të bëjnë me këtë Shtet Anëtar.

Shumica e cilësuar përcaktohet në përputhje me nenin 238(3)(b) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

5. Nëse një Shtet i cili ka dalë nga Bashkimi kërkon rianëtarësim, kërkesa e tij i nënshtrohet procedurës së parashikuar në nenin 49.

Neni 51

Protokollet dhe Shtojcat e Traktateve përbëjnë pjesë integrale të tyre.

Neni 52

1. Traktatet zbatohen për Mbretërinë e Belgjikës, Republikën e Bullgarisë, Republikën Çeke, Mbretërinë e Danimarkës, Republikën Federale të Gjermanisë, Republikën e Estonisë, Irlandën, Republikën e Greqisë, Mbretërinë e Spanjës, Republikën Franceze, Republikën Italiane, Republikën e Qipros, Republikën e Letonisë, Republikën e Lituanisë, Dukatin e Madh të Luksemburgut, Republikën e Hungarisë, Republikën e Maltës, Mbretërinë e Holandës, Republikën e Austrisë, Republikën e Polonisë, Republikën Portugeze, Rumaninë, Republikën e Sllovenisë, Republikën Sllovake, Republikën e Finlandës, Mbretërinë e Suedisë dhe Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

2. Fusha e veprimit territorial të Traktateve është përcaktuar në nenin 355 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 53
(ish-neni 51 TBE)

Ky Traktat miratohet për një periudhë të pakufizuar.

Neni 54
(ish-neni 52 TBE)

1. Ky Traktat ratifikohet nga të gjitha Palët e Larta Kontraktuese, në përputhje me kërkesat kushtetuese respektive të tyre. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës Italiane.

2. Ky Traktat hyn në fuqi, më 1 janar 1993, me kusht që të jenë depozituar të gjitha instrumentet e ratifikimit ose, nëse nuk arrihet kjo, ditën e parë të muajit pasardhës pas depozitimit të Instrumentit të ratifikimit nga Shteti i fundit nënshkrues që e bën këtë hap.

Neni 55
(ish-neni 53 TBE)

1. Ky Traktat, i përpiluar në një kopje të vetme origjinale në gjuhët bullgare, çeke, daneze, holandeze, angleze, estoneze, finlandeze, franceze, gjermane, greke, hungareze, irlandeze, italiane, letoneze, lituaneze, malteze, polake, portugeze, rumune, sllovake, sllovene, spanjolle dhe suedeze ku tekstet në secilën gjuhë janë njësoj origjinale, depozitohet në arkivin e Qeverisë së Republikës Italiane, e cila ia përcjell një kopje të vërtetuar secilës prej qeverive të Shteteve të tjera nënshkruese.

2. Ky Traktat mund të përkthehet edhe në gjuhë të tjera, si ta vendosin Shtetet Anëtare, mes të cilave edhe ato që në përputhje me rendin e tyre kushtetues gëzojnë status zyrtar në të gjithë ose një pjesë të territorit të tyre. Shteti Anëtar në fjalë jep një kopje të vërtetuar të përkthimeve të tilla, për t'u depozituar në arkivin e Këshillit.

NË DIJENI TË PËRMBAJTJES së tij, Të Plotfuqishmit e nënshkruan këtë Traktat.

Nënshkruar në Mastriht, më të shtatën ditë të muajit shkurt të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy.

(Lista e nënshkruesve nuk jepet këtu)

VERSIONI I KONSOLIDUAR

I

TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN

E BASHKIMIT EUROPIAN

PREAMBULA

MADHËRIA E TIJ MBRETI I BELGËVE, PRESIDENTI I REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PRESIDENTI I REPUBLIKËS FRANCEZE, PRESIDENTI I REPUBLIKËS ITALIANE, LARTMADHËRIA E SAJ MBRETËRORE DUKESHA E MADHE E LUKSEMBURGUT, MADHËRIA E SAJ MBRETËRESHA E HOLLANDËS,[1]

TË VENDOSUR për të hedhur themelet për një bashkim gjithnjë e më të afërt mes popujve të Europës,

TË VENDOSUR për të siguruar përparimin ekonomik dhe shoqëror të Shteteve të tyre duke vepruar bashkërisht për të eliminuar barrierat që e ndajnë Europën,

DUKE KONFIRMUAR si objektiv thelbësor të përpjekjeve të tyre përmirësimet e vazhdueshme të kushteve të jetesës dhe punës të popujve të tyre,

DUKE PRANUAR se heqja e pengesave ekzistuese kërkon veprim të bashkërenduar për të garantuar zgjerimin e qëndrueshëm, tregtinë e ekuilibruar dhe konkurrencën e ndershme,

ME PËRKUSHTIMIM për fuqizimin e bashkimit të ekonomive të tyre dhe sigurimin e zhvillimit harmonik të tyre përmes zvogëlimit të dallimeve që ekzistojnë midis rajoneve të ndryshme dhe të prapambetjes së rajoneve më pak të favorizuara,

DUKE DËSHIRUAR për të kontribuar, përmes një politike të përbashkët tregtare, në heqjen progresive të kufizimeve mbi tregtinë ndërkombëtare,

ME QËLLIMIN për të konfirmuar solidaritetin që lidh Europën dhe vendet jashtë saj, dhe me dëshirën për të siguruar zhvillimin e mirëqenies së tyre, në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara,

TË VENDOSUR për t'i bashkuar burimet e tyre për të ruajtur dhe fuqizuar paqen dhe lirinë dhe duke u bërë thirrje popujve të tjerë të Europës, të cilët kanë të njëjtin ideal me ta, që të bashkohen në përpjekjet e tyre,

TË VENDOSUR për të nxitur zhvillimin e nivelit më të lartë të mundshëm të dijes për popujt e tyre përmes dhënies së mundësisë sa më gjerësisht për arsim dhe përmes përditësimit të tij të vazhdueshëm,

dhe për këtë qëllim KANË CAKTUAR si Të Plotfuqishmit e tyre:

(Lista e të plotfuqishmëve nuk jepet këtu)

TË CILËT, pasi shkëmbyen plotfuqitë, që u konstatuan si të vlefshme dhe të rregullta, ranë dakord si vijon.

---

[1] Prej atëherë, në Bashkimin Europian janë anëtarësuar edhe Republika e Bullgarisë, Republika Çeke, Republika e Estonisë, Irlanda, Republika e Greqisë, Mbretëria e Spanjës, Republika e Qipros, Republika e Letonisë, Republika e Lituanisë, Republika e Hungarisë, Republika e Maltës, Republika e Austrisë, Republika e Polonisë, Republika Portugeze, Rumania, Republika e Sllovenisë, Republika Sllovake, Republika e Finlandës, Mbretëria e Suedisë dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

PJESA E PARË

PARIMET

Neni 1

1. Ky Traktat organizon funksionimin e Bashkimit dhe përcakton fushat, kufijtë dhe masat organizative për ushtrimin e kompetencave të tij.

2. Ky Traktat dhe Traktati për Bashkimin Europian përbëjnë Traktatet mbi të cilat themelohet Bashkimi. Këto dy Traktate, të cilët kanë të njëjtën fuqi ligjore, quhen "Traktatet".

TITULLI I

KATEGORITË DHE FUSHAT E KOMPETENCËS SË BASHKIMIT

Neni 2

1. Kur Traktatet i japin Bashkimit kompetencë ekskluzive në një fushë të caktuar, vetëm Bashkimi mund të miratojë legjislacion dhe akte me fuqi ligjore detyruese, ndërsa Shtetet Anëtare mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm nëse këtë të drejtë ia jep Bashkimi ose për zbatimin e akteve të Bashkimit.

2. Kur Traktatet i japin Bashkimit një kompetencë të përbashkët me Shtetet Anëtare në një fushë të caktuar, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare mund të miratojnë legjislacion dhe akte me fuqi ligjore detyruese. Shtetet Anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në masën dhe për aq sa Bashkimi nuk ka ushtruar kompetencën e tij. Shtetet Anëtare e ushtrojnë gjithashtu kompetencën e tyre për aq sa dhe kur Bashkimi ka vendosur të pushojë së ushtruari kompetencën e tij.

3. Shtetet Anëtare i bashkërendojnë politikat e tyre ekonomike dhe të punësimit brenda kuadrit të përcaktuar në këtë Traktat, të cilin Bashkimi ka kompetencë të parashikojë.

4. Bashkimi ka kompetencën, sipas dispozitave të Traktatit për Bashkimin Europian, të caktojë një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, duke përfshirë edhe shprehjen progresive të një politike të përbashkët të mbrojtjes.

5. Në disa fusha të caktuara dhe sipas kushteve të përcaktuara në Traktatet, Bashkimi ka kompetencën për të kryer veprime për të mbështetur, bashkërenduar ose plotësuar veprimet e Shteteve Anëtare, pa e kapërcyer përmes tyre kompetencën e Shteteve Anëtare, në këto fusha.

Aktet me fuqi ligjore detyruese të Bashkimit të miratuara në bazë të dispozitave të Traktateve, lidhur me këto fusha, nuk kërkojnë harmonizim të akteve ligjore ose nënligjore të Shteteve Anëtare.

6. Fusha e veprimit dhe masat organizative për ushtrimin e kompetencave të Bashkimit përcaktohen nga dispozitat e Traktateve, lidhur me secilën fushë.

Neni 3

1. Bashkimi ka kompetencë ekskluzive në fushat e mëposhtme:

(a) bashkimi doganor;

(b) vendosja e rregullave të konkurrencës, të nevojshme për funksionimin e tregut të brendshëm;

(c) politika monetare për Shtetet Anëtare, monedha e të cilave është Euro;

(d) ruajtja e burimeve biologjike detare në kuadër të politikës së përbashkët për peshkimin;

(e) politika e përbashkët tregtare.

2. Bashkimi ka gjithashtu kompetencë ekskluzive për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare, kur lidhja e saj parashikohet në një akt legjislativ të Bashkimit ose nevojitet për t'i dhënë mundësi Bashkimit të ushtrojë kompetencën e tij të brendshme, ose për aq sa lidhja e saj mund të prekë normat e brendshme, ose mund ta ndryshojë objektin e tyre.

Neni 4

1. Bashkimi ka kompetencë të përbashkët me Shtetet Anëtare kur Traktatet i japin një kompetencë e cila nuk lidhet me fushat e përmendura në nenet 3 dhe 6.

2. Kompetenca e ndarë midis Bashkimit dhe Shteteve Anëtare zbatohet në fushat e mëposhtme parësore:

(a) tregu i brendshëm;

(b) politika sociale, për aspektet e përcaktuara në këtë Traktat;

(c) kohezioni ekonomik, social dhe territorial;

(d) bujqësia dhe peshkimi, pa përfshirë ruajtjen e burimeve biologjike detare;

(e) mjedisi;

(f) mbrojtja e konsumatorit;

(g) transporti;

(h) rrjetet Trans-Europiane;

(i) energjetika;

(j) zona e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë;

(k) shqetësimet e përbashkëta për sigurinë në çështjet e shëndetit publik, për aspektet e përcaktuara

në këtë Traktat.

3. Në fushat e kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësirës, Bashkimi ka kompetencë të zhvillojë aktivitete, sidomos të caktojë dhe zbatojë programe. Megjithatë, ushtrimi i kësaj kompetence nuk pengon Shtetet Anëtare të ushtrojnë kompetencat e tyre.

4. Në fushat e bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmë humanitare, Bashkimi ka kompetencë të zhvillojë veprimtari dhe një politikë të përbashkët. Megjithatë, ushtrimi i kësaj kompetence nuk i pengon Shtetet Anëtare të ushtrojnë kompetencat e tyre.

Neni 5

1. Shtetet Anëtare i bashkërendojnë politikat e tyre ekonomike brenda Bashkimit. Për këtë qëllim, Këshilli miraton masa, në veçanti udhëzime të përgjithshme për këto politika.

Dispozita të veçanta zbatohen për ato Shtete Anëtare monedha e të cilave është euro.

2. Bashkimi merr masa për të siguruar bashkërendimin e politikave të punësimit të Shteteve Anëtare, në veçanti, duke përcaktuar udhëzime për këto politika.

3. Bashkimi merr nisma për të siguruar bashkërendimin e politikave sociale të Shteteve Anëtare.

Neni 6

Bashkimi ka kompetencë për kryerjen e veprimeve për të mbështetur, bashkërenduar ose plotësuar veprimet e Shteteve Anëtare. Fushat e një veprimi të tillë, në nivel Europian, janë:

(a) mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njeriut;

(b) industria;

(c) kultura;

(d) turizmi;

(e) arsimi, formimi profesional, rinia dhe sporti;

(f) mbrojtja civile;

(g) bashkëpunimi administrativ.

TITULLI II

DISPOZITA ME ZBATIM TË PËRGJITHSHËM

Neni 7

Bashkimi siguron pajtueshmërinë midis politikave dhe aktiviteteve të tij, duke marrë në konsideratë të gjitha objektivat e tij dhe në përputhje me parimin e delegimit të kompetencave.

Neni 8
(ish-neni 3(2) TKE)[1]

Në të gjitha aktivitetet e tij, Bashkimi ka si qëllim eliminimin e pabarazive dhe nxitjen e barazisë midis burrave dhe grave.

Neni 9

Gjatë vendosjes dhe zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të tij, Bashkimi merr në konsideratë kërkesat lidhur me promovimin e një niveli të lartë të punësimit, garantimin e mbrojtjes së mjaftueshme sociale, luftën kundër përjashtimit social dhe një nivel të lartë arsimi, formimi dhe mbrojtjeje të shëndetit të njeriut.

Neni 10

Gjatë vendosjes dhe zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të veta, Bashkimi ka si qëllim luftën kundër diskriminimit për shkak të gjinisë, racës ose origjinës etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual.

Neni 11
(ish-neni 6 TKE)

Kërkesat për mbrojtjen e mjedisit duhet të integrohen në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit, sidomos me synim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 12
(ish-neni 153(2) TKE)

Gjatë përcaktimit dhe zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të tjera të Bashkimit merren në konsideratë kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit.

---

[1] Këto referenca janë thjesht orientuese. Për informacion më të plotë, ju lutemi shihni tabelat e barasvlefshmërisë ndërmjet numërtimit të vjetër dhe atij të ri të dispozitave të Traktateve.

Neni 13

Gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave të Bashkimit për bujqësinë, peshkimin, transportin, tregun e brendshëm, kërkimin dhe zhvillimin teknologjik dhe hapësirën, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, duke qenë se kafshët janë qenie me ndjenja, u kushtojnë vëmendje të plotë kërkesave të mirëqenies së kafshëve, duke respektuar në të njëjtën kohë dispozitat legjislative ose administrative dhe zakonet e Shteteve Anëtare, sidomos lidhur me ritet fetare, traditat kulturore dhe trashëgiminë fetare.

Neni 14
(ish-neni 16 TKE)

Pa cenuar nenin 4 të Traktatit për Bashkimin Europian ose nenet 93, 106 dhe 107 të këtij Traktatit dhe duke pasur parasysh vendin që zënë shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik në vlerat e përbashkëta të Bashkimit si dhe rolin e tyre në nxitjen e kohezionit social dhe territorial, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, secili brenda kompetencave përkatëse të tyre dhe brenda fushës së zbatimit të Traktateve, kujdesen që shërbime të tilla të ushtrohen në bazë të parimeve dhe kushteve, veçanërisht të kushteve ekonomike dhe financiare, të cilat u japin mundësi të përmbushin misionet e tyre. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative, i vendosin këto parime dhe kushte pa cenuar kompetencën e Shteteve Anëtare, në përputhje me Traktatet, për ofrimin, porositjen dhe financimin e shërbimeve të tilla.

Neni 15
(ish-neni 255 TKE)

1. Për të nxitur qeverisjen e mirë dhe për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile, institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit e kryejnë punën e tyre në mënyrë sa më të hapur.

2. Parlamenti Europian i zhvillon mbledhjet publikisht, ashtu siç vepron edhe Këshilli kur shqyrton dhe voton për një projekt akt legjislativ.

3. Çdo shtetas i Bashkimit dhe çdo person fizik ose juridik që ka vendbanimin ose selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar, ka të drejtën e aksesit të dokumenteve të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit, në çfarëdo forme të jenë këto dokumente, në varësi të parimeve dhe kushteve që vendosen sipas këtij paragrafi.

Parimet e përgjithshme dhe kufijtë e përcaktuar në bazë të interesit publik ose privat, që e rregullojnë këtë të drejtë të aksesit në dokumente, vendosen nga Parlamenti Europian dhe Këshilli përmes rregulloreve, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative.

Çdo institucion, organ, zyrë ose agjenci kujdeset që veprimtaria e tyre të jetë transparente dhe përcaktojnë për këtë qëllim në Rregulloret e tyre të Brendshme dispozita konkrete lidhur me aksesin në dokumentet e tyre, në përputhje me rregulloret e përmendura në nënparagrafin e dytë.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, Banka Qendrore Europiane dhe Banka Europiane e Investimeve janë subjekt i këtij paragrafi vetëm gjatë ushtrimit të detyrave të tyre administrative.

Parlamenti Europian dhe Këshilli sigurojnë botimin e dokumenteve lidhur me procedurat legjislative, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloret e përmendura në nënparagrafin e dytë.

Neni 16
(ish-neni 286 TKE)

1. Çdo person ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale që lidhen me të.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, përcaktojnë rregullat lidhur me mbrojtjen e individëve përsa i përket përpunimit të të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit dhe Shtetet Anëtare gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre, që i mbulon fusha e veprimit të drejtës së Bashkimit, dhe rregullat që lidhen me lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Respektimi i këtyre rregullave kontrollohet nga autoritete të pavarura.

Rregullat e miratuara në bazë të këtij neni nuk i cenojnë rregullat e veçanta të përcaktuara në nenin 39 të Traktatit të Bashkimit Europian.

Neni 17

1. Bashkimi respekton dhe nuk e cenon statusin që u jep legjislacioni kombëtar kishave dhe shoqatave ose komuniteteve fetare në Shtetet Anëtare.

2. Bashkimi respekton gjithashtu edhe statusin që u jep legjislacioni kombëtar organizatave filozofike dhe jofetare.

3. Duke pranuar identitetin dhe kontributin e tyre të caktuar, Bashkimi zhvillon një dialog të hapur, transparent dhe të rregullt me këto kisha dhe organizata.

PJESA E DYTË

MOSDISKRIMINIMI DHE QYTETARIA E BASHKIMIT

Neni 18
(ish-neni 12 TKE)

Brenda fushës së veprimit të Traktateve dhe pa cenuar dispozitat e posaçme që përmbajnë këto Traktate, ndalohet çdo diskriminim për shkak të shtetësisë.

Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të miratojnë rregulla që synojnë ndalimin e një diskriminimi të tillë.

Neni 19
(ish-neni 13 TKE)

1. Pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve dhe brenda kufijve të kompetencave që ato i japin Bashkimit, Këshilli duke vendosur me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative,

dhe pasi merr pëlqimin nga Parlamenti Europian, mund të marrë masat e duhura për të luftuar diskriminimin për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual.

2. Duke u shmangur nga paragrafi 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të miratojnë parimet bazë të masave stimuluese të Bashkimit, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare, për të mbështetur masën e marrë nga Shtetet Anëtare, me qëlllim që të jepet kontribut në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin 1.

Neni 20
(ish-neni 17 TKE)

1. Përmes këtij Traktati krijohet qytetaria e Bashkimit. Çdo person që mban shtetësinë e një Shteti Anëtar është qytetar i Bashkimit. Qytetaria e Bashkimit i shtohet shtetësisë kombëtare dhe nuk e zëvendëson atë.

2. Qytetarët e Bashkimit gëzojnë të drejtat dhe u nënshtrohen detyrimeve që parashikohen nga Traktatet. Ndër të tjera ata:

(a) kanë të drejtën të lëvizin dhe banojnë lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare;

(b) kanë të drejtën për të të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet për në Parlamentin Europian dhe në zgjedhjet vendore në Shtetin Anëtar, ku kanë vendbanimin kryesor, sipas të njëjtave kushte që zbatohen për shtetasit e atij Shteti;

(c) kanë të drejtën të gëzojnë, në territorin e një vendi të tretë në të cilin nuk përfaqësohet Shteti Anëtar shtetas i të cilit janë, mbrojtjen e autoriteteve diplomatike dhe konsullore të çdo Shteti Anëtar, sipas të njëjtave kushte që zbatohen për shtetasit e atij Shteti;
(d) kanë të drejtën për të paraqitur kërkesa pranë Parlamentit Europian, Avokatit Europian të Popullit dhe institucioneve dhe organeve këshillimore të Bashkimit në secilën prej gjuhëve të Traktatit dhe të marrin përgjigje në të njëjtën gjuhë.

Këto të drejta ushtrohen sipas kushteve dhe kufijve të parashikuara nga Traktatet dhe masat e miratuara në zbatim të tyre.

Neni 21
(ish-neni 18 TKE)

1. Çdo qytetar i Bashkimit ka të drejtën të lëvizë dhe banojë lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare, në varësi të kufizimeve dhe kushteve të përcaktuara nga Traktatet dhe masat e miratuara në zbatim të tyre.

2. Nëse del nevoja që Bashkimi të veprojë për ta arritur këtë objektiv dhe Traktatet nuk i kanë parashikuar kompetencat e nevojshme, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të miratojnë dispozita me qëllim që të lehtësojnë ushtrimin e të drejtave të përmendura në paragrafin 1.

3. Për të njëjtin qëllim me atë të përmendur në paragrafin 1 dhe nëse Traktatet nuk i kanë parashikuar kompetencat e nevojshme, Këshilli, duke vepruar sipas një procedure të posaçme legjislative, mund të miratojë masa lidhur me sigurimet shoqërore ose mbrojtjen sociale. Këshilli vendos me unanimitet, pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Neni 22
(ish-neni 19 TKE)

1. Çdo qytetar i Bashkimit, me vendbanim në një Shtet Anëtar shtetas i të cilit nuk është, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në zgjedhjet vendore të Shtetit Anëtar në të cilin ka vendbanimin, sipas të njëjtave kushte që zbatohen për shtetasit e atij Shteti. Kjo e drejtë ushtrohet në varësi të masave organizative të hollësishme të miratuara nga Këshilli, i cili vendos me unanimitet, sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian. Këto masa organizative mund të parashikojnë shmangie ligjore kur këto justifikohen nga probleme të caktuara të një Shteti Anëtar.

2. Pa cenuar nenin 223(1) dhe dispozitat e miratuara në zbatim të tij, çdo qytetar i Bashkimit me vendbanim në një Shtet Anëtar shtetas i të cilit nuk është, ka të drejtën të votojë dhe kandidojë në zgjedhjet për në Parlamentin Europian në Shtetin Anëtar në të cilin ka vendbanimin, sipas të njëjtave kushte që zbatohen për shtetasit e atij Shteti. Kjo e drejtë ushtrohet në varësi të masave organizative të hollësishme të miratuara nga Këshilli, i cili vendos me unanimitet, sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian; këto masa organizative mund të parashikojnë shmangie ligjore kur këto justifikohen nga probleme të caktuara të një Shteti Anëtar.

Neni 23
(ish-neni 20 TKE)

Çdo qytetar i Bashkimit ka të drejtën të gëzojë, në territorin e një vendi të tretë në të cilin nuk përfaqësohet Shteti Anëtar shtetas i të cilit është, mbrojtjen e autoriteteve diplomatike dhe konsullore të çdo Shteti Anëtar, sipas të njëjtave kushte që zbatohen për shtetasit e atij Shteti. Shtetet Anëtare miratojnë dispozitat e nevojshme dhe zhvillojnë bisedimet ndërkombëtare të nevojshme për të siguruar këtë mbrojtje.

Këshilli, duke vepruar sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian, mund të miratojë direktiva ku vendosen masat e bashkërendimit dhe të bashkëpunimit, të nevojshme për të mundësuar një mbrojtje të tillë.

Neni 24
(ish-neni 21 TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë dispozita për procedurat dhe kushtet që kërkohen për një nismë të qytetarëve sipas kuptimit të nenit 11 të Traktatit për Bashkimin Europian, duke përfshirë numrin minimal të Shteteve Anëtare nga të cilat duhet të jenë këta qytetarë.

Çdo qytetar i Bashkimit ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës përpara Parlamentit Europian, në përputhje me nenin 227.

Çdo qytetar i Bashkimit mund të paraqesë kërkesë përpara Avokatit të Popullit të krijuar në përputhje me nenin 228.

Çdo qytetar i Bashkimit mund t'i drejtohet me shkrim çdonjërit prej institucioneve ose organeve të përmendura në këtë nen ose në nenin 13 të Traktatit për Bashkimin Europian, në njërën prej gjuhëve të përmendura në nenin 55(1) të Traktatit për Bashkimin Europian, dhe të marrë përgjigje në të njëjtën gjuhë.

Neni 25
(ish-neni 22 TKE)

Komisioni i raporton Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komitetit Ekonomik dhe Social çdo tre vjet për zbatimin e dispozitave të kësaj Pjese. Ky raport mban në konsideratë zhvillimin e Bashkimit.

Mbi këtë bazë dhe pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve, Këshilli me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, mund të miratojë dispozita për t'i fuqizuar ose për t'i shtuar të drejtat e renditura në nenin 20(2). Këto dispozita hyjnë në fuqi, pasi aprovohen nga të gjitha Shtetet Anëtare, sipas kërkesave kushtetuese përkatëse të tyre.

PJESA E TRETË

POLITIKAT DHE VEPRIMET E BRENDSHME TË BASHKIMIT

TITULLI I

TREGU I BRENDSHËM

Neni 26
(ish-neni 14 TKE)

1. Bashkimi miraton masa me qëllim krijimin ose sigurimin e funksionimit të tregut të brendshëm, në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktateve.

2. Tregu i brendshëm përfshin një zonë pa kufij të brendshëm, në të cilën sigurohet lëvizja e lirë e mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit, në përputhje me dispozitat e Traktateve.

3. Këshilli, me propozim të Komisionit, cakton orientimet dhe kushtet e nevojshme për të siguruar një progres të ekuilibruar në të gjithë sektorët e përfshirë.

Neni 27
(ish-neni 15 TKE)

Gjatë hartimit të propozimeve me qëllim arritjen e objektivave të parashikuara në nenin 26, Komisioni merr në konsideratë shkallën e përpjekjeve që duhet të përballojnë disa ekonomi të caktuara, të cilat kanë diferenca në zhvillim, për krijimin e tregut të brendshëm, dhe mund të propozojë dispozita të përshtatshme.

Nëse këto dispozita marrin formën e shmangieve, ato duhet të kenë natyrë të përkohshme dhe duhet të shkaktojnë çrregullime sa më të vogla të mundshme për funksionimin e tregut të brendshëm.

TITULLI II

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

Neni 28
(ish-neni 23 TKE)

1. Bashkimi përfshin një bashkim doganor i cili mbulon të gjithë tregtinë e mallrave dhe i cili kërkon ndalimin midis Shteteve Anëtare të taksave doganore mbi importet dhe eksportet, dhe të të gjitha detyrimeve me efekt të njëjtë, si dhe miratimin e një tarife të përbashkët doganore në marrëdhëniet e tyre me vendet e treta.

2. Dispozitat e nenit 30 dhe të Kreut 2 të këtij Titulli zbatohen për produktet që e kanë origjinën në Shtetet Anëtare dhe për produktet që vijnë nga vendet e treta dhe që janë në qarkullim të lirë në Shtetet Anëtare.

Neni 29
(ish-neni 24 TKE)

Produktet që vijnë nga një vend i tretë konsiderohen se janë në qarkullim të lirë në një Shtet Anëtar, nëse janë respektuar formalitetet e importimit dhe nëse janë vjelur në këtë Shtet Anëtar taksat doganore ose detyrimet me efekt të njëjtë dhe nëse këto produkte nuk kanë përfituar nga një tërheqje e plotë ose e pjesshme e këtyre detyrimeve.

KREU 1

BASHKIMI DOGANOR

Neni 30
(ish-neni 25 TKE)

Taksat doganore mbi importet dhe eksportet dhe detyrimet me efekt të njëjtë janë të ndaluara midis Shteteve Anëtare. Ky ndalim zbatohet edhe për taksat doganore me natyrë fiskale.

Neni 31
(ish-neni 26 TKE)

Tarifat e Përbashkëta Doganore caktohen nga Këshilli me propozim të Komisionit.

Neni 32
(ish-neni 27 TKE)

Gjatë kryerjes së detyrave që i ka besuar ky Krye, Komisioni orientohet nga:

(a) nevoja për të nxitur tregtinë midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta;

(b) zhvillimet në kushtet e konkurrencës brenda Bashkimit për aq sa këto kushte çojnë në përmirësimin e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve;

(c) kërkesat e Bashkimit lidhur me furnizimin me lëndë të para dhe produkte gjysmë të gatshme. Në këtë aspekt, Komisioni kujdeset të shmangë kushtet shtrembëruese të konkurrencës midis Shteteve Anëtare në lidhje me produktet e gatshme;

(d) nevoja për të shmangur shqetësimet serioze në ekonomitë e Shteteve Anëtare dhe për të siguruar zhvillimin racional të prodhimit dhe rritjen e konsumit brenda Bashkimit.

KREU 2

BASHKËPUNIMI DOGANOR

Neni 33
(ish-neni 135 TKE)

Brenda fushës së zbatimit të Traktateve, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, marrin masa për ta forcuar bashkëpunimin doganor midis Shteteve Anëtare dhe midis këtyre të fundit dhe Komisionit.

KREU 3

NDALIMI I KUFIZIMEVE SASIORE MIDIS SHTETEVE ANËTARE

Neni 34
(ish-neni 28 TKE)

Kufizimet sasiore mbi importet dhe të gjitha masat me efekt të njëjtë janë të ndaluara midis Shteteve Anëtare.

Neni 35
(ish-neni 29 TKE)

Kufizimet sasiore mbi eksportet dhe të gjitha masat me efekt të njëjtë janë të ndaluara midis Shteteve Anëtare.

Neni 36
(ish-neni 30 TKE)

Dispozitat e neneve 34 dhe 35 nuk pengojnë ndalimet ose kufizimet mbi importet, eksportet ose mallrat në regjim tranzitor, të arsyetuara me moralin publik, politikën publike ose sigurinë publik; mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjen e thesareve kombëtare që kanë vlerë artistike, historike ose arkeologjike; ose mbrojtjen e pronësisë industriale dhe tregtare. Megjithatë, ndalime ose kufizime të tilla nuk përbëjnë një mjet për diskriminim arbitrar ose kufizim të maskuar mbi tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Neni 37
(ish-neni 31 TKE)

1. Shtetet Anëtare i përshtatin monopolet shtetërore me karakter tregtar, për të siguruar që të mos ekzistojë asnjë diskriminim ndërmjet shtetasve të Shteteve Anëtare, sa u takon kushteve me të cilat blihen dhe tregtohen mallrat.

Dispozitat e këtij neni zbatohen për çdo organ përmes të cilit një Shtet Anëtar, de jure ose de facto, mbikëqyr, përcakton ose ndikon ndjeshëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në importet ose eksportet midis Shteteve Anëtare. Këto dispozita zbatohen po ashtu për monopolet që Shteti ua delegon të tjerëve.

2. Shtetet Anëtare nuk marrin asnjë masë të re, e cila bie ndesh me parimet e parashtruara në paragrafin 1, ose që e kufizojnë fushën e veprimit të neneve që trajtojnë ndalimin e detyrimeve doganore dhe kufizimeve sasiore ndërmjet Shteteve Anëtare.

3. Nëse një monopol shtetëror me karakter tregtar ka rregulla të cilat janë hartuar për ta bërë më të lehtë shitjen e produkteve bujqësore ose marrjen e fitimit më të mirë për to, gjatë zbatimit të rregullave që përmban ky nen, duhen bërë hapa për të siguruar mbrojtje të barasvlefshme për punësimin dhe standardin e jetesës së prodhuesve në fjalë.

TITULLI III

BUJQËSIA DHE PESHKIMI

Neni 38
(ish-neni 32 TKE)

1. Bashkimi vendos dhe zbaton një politikë të përbashkët për bujqësinë dhe peshkimin.

Tregu i brendshëm përfshin bujqësinë, peshkimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. "Produktet bujqësore" janë produktet e tokës, blegtorisë dhe të peshkimit dhe produktet e përpunimit në fazën e parë të lidhur drejtpërdrejt me këto produkte. Kur përmendet politika e përbashkët bujqësore ose bujqësia dhe kur përdoret termi "bujqësor", duhet të kuptohet se është përfshirë edhe peshkimi, duke mbajtur në konsideratë karakteristikat e veçanta të këtij sektori.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në nenet nga 39 deri në 44, për produktet bujqësore zbatohen rregullat e përcaktuara për krijimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm.

3. Produktet që u nënshtrohen dispozitave të neneve nga 39 deri në 44 janë të renditura në Shtojcën I.

4. Shfrytëzimi dhe zhvillimi i tregut të brendshëm për produktet bujqësore duhet të shoqërohet me vendosjen e një politike të përbashkët bujqësore.

Neni 39
(ish-neni 33 TKE)

1. Objektivat e politikës së përbashkët bujqësore janë:

(a) rritja e prodhimtarisë bujqësore përmes nxitjes së përparimit teknik dhe përmes sigurimit të zhvillimit racional të prodhimit bujqësor dhe shfrytëzimit optimal të faktorëve të prodhimit, sidomos të krahut të punës;

(b) sigurimi, kështu, i një standardi të drejtë jetese për komunitetin bujqësor, sidomos përmes rritjes së fitimeve individuale të personave që merren me bujqësi;
(c) stabilizimi i tregjeve;

(d) garantimi i gatishmërisë së furnizimeve;

(e) sigurimi që produktet të shkojnë te konsumatori me çmime të arsyeshme.

2. Gjatë hartimit të politikës së përbashkët bujqësore dhe metodave të posaçme për zbatimin e saj, duhet mbajtur në konsideratë:

(a) natyra e veçantë e aktiviteteve bujqësore, e cila vjen si rezultat i strukturës shoqërore të bujqësisë dhe i pabarazive strukturore dhe natyrore midis rajoneve të ndryshme bujqësore;

(b) nevoja për të realizuar përshtatjet e duhura, shkallë-shkallë;

(c) fakti se në Shtetet Anëtare bujqësia përbën një sektor të lidhur ngushtë me ekonominë në tërësi.

Neni 40
(ish-neni 34 TKE)

1. Për të arritur objektivat e parashikuara në nenin 39, krijohet një organizim i përbashkët i tregjeve bujqësore.

Ky organizim merr njërën prej formave të mëposhtme, në varësi të produktit për të cilin bëhet fjalë:

(a) rregulla të përbashkëta për konkurrencën;

(b) bashkërendim i detyrueshëm i organizimeve të ndryshme kombëtare të tregjeve;

(c) një organizim europian të tregjeve.

2. Organizimi i përbashkët i krijuar sipas paragrafit 1 mund të përfshijë të gjitha masat e nevojshme për të arritur objektivat e parashikuara në nenin 39, sidomos rregullimin e çmimeve, ndihmat për prodhimin dhe marketingun e produkteve të ndryshme, masat magazinuese dhe transportuese dhe makineri të përbashkëta për stabilizimin e importeve ose eksporteve.

Organizimi i përbashkët kufizohet me ndjekjen e objektivave të parashikuara në nenin 39 dhe përjashton çdo diskriminim midis prodhuesve ose konsumatorëve brenda Bashkimit.

Çdo politikë e përbashkët për çmimet mbështetet në kritere të përbashkëta dhe metoda të njëjta llogaritjeje.

3. Për t'i dhënë mundësi organizimit të përbashkët të përmendur në paragrafin 1 për arritjen e objektivave të tij, mund të ngrihen një ose më shumë fonde të orientimit dhe garantimit të bujqësisë.

Neni 41
(ish-neni 35 TKE)

Për të mundësuar arritjen e objektivave të parashikuara në nenin 39, brenda kuadrit të politikës së përbashkët bujqësore parashikohen masa të tilla si:

(a) bashkërendim i efektshëm i përpjekjeve në sferat e formimit profesional, kërkimit dhe përhapjes së njohurive bujqësore; kjo mund të përfshijë financim të përbashkët të projekteve ose institucioneve;

(b) masa të përbashkëta për nxitjen e konsumimit të produkteve të caktuara.

Neni 42
(ish-neni 36 TKE)

Dispozitat e këtij Kreu të lidhura me rregullat për konkurrencën zbatohen për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, vetëm për aq sa vendos Parlamenti Europian dhe Këshilli brenda kuadrit të nenit 43(2) dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në atë nen, duke u kushtuar vëmendje objektivave të parashikuara në nenin 39.
Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të lejojë dhënien e ndihmës:

(a) për mbrojtjen e ndërmarrjeve të vendosura në gjendje të pafavorshme nga kushtet strukturore ose natyrore;

(b) brenda kuadrit të programeve për zhvillim ekonomik.

Neni 43
(ish-neni 37 TKE)

1. Komisioni paraqet propozime për hartimin dhe zbatimin e politikës së përbashkët bujqësore, duke përfshirë zëvendësimin e organizimeve kombëtare me njërën prej formave të organizimit të përbashkët të parashikuara në nenin 40(1), dhe për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë Titull.

Këto propozime marrin në konsideratë ndërvarësinë e çështjeve bujqësore të përmendura në këtë Titull.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, vendosin organizimin e përbashkët të tregjeve bujqësore të parashikuar në nenin 40(1) dhe miratojnë dispozitat e tjera të nevojshme për ndjekjen e objektivave të politikës së përbashkët bujqësore dhe politikës së përbashkët për peshkimin.

3. Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton masat për caktimin e çmimeve, detyrimeve, ndihmës dhe kufizimeve sasiore dhe për caktimin dhe shpërndarjen e mundësive për peshkim.

4. Në përputhje me paragrafin 2, organizimet kombëtare të tregjeve mund të zëvendësohen me organizimin e përbashkët të parashikuar në nenin 40(1), nëse:

(a) organizimi i përbashkët u ofron Shteteve Anëtare, të cilat e kundërshtojnë këtë masë dhe të cilat kanë një organizim të vetin për prodhimin në fjalë, masa mbrojtëse të barasvlefshme për punësimin dhe standardin e jetesës së prodhuesve në fjalë, duke u kushtuar vëmendje përshtatjeve që do të jenë të mundshme dhe specializimit që do të jetë i nevojshëm me kalimin e kohës;

(b) një organizim i tillë siguron kushtet për tregti , brenda Bashkimit, të ngjashme me ato që ekzistojnë në një treg kombëtar.

5. Nëse krijohet një organizim i përbashkët për disa lëndë të para përpara se të ekzistojë një organizim i përbashkët për produktet përkatëse të përpunuara, këto lëndë të para që përdoren për produktet e përpunuara që janë për eksport në vende të treta mund të importohen nga jashtë Bashkimit.

Neni 44
(ish-neni 38 TKE)

Kur në një Shtet Anëtar, produkti i nënshtrohet një organizimi kombëtar të tregut ose rregullave të brendshme, që kanë efekt të njëjtë të cilat prekin pozicionin konkurrues të prodhimit të ngjashëm në një Shtet tjetër Anëtar, nga Shtetet Anëtare zbatohet një tarifë kundërpeshuese për importet e këtij produkti që vjen nga Shteti Anëtar ku ekzistojnë ky organizim ose rregulla nëse ky Shtet nuk zbaton një tarifë kundërpeshuese mbi eksportet.

Komisioni vendos vlerën e këtyre taksave, në nivelin që duhet, për të rregulluar balancën. Ai mund të lejojë edhe masa të tjera, kushtet dhe hollësitë e të cilave i vendos vetë.

TITULLI IV

LËVIZJA E LIRË E PERSONAVE, SHËRBIMEVE DHE KAPITALEVE

KREU 1

PUNONJËSIT

Neni 45
(ish-neni 39 TKE)

1. Brenda Bashkimit sigurohet liria e lëvizjes për punonjësit.

2. Një liri e tillë e lëvizjes përfshin ndalimin e çdo diskriminimi për shkak të shtetësisë mes punonjësve të Shteteve Anëtare, sa i takon punësimit, shpërblimit dhe kushteve të tjera të punës dhe marrëdhënieve të punës.

3. Ajo përfshin të drejtën, subjekt të kufizimeve të justifikuara për shkak të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik:

(a) për të pranuar oferta reale punësimi;

(b) për të lëvizur lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare për këtë qëllim;

(c) për të qëndruar në një Shtet Anëtar, me qëllim punësimi, në përputhje me dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet e punës të shtetasve të atij Shteti të përcaktuara në akte ligjore, nënligjore ose administrative;

(d) për të qëndruar në territorin e një Shteti Anëtar pas fillimit të marrëdhënieve të punës në atë Shtet, në varësi të kushteve që përcaktohen në rregulloret që harton Komisioni.

4. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për marrëdhëniet e punës në shërbimin publik.

Neni 46
(ish-neni 40 TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pas konsultimit me Komitetin Ekonomik dhe Social, nxjerrin direktiva ose miratojnë rregullore ku parashikohen masat e nevojshme për të realizuar lirinë e lëvizjes për punonjësit, sipas nenit 45, sidomos:

(a) duke siguruar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet shërbimeve kombëtare të punësimit;

(b) duke ndaluar ato procedura dhe praktika administrative dhe ato periudha kualifikuese për të fituar të drejtën e punësimit, që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar ose nga marrëveshjet e lidhura më parë midis Shteteve Anëtare, mbajtja e të cilave do të përbënte një pengesë për liberalizimin e lëvizjes së punonjësve;

(c) duke ndaluar të gjitha ato periudha kualifikuese dhe kufizime të tjera të parashikuara nga legjislacioni kombëtar ose nga marrëveshjet e lidhura më parë midis Shteteve Anëtare që vendosen mbi punonjësit e Shteteve të tjera Anëtare, lidhur me zgjedhjen e lirë të punësimit, me përjashtim të atyre që nuk janë të njëjta me ato që vendosen mbi punonjësit e Shtetit në fjalë;

(d) duke ngritur mekanizmin e duhur për t'i afruar ofertat për punësim me kërkesat për punësim dhe për të mundësuar arritjen e një drejtpeshimi midis ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, në mënyrë të atillë që të shmangen rreziqet serioze ndaj standardit të jetesës dhe nivelit të punësimit në rajonet dhe sektorët e ndryshëm të ekonomisë.

Neni 47
(ish-neni 41 TKE)

Shtetet Anëtare, brenda kuadrit të një programi të përbashkët, nxisin shkëmbimin e punonjësve në moshë të re.

Neni 48
(ish-neni 42 TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masa në fushën e sigurimeve shoqërore që janë të nevojshme për të siguruar lirinë e lëvizjes për punonjësit. Për këtë qëllim, ata marrin masat për të siguruar për punonjësit migrues të punësuar, të vetëpunësuar si dhe për personat që i kanë këta në varësi:

(a) agregimin, me qëllim fitimin dhe mbajtjen e të drejtës për përfitim dhe llogaritjen e vlerës së përfitimit, e të gjitha periudhave që merren në konsideratë sipas ligjeve të disa vendeve;

(b) pagesën e përfitimeve personave që kanë vendbanimin në territoret e Shteteve Anëtare.

Kur një anëtar i Këshillit deklaron se një projektakt legjislativ i përmendur në nënparagrafin e parë do të prekte aspekte të rëndësishme të sistemit të tij të sigurimeve shoqërore, përfshirë fushën e veprimit ose strukturën financiare a të kostos, ose do të prekte ekuilibrin financiar të këtij sistemi, ai mund të kërkojë që çështja t'i përcillet Këshillit Europian. Në këtë rast, procedura e zakonshme legjislative pezullohet. Pas diskutimit, brenda katër muajve prej këtij pezullimi, Këshilli Europian, ose:

(a) ia rikalon çështjen Këshillit, i cili i jep fund pezullimit të procedurës së zakonshme legjislative; ose

(b) nuk bën asnjë veprim ose i kërkon Komisionit të paraqesë një propozim të ri. Në këtë rast, konsiderohet se akti i propozuar më parë nuk është miratuar.

KREU 2

E DREJTA E VENDOSJES

Neni 49
(ish-neni 43 TKE)

Brenda kuadrit të dispozitave të parashikuara më poshtë, ndalohen kufizimet mbi lirinë e vendosjes së shtetasve të një Shteti Anëtar në territorin e një Shteti Anëtar tjetër. Ky ndalim zbatohet edhe për kufizimet mbi ngritjen e agjencive, degëve ose filialeve nga shtetasit e çdo Shteti Anëtar të vendosur në territorin e një Shteti tjetër Anëtar.

Liria e vendosjes përfshin të drejtën për të nisur dhe ndjekur veprimtari si persona të vetëpunësuar dhe për të ngritur dhe administruar ndërmarrje, në veçanti shoqëri tregtare apo firma sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 54, në bazë të kushteve të përcaktuara për shtetasit e vetë Shtetit Anëtar në legjislacionin e vendit ku realizohet kjo vendosje, në varësi të dispozitave të Kapitullit mbi kapitalin.

Neni 50
(ish-neni 44 TKE)

1. Për të arritur lirinë e vendosjes në lidhje me një aktivitet të veçantë, Parlamenti Europian dhe Këshilli veprojnë përmes direktivave, duke ndjekur procedurën e zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social.

2. Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni realizojnë detyrat që ua ngarkojnë dispozitat e mëparshme, në veçanti:

(a) duke u dhënë, si rregull i përgjithshëm, trajtim me përparësi të atyre aktiviteteve ku liria e vendosjes jep një kontribut veçanërisht të vlefshëm për zhvillimin e prodhimit dhe të tregtisë;

(b) duke siguruar bashkëpunim të ngushtë midis autoriteteve kompetente në Shtetet Anëtare për të sqaruar situatën e veçantë brenda Bashkimit, të aktiviteteve të ndryshme në fjalë;

(c) duke ndaluar ato procedura dhe praktika administrative, të cilat rrjedhin nga legjislacioni kombëtar ose nga marrëveshjet e lidhura më parë midis Shteteve Anëtare, mbajtja e të cilave do të përbënte pengesë për lirinë e vendosjes;

(d) duke siguruar që punonjësit e një Shteti Anëtar të punësuar në territorin e një Shteti tjetër Anëtar të mund të qëndrojnë në këtë territor, me qëllim nisjen e aktiviteteve atje si persona të vetëpunësuar, kur i përmbushin kushtet që do t'u kërkohej t'i përmbushnin nëse do të hynin në atë Shtet në kohën kur kishin si qëllim ta nisnin një aktivitet të tillë;

(e) duke i dhënë mundësi një shtetasi të një Shteti Anëtar të blejë dhe të përdorë tokë dhe ndërtesa që ndodhen në territorin e një Shteti tjetër Anëtar, për aq sa kjo nuk bie ndesh me parimet e përcaktuara në nenin 39(2);

(f) duke bërë ndalimin progresiv të kufizimeve mbi lirinë e vendosjes në çdo degë aktiviteti në shqyrtim, sa u takon si kushteve për krijimin e agjencive, degëve apo filialeve në territorin e një Shteti Anëtar, ashtu edhe filialeve në territorin e një Shteti Anëtar apo kushteve që rregullojnë hyrjen e personelit që i përket shoqërisë mëmë, në poste administruese ose mbikëqyrëse në agjenci, degë apo filiale të tilla;

(g) duke bashkërenduar, për aq sa është e nevojshme, masat mbrojtëse të cilat, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, kërkohen nga Shtetet Anëtare të shoqërive tregtare ose firmave brenda kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 54 me qëllim që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlefshme në të gjithë Bashkimin;

(h) duke u bindur që kushtet e vendosjes të mos shtrembërohen nga ndihmat që japin Shtetet Anëtare.

Neni 51
(ish-neni 45 TKE)

Dispozitat e këtij Kreu nuk zbatohen, për një Shtet Anëtar të caktuar, mbi veprimtaritë të cilat në këtë Shtet janë të lidhura qoftë edhe rastësisht, me ushtrimin e pushtetit publik.

Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të vendosin që dispozitat e këtij Kreu të mos zbatohen për disa aktivitete të caktuara.

Neni 52
(ish-neni 46 TKE)

1. Dispozitat e këtij Kreu dhe masat e marra në bazë të tyre nuk e cenojnë zbatueshmërinë e dispozitave të përcaktuara në akte ligjore, nënligjore ose administrative, ku parashikohet trajtim i veçantë për shtetasit e huaj për shkak të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, nxjerrin direktiva për bashkërendimin e dispozitave të lartpërmendura.

Neni 53
(ish-neni 47 TKE)

1. Për t'ua bërë më të lehtë personave të nisin dhe ndjekin aktivitet si të vetëpunësuar, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, nxjerrin direktiva për njohjen e ndërsjellë të diplomave, certifikatave dhe dëshmive të tjera të kualifikimeve formale dhe për bashkërendimin e dispozitave të përcaktuara në akte ligjore, nënligjore ose administrative në Shtetet Anëtare lidhur me nisjen dhe ndjekjen e veprimtarive si të vetëpunësuar.

2. Në rastin e profesioneve mjekësore dhe farmaceutike, ndalimi progresiv i kufizimeve varet nga bashkërendimi i kushteve për ushtrimin e tyre në Shtetet e ndryshme Anëtare.

Neni 54
(ish-neni 48 TKE)

Shoqëritë tregtare ose firmat e krijuara sipas ligjit të një Shteti Anëtar dhe që e kanë selinë e regjistruar, zyrat qendrore ose vendin kryesor të veprimtarisë brenda Bashkimit, për qëllimet e këtij Kreu, trajtohen njësoj si personat fizik që janë shtetas të Shteteve Anëtare.

"Shoqëritë tregtare ose firmat" janë shoqëri tregtare ose firma të regjistruara sipas të drejtës civile apo tregtare, duke përfshirë edhe shoqëritë e formës kooperativë si dhe personat e tjerë juridikë që i rregullon e drejta publike apo private, me përjashtim të atyre që janë jofitimprurëse.

Neni 55
(ish-neni 294 TKE)

Shtetet Anëtare u japin shtetasve të Shteteve të tjera Anëtare të njëjtin trajtim me shtetasit e tyre, sa i takon pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare ose firmave sipas kuptimit të nenit 54, pa cenuar zbatimin e dispozitave të tjera të Traktateve.

KREU 3

SHËRBIMET

Neni 56
(ish-neni 49 TKE)

Brenda kuadrit të dispozitave të parashikuara më poshtë,ndalohen kufizimet mbi lirinë e ofrimit të shërbimeve brenda Bashkimit lidhur me shtetasit e Shteteve Anëtare, të cilët janë vendosur në një Shtet Anëtar që është i ndryshëm nga ai i personit për të cilin ofrohen shërbimet.

Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund t'i shtrijnë dispozitat e këtij Kreu për të përfshirë shtetasit e një vendi të tretë të cilët ofrojnë shërbime dhe të cilët janë vendosur brenda Bashkimit.

Neni 57
(ish-neni 50 TKE)

Shërbimet konsiderohen si "shërbime" sipas kuptimit të Traktateve kur normalisht ofrohen kundrejt një shpërblimi, për aq sa nuk rregullohen nga dispozitat, që lidhen me lirinë e lëvizjes së mallrave, kapitalit dhe personave.

Në veçanti, "shërbimet" përfshijnë:

(a) aktivitetet me karakter industrial;

(b) aktivitetet me karakter tregtar;

(c) aktivitetet e artizanëve;

(d) aktivitetet e profesioneve.

Pa cenuar dispozitat e Kreut lidhur me të drejtën e vendosjes, personi që ofron shërbime, për ta bërë një gjë të tillë, mund ta ndjekë aktivitetin e tij përkohësisht në Shtetin Anëtar ku ofrohet shërbimi, me të njëjtat kushte me ato që ky Shtet vendos për shtetasit e tij.

Neni 58
(ish-neni 51 TKE)

1. Liria për të ofruar shërbime në fushën e transportit rregullohet nga dispozitat e Titullit që lidhet me transportin.

2. Liberalizimi i shërbimeve bankare dhe të sigurimeve, lidhur me lëvizjen e kapitalit, bëhet njëkohësisht me liberalizimin e lëvizjes së kapitalit.

Neni 59
(ish-neni 52 TKE)

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, nxjerrin direktiva për të arritur liberalizimin e një shërbimi të caktuar.

2. Lidhur me direktivat e përmendura në paragrafin 1, si rregull i përgjithshëm, përparësi u jepet atyre shërbimeve të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në kostot e prodhimit ose, liberalizimi i të cilave ndihmon, në promovimin e tregtisë së mallrave.

Neni 60
(ish-neni 53 TKE)

Shtetet Anëtare bëjnë përpjekje për të kryer liberalizimin e shërbimeve përtej shkallës së kërkuar prej direktivave të nxjerra në bazë të nenit 59(1), nëse ua lejon gjendja e përgjithshme ekonomike dhe gjendja e sektorit ekonomik në fjalë.

Për këtë qëllim, Komisioni u jep rekomandime Shteteve Anëtare në fjalë.

Neni 61
(ish-neni 54 TKE)

Për sa kohë nuk janë hequr kufizimet mbi lirinë për të ofruar shërbime, secili Shtet Anëtar i zbaton këto kufizime, pa bërë dallime, sipas shtetësisë apo vendbanimit kryesor për të gjithë personat që ofrojnë shërbime sipas kuptimit të paragrafit të parë të nenit 56.

Neni 62
(ish-neni 55 TKE)

Për çështjet që mbulon ky Krye zbatohen dispozitat e neneve nga 51 deri në 54.

KREU 4

KAPITALI DHE PAGESAT

Neni 63
(ish-neni 56 TKE)

1. Brenda kuadrit të dispozitave të parashikuara në këtë kapitulli, ndalohen të gjitha kufizimet mbi lëvizjen e kapitalit midis Shteteve Anëtare dhe midis Shteteve Anëtare e vendeve të treta.

2. Brenda kuadrit të dispozitave të parashikuara në këtë kapitull, ndalohen të gjitha kufizimet mbi pagesat midis Shteteve Anëtare dhe midis Shteteve Anëtare e vendeve të treta.

Neni 64
(ish-neni 57 TKE)

1. Dispozitat e nenit 63 nuk e cenojnë zbatimin për vendet e treta të kufizimeve të cilat ekzistojnë më 31 dhjetor 1993 në bazë të legjislacionit kombëtar ose atij të Bashkimit, lidhur me lëvizjen e kapitalit drejt vendeve të treta ose prej tyre, që kanë të bëjnë me investimet e drejtpërdrejta, duke përfshirë edhe investimet në pasuri të paluajtshme, vendosjen, ofrimin e shërbimeve financiare ose pranimin e letrave me vlerë në tregjet e kapitalit. Sa u takon kufizimeve që ekzistojnë sipas legjislacionit kombëtar të Bullgarisë, Estonisë dhe Hungarisë, data e përcaktuar është 31 dhjetor 1999.

2. Ndërkohë që bëjnë përpjekje për të arritur objektivin e lëvizjes së lirë të kapitalit midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta sa më shumë të jetë e mundur dhe pa cenuar Krerët e tjerë të Traktateve, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masa për lëvizjen e kapitalit drejt vendeve të treta dhe prej tyre që ka të bëjë me investimet e drejtpërdrejta - duke përfshirë investimet në pasuri të paluajtshme - vendosjen, ofrimin e shërbimeve financiare ose pranimin e letrave me vlerë në tregjet e kapitalit.

3. Pavarësisht parashikimeve të paragrafit 2, vetëm Këshilli, duke vepruar sipas një procedure të posaçme legjislative, mund të miratojë unanimisht, pasi konsultohet me Parlamentin Europian, masa të cilat përbëjnë një hap mbrapa në legjislacionin e Bashkimit lidhur me liberalizimin e lëvizjes së kapitalit drejt vendeve të treta ose prej tyre.

Neni 65
(ish-neni 58 TKE)

1. Dispozitat e nenit 63 nuk e cenojnë të drejtën e Shteteve Anëtare:

(a) për të zbatuar dispozitat përkatëse të legjislacionit tatimor, të cilat bëjnë dallim midis tatimpaguesve që nuk ndodhen në të njëjtën situatë lidhur me vendbanimin kryesor ose lidhur me vendndodhjen e investimit të kapitalit të tyre;

(b) për të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e shkeljes së akteve ligjore dhe nënligjore kombëtare, sidomos në fushën e tatim-taksave dhe të mbikëqyrjes së matur të institucioneve financiare, ose për të përcaktuar procedura për deklarimin e lëvizjeve të kapitalit me qëllim informacioni administrativ ose statistikor, ose për të marrë masat që arsyetohen me politikën publike ose sigurinë publike.

2. Dispozitat e këtij Kreu nuk e cenojnë zbatueshmërinë e kufizimeve mbi të drejtën e vendosjes, të cilat janë në pajtim me Traktatet.

3. Masat dhe procedurat e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 nuk duhet të përbëjnë një mjet për diskriminim arbitrar ose kufizim të maskuar për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe pagesave, sipas përkufizimit në nenin 63.

4. Në mungesë të masave të parashikuara në nenin 64(3), Komisioni, ose në mungesë të nxjerrjes së një vendimi nga ai brenda tre muajve pas kërkesës së Shtetit Anëtar në fjalë, Këshilli mund të miratojë një vendim ku thuhet se masat kufizuese tatimore që ka miratuar një Shtet Anëtar në lidhje me një ose më shumë vende të treta konsiderohen se janë në pajtim me Traktatet, për aq sa arsyetohen me njërin prej objektivave të Bashkimit, dhe janë në pajtim me funksionimin e duhur të tregut të brendshëm. Këshilli vendos me unanimitet me kërkesën e një Shteti Anëtar.

Neni 66
(ish-neni 59 TKE)

Kur në rrethana të jashtëzakonshme lëvizjet e kapitalit drejt një ose prej vendeve të treta shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë vështirësi serioze për funksionimin e bashkimit ekonomik dhe monetar, Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Bankën Qendrore Europiane, mund të marrë masa mbrojtëse në lidhje me vendet e treta për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj, nëse masa të tilla janë me të vërtetë të nevojshme.

TITULLI V

ZONA E LIRISË, SIGURISË DHE DREJTËSISË

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 67
(ish-neni 61 TKE dhe ish-neni 29 TBE)

1. Bashkimi përbën një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie, lidhur me respektimin e të drejtave themelore, sistemeve dhe traditave të ndryshme juridike të Shteteve Anëtare.

2. Ai garanton heqjen e kontrolleve të kufijve të brendshëm për personat dhe përcakton një politikë të përbashkët për azilin, imigracionin dhe kontrollin e kufijve të jashtëm, mbështetur në solidaritetin midis Shteteve Anëtare, që të jetë e drejtë kundrejt shtetasve të vendeve të treta. Në kuptimin e këtij Titulli, personat pa shtetësi trajtohen si shtetas të vendeve të treta.

3. Bashkimi bën përpjekje për të siguruar një nivel të lart sigurie përmes masave për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, racizmit dhe ksenofobisë dhe përmes masave për bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve policore dhe gjyqësore dhe autoriteteve të tjera kompetente, si edhe përmes njohjes së ndërsjellë të aktgjykimeve në çështjet penale dhe, nëse është nevoja, përmes përafrimit të legjislacionit penal.

4. Bashkimi mundëson ushtrimin e të drejtës për t'iu drejtuar sistemit të drejtësisë, sidomos përmes parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile.

Neni 68

Këshilli Europian jep orientimet strategjike për planifikimin legjislativ dhe operacional në zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Neni 69

Parlamentet kombëtare kujdesen që propozimet dhe nismat legjislative të paraqitura sipas Krerëve 4 dhe 5 të respektojnë parimin e subsidiaritetit, në përputhje me masat e përcaktuara nga Protokolli për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

Neni 70

Pa cenuar nenet 258, 259 dhe 260, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë masa përmes të cilave Shtetet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, bëjnë një vlerësim objektiv dhe të paanshëm të zbatimit të politikave të Bashkimit, të përmendura në këtë Titull nga autoritetet e Shteteve Anëtare, sidomos për të mundësuar zbatimin e plotë të parimit të njohjes së ndërsjellë. Parlamenti Europian dhe Parlamentet kombëtare informohen për përmbajtjen dhe rezultatet e vlerësimit.

Neni 71
(ish-neni 36 TBE)

Pranë Këshillit ngrihet një komitet i përhershëm, për të siguruar nxitjen dhe fuqizimin brenda Bashkimit të bashkëpunimit operacional për sigurinë e brendshme. Pa cenuar nenin 240, ky komitet mundëson bashkërendimin e veprimeve të autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare. Përfaqësuesit e organeve, zyrave dhe agjencive përkatëse të Bashkimit mund të përfshihen në punimet e këtij komiteti. Parlamenti Europian dhe Parlamentet kombëtare mbahen të informuara për punimet.

Neni 72
(ish-neni 64(1) TKE dhe ish-neni 33 TBE)

Ky Titull nuk e prek ushtrimin e përgjegjësive që u takojnë Shteteve Anëtare lidhur me ruajtjen e rendit dhe ligjit, si dhe garantimin e sigurisë së brendshme.

Neni 73

Shtetet Anëtare janë të lira të organizojnë me njëri-tjetrin dhe nën përgjegjësinë e tyre forma të tilla bashkëpunimi dhe bashkërendimi, të cilat i konsiderojnë të përshtatshme midis drejtorive kompetente të administratave të tyre që janë përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë kombëtare.

Neni 74
(ish-neni 66 TKE)

Këshilli miraton masa për të siguruar bashkëpunimin administrativ ndërmjet drejtorive përkatëse të Shteteve Anëtare në fushat që mbulon ky Titull, si edhe midis këtyre drejtorive dhe Komisionit. Këshilli vepron me propozim të Komisionit, duke respektuar parashikimet e nenit 76, dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Neni 75
(ish-neni 60 TKE)

Kur është e nevojshme për të arritur objektivat e parashikuara në nenin 67, lidhur me parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit dhe veprimtarive të lidhura me të, Parlamenti Europian vendos përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative, një kuadër për masat administrative lidhur me lëvizjet e kapitalit dhe pagesat, siç janë ngrirja e fondeve, pasurive financiare ose fitimeve ekonomike që u përkasin ose janë në pronësi të personave fizikë ose juridikë, grupimeve ose subjekteve jo shtetërore.

Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton masat për vënien në zbatim të kuadrit të përmendur në paragrafin e parë.

Aktet e përmendura në këtë nen, përfshijnë dispozitat e nevojshme për masat mbrojtëse ligjore.

Neni 76

Aktet e përmendura në Kreun 4 dhe 5, së bashku me masat e përmendura në nenin 74 që sigurojnë bashkëpunimin administrativ në fushat që mbulojnë këta krerë, miratohen:

(a) me propozim të Komisionit, ose

(b) me nismën e një të katërtës së Shteteve Anëtare.

KREU 2

POLITIKAT PËR KONTROLLET KUFITARE, AZILIN DHE IMIGRIMIN

Neni 77
(ish-neni 62 TKE)

1. Bashkimi harton një politikë me qëllim:

(a) sigurimin e heqjes së çdo kontrolli mbi personat, të çfarëdo shtetësie qofshin, kur kalojnë kufijtë e brendshëm;

(b) realizimin e kontrolleve mbi personat dhe vëzhgimin efikas të kalimit në kufijtë e jashtëm;

(c) futjen graduale të një sistemi menaxhimi të integruar për kufijtë e jashtëm.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli miratojnë, sipas procedurës së zakonshme legjislative, masa në lidhje me:

(a) politikën e përbashkët për vizat dhe lejet e tjera të qëndrimit afatshkurtër;

(b) kontrollet të cilave u nënshtrohen personat që kalojnë kufijtë e jashtëm;

(c) kushtet me të cilat shtetasit e vendeve të treta gëzojnë lirinë për të udhëtuar për një periudhë të shkurtër brenda Bashkimit;

(d) çdo masë të nevojshme për vendosjen graduale të një sistemi menaxhimi të integruar për kufijtë e jashtëm;

(e) heqjen e çdo kontrolli, mbi personat e çfarëdo shtetësie qofshin, kur kalojnë kufijtë e brendshëm.

3. Nëse del nevoja që Bashkimi të veprojë për ta mundësuar ushtrimin e të drejtës së përmendur në nenin 20(2)(a) dhe nëse Traktatet nuk i kanë parashikuar kompetencat e nevojshme, Këshilli, sipas një procedure të posaçme legjislative, mund të miratojë dispozita në lidhje me pasaportat, letërnjoftimet, lejet e qëndrimit ose çdo dokument tjetër të ngjashëm. Këshilli vendos me unanimitet pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

4. Ky nen nuk e prek kompetencën e Shteteve Anëtare lidhur me përcaktimin gjeografik të kufijve të tyre, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 78
(ish-nenet 63, pikat 1 dhe 2, dhe 64(2) TKE)

1. Bashkimi harton një politikë të përbashkët për azilin, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme, me qëllim ofrimin e statusit të duhur çdo shtetasi të një vendi të tretë që kërkon mbrojtje ndërkombëtare dhe sigurimin e respektimit të parimit të moskthimit në vendin ku rrezikohet liria ose jeta e azilkërkuesit. Kjo politikë duhet të pajtohet me Konventën e Gjenevës, datë 28.07.1951 dhe Protokollin e datës 31.01.1967 lidhur me statusin e refugjatëve, dhe me traktatet e tjera përkatëse.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masa për një sistem të përbashkët europian për azilin, që përfshin:

(a) status të njëjtë azili për shtetasit e vendeve të treta, i vlefshëm në të gjithë Bashkimin;

(b) status të njëjtë mbrojtjeje plotësuese për shtetasit e vendeve të treta të cilët, pa fituar azilin europian, kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare;

(c) sistem të përbashkët të mbrojtjes së përkohshme për personat e shpërngulur në rast të flukseve masive;

(d) procedura të përbashkëta për dhënien dhe heqjen e statusit të njëjtë të azilit ose mbrojtjes plotësuese;

(e) kritere dhe mekanizma për të përcaktuar se cili Shtet Anëtar është përgjegjës për shqyrtimin e një kërkese për azil ose mbrojtje plotësuese;

(f) standarde lidhur me kushtet për pranimin e personave që kërkojnë azil ose mbrojtje plotësuese;

(g) partneritet dhe bashkëpunim me vendet e treta me qëllim menaxhimin e fluksit të personave që kërkojnë azil ose mbrojtje plotësuese, apo të përkohshme.

3. Në rast se një a më shumë Shtete Anëtare përballen me një situatë emergjente të karakterizuar nga një fluks i papritur shtetasish të vendeve të treta, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë masa të përkohshme në favor të Shteteve Anëtare në fjalë. Ai vepron pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Neni 79
(ish-neni 63, pikat 3 dhe 4, TKE)

1. Bashkimi harton një politikë të përbashkët për imigrimin me qëllim sigurimin, në të gjitha fazat e menaxhimit efikas të flukseve migruese të trajtimit të drejtë të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në Shtetet Anëtare dhe të parandalimit të imigracionit të paligjshëm, dhe trafikimit të qenieve njerëzore si dhe të përforcimit të masave për t'i luftuar këto dy dukuri.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli miratojnë, sipas procedurës së zakonshme legjislative, masa në fushat e mëposhtme:

(a) kushtet e hyrjes, qëndrimit dhe standardet për dhënien e vizave afatgjata dhe lejeve të qëndrimit nga Shtetet Anëtare, duke përfshirë edhe ato që jepen për bashkim familjar;

(b) përkufizimi i të drejtave të shtetasve të vendeve të treta të cilët qëndrojnë ligjërisht në një Shtet Anëtar, duke përfshirë kushtet që rregullojnë lirinë e lëvizjes dhe të qëndrimit në Shtetet e tjera Anëtare;

(c) imigracioni i paligjshëm dhe qëndrimi pa leje, duke përfshirë largimin dhe riatdhesimin e personave që qëndrojnë pa leje;

(d) lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti të grave dhe fëmijëve.

3. Bashkimi mund të lidhë marrëveshje me vendet e treta për ripranimin në vendet e origjinës ose të ardhjes, të shtetasve të vendeve të treta të cilët nuk i përmbushin më kushtet e hyrjes, pranisë ose qëndrimit në territorin e njërit prej Shteteve Anëtare.

4. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të vendosin masa për dhënien e stimujve dhe mbështetjes për veprimet e Shteteve Anëtare, me qëllim nxitjen e integrimit të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në territoret e tyre, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

5. Ky nen nuk e prek të drejtën e Shteteve Anëtare për të përcaktuar vëllimet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta , që vijnë nga vendet e treta, drejt territorit të tyre për të kërkuar punë, qoftë si punëmarrës apo si të vetëpunësuar.

Neni 80

Politikat e Bashkimit të parashikuara në këtë kapitull dhe zbatimi i tyre rregullohen nga parimi i solidaritetit dhe ndarjes së drejtë të përgjegjësisë, duke përfshirë edhe rrjedhojat financiare midis Shteteve Anëtare. Sa herë është nevoja, aktet e Bashkimit të miratuara në zbatim të këtij Kreu përmbajnë masat e duhura për ta vënë në jetë këtë parim.

KREU 3

BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJET CIVILE

Neni 81
(ish-neni 65 TKE)

1. Bashkimi zhvillon një bashkëpunim gjyqësor në çështjet civile me rrjedhoja ndërkufitare, mbështetur në parimin e njohjes së ndërsjellë të aktgjykimeve si dhe vendimeve në çështjet jashtëgjyqësore. Një bashkëpunim i tillë, mund të përfshijë miratimin e masave për përafrimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masa, sidomos, kur është e nevojshme për funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, me qëllim sigurimin e:

(a) njohjes dhe zbatimit të ndërsjellë midis Shteteve Anëtare, të aktgjykimeve dhe të vendimeve në çështjet jashtëgjyqësore;

(b) dhënies ndërkufitare të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore;

(c) përputhshmërisë së rregullave të zbatueshme në Shtetet Anëtare lidhur me përplasjet e legjislacioneve dhe të juridiksioneve;

(d) bashkëpunimit në marrjen e provave;

(e) aksesit efektiv në sistemin e drejtësisë;

(f) eliminimit të pengesave ndaj funksionimit të duhur të proceseve civile, nëse është nevoja, përmes nxitjes së përafrimit të normave të procedurës civile të zbatueshme në Shtetet Anëtare;

(g) zhvillimit të mënyrave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;

(h) mbështetjes për trajnimin e gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore.

3. Pavarësisht paragrafit 2, masat që lidhen me të drejtën familjare me rrjedhoja ndërkufitare, përcaktohen nga Këshilli, i cili vepron sipas një procedure të posaçme legjislative. Këshilli vendos me unanimitet, pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë një vendim ku përcaktohen ato aspekte të së drejtës familjare me rrjedhoja ndërkufitare, të cilat mund të jenë objekt i akteve të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative. Këshilli vendos me unanimitet, pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Parlamentet kombëtare njoftohen për propozimin e përmendur në nënparagrafin e dytë. Nëse një parlament kombëtar bën të ditur kundërshtimin e vet brenda gjashtë muajve nga data e një njoftimi të tillë, vendimi nuk miratohet. Nëse nuk ka kundërshtim, Këshilli mund ta miratojë vendimin.

KREU 4

BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJET PENALE

Neni 82
(ish-neni 31 TBE)

1. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale në Bashkim mbështetet në parimin e njohjes së ndërsjellë të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore dhe përfshin përafrimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare në fushat e përmendura në paragrafin 2 të nenit 83.

Parlamenti Europian dhe Këshilli miratojnë masa sipas procedurës së zakonshme legjislative:

(a) për të përcaktuar rregullat dhe procedurat për sigurimin e njohjes në të gjithë Bashkimin, të të gjitha formave të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore;

(b) për të parandaluar dhe zgjidhur përplasjet e juridiksionit midis Shteteve Anëtare;

(c) për të mbështetur trajnimin e gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore;

(d) për të mundësuar bashkëpunimin midis autoriteteve gjyqësore ose autoriteteve të tjera të barasvlefshme të Shteteve Anëtare lidhur me procedurat në çështjet penale dhe me zbatimin e vendimeve.

2. Për aq sa është e nevojshme për mundësimin e njohjes së ndërsjellë të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore dhe të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale me dimensione ndërkufitare, Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes direktivave të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të vendosin rregulla minimale. Rregulla të tilla marrin në konsideratë dallimet midis traditave dhe sistemeve juridike të Shteteve Anëtare.

Ato kanë të bëjnë me:

(a) pranueshmërinë e ndërsjellë të provave midis Shteteve Anëtare;

(b) të drejtat e individit në procedurën penale;

(c) të drejtat e viktimës së krimit;

(d) çdo aspekt tjetër i caktuar të procedurës penale, që ka identifikuar Këshilli paraprakisht me një vendim. Për miratimin e një vendimi të tillë, Këshilli vendos me unanimitet, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian.

Miratimi i rregullave minimale të përmendura në këtë paragraf nuk i pengon Shtetet Anëtare të mbajnë ose të arrijnë një nivel më të lartë mbrojtjeje për individët.

3. Kur një anëtar i Këshillit mendon se një projektdirektivë e përmendur në paragrafin 2 do të prekte aspektet themelore të sistemit të tij të drejtësisë penale, ai mund të kërkojë që projektdirektiva t'i përcillet Këshillit Europian. Në këtë rast, procedura e zakonshme legjislative pezullohet. Pasi e diskuton, dhe nëse arrin një konsensus, Këshilli Europian, brenda katër muajve prej pezullimit, ia rikthen projektin Këshillit, i cili i jep fund pezullimit të procedurës së zakonshme legjislative.

Brenda të njëjtës periudhë nëse nuk arrihet në një marrëveshje, dhe nëse të paktën nëntë Shtete Anëtare dëshirojnë të vendosin një bashkëpunim të përforcuar në bazë të projektdirektivës në fjalë, ata njoftojnë për këtë Parlamentin Europian, Këshillin dhe Komisionin. Në këtë rast, autorizimi për të vijuar me bashkëpunim e përforcuar, të përmendur në nenin 20(2) e Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 329(1) e këtij Traktati, konsiderohet se është dhënë dhe zbatohen dispozitat për bashkëpunim e përforcuar.

Neni 83
(ish-neni 31 TBE)

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes direktivave të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të vendosin rregulla minimale lidhur me përkufizimin e veprave penale dhe sanksionet në fushat e krimeve, veçanërisht të rënda me dimensione ndërkufitare, që rrjedhin nga natyra ose efekti i veprave të tilla penale ose nga një nevojë e veçantë për t'i luftuar këto vepra penale mbi një bazë të përbashkët.

Këto fusha kriminaliteti janë: terrorizmi, trafikimi i qenieve njerëzore dhe shfrytëzimi seksual i grave dhe fëmijëve, trafikimi i paligjshëm i drogave, trafikimi i paligjshëm i armëve, pastrimi i parave, korrupsioni, falsifikimi i mjeteve të pagesës, krimi kompjuterik dhe krimi i organizuar.

Në bazë të zhvillimeve të kriminalitetit, Këshilli mund të miratojë një vendim me të cilin identifikon fusha të tjera të kriminalitetit, që përmbushin kriteret e këtij paragrafi. Ai vendos me unanimitet, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian.

2. Nëse përafrimi i akteve ligjore dhe nënligjore penale të Shteteve Anëtare shikohet si thelbësor për sigurimin e zbatimit të efektshëm të një politike të Bashkimit në një fushë që është objekt i masave të harmonizimit, direktivat mund të vendosin rregulla minimale lidhur me përkufizimin e veprave penale dhe të sanksioneve në fushën në fjalë. Direktiva të tilla miratohen

sipas të njëjtës procedurë të zakonshme ose të posaçme penale që është ndjekur për miratimin e masave për harmonizimin në fjalë, pa cenuar nenin 76.

3. Kur një anëtar i Këshillit mendon se një projektdirektivë e përmendur në paragrafin 1 ose 2 do të prekte aspektet themelore të sistemit të tij të drejtësisë penale, ai mund të kërkojë që projektdirektiva t'i përcillet Këshillit Europian. Në këtë rast, procedura e zakonshme legjislative pezullohet. Pasi e diskuton dhe nëse arrin një konsensus, Këshilli Europian, brenda katër muajve prej pezullimit, ia rikthen projektin Këshillit, i cili i jep fund pezullimit të procedurës së zakonshme legjislative.

Brenda të njëjtës periudhë, nëse nuk arrihet në një marrëveshje dhe nëse të paktën nëntë Shtete Anëtare dëshirojnë të vendosin një bashkëpunim të përforcuar në bazë të projektdirektivës në fjalë, ata njoftojnë për këtë Parlamentin Europian, Këshillin dhe Komisionin. Në këtë rast, autorizimi për të vijuar me bashkëpunimin e përforcuar, të përmendur në nenin 20(2) e Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 329(1) e këtij Traktati, konsiderohet se është dhënë dhe zbatohen dispozitat për bashkëpunimin e përforcuar.

Neni 84

Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të vendosin masa për të nxitur dhe mbështetur veprimet e Shteteve Anëtare në fushën e parandalimit të kriminalitetit, duke përjashtuar çdo harmonizim të akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

Neni 85
(ish-neni 31 TBE)

1. Misioni i Eurojust-it është të mbështesë dhe forcojë bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare të hetimit dhe ndjekjes penale, lidhur me krimet e rënda, që prekin dy ose më shumë Shtete Anëtare ose që kërkojnë ndjekje penale mbi baza të përbashkëta, mbështetur në operacionet e zhvilluara dhe informacionet që kanë dhënë autoritetet e Shteteve Anëtare dhe Europol-i.

Në këtë kuadër, Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes rregulloreve të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin strukturën, funksionimin, fushën e veprimit dhe detyrat e Eurojust-it. Këto detyra mund të përfshijnë:

(a) fillimin e hetimeve penale, si edhe propozimin e fillimit të ndjekjes penale nga ana e autoriteteve kompetente kombëtare, sidomos të atyre që lidhen me vepra penale kundër interesave financiare të Bashkimit;

(b) bashkërendimin e hetimeve dhe të ndjekjeve penale të përmendura në germën (a);

(c) forcimin e bashkëpunimin gjyqësor, duke përfshirë zgjidhjen e përplasjes së juridiksionit dhe bashkëpunimin e ngushtë me Rrjetin Gjyqësor Europian.

Këto rregullore vendosin edhe masat organizative për përfshirjen e Parlamentit Europian dhe të Parlamenteve kombëtare në vlerësimin e aktiviteteve të Eurojust-it.

2. Në ndjekjet penale të përmendura në paragrafin 1, dhe pa cenuar nenin 86, veprimet zyrtare të procedurës gjyqësore realizohen nga nëpunësit kompetentë kombëtarë.

Neni 86

1. Me qëllim luftën kundër kriminalitetit që prek interesat financiare të Bashkimit, Këshilli, përmes rregulloreve të miratuara sipas një procedure të posaçme legjislative, mund të krijojë një Zyrë të Prokurorisë Publike Europiane nga Eurojust-i. Këshilli vendos me unanimitet, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian.

Nëse nuk arrihet unanimiteti në Këshill, një grup prej të paktën nëntë Shtetesh Anëtare mund të kërkojnë që projektrregullorja t'i përcillet Këshillit Europian. Në këtë rast, procedura në Këshill pezullohet. Pasi e diskuton dhe nëse arrin një konsensus, Këshilli Europian, brenda katër muajve prej pezullimit, ia rikthen projektin Këshillit.

Brenda së njëjtës periudhë, nëse nuk arrihet në një marrëveshje dhe nëse të paktën nëntë Shtete Anëtare dëshirojnë të vendosin një bashkëpunim të përforcuar në bazë të projektrregullores në fjalë, ata njoftojnë për këtë Parlamentin Europian, Këshillin dhe Komisionin. Në këtë rast, autorizimi për të vijuar me bashkëpunimin e përforcuar të përmendur në nenin 20(2) e Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 329(1) e këtij Traktati, konsiderohet se është dhënë dhe zbatohen dispozitat për bashkëpunimin e përforcuar.

2. Zyra e Prokurorisë Publike Europiane është përgjegjëse për hetimin, ndjekjen penale dhe sjelljen përpara drejtësisë, kur duhet në bashkërendim me Europol-in, e autorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre për krime kundër interesave financiare të Bashkimit, siç përcaktohet nga rregullorja e parashikuar në paragrafin 1. Ajo ushtron funksionet e prokurorit në gjykatat kompetente të Shteteve Anëtare në lidhje me vepra të tilla penale.

3. Rregulloret e përmendura në paragrafin 1 parashikojnë rregullat e përgjithshme të zbatueshme për Zyrën e Prokurorisë Publike Europiane, kushtet që rregullojnë kryerjen e funksioneve të saj, rregulloren e brendshme të zbatueshme për aktivitetet e saj, ato që rregullojnë pranueshmërinë e provave si dhe rregullat e zbatueshme për shqyrtimin gjyqësor të masave procedurale që merr kjo Prokurori gjatë kryerjes së funksioneve të saj.

4. Këshilli Europian, njëkohësisht ose më pas, mund të miratojë një vendim përmes të cilit ndryshon paragrafin 1, për zgjerimin e kompetencave të Zyrës së Prokurorisë Publike Europiane për të përfshirë krimet e rënda që kanë dimensione ndërkufitare, dhe përkatësisht paragrafin 2 në lidhje me autorët dhe bashkëpunëtorët e tyre për krime të rënda që prekin më shumë se një Shtet Anëtar. Këshilli Europian vendos me unanimitet, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian dhe pasi konsultohet me Komisionin.

KREU 5

BASHKËPUNIMI POLICOR

Neni 87
(ish-neni 30 TBE)

1. Bashkimi vendos bashkëpunimin policor me përfshirjen e autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare, duke përfshirë policinë, doganat dhe shërbimet e tjera të specializuara të forcave të ligjit, lidhur me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të miratojnë masa në lidhje me:

(a) mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, analizimin dhe shkëmbimin e informacioneve përkatëse;

(b) mbështetjen për trajnimin e personelit dhe bashkëpunimin për shkëmbimin e personelit për pajisjet dhe për punën kërkimore në fushën e zbulimit të krimit;

(c) teknikat e përbashkëta hetimore lidhur me zbulimin e formave të rënda të krimit të organizuar.

3. Këshilli, sipas një procedure të posaçme legjislative, mund të vendosë masa lidhur me bashkëpunimin operacional midis autoriteteve të përmendura në këtë nen. Këshilli vendos me unanimitet, pasi konsultohet me Parlamentin Europian.
Nëse nuk arrihet unanimiteti në Këshill, një grup prej të paktën nëntë Shtetesh Anëtare mund të kërkojnë që projektmasat t'i përcillen Këshillit Europian. Në këtë rast, procedura në Këshill pezullohet. Pasi e diskuton dhe nëse arrin një konsensus, Këshilli Europian, brenda katër muajve prej pezullimit, ia rikthen projektin Këshillit.

Brenda të njëjtës periudhë, nëse nuk arrihet në një marrëveshje dhe nëse të paktën nëntë Shtete Anëtare dëshirojnë të vendosin një bashkëpunim të përforcuar në bazë të projektmasave në fjalë, ata njoftojnë për këtë Parlamentin Europian, Këshillin dhe Komisionin. Në këtë rast, autorizimi për të vijuar me bashkëpunimin e përforcuar të përmendur në nenin 20(2) e Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 329(1) e këtij Traktati, konsiderohet se është dhënë dhe zbatohen dispozitat për bashkëpunimin e përforcuar.

Procedura e caktuar e parashikuar në nënparagrafët e dytë dhe të tretë nuk zbatohet për aktet që përbëjnë zhvillim në tërësinë e legjislacionit të Shengenit.

Neni 88
(ish-neni 30 TBE)

1. Misioni i Europol-it është të mbështesë dhe fuqizojë veprimet e autoriteteve policore dhe shërbimeve të tjera të forcave të ligjit të Shteteve Anëtare dhe bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë në parandalimin dhe luftën kundër krimeve të rënda që prekin dy ose më shumë Shtete Anëtare, terrorizmin dhe format e kriminalitetit që prekin një interes të përbashkët të cilën e mbulon një politikë e Bashkimit.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes rregulloreve të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin strukturën, funksionimin, fushën e veprimit dhe detyrat e Europol-it. Këto detyra mund të përfshijnë:

(a) mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, analizimin dhe shkëmbimin e informacioneve, në veçanti të informacioneve që përcjellin autoritetet e Shteteve Anëtare, vendet e treta ose organet;

(b) bashkërendimin, organizimin dhe zbatimin e veprimeve hetimore dhe operacionale të realizuara bashkërisht me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare ose në kuadër të grupeve të përbashkëta hetimore, kur duhet në bashkërendim me Eurojust-in.

Këto rregullore përcaktojnë procedurat për kontrollin e veprimtarive të Europol-it nga Parlamenti Europian, së bashku me parlamentet kombëtare.

3. Çdo veprim operacional i Europol-it duhet të bëhet në bashkërendim dhe në marrëveshje me autoritetet e Shteteve Anëtare ose të Shteteve në territorin e të cilave veprohet. Zbatimi i masave shtrënguese është përgjegjësi vetëm e autoriteteve kompetente kombëtare.

Neni 89
(ish-neni 32 TBE)

Këshilli, duke vepruar sipas një procedure të posaçme legjislative, përcakton kushtet dhe kufizimet në të cilat autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të përmendura në nenet 82 dhe 87 mund të veprojnë në territorin e një Shteti tjetër Anëtar në bashkërendim dhe në marrëveshje me autoritetet e atij Shteti. Këshilli vendos me unanimitet, pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

TITULLI VI

TRANSPORTI

Neni 90
(ish-neni 70 TKE)

Objektivat e Traktateve, në çështjet që rregullon ky Titull, ndiqen brenda kuadrit të një politike të përbashkët për transportin.

Neni 91
(ish-neni 71 TKE)

1. Për qëllimet e zbatimit të nenit 90 dhe duke marrë në konsideratë karakteristikat dalluese të transportit, Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, përcaktojnë:

(a) rregullat e përbashkëta të zbatueshme për transportin ndërkombëtar drejt ose prej territorit të një Shteti Anëtar, ose që kalon nëpër territorin e një ose më shumë Shteteve Anëtare;

(b) kushtet me të cilat transportuesit e huaj mund të kryejnë shërbime transporti brenda një Shteti Anëtar;

(c) masat për përmirësimin e sigurisë së transportit;

(d) çdo dispozitë tjetër të duhur.

2. Kur miratohen masat e përmendura në paragrafin 1, u kushtohet vëmendje rasteve kur zbatimi i tyre mund të prekë seriozisht standardin e jetesës dhe nivelin e punësimit në disa rajone të caktuara dhe shfrytëzimin e mjeteve të transportit.

Neni 92
(ish-neni 72 TKE)

Deri sa të përcaktohen dispozitat e përmendura në nenin 91(1), nëse Këshilli nuk ka miratuar unanimisht një masë e cila lejon një shmangie, asnjë Shtet Anëtar nuk mund t'i bëjë dispozitat e ndryshme që rregullojnë objektin, më 1 janar 1958 ose, për Shtetet që anëtarësohen, më datën e anëtarësimit të tyre më pak të favorshme në ushtrimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tyre, mbi transportuesit e Shteteve të tjera Anëtare kundrejt transportuesve që janë shtetas të atij Shteti.

Neni 93
(ish-neni 73 TKE)

Ndihmat janë të pajtueshme me Traktatet nëse përmbushin nevojat e bashkërendimit të transportit ose nëse përbëjnë rimbursim për përmbushjen e disa detyrimeve të caktuara që përfshihen në konceptin e një shërbimi publik.

Neni 94
(ish-neni 74 TKE)

Masat e marra në kuadër të Traktateve lidhur me pagesat dhe kushtet e transportit marrin në konsideratë rrethanat ekonomike të transportuesve.

Neni 95
(ish-neni 75 TKE)

1. Nëse transporti bëhet brenda Bashkimit, ndalohet diskriminimi i cili merr formën e vendosjes së çmimeve dhe kushteve të ndryshme nga ana e transportuesve për transportin e të njëjtit mall në të njëjtën rrugë transporti, për shkak të vendit të nisjes ose të mbërritjes së mallit në fjalë.

2. Paragrafi 1 nuk pengon Parlamentin Europian dhe Këshillin të miratojnë masa të tjera në zbatim të nenit 91(1).

3. Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Komitetin Ekonomik dhe Social, përcakton rregullat për zbatimin e dispozitave të paragrafit 1.

Këshilli mund të përcaktojë, në veçanti, dispozitat e nevojshme për t'u dhënë mundësi institucioneve të Bashkimit që të sigurojnë respektimin e rregullit të përcaktuar në paragrafin 1 dhe përfitimin prej tij nga të gjithë përdoruesit.

4. Komisioni, kryesisht ose me kërkesë të një Shteti Anëtar, heton çdo rast diskriminimi që bie në objektin e paragrafit 1 dhe, pasi konsultohet me Shtetin Anëtar në fjalë, merr vendimet e nevojshme brenda kuadrit të rregullave të përcaktuara në zbatim të dispozitave të paragrafit 3.

Neni 96
(ish-neni 76 TKE)

1. Lidhur me operacionet e transportit të kryera brenda Bashkimit, ndalohet vendosja nga një Shtet Anëtar e çmimeve dhe kushteve që përfshijnë elemente të mbështetjes ose mbrojtjes në interes të një ose më shumë ndërmarrjeve ose sektorëve ekonomik të veçantë, nëse kjo nuk lejohet nga Komisioni.

2. Komisioni, kryesisht ose me kërkesë të një Shteti Anëtar, shqyrton çmimet dhe kushtet e përmendura në paragrafin 1, duke marrë në konsideratë kërkesat e një politike të duhur ekonomike rajonale, nevojat e zonave më pak të zhvilluara dhe problemet e zonave të prekura rëndë nga rrethanat politike nga njëra anë, dhe pasojat e çmimeve dhe kushteve të tilla për konkurrencën midis mënyrave të ndryshme të transportit nga ana tjetër.

Pasi konsultohet me secilin Shtet Anëtar në fjalë, Komisioni merr vendimet e nevojshme.

3. Ndalimi i parashikuar në paragrafin 1 nuk zbatohet për tarifat e vendosura për të arritur konkurrencën.

Neni 97
(ish-neni 77 TKE)

Detyrimet ose taksat lidhur me kalimin e kufijve, të cilat një transportues i kërkon krahas çmimeve të transportit, nuk duhet të kalojnë një nivel të arsyeshëm pasi janë marrë në konsideratë kostot e lindura prej tyre.

Shtetet Anëtare bëjnë përpjekje për t'i ulur këto kosto në mënyrë progresive.

Komisioni mund t'u japë Shteteve Anëtare rekomandime për zbatimin e këtij neni.

Neni 98
(ish-neni 78 TKE)

Dispozitat e këtij Titulli nuk e pengojnë zbatimin e masave të marra në Republikën Federale të Gjermanisë, për aq sa masa të tilla janë të nevojshme, për të kompensuar disavantazhet ekonomike që ka shkaktuar ndarja e Gjermanisë për ekonominë në disa zona të caktuara të Republikës Federale të prekura nga kjo ndarje. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë një vendim që e shfuqizon këtë nen.

Neni 99
(ish-neni 79 TKE)

Pranë Komisionit krijohet një Komitet Këshillimor që përbëhet nga ekspertë të caktuar nga qeveritë e Shteteve Anëtare. Sa herë e konsideron të dëshirueshme, Komisioni konsultohet me këtë Komitet për çështje të transportit.

Neni 100
(ish-neni 80 TKE)

1. Dispozitat e këtij Titulli zbatohen për transportin hekurudhor, rrugor dhe në rrugët e brendshme ujore.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të miratojnë dispozita të caktuara për transportin detar dhe ajror. Ata veprojnë pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve.

TITULLI VII

RREGULLAT E PËRBASHKËTA PËR KONKURRENCËN, TATIMET DHE PËRAFRIMIN E LEGJISLACIONIT

KREU 1

RREGULLAT PËR KONKURRENCËN

SEKSIONI 1

RREGULLAT QË ZBATOHEN PËR NDËRMARRJET

Neni 101
(ish-neni 81 TKE)

1. Sa më poshtë janë të ndaluara si të papajtueshme me tregun e brendshëm: të gjitha marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikat e bashkërenduara të cilat mund të prekin tregtinë midis Shteteve Anëtare dhe të cilat kanë si objekt ose pasojë të tyre pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm dhe, në veçanti, ato të cilat:

(a) vendosin drejtpërdrejt ose tërthorazi çmimet e shitjes e të blerjes ose çdo kusht tjetër tregtimi;

(b) kufizojnë ose mbajnë në kontroll prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

(c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

(d) zbatojnë kushte jo të njëjta për transaksione të barasvlefshme me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në pozitë të pafavorshme konkurruese;

(e) lidhjen e kontratave e kushtëzojnë me pranimin nga ana e palëve të tjera e detyrimeve shtesë të cilat, për nga natyra ose për nga përdorimi tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave të tilla.

2. Çdo marrëveshje apo vendim i cili është i ndaluar në zbatim të këtij neni, është automatikisht pa vlerë ligjore.

3. Por dispozitat e paragrafit 1 mund të deklarohen si të pazbatueshme në rast të:

– çdo marrëveshjeje ose kategorie marrëveshjesh midis ndërmarrjeve,

– çdo vendimi ose kategorie vendimesh të shoqatave të ndërmarrjeve,

– çdo praktike të bashkërenduar ose kategorie praktikash të bashkërenduara,

që kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjen e mallrave, ose në nxitjen e përparimit teknik, ose ekonomik, duke u lejuar konsumatorëve të kenë një pjesë të drejtë të përfitimit që rrjedh prej kësaj, dhe që:

(a) nuk vendos mbi ndërmarrjet në fjalë kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave;

(b) nuk u jep ndërmarrjeve mundësinë për ta eliminuar konkurrencën në lidhje me një pjesë të konsiderueshme të produkteve në fjalë.

Neni 102
(ish-neni 82 TKE)

Ndalohet çdo abuzim nga ana e një ose më shumë ndërmarrjeve i pozitës dominuese brenda tregut të brendshëm ose në një pjesë të konsiderueshme të tij si i papajtueshëm me tregun e brendshëm, për aq sa mund të prekë tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Në veçanti, një abuzim i tillë mund të konsistojë në:

(a) vendosjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çmimeve të padrejta të çmimeve të shit-blerjes ose të kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;

(b) kufizimin e zhvillimit të prodhimit, tregjeve ose teknikës, në dëm të konsumatorëve;

(c) zbatimin e kushteve jo të ngjashme për transaksione të barasvlefshme me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në pozitë të pafavorshme konkurruese;

(d) kushtëzimin e lidhjes së kontratave me pranimin nga ana e palëve të tjera e detyrimeve shtesë të cilat, për nga natyra ose për nga përdorimi tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave të tilla.

Neni 103
(ish-neni 83 TKE)

1. Rregulloret ose direktivat e duhura për të vënë në jetë parimet e parashikuara në nenet 101 dhe 102 përcaktohen nga Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian.

2. Rregulloret ose direktivat e përmendura në paragrafin 1 hartohen, në veçanti:

(a) për të siguruar respektimin e ndalimeve të parashikuara në nenin 101(1) dhe nenin 102 përmes vendosjes së gjobave dhe sanksioneve periodike;

(b) për të përcaktuar rregulla të hollësishme për zbatimin e nenit 101(3), duke marrë në konsideratë nevojën për të siguruar mbikëqyrjen e efektshme, nga njëra anë, dhe për të thjeshtuar sa më shumë administrimin, nga ana tjetër;

(c) për të përcaktuar, nëse është nevoja, në degët e ndryshme të ekonomisë, fushën e veprimit të dispozitave të neneve 101 dhe 102;

(d) për të përcaktuar funksionet përkatëse të Komisionit dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian lidhur me zbatimin e dispozitave të përcaktuara në këtë paragraf;

(e) për të përcaktuar marrëdhënien ndërmjet legjislacionit kombëtare dhe dispozitave që përmban ky Seksion ose dispozitave të miratuara në zbatim të këtij neni.

Neni 104
(ish-neni 84 TKE)

Deri në hyrjen në fuqi të dispozitave të miratuara në zbatim të nenit 103, autoritetet në Shtetet Anëtare vendosin për pranueshmërinë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara dhe për abuzimin e një pozite dominuese në tregun e brendshëm në përputhje me legjislacionin e vendeve të tyre dhe me dispozitat e nenit 101, në veçanti të paragrafit 3 të tij, dhe të nenit 102.

Neni 105
(ish-neni 85 TKE)

1. Pa cenuar nenin 104, Komisioni siguron zbatimin e parimeve të parashikuara në nenet 101 dhe 102. Me kërkesë të një Shteti Anëtar ose kryesisht, dhe në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të cilat i japin mbështetjen e tyre, Komisioni heton rastet kur dyshohet se janë shkelur këto parime. Nëse konstaton se ka pasur shkelje, ai propozon masat e duhura për t'i dhënë fund atyre.

2. Nëse shkeljes nuk i jepet fund, Komisioni e regjistron një shkelje të tillë të parimeve në një vendim të arsyetuar. Komisioni mund ta botojë këtë vendim dhe t'i autorizojë Shteteve Anëtare të marrin masa, kushtet dhe hollësitë e të cilave i përcakton vetë, që janë të nevojshme për ta ndrequr situatën.

3. Komisioni mund të miratojë rregullore, në lidhje me kategoritë e marrëveshjeve për të cilat Këshilli ka miratuar një rregullore ose direktivë, në zbatim të nenit 103(2)(b).

Neni 106
(ish-neni 86 TKE)

1. Në rast të ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve të cilave Shtetet Anëtare u japin të drejta të veçanta ose ekskluzive, Shtetet Anëtare nuk miratojnë dhe as nuk mbajnë në fuqi masa që bien ndesh me rregullat që përmbajnë Traktatet, në veçanti me ato rregulla që parashikohen në nenin 18 dhe nenet nga 101 deri në 109.

2. Ndërmarrjet të cilave u është besuar kryerja e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik ose që kanë një karakter monopoli fitimprurës u nënshtrohen rregullave që përmbajnë Traktatet, në veçanti rregullave për konkurrencën, për aq sa zbatimi i këtyre rregullave nuk pengon kryerjen, de jure ose de facto, të detyrave të veçanta që u janë ngarkuar. Zhvillimi i tregtisë nuk duhet të preket deri në atë shkallë, sa të bjerë ndesh me interesat e Bashkimit.

3. Komisioni siguron zbatimin e dispozitave të këtij neni dhe, kur është nevoja, u drejton Shteteve Anëtare direktivat ose vendimet e duhura.

SEKSIONI 2

NDIHMAT QË JAPIN SHTETET

Neni 107
(ish-neni 87 TKE)

1. Me përjashtim të rasteve kur Traktatet parashikojnë ndryshe, ndihma që jep një Shtet Anëtar ose që jepet përmes burimeve shtetërore në çfarëdolloj forme, e cila e shtrembëron ose rrezikon ta shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e disa mallrave të caktuara, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, për aq kohë sa prek tregtinë midis Shteteve Anëtare.

2. Sa më poshtë, janë të pajtueshme me tregun e brendshëm:

(a) ndihma me karakter social, që u jepet konsumatorëve individualë, me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek;

(b) ndihma për shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore ose ngjarjet e jashtëzakonshme;

(c) ndihma që i jepet ekonomisë në disa zona të caktuara të Republikës Federale të Gjermanisë të prekura nga ndarja e Gjermanisë, për aq kohë sa kjo ndihmë është e nevojshme për të kompensuar pozitën e pafavorshme ekonomike që ka shkaktuar kjo ndarje. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë një vendim që e shfuqizon këtë germë.

3. Sa më poshtë, mund të konsiderohen si të pajtueshme me tregun e brendshëm:

(a) ndihma për nxitjen e zhvillimin ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është i ulët në mënyrë jo normale dhe ku ka papunësi të theksuar dhe, të rajoneve të përmendura në nenin 349, duke mbajtur parasysh situatën e tyre strukturore, ekonomike dhe sociale;

(b) ndihma për nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët europian ose për ndreqjen e një çrregullimi të rëndë në ekonominë e një Shteti Anëtar;

(c) ndihma për lehtësimin e zhvillimit të disa aktiviteteve të caktuara ekonomike ose të disa fushave të caktuara ekonomike, ku një ndihmë e tillë nuk i prek aq keq kushtet e tregtimit sa të bien ndesh me interesin e përbashkët;

(d) ndihma për nxitjen e ruajtjes së kulturës dhe trashëgimisë, kur një ndihmë e tillë nuk i prek aq kushtet e tregtimit dhe konkurrencën në Bashkimin sa të bien ndesh me interesin e përbashkët;

(e) kategori të tjera të tilla ndihme të cilat mund të përcaktohen në një vendim të Këshillit me propozim të Komisionit.

Neni 108
(ish-neni 88 TKE)

1. Komisioni, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, i mban në shqyrtim të vazhdueshëm të gjitha sistemet e ndihmës që ekzistojnë në këto Shtete. Ai u propozon këtyre të fundit masat e duhura që janë të nevojshme për zhvillimin progresiv ose funksionimin e tregut të brendshëm.

2. Nëse, pasi u jep njoftim palëve në fjalë për të paraqitur komentet e tyre, Komisioni konstaton se ndihma e dhënë nga një Shtet ose nëpërmjet burimeve shtetërore nuk është e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke pasur parasysh nenin 107 ose se një ndihmë e tillë është shpërdoruar, ai vendos që Shteti në fjalë ta ndalojë ose ta ndryshojë këtë ndihmë brenda një afati të vendosur nga Komisioni.

Nëse Shteti në fjalë nuk e zbaton këtë vendim brenda afatit të përcaktuar, Komisioni ose Shtetet e tjera të interesuara, duke iu shmangur urdhërimeve të neneve 258 dhe 259, mund ta paraqesin çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Me kërkesë të një Shteti Anëtar, Këshilli, me unanimitet, mund të vendosë që ndihma që jep ose ka si qëllim të japë ky Shtet të konsiderohet si e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke iu shmangur urdhërimeve të nenit 107 ose të rregulloreve të parashikuara në nenin 109, nëse një vendim i tillë justifikohet me rrethana të jashtëzakonshme. Nëse lidhur me ndihmën në fjalë, Komisioni ka filluar më parë procedurën e parashikuar në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, fakti që Shteti i interesuar i ka paraqitur kërkesë Këshillit sjell për pasojë pezullimin e procedurës gjersa të jetë shprehur Këshilli.

Por, nëse Këshilli nuk shprehet brenda tre muajve pas paraqitjes së kërkesës në fjalë, Komisioni jep vendimin e tij për çështjen.

3. Komisioni informohet në kohë të mjaftueshme, për t'i dhënë mundësi të paraqesë komentet e tij për çdo plan që ka të bëjë me dhënien ose ndryshimin e një ndihme. Nëse gjykon se një plan i tillë nuk pajtohet me tregun e brendshëm, sipas nenit 107, Komisioni fillon pa vonesë procedurën e parashikuar në paragrafin 2. Shteti Anëtar në fjalë nuk i zbaton masat e propozuara gjersa nga kjo procedurë të ketë dalë një vendim përfundimtar.

4. Komisioni mund të miratojë rregullore në lidhje me kategoritë e ndihmës shtetërore për të cilat Këshilli, në zbatim të nenit 109, ka vendosur se mund të përjashtohen nga procedura e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 109
(ish-neni 89 TKE)

Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian, mund të miratojë rregulloret e duhura për zbatimin e neneve 107 dhe 108 dhe, në veçanti, mund të caktojë kushtet e zbatimit të nenit 108(3) dhe kategoritë e ndihmës të përjashtuara nga kjo procedurë.

KREU 2

DISPOZITAT TATIMORE

Neni 110
(ish-neni 90 TKE)

Asnjë Shtet Anëtar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nuk vendos mbi produktet e Shteteve të tjera Anëtare tatim të brendshëm, të çfarëdo lloji, përtej atij që vendoset drejtpërdrejt ose tërthorazi për produkte të ngjashme të brendshme.

Gjithashtu, asnjë Shtet Anëtar nuk vendos mbi produktet e Shteteve të tjera Anëtare tatim të brendshëm të një natyre të tillë, që do t'u siguronte mbrojtje të tërthortë produkteve të tjera.

Neni 111
(ish-neni 91 TKE)

Kur eksportohen produkte në territorin e një Shteti Anëtar, ripagimi i tatimit të brendshëm nuk mund të jetë më i madh se tatimi i brendshëm i vendosur mbi to drejtpërsëdrejti ose tërthorazi.

Neni 112
(ish-neni 92 TKE)

Në rast të taksave që nuk përfshijnë tatimin mbi të ardhurat, akcizat dhe format e tjera të tatimit të tërthortë, faljet dhe ripagimet e lidhura me eksportet drejt Shteteve të tjera Anëtare mund të mos jepen dhe tarifat kundërpeshuese në lidhje me importet nga Shtetet Anëtare mund të mos vendosen nëse masat e menduara nuk janë miratuar paraprakisht për një periudhë të kufizuar nga Këshilli me propozim të Komisionit.

Neni 113
(ish-neni 93 TKE)

Këshilli, me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Komitetin Ekonomik dhe Social, miraton dispozitat për harmonizimin e legjislacionit lidhur me tatimet mbi të ardhurat, akcizat dhe format e tjera të tatimit të tërthortë, për aq sa është i nevojshëm një harmonizim i tillë për të siguruar krijimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm dhe për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës.

KREU 3

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT

Neni 114
(ish-neni 95 TKE)

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Traktate, dispozitat e mëposhtme zbatohen për arritjen e objektivave të parashikuara në nenin 26. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, miratojnë masat për përafrimin e dispozitave të përcaktuara në akte ligjore, nënligjore ose administrative të Shteteve Anëtare, objekti i të cilave është krijimi dhe funksionimi i tregut të brendshëm.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet për dispozitat fiskale, për dispozitat që lidhen me lëvizjen e lirë të personave dhe për dispozitat që lidhen me të drejtat dhe interesat e punëmarrësve.

3. Komisioni, në propozimet tij të parashikuara në paragrafin 1 lidhur me shëndetin, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e konsumatorëve, merr për bazë një nivel të lartë mbrojtjeje, duke marrë në konsideratë, në veçanti, çdo zhvillim të ri të mbështetur në fakte shkencore. Brenda kompetencave të tyre përkatëse, Parlamenti Europian dhe Këshilli kanë si qëllim të arrijnë këtë objektiv.

4. Nëse një Shtet Anëtar, pas miratimit të një mase harmonizimi nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, nga Këshilli ose nga Komisioni, e gjykon të nevojshme t'i ruajë dispozitat kombëtare në bazë të nevojave madhore të përmendura në nenin 36, ose në lidhje me mbrojtjen e mjedisit apo të mjedisit të punës, ai njofton Komisionin për këto dispozita si dhe mbi arsyet e ruajtjes së tyre.

5. Gjithashtu, pa cënuar paragrafin 4, nëse, një Shtet Anëtar pas miratimit të një mase harmonizimi nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, nga Këshilli ose nga Komisioni e gjykon të nevojshme të miratojë dispozita kombëtare në bazë të provave shkencore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit apo të mjedisit të punës për arsye të një problemi të caktuar për atë Shtet Anëtar, problem i cili lind pas miratimit të masës së harmonizimit, ai njofton Komisionin për dispozitat e parashikuara si dhe për arsyet e miratimit të tyre.

6. Komisioni, brenda gjashtë muajve prej njoftimeve të përmendura në paragrafët 4 dhe 5, i aprovon ose i kundërshton dispozitat kombëtare në fjalë, pasi ka kontrolluar nëse janë apo jo një mjet diskriminimi arbitrar ose një kufizim i maskuar i tregtisë midis Shteteve Anëtare dhe nëse ato përbëjnë apo jo një pengesë për funksionimin e tregut të brendshëm.
Në mungesë të një vendimi nga Komisioni brenda kësaj periudhe, dispozitat kombëtare të përmendura në paragrafët 4 dhe 5 konsiderohen se janë aprovuar.

Kur e justifikon kompleksiteti i çështjes dhe në mungesë të rrezikut ndaj shëndetit të njeriut, Komisioni mund ta njoftojë Shtetin Anëtar në fjalë se periudha e përmendur në këtë paragraf mund të zgjatet me një periudhë tjetër shtesë që është deri në gjashtë muaj.

7. Kur, sipas paragrafit 6, një Shtet Anëtar lejohet të ruajë ose paraqesë dispozita kombëtare si shmangie nga masa e harmonizimit, Komisioni shqyrton menjëherë nëse duhet të propozojë apo jo një përshtatje të kësaj mase.

8. Kur një Shtet Anëtar ngre një problem të caktuar për shëndetin publik në një fushë e cila ka qenë objekt i masave të mëparshme të harmonizimit, ai ia sjell këtë në vëmendje Komisionit, i cili shqyrton menjëherë nëse duhet t'i propozojë apo jo masat e duhura Këshillit.

9. Duke u shmangur nga procedura e përcaktuar në nenet 258 dhe 259, Komisioni dhe çdo Shtet Anëtar mund ta ngrejë çështjen drejtpërdrejt përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, nëse mendon se një Shtet tjetër Anëtar po i përdor në mënyrë jo të duhur kompetencat që i jep ky nen.

10. Masat e harmonizimit të përmendura më lart, në rastet e duhura, përfshijnë një klauzolë mbrojtëse që i lejon Shtetet Anëtare të marrin masa të përkohshme, për një ose më shumë prej arsyeve joekonomike që përmenden në nenin 36, që i nënshtrohen një procedure kontrolli nga Bashkimi.

Neni 115
(ish-neni 94 TKE)

Pa cenuar nenin 114, Këshilli, me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Komitetin Ekonomik dhe Social, nxjerr direktiva për përafrimin e dispozitave të akteve ligjore, nënligjore dhe administrative të Shteteve Anëtare, të cilat prekin drejtpërdrejt krijimin ose funksionimin e tregut të brendshëm.

Neni 116
(ish-neni 96 TKE)

Kur Komisioni konstaton se një dallim midis dispozitave të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore ose administrative të Shteteve Anëtare i shtrembëron kushtet e konkurrencës në tregun e brendshëm dhe ky shtrembërim duhet eliminuar, ai konsultohet me Shtetet Anëtare në fjalë.

Nëse ky konsultim nuk sjell një marrëveshje për eliminimin e shtrembërimit në fjalë, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, nxjerrin direktivat e nevojshme. Mund të miratohen edhe masa të tjera të duhura, të parashikuara në Traktatet.

Neni 117
(ish-neni 97 TKE)

1. Kur ka arsye për të pasur frikë se miratimi apo ndryshimi i një dispozite të përcaktuar në një akt ligjor, nënligjor ose administrativ mund të shkaktojë shtrembërimin e përmendur në nenin 116, një Shtet Anëtar që dëshiron ta bëjë këtë duhet të konsultohet me Komisionin. Pasi konsultohet me Shtetet Anëtare, Komisioni u rekomandon Shteteve në fjalë masa të tilla që janë të përshtatshme për ta shmangur shtrembërimin në fjalë.

2. Nëse një Shtet që dëshiron të fusë ose ndryshojë dispozitat e veta nuk e zbaton rekomandimin që i drejton Komisioni, Shteteve të tjera Anëtare nuk u kërkohet që, sipas nenit 116, t'i ndryshojnë dispozitat e tyre për ta eliminuar shtrembërimin në fjalë. Nëse Shteti Anëtar që e ka shpërfillur rekomandimin e Komisionit shkakton një shtrembërim i cili dëmton vetëm atë Shtet, dispozitat e nenit 116 nuk zbatohen.

Neni 118

Në kuadër të krijimit dhe funksionimit të tregut të brendshëm, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat për krijimin e të drejtave të pronësisë intelektuale europiane për të siguruar mbrojtje të njëjtë të të drejtave të pronësisë intelektuale në të gjithë Bashkimin dhe për ngritjen e kuadrit organizativ të centralizuar në mbarë Bashkimin për autorizimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen.

Këshilli, sipas një procedure të posaçme legjislative përmes rregulloreve, vendos masat organizative gjuhësore për të drejtat e pronësisë intelektuale europiane. Këshilli vendos me unanimitet, pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

TITULLI VIII

POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

Neni 119
(ish-neni 4 TKE)

1. Për qëllimet e parashikuara në nenin 3 të Traktatit për Bashkimin Europian, aktivitetet e Shteteve Anëtare dhe Bashkimit përfshijnë, sikurse parashikohet nga Traktatet, miratimin e një politike ekonomike, e cila mbështetet në bashkërendimin e ngushtë të politikave ekonomike të Shteteve Anëtare në tregun e brendshëm dhe në përcaktimin e objektivave të përbashkëta dhe e cila zhvillohet në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë.

2. Krahas, sa më lart dhe sikurse parashikohet nga Traktatet si dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në to, këto aktivitete përfshijnë një monedhë të vetme euron dhe përcaktimin e realizimin e një politike të vetme monetare dhe një politike të vetme për kurset e këmbimit, objektivi parësor i të cilave është ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe, pa e cenuar këtë objektiv, mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike të Bashkimit, në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë.

3. Këto aktivitete të Shteteve Anëtare dhe Bashkimit përfshijnë respektimin e këtyre parimeve orientuese: çmime të qëndrueshme, financa publike dhe kushte monetare të qëndrueshme si dhe një bilanc të qëndrueshëm pagesash.

KREU 1

POLITIKA EKONOMIKE

Neni 120
(ish-neni 98 TKE)

Shtetet Anëtare i realizojnë politikat e tyre ekonomike në mënyrë të atillë që të kontribuojnë në arritjen e objektivave të Bashkimit, të përcaktuar në nenin 3 të Traktatit për Bashkimin Europian, dhe në kuadër

të orientimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 121(2). Shtetet Anëtare dhe Bashkimi veprojnë në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar një shpërndarje efikase të burimeve dhe në përputhje me parimet e parashikuara në nenin 119.

Neni 121
(ish-neni 99 TKE)

1. Shtetet Anëtare i konsiderojnë politikat e tyre ekonomike si një çështje interesi të përbashkët dhe i bashkërendojnë brenda Këshillit, në përputhje me dispozitat e nenit 120.

2. Këshilli, me rekomandim të Komisionit, harton një projekttekst për orientimet e përgjithshme të politikave ekonomike të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit dhe ia raporton konstatimet Këshillit Europian.

Këshilli Europian, duke vepruar në bazë të raportit të Këshillit, diskuton për orientimet e përgjithshme të politikave ekonomike të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit.

Në bazë të këtij përfundimi, Këshilli miraton një rekomandim ku paraqiten këto orientime të përgjithshme. Këshilli informon Parlamentin Europian për rekomandimin e tij.

3. Për të siguruar një bashkërendim më të ngushtë të politikave ekonomike dhe një konvergjencë të qëndrueshme të ecurive ekonomike të Shteteve Anëtare, Këshilli, në bazë të raporteve të paraqitura nga Komisioni, vëzhgon zhvillimet ekonomike në secilin prej Shteteve Anëtare dhe në Bashkimin, si edhe pajtueshmërinë e politikave ekonomike me orientimet e përgjithshme të përmendura në paragrafin 2 dhe kryen rregullisht një vlerësim të përgjithshëm.

Për qëllimet e kësaj mbikëqyrjeje të shumëanshme, Shtetet Anëtare i përcjellin Komisionit informacion për masat e rëndësishme që kanë marrë në fushën e politikës së tyre ekonomike, si dhe informacione të tilla të tjera që ato i vlerësojnë si të nevojshme.

4. Sipas procedurës të përmendur në paragrafin 3, kur konstatohet se politikat ekonomike të një Shteti Anëtar nuk përputhen me orientimet e përgjithshme të përmendura në paragrafin 2 ose se vënë në rrezik funksionimin e duhur të bashkimit ekonomik dhe monetar, Komisioni mund t'i drejtohet me një paralajmërim Shtetit Anëtar në fjalë. Këshilli, me rekomandim të Komisionit, mund t'i drejtojë rekomandimet e nevojshme Shtetit Anëtar në fjalë. Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të vendosë t'i bëjë publike rekomandimet e veta.

Brenda objektit të këtij paragrafi, Këshilli vepron pa marrë në konsideratë votën e anëtarit të Këshillit që përfaqëson Shtetin Anëtar në fjalë.
Shumica e cilësuar e anëtarëve të tjerë të Këshillit përcaktohet sipas nenit 238(3)(a).

5. Presidenti i Këshillit dhe Komisioni raportojnë përpara Parlamentit Europian për rezultatet e mbikëqyrjes së shumëanshme. Presidenti i Këshillit mund të ftohet përpara komisionit kompetent të Parlamentit Europian, nëse Këshilli i ka bërë publike rekomandimet e veta.

6. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të miratojnë rregulla të hollësishme për procedurën e mbikëqyrjes së shumëanshme të përmendura në paragrafët 3 dhe 4.

Neni 122
(ish-neni 100 TKE)

1. Këshilli, me propozim të Komisionit, pa cenuar asnjë prej procedurave të parashikuara nga Traktatet mund të vendosë, në kuadër të solidaritetit midis Shteteve Anëtare, për marrjen e masave të nevojshme për situatën ekonomike, në veçanti nëse lindin vështirësi të mëdha lidhur me furnizimin e disa produkteve të caktuara, sidomos në fushën e energjetikës.

2. Kur një Shtet Anëtar gjendet në vështirësi ose rrezikohet seriozisht nga vështirësi të mëdha të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose ngjarje të jashtëzakonshme, të cilat nuk i ka në dorë, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund t'i japë Shtetit Anëtar në fjalë mbështetje financiare nga Bashkimi sipas disa kushteve të caktuara. Presidenti i Këshillit informon Parlamentin Europian për vendimin e marrë.

Neni 123
(ish-neni 101 TKE)

1. Ndalohen kreditë në formën e llogarisë së zbuluar, ose çdo lloj tjetër linjash financimi nga Banka Qendrore Europiane ose nga bankat qendrore të Shteteve Anëtare (të quajtura më poshtë "bankat qendrore kombëtare") në favor të institucioneve, organeve, zyrave apo agjencive të Bashkimit, qeverive qendrore, autoriteteve rajonale vendore ose të tjera, të cilat i mbulon e drejta publike, ose në favor të ndërmarrjeve shtetërore të Shteteve Anëtare, sikurse ndalohet edhe blerja drejtpërdrejt prej tyre e instrumenteve të borxhit nga ana e Bankës Qendrore Europiane.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet për institucionet shtetërore kredidhënëse të cilave, në kuadër të furnizimit të rezervave nga bankat qendrore, u bëhet i njëjti trajtim nga bankat qendrore kombëtare dhe nga Banka Qendrore Europiane, sikur të ishin institucione private kredidhënëse.

Neni 124
(ish-neni 102 TKE)

Ndalohen të gjitha masat që nuk mbështeten në argumente të matura dhe që u japin mundësi institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit, qeverive qendrore, autoriteteve rajonale, vendore ose të tjera,organeve të tjera që i mbulon e drejta publike ose ndërmarrjeve publike të Shteteve Anëtare të marrin shërbime nga institucionet financiare.

Neni 125
(ish-neni 103 TKE)

1. Bashkimi nuk mban përgjegjësi e as nuk merr përsipër angazhimet e qeverive qendrore, autoriteteve rajonale, vendore ose të tjera, organeve të tjera që i mbulon e drejta publike ose ndërmarrjeve publike të Shteteve Anëtare, pa cenuar garancitë e ndërsjella financiare për realizimin e përbashkët të një projekti të veçantë. Një Shtet Anëtar nuk mban përgjegjësi e as nuk merr përsipër angazhimet e qeverive qendrore, autoriteteve rajonale, vendore ose të tjera, organeve të tjera që i mbulon e drejta publike ose ndërmarrjeve publike të një Shteti tjetër Anëtar, pa cenuar garancitë e ndërsjella financiare për realizimin e përbashkët të një projekti të veçantë.

2. Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamenti Europian, sipas nevojës, mund të përcaktojë nocionet për zbatimin e ndalimeve të përmendura në nenet 123, 124 dhe në këtë nen.

Neni 126
(ish-neni 104 TKE)

1. Shtetet Anëtare duhet t'i shmangin deficitet e tepërta publike.

2. Komisioni ndjek zhvillimin e situatës buxhetore dhe të stokut të borxhit publik në Shtetet Anëtare, me qëllim identifikimin e gabimeve flagrante. Në veçanti, shqyrton zbatimin e disiplinës buxhetore në bazë të dy kritereve të mëposhtme:

(a) nëse raporti i deficitit të planifikuar ose faktik publik mbi produktin e brendshëm bruto e kalon një vlerë krahasuese, me përjashtim të rastit kur:

- ose raporti ka rënë ndjeshëm dhe vazhdimisht dhe ka arritur një nivel i cili i afrohet vlerës së referencës;

- ose, në mënyrë alternative, teprica mbi vlerën e referencës është vetëm si përjashtim dhe e përkohshme dhe raporti qëndron afër vlerës së referencës;

(b) nëse raporti i borxhit publik mbi produktin e brendshëm bruto kalon një vlerë krahasuese, me përjashtim të rastit kur raporti zvogëlohet ndjeshëm dhe i afrohet vlerës së referencës me një ritëm të kënaqshëm.

Vlerat e referencës përcaktohen në Protokollin për procedurën e deficitit të tepërt, i cili u bashkëlidhet Traktateve.

3. Nëse një Shtet Anëtar nuk i përmbush kërkesat ligjore në kuadër të njërit ose të dy kritereve të mësipërme, Komisioni harton një raport. Raporti i Komisionit merr në konsideratë edhe faktin nëse deficiti publik i kalon shpenzimet e investimeve publike dhe merr në konsideratë të gjithë faktorët e tjerë përkatës, duke përfshirë edhe pozicionin ekonomik dhe buxhetor afatmesëm të Shtetit Anëtar.

Komisioni mund të hartojë edhe një raport, nëse, pavarësisht përmbushjes së kërkesave të kritereve, është i mendimit se ekziston rreziku i një deficiti të tepërt në një Shtet Anëtar.

4. Komiteti Ekonomik dhe Financiar harton një opinion për raportin e Komisionit.

5. Nëse Komisioni mendon se ekziston ose mund të ndodhë një deficit i tepërt në një Shtet Anëtar, ai i drejtohet me një opinion Shtetit Anëtar në fjalë dhe informon për këtë Këshillin.

6. Këshilli, me propozim të Komisionit, dhe pasi ka marrë në konsideratë vërejtjet që dëshiron të bëjë Shteti Anëtar në fjalë, vendos pas një vlerësimi të përgjithshëm nëse ekziston apo jo një deficit i tepërt.

7. Kur Këshilli, në përputhje me paragrafin 6, vendos se ekziston një deficit i tepërt, ai miraton pa vonesë të pajustifikuar dhe me rekomandim të Komisionit, rekomandimet që i drejtohen

Shtetit Anëtar në fjalë, me qëllim dhënien fund të situatës brenda një afati të caktuar. Në varësi të dispozitave të paragrafit 8, këto rekomandime nuk bëhen publike.

8. Kur konstaton se nuk është vepruar me efektshmëri në përgjigje të rekomandimeve të tij, brenda afatit të përcaktuar, Këshilli mund t'i bëjë rekomandimet publike.

9. Nëse Shteti Anëtar vazhdon të mos i zbatojë rekomandimet e Këshillit, Këshilli mund të vendosë t'i bëjë njoftim Shtetit Anëtar që për uljen e deficitit, të marrë brenda një afati të caktuar masat të cilat gjykohen të nevojshme nga Këshilli për të ndrequr situatën.

Në një rast të tillë, Këshilli mund t'i kërkojë Shtetit Anëtar në fjalë të paraqesë raporte sipas një grafiku kohor të caktuar, në mënyrë që të vlerësojë përpjekjet rregulluese të këtij Shteti Anëtar.

10. Të drejtat për t'iu drejtuar gjykatës, të parashikuara në nenet 258 dhe 259, nuk mund të ushtrohen në lidhje me paragrafët nga 1 deri në 9 të këtij neni.

11. Sa kohë që një Shtet Anëtar nuk e respekton një vendim të marrë në zbatim të paragrafit 9, Këshilli mund të vendosë të zbatojë ose, sipas rastit, të intensifikojë një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

– t'i kërkojë Shtetit Anëtar në fjalë të botojë informacion shtesë i cili përcaktohet nga Këshilli, përpara emetimit të bonove dhe letrave me vlerë,

– t'i kërkojë Bankës Europiane të Investimeve të rishqyrtojë politikën e saj për huatë për Shtetin Anëtar në fjalë,

– t'i kërkojë Shtetit Anëtar në fjalë të vendosë një depozitë pa interes të një shume të mjaftueshme pranë Bashkimit gjersa sipas mendimit të Këshillit, të jetë korrigjuar deficiti i tepërt,

– të vendosë gjoba në një shume të mjaftueshme.

Presidenti i Këshillit informon Parlamentin Europian për vendimet e marra.

12. Këshilli i shfuqizon disa ose të gjitha vendimet ose rekomandimet e veta, të përmendura në paragrafët nga 6 deri në 9 dhe 11, për aq sa, sipas mendimit të Këshillit, është korrigjuar deficiti i tepërt në Shtetin Anëtar. Nëse Këshilli i ka bërë më parë publike rekomandimet, me t'u shfuqizuar vendimi i marrë sipas paragrafit 8, ai nxjerr një deklaratë publike ku thuhet se deficiti i tepërt në Shtetin Anëtar në fjalë nuk ekziston më.

13. Kur merr vendimet ose rekomandimet e përmendura në paragrafët 8, 9, 11 dhe 12, Këshilli vepron me rekomandim të Komisionit.

Kur Këshilli miraton masat e përmendura në paragrafët nga 6 deri në 9, 11 dhe 12, ai vepron pa marrë në konsideratë votën e anëtarit të Këshillit i cili përfaqëson Shtetin Anëtar në fjalë.
Shumica e cilësuar e anëtarëve të tjerë të Këshillit përcaktohet sipas nenit 238(3)(a).

14. Dispozitat e tjera në lidhje me zbatimin e procedurës që përshkruhet në këtë nen janë të parashikuara në Protokollin për procedurën e deficitit të tepërt, i cili u bashkëlidhet Traktateve.

Këshilli, me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe me Bankën Qendrore Europiane, miraton dispozitat e duhura të cilat e zëvendësojnë më pas Protokollin e lartpërmendur.

Në varësi të dispozitave të tjera të këtij paragrafi, Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian, përcakton rregullat e hollësishme dhe nocionet për zbatimin e dispozitave të Protokollit të lartpërmendur.

KREU 2

POLITIKA MONETARE

Neni 127
(ish-neni 105 TKE)

1. Objektivi parësor i Sistemit Europian të Bankave Qendrore (i quajtur më tej këtu "SEBQ") është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Pa cenuar objektivin e stabilitetit të çmimeve, SEBQ-ja mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Bashkimit, në mënyrë të atillë, që të kontribuojnë në arritjen e objektivave të Bashkimit të përcaktuara në nenin 3 të Traktatit për Bashkimin Europian. SEBQ-ja vepron në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar një shpërndarje efektive të burimeve dhe në përputhje me parimet e parashikuara në nenin 119.

2. Detyrat bazë që duhen realizuar përmes SEBQ-së janë:

– përcaktimi dhe zbatimi i politikës monetare të Bashkimit,

– kryerja e operacioneve të këmbimit valutor në përputhje me dispozitat e nenit 219,

– mbajtja dhe administrimi i rezervave zyrtare në monedhë të huaj të Shteteve Anëtare,

– nxitja e funksionimit pa probleme të sistemit të pagesave.

3. Pika e tretë e paragrafit 2 nuk cenon mbajtjen dhe administrimin nga qeveritë e Shteteve Anëtare, të tepricave qarkulluese në monedhë të huaj.

4. Banka Qendrore Europiane konsultohet:

– për çdo akt të propozuar të Bashkimit në fushat e saj të kompetencës,

– nga autoritetet kombëtare, në lidhje me çdo projektdispozitë legjislative në fushat e saj të kompetencës, por brenda kufijve dhe sipas kushteve që ka parashikuar Këshilli në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 129(4).

Banka Qendrore Europiane mund t'u paraqesë opinione institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të duhura të Bashkimit ose autoriteteve kombëtare, për çështje që bien në fushat e saj të kompetencës.

5. SEBQ kontribuon në realizimin pa pengesa të politikave që ndjekin autoritetet kombëtare në lidhje me mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve kredidhënëse dhe stabilitetin e sistemit financiar.

6. Këshilli, duke vepruar përmes rregulloreve sipas një procedure të posaçme legjislative, pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe me Bankën Qendrore Europiane, me unanimitet, mund ti ngarkojë Bankës Qendrore Europiane detyra që kanë të bëjnë me politikat e lidhura me mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve kredidhënëse dhe të institucioneve të tjera financiare, me përjashtim të shoqërive të sigurimit.

Neni 128
(ish-neni 106 TKE)

1. Banka Qendrore Europiane ka të drejtën ekskluzive të autorizojë emetimin e kartëmonedhave të euros brenda Bashkimit. Kartëmonedha të tilla mund t'i emetojnë Banka Qendrore Europiane dhe bankat qendrore kombëtare. Kartëmonedhat e emetuara nga Banka Qendrore Europiane dhe bankat qendrore kombëtare janë të vetmet kartëmonedha me kurs ligjor brenda Bashkimit.

2. Shtetet Anëtare mund të emetojnë monedha të euros, në varësi të miratimit të vëllimit të emetimit nga Banka Qendrore Europiane. Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Bankën Qendrore Europiane, mund të miratojë masa për të harmonizuar prerjet dhe të dhënat teknike të të gjitha monedhave të synuara për qarkullim, për aq sa është e nevojshme për të lejuar qarkullimin e tyre pa pengesa brenda Bashkimit.

Neni 129
(ish-neni 107 TKE)

1. SEBQ drejtohet nga organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Europiane, të cilat janë Këshilli Drejtues dhe Bordi Ekzekutiv.

2. Statuti i Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe i Bankës Qendrore Europiane (më tej i quajtur këtu "Statuti i SEBQ-së dhe i BQE-së") është përcaktuar në një Protokoll bashkëlidhur Traktateve.

3. Nenet 5.1, 5.2, 5.3, 17, 18, 19.1, 22, 23, 24, 26, 32.2, 32.3, 32.4, 32.6, 33.1(a) dhe 36 të Statutit të SEBQ-së dhe të BQE-së mund të ndryshohen nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative. Ata veprojnë ose me rekomandim të Bankës Qendrore Europiane dhe pasi konsultohen me Komisionin, ose me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohen me Bankën Qendrore Europiane.

4. Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Bankën Qendrore Europiane, ose me rekomandim të Bankës Qendrore Europiane dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Komisionin, miraton dispozitat e përmendura në nenet 4, 5.4, 19.2, 20, 28.1, 29.2, 30.4 dhe 34.3 të Statutit të SEBQ-së dhe BQE-së.

Neni 130
(ish-neni 108 TKE)

Gjatë ushtrimit të kompetencave dhe kryerjes së detyrave dhe detyrimeve që u ngarkojnë Traktatet dhe Statuti i SEBQ-së dhe BQE-së, as Banka Qendrore Europiane, asnjë bankë qendrore kombëtare dhe as anëtarët e organeve të tyre vendimmarrëse nuk kërkojnë ose marrin udhëzime nga institucionet, organet, zyrat ose agjencitë e Bashkimit, nga qeveria e një Shteti Anëtar apo nga ndonjë organ tjetër. Institucionet, organet, zyrat ose agjencitë e Bashkimit dhe qeveritë e Shteteve Anëtare marrin përsipër ta respektojnë këtë parim dhe të mos kërkojnë të ndikojnë tek anëtarët e organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore Europiane ose të bankave qendrore kombëtare në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 131
(ish-neni 109 TKE)

Secili Shtet Anëtar siguron që legjislacioni i tij kombëtar, duke përfshirë statutet e bankës qendrore kombëtare të tij, të jenë në përputhje me Traktatet dhe Statutin e SEBQ-së dhe të BQE-së.

Neni 132
(ish-neni 110 TKE)

1. Banka Qendrore Europiane, për të kryer detyrat që i ngarkohen SEBQ-së në përputhje me dispozitat e Traktateve dhe me kushtet e përcaktuara në Statutin e SEBQ-së dhe të BQE-së:

– miraton rregullore për aq sa është e nevojshme për zbatimin e detyrave të përcaktuara në nenin 3.1, pika e parë, nenet 19.1, 22 dhe 25.2 të Statutit të SEBQ-së dhe të BQE-së në rastet që përcaktohen në aktet e Këshillit të përmendura në nenin 129(4),

– marrë vendimet e nevojshme për kryerjen e detyrave që i ngarkohen SEBQ-së sipas Traktateve dhe Statutit të SEBQ-së dhe të BQE-së,

– bën rekomandime dhe jep opinione.

2. Banka Qendrore Europiane mund të vendosë t'i botojë vendimet, rekomandimet dhe opinionet e veta.

3. Brenda kufijve dhe sipas kushteve të miratuara nga Këshilli sipas procedurës të përcaktuar në nenin 129(4), Banka Qendrore Europiane ka të drejtën të vendosë gjoba ose sanksione periodike për ndërmarrjet që nuk i përmbushin detyrimet që rrjedhin nga rregulloret dhe vendimet e saj.

Neni 133

Pa cenuar kompetencat e Bankës Qendrore Europiane, Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, përcaktojnë masat e nevojshme për përdorimin e euros si monedhë e vetme. Masa të tilla miratohen pas konsultimit me Bankën Qendrore Europiane.

KREU 3

DISPOZITA INSTITUCIONALE

Neni 134
(ish-neni 114 TKE)

1. Për të nxitur bashkërendimin e politikave të Shteteve Anëtare në shkallën e plotë të nevojshme për funksionimin e tregut të brendshëm, krijohet një Komitet Ekonomik dhe Financiar.

2. Komiteti Ekonomik dhe Financiar ka këto detyra:

– dhënien e opinioneve me kërkesën e Këshillit ose të Komisionit, ose me nismën e vet për t'ua paraqitur këtyre institucioneve,

– mbajtjen në shqyrtim të situatës ekonomike dhe financiare të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit si dhe raportimin rregullisht për këtë qëllim përpara Këshillit dhe Komisionit, në veçanti për marrëdhëniet financiare me vendet e treta dhe institucionet ndërkombëtare,

– pa cenuar nenin 240, dhënien e kontributit në përgatitjen e punës së Këshillit të përmendur në nenet 66, 75, 121(2), (3),(4) dhe (6), 122, 124, 125, 126, 127(6), 128(2), 129(3) dhe(4), 138, 140(2) dhe (3), 143, 144(2) dhe (3), dhe në nenin 219, si dhe kryerja e detyrave të tjera këshillimore dhe përgatitore që ia ngarkon Këshilli,

– shqyrtimin të paktën një herë në vit të situatës në lidhje me lëvizjen e kapitalit dhe lirinë e pagesave, meqënëse rrjedhin nga zbatimi i Traktateve dhe i masave të miratuara nga Këshilli; shqyrtimi mbulon të gjitha masat e lidhura me lëvizjet e kapitalit dhe pagesave; Komiteti i raporton Komisionit dhe Këshillit për rezultatin e shqyrtimit.

Shtetet Anëtare, Komisioni dhe Banka Qendrore Europiane secila emërojnë jo më shumë se dy anëtarë të Komitetit.

3. Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Bankën Qendrore Europiane dhe Komitetin e përmendur në këtë nen, përcakton rregulla të hollësishme lidhur me përbërjen e Komitetit Ekonomik dhe Financiar. Presidenti i Këshillit informon Parlamentin Europian për një vendim të tillë.

4. Krahas detyrave të parashikuara në paragrafin 2, nëse dhe për aq kohë sa ka Shtete Anëtare me një shmangie siç parashikohet në nenin 139, Komiteti mban në shqyrtim situatën monetare dhe financiare si dhe sistemin e përgjithshëm të pagesave të këtyre Shteteve Anëtare dhe raporton rregullisht për këtë përpara Këshillit dhe Komisionit.

Neni 135
(ish-neni 115 TKE)

Për çështjet që bien brenda rregullimit të neneve 121(4), 126 me përjashtim të paragrafit 14, 138, 140(1), 140(2), nënparagrafi i parë, 140(3) dhe 219, Këshilli ose një Shtet Anëtar sipas rastit, mund t'i kërkojë Komisionit të bëjë një rekomandim ose një propozim. Komisioni e shqyrton këtë kërkesë dhe ia paraqet pa vonesë konkluzionet e veta Këshillit.

KREU 4

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR SHTETET ANËTARE MONEDHA E TË CILAVE ËSHTË EURO.

Neni 136

1. Për të siguruar funksionimin e duhur të bashkimit ekonomik dhe monetar dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktateve, Këshilli, sipas procedurës përkatëse prej atyre të përmendura në nenet 121 dhe 126, me përjashtim të procedurës së parashikuar në nenin 126(14), miraton masat e caktuara për ato Shtete Anëtare monedha e të cilave është euro:

(a) për të forcuar bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e disiplinës së tyre buxhetore;

(b) për të parashikuar orientimet e politikës ekonomike për këto Shtete, duke siguruar në të njëjtën kohë që të pajtohen me ato të miratuara për Bashkimin si i tërë dhe të mbahen nën mbikëqyrje.

2. Për masat e parashikuara në paragrafin 1, në votim marrin pjesë vetëm ata anëtarë të Këshillit të cilët përfaqësojnë Shtetet Anëtare monedha e të cilave është euro.

Shumica e cilësuar e anëtarëve të mësipërm përcaktohet sipas nenit 238(3)(a).

Neni 137

Masat organizative për takimet midis ministrave të atyre Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euro, përcaktohen në Protokollin për Euro Grupin.

Neni 138
(ish-neni 111(4), TKE)

1. Për të siguruar vendin e euros në sistemin monetar ndërkombëtar, Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton një vendim që përcakton qëndrimet e përbashkëta për çështjet me interes të veçantë për bashkimin ekonomik dhe monetar brenda institucioneve dhe konferencave financiare ndërkombëtare kompetente. Këshilli vepron pasi konsultohet me Bankën Qendrore Europiane.

2. Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë masat e duhura për të siguruar përfaqësimin e unifikuar brenda institucioneve dhe konferencave financiare ndërkombëtare. Këshilli vepron pasi konsultohet me Bankën Qendrore Europiane.

3. Për masat e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, në votim marrin pjesë vetëm ata anëtarë të Këshillit të cilët përfaqësojnë Shtetet Anëtare monedha e të cilave është euro.

Shumica e cilësuar e anëtarëve të mësipërm përcaktohet sipas nenit 238(3)(a).

KREU 5

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 139

1. Shtetet Anëtare për të cilat Këshilli nuk ka vendosur se i përmbushin kushtet e nevojshme për përdorimin e euros si monedhë të tyre kombëtare, quhen më poshtë "Shtete Anëtare me një shmangie".

2. Dispozitat e mëposhtme të Traktateve nuk zbatohen për Shtetet Anëtare me një shmangie:

(a) miratimi i atyre pjesëve të orientimeve të përgjithshme të politikës ekonomike që kanë të bëjnë me zonën e euros në përgjithësi (neni 121(2));

(b) mjetet shtrënguese për korrigjimin e deficiteve të tepërta (neni 126(9) dhe (11));

(c) objektivat dhe detyrat e SEBQ-së (neni 127(1) deri në (3) dhe(5));

(d) emetimi i euros (neni 128);

(e) aktet e Bankës Qendrore Europiane (neni 132);

(f) masat që rregullojnë përdorimin e euros (neni 133);

(g) marrëveshjet monetare dhe masat e tjera që lidhen me politikën e kursit të këmbimit (neni 219);

(h) emërimi i anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Europiane (neni 283(2);

(i) vendimet që përcaktojnë qëndrimet e përbashkëta për çështjet me interes të veçantë për bashkimin ekonomik dhe monetar brenda institucioneve dhe konferencave financiare ndërkombëtare kompetente (neni 138(1));

(j) masat për të siguruar një përfaqësim të unifikuar brenda institucioneve dhe konferencave financiare ndërkombëtare (neni 138(2)).

Në nenet e përmendura në germat nga (a) deri në (j), "Shtete Anëtare" konsiderohen rrjedhimisht, Shtetet Anëtare monedha e të cilave është Euro.

3. Sipas Kreut IX të Statutit të SEBQ-së dhe të BQE-së, Shtetet Anëtare me një shmangie dhe bankat qendrore kombëtare të tyre janë të përjashtuara nga të drejtat dhe detyrimet në kuadër të SEBQ-së.

4. Të drejtat e votimit të anëtarëve të Këshillit të cilët përfaqësojnë Shtetet Anëtare me një shmangie pezullohen kur Këshilli miraton masat e përmendura në nenet e renditura në paragrafin 2, si dhe në rastet e mëposhtme:

(a) rekomandimet që u jepen atyre Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euro në kuadër të mbikëqyrjes së shumëanshme, duke përfshirë programet e stabilitetit dhe paralajmërimet (neni 121(4));

(b) masat e lidhura me deficitet e tepërta që kanë të bëjnë me ato Shtete Anëtare monedha e të cilave është euro (neni 126(6), (7), (8), (12) dhe (13)).

Shumica e cilësuar e anëtarëve të tjerë të Këshillit përcaktohet sipas nenit 238(3)(a).

Neni 140
(ish-nenet 121(1), 122(2), fjalia e dytë,
dhe 123(5) TKE)

1. Të paktën një herë në dy vjet ose me kërkesë të një Shteti Anëtar me një shmangie, Komisioni dhe Banka Qendrore Europiane i raportojnë Këshillit për progresin që kanë bërë Shtetet Anëtare me një shmangie lidhur me përmbushjen e detyrimeve të tyre që kanë të bëjnë me arritjen e bashkimit ekonomik dhe monetar. Këto raporte përfshijnë një shqyrtim të përputhshmërisë të legjislacionit kombëtar të secilit prej këtyre Shteteve Anëtare, duke përfshirë edhe statutet e bankës qendrore kombëtare, me nenet 130 dhe 131 dhe Statutin e SEBQ-së dhe të BQE-së. Raportet shqyrtojnë edhe arritjen e një shkalle të lartë të një konvergjence të qëndrueshme, duke bërë lidhjen me përmbushjen e kritereve të mëposhtme nga secili Shtet Anëtar:

– arritja e një shkalle të lartë stabiliteti të çmimeve; tregues i kësaj është norma e inflacionit e cila u afrohet tre Shteteve Anëtare me ecurinë më të mirë sa i takon stabilitetit të çmimeve,

– qëndrueshmëria e pozicionit financiar publik; tregues i kësaj është arritja e një pozicioni buxhetor pa deficit që të jetë i tepërt, sipas përcaktimeve të nenit 126(6),

– respektimi i kufijve normale të luhatjes të parashikuara nga mekanizmi i kursit të këmbimit të Sistemit Monetar Europian, për të paktën dy vjet, pa zhvlerësim kundrejt euro-s,

– qëndrueshmëria e konvergjencës së arritur nga Shteti Anëtar me një shmangie dhe e pjesëmarrjes së tij në mekanizmin e kursit të këmbimit, e cila pasqyrohet në nivelet afatgjata të normës së interesit.

Katër kriteret e përmendura në këtë paragraf dhe afatet përkatëse brenda të cilave duhen respektuar, shtjellohen më tej në një Protokoll që u bashkëlidhet Traktateve. Raportet e Komisionit dhe Bankës Qendrore Europiane marrin në konsideratë edhe rezultatet e integrimit të tregjeve, situatën dhe zhvillimin e bilanceve të pagesave në llogarinë rrjedhëse dhe një shqyrtim të zhvillimit të kostove të punës për njësi dhe të treguesve të tjerë të çmimeve.

2. Pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe pas diskutimeve në Këshillin Europian, Këshilli, me propozim të Komisionit, vendos se cilat Shtete Anëtare me një shmangie i përmbushin kushtet e nevojshme në bazë të kritereve të parashikuara në paragrafin 1 dhe i shfuqizojnë shmangiet e Shteteve Anëtare në fjalë.

Këshilli vepron pasi merr rekomandimin e një shumice të cilësuar të anëtarëve të tij që përfaqësojnë ato Shtete Anëtare monedha e të cilave është Euro. Këta anëtarë veprojnë brenda gjashtë muajve pasi Këshilli merr propozimin e Komisionit.

Shumica e cilësuar e anëtarëve të mësipërm, të përmendur në nënparagrafin e dytë, përcaktohet sipas nenit 238(3)(a).

3. Nëse, sipas procedurës të parashikuar në paragrafin 2, vendoset shfuqizimi i një shmangieje, Këshilli, duke vepruar me unanimitetin e Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euro dhe të Shtetit Anëtar në fjalë, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Banka Qendrore Europiane, vendos në mënyrë të pakthyeshme normën e këmbimit që do të përdoret për të zëvendësuar monedhën e Shtetit Anëtar në fjalë me monedhën euro dhe merr masat e tjera të nevojshme për futjen e euros në qarkullim si monedhë e vetme e Shtetit Anëtar në fjalë.

Neni 141
(ish-nenet 123(3) dhe 117(2)pesë pikat e para, TKE)

1. Nëse dhe për sa kohë ka Shtete Anëtare me një shmangie dhe pa cenuar nenin 129(1), Këshilli i Përgjithshëm i Bankës Qendrore Europiane që përmendet në nenin 44 të Statutit të SEBQ-së dhe të BQE-së, themelohet si organi i tretë vendimmarrës i Bankës Qendrore Europiane.

2. Nëse dhe për sa kohë ka Shtete Anëtare me një shmangie, në lidhje me këto Shtete Anëtare, Banka Qendrore Europiane:

– fuqizon bashkëpunimin midis bankave qendrore kombëtare,

– fuqizon bashkërendimin e politikave monetare të Shteteve Anëtare, me qëllim sigurimin e stabilitetit të çmimeve,

– vëzhgon funksionimin e mekanizmit të kursit të këmbimit,

– zhvillon konsultime lidhur me çështje që bien brenda kompetencës së bankave qendrore kombëtare dhe prekin stabilitetin e institucioneve dhe tregjeve financiare,

– kryen detyrat e mëparshme të Fondit të Bashkëpunimit Monetar Europian i cili është zëvendësuar më pas nga Instituti Monetar Europian.

Neni 142
(ish-neni 124(1) TKE)

Secili Shtet Anëtar me një shmangie e trajton politikën e vet të kursit të këmbimit si çështje me interes të përbashkët. Kur veprojnë kështu, Shtetet Anëtare marrin në konsideratë përvojën e fituar gjatë bashkëpunimit brenda kuadrit të mekanizmit të kursit të këmbimit.

Neni 143
(ish-neni 119 TKE)

1. Kur një Shtet Anëtar me një shmangie gjendet në vështirësi ose rrezikohet seriozisht nga vështirësi lidhur me bilancin e pagesave si rezultat i një çekuilibri të përgjithshëm të bilancit të pagesave ose si rezultat i llojit të monedhës që ka në dispozicion, dhe kur këto vështirësi ka të ngjarë në veçanti të vënë në rrezik funksionimin e tregut të brendshëm ose zbatimin e politikës së përbashkët tregtare, Komisioni heton menjëherë pozicionin e Shtetit në fjalë dhe veprimin që ka kryer ose mund të kryejë ai Shtet në përputhje me dispozitat e Traktateve, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet që ka në dispozicion. Komisioni shprehet për masat që i rekomandohen të marrë Shtetit në fjalë.

Nëse veprimi i kryer nga një Shtet Anëtar me një shmangie dhe masat e propozuara nga Komisioni nuk dalin të mjaftueshme për t'i kapërcyer vështirësitë që kanë lindur ose rrezikojnë të lindin, Komisioni, pasi konsulton Komitetin Ekonomik dhe Financiar, i rekomandon Këshillit dhënien e mbështetjes së ndërsjellë dhe metodat e duhura për këtë qëllim.

Komisioni e mban Këshillin të informuar rregullisht për situatën dhe për mënyrën si po zhvillohet ajo.

2. Këtë mbështetje të tillë të ndërsjellë e jep Këshilli; ai miraton direktiva ose vendime ku përcaktohen kushtet dhe hollësitë e kësaj mbështetjeje, e cila mund të marrë forma të tilla si:

(a) një qasje në bashkëpunim brenda organizatave të tjera ndërkombëtare të cilave mund t'u drejtohen Shtetet Anëtare me një shmangie;

(b) masat e nevojshme për të shmangur devijimin e tregtisë kur një Shtet Anëtar me një shmangie i cili ndodhet në vështirësi mban ose rivendos kufizime sasiore kundrejt vendeve të treta;

(c) dhënia e kredive të kufizuara nga Shtetet e tjera Anëtare, në varësi të miratimit prej tyre.

3. Nëse Këshilli nuk e jep mbështetjen e ndërsjellë të rekomanduar nga Komisioni ose nëse mbështetja e ndërsjellë jepet dhe masat e marra nuk janë të mjaftueshme, Komisioni e autorizon Shtetin Anëtar, i cili ndodhet në vështirësi për të marrë masa mbrojtëse, me një shmangie, kushtet dhe hollësitë e të cilave i cakton Komisioni.

Ky autorizim mund ta tërhiqet dhe Këshilli mund t'i ndryshojë kushtet dhe hollësitë e tij.

Neni 144
(ish-neni 120 TKE)

1. Kur ndodh një krizë e papritur në bilancin e pagesave dhe nuk merret menjëherë një vendim sipas kuptimit të nenit 143(2), një Shtet Anëtar me një shmangie mund të marrë si parandalim masat e nevojshme mbrojtëse. Këto masa duhet të shkaktojnë shqetësimin më të vogël të mundshëm në funksionimin e tregut të brendshëm dhe nuk duhet të jenë më të gjera në fushën e veprimit të tyre se çfarë është e nevojshme për të përballuar vështirësitë e papritura që kanë lindur.

2. Komisioni dhe Shtetet e tjera Anëtare informohen për masa të tilla mbrojtëse jo më vonë se data e hyrjes së tyre në fuqi. Komisioni mund t'i rekomandojë Këshillit të japë mbështetjen e ndërsjellë sipas nenit 143.

3. Pasi Komisioni ka dhënë rekomandimin dhe është konsultuar Komiteti Ekonomik dhe Financiar, Këshilli mund të vendosë që Shteti Anëtar në fjalë t'i ndryshojë, pezullojë ose ndalojë masat mbrojtëse të përmendura më lart.

TITULLI IX

PUNËSIMI

Neni 145
(ish-neni 125 TKE)

Shtetet Anëtare dhe Bashkimi, në zbatim të këtij Titulli, punojnë drejt hartimit të një strategjie të bashkërenduar për punësimin dhe në veçanti për promovimin e një krahu pune të kualifikuar, të trajnuar dhe të aftë për t'u përshtatur dhe të tregjeve të punës që reagojnë ndaj ndryshimeve ekonomike, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 3 të Traktatit për Bashkimin Europian.

Neni 146
(ish-neni 126 TKE)

1. Shtetet Anëtare, përmes politikave për punësimin, kontribuojnë në arritjen e objektivave të përmendura në nenin 145 në mënyrë të atillë që të përputhet me orientimet e përgjithshme të politikave ekonomike të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit, të miratuara sipas nenin 121(2).

2. Shtetet Anëtare, duke u kushtuar vëmendje praktikave kombëtare që lidhen me përgjegjësitë e administratorëve dhe të krahut të punës, e konsiderojnë nxitjen e punësimit si çështje me interes të përbashkët dhe i bashkërendojnë veprimet e tyre në këtë aspekt brenda Këshillit, në përputhje me dispozitat e nenit 148.

Neni 147
(ish-neni 127 TKE)

1. Bashkimi kontribuon për një nivel të lartë punësimi përmes nxitjes së bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare dhe përmes mbështetjes, si dhe, nëse është nevoja, përmes plotësimit të veprimeve të tyre. Në këtë veprim, respektohen kompetencat e Shteteve Anëtare.

2. Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit merr në konsideratë objektivin për një nivel të lartë punësimi.

Neni 148
(ish-neni 128 TKE)

1. Këshilli Europian shqyrton çdo vit situatën e punësimit brenda Bashkimit dhe miraton përfundime për këtë situatë, në bazë të një raporti të përbashkët vjetor të Këshillit dhe Komisionit.

2. Në bazë të përfundimeve të Këshillit Europian, Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian, Komitetin Ekonomik dhe Social, Komitetin e Rajoneve dhe Komitetin e Punësimit të përmendur në nenin 150, harton çdo vit udhëzime të cilat Shtetet Anëtare duhet t'i mbajnë në konsideratë në politikat e tyre për punësimin. Këto udhëzime duhet të përputhen me udhëzimet e përgjithshme të miratuara sipas nenit 121(2).

3. Secili Shtet Anëtar i jep Këshillit dhe Komisionit një raport vjetor të masave kryesore të marra për të vënë në zbatim politikën e tij për punësimin në dritën e udhëzimeve për punësimin të cilat përmenden në paragrafin 2.

4. Këshilli, në bazë të raporteve të përmendura në paragrafin 3 dhe pasi merr mendimet e Komitetit të Punësimit, kryen çdo vit një shqyrtim të zbatimit të politikave për punësimin të Shteteve Anëtare në dritën e udhëzimeve për punësimin. Këshilli, me rekomandim të Komisionit, mund t'u japë rekomandime Shteteve Anëtare, nëse e gjykon të arsyeshme në bazë të këtij shqyrtimi.

5. Në bazë të rezultateve të këtij shqyrtimi, Këshilli dhe Komisioni bëjnë një raport vjetor të përbashkët, të cilin ia paraqesin Këshillit Europian, për situatën e punësimit në Bashkimin dhe për zbatimin e orientimeve për punësimin.

Neni 149
(ish-neni 129 TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, mund të miratojnë masa stimuluese që kanë për qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare dhe mbështetjen e veprimeve të tyre në fushën e punësimit përmes nismave që kanë si qëllim zhvillimin e shkëmbimit të informacionit dhe të praktikave më të mira, ofrimin e analizave krahasuese dhe të këshillave si edhe nxitjen e qasjeve novatore dhe përvojave vlerësuese, në veçanti me ndihmën e projekteve pilot.

Këto masa nuk përfshijnë harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

Neni 150
(ish-neni 130 TKE)

Këshilli, me shumicë të thjeshtë, pasi konsultohet me Parlamentin Europian, krijon një Komitet Punësimi me status këshillimor për nxitjen e bashkërendimit midis Shteteve Anëtare të politikave të punësimit dhe të tregut të punës. Detyrat e Komitetit janë:

– vëzhgimi i situatës së punësimit dhe i politikave të punësimit për Shtetet Anëtare dhe Bashkimin,

– pa cenuar nenin 240, hartimi i opinioneve me kërkesë të Këshillit ose të Komisionit, apo me nismën e vet, dhe dhënia e kontributit për përgatitjen e punimeve të Këshillit që përmenden në nenin 148.

Gjatë përmbushjes së mandatit të tij, Komiteti konsultohet me drejtuesit dhe punonjësit.

Secili Shtet Anëtar dhe Komisioni emërojnë dy anëtarë të Komitetit.

TITULLI X

POLITIKA SOCIALE

Neni 151
(ish-neni 136 TKE)

Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, duke pasur parasysh të drejtat themelore sociale, siç janë ato të parashikuara në Kartën Sociale Europiane të nënshkruar në Torino më 18 tetor 1961 dhe në Kartën e Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale të Punonjësve e vitit 1989, kanë si objektiva të tyre nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës, në mënyrë që të mundësohet harmonizimi i tyre gjatë ruajtjes së përmirësimit, mbrojtja e duhur sociale, dialogu midis drejtuesve dhe punonjësve, zhvillimi i burimeve njerëzore me qëllim ruajtjen në periudhë afatgjatë të punësimit të lartë dhe luftën kundër përjashtimit social.

Për këtë qëllim, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare zbatojnë masa që marrin në konsideratë format e ndryshme të praktikave kombëtare, në veçanti në fushën e marrëdhënieve kontraktore, dhe nevojën për të ruajtur aftësinë konkurruese të ekonomisë së Bashkimit.

Ata besojnë se një zhvillim i tillë do të rrjedhë jo vetëm nga funksionimi i tregut të brendshëm, i cili favorizon harmonizimin e sistemeve sociale, por edhe nga procedurat e parashikuara nga Traktatet dhe nga përafrimi i dispozitave të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore ose administrative.

Neni 152

Bashkimi njeh dhe promovon rolin e partnerëve socialë në nivelin e tij, duke mbajtur në konsideratë larminë e sistemeve kombëtare. Ai mundëson dialogun midis partnerëve socialë, duke respektuar autonominë e tyre.

Samiti Social Trepalësh për Rritjen dhe Punësimin kontribuon në dialogun social.

Neni 153
(ish-neni 137 TKE)

1. Me qëllim arritjen e objektivave të nenit 151, Bashkimi mbështet dhe plotëson aktivitetet e Shteteve Anëtare në fushat e mëposhtme:

(a) përmirësimin në veçanti të mjedisit të punës, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punonjësve;

(b) kushtet e punës;

(c) sigurimet shoqërore dhe mbrojtjen sociale të punonjësve;

(d) mbrojtjen e punonjësve kur zgjidhet marrëdhënia e punës;

(e) informimin dhe konsultimin e punonjësve;

(f) përfaqësimin dhe mbrojtjen kolektive të interesave të punonjësve dhe punëdhënësve, duke përfshirë bashkëvendosjen, në varësi të paragrafit 5;

(g) kushtet e punësimit për shtetasit e vendeve të treta të cilët qëndrojnë ligjërisht në territorin e Bashkimit;

(h) integrimin e personave të përjashtuar nga tregu i punës, pa cenuar nenin 166;

(i) barazinë midis burrave dhe grave në lidhje me mundësitë në tregun e punës dhe trajtimin në punë;

(j) luftën kundër përjashtimit social;

(k) modernizimin e sistemeve të mbrojtjes sociale, pa cenuar germën (c).

2. Për këtë qëllim, Parlamenti Europian dhe Këshilli:

(a) mund të miratojnë masa për të nxitur bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare përmes nismave që kanë si qëllim përmirësimin e njohurive, zhvillimin e shkëmbimit të informacionit dhe praktikave më të mira, nxitjen e qasjeve novatore dhe përvojave vlerësuese, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare;

(b) mund të miratojnë në fushat e përmendura në germat nga (a) deri në (i) të paragrafit 1, përmes direktivave, kërkesat minimale për zbatimin gradual, duke u kushtuar vëmendje kushteve dhe rregullave teknike në secilin prej Shteteve Anëtare. Direktiva të tilla duhet të shmangin vendosjen e kufizimeve administrative, financiare dhe juridike në një mënyrë e cila do ta pengonte krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Parlamenti Europian dhe Këshilli veprojnë sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve.

Në fushat e përmendura në paragrafin 1 germat (c), (d), (f) dhe (g), Këshilli vendos me unanimitet, sipas një procedure të posaçme legjislative, pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Këshilli, me unanimitet, me propozim të Komisionit, pasi konsultohet me Parlamentin Europian, mund të vendosë të ndjekë procedurën e zakonshme legjislative për paragrafin 1 germat (d), (f) dhe (g).

3. Një Shtet Anëtar mund t'u besojë administratorëve dhe punonjësve, me kërkesën e tyre, zbatimin e direktivave të miratuara në zbatim të paragrafit 2, ose, sipas rastit, zbatimin e një vendimi të Këshillit të miratuar në zbatim të nenit 155.

Në këtë rast, ai siguron, jo më vonë se data kur duhet transpozuar apo zbatuar direktiva ose vendimi, që drejtuesit dhe punonjësit të kenë filluar zbatimin e masave të nevojshme sipas marrëveshjes, ku Shtetit Anëtar në fjalë i kërkohet të marrë masat e nevojshme që i japin mundësi të jetë në çdo kohë në gjendje të garantojë rezultatet e vendosura nga direktiva ose nga vendimi.

4. Dispozitat e miratuara sipas këtij neni:

– nuk e prekin të drejtën e Shteteve Anëtare për të përcaktuar parimet themelore të sistemeve të tyre të sigurimeve shoqërore, si dhe nuk duhet t'u prekin ndjeshëm ekuilibrin financiar,

– nuk i pengojnë Shtetet Anëtare të mbajnë ose të paraqesin masa mbrojtëse më të shtrënguara të pajtueshme me Traktatet.

5. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për pagën, të drejtën e pjesëmarrjes në shoqata, të drejtën e grevës dhe të drejtën e mbylljes së dyerve punëtorëve.

Neni 154
(ish-neni 138 TKE)

1. Komisioni ka detyrën e nxitjes së konsultimeve të drejtuesve dhe punonjësve në nivel të Bashkimit dhe merr çdo masë përkatëse për të mundësuar dialogun e tyre përmes sigurimit të një mbështetjeje të drejtpeshuar për palët.

2. Për këtë qëllim, përpara paraqitjes së propozimeve në fushën e politikës sociale, Komisioni konsultohet me drejtuesit dhe punonjësit për drejtimin e mundshëm të veprimit të Bashkimit.

3. Nëse, pas konsultimesh të tilla, Komisioni e konsideron të këshillueshëm veprimin e Bashkimit, ai konsultohet me drejtuesit dhe punonjësit për përmbajtjen e propozimit të parashikuar. Drejtuesit dhe punonjësit i përcjellin Komisionit një opinion ose, sipas rastit, një rekomandim.

4. Me rastin e konsultimit të përmendur në paragrafët 2 dhe 3, drejtuesit dhe punonjësit mund ta informojnë Komisionin për dëshirën e tyre për të nisur procesin e parashikuar në nenin 155. Kohëzgjatja e këtij procesi nuk i kalon nëntë muaj, nëse drejtuesit dhe punonjësit në fjalë dhe Komisioni nuk vendosin bashkërisht ta zgjasin atë.

Neni 155
(ish-neni 139 TKE)

1. Nëse dëshirojnë drejtuesit dhe punonjësit, dialogu mes tyre në nivel të Bashkimit mund të çojë në marrëdhënie kontraktore, duke përfshirë edhe marrëveshje.

2. Marrëveshjet e lidhura në nivel të Bashkimit zbatohen ose sipas procedurave dhe praktikave që ndjekin drejtuesit dhe punonjësit dhe Shtetet Anëtare ose, në çështjet që mbulon neni 153, me kërkesën e përbashkët të palëve, sipas një vendimi të Këshillit me propozim të Komisionit. Për këtë informohet Parlamenti Europian.

Këshilli vendos me unanimitet kur marrëveshjet në fjalë përmbajnë një ose më shumë dispozita që lidhen me njërën prej fushave për të cilat kërkohet unanimiteti në zbatim të nenit 153(2).

Neni 156
(ish-neni 140 TKE)

Me qëllim arritjen e objektivave të nenit 151 dhe pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve, Komisioni nxit bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare dhe mundëson bashkërendimin e veprimit të tyre në të gjitha fushat e politikave sociale sipas këtij Kreu, në veçanti në çështjet e lidhura me:

– marrëdhëniet e punës,

– legjislacionin e punës dhe kushtet e punës,

– formimin profesional bazë dhe të avancuar,

– sigurimet shoqërore,

– parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale,

– higjienën në punë,

– të drejtën e shoqërimit dhe negociatave kolektive midis punëdhënësve dhe punonjësve.

Për këtë qëllim, Komisioni vepron në kontakt të ngushtë me Shtetet Anëtare përmes bërjes së studimeve, dhënies së opinioneve dhe organizimit të konsultimeve si për problemet që lindin në nivel kombëtar ashtu edhe për problemet që përbëjnë shqetësim për organizatat ndërkombëtare, në veçanti nismat që kanë si qëllim krijimin e orientimeve dhe treguesve, organizimin e shkëmbimit të praktikës më të mirë dhe përgatitjen e elementeve të nevojshme për vëzhgimin dhe vlerësimin periodik. Për këtë mbahet tërësisht i informuar Parlamenti Europian.

Përpara dhënies së opinioneve të parashikuara në këtë nen, Komisioni konsultohet me Komitetin Ekonomik dhe Social.

Neni 157
(ish-neni 141 TKE)

1. Secili Shtet Anëtar siguron që të zbatohet parimi i pagës së barabartë për punonjësit meshkuj dhe femra për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë.

2. Për qëllimin e këtij neni, "pagë" do të thotë rroga e zakonshme bazë ose minimale dhe çdo lloj tjetër kundërvlefte, në para ose në natyrë, që punëdhënësi i jep punonjësit drejtpërdrejt ose tërthorazi, nisur nga marrëdhëniet e punës.

Pagë e barabartë pa diskriminim për shkak të gjinisë do të thotë:

(a) që paga për të njëjtën punë të normuar të llogaritet në bazë të së njëjtës njësi matjeje;

(b) që paga për punë të matur me kohë të jetë e njëjtë për të njëjtin pozicion pune.

3. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, miratojnë masa për të siguruar zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështjet e punësimit dhe profesionit, duke përfshirë parimin e pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë.

4. Me qëllimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë midis burrave dhe grave në punë, parimi i trajtimit të barabartë nuk e pengon asnjë Shtet Anëtar të mbajë ose miratojë masa që parashikojnë avantazhe konkrete për t'ia bërë më të lehtë gjinisë më pak të përfaqësuar që të ndjekë një aktivitet profesional ose për të parandaluar ose kompensuar pozitat e pafavorshme në karrierat profesionale.

Neni 158
(ish-neni 142 TKE)

Shtetet Anëtare bëjnë përpjekje për të ruajtur barasvlerën ndërmjet skemave të pushimeve me të drejtë rroge.

Neni 159
(ish-neni 143 TKE)

Komisioni harton një raport çdo vit për progresin në arritjen e objektivave të nenit 151, duke përfshirë situatën demografike të Bashkimit. Ai ia përcjell raportin Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komitetit Ekonomik dhe Social.

Neni 160
(ish-neni 144 TKE)

Këshilli, me shumicë të thjeshtë pasi konsultohet me Parlamentin Europian, krijon një Komitet për Mbrojtjen Sociale me status këshillimor për nxitjen e bashkëpunimit për politikat e mbrojtjes sociale midis Shteteve Anëtare dhe Komisionit. Detyrat e Komitetit janë:

– vëzhgimi i situatës sociale dhe hartimi i politikave të mbrojtjes sociale për Shtetet Anëtare dhe Bashkimin,

– nxitja e shkëmbimit të informacionit, përvojës dhe praktikave të mira midis Shteteve Anëtare dhe me Komisionin,

– pa cenuar nenin 240, përgatitja e raporteve, hartimi i opinioneve ose kryerja e punëve të tjera brenda fushave të kompetencës, me kërkesë të Këshillit, të Komisionit ose me nismën e vet.

Komiteti, gjatë përmbushjes së mandatit të tij, vendos kontaktet e duhura me drejtuesit dhe punonjësit.

Secili Shtet Anëtar dhe Komisioni emërojnë dy anëtarë të Komitetit.

Neni 161
(ish-neni 145 TKE)

Komisioni përfshin një krye më vete për zhvillimet sociale brenda Bashkimit në raportin vjetor për Parlamentin Europian.

Parlamenti Europian mund t'i kërkojë Komisionit të hartojë raporte për probleme të veçanta në lidhje me kushtet sociale.

TITULLI XI

FONDI SOCIAL EUROPIAN

Neni 162
(ish-neni 146 TKE)

Për të përmirësuar mundësitë për punësim për punonjësit në tregun e brendshëm dhe për të kontribuar përmes tyre në rritjen e standardit të jetesës, me këtë nen krijohet Fondi Social Europian sipas dispozitave të parashikuara më poshtë; Fondi ka si qëllim ta bëjë më të lehtë punësimin e punonjësve dhe ta rrisë lëvizshmërinë e tyre gjeografike dhe profesionale brenda Bashkimit dhe të mundësojë përshtatjen e tyre ndaj ndryshimeve industriale dhe ndaj ndryshimeve në sistemet e prodhimit, në veçanti përmes formimit dhe riformimit profesional.

Neni 163
(ish-neni 147 TKE)

Fondi administrohet nga Komisioni.

Në këtë detyrë Komisioni mbështetet nga një Komitet i kryesuar nga një Anëtar i Komisionit dhe i përbërë nga përfaqësues të qeverive, sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve.

Neni 164
(ish-neni 148 TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, miratojnë rregullore zbatuese që lidhen me Fondin Social Europian.

TITULLI XII

ARSIMI, FORMIMI PROFESIONAL, RINIA DHE SPORTI

Neni 165
(ish-neni 149 TKE)

1. Bashkimi kontribuon në zhvillimin e arsimit cilësor përmes nxitjes së bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, përmes mbështetjes dhe plotësimit të veprimeve të tyre, duke respektuar, në të njëjtën kohë, përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen e mësimdhënies dhe organizimin e sistemeve arsimore si edhe larminë e tyre kulturore dhe gjuhësore.

Bashkimi kontribuon në promovimin e çështjeve sportive europiane, duke marrë në konsideratë, në të njëjtën kohë, natyrën e veçantë të sportit, strukturat e tij të mbështetura në aktivitetet vullnetare dhe funksionin e tij social dhe edukativ.

2. Veprimi i Bashkimit ka si qëllim:

– zhvillimin e dimensionit europian në arsim, sidomos përmes mësimdhënies dhe përhapjes së gjuhëve të Shteteve Anëtare,

– nxitjen e lëvizshmërisë së studentëve dhe mësuesve, ndër të tjera duke nxitur njohjen akademike të diplomave dhe periudhave të studimit,

– nxitjen e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore,

– zhvillimin e shkëmbimit të informacionit dhe përvojave për çështjet e përbashkëta për sistemet arsimore të Shteteve Anëtare,

– nxitjen e zhvillimit të shkëmbimeve të të rinjve dhe të shkëmbimeve të instruktorëve shoqëroro-edukativë, dhe nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike në Europë,

– nxitjen e zhvillimit të arsimit në distancë,

– zhvillimin e dimensionit europian në sporte, përmes promovimit të ndershmërisë dhe transparencës në garat sportive dhe bashkëpunimit midis organeve përgjegjëse për sportet, si dhe përmes mbrojtjes së integritetit fizik dhe moral të sportistëve dhe sportisteve, sidomos të sportistëve të rinj dhe sportisteve të reja.

3. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare nxisin bashkëpunimin me vendet e treta dhe organizatat kompetente ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe sportit, në veçanti me Këshillin e Europës.

4. Për të kontribuar në arritjen e objektivave të përmendura në këtë nen:

– Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, miratojnë masa stimuluese, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

– Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton rekomandime.

Neni 166
(ish-neni 150 TKE)

1. Bashkimi zbaton një politikë të formimit profesional e cila mbështet dhe plotëson veprimet e Shteteve Anëtare, duke respektuar në të njëjtën kohë përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen dhe organizimin e formimit profesional.

2. Veprimi i Bashkimit ka si qëllim:

– lehtësimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve industriale, në veçanti përmes formimit dhe riformimit profesional,

– përmirësimin e formimit profesional fillestar dhe të vazhduar në mënyrë që të mundësohet integrimi dhe riintegrimi profesional në tregun e punës,

– lehtësimin e pjesëmarrjes në formimin profesional dhe nxitjen e lëvizshmërisë së instruktorëve dhe pjesëmarrësve në formim dhe në veçanti të të rinjve,

– nxitjen e bashkëpunimit për formimin midis institucioneve arsimore ose formuese dhe firmave,

– zhvillimin e shkëmbimit të informacionit dhe përvojave për çështjet e përbashkëta për sistemet formuese të Shteteve Anëtare.

3. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare nxisin bashkëpunimin me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare kompetente në sferën e formimit profesional.

4. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, miratojnë masa për të kontribuar në arritjen e objektivave të përmendura në këtë nen, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare, dhe Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton rekomandime.

TITULLI XIII

KULTURA

Neni 167
(ish-neni 151 TKE)

1. Bashkimi kontribuon në lulëzimin e kulturave të Shteteve Anëtare, duke respektuar në të njëjtën kohë larminë kombëtare dhe rajonale dhe duke nxjerrë në pah trashëgiminë e përbashkët kulturore.

2. Veprimi i Bashkimit ka si qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme mbështetjen dhe plotësimin e veprimeve të tyre në fushat e mëposhtme:

– përmirësimin e njohurive dhe përhapjen e kulturës dhe historisë së popujve europianë,

– ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me rëndësi europiane,

– shkëmbimet kulturore jo tregtare,
– krijimin artistik dhe letrar, duke përfshirë edhe atë në sektorin audioviziv.

3. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare nxisin bashkëpunimin me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare kompetente në sferën e kulturës, në veçanti me Këshillin e Europës.

4. Bashkimi merr në konsideratë aspektet kulturore në veprimin e tij sipas dispozitave të tjera të Traktateve, në veçanti për të respektuar dhe promovuar larminë e kulturave të tij.

5. Për të kontribuar në arritjen e objektivave të përmendura në këtë nen:

– Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin e Rajoneve, miratojnë masa stimuluese, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

– Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton rekomandime.

TITULLI XIV

SHËNDETI PUBLIK

Neni 168
(ish-neni 152 TKE)

1. Sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit publik gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit.

Veprimi i Bashkimit, i cili plotëson politikat kombëtare, orientohet drejt përmirësimit të shëndetit publik, parandalimit të sëmundjeve fizike dhe mendore dhe eliminimit të burimeve të rrezikut ndaj

shëndetit fizik dhe mendor. Një veprim i tillë mbulon luftën kundër armiqve madhorë të shëndetit, përmes nxitjes së studimit të shkaqeve, transmetimit dhe parandalimit të tyre, përmes informimit dhe edukimit shëndetësor dhe përmes vëzhgimit, njoftimit të hershëm dhe luftës kundër rreziqeve serioze ndërkufitare që i kanosen shëndetit.

Bashkimi e plotëson veprimin e Shteteve Anëtare në zvogëlimin e dëmit shëndetësor të lidhur me drogat, duke përfshirë informimin dhe parandalimin.

2. Bashkimi nxit bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare në fushat e përmendura në këtë nen dhe, nëse është e nevojshme, jep mbështetje për veprimin e tyre. Në veçanti, ai nxit bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare për të përmirësuar plotësueshmërinë e shërbimeve të tyre shëndetësore në zonat ndërkufitare.

Shtetet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, bashkërendojnë politikat dhe programet e tyre në fushat e përmendura në paragrafin 1. Komisioni, në kontakt të afërt me Shtetet Anëtare, mund të marrë nisma të dobishme për nxitjen e një bashkërendimi të tillë, në veçanti nisma që kanë si qëllim krijimin e orientimeve dhe treguesve, organizimin e shkëmbimit të praktikës më të mirë dhe përgatitjen e elementeve të nevojshme për vëzhgimin dhe vlerësimin periodik. Për këtë mbahet tërësisht i informuar Parlamenti Europian.

3. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare nxisin bashkëpunimin me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare kompetente në sferën e shëndetit publik.

4. Duke u shmangur nga neni 2(5) dhe neni 6(a) dhe në zbatim të nenit 4(2)(k), Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, për të kontribuar në arritjen e objektivave të përmendura në këtë nen, miratojnë në përgjigje të shqetësimeve të përbashkëta për sigurinë:

(a) masa që vendosin standarde të larta cilësie dhe sigurie për organet dhe lëndët me origjinë njerëzore, gjakun dhe produktet e nxjerra nga gjaku; këto masa nuk i pengojnë Shtetet Anëtare që të mbajnë ose të paraqesin masa mbrojtëse më të shtrënguara;

(b) masa në fushat veterinare dhe fitosanitare të cilat kanë si objektiv të drejtpërdrejtë mbrojtjen e shëndetit publik;

(c) masa që vendosin standarde të larta cilësie dhe sigurie për medikamentet dhe aparatet që përdoren në mjekësi.

5. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, mund të miratojnë edhe masa stimuluese që kanë për qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të njeriut dhe, në veçanti, luftën kundër armiqve madhorë ndërkufitarë të shëndetit, masa që kanë të bëjnë me vëzhgimin, njoftimin e hershëm dhe luftën kundër rreziqeve serioze ndërkufitare që i kanosen shëndetit, dhe masa të cilat kanë si objektiv të drejtpërdrejtë të tyre mbrojtjen e shëndetit publik në lidhje me duhanin dhe abuzimin me alkoolin, pa përfshirë harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

6. Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë edhe rekomandime për qëllimet e parashikuara në këtë nen.

7. Veprimi i Bashkimit respekton përgjegjësitë e Shteteve Anëtare për përcaktimin e politikës së tyre shëndetësore dhe për organizimin dhe realizimin e shërbimeve shëndetësore dhe të kujdesit shëndetësor. Përgjegjësitë e Shteteve Anëtare përfshijnë administrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të kujdesit shëndetësor dhe shpërndarjen e burimeve të caktuara për to. Masat e përmendura në paragrafin 4 germa (a) nuk i prekin dispozitat kombëtare për dhurimin ose përdorimin mjekësor të organeve dhe gjakut.

TITULLI XV

MBROJTJA E KONSUMATORIT

Neni 169
(ish-neni 153 TKE)

1. Për të promovuar interesat e konsumatorëve dhe për të siguruar një nivel të mbrojtjes së konsumatorëve, Bashkimi kontribuon në mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe interesave ekonomike të konsumatorëve, si edhe në promovimin e të drejtës për informim, edukim dhe organizim, në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre.
2. Bashkimi kontribuon në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin 1 përmes:

(a) masave të miratuara në zbatim të nenit 114 në kuadër të realizimit të tregut të brendshëm;

(b) masave të cilat mbështesin, plotësojnë dhe vëzhgojnë politikën që ndjekin Shtetet Anëtare.

3. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, miratojnë masat e përmendura në paragrafin 2(b).

4. Masat e miratuara në zbatim të paragrafit 3 nuk i pengojnë Shtetet Anëtare që të mbajnë ose të ndërmarrin masa mbrojtëse më të shtrënguara. Masa të tilla duhet të jenë në pajtim me Traktatet. Për to njoftohet Komisioni.

TITULLI XVI

RRJETET TRANS-EUROPIANE

Neni 170
(ish-neni 154 TKE)

1. Për të ndihmuar në arritjen e objektivave të përmendura në nenet 26 dhe 174 dhe për t'u dhënë mundësi qytetarëve të Bashkimit, operatorëve ekonomikë dhe komuniteteve rajonale dhe vendore të përfitojnë plotësisht nga krijimi i një zone pa kufij, Bashkimi kontribuon në krijimin dhe zhvillimin e rrjeteve trans-Europiane në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturave të energjetikës.

2. Brenda kuadrit të një sistemi tregjesh të hapura dhe konkurruese, veprimi i Bashkimit ka si qëllim promovimin e ndërlidhjes dhe ndërshfrytëzueshmërisë së rrjeteve kombëtare si edhe lidhjen me këto rrjete. Ai mban në konsideratë, në veçanti, nevojën për të lidhur rajonet ishullore, ato pa dalje në det si edhe ato periferike me rajonet qendrore të Bashkimit.

Neni 171
(ish-neni 155 TKE)

1. Për të arritur objektivat e përmendura në nenin 170, Bashkimi:

– nxjerr një sërë udhëzimesh që mbulojnë objektivat, përparësitë dhe drejtimet e përgjithshme të masave të parashikuara në sferën e rrjetet Trans-Europiane; këto udhëzime identifikojnë projektet me interes të përbashkët,

– zbaton masat që mund të dalin të nevojshme për të siguruar ndërshfrytëzueshmërinë e rrjeteve, në veçanti në fushën e standardizimit teknik,

– mund të mbështesë projekte me interes të përbashkët të mbështetura nga Shtetet Anëtare, të cilat janë identifikuar në kuadër të orientimeve të përmendura në nënpikën e parë, sidomos përmes studimeve të realizueshmërisë, dorëzanive të huave ose subvencioneve për normën e interesit; Bashkimi mund të kontribuojë, edhe përmes Fondit të Kohezionit të krijuar në zbatim të nenit 177, për financimin e projekteve të caktuara në Shtetet Anëtare në fushën e infrastrukturës së transportit.

Veprimtaritë e Bashkimit marrin në konsideratë mundësitë për sukses ekonomik të projekteve.

2. Shtetet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, bashkërendojnë mes tyre politikat e ndjekura në nivel kombëtar të cilat mund të kenë një ndikim të ndjeshëm në arritjen e objektivave të përmendura në nenin 170. Komisioni, në bashkëpunim të ngushtë me Shtetin Anëtar, mund të marrë nisma të dobishme për nxitjen e një bashkëpunimi të tillë.

3. Bashkimi mund të vendosë të bashkëpunojë me vendet e treta për të promovuar projektet me interes të përbashkët dhe për të siguruar ndërshfrytëzueshmërinë e rrjeteve.

Neni 172
(ish-neni 156 TKE)

Orientimet dhe masat e tjera të përmendura në nenin 171(1) miratohen nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve.

Orientimet dhe projektet me interes të përbashkët të cilat lidhen me territorin e një Shteti Anëtar kërkojnë miratimin e Shtetit Anëtar në fjalë.

TITULLI XVII

INDUSTRIA

Neni 173
(ish-neni 157 TKE)

1. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare sigurojnë ekzistencën e kushteve të nevojshme për aftësinë konkurruese të industrisë së Bashkimit.

Për këtë qëllim, në përputhje me një sistem tregjesh të hapura dhe konkurruese, veprimi i tyre ka si qëllim:

– përshpejtimin e përshtatjes së industrisë ndaj ndryshimeve strukturore

– nxitjen e një mjedisi të favorshëm për iniciativën dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve në mbarë Bashkimin, sidomos të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,

– nxitjen e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunimin midis ndërmarrjeve,

– nxitjen e një shfrytëzimi më të mirë të potencialit industrial të politikave të novacionit, kërkimit dhe zhvillimit teknologjik.

2. Shtetet Anëtare konsultohen me njëra-tjetrën në bashkëpunim me Komisionin dhe, kur është e nevojshme, i bashkërendojnë veprimet e tyre. Komisioni mund të marrë nisma të dobishme për promovimin e një bashkërendimi të tillë, në veçanti nisma që kanë si qëllim krijimin e orientimeve dhe treguesve, organizimin e shkëmbimit të praktikës më të mirë, dhe përgatitjen e elementeve të nevojshme për vëzhgimin dhe vlerësimin periodik. Për këtë mbahet tërësisht i informuar Parlamenti Europian.

3. Bashkimi kontribuon në arritjen e objektivave të parashikuara në paragrafin 1 përmes politikave dhe aktiviteteve që ndjek në zbatim të dispozitave të tjera të Traktateve. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, mund të vendosin për masa të caktuara në mbështetje të veprimeve të Shteteve Anëtare për të arritur objektivat e parashikuara në paragrafin 1, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

Ky Titull nuk përbën bazë për marrjen nga Bashkimi të ndonjë mase e cila mund të çojë në shtrembërim të konkurrencës ose e cila përmban dispozita tatimore apo dispozita që lidhen me të drejtat dhe interesat e punëmarrësve.

TITULLI XVIII

KOHEZIONI EKONOMIK, SOCIAL DHE TERRITORIAL

Neni 174
(ish-neni 158 TKE)

Për të promovuar zhvillimin e përgjithshëm harmonik, Bashkimi përgatit dhe zbaton veprime të cilat çojnë në forcimin e kohezionit të tij ekonomik, social dhe territorial.

Në veçanti, Bashkimi ka si qëllim zvogëlimin e pabarazive midis niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme dhe prapambetjes së rajoneve më pak të favorizuara.

Mes rajoneve në fjalë, vëmendje e veçantë duhet t'u tregohet zonave rurale, zonave të prekura nga tranzicioni industrial dhe rajoneve që vuajnë nga mangësi të rënda dhe të përhershme natyrore ose demografike siç janë rajonet më veriore me dendësi shumë të ulët të popullsisë dhe rajonet ishullore, ndërkufitare dhe malore.

Neni 175
(ish-neni 159 TKE)

Shtetet Anëtare i realizojnë politikat e tyre ekonomike dhe i bashkërendojnë ato në mënyrë të atillë që, krahas tyre, të arrijnë edhe objektivat e parashikuara në nenin 174. Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe veprimeve të Bashkimit dhe zbatimi i tregut të brendshëm marrin në konsideratë objektivat e parashtruara në nenin 174 dhe kontribuojnë në arritjen e tyre. Bashkimi mbështet arritjen e këtyre objektivave edhe përmes veprimit që ndërmerr përmes Fondeve Strukturore (Fondi Europian i Garancisë dhe Orientimit Bujqësor, Seksioni i Orientimit; Fondi Social Europian; Fondi Europian për Zhvillim Rajonal), Banka Europiane e Investimeve dhe instrumentet e tjera financiare.

Komisioni i paraqet një raport çdo tre vjet Parlamentit Europian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve për progresin e bërë drejt arritjes së kohezionit ekonomik, social dhe territorial dhe për mënyrën se si kanë kontribuar në këtë mjetet e ndryshme të parashikuara në këtë nen. Ky raport, kur është e nevojshme, shoqërohet me propozimet e duhura.

Nëse lind nevoja për masa të caktuara jashtë Fondeve dhe pa cenuar masat e vendosura brenda kuadrit të politikave të tjera të Bashkimit, këto masa mund të miratohen nga Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsulton Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve.

Neni 176
(ish-neni 160 TKE)

Fondi Europian për Zhvillim Rajonal ka si qëllim të ndihmojë rregullimin e çekuilibreve kryesore rajonale në Bashkim përmes pjesëmarrjes në zhvillimin dhe përshtatjen e strukturuar të rajoneve, zhvillimi i të cilave ka mbetur pas dhe në shndërrimin e rajoneve industriale në rënie.

Neni 177
(ish-neni 161 TKE)

Pa cenuar nenin 178, Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe duke u konsultuar me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, caktojnë detyrat, objektivat parësore dhe organizimin e Fondeve Strukturore, çka mund të përfshijë edhe grupimin e Fondeve. Edhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme për to dhe dispozitat e nevojshme për të siguruar efektivitetin dhe bashkërendimin e Fondeve mes tyre dhe me Instrumentet e tjera ekzistuese financiare, përcaktohen sipas së njëjtën procedurë.

Fondi i Kohezionit i krijuar sipas së njëjtës procedurë jep kontribut financiar në projektet e fushat e mjedisit dhe rrjeteve trans-Europiane në fushën e transportit dhe të infrastrukturës.

Neni 178
(ish-neni 162 TKE)

Rregulloret zbatuese që lidhen me Fondin Europian për Zhvillim Rajonal miratohen nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pas konsultimit me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve.

Në lidhje me Fondin Europian të Garancisë dhe Orientimit Bujqësor dhe Fondin Social Europian, vijojnë të zbatohen, përkatësisht, nenet 43 dhe 164.

TITULLI XIX

KËRKIMI DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK DHE HAPËSIRA

Neni 179
(ish-neni 163 TKE)

1. Bashkimi ka objektivin të fuqizojë bazat e veta shkencore dhe teknologjike përmes arritjes së një zone europiane kërkimi në të cilën të qarkullojnë lirisht studiuesit, njohuritë shkencore dhe teknologjia, dhe nxitjes së kësaj zone që të bëhet më konkurruese, duke përfshirë edhe industrinë e tij, ndërkohë që nxit të gjitha aktivitetet kërkimore që cilat mendohen si të nevojshme në zbatim të Krerëve të Traktateve.

2. Për këtë qëllim Bashkimi i nxit ndërmarrjet në të gjithë Bashkimin, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, qendrat kërkimore dhe universitetet në veprimtaritë kërkimore dhe teknologjike të tyre të cilësisë së lartë; ai mbështet përpjekjet e tyre për të bashkëpunuar me njëra- tjetrën, duke synuar, sidomos, lejimin e studiuesve të bashkëpunojnë lirisht përtej kufijve dhe mundësimin e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e tregut të brendshëm, në veçanti përmes hapjes së kontratave kombëtare publike, përcaktimit të standardeve të përbashkëta dhe heqjes së pengesave juridike dhe fiskale ndaj këtij bashkëpunimi.

3. Të gjitha aktivitetet në zbatim të Traktateve në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik, duke përfshirë projektet e demonstrimit, vendosen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e këtij Titulli.

Neni 180
(ish-neni 164 TKE)

Gjatë ndjekjes së këtyre objektivave, Bashkimi realizon aktivitetet e mëposhtme, duke plotësuar aktivitetet e realizuara nga Shtetet Anëtare:

(a) zbatimi i programeve të kërkimit, demonstrimit dhe zhvillimit teknologjik, përmes promovimit të bashkëpunimit me dhe ndërmjet ndërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe universiteteve;

(b) promovimi i bashkëpunimit në fushën e kërkimit, demostrimit dhe zhvillimit teknologjik me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare;

(c) përhapja dhe përmirësimi i rezultateve të aktiviteteve të kërkimit, demostrimit dhe zhvillimit teknologjik të Bashkimit;

(d) nxitja e trajnimit dhe lëvizshmërisë së studiuesve në Bashkim.

Neni 181
(ish-neni 165 TKE)

1. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare i bashkërendojnë aktivitetet e tyre të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik në mënyrë që të sigurojnë që politikat kombëtare dhe politika e Bashkimit të pajtohen në mënyrë të ndërsjellë.

2. Në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare, Komisioni mund të marrë nisma të dobishme për promovimin e bashkërendimit të përmendur në paragrafin 1, në veçanti nisma që kanë si qëllim miratimin e udhëzimeve dhe treguesve, organizimin e shkëmbimit të praktikës më të mirë, dhe përgatitjen e elementeve të nevojshme për vëzhgimin dhe vlerësimin periodik. Për këtë mbahet tërësisht i informuar Parlamenti Europian.

Neni 182
(ish-neni 166 TKE)

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, miratojnë një program kuadër shumëvjeçar, që parashikon të gjitha aktivitetet e Bashkimit.

Programi kuadër:

– vendos objektivat shkencorë dhe teknologjikë që duhen arritur nga aktivitetet e parashikuara në nenin 180, si edhe përparësitë përkatëse,

– tregon drejtimet e përgjithshme të aktiviteteve të tilla,
– cakton shumën e përgjithshme maksimale dhe rregullat e hollësishme për pjesëmarrjen financiare të Bashkimit në programin kuadër dhe pjesët përkatëse në secilin prej aktiviteteve të parashikuara.

2. Programi kuadër përshtatet ose plotësohet sipas ndryshimeve të situatës.

3. Programi kuadër vihet në zbatim përmes programeve të caktuara të përgatitura brenda secilës veprimtari. Secili program i caktuar përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e tij, cakton kohëzgjatjen e tij dhe parashikon mjetet që konsiderohen të nevojshme. Shuma e vlerave që konsiderohen të nevojshme, të vendosura në programet e caktuara, nuk mund ta kalojë vlerën e përgjithshme maksimale të caktuar për programin kuadër dhe secilën veprimtari.

4. Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Komitetin Ekonomik dhe Social, miraton programe të caktuara.

5. Si plotësues për aktivitetet e planifikuara në programin kuadër shumëvjeçar, Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, vendosin masat e nevojshme për vënien në zbatim të zonës europiane të kërkimit.

Neni 183
(ish-neni 167 TKE)

Për zbatimin e programit kuadër shumëvjeçar, Bashkimi:

– përcakton rregullat për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe universiteteve,

– përcakton rregullat mbi përhapjen e rezultateve të kërkimit.

Neni 184
(ish-neni 168 TKE)

Gjatë zbatimit të programit kuadër shumëvjeçar, mund të vendosen programe shtesë për përfshirjen e pjesëmarrjes vetëm të disa Shteteve Anëtare, të cilat i financojnë këto programe në varësi të pjesëmarrjes së mundshme të Bashkimit.

Bashkimi miraton rregullat e zbatueshme për programet shtesë, në veçanti në lidhje me përhapjen e njohurive dhe të drejtën e aksesit nga Shtetet e tjera Anëtare.

Neni 185
(ish-neni 169 TKE)

Gjatë zbatimit të programit kuadër shumëvjeçar, Bashkimi mund të parashikojë, me miratimin e Shteteve Anëtare në fjalë, pjesëmarrjen në programet e kërkimit dhe zhvillimit të filluara nga disa Shtete Anëtare, duke përfshirë pjesëmarrjen në strukturat e krijuara për realizimin e këtyre programeve.

Neni 186
(ish-neni 170 TKE)

Gjatë zbatimit të programit kuadër shumëvjeçar, Bashkimi mund të parashikojë bashkëpunimin për kërkimin, demonstrimin dhe zhvillimin teknologjik brenda Bashkimit me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare.

Organizimi i hollësishëm i një bashkëpunimi të tillë mund të jetë objekt i marrëveshjeve midis Bashkimit dhe palëve të treta të interesuara.

Neni 187
(ish-neni 171 TKE)

Bashkimi mund të krijojë ndërmarrje të përbashkëta dhe struktura të tjera të nevojshme për realizimin efikas të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe demonstrimit brenda Bashkimit.

Neni 188
(ish-neni 172 TKE)

Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Komitetin Ekonomik dhe Social, miraton dispozitat e përmendura në nenin 187.

Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, miratojnë dispozitat e përmendura në nenet 183, 184 dhe 185. Miratimi i programeve shtesë kërkon pëlqimin e Shteteve Anëtare në fjalë.

Neni 189

1. Për të promovuar progresin shkencor dhe teknik, aftësinë konkurruese industriale dhe zbatimin e politikave të tij, Bashkimi harton një politikë europiane për hapësirën. Për këtë qëllim, ai mund të promovojë nisma të përbashkëta, të mbështesë kërkimin dhe zhvillimin teknologjik dhe të bashkërendojë punën e nevojshme për eksplorimin dhe shfrytëzimin e hapësirës.

2. Për të kontribuar në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin 1, Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat e nevojshme, të cilat mund të kenë formën e një programi europian për hapësirën, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

3. Bashkimi vendos marrëdhëniet e duhura me Agjencinë Europiane për Hapësirën.

4. Ky nen nuk i cenon dispozitat e tjera të këtij Titulli.

Neni 190
(ish-neni 173 TKE)

Në fillim të çdo viti, Komisioni i dërgon një raport Parlamentit Europian dhe Këshillit. Raporti përfshin informacione për aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik, përhapjen e rezultateve gjatë vitit të fundit si dhe programin e punës për vitin në vijim.

TITULLI XX

MJEDISI

Neni 191
(ish-neni 174 TKE)

1. Politika e Bashkimit për mjedisin kontribuon në arritjen e objektivave të mëposhtëm:

– ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit,

– mbrojtja e shëndetit të njeriut,

– shfrytëzimi i kujdesshëm dhe racional i burimeve natyrore,

– promovimi i masave në nivel ndërkombëtar për të trajtuar probleme mjedisore rajonale ose botërore, dhe në veçanti për të luftuar ndryshimin e klimës.

2. Politika e Bashkimit për mjedisin ka si qëllim një nivel të lartë mbrojtjeje, duke marrë në konsideratë larminë e situatave në rajonet e ndryshme të Bashkimit. Ajo mbështetet në parimin parandalues dhe në parimet se duhen marrë masa parandaluese, që dëmi ndaj mjedisit si përparësi duhet ndrequr në burim dhe që ndotësi duhet të paguajë.

Në këtë kuadër, masat e harmonizimit që u përgjigjen kërkesave për mbrojtjen e mjedisit përfshijnë, sipas rastit, një klauzolë për masat mbrojtëse që u lejon Shteteve Anëtare të marrin masa të përkohshme, për arsye mjedisore jo ekonomike, në varësi të një procedure kontrolli nga Bashkimi.

3. Gjatë përgatitjes së politikës së tij për mjedisin, Bashkimi merr në konsideratë:

– të dhënat shkencore dhe teknike të disponueshme,

– kushtet mjedisore në rajonet e ndryshme të Bashkimit,

– përfitimet dhe kostot e mundshme të veprimit ose mungesës së veprimit,

– zhvillimin ekonomik dhe social të Bashkimit në tërësi dhe zhvillimin e drejtpeshuar të rajoneve të tij.

4. Brenda sferave përkatëse të kompetencës, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me vendet e treta dhe me organizatat kompetente ndërkombëtare. Organizimi i bashkëpunimit të Bashkimit mund të jetë objekt i marrëveshjeve midis Bashkimit dhe të palëve të treta të interesuara.

Nënparagrafi i mësipërm nuk e cenon kompetencën e Shteteve Anëtare për të negociuar në mekanizma ndërkombëtare dhe për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 192
(ish-neni 175 TKE)

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, vendosin se çfarë veprimi duhet të ndërmarrë Bashkimi për të arritur objektivat e përmendur në nenin 191.

2. Duke u shmangur nga procedura vendimmarrëse e parashikuar në paragrafin 1 dhe pa cenuar nenin 114, Këshilli, me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian, Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, miraton:

(a) dispozita kryesisht të një natyre fiskale;

(b) masa që prekin:

– urbanistikën,

– administrimin sasior të burimeve ujore ose që prekin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pasjen e këtyre burimeve të gatshme për përdorim,

– përdorimin e territorit, me përjashtim të administrimit të mbetjeve;

(c) masa që prekin ndjeshëm zgjedhjen e Shtetit Anëtar midis burimeve të ndryshme të energjisë dhe strukturës së përgjithshme të furnizimit të tij me energji.

Këshilli, me unanimitet, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian, Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, mund të vendosë që procedura e zakonshme legjislative të jetë e zbatueshme për çështjet e përmendura në nënparagrafin e parë.

3. Programet e përgjithshme të veprimit ku vendosen objektivat parësore që duhen arritur miratohen nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve.

Masat e nevojshme për zbatimin e këtyre programeve miratohen sipas kushteve të paragrafit 1 ose 2, në varësi të rastit.

4. Shtetet Anëtare financojnë dhe zbatojnë politikën mjedisore pa cenuar disa masa të caktuara që miratohen nga Bashkimi.

5. Pa cenuar parimin se ndotësi duhet të paguajë, nëse një masë që mbështetet në dispozitat e paragrafit 1 sjell kosto të cilat konsiderohen si jo proporcionale për autoritetet publike të një Shteti Anëtar, një masë e tillë përcakton dispozitat e duhura në formën e:

– shmangieve të përkohshme dhe/ose

– mbështetjes financiare nga Fondi i Kohezionit i ngritur në zbatim të nenit 177.

Neni 193
(ish-neni 176 TKE)

Masat mbrojtëse të miratuara në zbatim të nenit 192 nuk i pengojnë Shtetet Anëtare që të mbajnë ose të marrin masa mbrojtëse më të shtrënguara. Masa të tilla duhet të jenë në pajtim me Traktatet. Komisioni njoftohet për këto masa.

TITULLI XXI

ENERGJETIKA

Neni 194

1. Në kuadër të krijimit dhe funksionimit të tregut të brendshëm dhe në vëmendje të nevojës për ta ruajtur dhe përmirësuar mjedisin, politika e Bashkimit për energjinë, me frymën e solidaritetit midis Shteteve Anëtare, ka si qëllim:

(a) sigurimin e funksionimit të tregut të energjisë;

(b) arritjen e sigurisë së furnizimit me energji brenda Bashkimit;

(c) promovimi i rendimentit të energjisë, kursimit të energjisë dhe të zhvillimit të formave të reja dhe të ripërtëritshme të energjisë; si dhe

(d) promovimin e ndërlidhjes së rrjeteve energjetike.

2. Pa cenuar zbatimin e dispozitave të tjera të Traktateve, Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat e nevojshme për arritjen e objektivave të parashikuara në paragrafin 1. Masa të tilla miratohen pas konsultimeve me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve.

Masa të tilla nuk e prekin të drejtën e një Shteti Anëtar për të përcaktuar kushtet për shfrytëzimin e burimeve energjetike, zgjedhjen e tij midis burimeve të ndryshme të energjisë dhe strukturës së përgjithshme të furnizimit të tij me energji, pa cenuar nenin 192(2)(c).

3. Duke u shmangur nga paragrafi 2, Këshilli me unanimitet vendos masat e përmendura në atë pikë, sipas një procedure të posaçme legjislative, dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian, kur këto masa janë kryesisht të një natyre fiskale.

TITULLI XXII

TURIZMI

Neni 195

1. Bashkimi e plotëson veprimin e Shteteve Anëtare në sektorin e turizmit, në veçanti përmes promovimit të aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të Bashkimit në këtë sektor.

Për këtë qëllim, veprimi i Bashkimit ka si qëllim:

(a) nxitjen e krijimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve në këtë sektor;

(b) promovimin e bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare, sidomos përmes shkëmbimit të praktikës së mirë.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masa të caktuara për të plotësuar veprimet brenda Shteteve Anëtare për të arritur objektivat e përmendura në këtë nen, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

TITULLI XXIII

MBROJTJA CIVILE

Neni 196

1. Bashkimi nxit bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti i sistemeve për parandalimin e fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu si dhe mbrojtjen prej tyre.

Veprimi i Bashkimit ka si qëllim:

(a) mbështetjen dhe plotësimin e veprimit të Shteteve Anëtare në nivel qendror, rajonal dhe vendor në fushën e parandalimit të rrezikut, në fushën e përgatitjes së forcave të tyre të mbrojtjes civile dhe në fushën e kundërpërgjigjes ndaj fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu brenda Bashkimit;

(b) promovimin e bashkëpunimit të shpejtë dhe të efektshëm operacional brenda Bashkimit midis shërbimeve kombëtare të mbrojtjes civile;

(c) promovimin e vijimësisë në punën ndërkombëtare për mbrojtjen civile.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat e nevojshme për të ndihmuar në arritjen e objektivave të përmendur në paragrafin 1, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

TITULLI XXIV

BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 197

1. Zbatimi i efektshëm i të drejtës së Bashkimit nga Shtetet Anëtare, i cili është thelbësor për funksionimin e duhur të Bashkimit, konsiderohet si çështje me interes të përbashkët.

2. Bashkimi mund të mbështesë përpjekjet e Shteteve Anëtare për përmirësimin e kapacitetit të tyre administrativ për të zbatuar të drejtën e Bashkimit. Një veprim i tillë mund të përfshijë mundësimin e shkëmbimit të informacionit dhe të nëpunësve civilë si edhe mbështetjen e skemave të trajnimit. Asnjë Shtet Anëtar nuk është i detyruar të përfitojë një mbështetje të tillë. Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat e nevojshme për këtë qëllim, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.

3. Ky nen nuk i cenon detyrimet e Shteteve Anëtare për të zbatuar të drejtën e Bashkimit apo të drejtat dhe detyrimet e Komisionit. Ai nuk i cenon dispozitat e tjera të Traktateve të cilat parashikojnë bashkëpunimin administritiv midis Shteteve Anëtare dhe midis tyre dhe Bashkimit.

PJESA E KATËRT

ASOCIIMI I VENDEVE DHE TERRITOREVE JASHTË EUROPËS

Neni 198
(ish-neni 182 TKE)

Shtetet Anëtare bien dakord të asociojnë me Bashkimin vende dhe territore jo-europiane të cilat kanë marrëdhënie të veçanta me Danimarkën, Francën, Hollandën dhe Mbretërinë e Bashkuar. Lista e këtyre vendeve dhe territoreve (quajtur më poshtë "vende dhe territore") jepet në Shtojcën II.

Qëllimi i asociimit është nxitja e zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve dhe territoreve dhe vendosja e marrëdhënieve të ngushta ekonomike midis tyre dhe Bashkimit në tërësi.

Në përputhje me parimet e parashikuara në Preambulën e këtij Traktati, asociimi i shërben kryesisht mbështetjes së interesave dhe mirëqenies së banorëve të këtyre vendeve dhe territoreve në mënyrë që t'i çojë ata drejt zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor për të cilin aspirojnë.

Neni 199
(ish-neni 183 TKE)

Asociimi ka këta objektiva:

1. Shtetet Anëtare zbatojnë në tregtinë e tyre me vendet dhe territoret të njëjtin trajtim që zbatojnë për njëri-tjetrin në zbatim të Traktateve.

2. Secili vend ose territor zbaton në tregtinë e tij me Shtetet Anëtare dhe me vendet dhe territoret e tjera të njëjtin trajtim që zbaton me Shtetin Europian me të cilin ka marrëdhënie të veçanta.

3. Shtetet Anëtare kontribuojnë në investimet e nevojshme për zhvillimin progresiv të këtyre vendeve dhe territoreve.

4. Për investimet e financuara nga Bashkimi, pjesëmarrja në tendera dhe furnizime është e hapur me kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që janë shtetas të një Shteti Anëtar ose të njërit prej vendeve dhe territoreve.

5. Në marrëdhëniet midis Shteteve Anëtare si dhe vendeve dhe territoreve, e drejta e vendosjes së shtetasve, shoqërive apo firmave rregullohet sipas dispozitave dhe procedurave të parashikuara në kapitullin që lidhet me të drejtën e vendosjes dhe mbi baza jo diskriminuese, në varësi të dispozitave të posaçme të nxjerra në zbatim të nenit 203.

Neni 200
(ish-neni 184 TKE)

1. Ndalohen taksat doganore mbi importet që hyjnë në Shtetet Anëtare të mallrave të cilat vijnë nga vendet dhe territoret, në përputhje me ndalimin e taksave doganore midis Shteteve Anëtare sipas dispozitave të Traktateve.

2. Ndalohen detyrime doganore mbi importet që hyjnë në secilin vend ose territor nga Shtetet Anëtare ose nga vendet ose territoret e tjera, në përputhje me dispozitat e nenit 30.

3. Megjithatë, vendet dhe territoret mund të vjelin detyrime doganore që përmbushin nevojat për zhvillimin dhe industrializimin e tyre ose sjellin të ardhura fiskale për buxhetet e tyre.

Taksat e përmendura në nënparagrafin e mësipërm nuk mund ta kalojnë nivelin e atyre që vendosen mbi importet e produkteve nga Shteti Anëtar me të cilin vendi ose territori ka marrëdhënie të veçanta.

4. Paragrafi 2 nuk zbatohet për vendet dhe territoret të cilat, për arsye të detyrimeve të veçanta ndërkombëtare që duhet të përmbushin, zbatojnë një tarifë doganore jo diskriminuese.

5. Futja ose ndryshimi i detyrimeve doganore të vendosura mbi mallrat e importuara në vendet dhe territoret nuk duhet të çojë, de jure ose de facto, në një diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë midis importeve prej Shteteve Anëtare të ndryshme.

Neni 201
(ish-neni 185 TKE)

Nëse niveli i taksave të zbatueshme për mallrat e një vendi të tretë kur hyn në një vend ose territor ka të ngjarë, pas zbatimit të dispozitave të nenit 200(1), të shkaktojë devijim të tregtisë në dëm të një Shteti Anëtar, ky i fundit mund t'i kërkojë Komisionit t'u propozojë Shteteve të tjera Anëtare masat e nevojshme për ta ndrequr situatën.

Neni 202
(ish-neni 186 TKE)

Në varësi të dispozitave që lidhen me shëndetin publik, sigurinë publike ose politikën publike, liria e lëvizjes brenda Shteteve Anëtare për punonjësit nga vendet dhe territoret, dhe brenda vendeve dhe territoreve për punonjësit nga Shtetet Anëtare, rregullohet përmes akteve të miratuara në përputhje me nenin 203.

Neni 203
(ish-neni 187 TKE)

Këshilli, me unanimitet, me propozim të Komisionit, në bazë të përvojës të fituar nga asociimi i vendeve dhe territoreve me Bashkimin dhe në bazë të parimeve të parashikuara në Traktatet, përcakton dispozita lidhur me rregullat e hollësishme dhe procedurën për asociimin e vendeve dhe territoreve me Bashkimin. Kur dispozitat në fjalë miratohen nga Këshilli sipas një procedure të posaçme legjislative, ai vendos me unanimitet me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Neni 204
(ish-neni 188 TKE)

Dispozitat e neneve nga 198 deri në 203 zbatohen për Groenlandën, në varësi të dispozitave të caktuara për Groenlandën të parashikuara në Protokollin për rregullat e posaçme për Groenlandën, që i bashkëngjitet Traktateve.

PJESA E PESTË

VEPRIMI I JASHTËM I BASHKIMIT

TITULLI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR VEPRIMIN E JASHTËM TË BASHKIMIT

Neni 205

Veprimi i Bashkimit në skenën ndërkombëtare, sipas kësaj Pjese, orientohet nga parimet, ndjek objektivat dhe realizohet në përputhje me dispozitat e përgjithshme të përcaktuara në Kreun 1 të Titullit V të Traktatit për Bashkimin Europian.

TITULLI II

POLITIKA E PËRBASHKËT TREGTARE

Neni 206
(ish-neni 131 TKE)

Përmes krijimit të një bashkimi doganor në përputhje me nenet nga 28 deri në 32, në funksion të interesit të përbashkët, Bashkimi kontribuon për zhvillimin harmonik të tregtisë botërore, ndalimin progresiv të kufizimeve mbi tregtinë ndërkombëtare dhe mbi investimet e huaja të drejtpërdrejta, si dhe uljen e detyrimeve doganore dhe pengesave të tjera.

Neni 207
(ish-neni 133 TKE)

1. Politika e përbashkët tregtare bazohet në parime të njëtrajtshme, sidomos sa u takon ndryshimeve të normave tarifore, lidhjes së marrëveshjeve për tarifat dhe tregtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe aspekteve tregtare të pronësisë intelektuale, investimeve të huaja të drejtpërdrejta, arritjes së njëtrajtshmërisë në masat e liberalizimit, politikës së eksporteve dhe masave për të mbrojtur tregtinë siç janë ato që duhen marrë në rast të dampingut ose subvencioneve. Politika e përbashkët tregtare zhvillohet në kuadër të parimeve dhe objektivave të veprimit të jashtëm të Bashkimit.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masat ku përcaktohet kuadri për vënien në zbatim të politikës së përbashkët tregtare.

3. Kur duhen negociuar apo lidhur marrëveshje me një ose më shumë vende të treta ose organizata ndërkombëtare, zbatohet neni 218, në varësi të dispozitave të posaçme të këtij neni.

Komisioni i jep rekomandime Këshillit, i cili e autorizon të hapë negociatat e nevojshme. Këshilli dhe Komisioni janë përgjegjës për të siguruar që marrëveshjet e negociuara të pajtohen me politikat dhe rregullat e brendshme të Bashkimit.

Komisioni i zhvillon këto negociata duke u konsultuar me një komitet të posaçëm të emëruar nga Këshilli për ta mbështetur Komisionin për këtë detyrë dhe brenda kuadrit të direktivave të tilla që mund t'i japë Këshilli. Komisioni i raporton rregullisht komitetit të posaçëm dhe Parlamentit Europian për ecurinë e negociatave.

4. Për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve të përmendura në paragrafin 3, Këshilli vendos me shumicë të cilësuar.

Për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve në fushat e tregtisë së shërbimeve dhe aspekteve tregtare të pronësisë intelektuale, si dhe të investimeve të huaja direkte, Këshilli vendos me unanimitet, kur këto marrëveshje përfshijnë dispozita për të cilat nevojitet unanimiteti për miratimin e rregullave të brendshme.

Këshilli vendos me unanimitet edhe për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve:

(a) në fushën e tregtisë së shërbimeve kulturore dhe audiovizive, kur këto marrëveshje rrezikojnë të cenojnë larminë kulturore dhe gjuhësor të Bashkimit;

(b) në fushën e tregtisë së shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësore, kur këto marrëveshje rrezikojnë të shqetësojnë seriozisht organizimin kombëtar të shërbimeve të tilla dhe të cenojnë përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për t'i realizuar ato.

5. Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e transportit i nënshtrohen Titullit VI të Pjesës së Tretë dhe nenit 218.

6. Ushtrimi i kompetencave të përmendura në këtë nen në fushën e politikës së përbashkët tregtare nuk e prek ndarjen e kompetencave midis Bashkimit dhe Shteteve Anëtare dhe nuk çon në harmonizim të dispozitave legjislative ose rregullatore të Shteteve Anëtare për aq sa Traktatet e përjashtojnë një harmonizim të tillë.

TITULLI III

BASHKËPUNIMI ME VENDET E TRETA DHE NDIHMA HUMANITARE

KREU 1

BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM

Neni 208
(ish-neni 177 TKE)

1. Politika e Bashkimit në fushën e bashkëpunimit për zhvillim zhvillohet në kuadër të parimeve dhe objektivave të veprimit të jashtëm të Bashkimit. Politika e Bashkimit për bashkëpunimin për zhvillim dhe ajo e Shteteve Anëtare plotësojnë dhe përforcojnë njëra tjetrën.

Politika e Bashkimit për bashkëpunimin për zhvillim ka si objektiv parësor uljen dhe, në periudhën afatgjatë, zhdukjen e varfërisë. Bashkimi merr në konsideratë objektivat e bashkëpunimit për zhvillim në politikat që zbaton të cilat ka të ngjarë të prekin vendet në zhvillim.

2. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare përmbushin angazhimet dhe marrin në konsideratë objektivat që kanë miratuar në kuadër të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare kompetente.

Neni 209
(ish-neni 179 TKE)

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masat e nevojshme për zbatimin e bashkëpunimit për zhvillim, të cilat mund të lidhen me programet shumëvjeçare të bashkëpunimit me vendet në zhvillim ose me programe me qasje tematike.

2. Bashkimi mund të lidhë me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare kompetente marrëveshje që ndihmojnë në arritjen e objektivave të përmendura në nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe në nenin 208 të këtij Traktati.

Nënparagrafi i parë nuk e cenon kompetencën e Shteteve Anëtare për të negociuar në organet ndërkombëtare dhe për të lidhur marrëveshje.

3. Sipas kushteve të përcaktuara në Statutin e saj, Banka Europiane e Investimeve kontribuon në zbatimin e masave të përmendura në paragrafin 1.

Neni 210
(ish-neni 180 TKE)

1. Për të promovuar plotësueshmërinë dhe efikasitetin e veprimit të tyre, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare i bashkërendojnë politikat e tyre për bashkëpunimin për zhvillim dhe konsultohen

me njëri-tjetrin për programet e tyre të ndihmës, edhe brenda organizatave ndërkombëtare dhe gjatë konferencave ndërkombëtare. Ata mund të ndërmarrin veprim të përbashkët. Shtetet Anëtare kontribuojnë nëse është e nevojshme në zbatimin e programeve të ndihmës të Bashkimit.

2. Komisioni mund të marrë nisma të dobishme për të promovuar bashkërendimin e përmendur në paragrafin 1.

Neni 211
(ish-neni 181 TKE)

Brenda sferave përkatëse të kompetencës, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me vendet e treta dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente.

KREU 2

BASHKËPUNIMI EKONOMIK, FINANCIAR DHE TEKNIK ME VENDET E TRETA

Neni 212
(ish-neni 181*a* TKE)

1. Pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve dhe në veçanti nenet nga 208 deri në 211, Bashkimi realizon masa të bashkëpunimit ekonomik, financiar dhe teknik, duke përfshirë mbështetje, në veçanti mbështetje financiare, me vendet e treta që nuk janë vende në zhvillim. Masa të tilla janë në pajtim me politikën e Bashkimit për zhvillim dhe zhvillohen në kuadër të parimeve dhe objektivave të veprimit të jashtëm të Bashkimit. Veprimet e Bashkimit dhe ato të Shteteve Anëtare plotësojnë dhe përforcojnë njëra-tjetrën.

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masat e nevojshme për zbatimin e paragrafit 1.

3. Brenda sferave përkatëse të kompetencës, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me vendet e treta dhe me organizatat kompetente ndërkombëtare. Organizimi i bashkëpunimit të Bashkimit mund të jetë objekt i marrëveshjeve midis Bashkimit dhe palëve të treta të interesuara.

Nënparagrafi i parë nuk e cenon kompetencën e Shteteve Anëtare për të negociuar në organet ndërkombëtare dhe për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 213

Kur situata e një vendi të tretë kërkon ndihmë financiare urgjente nga Bashkimi, Këshilli miraton vendimet e nevojshme, me propozim të Komisionit.

KREU 3

NDIHMA HUMANITARE

Neni 214

1. Operacionet e Bashkimit në fushën e ndihmës humanitare zhvillohen në kuadër të parimeve dhe objektivave të veprimit të jashtëm të Bashkimit. Operacione të tilla kanë si qëllim dhënien e ndihmës ad hoc dhe mbështetjes, si dhe mbrojtjen e popullsive të vendeve të treta që janë viktimë e fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, në mënyrë që të plotësohen nevojat humanitare që lindin në situata të tilla. Masat e Bashkimit dhe ato të Shteteve Anëtare plotësojnë dhe përforcojnë njëra tjetrën.

2. Operacionet e ndihmës humanitare zhvillohen në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe me parimet e paanshmërisë, asnjanësisë dhe mosdiskriminimit.

3. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat ku caktohet kuadri brenda të cilit zbatohen operacionet e Bashkimit për ndihmën humanitare.

4. Bashkimi mund të lidhë me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare kompetente marrëveshje që ndihmojnë në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin 1 të nenit 21 të Traktatit për Bashkimin Europian.

Nënparagrafi i parë nuk e cenon kompetencën e Shteteve Anëtare për të negociuar në organet ndërkombëtare dhe për të lidhur marrëveshje.

5. Për të krijuar një kuadër për kontributet e përbashkëta të rinisë europiane në operacionet e ndihmës humanitare të Bashkimit, krijohet një Korpus Vullnetar Europian i Ndihmës Humanitare. Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes rregulloreve të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin rregullat dhe procedurat e funksionimit të Korpusit.

6. Komisioni mund të marrë nisma të dobishme për promovimin e bashkërendimit midis veprimeve të Bashkimit dhe atyre të Shteteve Anëtare, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe plotësueshmëria e masave të Bashkimit dhe atyre kombëtare për ndihmën humanitare.

7. Bashkimi kujdeset që operacionet e tij të ndihmës humanitare të bashkërendohen dhe përputhen me ato të organizatave dhe organeve ndërkombëtare, në veçanti të atyre që bëjnë pjesë në sistemin e Kombeve të Bashkuara.

TITULLI IV

MASAT KUFIZUESE

Neni 215
(ish-neni 301 TKE)

1. Kur një vendim i miratuar në përputhje me Kreun 2 të Titulli V të Traktatit për Bashkimin Europian parashikon ndërprerjen ose pakësimin pjesërisht ose plotësisht të marrëdhënieve

ekonomike dhe financiare me një ose më shumë vende të treta, Këshilli, me shumicë të cilësuar me propozim të përbashkët të Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe të Komisionit, miraton masat e nevojshme. Ai e informon Parlamentin Europian për to.

2. Kur e parashikon një vendim i miratuar në përputhje me Kreun 2 të Titullit V të Traktatit për Bashkimin Europian, Këshilli mund të miratojë masa kufizuese sipas procedurës të përmendur në paragrafin 1, kundër personave fizikë ose juridikë dhe grupimeve ose subjekteve joshtetërore.

3. Aktet e përmendura në këtë nen përfshijnë dispozitat e nevojshme për masat mbrojtëse ligjore.

TITULLI V

MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Neni 216

1. Bashkimi mund të lidhë një marrëveshje me një ose më shumë vende të treta apo organizata ndërkombëtare kur këtë e parashikojnë Traktatet ose kur lidhja e një marrëveshjeje është e nevojshme për të arritur, brenda kuadrit të politikave të Bashkimit, një prej objektivave të përmendur në Traktatet, ose parashikohet në një akt me fuqi detyruese ligjore të Bashkimit apo ka të ngjarë të prekë rregullat e përbashkëta ose ta ndryshojë fushën e veprimit të tyre.

2. Marrëveshjet e lidhura nga Bashkimi kanë fuqi ligjore detyruese për institucionet e Bashkimit dhe Shtetet Anëtare.

Neni 217
(ish-neni 310 TKE)

Bashkimi mund të lidhë me një ose më shumë vende të treta ose organizata ndërkombëtare marrëveshje që vendosin një asociim i cili përfshin të drejta dhe detyrime të ndërsjella, veprim të përbashkët dhe procedurë të posaçme.

Neni 218
(ish-neni 300 TKE)

1. Pa cenuar dispozitat e caktuara të përcaktuara në nenin 207, marrëveshjet midis Bashkimit dhe vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare negociohen dhe lidhen në përputhje me procedurën e mëposhtme.

2. Këshilli autorizon hapjen e negociatave, miraton direktivat për negociatat, autorizon nënshkrimin e marrëveshjeve dhe i lidh ato.

3. Komisioni, ose Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë kur marrëveshja e parashikuar ka të bëjë vetëm ose kryesisht me politikën e përbashkët të jashtme

dhe të sigurisë, i paraqet rekomandime Këshillit, i cili miraton një vendim përmes të cilit lejon hapjen e negociatave dhe, në varësi të objektit të marrëveshjes së parashikuar, emëron negociuesin e Bashkimit ose kreun e ekipit negociues të Bashkimit.

4. Këshilli mund t'i drejtohet me direktiva negociuesit dhe të caktojë një komitet të posaçëm në konsultim me të cilin duhen zhvilluar negociatat.

5. Këshilli, me propozim të negociuesit, miraton një vendim ku autorizohet nënshkrimi i marrëveshjes dhe, nëse është e nevojshme, zbatimi i përkohshëm i saj përpara hyrjes në fuqi.

6. Këshilli, me propozim të negociuesit, miraton një vendim përmes të cilit lidh marrëveshjen.

Me përjashtim të rasteve kur marrëveshjet kanë të bëjnë vetëm me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, Këshilli e miraton vendimin përmes të cilit lidh marrëveshjen:

(a) pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian në rastet e mëposhtme:

(i) marrëveshjet e asociimit;

(ii) marrëveshjen për anëtarësimin e Bashkimit në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;

(iii) marrëveshjet me të cilat krijohet një kuadër ndërkombëtar i caktuar përmes organizimit të procedurave të bashkëpunimit;

(iv) marrëveshjet me rrjedhoja buxhetore të rëndësishme për Bashkimin;

(v) marrëveshjet që mbulojnë fusha për të cilat zbatohet ose procedura e zakonshme legjislative ose procedura e posaçme legjislative kur nevojitet pëlqimi i Parlamentit Europian.

Parlamenti Europian dhe Këshilli, në një situatë urgjente, bien dakord për një afat për pëlqimin.

(b) pasi konsultohet me Parlamentin Europian në rastet e tjera. Parlamenti Europian e jep opinionin e tij brenda afatit që mund të vendosë Këshilli në varësi të urgjencës së çështjes. Në mungesë të një opinioni brenda afatit të përcaktuar, Këshilli mund të veprojë vetë.

7. Kur lidh një marrëveshje, Këshilli, me shmangie nga paragrafët 5, 6 dhe 9, mund ta lejojë negociuesin të miratojë në emër të Bashkimit ndryshime në marrëveshje kur parashikon që ato të miratohen me procedurë të thjeshtuar ose nga një organ i krijuar nga marrëveshja. Këshilli mund ta shoqërojë këtë autorizim me kushte të caktuara.

8. Këshilli vendos me shumicë të cilësuar gjatë gjithë procedurës.

Megjithatë, ai vendos me unanimitet kur marrëveshja mbulon fushat për të cilat kërkohet unanimiteti për miratimin e një veprimi të Bashkimit si edhe për marrëveshjet e asociimit dhe marrëveshjet e përmendura në nenin 212 me Shtetet që janë kandidate për anëtarësim. Këshilli vendos me unanimitet edhe për marrëveshjen e anëtarësimit të Bashkimit në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Vendimi që lidh marrëveshjen hyn në fuqi pasi miratohet nga Shtetet Anëtare, sipas kërkesave kushtetuese përkatëse të tyre.

9. Këshilli, me propozim të Komisionit ose të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit, miraton një vendim përmes të cilit pezullon zbatimin e një marrëveshjeje dhe vendos qëndrimet që duhen mbajtur në emër të Bashkimit në një organ të ngritur nga një marrëveshje, kur këtij organi i kërkohet të miratojë akte që kanë pasoja ligjore, me përjashtim të akteve që plotësojnë ose ndryshojnë kuadrin institucional të marrëveshjes.

10. Parlamenti Europian informohet menjëherë dhe plotësisht në të gjitha fazat e procedurës.

11. Një Shtet Anëtar, Parlamenti Europian, Këshilli ose Komisioni mund të marrin opinionin e Gjykatës së Drejtësisë nëse një marrëveshje e parashikuar është në pajtim ose jo me Traktatet. Kur opinioni i Gjykatës është negativ, marrëveshja e parashikuar nuk mund të hyjë në fuqi nëse ajo nuk ndryshohet, ose nëse nuk rishikohen Traktatet.

Neni 219
(ish-neni 111(1) deri në (3) dhe (5) TKE)

1. Duke u shmangur nga neni 218, Këshilli, me rekomandim nga Banka Qendrore Europiane ose me rekomandim nga Komisioni dhe pasi konsultohet me Bankën Qendrore Europiane, në përpjekje për të arritur një konsensus që pajtohet me objektivin e stabilitetit të çmimeve, mund të lidhë marrëveshje zyrtare për një sistem të kurseve të këmbimit për euron kundrejt monedhave të Shteteve të treta. Këshilli vendos me unanimitet, pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe sipas procedurës së parashikuar në paragrafin 3.

Këshilli, me rekomandim nga Banka Qendrore Europiane ose me rekomandim nga Komisioni dhe pasi konsultohet me Bankën Qendrore Europiane, në përpjekje për të arritur një konsensus që pajtohet me objektivin e stabilitetin të çmimeve, mund të miratojë, ndryshojë ose heqë kurse këmbimi të euros brenda sistemit të kurseve të këmbimit. Presidenti i Këshillit e informon Parlamentin Europian për miratimin, ndryshimin ose heqjen e kurseve qendrore të këmbimit të euros.

2. Në mungesë të një sistemi të kurseve të këmbimit kundrejt një ose më shumë monedhave të Shteteve të treta, që përmendet në paragrafin 1, Këshilli, me rekomandim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Bankën Qendrore Europiane ose me rekomandim të Bankës Qendrore Europiane, mund të hartojë udhëzime të përgjithshme për politikën e kurseve të këmbimit kundrejt këtyre monedhave. Këto udhëzime të përgjithshme nuk e cenojnë objektivin parësor të SEBQ-së për ruajtjen e stabilitetin të çmimeve.

3. Duke u shmangur nga neni 218, kur Bashkimi duhet të negociojë me një ose më shumë Shtete të treta ose organizata ndërkombëtare marrëveshje lidhur me çështje të regjimit monetar ose këmbimit valutor, Këshilli, me rekomandim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Bankën Qendrore Europiane, vendos masat organizative për negocimin dhe për lidhjen e marrëveshjeve të tilla. Këto masa organizative sigurojnë që Bashkimi të shprehë një qëndrim të vetëm. Komisioni duhet të jetë i angazhuar plotësisht me negociatat.

4. Pa cenuar kompetencën e Bashkimit dhe marrëveshjet e Bashkimit në lidhje me bashkimin ekonomik dhe monetar, Shtetet Anëtare mund të negociojnë në organet ndërkombëtare dhe të lidhin marrëveshje ndërkombëtare.

TITULLI VI

MARRËDHËNIET E BASHKIMIT ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE VENDET E TRETA DHE DELEGACIONET E BASHKIMIT

Neni 220
(ish-nenet nga 302 deri në 304 TKE)

1. Bashkimi vendos të gjitha format e duhura të bashkëpunimit me organet e Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë e specializuara të tyre, Këshillin e Europës, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë dhe Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Bashkimi mban marrëdhënie të tilla, sipas rastit, edhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

2. Këtë nen e zbaton Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë si dhe Komisioni.

Neni 221

1. Bashkimin e përfaqësojnë delegacionet e Bashkimit në vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare.
2. Delegacionet e Bashkimit vendosen në vartësi të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë. Ato veprojnë në bashkëpunim të ngushtë me misionet diplomatike dhe konsullore të Shteteve Anëtare.

TITULLI VII

KLAUZOLA E SOLIDARITETIT

Neni 222

1. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare veprojnë bashkërisht, me frymë solidariteti, nëse një Shtet Anëtar bëhet objekt i një sulmi terrorist ose viktimë e një fatkeqësie të shkaktuar nga natyra ose njeriu. Bashkimi mobilizon të gjitha instrumentet që ka në dispozicion, duke përfshirë burimet ushtarake që ia vendosin në dispozicion Shtetet Anëtare:

(a) – për të parandaluar rrezikun terrorist në territorin e Shteteve Anëtare;

– për të mbrojtur institucionet demokratike dhe popullsinë civile nga sulmet terroriste;

– për ta mbështetur një Shtet Anëtar në territorin e tij, me kërkesën e autoriteteve të tij politike, në rast të një sulmi terrorist;

(b) për ta mbështetur një Shtet Anëtar në territorin e tij, me kërkesën e autoriteteve të tij politike, në rast të një fatkeqësie të shkaktuar nga natyra ose nga njeriu.

2. Nëse një Shtet Anëtar bëhet objekt i një sulmi terrorist ose viktimë e një fatkeqësie të shkaktuar nga natyra ose nga njeriu, Shtetet e tjera Anëtare e mbështetin atë me kërkesën e autoriteteve të tij politike. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare bashkërendohen mes tyre brenda Këshillit.

3. Organizimi i zbatimit nga Bashkimi i klauzolës së solidaritetit përcaktohet me një vendim të miratuar nga Këshilli, me propozimin e përbashkët të Komisionit dhe Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë. Këshilli vepron në përputhje me nenin 31(1) të Traktatit për Bashkimin Europian kur ky vendim ka rrjedhoja për mbrojtjen. Për këtë informohet Parlamenti Europian.

Për qëllimet e këtij paragrafi dhe pa cenuar nenin 240, Këshilli mbështetet nga Komiteti Politik dhe i Sigurisë me mbështetjen e strukturave të zhvilluara në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes dhe nga Komiteti i përmendur në nenin 71. Nëse është e nevojshme, të dy komitetet paraqesin opinione të përbashkëta.

4. Këshilli Europian i analizon rregullisht rreziqet që i kanosen Bashkimit, në mënyrë që t'u japë mundësi Bashkimit dhe Shteteve Anëtare të tij të marrin masa efektive.

PJESA E GJASHTË

DISPOZITA INSTITUCIONALE DHE FINANCIARE

TITULLI I

DISPOZITA INSTITUCIONALE

KREU 1

INSTITUCIONET

SEKSIONI 1

PARLAMENTI EUROPIAN

Neni 223
(ish-neni 190(4) dhe (5) TKE)

1. Parlamenti Europian harton një propozim për të përcaktuar dispozitat e nevojshme për zgjedhjen e deputetëve të tij përmes votës së drejtpërdrejtë e të përgjithshme, në përputhje me një procedurë të njëjtë në të gjitha Shtetet Anëtare ose në përputhje me parimet që janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare.

Këshilli, duke vepruar me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, i cili vepron me shumicën e deputetëve që e përbëjnë, përcakton dispozitat e nevojshme. Këto dispozita hyjnë në fuqi pasi aprovohen nga të gjitha Shtetet Anëtare, sipas kërkesave kushtetuese përkatëse të tyre.

2. Parlamenti Europian, përmes rregulloreve të miratuara me nismën e tij sipas një procedure të posaçme legjislative, pasi i kërkon opinion Komisionit dhe me pëlqimin e Këshillit, miraton rregulloret dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë kryerjen e detyrave nga deputetët e tij. Të gjitha rregullat ose kushtet në lidhje me tatimin e deputetëve ose të ish-deputetëve kërkojnë unanimitetin e Këshillit.

Neni 224
(ish-neni 191, nënparagrafi i dytë, TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, përmes rregulloreve, përcaktojnë rregullimin e partive politike në nivel europian të përmendura në nenin 10(4) të Traktatit për Bashkimin Europian, dhe në veçanti rregullat lidhur me financimin e tyre.

Neni 225
(ish-neni 192, nënparagrafi i dytë, TKE)

Parlamenti Europian, me shumicën e deputetëve që e përbëjnë, mund t'i kërkojë Komisionit të paraqesë propozimet e duhura për çështje për të cilat është i mendimit se veprimi i Bashkimit është i nevojshëm për zbatimin e Traktateve. Nëse Komisioni nuk paraqet asnjë propozim, ai e informon Parlamentin Europian për arsyet.

Neni 226
(ish-neni 193 TKE)

Gjatë realizimit të detyrave të tij, Parlamenti Europian, me kërkesën e një të katërtës së deputetëve që e përbëjnë, mund të ngrejë një Komision Hetimor të përkohshëm për të hetuar, pa cenuar kompetencat që Traktatet ua japin institucioneve ose organeve të tjera, shkeljet ose keqadministrimin e dyshuar gjatë zbatimit të së drejtës së Bashkimit, me përjashtim të rastit kur faktet e dyshuara janë duke u shqyrtuar përpara një gjykate dhe gjatë kohës kur çështja është ende objekt i procesit ligjor.

Komisioni Hetimor i përkohshëm pushon së ekzistuari me dorëzimin e raportit të tij.

Dispozitat e hollësishme që rregullojnë ushtrimin e të drejtës së hetimit i vendos Parlamenti Europian përmes rregulloreve të miratuara me nismën e tij, sipas një procedure të posaçme legjislative, pasi merr pëlqimin e Këshillit dhe të Komisionit.

Neni 227
(ish-neni 194 TKE)

Çdo qytetar i Bashkimit dhe çdo person fizik ose juridik që banon ose ka selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar ka të drejtën t'i drejtohet, më vete ose së bashku me shtetas ose persona të tjerë,

Parlamentit Europian me një peticion për një çështje e cila bie në fushën e aktiviteteve të Bashkimit dhe e cila e prek atë drejtpërsëdrejti.

Neni 228
(ish-neni 195 TKE)

1. Avokati Europian i Popullit, i zgjedhur nga Parlamenti Europian, ka të drejtë të marrë ankesa nga çdo shtetas i Bashkimit ose çdo person fizik ose juridik që banon ose ka selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar në lidhje me rastet e keqadministrimit gjatë veprimtarive të institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit, me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, kur kjo e fundit kryen detyrat e saj gjyqësore. Ai i shqyrton këto ankesa dhe raporton për to.

Në përputhje me detyrat e tij, Avokati i Popullit kryen hetime për të cilat i gjen arsyet me iniciativën e tij ose në bazë të ankesave që i janë paraqitur përpara tij drejtpërsëdrejti ose përmes një deputeti të Parlamentit Europian, me përjashtim të rastit kur faktet e dyshuara janë ose kanë qenë objekt i proceseve ligjore. Kur Avokati i Popullit konstaton një rast keqadministrimi, ai ia përcjell çështjen institucionit, organit, zyrës ose agjencisë në fjalë, e cila ka tre muaj në dispozicion për ta informuar lidhur me qëndrimet e tyre. Avokati i Popullit pastaj i përcjell një raport Parlamentit Europian dhe institucionit, organit, zyrës ose agjencisë në fjalë. Personi që ka paraqitur ankesën informohet për rezultatin e hetimeve të tilla.

Avokati i Popullit i paraqet një raport vjetor Parlamentit Europian për rezultatin e hetimeve të veta.

2. Për ushtrimin e funksionit të tij, Avokati i Popullit zgjidhet pas çdo zgjedhjeje të Parlamentit Europian. Avokati i Popullit ka të drejtë riemërimi.

Avokati i Popullit mund të lirohet nga detyra nga Gjykata e Drejtësisë me kërkesë të Parlamentit Europian, nëse nuk i përmbush më kushtet e nevojshme për kryerjen e detyrave ose nëse është fajtor për shkelje të rënda.

3. Avokati i Popullit është tërësisht i pavarur në kryerjen e detyrave të tij. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave ai nuk kërkon dhe nuk merr asnjë udhëzim nga asnjë qeveri, institucion, organ, zyrë apo subjekt. Gjatë mandatit të tij, Avokati i Popullit nuk mund të angazhohet në asnjë punë tjetër, me ose pa fitim.

4. Parlamenti Europian, përmes rregulloreve të miratuara me nismën e tij sipas një procedure të posaçme legjislative, pasi i kërkon opinion Komisionit dhe me pëlqimin e Këshillit, miraton rregulloret dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë kryerjen e detyrave të Avokatit të Popullit.

Neni 229
(ish-neni 196 TKE)

Parlamenti Europian zhvillon një seancë vjetore. Ai mblidhet, pa pasur nevojë të thirret, të martën e dytë të muajit mars.

Parlamenti Europian mund të mblidhet në seancë të pjesshme të jashtëzakonshme me kërkesën e një shumice të deputetëve që e përbëjnë ose me kërkesën e Këshillit ose të Komisionit.

Neni 230
(ish-neni 197, paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt, TKE)

Komisioni mund t'i ndjekë të gjitha mbledhjet dhe, me kërkesën e vet, mund të flasë në to.

Komisioni mund t'u përgjigjet me gojë ose me shkrim pyetjeve që ia drejton Parlamenti Europian ose deputetët e tij.

Këshilli Europian dhe Këshilli kanë të drejtën e fjalës përpara Parlamentit Europian në përputhje me kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Këshillit Europian dhe Rregulloren e Brendshme të Këshillit.

Neni 231
(ish-neni 198 TKE)

Nëse nuk parashikohet ndryshe në Traktatet, Parlamenti Europian vendos me shumicën e votave të hedhura.

Kuorumin e përcakton Rregullorja e Brendshme.

Neni 232
(ish-neni 199 TKE)

Parlamenti Europian miraton me shumicën e deputetëve Rregulloren e Brendshme të tij.

Punimet e Parlamentit Europian botohen sipas mënyrës të përcaktuar në Traktatet dhe në Rregulloren e Brendshme.

Neni 233
(ish-neni 200 TKE)

Parlamenti Europian diskuton në seancë të hapur raportin e përgjithshëm vjetor të paraqitur nga Komisioni.

Neni 234
(ish-neni 201 TKE)

Nëse i propozohet një mocion mosbesimi për aktivitetet e Komisionit, Parlamenti Europian nuk voton për këtë kërkesë të paktën deri tre ditë pas propozimit të kërkesës dhe votimi bëhet me votë të hapur.

Nëse mocioni i mosbesimit mbështetet me shumicë prej dy të tretave të votave të hedhura, të cilat përfaqësojnë shumicën e deputetëve që përbëjnë Parlamentin Europian, anëtarët e Komisionit japin dorëheqjen si organ dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë tërhiqet nga detyrat që kryen pranë Komisionit. Ata qëndrojnë në detyrë dhe vijojnë të merren me punën e tyre gjersa të zëvendësohen në përputhje me nenin 17 të Traktatit për Bashkimin Europian. Në këtë rast, mandati në detyrë i anëtarëve të Komisionit të emëruar për t'i zëvendësuar ata mbaron në datën në të cilën do të kishte mbaruar mandati në detyrë i anëtarëve të Komisionit të detyruar për të dhënë dorëheqjen si organ.

SEKSIONI 2

KËSHILLI EUROPIAN

Neni 235

1. Kur bëhet një votim, çdo anëtar i Këshillit Europian mund të veprojë edhe në emër të jo më shumë se një anëtari tjetër.

Neni 16(4) i Traktatit për Bashkimin Europian dhe neni 238(2) i këtij Traktati zbatohen kur Këshilli Europian vendos me shumicë të cilësuar. Kur Këshilli Europian merr vendim përmes votës, Presidenti i tij dhe Presidenti i Komisionit nuk marrin pjesë në votim.

Abstenimet e anëtarëve që janë të pranishëm fizikisht ose që përfaqësohen nuk e pengojnë miratimin nga Këshilli Europian të akteve që kërkojnë unanimitet.

2. Kryetari i Parlamentit Europian mund të ftohet të flasë përpara Këshillit Europian.

3. Këshilli Europian vendos me shumicë të thjeshtë për çështjet procedurale dhe për miratimin e Rregullores së Brendshme të tij.

4. Këshilli Europian mbështetet nga Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit.

Neni 236

Këshilli Europian miraton me shumicë të cilësuar:

(a) një vendim ku përcaktohet lista e konfigurimeve të Këshillit, me përjashtim të atyre të Këshillit për Çështje të Përgjithshme dhe të Këshillit për Punët e Jashtme, në zbatim të nenit 16(6) të Traktatit për Bashkimin Europian;

(b) një vendim për konfigurimet e Presidencës së Këshillit, me përjashtim të atij të Punëve të Jashtme, në përputhje me nenin 16(9) të Traktatit për Bashkimin Europian.

SEKSIONI 3

KËSHILLI

Neni 237
(ish-neni 204 TKE)

Këshilli mblidhet kur e thërret Presidenti me nismën e tij, me kërkesën e njërit prej Anëtarëve të tij ose me kërkesë të Komisionit.

Neni 238
(ish-neni 205(1) dhe (2), TKE)

1. Kur i kërkohet të veprojë me shumicë të thjeshtë, Këshilli vendos me shumicën e anëtarëve që e përbëjnë.

2. Duke u shmangur nga neni 16(4) e Traktatit për Bashkimin Europian, duke filluar nga data 1 nëntor 2014 dhe në varësi të dispozitave të përcaktuara në Protokollin për dispozitat kalimtare, kur Këshilli nuk vepron me propozim të Komisionit ose të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, shumica e cilësuar përcaktohet si të paktën 72% e anëtarëve të Këshillit, që përfaqësojnë Shtetet Anëtare të cilat përbëjnë të paktën 65% të popullsisë së Bashkimit.

3. Duke filluar nga data 1 nëntor 2014 dhe në varësi të dispozitave të përcaktuara në Protokollin për dispozitat kalimtare, në rastet kur, sipas Traktateve, jo të gjithë anëtarët e Këshillit marrin pjesë në votim, shumica e cilësuar përcaktohet si më poshtë:

(a) Shumica e cilësuar është të paktën 55% e anëtarëve të Këshillit që përfaqësojnë Shtetet Anëtare pjesëmarrëse të cilat përbëjnë të paktën 65% të popullsisë të këtyre Shteteve.
Pakica bllokuese duhet të përfshijë të paktën një numër minimal të anëtarëve të Këshillit që përfaqësojnë më shumë se 35% të popullsisë së Shteteve Anëtare pjesëmarrëse, plus një anëtar, dhe nëse nuk arrihet kjo, atëherë quhet e arritur shumica e cilësuar;

(b) Duke u shmangur nga germa (a), kur Këshilli nuk vendos me propozim të Komisionit ose të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, shumica e cilësuar përcaktohet si të paktën 72% e anëtarëve të Këshillit, që përfaqësojnë Shtetet Anëtare pjesëmarrëse të cilat përbëjnë të paktën 65% të popullsisë të këtyre Shteteve.

4. Abstenimet e anëtarëve që janë të pranishëm fizikisht ose që përfaqësohen nuk e pengojnë miratimin nga Këshilli të akteve që kërkojnë unanimitet.

Neni 239
(ish-neni 206 TKE)

Kur bëhet një votim, çdo anëtar i Këshillit mund të veprojë edhe në emër të jo më shumë se një anëtari tjetër.

Neni 240
(ish-neni 207 TKE)

1. Një komitet i përbërë nga Përfaqësuesit e Përhershëm të Qeverive të Shteteve Anëtare është përgjegjës për përgatitjen e punës së Këshillit dhe për realizimin e detyrave që ia ngarkon ky i fundit. Komiteti mund të miratojë vendime procedurale në rastet e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Këshillit.

2. Këshilli mbështetet nga një Sekretariat i Përgjithshëm, nën përgjegjësinë e një Sekretari të Përgjithshëm të emëruar nga Këshilli.

Këshilli vendos me shumicë të thjeshtë për organizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm.

3. Këshilli vendos me shumicë të thjeshtë për çështjet procedurale dhe për miratimin e Rregullores së Brendshme të tij.

Neni 241
(ish-neni 208 TKE)

Këshilli, me shumicë të thjeshtë, mund t'i kërkojë Komisionit të bëjë studime të cilat Këshilli i konsideron të dëshirueshme për arritjen e objektivave të përbashkëta dhe t'i paraqesë Këshillit propozimet e duhura. Nëse Komisioni nuk paraqet asnjë propozim, ai e informon Këshillin për arsyet.

Neni 242
(ish-neni 209 TKE)

Këshilli, me shumicë të thjeshtë, pasi konsultohet me Komisionin, përcakton rregullat për komitetet e parashikuara në Traktatet.

Neni 243
(ish-neni 210 TKE)

Këshilli vendos për pagat, dietat dhe pensionet e Presidentit të Këshillit Europian, e Presidentit të Komisionit, e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, e Anëtarëve të Komisionit, e Kryetarëve, Anëtarëve dhe Kancelarëve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit. Ai vendos edhe për çdo pagesë që bëhet në vend të shpërblimit të punës.

SEKSIONI 4

KOMISIONI

Neni 244

Në mbështetje të nenit 17(5) të Traktatit për Bashkimin Europian, anëtarët e Komisionit zgjidhen në bazë të një sistemi rotacioni të vendosur unanimisht nga Këshilli Europian dhe në bazë të parimeve të mëposhtme:

(a) Shtetet Anëtare trajtohen në mënyrë të barabartë në lidhje me caktimin e radhës dhe kohës së kaluar nga shtetasit e tyre si anëtarë të Komisionit; rrjedhimisht, diferenca midis numrit total të mandateve që kanë mbajtur shtetasit e dy Shteteve Anëtare nuk mund të jetë asnjëherë më shumë se një;

(b) në varësi të germës (a), çdo Komision pasardhës përbëhet në mënyrë të atillë që të pasqyrojë në mënyrë të kënaqshme përhapjen demografike dhe gjeografike të të gjitha Shteteve Anëtare.

Neni 245
(ish-neni 213 TKE)

Anëtarët e Komisionit nuk përfshihen në veprime që nuk përputhen me detyrat e tyre. Shtetet Anëtare respektojnë pavarësinë e Anëtarëve të Komisionit dhe nuk përpiqen të ushtrojnë ndikim tek ata.

Gjatë mandatit të tyre, Anëtarët e Komisionit nuk mund të angazhohen në asnjë punë tjetër, me ose pa fitim. Kur marrin detyrën, ata betohen se si gjatë mandatit të detyrës ashtu edhe pas tij do të respektojnë detyrimet që lindin prej detyrës dhe në veçanti detyrimin për të vepruar me integritet dhe maturi sa i takon pranimit të disa emërimeve ose përfitimeve pas përfundimit të mandatit të detyrës. Në rast shkeljeje të këtyre detyrimeve, Gjykata e Drejtësisë, me kërkesë të Këshillit i cili vendos me shumicë të thjeshtë ose me kërkesë të Komisionit, mund të vendosë që Anëtari në fjalë, sipas rrethanave, të shkarkohet sipas nenit 247 ose t'i hiqet e drejta e pensionit ose të pagesave të tjera në vend të pensionit.

Neni 246
(ish-neni 215 TKE)

Përveç zëvendësimit normal ose vdekjes, detyrat e një Anëtari të Komisionit mbarojnë kur ai jep dorëheqjen ose kur shkarkohet.

Vendi i lirë i krijuar nga dorëheqja, lirimi i detyrueshëm ose vdekja plotësohet për pjesën e mbetur të mandatit të Anëtarit nga një Anëtar i ri me të njëjtën shtetësi, të emëruar nga Këshilli, me miratimin e përbashkët të Presidentit të Komisionit, pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe në mbështetje të kritereve të parashikuara në nënparagrafin e dytë të nenit 17(3) të Traktatit për Bashkimin Europian.

Këshilli, me unanimitet, me propozim të Presidentit të Komisionit, mund të vendosë që ky vend i lirë të mos plotësohet, sidomos kur pjesa e mbetur e mandatit të Anëtarit është e shkurtër.

Në rast dorëheqjeje, lirimi të detyrueshëm ose vdekjeje, Presidenti zëvendësohet për pjesën e mbetur të mandatit. Për zëvendësimin e Presidentit zbatohet procedura e parashikuar në nënparagrafin e parë të nenit 17(7) të Traktatit për Bashkimin Europian.

Në rast dorëheqjeje, lirimi të detyrueshëm ose vdekjeje, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë zëvendësohet, për pjesën e mbetur të mandatit, në përputhje me nenin 18(1) të Traktatit për Bashkimin Europian.

Në rast të dorëheqjes së të gjithë Anëtarëve të Komisionit, ata qëndrojnë në detyrë dhe vazhdojnë të merren me detyrat që kryejnë gjersa të zëvendësohen, për pjesën e mbetur të mandatit, në përputhje me nenin 17 të Traktatit për Bashkimin Europian.

Neni 247
(ish-neni 216 TKE)

Nëse një Anëtar i Komisionit nuk i përmbush më kushtet për kryerjen e detyrave të tij ose nëse ka qenë fajtor për shkelje të rëndë, Gjykata e Drejtësisë, me kërkesë të Këshillit i cili vepron me shumicë të thjeshtë ose të Komisionit, mund ta shkarkojë atë.

Neni 248
(ish-neni 217(2) TKE)

Pa cenuar nenin 18(4) të Traktatit për Bashkimin Europian, përgjegjësitë që i ngarkohen Komisionit strukturohen dhe u shpërndahen anëtarëve nga Presidenti i tij, në mbështetje të nenit 17(6) të Traktatit për Bashkimin Europian. Presidenti mund ta ndryshojë shpërndarjen e këtyre përgjegjësive gjatë mandatit në detyrë të Komisionit. Anëtarët e Komisionit i realizojnë detyrat që ua delegon Presidenti nën drejtimin e tij.

Neni 249
(ish nenet 218(2) dhe 212 TKE)

1. Komisioni miraton Rregulloren e Brendshme për të siguruar funksionimin e tij dhe të drejtorive që e përbëjnë. Komisioni kujdeset që Rregullorja të botohet.

2. Komisioni boton çdo vit, jo më vonë se një muaj pas çeljes së sesionit të Parlamentit Europian, një raport të përgjithshëm për aktivitetet e Bashkimit.

Neni 250
(ish-neni 219 TKE)

Komisioni vendos me shumicën e Anëtarëve të tij.

Kuorumin e përcakton Rregullorja e Brendshme.

SEKSIONI 5

GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EUROPIAN

Neni 251
(ish-neni 221 TKE)

Gjykata e Drejtësisë mblidhet në dhoma gjyqësore ose në një Dhomë të Madhe Gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara për këtë qëllim në Statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Kur e parashikon Statuti, Gjykata e Drejtësisë mund të mblidhet edhe në Seancë Plenare.

Neni 252
(ish-neni 222 TKE)

Gjykata e Drejtësisë mbështetet nga tetë Avokatë të Përgjithshëm. Këshilli, me unanimitet, mund ta rrisë numrin e Avokatëve të Përgjithshëm, nëse këtë e kërkon Gjykata e Drejtësisë.

Avokati i Përgjithshëm ka për detyrë që, me paanshmëri dhe pavarësi të plotë, të bëjë parashtrime të arsyetuara në seancë të hapur gjyqësore, për çështje të cilat, sipas Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, kërkojnë përfshirjen e tij.

Neni 253
(ish-neni 223 TKE)

Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime, të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për të mbajtur postet më të larta gjyqësore në vendet përkatëse të tyre ose janë juristë me aftësi profesionale të njohura. Ata emërohen me miratimin e përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare për një mandat gjashtëvjeçar, pasi konsultohen me panelin e parashikuar në nenin 255.

Çdo tre vjet bëhet një zëvendësim i pjesshëm i Gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm, sipas kushteve të përcaktuara në Statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Gjyqtarët zgjedhin mes radhëve të tyre Kryetarin e Gjykatës së Drejtësisë, për një mandat trevjeçar. Kryetari mund të rizgjidhet.

Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm, të cilëve u ka mbaruar mandati, mund të riemërohen.

Gjykata e Drejtësisë emëron Kancelarin e vet dhe përcakton rregullat për punën e tij.

Gjykata e Drejtësisë krijon Rregulloren e Brendshme të saj. Kjo Rregullore kërkon miratimin e Këshillit.

Neni 254
(ish-neni 224 TKE)

Numri i Gjyqtarëve të Gjykatës e Përgjithshme përcaktohet në Statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian. Statuti mund të parashikojë që Gjykata e Përgjithshme të mbështetet nga Avokatët e Përgjithshëm.

Anëtarët e Gjykatës së Përgjithshme zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime dhe të cilët kanë aftësitë që kërkohen për emërimin në poste të larta gjyqësore. Ata emërohen me miratimin e përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare për një mandat gjashtëvjeçar, pas konsultimit me panelin e parashikuar në nenin 255. Anëtarët zëvendësohen pjesërisht çdo tre vjet. Anëtarët që lirohen nga detyra kanë të drejtë riemërimi.

Gjyqtarët zgjedhin mes vetes së tyre Kryetarin e Gjykatës së Drejtësisë, për një mandat trevjeçar. Kryetari mund të rizgjidhet.

Gjykata e Përgjithshme emëron Kancelarin e vet dhe përcakton rregullat për punën e tij.

Gjykata e Përgjithshme përcakton Rregulloren e Brendshme të saj në marrëveshje me Gjykatën e Drejtësisë. Kjo Rregullore kërkon miratimin e Këshillit.

Për Gjykatën e Përgjithshme zbatohen dispozitat e Traktateve të cilat kanë të bëjnë me Gjykatën e Drejtësisë, nëse nuk parashikohet ndryshe në Statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Neni 255

Krijohet një panel për të dhënë mendimin e tij lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve për kryerjen e detyrave të Gjyqtarit dhe Avokatit të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, përpara se qeveritë e Shteteve Anëtare të bëjnë emërimet e përmendura në nenet 253 dhe 254.

Paneli përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur mes ish-anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, anëtarëve të gjykatave të larta kombëtare dhe juristëve që njihen për aftësitë profesionale, njërin prej të cilëve e propozon Parlamenti Europian. Këshilli miraton një vendim për rregullat e punës të panelit dhe një vendim për emërimin e anëtarëve të panelit. Ai vepron me nismën e Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë.

Neni 256
(ish-neni 225 TKE)

1. Gjykata e Përgjithshme ka kompetencë të dëgjojë dhe të vendosë mbi çështjet ose procedurat e shkallës së parë të përmendura në nenet 263, 265, 268, 270 dhe 272, me përjashtim të atyre që i takojnë një gjykate të specializuar të krijuar sipas nenit 257 dhe të atyre të cilat Statuti ia ka rezervuar Gjykatës së Drejtësisë. Statuti mund të parashikojë që Gjykata e Përgjithshme të ketë kompetencë për kategori të tjera çështjesh dhe procedurash.

Kundër vendimeve që nxjerr Gjykata e Përgjithshme sipas këtij paragrafi mund të apelohet përpara Gjykatës së Drejtësisë vetëm për çështje të interpretimit ligjor, sipas kushteve dhe brenda kufijve që përcakton Statuti.

2. Gjykata e Përgjithshme ka kompetencë të dëgjojë dhe të vendosë për çështjet ose procedurat kundër vendimeve të gjykatave të specializuara.

Vendimet që nxjerr Gjykata e Përgjithshme sipas këtij paragrafi mund të shqyrtohen në mënyrë të jashtëzakonshme nga Gjykata e Drejtësisë, sipas kushteve dhe brenda kufijve që përcakton Statuti, kur ka rrezik serioz për unifikimin ose pajtueshmërinë e legjislacionit të Bashkimit që preket.

3. Gjykata e Përgjithshme ka kompetencë të dëgjojë dhe vendosë për çështjet e përcjella për vendim paragjykimor sipas nenit 267, në fushat e caktuara që përcakton Statuti.

Kur Gjykata e Përgjithshme mendon se çështja kërkon një vendim në parim i cili ka të ngjarë të prekë unifikimin ose pajtueshmërinë e të drejtës së Bashkimit, ajo mund t'ia përcjellë çështjen për vendim Gjykatës së Drejtësisë.

Vendimet që nxjerr Gjykata e Përgjithshme lidhur me çështjet e përcjella për vendim paragjykimor, përjashtimisht mund të shqyrtohen nga Gjykata e Drejtësisë, sipas kushteve dhe brenda kufijve që përcakton Statuti, kur ka rrezik serioz për unifikimin ose pajtueshmërinë e të drejtës së Bashkimit që preket.

Neni 257
(ish-neni 225*a* TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të krijojnë gjykata të specializuara, të cilat vendosen pranë Gjykatës së Përgjithshme për të dëgjuar dhe

vendosur në shkallë të parë për disa kategori të caktuara çështjesh dhe procedurash që u takojnë fushave të caktuara. Parlamenti Europian dhe Këshilli veprojnë përmes rregulloreve ose me propozim të Komisionit pasi konsultohen me Gjykatën e Drejtësisë ose me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë pasi konsultohen me Komisionin.

Rregullorja përmes së cilës krijohet një gjykatë e specializuar vendos rregullat për organizimin e gjykatës dhe shkallën e kompetencës së saj.

Kundër vendimeve që nxjerrin gjykatat e specializuara mund të apelohet vetëm për çështje të interpretimit ligjor ose, kur e parashikon rregullorja përmes së cilës krijohet gjykata e specializuar, mund të apelohet edhe për faktet e parashtruara, përpara Gjykatës së Përgjithshme.
Anëtarët e gjykatave të specializuara zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime dhe të cilët kanë aftësitë që kërkohen për emërimin në detyra gjyqësore. Ata emërohen nga Këshilli, i cili vendos me unanimitet.

Gjykatat e specializuara përcaktojnë Rregulloret e Brendshme të tyre në marrëveshje me Gjykatën e Drejtësisë. Këto Rregullore kërkojnë miratimin e Këshillit.

Për gjykatat e specializuara zbatohen dispozitat e Traktateve të cilat kanë të bëjnë me Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Europian dhe dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, nëse nuk parashikohet ndryshe në rregulloren përmes së cilës krijohet gjykata e specializuar. Titulli i Statutit dhe neni 64 i tij zbatohen në çdo rast për gjykatat e specializuara.

Neni 258
(ish-neni 226 TKE)

Nëse Komisioni është i mendimit se një Shtet Anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet, ai nxjerr një opinion të arsyetuar për çështjen në fjalë pasi i ka dhënë Shtetit në fjalë mundësinë të paraqesë komentet e veta.

Nëse Shteti në fjalë nuk e zbaton opinionin brenda periudhës së vendosur nga Komisioni, ky i fundit mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Neni 259
(ish-neni 227 TKE)

Një Shtet Anëtar i cili mendon se një Shtet tjetër Anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Përpara se Shteti Anëtar të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar për një shkelje të dyshuar të një detyrimi që rrjedh nga Traktatet, ai e ngre këtë çështje përpara Komisionit.

Komisioni nxjerr një opinion të arsyetuar pasi i ka dhënë secilit prej Shteteve në fjalë mundësinë të paraqesin argumentet e tyre dhe komentet e tyre për argumentet e palës tjetër, me gojë dhe me shkrim.

Nëse Komisioni nuk e nxjerr opinionin brenda tre muajve pas datës kur është ngritur çështja përpara tij, mungesa e opinionit nuk përbën pengesë që çështja të kalojë në Gjykatë.

Neni 260
(ish-neni 228 TKE)

1. Nëse Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian konstaton se një Shtet Anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet, Shtetit i kërkohet të marrë masat e nevojshme për të respektuar vendimin e Gjykatës.

2. Nëse Komisioni është i mendimit se Shteti Anëtar në fjalë nuk i ka marrë masat e nevojshme për të respektuar vendimin e Gjykatës, ai mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës pasi i ka dhënë mundësi Shtetit të paraqesë komentet e veta. Ai përcakton vlerën e shumës apo gjobës që duhet të paguajë Shteti Anëtar në fjalë, siç e gjykon të arsyeshme sipas rrethanave.

Nëse Gjykata konstaton se Shteti Anëtar në fjalë nuk e ka respektuar vendimin e saj, ajo mund të vendosë një shumë ose gjobë për t'u paguar nga ky Shtet Anëtar.

Kjo procedurë nuk e cenon nenin 259.

3. Kur Komisioni e ngre çështjen përpara Gjykatës, sipas nenit 258, me arsyen se Shteti Anëtar në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin për të njoftuar masat që transpozojnë një direktivë të miratuar sipas një procedure legjislative, kur e gjykon të arsyeshme ai mund të përcaktojë vlerën e shumës së njëhershme ose të gjobës që duhet të paguajë Shteti Anëtar në fjalë, siç e gjykon të arsyeshme sipas rrethanave.

Nëse Gjykata konstaton se ka shkelje ajo mund të vendosë shumën ose gjobën për Shtetin Anëtar në fjalë, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se vlera e përcaktuar nga Komisioni. Detyrimi për të paguar fillon më datën e vendosur nga Gjykata në vendimin e saj.

Neni 261
(ish-neni 229 TKE)

Rregulloret e miratuara bashkërisht nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, si dhe ato të miratuara vetëm nga Këshilli, në zbatim të dispozitave të Traktateve, mund t'i japin Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian kompetencë të pakufizuar sa u takon gjobave që parashikojnë këto rregullore.

Neni 262
(ish-neni 229*a* TKE)

Pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve, Këshilli, me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi konsultohet me Parlamenti Europian, mund të miratojë dispozita përmes të cilave i jep kompetencë, për aq sa e vendos ai vetë, Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian për mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me zbatimin e akteve të miratuara në mbështetje të Traktateve të cilat krijojnë të drejta europiane të pronësisë intelektuale. Këto dispozita hyjnë në fuqi pasi aprovohen nga të gjitha Shtetet Anëtare, sipas kërkesave kushtetuese përkatëse të tyre.

Neni 263
(ish-neni 230 TKE)

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian shqyrton ligjshmërinë e akteve legjislative, e akteve të Këshillit, të Komisionit dhe të Bankës Qendrore Europiane, që nuk janë rekomandime dhe opinione, dhe të akteve të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian të cilat kanë për qëllim të prodhojnë pasoja ligjore kundrejt të tretëve. Ajo shqyrton edhe ligjshmërinë e akteve të organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit të cilat kanë për qëllim të prodhojnë pasoja ligjore kundrejt të tretëve.

Për këtë qëllim ajo ka kompetencë mbi çështjet e ngritura nga një Shtet Anëtar, Parlamenti Europian, Këshilli ose Komisioni për mungesë kompetence, për shkelje të një kërkese thelbësore procedurale, për shkelje të Traktateve ose të një norme ligjore që ka të bëjë me zbatimin e tyre, ose për shpërdorim detyre.

Bazuar në të njëjtat kushte, Gjykata ka kompetencë mbi çështjet e ngritura nga Gjykata e Audituesve, nga Banka Qendrore Europiane dhe nga Komiteti i Rajoneve me qëllim mbrojtjen e kompetencave të tyre.

Bazuar në kushtet e përcaktuara në paragrafin e parë dhe të dytë, çdo person fizik ose juridik mund të fillojë proces kundër një akti që i drejtohet atij personi ose i cili është në interes të drejtpërdrejtë të atij personi dhe kundër një akti rregullator i cili është në interes të drejtpërdrejtë të atij personi dhe i cili nuk nënkupton masa zbatuese.

Aktet përmes të cilave krijohen organe, zyra dhe agjenci të Bashkimit mund të përcaktojnë kushte dhe masa organizative të caktuara lidhur me paditë e ngritura nga persona fizikë ose juridikë kundër akteve të këtyre organeve, zyrave ose agjencive, të cilat kanë për qëllim prodhimin e pasojave ligjore kundrejt tyre.

Proceset e parashikuara në këtë nen fillojnë brenda dy muajve nga botimi i masës ose nga njoftimi i masës paditësit ose, në mungesë të kësaj, nga dita kur ky ka marrë dijeni për këtë të fundit, sipas rastit.

Neni 264
(ish-neni 231 TKE)

Nëse padia është e bazuar, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian e deklaron të pavlefshëm aktin në fjalë.

Por nëse e mendon të nevojshme, Gjykata përcakton se cilat pasoja të aktit që ka deklaruar si të pavlefshëm do të konsiderohen si përfundimtare.

Neni 265
(ish-neni 232 TKE)

Nëse Parlamenti Europian, Këshilli Europian, Këshilli, Komisioni ose Banka Qendrore Europiane, në shkelje të Traktateve nuk veprojnë, Shtetet Anëtare dhe institucionet e tjera të Bashkimit mund të ngrenë padi përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian për të konstatuar shkeljen. Ky nen zbatohet me të njëjtat kushte për organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit të cilat nuk veprojnë.

Padia është e pranueshme vetëm nëse i është bërë më parë thirrje për të vepruar institucionit, organit, zyrës ose agjencisë. Nëse, brenda dy muajve pas thirrjes, institucioni, organi, zyra ose agjencia në fjalë nuk ka dalë me një qëndrim, padia mund të ngrihet brenda një periudhe shtesë dymujore.

Çdo person fizik ose juridik mund të ankohet përpara Gjykatës sipas kushteve të përcaktuara në paragrafët e mësipërme, se një institucion, organ, zyrë ose agjenci e Bashkimit nuk i është drejtuar personit me asnjë akt, përveç një rekomandimi ose një opinioni.

Neni 266
(ish-neni 233 TKE)

Institucioni veprimi i të cilit është shpallur si i pavlefshëm ose mosveprimi i të cilit është shpallur se bie ndesh me Traktatet i kërkohet të marrë masat e nevojshme për të zbatuar vendimin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Ky detyrim nuk prek asnjë detyrim që mund të rrjedhë nga zbatimi i paragrafit të dytë të nenit 340.

Neni 267
(ish-neni 234 TKE)

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka juridiksion të shprehet përmes procedurës paragjykimore lidhur me:

(a) interpretimin e Traktateve;

(b) vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit;

Kur një çështje e tillë ngrihet përpara një gjykate ose tribunali të një Shteti Anëtar, kjo gjykatë ose tribunal, nëse është e mendimit se nevojitet një vendim në mënyrë që të gjykohet çështja, i kërkon Gjykatës nxjerrjen e një vendimi paraprak për të.

Kur një çështje e tillë ngrihet në një çështje gjyqësore që ndodhet për gjykim përpara një gjykate ose tribunali të një Shteti Anëtar kundër vendimeve të të cilit nuk ka zgjidhje ligjore që mund të ndiqet në bazë të legjislacionit kombëtar, kjo gjykatë ose ky tribunal mund ta paraqesë çështjen përpara Gjykatës.

Nëse një çështje e tillë ngrihet në një çështje gjyqësore që ndodhet për gjykim përpara një gjykate ose tribunali të një Shteti Anëtar në lidhje me një person të shoqëruar, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian vepron me vonesën më të vogël.

Neni 268
(ish-neni 235 TKE)

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka kompetencë mbi mosmarrëveshjet që lidhen me dëmshpërblimin e parashikuar në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 340.

Neni 269

Gjykata e Drejtësisë ka kompetencë për të vendosur në lidhje me ligjshmërinë e një akti të miratuar nga Këshilli Europian ose nga Këshilli në mbështetje të nenit 7 të Traktatit për Bashkimin Europian vetëm me kërkesë të Shtetit Anëtar në fjalë me konstatim të Këshillit Europian ose të Këshillit dhe vetëm në respektim të parashikimeve procedurale që përmban neni i sipërpërmendur.

Një kërkesë e tillë duhet bërë brenda një muaji prej datës së një konstatimi të tillë. Gjykata e jep vendimin brenda një muaji prej datës së paraqitjes së kërkesës.

Neni 270
(ish-neni 236 TKE)

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka kompetencë mbi çdo mosmarrëveshje midis Bashkimit dhe punonjësve të tij brenda kufijve dhe sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloret e Personelit për Zyrtarët dhe në Kushtet e Marrëdhënieve të Punës për nëpunësit e tjerë të Bashkimit.

Neni 271
(ish-neni 237 TKE)

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, brenda kufijve të përcaktuara më poshtë, ka kompetencë mbi mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me:

(a) përmbushjen nga Shtetet Anëtare të detyrimeve që rrjedhin nga Statuti i Bankës Europiane të Investimeve. Në lidhje me këtë Bordi Drejtues i Bankës gëzon kompetencat që ia jep Komisioni me nenin 258;

(b) masat e miratuara nga Bordi i Guvernatorëve i Bankës Europiane të Investimeve. Në lidhje me këtë, çdo Shtet Anëtar, Komisioni ose Bordi Drejtues i Bankës mund të çelë procedurën sipas kushteve të përcaktuara në nenin 263;

(c) masat e miratuara nga Bordi Drejtues i Bankës Europiane të Investimeve. Procedura kundër masave të tilla mund të fillojë vetëm nga Shtetet Anëtare ose nga Komisioni, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 263 dhe vetëm në bazë të arsyeve të moszbatimit të procedurës të parashikuar në nenin 19(2), (5), (6) dhe (7) të Statutit të Bankës;

(d) përmbushjen nga bankat qendrore kombëtare të detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet dhe Statuti i SEBQ-së dhe i BQE-së. Në lidhje me këtë, kompetencat e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në lidhje me bankat qendrore kombëtare janë të njëjta me ato që Komisionit ia japin Shtetet Anëtare përmes nenit 258. Nëse Gjykata konstaton se një bankë qendrore kombëtare nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet, kësaj banke i kërkohet të marrë masat e nevojshme për të respektuar vendimin e Gjykatës.

Neni 272
(ish-neni 238 TKE)

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka kompetencë të gjykojë dhe vendosur në mbështetje të klauzolave të arbitrazhit të përfshira në kontratat e lidhura nga Bashkimi ose për llogari të Bashkimit, pavarësisht nëse këto kontrata i rregullon e drejta publike ose ajo private.

Neni 273
(ish-neni 239 TKE)

Gjykata e Drejtësisë ka kompetencë mbi çdo mosmarrëveshje midis Shteteve Anëtare që ka të bëjë me objektin e Traktateve, nëse mosmarrëveshja i paraqitet në bazë të një marrëveshjeje të veçantë midis palëve.

Neni 274
(ish-neni 240 TKE)

Mosmarrëveshjet në të cilat Bashkimi është një prej palëve nuk mund të përjashtohen, për shkak të kësaj, nga juridiksioni i gjykatave të Shteteve Anëtare, me përjashtim të rastit kur juridiksionin për këto mosmarrëveshje Traktatet ia kanë dhënë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Neni 275

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian nuk ka kompetencë lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe as lidhur me aktet e miratuara në mbështetje të këtyre dispozitave.

Por, Gjykata ka kompetencë të vëzhgojë respektimin e nenit 40 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe të vendosë mbi proceset e hapura në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin e katërt të nenit 263 të këtij Traktati, duke shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve që parashikojnë masa kufizuese kundër personave fizikë dhe juridikë të miratuara nga Këshilli në mbështetje të Kreut 2 të Titullit V të Traktatit për Bashkimin Europian.

Neni 276

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, gjatë ushtrimit të tagrave lidhur me dispozitat e Krerëve 4 dhe 5 të Titullit V të Pjesës së Tretë të cilat lidhen me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, nuk ka juridiksion për të shqyrtuar vlefshmërinë ose proporcionalitetin e operacioneve të realizuara nga forcat policore apo nga shërbimet e tjera të forcave të zbatimit të ligjit të një Shteti Anëtar ose ushtrimin e përgjegjësive që u janë ngarkuar Shteteve Anëtare në lidhje me ruajtjen e ligjit dhe të rendit dhe mbrojtjen e sigurisë së brendshme.

Neni 277
(ish-neni 241 TKE)

Pavarësisht kalimit të afatit të përcaktuar në nenin 263, paragrafi i gjashtë, gjatë procesit objekt i të cilit është një akt me zbatim të përgjithshëm i miratuar nga një institucion, organ, zyrë ose agjenci e Bashkimit, çdo palë mund të përdorë arsyetimin e përcaktuar në nenin 263, paragrafi i dytë, për të argumentuar përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian moszbatueshmërinë e aktit në fjalë.

Neni 278
(ish-neni 242 TKE)

Paditë e ngritura përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian nuk kanë pasoja pezulluese. Megjithatë, Gjykata mund të nxjerrë një vendim për pezullimin e aktit që është objekt i padisë, nëse e gjykon se kështu e kërkojnë rrethanat.

Neni 279
(ish-neni 243 TKE)

Në çdo çështje që shqyrton, nëse është e nevojshme, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian mund të marrë masa me karakter të përkohshëm.

Neni 280
(ish-neni 244 TKE)

Aktgjykimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian janë të zbatueshme sipas kushteve të përcaktuara në nenin 299.

Neni 281
(ish-neni 245 TKE)

Statuti i Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian përcaktohet në një Protokoll të veçantë.

Parlamenti Europian dhe Këshilli mund t'i ndryshojnë, përmes procedurës së zakonshme legjislative, dispozitat e Statutit, me përjashtim të Titullit I dhe nenit 64. Parlamenti Europian dhe Këshilli veprojnë me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë dhe pas konsultimit me Komisionin, ose me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Gjykatën e Drejtësisë.

SEKSIONI 6

BANKA QENDRORE EUROPIANE

Neni 282

1. Sistemi Europian i Bankave Qendrore përbëhet nga Banka Qendrore Europiane, së bashku me bankat qendrore kombëtare. Banka Qendrore Europiane, së bashku me bankat qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja, të cilat përbëjnë Eurosistemin, realizon politikën monetare të Bashkimit.

2. SEBQ drejtohet nga organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Europiane. Objektivi parësor i SEBQ-së është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Pa cenuar këtë objektiv, ajo mbështet politikat ekonomike të Bashkimit në mënyrë që të kontribuojë në arritjen e objektivave të këtij të fundit.

3. Banka Qendrore Europiane ka personalitet juridik. Vetëm ajo mund të autorizojë emetimin e euros. Ajo është e pavarur në ushtrimin e kompetencave të saj si dhe në administrimin e mjeteve të saj financiare. Kjo pavarësi respektohet nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit dhe qeveritë e Shteteve Anëtare.

4. Banka Qendrore Europiane miraton ato masa që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të saj në mbështetje të neneve nga 127 deri në 133, nenit 138 dhe në përputhje me kushtet

e përcaktuara në Statuti i SEBQ-së dhe i BQE-së. Në mbështetje të të njëjtave neneve, ato Shtete Anëtare monedha e të cilave nuk është euroja dhe bankat e tyre qendrore mbajnë kompetencat e tyre lidhur me çështjet monetare.

5. Brenda fushave që bien në kompetencat e saj, Banka Qendrore Europiane konsultohet për të gjitha aktet e propozuara dhe për të gjitha propozimet për rregullim në nivel kombëtar, dhe ajo mund të japë një opinion.

Neni 283
(ish-neni 112 TKE)

1. Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore Europiane përbëhet nga anëtarët e Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Europiane dhe Guvernatorët e bankave qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja.

2. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Presidenti, Zëvendëspresidenti dhe katër anëtarë të tjerë.

Këshilli Europian emëron me shumicë të cilësuar Presidentin, Zëvendëspresidentin dhe anëtarët e tjerë të Bordit Ekzekutiv, mes personave me reputacion të njohur dhe përvojë profesionale në çështjet monetare dhe bankare, me rekomandim të Këshillit, pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe me Këshillin Drejtues të Bankës Qendrore Europiane.

Mandati i tyre është tetëvjeçar dhe nuk është i ripërtëritshëm.
Anëtarë të Bordit Ekzekutiv mund të jenë vetëm shtetas të Shteteve Anëtare.

Neni 284
(ish-neni 113 TKE)

1. Presidenti i Këshillit dhe një Anëtar i Komisionit mund të marrin pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane.

Presidenti i Këshillit mund të paraqesë një kërkesë për diskutim përpara Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane.

2. Presidenti i Bankës Qendrore Europiane ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit kur Këshilli diskuton çështje që kanë të bëjnë me objektivat dhe detyrat e SEBQ-së.

3. Banka Qendrore Europiane i drejton Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit, si edhe Këshillit Europian, një raport vjetor për aktivitetet e SEBQ-së dhe politikën monetare të ndjekur në vitin e mëparshëm dhe vitin në vazhdim. Presidenti i Bankës Qendrore Europiane ia paraqet këtë raport Këshillit dhe Parlamentit Europian, të cilët mund të zhvillojnë një debat të përgjithshëm mbështetur në të.

Presidenti i Bankës Qendrore Europiane dhe anëtarët e tjerë të Bordit Ekzekutiv, me kërkesë të Parlamentit Europian ose me nismën e tyre, mund të flasin përpara komisioneve kompetente të Parlamentit Europian.

SEKSIONI 7

GJYKATA E AUDITUESVE

Neni 285
(ish-neni 246 TKE)

Gjykata e Audituesve kryen auditimin e Bashkimit.

Ajo përbëhet nga një shtetas prej secilit Shtet Anëtar. Anëtarët e saj janë tërësisht të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre, në interesin e përgjithshëm të Bashkimit.

Neni 286
(ish-neni 247 TKE)

1. Anëtarët e Gjykatës së Audituesve zgjidhen mes personave të cilët u përkasin ose u kanë përkitur në Shtetet përkatëse të tyre organeve të auditimit të jashtëm ose të cilët janë veçanërisht të kualifikuar për këtë detyrë. Pavarësia e tyre duhet të jetë përtej dyshimit.

2. Anëtarët e Gjykatës së Audituesve emërohen për një mandat gjashtëvjeçar. Pasi konsultohet me Parlamentin Europian, Këshilli miraton listën e Anëtarëve të hartuar në përputhje me propozimet që bën secili Shtet Anëtar. Mandati i Anëtarëve të Gjykatës së Audituesve mund të ripërtërihet.

Ata zgjedhin mes radhëve të tyre Kryetarin e Gjykatës së Audituesve, për një mandat trevjeçar. Kryetari mund të rizgjidhet.

3. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave, Anëtarët e Gjykatës së Audituesve nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga asnjë qeveri ose nga asnjë organ tjetër. Anëtarët e Gjykatës së Audituesve nuk përfshihen në asnjë veprim që nuk përputhet me detyrat e tyre.

4. Gjatë mandatit të tyre, Anëtarët e Gjykatës së Audituesve nuk mund të angazhohen në asnjë punë tjetër, me ose pa fitim. Kur marrin detyrën, ata betohen se si gjatë mandatit të detyrës ashtu edhe pas tij do të respektojnë detyrimet që lindin prej detyrës dhe në veçanti detyrimin për të vepruar me integritet dhe maturi sa i takon pranimit të disa emërimeve ose përfitimeve pas përfundimit të mandatit të detyrës.

5. Krahas zëvendësimit normal ose vdekjes, detyrimet e një Anëtari të Gjykatës së Audituesve marrin fund kur ai jep dorëheqjen ose kur lirohet me vendim të Gjykatës së Drejtësisë në mbështetje të paragrafit 6.

Vendi i liruar në këtë mënyrë plotësohet për pjesën e mbetur të mandatit të Anëtarit.

Me përjashtim të rastit të lirimit të detyrueshëm, Anëtarët e Gjykatës së Audituesve qëndrojnë në detyrë derisa të zëvendësohen.

6. Një Anëtar i Gjykatës së Audituesve mund të privohet nga detyra ose nga e drejta për pension apo përfitime të tjera në vend të pensionit vetëm nëse Gjykata e Drejtësisë, me kërkesë të

Gjykatës së Audituesve, konstaton se ai nuk i përmbush më parakushtet ose detyrimet që rrjedhin nga detyra e tij.

7. Këshilli vendos kushtet e marrëdhënieve të punës për Kryetarin dhe Anëtarët e Gjykatës së Audituesve dhe, në veçanti, pagat, shpenzimet personale të lejuara dhe pensionet. Ai vendos edhe çdo pagesë që bëhet në vend të shpërblimit të punës.

8. Dispozitat e Protokollit për privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Europian që janë të zbatueshme për Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian zbatohen edhe për Anëtarët e Gjykatës së Audituesve.

Neni 287
(ish-neni 248 TKE)

1. Gjykata e Audituesve shqyrton llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve publike të Bashkimit. Ajo shqyrton gjithashtu edhe llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të të gjitha organeve, zyrave ose agjencive të krijuara nga Bashkimi për aq sa instrumenti përkatës themelues nuk e ndalon një shqyrtim të tillë.

Gjykata e Audituesve i jep Parlamentit Europian dhe Këshillit një deklaratë garancie lidhur me korrektesën e llogarive, ligjshmërinë dhe rregullsinë e veprimeve mbi të cilat mbështeten këto llogari, e cila botohet në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.* Kjo deklaratë mund të plotësohet me vlerësime të veçanta për secilën fushë madhore të aktivitetit të Bashkimit.

2. Gjykata e Audituesve shikon nëse janë arkëtuar të gjitha të ardhurat dhe nëse të gjitha shpenzimet janë bërë në mënyrë të ligjshme dhe të rregullt dhe nëse drejtimi financiar ka qenë me baza të shëndosha. Në kuadër të kësaj, Gjykata e Audituesve raporton në veçanti për çdo rast parregullsie.

Auditimi i të ardhurave publike bëhet në bazë të vlerave të konstatuara si detyrime dhe vlera të arkëtuara nga Bashkimi.

Auditimi i shpenzimeve bëhet në bazë të angazhimeve dhe të pagesave të kryera.

Këto auditime mund të bëhen përpara mbylljes së bilancit për vitin financiar në fjalë.

3. Auditimi mbështetet në evidenca dhe, nëse është e nevojshme, bëhet në vend në institucionet e tjera të Bashkimit, në mjediset e çdo organi, zyre ose agjencie që administron të ardhura dhe shpenzime në emër të Bashkimit dhe në Shtetet Anëtare, duke përfshirë mjediset e çdo personi fizik ose juridik që arkëton pagesa nga buxheti. Në Shtetet Anëtare auditimi bëhet në bashkëpunim me organet kontrolluese kombëtare ose, nëse këto nuk kanë kompetencat e nevojshme, me departamentet kompetente kombëtare. Gjykata e Audituesve dhe organet kontrolluese kombëtare të Shteteve Anëtare bashkëpunojnë me frymën e besimit, duke ruajtur në të njëjtën kohë pavarësinë e tyre. Këto organe ose departamente e informojnë Gjykatën e Audituesve nëse duan të marrin pjesë në auditim.

Institucionet e tjera të Bashkimit, çdo organ, zyrë ose agjenci që administrojnë të ardhura dhe shpenzime publike në emër të Bashkimit, çdo person fizik ose juridik që merr pagesa nga buxheti dhe

organet kontrolluese kombëtare ose, nëse këto nuk i kanë kompetencat e nevojshme, departamentet kompetente kombëtare, i përcjellin Gjykatës së Audituesve, me kërkesën e saj, çdo dokument ose informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të saj.

Lidhur me aktivitetin e Bankës Europiane të Investimeve në administrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të Bashkimit, të drejtat e Gjykatës për akses në informacionin që mban Banka rregullohen nga një marrëveshje midis Gjykatës, Bankës dhe Komisionit. Në mungesë të një marrëveshjeje, Gjykata ka akses në informacionin e nevojshëm për auditimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të Bashkimit të administruara nga Banka.

4. Gjykata e Audituesve harton një raport vjetor pas mbylljes së çdo viti financiar. Ky raport u përcillet institucioneve të tjera të Bashkimit dhe botohet, së bashku me përgjigjet e këtyre institucioneve lidhur me vërejtjet e Gjykatës së Audituesve, në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.*

Gjykata e Audituesve mund të paraqesë gjithashtu vërejtje në çdo kohë, sidomos në formën e raporteve të posaçme, për çështje të veçanta, dhe të japë opinione me kërkesë të njërit prej institucioneve të tjera të Bashkimit.

Ajo i miraton raportet e veta vjetore, raportet e posaçme ose opinionet me shumicën e Anëtarëve të saj. Megjithatë ajo mund të krijojë dhoma të brendshme për miratimin e disa kategorive të caktuara të raporteve ose opinioneve, sipas kushteve të përcaktuara nga Rregullorja e Brendshme e saj.
Ajo e mbështet Parlamentin Europian dhe Këshillin në ushtrimin e kompetencave të tyre të kontrollit mbi zbatimin e buxhetit.

Gjykata e Audituesve harton Rregulloren e Brendshme të saj. Kjo Rregullore kërkon miratimin nga Këshilli.

KREU 2

AKTET JURIDIKE TË BASHKIMIT, PROCEDURAT E MIRATIMIT DHE DISPOZITA TË TJERA

SEKSIONI 1

AKTET JURIDIKE TË BASHKIMIT

Neni 288
(ish-neni 249 TKE)

Për të ushtruar kompetencat e Bashkimit, institucionet miratojnë rregullore, direktiva, vendime, rekomandime dhe opinione.

Rregullorja ka zbatim të përgjithshëm. Ajo ka fuqi detyruese në tërësinë e saj dhe është drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Direktiva ka fuqi detyruese, në lidhje me rezultatin që duhet arritur, për çdo Shtet Anëtar të cilit i drejtohet, por ua lë autoriteteve kombëtare kompetencën e përzgjedhjes së formës dhe të mënyrave.

Vendimi ka fuqi detyruese në tërësinë e tij. Vendimi që e përcakton se kujt i drejtohet ka fuqi detyruese vetëm për këta.

Rekomandimet dhe opinionet nuk kanë fuqi detyruese.

Neni 289

1. Procedura e zakonshme legjislative konsiston në miratimin e përbashkët nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, të një rregulloreje, direktive ose vendimi, me propozim të Komisionit. Kjo procedurë përkufizohet në nenin 294.

2. Në rastet e caktuara të parashikuara nga Traktatet, miratimi i një rregulloreje, direktive ose vendimi nga Parlamenti Europian me pjesëmarrjen e Këshillit, ose nga ky i fundit me pjesëmarrjen e Parlamentit Europian, përbën një procedurë të posaçme legjislative.

3. Aktet juridike të miratuara përmes një procedure legjislative janë akte legjislative.

4. Në rastet e caktuara të parashikuara nga Traktatet, aktet legjislative mund të miratohen me nismën e një grupi Shtetesh Anëtare ose të Parlamentit Europian, me rekomandim të Bankës Qendrore Europiane ose me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë ose të Bankës Europiane të Investimeve.

Neni 290

1. Një akt legjislativ mund t'i delegojë Komisionit kompetencën për të miratuar akte jo legjislative me zbatim të përgjithshëm për të shtuar ose ndryshuar disa elemente jo thelbësore të aktit legjislativ.

Objektivat, përmbajtja, fusha e veprimit dhe kohëzgjatja e delegimit të kompetencës përcaktohen shprehimisht në aktet legjislative. Elementet thelbësore të një fushe rezervohen për aktin legjislativ dhe rrjedhimisht nuk janë objekt i delegimit të kompetencës.

2. Aktet legjislative përcaktojnë shprehimisht kushtet të cilave u nënshtrohet delegimi.

(a) Parlamenti Europian ose Këshilli mund të vendosin anulimin e delegimit;

(b) akti i deleguar mund të hyjë në fuqi vetëm nëse Parlamenti Europian apo Këshilli nuk kanë shprehur asnjë kundërshtim brenda një periudhe të përcaktuar nga akti legjislativ.

Për qëllimet e germave (a) dhe (b), Parlamenti Europian vendos me shumicën e deputetëve që e përbëjnë, ndërsa Këshilli me shumicë të cilësuar.

3. Në titullin e akteve të deleguara futet mbiemri "i deleguar".

Neni 291

1. Shtetet Anëtare miratojnë të gjitha masat e legjislacionit kombëtar, të nevojshme për vënien në zbatim të akteve të Bashkimit me fuqi ligjore detyruese.

2. Kur nevojiten kushte të njëtrajtshme për vënien në zbatim të akteve të Bashkimit me fuqi ligjore detyruese, këto akte i japin kompetenca zbatuese Komisionit ose, në rastet e caktuara të justifikuara rregullisht dhe në rastet e parashikuara në nenet 24 dhe 26 të Traktatit për Bashkimin Europian, këtë të drejtë ia japin Këshillit.

3. Për qëllimet e paragrafit 2, Parlamenti Europian dhe Këshilli, përmes rregulloreve të nxjerra sipas procedurës së zakonshme legjislative, përcaktojnë paraprakisht rregullat dhe parimet e përgjithshme lidhur me mekanizmin përmes të cilit Shtetet Anëtare bëjnë kontroll mbi ushtrimin e kompetencave zbatuese të Komisionit.

4. Në titullin e akteve zbatuese futet fjala "zbatues".

Neni 292

Këshilli miraton rekomandime. Ai vepron me propozim të Komisionit në të gjitha rastet kur Traktatet parashikojnë se duhet t'i miratojë aktet me propozim të Komisionit. Ai vendos me unanimitet në të gjitha ato fusha në të cilat kërkohet unanimiteti për miratimin e një akti të Bashkimit. Komisioni, dhe Banka Qendrore Europiane në rastet e caktuara të parashikuara nga Traktatet, miratojnë rekomandime.

SEKSIONI 2

PROCEDURA PËR MIRATIMIN E AKTEVE DHE DISPOZITAVE TË TJERA

Neni 293
(ish-neni 250 TKE)

1. Kur, në mbështetje të Traktateve, Këshilli vepron me propozim të Komisionit, ai mund ta ndryshojë këtë propozim vetëm me unanimitet, me përjashtim të rasteve të përmendura në paragrafët 10 dhe 13 të nenit 294, në nenet 310, 312 dhe 314 dhe në paragrafin e dytë të nenit 315.

2. Sa kohë nuk ka vepruar Këshilli, Komisioni mund ta ndryshojë propozimin në çdo moment gjatë procedurës së ndjekur për miratimin e aktit të Bashkimit.

Neni 294
(ish-neni 251 TKE)

1. Kur në Traktatet përmendet procedura e zakonshme legjislative për miratimin e një akti, do të ndiqet procedura e mëposhtme.

2. Komisioni i paraqet një propozim Parlamentit Europian dhe Këshillit.

Leximi i parë

3. Parlamenti Europian miraton një qëndrim pas leximit të parë, të cilin ia komunikon Këshillit.

4. Nëse Këshilli e aprovon qëndrimin e Parlamentit Europian, akti në fjalë miratohet sipas formulimit që i korrespondon qëndrimit të Parlamentit Europian.

5. Nëse Këshilli nuk e aprovon qëndrimin e Parlamentit Europian, ai miraton qëndrimin e vet në leximin e parë dhe ia komunikon atë Parlamentit Europian.

6. Këshilli e informon Parlamentin Europian plotësisht lidhur me arsyet që e kanë detyruar të miratojë qëndrimin e vet në leximin e parë. Komisioni e informon Parlamentin Europian plotësisht për qëndrimin e tij.

Shqyrtimi i dytë

7. Nëse brenda tre muajve pas këtij komunikimi, Parlamenti Europian:

(a) e aprovon qëndrimin e Këshillit në leximin e parë ose nuk merr asnjë vendim, akti në fjalë konsiderohet si i miratuar me formulimin që i korrespondon qëndrimit të Këshillit;

(b) e hedh poshtë me shumicën e deputetëve që e përbëjnë qëndrimin e Këshillit në leximin e parë, akti i propozuar konsiderohet se nuk është miratuar;

(c) propozon me shumicën e deputetëve që e përbëjnë shtesa dhe ndryshime në qëndrimin e Këshillit në leximin e parë, teksti me shtesat dhe ndryshimet i përcillet Këshillit dhe Komisionit, të cilët japin një opinion për këto shtesa dhe ndryshime.

8. Nëse brenda tre muajve pas marrjes së shtesave dhe ndryshimeve nga Parlamenti Europian, Këshilli, me shumicë të cilësuar:

(a) i aprovon të gjitha shtesat dhe ndryshimet, akti në fjalë konsiderohet si i miratuar;

(b) nuk i aprovon të gjitha shtesat dhe ndryshimet, Presidenti i Këshilli, në marrëveshje me Presidentin e Parlamenti Europian, brenda gjashtë javëve thërret një mbledhje të Komitetit të Pajtimit.

9. Këshilli vendos me unanimitet për shtesat dhe ndryshimet për të cilat Komisioni ka dhënë opinion negativ.

Pajtimi

10. Komiteti i Pajtimit, i cili përbëhet nga anëtarët e Këshillit ose përfaqësuesit e tyre dhe nga një numër i barabartë deputetësh të Parlamentit Europian, ka për detyrë të arrijë një marrëveshje për një tekst të përbashkët, me shumicën e cilësuar të anëtarëve të Këshillit ose përfaqësuesve të tyre dhe me shumicën e deputetëve që përfaqësojnë Parlamentin Europian, brenda gjashtë javëve pasi thirret mbledhja e tij, mbështetur në qëndrimet e Parlamentit Europian dhe të Këshillit në leximin e dytë.

11. Komisioni merr pjesë në punimet e Komitetit të Pajtimit dhe merr të gjitha nismat e nevojshme me qëllim pajtimin e qëndrimeve të Parlamentit Europian dhe Këshillit.

12. Nëse, brenda gjashtë javëve pasi thirret mbledhja e tij, Komiteti i Pajtimit nuk e aprovon tekstin e përbashkët, akti i propozuar konsiderohet i pamiratuar.

Leximi i tretë

13. Nëse brenda kësaj periudhe, Komiteti i Pajtimit aprovon një tekst të përbashkët, Parlamenti Europian me shumicën e votave të hedhura, dhe Këshilli me shumicë të cilësuar, ka secili një periudhë gjashtë javore nga data e aprovimit, brenda së cilës mund ta miratojnë aktin në fjalë në përputhje me tekstin e përbashkët. Nëse nuk e arrijnë këtë, akti i propozuar konsiderohet se nuk është miratuar.

14. Periudhat tremujore dhe gjashtë javore të përmendura në këtë nen mund të zgjaten me një periudhë maksimumi, përkatësisht një muaj dhe dy javë, me nismën e Parlamentit Europian ose të Këshillit.

Dispozita të posaçme

15. Paragrafi 2, fjalia e dytë e paragrafit 6 dhe paragrafi 9 nuk zbatohen kur, në rastet e parashikuara në Traktatet, një akt legjislativ paraqitet sipas procedurës së zakonshme legjislative me nismën e një grupi Shtetesh Anëtare, me rekomandimin e Bankës Qendrore Europiane ose me kërkesën e Gjykatës së Drejtësisë.

Në këto raste, Parlamenti Europian dhe Këshilli ia komunikojnë aktin e propozuar Komisionit, së bashku me qëndrimet e tyre në leximin e parë dhe të dytë. Parlamenti Europian ose Këshilli mund të kërkojnë opinionin e Komisionit gjatë gjithë procedurës, opinion të cilin Komisioni mund ta japë edhe kryesisht. Komisioni, nëse e gjykon të nevojshme, mund të marrë pjesë edhe në Komitetin e Pajtimit, në përputhje me paragrafin 11.

Neni 295

Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin dhe me marrëveshje të përbashkët marrin masat organizative për bashkëpunimin mes tyre. Për këtë qëllim, në zbatim të Traktateve ata mund të lidhin marrëveshje ndërinstitucionale të cilat mund të kenë natyrë detyruese.

Neni 296
(ish-neni 253 TKE)

Kur Traktatet nuk e përcaktojnë llojin e aktit që duhet miratuar, institucionet e përzgjedhin llojin rast pas rasti, në përputhje me procedurat e zbatueshme dhe me parimin e proporcionalitetit.

Aktet juridike japin arsyet mbi të cilat mbështeten dhe përmendin çdo propozim, nismë, rekomandim, kërkesë apo opinion që kërkojnë Traktatet.

Gjatë shqyrtimit të projekt akteve legjislative, Parlamenti Europian dhe Këshilli nuk i miratojnë ato akte të cilat nuk parashikohen nga procedura përkatëse legjislative në fushën në fjalë.

Neni 297
(ish-neni 254 TKE)

1. Aktet legjislative të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative nënshkruhen nga Kryetari i Parlamentit Europian dhe nga Presidenti i Këshillit.

Aktet legjislative të miratuara sipas një procedure të posaçme legjislative nënshkruhen nga Titullari i institucionit që i miraton.

Aktet legjislative botohen në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian*. Ato hyjnë në fuqi më datën e përcaktuar në tekstin e tyre ose, në mungesë të këtij parashikimi, njëzet ditë pas botimit të tyre.

2. Aktet jo legjislative të miratuara në formën e rregulloreve, direktivave ose vendimeve, kur nuk e përcaktojnë se cilit i drejtohen, nënshkruhen nga Titullari i institucionit që i miraton.
Rregulloret dhe direktivat që u drejtohen të gjitha Shteteve Anëtare, si edhe vendimet që nuk e përcaktojnë se cilëve u drejtohen, botohen në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian*. Ato hyjnë në fuqi më datën e përcaktuar në tekstin e tyre ose, në mungesë të këtij parashikimi, njëzet ditë pas botimit të tyre.

Direktivat e tjera dhe vendimet që e përcaktojnë se cilëve u drejtohen u njoftohen atyre të cilëve u drejtohen dhe hyjnë në fuqi në momentin e njoftimit.

Neni 298

1. Gjatë përmbushjes së misionit të tyre, institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit marrin mbështetjen e një administrate të hapur, efektive dhe të pavarur europiane.

2. Në respektim të Rregulloreve të Personelit dhe Kushteve të Marrëdhënieve të Punës të miratuara në mbështetje të nenit 336, Parlamenti Europian miraton dispozita për këtë qëllim, përmes rregulloreve të nxjerra sipas procedurës së zakonshme legjislative.

Neni 299
(ish-neni 256 TKE)

Aktet e Këshillit, Komisionit ose Bankës Qendrore Europiane të cilat vendosin një detyrim monetar mbi persona që nuk janë Shtete, janë akte të detyrueshme.

Ekzekutimi i tyre rregullohet nga normat e procedurës civile në fuqi në Shtetin në territorin e të cilit realizohet ky ekzekutim. Urdhri i ekzekutimit i bashkëlidhet vendimit, pa formalitete të tjera përveç verifikimit të vërtetësisë së vendimit, e bërë nga autoriteti kombëtar të cilin qeveria e çdo Shteti Anëtar e ka caktuar për këtë qëllim, dhe i njoftohet Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Kur këto formalitete janë përfunduar me kërkesën e palës së interesuar, kjo e fundit mund të kryejë procedurat e ekzekutimit në përputhje me legjislacionin kombëtar, duke paraqitur kërkesë drejtpërsëdrejti përpara autoritet kompetent.

Ekzekutimi mund të pezullohet vetëm me vendim të Gjykatës. Megjithatë, gjykatat e vendit të interesuar kanë kompetenca mbi ankesat për parregullsi të ekzekutimit.

KREU 3

ORGANET KËSHILLIMORE TË BASHKIMIT

Neni 300

1. Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni mbështeten nga një Komiteti Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve, të cilët ushtrojnë funksione këshillimore.

2. Komiteti Ekonomik dhe Social përbëhet nga përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, të punëmarrësve dhe të palëve të tjera përfaqësuese të shoqërisë civile, sidomos nga fushat shoqëroro-ekonomike, qytetare, profesionale dhe kulturore.

3. Komiteti i Rajoneve përbëhet nga përfaqësues të organeve rajonale dhe vendore të cilët kanë mandat pushteti rajonal ose vendor të marrë përmes zgjedhjeve ose që japin llogari politikisht përpara një kuvendi të zgjedhur.

4. Anëtarët e Komitetit Ekonomik dhe Social dhe të Komitetit të Rajoneve nuk janë të detyruar të ndjekin asnjë udhëzim të detyrueshëm. Ata janë tërësisht të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre, në interesin e përgjithshëm të Bashkimit.

5. Rregullat e përmendura në paragrafët 2 dhe 3 që rregullojnë natyrën e përbërjes së Komiteteve shqyrtohen me intervale të rregullta nga Këshilli në mënyrë që merren në konsideratë zhvillimet ekonomike, shoqërore dhe ekonomike brenda Bashkimit. Këshilli miraton vendimet për këtë qëllim, me propozim të Komisionit.

SEKSIONI 1

KOMITETI EKONOMIK DHE SOCIAL

Neni 301
(ish-neni 258 TKE)

Komiteti Ekonomik dhe Social ka jo më shumë se 350 anëtarë.

Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton me unanimitet një vendim ku caktohet përbërja e Komitetit.

Këshilli përcakton shpenzimet e lejuara të anëtarëve të Komitetit.

Neni 302
(ish-neni 259 TKE)

1. Anëtarët e Komitetit emërohen për një mandat pesëvjeçar. Këshilli, pasi konsultohet me Parlamentin Europian, miraton listën e anëtarëve të hartuar në përputhje me propozimet që bën secili Shtet Anëtar. Mandati i Anëtarëve të Komitetit ripërtërihet.

2. Këshilli vendos pasi konsultohet me Parlamentin Europian. Ai mund të marrë mendimin e organeve europiane që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe shoqërorë dhe shoqërinë civile që janë të interesuara për aktivitetet e Bashkimit.

Neni 303
(ish-neni 260 TKE)

Komiteti zgjedh kryetarin dhe nëpunësit e tij, mes anëtarëve të vet për një mandat dy vjet e gjysmë.

Ai miraton Rregulloren e Brendshme të tij.

Mbledhja e Komitetit thirret nga kryetari i tij me kërkesë të Parlamentit Europian, Këshillit ose Komisionit. Ai mund mblidhet edhe me nismën e vet.

Neni 304
(ish-neni 262 TKE)

Komiteti konsultohet nga Parlamenti Europian, Këshilli ose Komisioni në rastet kur parashikohet nga Traktatet. Komiteti mund të konsultohet nga këto institucione edhe në të gjitha rastet kur ato e gjykojnë të përshtatshme. Ai mund të japë një opinion me nismën e vet në rastet në të cilat e gjykon të përshtatshme.

Parlamenti Europian, Këshilli ose Komisioni, nëse e gjykon të nevojshme, i vendosin afat Komitetit për paraqitjen e opinionit të tij, i cili nuk mund të jetë më pak se një muaj nga data kur për këtë njoftohet kryetari. Pas kalimit të afatit, mungesa e opinionit nuk pengon kryerjen e veprimeve të mëtejshme.

Opinioni i Komitetit, së bashku me procesverbalin e punimeve, i përcillet Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit.

SEKSIONI 2

KOMITETI I RAJONEVE

Neni 305
(ish-neni 263, paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt, TKE)

Komiteti i Rajoneve ka jo më shumë se 350 anëtarë.

Me propozim të Komisionit, Këshilli miraton unanimisht një vendim ku caktohet përbërja e Komitetit.

Anëtarët e Komitetit dhe një numër i barabartë anëtarësh zëvendësues emërohen për një mandat pesëvjeçar. Mandati i tyre është i përsëritshëm. Këshilli miraton listën e anëtarëve dhe të anëtarëve zëvendësues të hartuar në përputhje me propozimet që bën secili Shtet Anëtar. Kur mbaron mandati i përmendur në nenin 300(3) mbi bazën e të cilit janë propozuar, mandati i anëtarëve të Komitetit përfundon automatikisht dhe ata zëvendësohen për pjesën e mbetur të mandatit të tyre sipas së njëjtës procedurë. Asnjë anëtar i Komitetit nuk mund të jetë në të njëjtën kohë deputet i Parlamentit Europian

Neni 306
(ish-neni 264 TKE)

Komiteti i Rajoneve zgjedh kryetarin dhe nëpunësit e tij mes anëtarëve të vet për një mandat dy vjet e gjysmë.

Ai miraton Rregulloren e Brendshme të tij.

Mbledhja e Komitetit thirret nga kryetari i tij me kërkesë të Parlamentit Europian, Këshillit ose Komisionit. Ai mund mblidhet edhe me nismën e vet.

Neni 307
(ish-neni 265 TKE)

Komiteti i Rajoneve konsultohet nga Parlamenti Europian, Këshilli ose Komisioni në rastet kur parashikohet nga Traktatet dhe në të gjitha rastet e tjera, sidomos në ato që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkufitar, në të cilat e gjykon të përshtatshme njëri prej institucioneve.

Parlamenti Europian, Këshilli ose Komisioni, nëse e gjykojnë të nevojshme, i vendosin afat Komitetit për paraqitjen e opinionit të tij, i cili nuk mund të jetë më pak se një muaj nga data kur për këtë njoftohet kryetari. Pas kalimit të afatit, mungesa e opinionit nuk pengon kryerjen e veprimeve të mëtejshme.

Kur konsultohet Komitetit Ekonomik dhe Social sipas nenit 304, Komiteti i Rajoneve informohet nga Parlamenti Europian, Këshilli ose Komisioni lidhur me kërkesën për opinion. Kur Komiteti i Rajoneve është i mendimit se preken interesa të caktuara rajonale, ai mund të japë një opinion për çështjen.

Ai mund të japë një opinion me nismën e vet në rastet në të cilat e gjykon të përshtatshme.

Opinioni i Komitetit, së bashku me procesverbalin e punimeve, i përcillet Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit.

KREU 4

BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE

Neni 308
(ish-neni 266 TKE)

Banka Europiane e Investimeve ka personalitet juridik.

Anëtarët e Bankës Europiane të Investimeve janë Shtetet Anëtare.

Statuti i Bankës Europiane të Investimeve përcaktohet në një Protokoll që u bashkëlidhet Traktateve. Këshilli mund ta ndryshojë Statutin e Bankës me unanimitet, sipas një procedure të posaçme legjislative, me kërkesë të Bankës Europiane të Investimeve dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Komisionin, ose me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Bankën Europiane të Investimeve.

Neni 309
(ish-neni 267 TKE)

Banka Europiane e Investimeve ka për detyrë të kontribuojë përmes përdorimit të tregut të kapitalit dhe të burimeve të veta, në zhvillimin e drejtpeshuar dhe të qëndrueshëm të tregut të brendshëm në interes të Bashkimit. Për këtë qëllim, duke ushtruar aktivitet jofitimprurës, Banka jep hua dhe lëshon dorëzani të cilat mundësojnë financimin e projekteve të mëposhtme në të gjithë sektorët e ekonomisë:

(a) projektet për zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluara;

(b) projektet për modernizimin ose shndërrimin e ndërmarrjeve ose për zhvillimin e aktiviteteve të reja të cilat i kërkon krijimi ose funksionimi i tregut të brendshëm, në ato raste kur këto projekte janë të një madhësie ose natyre të tillë që nuk mund të financohen tërësisht përmes mjeteve të ndryshme që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të veçanta;

(c) projektet me interes të përbashkët për disa Shtete Anëtare të cilat janë të një madhësie ose natyre të tillë që nuk mund të financohen tërësisht përmes mjeteve të ndryshme që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të veçanta.

Gjatë kryerjes së detyrës së saj, Banka mundëson financimin e programeve të investimeve paralelisht me mbështetjen që vjen nga Fondet Strukturore dhe Instrumentet e tjera Financiare të Bashkimit.

TITULLI II

DISPOZITA FINANCIARE

Neni 310
(ish-neni 268 TKE)

1. Të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkimit përfshihen në vlerësimet e hartuara për secilin vit financiar dhe paraqiten në buxhet.

Buxheti vjetor i Bashkimit vendoset nga Parlamenti Europian dhe Këshilli në përputhje me nenin 314.

Të ardhurat dhe shpenzimet që paraqiten në buxhet duhet të rakordojnë.

2. Shpenzimet e paraqitura në buxhet autorizohen për periudhën buxhetore vjetore në përputhje me rregulloren e përmendur në nenin 322.

3. Realizimi i shpenzimeve të paraqitura në buxhet kërkon miratimin paraprak të një akti me fuqi ligjore detyruese të Bashkimit në të cilin jepet baza ligjore për veprim dhe për realizimin e shpenzimit përkatës në përputhje me rregulloren e përmendur në nenin 322, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

4. Me qëllim ruajtjen e disiplinës buxhetore, Bashkimi nuk miraton asnjë akt i cili ka të ngjarë të ketë rrjedhoja të konsiderueshme për buxhetin pa marrë një garanci se shpenzimi i lindur nga ky akt mund të financohet brenda kufijve të burimeve të veta të Bashkimit dhe se është në përputhje me kuadrin financiar shumëvjeçar të përmendur në nenin 312.

5. Buxheti zbatohet në përputhje me parimin e drejtimit të shëndoshë financiar. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me Bashkimin për të siguruar që fondet e miratuara në buxhet të përdoren në bazë të këtij parimi.

6. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, në përputhje me nenin 325, luftojnë krimin ekonomik dhe aktivitetet e tjera të paligjshme që prekin interesat financiare të Bashkimit.

KREU 1

BURIMET E VETA TË BASHKIMIT

Neni 311
(ish-neni 269 TKE)

Bashkimi i siguron vetes mjetet e nevojshme për arritjen e objektivave të tij si dhe realizimin e politikave të tij.

Pa cenuar të ardhurat e tjera, buxheti financohet tërësisht me burime të veta.

Këshilli, duke vepruar sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, miraton unanimisht një vendim ku përcaktohen dispozitat që lidhen me sistemin e burimeve të veta të Bashkimit. Në këtë kuadër, ai mund të krijojë kategori të reja burimesh të veta ose të heqë kategori ekzistuese. Ky vendim nuk hyn në fuqi derisa të miratohet nga Shtetet Anëtare, sipas kërkesave kushtetuese përkatëse të tyre.

Këshilli, përmes rregulloreve sipas një procedure të posaçme legjislative, vendos masat zbatuese për sistemin e burimeve të veta të Bashkimit për aq sa parashikohet në vendimin e miratuar në bazë të paragrafit të tretë. Këshilli vepron pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian.

KREU 2

KUADRI FINANCIAR SHUMËVJEÇAR

Neni 312

1. Kuadri financiar shumëvjeçar siguron që shpenzimet e Bashkimit të zhvillohen në mënyrë të rregullt dhe brenda kufijve të burimeve të veta. Kuadri vendoset për një periudhë të paktën pesëvjeçare.

Buxheti vjetor i Bashkimit respekton kuadrin financiar shumëvjeçar.

2. Këshilli miraton një rregullore sipas një procedure të posaçme legjislative, në të cilën përcakton kuadrin financiar shumëvjeçar. Këshilli vendos me unanimitet, pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, i cili jepet me shumicën e deputetëve që e përbëjnë.

Këshilli Europian mund të miratojë unanimisht një vendim përmes të cilit e autorizon Këshillin të veprojë me shumicë të cilësuar kur miraton rregulloren e përmendur në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi.

3. Kuadri financiar përcakton vlerat e tavaneve vjetore për angazhimet e miratuara sipas kategorive të shpenzimeve dhe të tavanit vjetor të fondeve të miratuara për pagesat. Kategoritë e shpenzimeve, të kufizuara në numër, korrespondojnë me sektorët kryesorë të aktivitetit të Bashkimit.

Kuadri financiar përcakton çdo dispozitë tjetër që nevojitet për zhvillimin pa probleme të procedurës buxhetore vjetore.

4. Kur brenda përfundimit të kuadrit të fundit financiar nuk është miratuar asnjë rregullore e Këshillit në të cilin përcaktohet kuadri financiar, zbatohen tavanet dhe dispozitat e tjera që i përkasin vitit të fundit të atij kuadri deri në momentin e miratimit të aktit të lartpërmendur.

5. Gjatë gjithë procedurës deri në miratimin e kuadrit financiar, Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni marrin masat e nevojshme për mundësimin e miratimit të tij.

KREU 3

BUXHETI VJETOR I BASHKIMIT

Neni 313
(ish-neni 272(1), TKE)

Viti financiar është nga data 1 janar deri më 31 dhjetor.

Neni 314
(ish-neni 272(2) deri në (10), TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli përcaktojnë buxhetin vjetor të Bashkimit sipas një procedure të posaçme legjislative, në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

1. Me përjashtim të Bankës Qendrore Europiane, secili institucion vlerëson shpenzimet e veta për vitin e ardhshëm financiar, brenda datës 1 korrik. Komisioni e pasqyron këtë vlerësim në projektbuxhet, duke pasur të drejtë ti bëjë edhe korrigjime.

Projektbuxheti përmban vlerësimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2. Komisioni i paraqet Parlamentit Europian dhe Këshillit një propozim me projektbuxhetin, jo më vonë se data 1 shtator e vitit të fundit përpara vitit në të cilin do të zbatohet buxheti.

Komisioni mund ta ndryshojë projektbuxhetin gjatë procedurës së miratimit, deri në thirrjen e mbledhjes së Komitetit të Pajtimit, të përmendur në paragrafin 5.

3. Këshilli e miraton qëndrimin e tij për projektbuxhetin dhe ia përcjell Parlamentit Europian, jo më vonë se data 1 tetor e vitit të fundit përpara vitit në të cilin do të zbatohet buxheti. Këshilli e informon Parlamenti Europian plotësisht lidhur me arsyet që e kanë detyruar të miratojë qëndrimin e vet.

4. Nëse brenda dyzet e dy ditëve pas këtij komunikimi, Parlamenti Europian:

(a) e miraton qëndrimin e Këshillit, buxheti miratohet;

(b) nuk ka marrë vendim, buxheti konsiderohet si i miratuar;

(c) i miraton shtesat dhe ndryshimet me shumicën e deputetëve që e përbëjnë, projekti me shtesat dhe ndryshimet i përcillet Këshillit dhe Komisionit. Presidenti i Parlamentit Europian, në marrëveshje me Presidentin e Këshillit, thërret menjëherë një mbledhje të Komitetit të Pajtimit. Megjithatë, nëse brenda dhjetë ditësh pasi përcillet projekti Këshilli informon Parlamentin Europian se i ka aprovuar të gjitha shtesat dhe ndryshimet e tij, Komiteti i Pajtimit nuk mblidhet.

5. Komiteti i Pajtimit, i cili përbëhet nga anëtarët e Këshillit ose përfaqësuesit e tyre dhe nga një numër i barabartë deputetësh të Parlamentit Europian, ka për detyrë të arrijë një marrëveshje për një tekst të përbashkët, me shumicën e cilësuar të anëtarëve të Këshillit ose përfaqësuesve të tyre dhe me shumicën e deputetëve që përfaqësojnë Parlamentit Europian, brenda njëzetenjë ditëve pasi thirret mbledhja e tij, mbështetur në qëndrimet e Parlamentit Europian dhe të Këshillit në leximin e dytë. Komisioni merr pjesë në punimet e Komitetit të Pajtimit dhe merr të gjitha nismat e nevojshme me qëllim pajtimin e qëndrimeve të Parlamentit Europian dhe Këshillit.

6. Nëse, brenda njëzetenjë ditëve të përmendura në paragrafin 5, Komiteti i Pajtimit bie dakord për një tekst të përbashkët, Parlamenti Europian dhe Këshilli kanë secili nga një periudhë katërmbëdhjetë ditore për ta aprovuar tekstin e përbashkët, duke filluar nga data kur është rënë dakord.

7. Nëse, brenda afatit katërmbëdhjetë ditor të përmendur në paragrafin 6:

(a) Parlamenti Europian dhe Këshilli e aprovojnë tekstin e përbashkët ose nuk marrin asnjë vendim, ose nëse njëri prej këtyre institucioneve e aprovon tekstin e përbashkët ndërsa tjetri nuk merr asnjë vendim, buxheti konsiderohet si i miratuar përfundimisht sipas tekstit të përbashkët; ose

(b) Parlamenti Europian, me shumicën e deputetëve që e përbëjnë, dhe Këshilli e hedhin poshtë tekstin e përbashkët, ose nëse njëri prej këtyre institucioneve e hedh poshtë tekstin e përbashkët ndërsa tjetri nuk merr asnjë vendim, Komisioni paraqet një projektbuxhet të ri; ose

(c) Parlamenti Europian, me shumicën e deputetëve që e përbëjnë, e hedh poshtë tekstin e përbashkët ndërsa Këshilli e aprovon atë, Komisioni paraqet një projektbuxhet të ri; ose

(d) Parlamenti Europian, me shumicën e deputetëve që e përbëjnë e aprovon tekstin e përbashkët, ndërsa Këshilli e hedh poshtë atë, Parlamenti Europian, brenda katërmbëdhjetë ditëve nga data e hedhjes poshtë nga Këshilli, me shumicën e deputetëve që e përbëjnë dhe me tri të katërtat e votave të hedhura, vendos të konfirmojë të gjitha ose disa prej shtesave dhe ndryshimeve të përmendura në paragrafin 4(c). Kur një shtesë apo ndryshim i Parlamentit Europian nuk konfirmohet, mbahet qëndrimi i miratuar nga Komiteti i Pajtimit lidhur me zërin e buxhetit që është objekt i shtesës apo i ndryshimit. Buxheti konsiderohet si i miratuar përfundimisht mbi këtë bazë.

8. Nëse brenda njëzetenjë ditëve të përmendura në paragrafin 5 Komiteti i Pajtimit nuk bie dakord për një tekst të përbashkët, Komisioni paraqet një projektbuxhet të ri.

9. Kur ka përfunduar procedura e përmendur në këtë nen, Kryetari i Parlamentit Europian shpall se buxheti është miratuar përfundimisht.

10. Secili institucion ushtron kompetencat që ua jep ky nen në përputhje me Traktatet dhe aktet e miratuara në mbështetje të tyre, sidomos lidhur me burimet e veta të Bashkimit dhe rakordimin midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

Neni 315
(ish-neni 273 TKE)

Nëse në fillim të një viti financiar, buxheti nuk është miratuar ende përfundimisht, një shumë e barasvlefshme me jo më shumë se një të dymbëdhjetën e fondeve të miratuara në buxhet për vitin e fundit financiar mund të shpenzohet çdo muaj në lidhje me çdo kapitull të buxhetit në përputhje me dispozitat e Rregulloreve të miratuara në mbështetje të nenit 322. Megjithatë, kjo shumë nuk duhet të jetë më e madhe se një e dymbëdhjeta e fondeve të parashikuara në të njëjtin kapitull të projektbuxhetit.

Nëse janë plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara në paragrafin e parë, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të autorizojë shpenzime që e kalojnë një të dymbëdhjetën në përputhje me rregulloret e miratuara në mbështetje të nenit 322. Këshilli ia përcjell menjëherë vendimin Parlamentit Europian.

Vendimi i përmendur në paragrafin e dytë përcakton masat e nevojshme në lidhje me burimet për të siguruar zbatimin e këtij neni, në përputhje me aktet e përmendura në nenin 311.

Ai hyn në fuqi tridhjetë ditë pas miratimit të tij, nëse Parlamenti Europian me shumicën e deputetëve që e përbëjnë nuk ka vendosur të ulë shpenzimin brenda këtij afati.

Neni 316
(ish-neni 271 TKE)

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në mbështetje të nenit 322, çdo fond i miratuar, përveç atyre që kanë të bëjnë me shpenzimet për personelin, të cilat nuk janë shpenzuar ende deri në mbyllje të vitit financiar, mund të mbarten vetëm në vitin e ardhshëm financiar.

Fondet e miratuara në buxhet klasifikohen në kapituj të ndryshëm, duke i grupuar zërat e shpenzimeve sipas natyrës ose qëllimit të tyre dhe duke i ndarë më tej në përputhje me rregulloret e hartuara në mbështetje të nenit 322.

Shpenzimet e Parlamentit Europian, Këshillit Europian dhe Këshillit, Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian parashikohen në pjesë të veçanta të buxhetit, pa cenuar masat e posaçme organizative për disa zëra të përbashkët të shpenzimeve.

KREU 4

ZBATIMI I BUXHETIT DHE APROVIMI I REALIZIMIT

Neni 317
(ish-neni 274 TKE)

Komisioni e zbaton buxhetin në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, në përputhje me dispozitat e rregulloreve të nxjerra në mbështetje të nenit 322, nën përgjegjësinë e tij dhe brenda kufijve të fondeve të miratuara, duke u kushtuar vëmendje parimeve të drejtimit të shëndoshë financiar. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me Komisionin për të siguruar që fondet e miratuara në buxhet të përdoren në bazë të parimeve të drejtimit të shëndoshë financiar.

Rregulloret përcaktojnë detyrime të kontrollit dhe auditimit për Shtetet Anëtare në kuadër të zbatimit të buxhetit, si dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tyre. Ato përcaktojnë edhe përgjegjësitë dhe rregullat e hollësishme për secilin institucion lidhur me pjesën e tij për realizimin e shpenzimeve të veta.

Brenda buxhetit, Komisioni, në varësi të kufijve dhe kushteve të përcaktuara në rregulloret e nxjerra në mbështetje të nenit 322, mund t'i kalojë fondet e miratuara nga njëri kapitull në një tjetër ose nga njëra nënndarje në një tjetër.

Neni 318
(ish-neni 275 TKE)

Komisioni i paraqet çdo vit Parlamentit Europian dhe Këshillit llogaritë e vitit të fundit financiar lidhur me zbatimin e buxhetit. Komisioni u përcjell edhe një pasqyrë financiare të aktiveve dhe pasiveve të Bashkimit.

Komisioni i paraqet Parlamentit Europian dhe Këshillit edhe një relacion vlerësimi për financat e Bashkimit mbështetur në rezultatet e arritura, në veçanti në lidhje me udhëzimet që ka dhënë Parlamenti Europian dhe Këshilli në mbështetje të nenit 319.

Neni 319
(ish-neni 276 TKE)

1. Parlamenti Europian, me rekomandim të Këshillit, i jep aprovimin Komisionit lidhur me zbatimin e buxhetit. Për këtë qëllim, Këshilli dhe Parlamenti Europian i shqyrtojnë me radhë llogaritë, pasqyrën financiare dhe relacionin e vlerësimit të përmendur në nenin 318, raportin vjetor të Gjykatës së Audituesve së bashku me përgjigjet e institucioneve të audituara për vërejtjet e Gjykatës së Audituesve, deklaratën e garancisë të përmendur në nenin 287(1), nënparagrafi i dytë si dhe çdo raport tjetër përkatës të nxjerrë nga Gjykata e Audituesve.

2. Përpara se t'i japë Komisionit aprovimin për realizimin e buxhetit, ose për çdo qëllim tjetër ne lidhje me ushtrimin e kompetencave të tij për zbatimin e buxhetit, Parlamenti Europian mund të kërkojë që Komisioni në një seancë dëgjimore të japë informacion lidhur me realizimin

e shpenzimeve apo me shfrytëzimin e sistemeve të kontrollit financiar. Komisioni i paraqet Parlamentit Europian çdo informacion të nevojshëm që është kërkuar prej tij.

3. Komisioni bën të gjithë hapat e duhur për të vepruar lidhur me vërejtjet e përfshira në vendimet që japin aprovimin për realizimin e buxhetit dhe lidhur me vërejtjet e tjera të Parlamentit Europian që i përkasin realizimit të shpenzimeve, si dhe lidhur me komentet që shoqërojnë rekomandimet për aprovimin e realizimit të buxhetit të miratuara nga Këshilli.

Me kërkesë të Parlamentit Europian ose të Këshillit, Komisioni raporton për masat e marra në kuadër të këtyre vërejtjeve dhe komenteve dhe në veçanti për udhëzimet që u janë dhënë departamenteve përgjegjëse për zbatimin e buxhetit. Këto raporte i përcillen edhe Gjykatës së Adituesve.

KREU 5

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 320
(ish-neni 277 TKE)

Kuadri financiar shumëvjeçar dhe buxheti vjetor hartohen në euro.

Neni 321
(ish-neni 278 TKE)

Komisioni, me kusht që të njoftojë autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në fjalë, mund t'i kalojë në monedhën e njërit të Shteteve Anëtare shumat në monedhën e një Shteti tjetër Anëtar, për aq sa është e nevojshme t'u japë mundësi atyre të përdoren për qëllime që bien brenda fushës së veprimit të Traktateve. Komisioni eviton sa më shumë kryerjen e kalimeve të tilla, nëse ka mjete monetare ose aktive likuide në monedhat që i nevojiten.

Komisioni punon me secilin Shtet Anëtar përmes autoritetit të caktuar nga Shteti në fjalë. Gjatë kryerjes së operacioneve financiare Komisioni përdor shërbimet e bankës që emeton monedhën e Shtetit Anëtar në fjalë ose shërbimet e çdo institucioni tjetër financiar të aprovuar nga ai Shtet.

Neni 322
(ish-neni 279 TKE)

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative e pasi konsultohen me Gjykatën e Adituesve, miratojnë përmes rregulloreve:

(a) rregullat financiare që përcaktojnë në veçanti procedurën që duhet miratuar për vendosjen dhe zbatimin e buxhetit dhe për paraqitjen dhe auditimin e llogarive;

(b) rregullat që parashikojnë kontrollet mbi përgjegjësinë e aktorëve financiarë, në veçanti të nëpunësve autorizues dhe të nëpunësve kontabël.

2. Me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian dhe Gjykatën e Audituesve, Këshilli përcakton mënyrën dhe procedurën përmes së cilave të ardhurat buxhetore të parashikuara në kuadër të masave organizative që lidhen me burimet e veta të Bashkimit vendosen në dispozicion të Komisionit si dhe përcakton masat që duhen zbatuar, nëse është nevoja, për të përmbushur kërkesat për mjete monetare në formë keshi.

Neni 323

Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni kujdesen që të ekzistojnë mjetet financiare për t'i dhënë mundësi Bashkimit të përmbushë detyrimet e tij ligjore kundrejt të tretëve.

Neni 324

Në kuadër të procedurave buxhetore të përmendura në këtë Titull, me nismën e Komisionit thirren mbledhje të rregullta midis Kryetarit të Parlamentit Europian, Presidentit të Këshillit dhe Presidentit të Komisionit. Këta bëjnë të gjithë hapat e nevojshëm për të promovuar konsultimin dhe rakordimin e qëndrimeve të institucioneve që drejtojnë, në mënyrë që të mundësojnë zbatimin e këtij Titulli.

KREU 6

LUFTA KUNDËR KRIMIT EKONOMIK

Neni 325
(ish-neni 280 TKE)

1. Bashkimi dhe Shtetet Anëtare luftojnë krimin ekonomik dhe çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat e Bashkimit, përmes masave që duhen marrë në përputhje me këtë nen, të cilat veprojnë si frenues dhe janë të tilla që ofrojnë mbrojtje efektive në Shtetet Anëtare dhe në të gjitha institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit.

2. Shtetet Anëtare marrin të njëjtat masa si për të luftuar krimin ekonomik që prek interesat financiare të Bashkimit, si për të luftuar krimin ekonomik që prek interesat e tyre financiare.

3. Pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve, Shtetet Anëtare i bashkërendojnë veprimet e tyre që kanë si qëllim mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit nga krimi ekonomik. Për këtë qëllim, së bashku me Komisionin, ato organizojnë një bashkëpunim të ngushtë dhe të rregullt midis autoriteteve kompetente.

4. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, pasi konsultohen me Gjykatën e Audituesve, miratojnë masat e nevojshme në fushat e parandalimit dhe luftimit të krimit ekonomik që prek interesat financiare të Bashkimit me qëllim ofrimin e një mbrojtjeje të efektshme dhe të barasvlefshme në Shtetet Anëtare dhe në të gjitha institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit.

5. Komisioni në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, çdo vit i paraqet Parlamentit Europian dhe Këshillit një raport për masat e marra për zbatimin e këtij neni.

TITULLI III

BASHKËPUNIMI I PËRFORCUAR

Neni 326
(ish-nenet 27a deri në 27e, 40 deri në 40b dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11a TKE)

Çdo bashkëpunimi përforcuar respekton Traktatet dhe legjislacionin e Bashkimit.

Një bashkëpunim i tillë nuk duhet të cenojë tregun e brendshëm apo kohezionin ekonomik, social dhe territorial. Ai nuk duhet të përbëjë pengesë ose diskriminim në tregtinë midis Shteteve Anëtare dhe nuk duhet ta shtrembërojë konkurrencën mes tyre.

Neni 327
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

Çdo bashkëpunimi përforcuar respekton kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare që nuk marrin pjesë në të. Këto Shtete Anëtare nuk duhet ta pengojnë zbatimin e tij nga Shtetet Anëtare pjesëmarrëse.

Neni 328
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

1. Kur vendoset bashkëpunimi i përforcuar, ai është i hapur për të gjitha Shtetet Anëtare, në varësi të përmbushjes së kushteve të pjesëmarrjes të përcaktuara në vendimin autorizues. Ai është i hapur për këto shtete në çdo kohë, në varësi të respektimit të akteve të miratuara brenda kuadrit të tij, krahas kushteve.

Komisioni dhe Shtetet Anëtare që marrin pjesë në bashkëpunimin e përforcuar kujdesen që të nxisin pjesëmarrjen e sa më shumë Shteteve Anëtare.

2. Komisioni dhe, kur është rasti, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë e informojnë rregullisht Parlamentin Europian lidhur me zhvillimet në bashkëpunimin e përforcuar.

Neni 329
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

1. Shtetet Anëtare që dëshirojnë të vendosin bashkëpunim të përforcuar mes tyre në njërën prej fushave që mbulojnë Traktatet, me përjashtim të fushave të kompetencës ekskluzive dhe të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, i drejtohen me një kërkesë Komisionit, ku përcaktojnë fushën e veprimit dhe objektivat e bashkëpunimit të përforcuar të propozuar. Komisioni

mund t'i paraqesë një propozim për këtë qëllim Këshillit. Nëse Komisioni nuk paraqet propozim, i informon Shtetet Anëtare në fjalë për arsyet e këtij mosveprimi.

Autorizimin për të kryer veprimet për vendosjen e bashkëpunimit të përforcuar të përmendur në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi e jep Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian.

2. Kërkesa e Shteteve Anëtare që dëshirojnë të vendosin bashkëpunim të përforcuar mes tyre brenda kuadrit të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, i drejtohet Këshillit. Ajo i përcillet Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, i cili jep një opinion nëse bashkëpunimi përforcuar që propozohet përputhet ose jo me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit, si dhe Komisionit, i cili jep opinion në veçanti nëse bashkëpunimi i përforcuar që propozohet përputhet ose jo me politikat e Bashkimit. Ajo i përcillet Parlamentit Europian për dijeni.

Leja për të vepruar me bashkëpunim të përforcuar jepet me vendim të Këshillit, të miratuar me unanimitet.

Neni 330
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

Të gjithë anëtarët e Këshillit mund të marrin pjesë në diskutimet e tij, por në votim marrin pjesë vetëm ata anëtarë të Këshillit të cilët përfaqësojnë Shtetet Anëtare që marrin pjesë në bashkëpunimin e përforcuar.

Miratimi unanimisht përbëhet vetëm nga votat e përfaqësuesve të Shteteve Anëtare pjesëmarrëse.

Shumica e cilësuar përcaktohet sipas nenit 238(3).

Neni 331
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

1. Çdo Shtet Anëtar që dëshiron të marrë pjesë në një bashkëpunim të përforcuar që është krijuar tashmë në njërën prej fushave të përmendura në nenin 329(1), njofton për këtë qëllim Këshillin dhe Komisionin.

Brenda katër muajve nga data e marrjes së njoftimit, Komisioni konfirmon pjesëmarrjen e Shtetit Anëtar në fjalë. Nëse është e nevojshme, Komisioni vëren se janë përmbushur kushtet e pjesëmarrjes dhe miraton masat kalimtare të nevojshme në lidhje me zbatimin e akteve të miratuara më parë brenda kuadrit të bashkëpunimit të përforcuar.

Por, nëse Komisioni është i mendimit se nuk janë përmbushur kushtet e pjesëmarrjes, ai bën të ditur masat organizative që duhen miratuar për përmbushjen e këtyre kushteve dhe vendos një afat për rishqyrtimin e kërkesës. Pas mbarimit të afatit, e rishqyrton kërkesën sipas procedurës së parashikuar në nënparagrafin e dytë. Nëse Komisioni është i mendimit se ende nuk janë përmbushur kushtet e pjesëmarrjes, Shteti Anëtar në fjalë mund t'ia kalojë çështjen Këshillit, i cili merr vendim për kërkesën. Këshilli vepron në përputhje me nenin 330. Ai mund të miratojë edhe masat kalimtare të përmendura në paragrafin e dytë, me propozim të Komisionit.

2. Çdo Shtet Anëtar i cili dëshiron të marrë pjesë në bashkëpunimin e përforcuar të krijuar tashmë në kuadër të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, njofton për këtë qëllim Këshillin, Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Politikën te Jashtme dhe të Sigurisë dhe Komisionin.

Këshilli e konfirmon pjesëmarrjen e Shtetit Anëtar në fjalë, pasi konsultohet me Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe pasi vëren, nëse është nevoja, se janë përmbushur kushtet e pjesëmarrjes. Me propozim të Përfaqësuesit të Lartë, Këshilli mund të miratojë edhe masat kalimtare të nevojshme lidhur me zbatimin e akteve të miratuara më parë brenda kuadrit të bashkëpunimit të përforcuar. Por, nëse Këshilli është i mendimit se nuk janë përmbushur kushtet e pjesëmarrjes, ai bën të ditur masat organizative që duhen miratuar për përmbushjen e këtyre kushteve dhe vendos një afat për rishqyrtimin e kërkesës për pjesëmarrje.

Për qëllimet e këtij paragrafi, Këshilli vendos me unanimitet dhe në përputhje me nenin 330.

Neni 332
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

Shpenzimet e lindura nga zbatimi i bashkëpunimit të përforcuar, përveç kostove administrative që kërkohen për institucionet, mbulohen nga Shtetet Anëtare pjesëmarrëse, nëse nuk vendosin ndryshe me unanimitet të gjithë anëtarët e Këshillit, pasi konsultohen me Parlamentin Europian.

Neni 333
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

1. Kur një dispozitë e Traktateve e cila mund të zbatohet në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar përcakton që Këshilli vendos me unanimitet, Këshilli mund të miratojë unanimisht, në përputhje me masat organizative të përcaktuara në nenin 330, një vendim ku të përcaktojë se do të veprojë me shumicë të cilësuar.

2. Kur një dispozitë e Traktateve e cila mund të zbatohet në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar përcakton që Këshilli miraton akte sipas një procedure të posaçme legjislative, Këshilli mund të miratojë me unanimitet, në përputhje me masat organizative të përcaktuara në nenin 330, një vendim ku të përcaktojë se ai do të veprojë sipas procedurës së zakonshme legjislative. Këshilli vendos pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk zbatohen për vendimet që kanë rrjedhoja ushtarake ose të mbrojtjes.

Neni 334
(ish-nenet 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b* dhe 43 deri në 45 TBE
dhe ish-nenet 11 dhe 11*a* TKE)

Këshilli dhe Komisioni sigurojnë vijimësinë e aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar dhe pajtueshmërinë e këtyre aktiviteteve me politikat e Bashkimit, dhe bashkëpunojnë për këtë qëllim.

PJESA E SHTATË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE TË FUNDIT

Neni 335
(ish-neni 282 TKE)

Në secilin prej Shteteve Anëtare, Bashkimi gëzon zotësinë më të zgjeruar për të vepruar, të cilën legjislacioni i këtyre vendeve ua ka njohur personave juridikë. Në veçanti, ai mund të blejë ose shesë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe mund të jetë palë në procese ligjore. Komisioni e përfaqëson Bashkimin për këtë qëllim. Megjithatë, Bashkimi përfaqësohet nga secili prej institucioneve, në bazë të autonomisë së tyre administrative, për çështje që kanë të bëjnë me veprimtaritë e tyre respektive.

Neni 336
(ish-neni 283 TKE)

Parlamenti Europian dhe Këshilli vendosin sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me institucionet e tjera të interesuara, Rregulloret e Personelit të Zyrtarëve të Bashkimit Europian si dhe Kushtet e Punësimit të nëpunësve të tjerë të Bashkimit.

Neni 337
(ish-neni 284 TKE)

Brenda kufijve dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Këshilli me shumicë të thjeshtë në përputhje me dispozitat e Traktateve, Komisioni mund të mbledhë informacione dhe të kryejë kontrollet e nevojshme për kryerjen e detyrave që i janë besuar.

Neni 338
(ish-neni 285 TKE)

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli, pa cenuar nenin 5 të Protokollit për Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane, miratojnë sipas procedurës së zakonshme legjislative masat për nxjerrjen e statistikave kur kjo është e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të Bashkimit.

2. Nxjerrja e statistikave të Bashkimit bëhet me paanshmëri, besueshmëri, objektivitet, pavarësi shkencore, justifikim të kostos dhe ruajtje të fshehtësisë së informacionit statistikor. Nxjerrja e statistikave nuk duhet të përbëjë barrë të tepërt për operatorët ekonomikë.

Neni 339
(ish-neni 287 TKE)

Anëtarëve të institucioneve të Bashkimit, anëtarëve të komiteteve, zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë të Bashkimit u kërkohet që, edhe pas largimit nga detyra, të mos nxjerrin informacione që i mbulon

detyrimi i fshehtësisë profesionale, sidomos informacione për ndërmarrjet, marrëdhëniet e tyre tregtare apo përbërësit e kostove të tyre.

Neni 340
(ish-neni 288 TKE)

Përgjegjësia kontraktuese e Bashkimit rregullohet nga ligji i zbatueshëm për kontratën në fjalë.

Në rastin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, Bashkimi mund të japë dëmshpërblim, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare, për çdo dëm që shkaktojnë institucionet ose nëpunësit e tij gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Pavarësisht paragrafit të dytë, Banka Qendrore Europiane mund të japë dëmshpërblim, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare, për çdo dëm që shkaktojnë ajo ose nëpunësit e saj gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Përgjegjësia personale e nëpunësve kundrejt Bashkimit rregullohet nga dispozitat e përcaktuara në Rregulloret e Personelit ose në Kushtet e Punësimit që janë të zbatueshme për ta.

Neni 341
(ish-neni 289 TKE)

Selia e institucioneve të Bashkimit vendoset me marrëveshje të përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare.

Neni 342
(ish-neni 290 TKE)

Pa cenuar dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, normat që rregullojnë përdorimin e gjuhëve në institucionet e Bashkimit i vendos me unanimitet Këshilli përmes rregulloreve.

Neni 343
(ish-neni 291 TKE)

Bashkimi gëzon në territoret e Shteteve Anëtare ato privilegje dhe imunitete që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, sipas kushteve të përcaktuara në Protokollin e datës 8 prill 1965 "Për privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Europian". Kjo vlen edhe për Bankën Qendrore Europiane dhe Bankën Europiane të Investimeve.

Neni 344
(ish-neni 292 TKE)

Shtetet Anëtare angazhohen të mos përdorin asnjë mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin ose zbatimin e Traktateve, përveç mjeteve që parashikohen këtu.

Neni 345
(ish-neni 295 TKE)

Traktatet nuk i cenojnë në asnjë mënyrë normat e Shteteve Anëtare që rregullojnë sistemin e të drejtave të pronësisë.

Neni 346
(ish-neni 296 TKE)

1. Dispozitat e Traktateve nuk e pengojnë zbatimin e rregullave të mëposhtme:

(a) asnjë Shtet Anëtar nuk ka detyrimin të japë informacion, dhënia e të cilit konsiderohet prej tij se bie ndesh me interesat thelbësore të sigurisë së tij;

(b) çdo Shtet Anëtar mund të marrë ato masa që i konsideron të nevojshme për mbrojtjen e interesave thelbësore të sigurisë të tij të cilat lidhen me prodhimin ose tregtimin e armëve, municioneve dhe materialeve të luftës; masa të tilla nuk duhet t'i prekin negativisht kushtet e konkurrencës në tregun e brendshëm lidhur me produktet përdorimi i të cilave nuk është për qëllime veçanërisht ushtarake.

2. Me propozim të Komisionit, Këshilli mund të bëjë ndryshime në listën e produkteve për të cilat zbatohen dispozitat e paragrafit 1(b), që ka përgatitur më 15 prill 1958.

Neni 347
(ish-neni 297 TKE)

Shtetet Anëtare konsultohen me njëri tjetrin me qëllim kryerjen bashkërisht të hapave që nevojiten për të penguar prekjen e funksionimit të tregut të brendshëm nga masat që një Shteti Anëtar mund t'i kërkohet që t'i marrë në rast trazirash të brendshme serioze të cilat prekin ruajtjen e ligjit dhe të rendit, në rast lufte dhe në rast tensioni serioz ndërkombëtar që përbën rrezik për luftë, ose në mënyrë që të përmbushë detyrimet që ka pranuar me qëllim ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Neni 348
(ish-neni 298 TKE)

Nëse masat e marra në rrethanat e përmendura në nenet 346 dhe 347 sjellin për pasojë devijimin e kushteve të konkurrencës në tregun e brendshëm, Komisioni, së bashku me Shtetin në fjalë, shqyrton se si mund t'u përshtaten këto masa normave të përcaktuara në Traktatet.

Duke u shmangur nga procedura e përcaktuar në nenet 258 dhe 259, Komisioni ose çdo Shtet Anëtar mund ta ngrejë çështjen drejtpërsëdrejti përpara Gjykatës së Drejtësisë, nëse mendon se një Shtet tjetër Anëtar po i përdor në mënyrë jo të duhur kompetencat që parashikohen në nenet 346 dhe 347. Gjykata e Drejtësisë e merr vendimin në seancë me dyer të mbyllura.

Neni 349
(ish-neni 299(2), nënparagrafi i dytë, i tretë dhe i katërt, TKE)

Duke pasur parasysh situatën strukturore shoqërore dhe ekonomike të Guadalupës, Guajanës Franceze, Martinikës, Riunionit, Shën Bartolomeut, Shën Martinit, Azoreve, Madejrës dhe Ishujve Kanarie, e cila bëhet më e vështirë nga largësia, izolimi, vogëlsia, terreni i vështirë dhe klima e tyre, dhe vartësinë ekonomike në disa produkte, përhershmëria dhe gërshetimi i të cilave e kufizon shumë zhvillimin e tyre, Këshilli me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian, miraton masa të caktuara që kanë si qëllim në veçanti vendosjen e kushteve të zbatimit të Traktatit për këto rajone, duke përfshirë edhe politikat e përbashkëta. Kur masat e caktuara në fjalë miratohen nga Këshilli sipas një procedure të posaçme legjislative, ai vendos me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin Europian.

Masat e përmendura në paragrafin e parë kanë të bëjnë me fusha të veçanta siç janë politikat doganore dhe tregtare, politika fiskale, politikat për zonat e lira, bujqësinë dhe peshkimin, kushtet për furnizimin e lëndëve të para dhe mallrave të konsumit bazë, ndihmën shtetërore dhe kushtet e përfitimit nga fondet strukturore dhe nga programet horizontale të Bashkimit.

Këshilli i miraton masat e përmendura në paragrafin e parë duke mbajtur në konsideratë karakteristikat dhe kufizimet e veçanta të rajoneve të largëta, pe cenuar integritetin dhe koherencën e rendit juridik të Bashkimit, duke përfshirë tregun e brendshëm dhe politikat e përbashkëta#

Neni 350
(ish-neni 306 TKE)

Dispozitat e Traktateve nuk e pengojnë ekzistencën ose realizimin e bashkimeve rajonale ndërmjet Belgjikës dhe Luksemburgut, ose ndërmjet Belgjikës, Luksemburgut dhe Hollandës, për aq sa objektivat e këtyre bashkimeve rajonale nuk arrihen përmes zbatimit të Traktateve.

Neni 351
(ish-neni 307 TKE)

Dispozitat e Traktateve nuk prekin të drejtat dhe detyrimet që lindin nga marrëveshjet e lidhura përpara datës 1 janar 1958 ose, për Shtetet e anëtarësuara, përpara datës së anëtarësimit të tyre, ndërmjet një ose më shumë Shteteve Anëtare nga njëra anë, dhe një ose më shumë vendeve të treta nga ana tjetër.

Për aq sa këto marrëveshje nuk pajtohen me Traktatet, Shtetet Anëtare ose Shtetet në fjalë kryejnë të gjithë hapat e duhura për të eliminuar papajtueshmëritë e krijuara. Shtetet Anëtare e mbështesin për këtë qëllim njëra-tjetrën sa herë të jetë e nevojshme, dhe nëse është rasti mbajnë një qëndrim të përbashkët.

Gjatë zbatimit të marrëveshjeve të përmendura në paragrafin e parë, Shtetet Anëtare marrin parasysh faktin se avantazhet që jep secili Shtet Anëtar në bazë të Traktateve përbëjnë pjesë integrale të themelimit të Bashkimit dhe rrjedhimisht janë të lidhura pazgjidhshmërisht me krijimin e institucioneve të përbashkëta, dhënien e kompetencave atyre dhe dhënien e të njëjtave avantazhe nga të gjitha Shtetet e tjera Anëtare.

Neni 352
(ish-neni 308 TKE)

1. Nëse del nevoja që të veprojë Bashkimi, brenda kuadrit të politikave të përcaktuara në Traktatet, për të arritur një prej objektivave të parashikuar në Traktatet, dhe nëse Traktatet nuk i kanë parashikuar kompetencat e nevojshme, Këshilli miraton me unanimitet masat e duhura, me propozim të Komisionit dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian. Kur masat në fjalë miratohen nga Këshilli sipas një procedure të veçantë legjislative, ai vendos edhe me unanimitet, me propozim të Komisionit dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian.

2. Duke përdorur procedurën për vëzhgimin e zbatimit të parimit të subsidiaritetit të përmendur në nenin 5(3) të Traktatit për Bashkimin Europian, Komisioni e drejton vëmendjen e Parlamenteve kombëtare tek propozimet që bazohen në këtë nen.

3. Masat e mbështetura në këtë nen nuk kërkojnë harmonizimin e akteve ligjore ose nënligjore të Shteteve Anëtare në rastet kur Traktatet e përjashtojnë këtë harmonizim.

4. Ky nen nuk mund të shërbejë si bazë për arritjen e objektivave që i përkasin politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe çdo akt i miratuar në mbështetje të këtij neni duhet të respektojë kufijtë e parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 40 të Traktatit për Bashkimin Europian.

Neni 353

Neni 48(7) e Traktatit për Bashkimin Europian nuk zbatohet për nenet e mëposhtme:

– Neni 311, paragrafi i tretë dhe i katërt,

– Neni 312(2), nënparagrafi i parë,

– Neni 352, dhe

– Neni 354.

Neni 354
(ish-neni 309 TKE)

Për qëllimet e nenit 7 të Traktatit për Bashkimin Europian për pezullimin e disa të drejtave të caktuara që rrjedhin nga anëtarësimi në Bashkim, anëtari i Këshillit Europian ose i Këshillit i cili përfaqëson Shtetin Anëtar në fjalë nuk merr pjesë në votim dhe Shteti Anëtar në fjalë nuk merret parasysh në llogaritjen e një të tretës ose e tri të katërtave të Shteteve Anëtare të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Abstenimet e anëtarëve të pranishëm fizikisht ose të përfaqësuar nuk e pengojnë miratimin e vendimeve të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.

Për miratimin e vendimeve të përmendura në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 7 të Traktatit për Bashkimin Europian, shumica e cilësuar përcaktohet në përputhje me nenin 238(3)(b) të këtij Traktati.

Kur, pas një vendimi për pezullim të të drejtave të votës të miratuara në mbështetje të paragrafit 3 të nenit 7 të Traktatit për Bashkimin Europian, Këshilli vendos me shumicë të cilësuar në bazë të

një dispozite të Traktateve, që shumica e cilësuar përcaktohet në përputhje me nenin 238(3)(b) e këtij Traktati, ose, kur Këshilli vepron me propozim të Komisionit ose të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, në përputhje me nenin 238(3)(a).

Për qëllimet e nenit 7 të Traktatit për Bashkimin Europian, Parlamenti Europian vendos me shumicë prej dy të tretave të votave të hedhura, që përbën shumicën e deputetëve të tij.

Neni 355
(ish-neni 299(2), nënparagrafi i parë, dhe neni 299(3) deri në (6) TKE)

Krahas dispozitave të nenit 52 të Traktatit për Bashkimin Europian lidhur me fushën territoriale të veprimit të Traktateve, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

1. Dispozitat e Traktateve zbatohen për Guadalupën, Guajanën Franceze, Martinikën, Riunionin, Shën Bartolomeun, Shën Martinin, Azoret, Madejrën dhe Ishujt Kanarie në përputhje me nenin 349.

2. Rregullimet e veçanta për asociimin të parashikuara në Pjesën e Katërt zbatohen për vendet dhe territoret jashtë Europës të përcaktuara në Shtojcën II.

Traktatet nuk zbatohen për ato vende dhe territore jashtë Europës të cilat kanë marrëdhënie të veçanta me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut të cilat nuk janë përfshirë në listën e lartpërmendur.

3. Dispozitat e Traktateve zbatohen për ato territore europiane për marrëdhëniet e jashtme të të cilave është përgjegjës një Shtet Anëtar.

4. Dispozitat e Traktateve zbatohen për Ishujt Aland në përputhje me dispozitat e parashikuara në Protokollin 2 të Aktit për kushtet e anëtarësimit të Republikës së Austrisë, Republikës së Finlandës dhe Mbretërisë së Suedisë.

5. Pavarësisht nenit 52 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe paragrafëve nga 1 deri në 4 të këtij neni:

(a) Traktatet nuk zbatohen për Ishujt Faroe;

(b) Traktatet nuk zbatohen për Zonat e Bazave në Territor Sovran të Mbretërisë së Bashkuar të Akrotirit dhe Dhekelias në Qipro, përveç se për aq sa është e nevojshme për të siguruar zbatimin e masave organizative të parashikuara në Protokollin për Zonat e Bazave në Territor Sovran të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në Qipro, i cili i bashkëngjitet Aktit për kushtet e anëtarësimit të Republikës Çeke, Republikës së Estonisë, Republikës së Qipros, Republikës së Letonisë, Republikës së Lituanisë, Republikës së Hungarisë, Republikës së Maltës, Republikës së Polonisë, Republikës së Sllovenisë dhe Republikës Sllovake në Bashkimin Europian dhe në përputhje me kushtet e Protokollit të lartpërmendur;

(c) Traktatet zbatohen për Ishujt e Kanalit të La Manshit dhe Ishullin e Manit vetëm për aq sa është e nevojshme për të siguruar zbatimin e masave organizative për këta ishuj të parashikuara në Traktatin për anëtarësimin e Shteteve të reja Anëtare në Komunitetin Ekonomik Europian dhe në Komunitetin Europian të Energjisë Bërthamore të nënshkruar më 22 janar 1972.

6. Me nismën e Shteteve Anëtare përkatëse, Këshilli Europian mund të miratojë një vendim për të ndryshuar statusin kundrejt Bashkimit, të një vendi ose territori danez, francez ose holandez të përmendur në paragrafët 1 dhe 2. Këshilli Europian vendos me unanimitet pasi konsultohet me Komisionin.

Neni 356
(ish-neni 312 TKE)

Ky Traktat miratohet për një periudhë të pakufizuar.

Neni 357
(ish-neni 313 TKE)

Ky Traktat ratifikohet nga të gjitha Palët e Larta Kontraktuese sipas kërkesave kushtetuese përkatëse të tyre. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës Italiane.

Ky Traktat hyn në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës pas depozitimit të Instrumentit të ratifikimit nga Shteti i fundit nënshkrues që e merr këtë hap. Por, nëse ky depozitim bëhet më pak se 15 ditë përpara fillimit të muajit pasardhës, ky Traktat hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pasardhës pas datës së këtij depozitimi.

Neni 358

Për këtë Traktat zbatohen dispozitat e nenit 55 të Traktatit për Bashkimin Europian.

NË DIJENI TË PËRMBAJTJES së tij, Të Plotfuqishmit e nënshkruan këtë Traktat.

Nënshkruar në Romë sot më ditën e njëzet e pestë të muajit mars të vitit njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë.

(Lista e nënshkruesve nuk jepet këtu)

Pr
+
Sh

PROTOKOLLET

PROTOKOLLI (nr. 1)

PËR ROLIN E PARLAMENTEVE KOMBËTARE NË BASHKIMIN EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE KUJTUAR që mënyra se si parlamentet kombëtare kontrollojnë qeveritë e tyre në lidhje me aktivitetet e Bashkimit është çështje për organizimin dhe praktikën e veçantë kushtetuese të çdo Shteti Anëtar,

ME DËSHIRËN për të nxitur përfshirje më të madhe të parlamenteve kombëtare në aktivitetet e Bashkimit dhe për të rritur aftësinë e tyre në shprehjen e pikëpamjeve për projektakte legjislative si edhe për çështje të tjera që mund të jenë me interes për to,

KANË RËNË DAKORD PËR dispozitat e mëposhtme, të cilat i shtohen Traktatit të Bashkimit Europian, Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Traktatit Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Atomike:

TITULLI I

INFORMACION PËR PARLAMENTET KOMBËTARE

Neni 1

Komisioni u dërgon drejtpërdrejt parlamenteve kombëtare dokumentet konsultuese të Komisionit (Libri e Bardhë, dhe të Gjelbër dhe komunikatat). Gjithashtu, Komisioni u dërgon parlamenteve kombëtare, në të njëjtën kohë që ia nis edhe Parlamentit Europian dhe Këshillit, programin vjetor legjislativ si edhe çdo instrument tjetër planifikimi legjislativ ose politikash legjislative.

Neni 2

Projektaktet legjislative që i janë dërguar Parlamentit Europian dhe Këshillit u dërgohen parlamenteve kombëtare.

Për qëllimet e këtij Protokolli, janë "projektakte legjislative", propozimet e Komisionit, nismat nga një grup Shtetesh Anëtare, nismat e Parlamentit Europian, kërkesat e Gjykatës së Drejtësisë, rekomandimet e Bankës Qendrore Europiane dhe kërkesat e Bankës Europiane të Investimeve, me qëllim miratimin e një akti legjislativ.

Komisioni u dërgon drejtpërdrejt parlamenteve kombëtare projektaktet legjislative që dalin me nismën e Komisionit, në të njëjtën kohë që ia përcjell këto Parlamentit Europian dhe Këshillit.

Parlamenti Europian u dërgon drejtpërdrejt parlamenteve kombëtare projektaktet legjislative që dalin me nismën e Parlamentit Europian.

Këshilli u dërgon parlamenteve kombëtare projektaktet legjislative që dalin me nismën e një grupi Shtetesh Anëtare, të Gjykatës së Drejtësisë, të Bankës Qendrore Europiane ose të Bankës Europiane të Investimeve.

Neni 3

Parlamentet kombëtare mund t'i dërgojnë Presidentit të Parlamentit Europian, Presidentit të Këshillit dhe Presidentit të Komisionit një opinion të arsyetuar nëse një projektakt legjislativ është në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas procedurës së përcaktuar në Protokollin mbi zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit.

Nëse projektakti legjislativ del me nismën e një grupi Shtetesh Anëtare, Presidenti i Këshillit u dërgon qeverive të këtyre Shteteve Anëtare opinionin ose opinionet e arsyetuara .

Nëse projektakti legjislativ del me nismën e Gjykatës së Drejtësisë, të Bankës Qendore Europiane ose të Bankës Europiane të Investimeve, Presidenti i Këshillit i dërgon institucionit apo organit të interesuar opinionin ose opinionet e arsyetuara.

Neni 4

Nga paraqitja e projektaktit legjislativ tek parlamentet kombëtare, në gjuhët zyrtare të Bashkimit, deri më datën e përfshirjes së tij në rendin e ditës paraprak të Këshillit për miratimi, ose për miratimin e një qëndrimi sipas një procedure legjislative, kalon një periudhë tetë javore. Lejohen përjashtime në raste urgjente, arsyet e të cilave do të përmenden në aktin ose qëndrimin e Këshillit. Përveç rasteve urgjente, për të cilat janë përcaktuar arsyet , asnjë marrëveshje për një projektakt legjislativ nuk mund të arrihet gjatë këtyre tetë javëve. Përveç rasteve urgjente, për të cilat janë përcaktuar arsyet, duhet të kalojë një periudhë dhjetë ditore nga përfshirja e projektaktit legjislativ në rendin e ditës paraprak të Këshillit për miratim, deri në miratimin e një qëndrimi.

Neni 5

Rendi i ditës për mbledhjet e Këshillit dhe rezultati i tyre, si edhe procesverbali i takimeve ku Këshilli diskuton projektaktet legjislative, u dërgohet drejtpërdrejt parlamenteve kombëtare dhe në të njëjtën kohë edhe qeverive të Shteteve Anëtare.

Neni 6

Kur Këshilli Europian synon të përdorë nënparagrafët e parë ose të dytë të nenit 48(7) të Traktatit të Bashkimit Europian, parlamentet kombëtare vihen në dijeni të nismës së Këshillit Europian të paktën gjashtë muaj përpara miratimit të një vendimi.

Neni 7

Gjykata e Audituesve u dërgon parlamenteve kombëtare, për dijeni, raportin vjetor , në të njëjtën kohë që ia dërgon Parlamentit Europian dhe Këshillit.

Neni 8

Nëse sistemi parlamentar kombëtar nuk është njëdhomësh, për dhomat përbërëse zbatohen nenet 1 deri në 7 .

TITULLI II

BASHKËPUNIMI NDËRPARLAMENTAR

Neni 9

Parlamenti Europian dhe parlamentet kombëtare vendosin së bashku për organizimin dhe nxitjen e një bashkëpunimi të rregullt dhe të efektshëm ndërparlamentar brenda Bashkimit.

Neni 10

Një konferencë e Komisioneve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit mund të paraqesë çdo kontribut që gjykon me vend se kërkon vëmendjen e Parlamentit Europian, të Këshillit dhe të Komisionit. Kjo konferencë, përveç kësaj, nxit shkëmbimin e informacionit dhe praktikës më të mirë ndërmjet parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Europian, përfshirë këtu komisionet e tyre të posaçme. Ajo mund të organizojë gjithashtu konferenca ndërparlamentare mbi çështje specifike, në veçanti për diskutimin e çështjeve të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, duke përfshirë politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes. Kontributet e konferencës nuk janë detyruese për parlamentet kombëtare dhe nuk cenojnë qëndrimet e tyre.

———

PROTOKOLLI (nr. 2)

PËR ZBATIMIN E PARIMEVE TË SUBSIDIARITETIT DHE PROPORCIONALITETIT

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të siguruar marrjen e vendimeve sa më pranë qytetarëve të Bashkimit,

TË VENDOSUR për të krijuar kushtet për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit, siç parashikohen në nenin 5 të Traktatit të Bashkimit Europian, dhe për të krijuar një sistem për monitorimine zbatimit të këtyre parimeve,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Çdo institucion siguron respektimin e vazhdueshëm të parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit, siç parashikohen në nenin 5 të Traktatit për Bashkimin Europian.

Neni 2

Përpara propozimit të akteve legjislative, Komisioni duhet të konsultohet gjerësisht. Këto konsultime, kur duhet, marrin parasysh dimensionin rajonal dhe vendor të veprimit të parashikuar. Në raste urgjence të jashtëzakonshme, Komisioni nuk zhvillon konsultime të tilla. Komisioni jep në propozimin që bën arsyet për vendimin e tij.

Neni 3

Për qëllimet e këtij Protokolli, "projektakte legjislative" janë propozimet për miratimin e një akti legjislativ prej Komisionit, nismat nga një grup Shtetesh Anëtare, nismat nga Parlamenti Europian, kërkesat nga Gjykata e Drejtësisë, rekomandimet nga Banka Qendrore Europiane dhe kërkesat nga Banka Europian e Investimeve.

Neni 4

Komisioni u dërgon parlamenteve kombëtare projektaktet e tij legjislative dhe projektet e ndryshuara, në të njëjtën kohë që ia kalon edhe ligjvënësit të Bashkimit.

Parlamenti Europian u dërgon parlamenteve kombëtare projektaktet e tij legjislative dhe projektet e ndryshuara.

Këshilli u dërgon parlamenteve kombëtare projektaktet legjislative që dalin nga një grup Shtetesh Anëtare, nga Gjykata e Drejtësisë, nga Banka Qendrore Europiane apo nga Banka Europiane e Investimeve si dhe u dërgon parlamenteve kombëtare projektet e ndryshuara.

Sapo miratohen, rezolutat legjislative të Parlamentit Europian dhe qëndrimet e Këshillit u dërgohen, prej këtyre, parlamenteve kombëtare.

Neni 5

Projektaktet legjislative duhet të arsyetohen kundrejt parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Çdo projektakt legjislativ duhet të përmbajë një deklaratë të hollësishme që mundëson vlerësimin e përputhshmërisë me parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Kjo deklaratë duhet të përmbajë disa vlerësime mbi efektet financiare të propozimit dhe, në rastin e një direktive, deklarata duhet të përmbajë rrjedhojat e saj lidhur me miratimin e normave nga Shtetet Anëtare, duke përfshirë, kur është e nevojshme, legjislacionin rajonal. Arsyetimi që të çon në përfundimin se një objektiv i Bashkimit mund të arrihet më mirë në nivel të Bashkimit, duhet të mbështetet në tregues cilësorë, dhe, kur është e mundur, në tregues sasiorë. Projektaktet legjislative duhet të marrin parasysh nevojën për të minimizuar dhe mbajtur në përpjesëtim me objektivin çdo barrë, qoftë financiare apo administrative, që bie mbi Bashkimin, qeveritë kombëtare, autoritetet rajonale e vendore, apo operatorët ekonomikë dhe qytetarëve.

Neni 6

Çdo parlament kombëtar apo dhomë e një parlamenti kombëtar, brenda tetë javëve nga data e dërgimit të një projektakti legjislativ në gjuhët zyrtare të Bashkimit, mund t'i dërgojë Presidentit të Parlamentit Europian, Presidentit të Këshillit dhe Komisionit një opinion të arsyetuar ku të shprehet pse projekti në fjalë nuk përputhet me parimin e subsidiaritetit. I takon çdo parlamenti kombëtar ose çdo dhome të një parlamenti kombëtar të këshillohet, kur duhet, me parlamentet rajonale që kanë kompetenca legjislative.

Nëse projektakti legjislativ iniciohet nga një grup Shtetesh Anëtare, Presidenti i Këshillit ua dërgon opinionin qeverive të këtyre Shteteve Anëtare.

Nëse projektakti legjislativ iniciohet nga Gjykata e Drejtësisë, nga Banka Qendrore Europiane apo nga Banka Europiane e Investimeve, Presidenti i Këshillit ia dërgon opinionin institucionit apo organit të interesuar.

Neni 7

1. Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni, si dhe, nëse është e nevojshme , një grup Shtetesh Anëtare, Gjykata e Drejtësisë, Banka Qendrore Europiane ose Banka Europiane e Investimeve, kur projektakti legjislativ iniciohet prej tyre, duhet të marrin parasysh opinionet e arsyetuara të dhëna nga parlamentet kombëtare ose nga një dhomë e një parlamenti kombëtar.

Çdo parlament kombëtar ka dy vota, të ndara në bazë të sistemit parlamentar kombëtar. Në rast të një sistemi parlamentar dydhomësh, çdo dhomë ka një votë.

2. Nëse opinionet e arsyetuara mbi mospërputhshmërinë e një projektakti legjislativ me parimin e subsidiaritetit përfaqësojnë, të paktën, një të tretën e të gjitha votave që u janë caktuar parlamenteve kombëtare në përputhje me nënparagrafin e dytë të paragrafit 1, projekti duhet të rishikohet. Ky prag minimal, është një e katërta, në rastin e një projektakti legjislativ të paraqitur në bazë të nenit 76 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian për zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Pas këtij rishikimi, Komisioni, ose kur duhet, grupi i Shteteve Anëtare, Parlamenti Europian, Gjykata e Drejtësisë, Banka Qendrore Europiane ose Banka Europiane e Investimeve, kur projektakti legjislativ iniciohet prej tyre, mund të vendosin ta mbajnë, ta ndryshojnë ose ta tërheqin projektin. Për këtë vendim duhet të jepen arsyet.

3. Gjithashtu, sipas procedurës së zakonshme legjislative, nëse opinionet e arsyetuara për mospërputhjen e një propozimi për një akt legjislativ me parimin e subsidiaritetit, përfaqësojnë të paktën një shumicë të thjeshtë të votave që u janë caktuar parlamenteve kombëtare në përputhje me nënparagrafin e dytë të paragrafit 1, propozimi duhet të rishikohet. Pas këtij rishikimi, Komisioni mund të vendosë ta mbajë, ta ndryshojë ose ta tërheqë propozimin.

Nëse zgjedh ta mbajë propozimin, Komisioni, me opinion të arsyetuar, duhet të argumentojë arsyet se pse vlerëson që propozimi është në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Ky opinion i arsyetuar si dhe opinionet e arsyetuara të parlamenteve kombëtare do të duhet t'i paraqiten ligjvënësit të Bashkimit, për t'u shqyrtuar sipas procedurës:

(a) përpara përfundimit të leximit të parë, ligjvënësi (Parlamenti Europian dhe Këshilli), shqyrton nëse propozimi legjislativ është në përputhje me parimin e subsidiaritetit, duke pasur parasysh veçanërisht arsyet e shprehura dhe të përbashkëta për shumicën e parlamenteve kombëtare si dhe opinionin e arsyetuar të Komisionit;

(b) nëse, me shumicën e 55% të anëtarëve të Këshillit ose shumicën e votave të hedhura në Parlamentin Europian, ligjvënësi është i mendimit që propozimi nuk është në përputhje me parimin e subsidiaritetit, atëherë propozimi legjislativ nuk do të shqyrtohet më tej.

Neni 8

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka juridiksion për paditë me objekt shkeljen e parimit të subsidiaritetit nëpërmjet një akti legjislativ, të cilat janë paraqitur nga Shtetet Anëtare në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian ose të cilat janë bërë të ditura sipas rendit të tyre juridik, në emër të parlamentit të tyre kombëtar ose një dhome të këtij.

Në përputhje me rregullat e parashtruara në nenin e përmendur, Komiteti i Rajoneve mund të ngrejë padi të tilla edhe kundër akteve legjislative europiane, për miratimin e të cilave Kushtetuta parashikon që të konsultohen me të.

Neni 9

Komisioni, çdo vit, i paraqet Këshillit Europian, Parlamentit Europian, Këshillit dhe parlamenteve kombëtare një raport mbi zbatimin e nenit 5 të Traktatit për Bashkimin Europian. Ky raport vjetor i dërgohet gjithashtu Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve.

———

PROTOKOLLI (nr. 3)

PËR STATUTIN E GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të krijuar Statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian të parashikuar në nenin 281 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit të Bashkimit Europian, Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian si dhe Traktatit Themelues për Komunitetin Europian të Energjisë Bërthamore:

Neni 1

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian krijohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e Traktateve, të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Bërthamore (Traktati EURATOM) dhe të këtij Statuti.

TITULL I

GJYQTARËT DHE AVOKATËT E PËRGJITHSHËM

Neni 2

Përpara se të marrë detyrën, çdo gjyqtar betohet përpara Gjykatës së Drejtësisë të mbledhur në seancë me dyer të hapura, për kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të paanshme dhe parimore dhe për ruajtjen e fshehtësisë së debatit gjyqësor të Gjykatës.

Neni 3

Gjyqtarët janë imunë nga procedimi ligjor. Pas përfundimit të detyrës, ata vazhdojnë të gëzojnë imunitet në lidhje me veprimet e kryera prej tyre për shkak të detyrës, duke përfshirë fjalët e thëna apo të shkruara.

Gjykata e Drejtësisë, e mbledhur në seancë plenare, mund të heqë imunitetin. Nëse vendimi ka të bëjë me një anëtar të Gjykatës së Përgjithshme ose të një gjykate të specializuar, Gjykata vendos pas konsultimit me gjykatën e përfshirë.

Nëse një gjyqtari i hiqet imuniteti dhe ndaj tij nis procedimi penal, ai gjykohet, në çdo Shtet Anëtar, vetëm nga gjykata kompetente për të gjykuar anëtarët e organeve më të larta gjyqësore në vend.

Neni 11 deri në 14 dhe neni 17 i Protokollit për privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Europian vlen për Gjyqtarët, Avokatët e Përgjithshëm, Kancelarin dhe Asistent Relatorin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, pa cenuar dispozitat në lidhje me imunitetin nga procedimi ligjor i gjyqtarëve të cilat janë parashikuar në paragrafët paraardhës.

Neni 4

Gjyqtarët nuk mund të mbajnë funksione politike ose administrative.

Ata nuk mund të angazhohen në asnjë veprimtari, fitimprurëse apo jo, përveç rasteve kur Këshilli, me shumicë të thjeshtë, vendos për një përjashtim.

Kur marrin përsipër detyrën, ata angazhohen solemnisht që, si gjatë, ashtu dhe pas mandatit të tyre, do të përmbushin detyrimet që rrjedhin prej detyrës, sidomos detyrimin për t'u sjellë me integritet dhe maturi për sa i përket pranimit të emërimeve ose përfitimeve të caktuara pas mbarimit të detyrës.

Çdo dyshim në këtë drejtim zgjidhet me vendim të Gjykatës së Drejtësisë. Nëse vendimi ka të bëjë me një anëtar të Gjykatës së Përgjithshme ose të një gjykate të specializuar, Gjykata vendos pas konsultimit me gjykatën e përfshirë.

Neni 5

Detyrat e gjyqtarit, përveç rasteve të zëvendësimit të zakonshëm ose vdekjes, përfundojnë kur ai jep dorëheqjen.

Kur gjyqtari jep dorëheqjen, kërkesa e dorëheqjes i drejtohet Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë për t'iu dërguar Presidentit të Këshillit. Me këtë njoftim, krijohet një vend vakant për këtë funksion.

Përveçse kur zbatohet neni 6, gjyqtari vazhdon të mbajë detyrën deri në marrjen e saj nga pasuesi i vet.

Neni 6

Gjyqtari mund të privohet nga funksioni, e drejta për pension apo përfitime të tjera në vend të tij, vetëm nëse sipas opinionit unanim të Gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë, nuk i plotëson më kushtet apo detyrimet që i rrjedhin nga funksioni. Gjyqtari në fjalë nuk merr pjesë në këto debate. Nëse personi në fjalë është anëtar i Gjykatës së Përgjithshme ose një gjykate të specializuar, Gjykata vendos pas konsultimit me gjykatën në fjalë.

Kancelari i Gjykatës ia komunikon vendimin e Gjykatës Presidentit të Parlamentit Europian dhe Presidentit të Komisionit, si dhe ia njofton atë Presidentit të Këshillit.

Në rastin e një vendimi që e privon gjyqtarin nga ushtrimi i detyrës, krijohet një vend vakant për funksionin me njoftimin e këtij të fundit.

Neni 7

Gjyqtari që do të zëvendësojë një anëtar të Gjykatës, mandati i të cilit nuk ka mbaruar, emërohet për pjesën e mbetur të mandatit të paraardhësit.

Neni 8

Dispozitat e nenit 2 deri në 7 zbatohen për Avokatët e Përgjithshëm.

TITULLI II

ORGANIZIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË

Neni 9

Nëse gjyqtarët zëvendësohen çdo tre vjet pjesërisht, 14 dhe 13 gjyqtarë zëvendësohen në mënyrë të alternuar.

Nëse Avokatët e Përgjithshëm zëvendësohen pjesërisht çdo tre vjet, katër Avokatë të Përgjithshëm zëvendësohen në çdo rast.

Neni 10

Kancelari betohet përpara Gjykatës së Drejtësisë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme dhe parimore dhe për të ruajtur fshehtësinë e debatit gjyqësor të Gjykatës së Drejtësisë.

Neni 11

Gjykata e Drejtësisë merr masat për zëvendësimin e Kancelarit në rastet kur ky ndalohet të marrë pjesë në Gjykatën e Drejtësisë.

Neni 12

Zyrtarë dhe nëpunës të tjerë caktohen pranë Gjykatës së Drejtësisë, që të mundësojnë funksionimin e saj. Ata përgjigjen përpara Kancelarit nën autoritetin e Kryetarit.

Neni 13

Me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë, Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të parashikojnë emërimet e Asistent Relatorëve dhe të përcaktojnë rregullat që rregullojnë shërbimet e tyre . Asistent Relatorëve, sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, mund t'u kërkohet të marrin pjesë në fazën përgatitore për çështjet e paraqitura përpara Gjykatës dhe të bashkëpunojnë me Gjyqtarin që vepron si Relator.

Asistent Relatorët zgjidhen mes personave pavarësia e të cilëve është e garantuar dhe që kanë kualifikimin e nevojshëm juridik; ata emërohen nga Këshilli me shumicë të thjeshtë. Ata betohen përpara Gjykatës për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të paanshme dhe parimore dhe për ruajtjen e fshehtësisë së debateve të Gjykatës.

Neni 14

Gjyqtarët, Avokatët e Përgjithshëm dhe Kancelari duhet ta kenë vendbanimin në vendin ku ka selinë Gjykata e Drejtësisë.

Neni 15

Gjykata e Drejtësisë është përherë në seancë. Periudha e pushimit gjyqësor përcaktohet nga Gjykata duke pasur parasysh nevojat e punës së saj.

Neni 16

Gjykata e Drejtësisë krijon dhoma që përbëhen nga tre dhe pesë gjyqtarë. Gjyqtarët zgjedhin Kryetarët e dhomave mes radhëve të tyre. Kryetarët e dhomave me pesë gjyqtarë zgjidhen për tre vjet. Ata mund të rizgjidhen vetëm një herë.

Dhoma e Madhe Gjyqësore përbëhet nga 13 Gjyqtarë. Ajo kryesohet nga Kryetari i Gjykatës. Kryetarët e dhomave me pesë gjyqtarë dhe gjyqtarë të tjerë të emëruar sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme janë gjithashtu pjesë e Dhomës së Madhe Gjyqësore.

Gjykata mblidhet në një Dhomë të Madhe Gjyqësore kur e kërkon një Shtet Anëtar ose një institucion i Bashkimit që është palë në procedim.

Gjykata gjykon në seancë plenare kur çështjet janë ngritur përpara saj sipas nenit 228(2), nenit 245(2), nenit 247 apo nenit 286(6) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Gjithashtu, kur Gjykata konsideron që një çështje përpara saj është me rëndësi të jashtëzakonshme, mund të vendosë t'ia përcjellë çështjen seancës plenare, pasi të dëgjojë Avokatin e Përgjithshëm.

Neni 17

Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë janë të vlefshme vetëm kur në debate përfshihet një numër tek i anëtarëve të saj.

Vendimet e dhomës të përbërë nga tre apo pesë gjyqtarë janë të vlefshme vetëm nëse merren nga tre gjyqtarë.

Vendimet e Dhomës së Madhe Gjyqësore janë të vlefshme vetëm nëse janë mbledhur nëntë gjyqtarë.

Vendimet e seancës plenare janë të vlefshme vetëm nëse janë mbledhur 15 gjyqtarë.

Në rastin kur gjyqtarët e një dhome nuk mund të marrin pjesë, një gjyqtar i një dhome tjetër mund të thirret sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Neni 18

Asnjë Gjyqtar ose Avokat i Përgjithshëm nuk mund të marrë pjesë në trajtimin e një çështjeje ku ka marrë pjesë më përpara si agjent ose këshilltar, ku ka vepruar për një nga palët, ku është thirrur të shprehet si anëtar i gjykatës, i një komisioni hetimor, apo në çdo cilësi tjetër.

Nëse, për disa arsye të veçanta, një Gjyqtar apo Avokat i Përgjithshëm vlerëson që nuk duhet të marrë pjesë në gjykimin ose shqyrtimin e një çështjeje të caktuar, njofton Kryetarin në lidhje

me këtë. Nëse, për disa arsye të veçanta, Kryetari vlerëson se ndonjë Gjyqtar ose Avokat i Përgjithshëm nuk duhet të gjykojë ose të bëjë parashtrime për një çështje të caktuar, ai e njofton për këtë.

Çdo vështirësi që krijohet në lidhje me zbatimin e këtij neni, zgjidhet me vendim të Gjykatës së Drejtësisë.

Një palë nuk mund të kërkojë ndryshimin e përbërjes së Gjykatës ose të njërës prej dhomave të saj për arsye të kombësisë së një gjyqtari apo mungesës në gjykatë ose në dhomë të një gjyqtari që të ketë kombësinë e asaj pale.

TITULLI III

PROCEDURA PËRPARA GJYKATËS SË DREJTËSISË

Neni 19

Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit përfaqësohen përpara Gjykatës së Drejtësisë nga një agjent i emëruar për çdo çështje; agjenti mund të mbështetet nga një këshilltar ose një avokat.

Shtetet jo Anëtare, të cilat janë palë në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Europiane dhe gjithashtu në Autoritetin e Mbikëqyrjes të SHETL-së të përmendura në atë marrëveshje, përfaqësohen në të njëjtën mënyrë.

Palët e tjera duhet të përfaqësohen nga një avokat.

Vetëm një avokat i autorizuar për të vepruar përpara një gjykate të një Shteti Anëtar ose një Shteti tjetër i cili është palë në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Europiane mund të përfaqësojë ose mbështetë një palë përpara Gjykatës.

Këta agjentë, këshilltarë dhe avokatë, kur paraqiten përpara Gjykatës, gëzojnë të drejtat dhe imunitetin e nevojshëm për ushtrimin e pavarur të detyrave të tyre, sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Gjykata, në lidhje me këta këshilltarë dhe avokatë që paraqiten para saj, ka kompetencat që normalisht u jepen gjykatave, sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Pedagogët e universitetit, që janë shtetas të një Shteti Anëtar, ku legjislacioni u jep të drejtën e përfaqësimit në gjykatë, kanë të njëjtat të drejta përpara Gjykatës me ato që ky nen u jep avokatëve.

Neni 20

Procedura përpara Gjykatës së Drejtësisë përbëhet nga dy pjesë: me shkrim dhe me gojë.

Procedura me shkrim përfshin komunikimin me palët dhe institucionet e Bashkimit vendimet e të cilit janë në diskutim, përfshin kërkesat, parashtrimin e argumenteve, mbrojtjen, konstatimet dhe përgjigjet, nëse ka, si dhe të gjitha shkresat dhe dokumentet mbështetëse ose kopje të noterizuara të tyre.

Komunikimi bëhet nga Kancelari, sipas radhës dhe brenda kohës së përcaktuar në Rregulloren e Brendshme.

Procedura verbale përbëhet nga leximi i raportit të paraqitur nga një gjyqtar në cilësinë e Relatorit, dëgjimi i agjentëve, këshilltarëve dhe avokatëve nga Gjykata, nga parashtrimet e Avokatit të Përgjithshëm dhe dëgjimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve nëse ka.

Gjykata, kur konsideron që çështja nuk ngre çështje të reja të interpretimit ligjor, mund të vendosë, pasi të ketë dëgjuar Avokatin e Përgjithshëm, që çështja të zgjidhet pa parashtrim nga Avokati i Përgjithshëm.

Neni 21

Një çështje i paraqitet Gjykatës së Drejtësisë me anë të një kërkese me shkrim drejtuar Kancelarit. Kërkesa përmban emrin e kërkuesit, adresën e banimit të përhershëm dhe përshkrimin e palës nënshkruese, emrin e palës ose emrat e palëve kundër të cilave është bërë kërkesa, objektin e mosmarrëveshjes, formën e urdhrit që kërkohet dhe një deklaratë të shkurtër të bazës ligjore ku mbështetet kërkesa.

Kërkesa shoqërohet, kur duhet, nga masa që kërkohet të shfuqizohet, ose në rrethanat e përmendura në nenin 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nga prova shkresore të datës kur institucionit i është kërkuar të vepronte, sipas këtyre neneve. Nëse dokumentet nuk paraqiten së bashku me kërkesën, Kancelari i kërkon palës së interesuar t'i paraqesë ato brenda një kohe të arsyeshme, por, në këtë rast, të drejtat e palës nuk parashkruhen edhe nëse këto dokumente sigurohen pas afatit kohor për të nisur procedimin.

Neni 22

Një çështje e rregulluar nga neni 18 i Traktatit EURATOM ngrihet përpara Gjykatës së Drejtësisë përmes ankimit drejtuar Kancelarit. Ankimi përmban emrin dhe adresën e përhershme të banimit të kërkuesit dhe përshkrimin e palës nënshkruese, një referencë të vendimit kundër të cilit është bërë ankimi, emrat e të padituve, objektin e mosmarrëveshjes, parashtrimet dhe një tekst të shkurtër të arsyeve mbi bazën e të cilave paraqitet ankimi.

Ankimi shoqërohet me një kopje të vërtetuartë vendimit të Komitetit të Arbitrazhit i cili është kundërshtuar.

Nëse Gjykata refuzon ankimin, vendimi i Komitetit të Arbitrazhit merr formë të prerë.

Nëse Gjykata shfuqizon vendimin e Komitetit të Arbitrazhit, çështja, kur duhet, me nismën e njërës prej palëve në çështje, mund të hapet përsëri përpara Komitetit të Arbitrazhit. Ky i fundit respekton çdo vendim për çështje të interpretimit ligjor që nxjerr Gjykata.

Neni 23

Në çështje që rregullohen nga neni 267 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, vendimi i gjykatës së një Shteti Anëtar, i cili pezullon procedimet e saj dhe e dërgon çështjen në Gjykatën e

Drejtësisë, i njoftohet Gjykatës nga gjykata e përfshirë. Vendimi më pas u njoftohet nga Kancelari i Gjykatës, palëve, Shteteve Anëtare, Komisionit dhe institucionit, organit, zyrës ose agjencisë të Bashkimit që ka miratuar aktin, vlefshmëria apo interpretimi i të cilit është në diskutim.

Brenda dy muajve nga ky njoftim, palët, Shtetet Anëtare, Komisioni dhe, kur duhet, institucioni, organi, zyra ose agjencia që ka miratuar aktin vlefshmëria ose interpretimi i të cilit është në diskutim, kanë të drejtë të paraqesin në gjykatë argumente mbi çështjen ose konstatime me shkrim.

Në çështjet që rregullohen nga neni 267 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nga Kancelari i Gjykatës u njoftohet vendimi i gjykatës kombëtare Shteteve që nuk janë Shtete Anëtare, por palë në Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Europiane dhe gjithashtu në Autoritetin e Mbikëqyrjes së SHETL-së të përmendura në atë Marrëveshje, të cilat brenda dy muajve nga ky njoftim, kur bëhet fjalë për një nga fushat e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, mund të paraqesin pohimin e fakteve ose konstatime me shkrim në Gjykatë.

Kur një marrëveshje në lidhje me një objekt specifik, e lidhur mes Këshillit dhe një ose më shumë shteteve jo anëtare, parashikon që këto Shtete të kenë të drejtën të paraqesin pohimin e fakteve ose konstatime me shkrim, kur një gjykatë e një Shteti Anëtar i drejtohet Gjykatës së Drejtësisë për t'u shprehur me vendim paragjyqësor për një çështje që është brenda fushës së veprimit të marrëveshjes, vendimi i gjykatës kombëtare në lidhje me atë çështje u njoftohet edhe shteteve jo anëtare të interesuara. Këto Shtete, brenda dy muajve nga ky njoftim, mund të depozitojnë në gjykatë pohimin e fakteve ose konstatime me shkrim.

Neni 23a[1]

Rregullorja e Brendshme mund të parashikojë një procedurë të përshpejtuar dhe, në rastin e referencave për një vendim paragjyqësor në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, një procedurë emergjente.

Këto procedura, në lidhje me parashtrimin e pohimit të fakteve ose konstatimeve me shkrim, mund të parashikojnë një periudhë më të shkurtër sesa ajo që parashikon neni 23, si dhe shmangie nga paragrafi i katërt i nenit 20, duke bërë që çështja të vendoset pa parashtrim nga Avokati i Përgjithshëm.

Gjithashtu, procedura urgjente mund të parashikojë kufizim të palëve dhe personave të tjerë të interesuar të përmendur në nenin 23, të cilët janë autorizuar për të paraqitur pohimin e fakteve ose konstatime me shkrim dhe, në çështje tepër urgjente, mund të parashikojë moskryerjen e hapave me shkrim të procedurës.

Neni 24

Gjykata e Drejtësisë mund t'u kërkojë palëve të paraqesin të gjitha dokumentet dhe të japin të gjithë informacionin që Gjykata e konsideron të nevojshëm. Çdo refuzim do të mbahet shënim formalisht.

---

[1] Nen i shtuar me Vendimin 2008/79/KE, Euratom (OJ L 24, 29.1.2008, fq 42).

Gjykata gjithashtu mund t'u kërkojë Shteteve Anëtare dhe institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive që nuk janë palë në çështje, të japin të gjithë informacionin që Gjykata e konsideron të nevojshëm për procesin.

Neni 25

Gjykata e Drejtësisë mundet që, në çdo kohë, t'i besojë detyrën për të dhënë opinion prej eksperti çdo individi, institucioni, organi, autoriteti, komiteti ose organizatë tjetër që zgjedh.

Neni 26

Dëshmitarët mund të dëgjohen sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Neni 27

Në lidhje me dëshmitarët në mungesë, Gjykata e Drejtësisë ka kompetenca që përgjithësisht u jepen gjykatave dhe mund të vendosë gjoba monetare sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Neni 28

Dëshmitarët dhe ekspertët mund të dëgjohen nën betim të bërë sipas formës së përcaktuar në Rregulloren e Brendshme ose sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin e vendit të dëshmitarit ose ekspertit.

Neni 29

Gjykata e Drejtësisë mund të urdhërojë që një dëshmitar ose ekspert të dëgjohet nga autoriteti gjyqësor i vendbanimit të tij të përhershëm.

Urdhri i dërgohet për zbatim autoritetit gjyqësor kompetent sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme. Dokumentet e hartuara në përputhje me letërporositë i kthehen Gjykatës sipas të njëjtave kushte.

Gjykata mbulon shpenzimet, pa cenuar të drejtën për t'ua ngarkuar ato, kur është rasti i duhur, palëve.

Neni 30

Një Shtet Anëtar trajton çdo shkelje të betimit nga një dëshmitar ose ekspert në të njëjtën mënyrë sikur shkelja të ishte kryer përpara njërës prej gjykatave të tij me juridiksion në çështjet civile. Në shkallën e Gjykatës së Drejtësisë, Shteti Anëtar i përfshirë ndjek shkelësin përpara gjykatës kompetente të tij.

Neni 31

Seanca gjyqësore është me dyer të hapura, përveçse kur, për arsye serioze, Gjykata e Drejtësisë sipas vlerësimit të vet, ose me kërkesë të palëve, vendos ndryshe.

Neni 32

Gjatë seancave dëgjimore, Gjykata e Drejtësisë mund të marrë në pyetje ekspertë, dëshmitarë dhe vetë palët. Megjithatë, këto të fundit, mund t'i drejtohen Gjykatës së Drejtësisë vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Neni 33

Procesverbali mbahet për çdo seancë dëgjimore dhe firmoset nga Kryetari dhe Kancelari.

Neni 34

Lista e çështjeve përcaktohet nga Kryetari.

Neni 35

Debatet gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë zhvillohen dhe mbahen sekret.

Neni 36

Vendimet përmbajnë arsyet mbi të cilat janë bazuar. Ato përmbajnë emrat e Gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në debate.

Neni 37

Vendimet nënshkruhen nga Kryetari dhe Kancelari. Ato lexohen në gjykatë me dyer të hapura.

Neni 38

Gjykata e Drejtësisë vendos për shpenzimet gjyqësore.

Neni 39

Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, me anë të një procedure të shkurtuar e cila, për sa është e nevojshme, mund të ndryshojë nga disa prej rregullave që përmban ky Statut dhe e cila parashikohet në Rregulloren e Brendshme, mund të gjykojë për kërkesat për pezullimin e ekzekutimit, siç e parashikon neni 278 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe neni 157 i Traktatit EURATOM ose të

ndërmarrë masa të ndërmjetme sipas nenit 279 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, ose të pezullojë zbatimin e vendimit në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 229 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian ose paragrafin e tretë të nenit 164 të Traktatit EURATOM.

Nëse Kryetari nuk mund të marrë pjesë në gjykim, zëvendësohet nga një gjyqtar, sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Vendimi i Kryetarit ose i Gjyqtarit që e zëvendëson atë është i përkohshëm dhe nuk cenon në asnjë mënyrë vendimin e Gjykatës për themelin e çështjes.

Neni 40

Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit mund të ndërhyjnë në çështje të ngritura përpara Gjykatës së Drejtësisë.

E njëjta e drejtë është e hapur për organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit dhe për çdo person tjetër që mund të jetë i interesuar për rezultatin e një çështjeje të ngritur përpara Gjykatës. Personat fizikë ose juridikë nuk ndërhyjnë në çështje ndërmjet Shteteve Anëtare, në ato ndërmjet institucioneve të Bashkimit ose ato ndërmjet Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit.

Shtetet, përveç Shteteve Anëtare, të cilat janë palë në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Europiane dhe gjithashtu në Autoritetin e Mbikëqyrjes të SHETL-së të përmendura në atë Marrëveshje, pa cenuar paragrafin e dytë, mund të ndërhyjnë në çështje të ngritura përpara Gjykatës, nëse bëhet fjalë për një nga fushat e zbatimit të asaj Marrëveshjeje.

Kërkesa për të ndërhyrë në proces, kufizohet në mbështetjen e formës së vendimit të kërkuar nga një prej palëve.

Neni 41

Kur pala e paditur, pasi thirret rregullisht, nuk arrin të depozitojë parashtrime me shkrim lidhur me mbrojtjen, vendimi kundër palës jepet në mungesë. Kundërshtimi i vendimit mund të depozitohet brenda një muaji nga njoftimi i tij. Kundërshtimi nuk ka efekt pezullues, mbi zbatimin e vendimit në mungesë, nëse Gjykata e Drejtësisë nuk vendos ndryshe.

Neni 42

Shtete Anëtare, institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit dhe çdo person tjetër fizik apo juridik, në rastet dhe sipas kushteve që duhen përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, iniciojnë procedimin gjyqësor si palë e tretë për të kundërshtuar një vendim të dhënë pa i dëgjuar ata, nëse vendimi cenon të drejtat e tyre.

Neni 43

Nëse kuptimi ose qëllimi i një vendimi është i paqartë, Gjykata e Drejtësisë bën interpretimin e tij me kërkesë të ndonjë pale apo institucioni të Bashkimit që është i interesuar në lidhje me të.

Neni 44

Kërkesa për rishikim të një vendimi mund t'i bëhet Gjykatës së Drejtësisë vetëm me zbulimin e një fakti që ka natyrë të tillë që është faktor vendimtar dhe, për të cilin, Gjykata dhe pala që pretendon rishikimin, nuk kanë qenë në dijeni në kohën kur është dhënë vendimi.

Rishikimi hapet me një vendim të Gjykatës që shprehimisht pasqyron ekzistencën e një fakti të ri, duke pranuar që ky ka natyrë të tillë që çështja mund të hapet për rishikim dhe deklaron të pranueshme kërkesën për këtë arsye.

Pas mbarimit të afatit 10 vjeçar nga data e vendimit, nuk mund të bëhet kërkesë për rishikim.

Neni 45

Afati shtesë, për arsye të largësisë, përcaktohet në Rregulloren e Brendshme.

Asnjë e drejtë nuk cenohet si pasojë e mbarimit të afatit, nëse pala e prekur provon ekzistencën e rrethanave të paparashikueshme ose të forcës madhore.

Neni 46

Ndalohet procedimi kundër Bashkimit në çështje që lindin nga përgjegjësia jashtëkontraktore pas një periudhe pesëvjeçare që nga ndodhja e ngjarjes që ka çuar drejt saj. Periudha e parashkrimit ndërpritet nëse fillon procesi përpara Gjykatës së Drejtësisë ose nëse përpara fillimit të procesit pala e dëmtuar ka paraqitur një kërkesë tek institucioni përkatës i Bashkimit. Në rastin e fundit, procesi duhet të fillojë brenda një periudhe dymujore të parashikuar në nenin 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian; dispozitat e paragrafit të dytë të nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian zbatohen sipas rastit.

Ky nen zbatohet edhe për proceset kundër Bankës Qendrore Europiane në lidhje me përgjegjësinë jashtëkontraktore.

TITULLI IV

GJYKATA E PËRGJITHSHME

Neni 47

Paragrafi i parë i nenit 9, neni 14 dhe 15, paragrafi i parë, i dytë, i katërt dhe i pestë i nenit 17 dhe neni 18 zbatohen për Gjykatën e Përgjithshme dhe anëtarët e saj.

Paragrafi i katërt i nenit 3 dhe neni 10, 11 dhe 14 zbatohen për Kancelarin e Gjykatës së Përgjithshme, *mutatis mutandis*.

Neni 48

Gjykata e Përgjithshme përbëhet nga 27 gjyqtarë.

Neni 49

Anëtarëve të Gjykatës së Përgjithshme mund t'u kërkohet të kryejnë detyrën e një Avokati të Përgjithshëm.

Është detyrë e Avokatit të Përgjithshëm, i cili vepron me paanshmëri dhe pavarësi të plotë, të paraqesë në seancë me dyer të hapura, parashtrime të arsyetuara për çështje të caktuara që janë paraqitur përpara Gjykatës së Përgjithshme për të mbështetur Gjykatën e Përgjithshme në kryerjen e detyrës së saj.

Kriteret për përzgjedhjen e këtyre çështjeve, si dhe procedurat për caktimin e Avokatëve të Përgjithshëm, përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Gjykatës së Përgjithshme.

Anëtari, të cilit i është kërkuar të kryejë detyrën e Avokatit të Përgjithshëm në një çështje,mund të mos marrë pjesë në gjykimin e çështjes.

Neni 50

Gjykata e Përgjithshme mblidhet në dhoma me tre ose pesë gjyqtarë. Gjyqtarët zgjedhin Kryetarët e dhomave mes radhëve të tyre. Kryetarët e dhomave me pesë gjyqtarë zgjidhen për tre vjet. Ata mund të rizgjidhen vetëm një herë.

Përbërja e dhomave dhe caktimi i çështjeve për to rregullohen në Rregulloren e Brendshme. Në çështje të caktuara që rregullohen nga Rregullorja e Brendshme, Gjykata e Përgjithshme mund të mblidhet në seancë plenare ose të përbëhet nga një gjyqtar i vetëm.

Rregullorja e Brendshme mund të parashikojë gjithashtu që Gjykata e Përgjithshme të mblidhet në Dhomë të Madhe në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në të.

Neni 51

Duke u shmangur nga rregulli i përcaktuar në nenin 256(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Gjykatës së Drejtësisë i rezervohet juridiksioni për paditë e përmendura në nenin 263 dhe 265 të Traktatit për Bashkimin Europian kur ato ngrihen nga një Shtet Anëtar kundër:

(a) një veprimi apo mosveprimi të Parlamentit Europian ose Këshillit, ose të atyre institucioneve që veprojnë bashkërisht, përveç:

– vendimeve që merren nga Këshilli sipas nënparagrafit të tretë të nenit 108(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian;

– akteve të Këshillit të miratuara sipas një rregulloreje të Këshillit në lidhje me masat për të mbrojtur tregtinë sipas kuptimit të nenit 207 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian;

– akteve të Këshillit me të cilat Këshilli ushtron kompetenca zbatuese në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 291 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian;

(b) kundër një veprimi ose mosveprimi të Komisionit sipas paragrafit të parë të nenit 331 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Gjykatës së Drejtësisë i rezervohet juridiksion edhe për paditë e përmendura në të njëjtat nene kur ato ngrihen nga një institucion i Bashkimit kundër një veprimi apo mosveprimi të Parlamentit Europian, Këshillit, të dyja këtyre institucioneve kur veprojnë bashkërisht, ose të Komisionit, apo të një institucioni të Bashkimit kundër një veprimi ose mosveprimi të Bankës Qendrore Europiane.

Neni 52

Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë dhe Kryetari i Gjykatës së Përgjithshme, me marrëveshje të përbashkët, përcaktojnë kushtet sipas të cilave zyrtarë dhe nëpunës të tjerë pranë Gjykatës së Drejtësisë ofrojnë shërbimet e tyre për Gjykatën e Përgjithshme duke bërë të mundur funksionimin e saj. Disa zyrtarë ose nëpunës të tjerë të caktuar përgjigjen para Kancelarit të Gjykatës së Përgjithshme nën autoritetin e Kryetarit të Gjykatës së Përgjithshme.

Neni 53

Procedura përpara Gjykatës së Përgjithshme rregullohet në Titullin III.

Rregullime të tilla të nevojshme, të mëtejshme dhe më të hollësishme përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të saj. Rregullorja e Brendshme mund të shmanget nga paragrafi i katërt i nenit 40 dhe nga neni 41 me qëllim që të marrë parasysh veçoritë specifike të procesit gjyqësor në fushën e pronësisë intelektuale.

Avokati i Përgjithshëm, pavarësisht paragrafit të katërt të nenit 20, mund të bëjë parashtrimet e tij të arsyetuara me shkrim.

Neni 54

Nëse një kërkesë ose dokument tjetër procedural që i drejtohet Gjykatës së Përgjithshme, depozitohet gabimisht tek Kancelari i Gjykatës së Drejtësisë, ky ia kalon menjëherë Kancelarit të Gjykatës së Përgjithshme; po kështu, nëse një kërkesë ose dokument tjetër procedural që i drejtohet Gjykatës së Drejtësisë, depozitohet gabimisht tek Kancelari i Gjykatës së Përgjithshme, ky ia kalon menjëherë Kancelarit të Gjykatës së Drejtësisë.

Nëse Gjykata e Përgjithshme konstaton që nuk ka kompetencë për të dëgjuar dhe vendosur për një padi në lidhje me të cilën ka kompetencë Gjykata e Drejtësisë, e dërgon atë padi në Gjykatën e Drejtësisë; po kështu, nëse Gjykata e Drejtësisë konstaton se një padi është kompetencë e Gjykatës së Përgjithshme, e dërgon padinë në Gjykatën e Përgjithshme që në këtë rast nuk mund të tërhiqet nga kompetenca që ka. Nëse Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Përgjithshme janë vënë në lëvizje për çështje ku kërkohet e njëjta zgjidhje, ku paraqitet kërkesa për interpretimin e të njëjtës çështje ose vihet në diskutim vlefshmëria e të njëjtit akt, Gjykata e Përgjithshme, pas dëgjimit të palëve, mund të pezullojë çështjen përpara saj deri kur Gjykata e Drejtësisë të japë një vendim ose nëse padia është ngritur

sipas nenit 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, ajo mund të tërhiqet nga kompetenca në mënyrë që Gjykata e Drejtësisë të lejohet të vendosë për këto padi. Në të njëjtat rrethana, Gjykata e Drejtësisë mund të vendosë gjithashtu të pezullojë çështjen përpara saj; në këtë rast, procesi vazhdon përpara Gjykatës së Përgjithshme.

Kur një Shtet Anëtar dhe një institucion i Bashkimit kundërshtojnë të njëjtin akt, Gjykata e Përgjithshme tërhiqet nga kompetenca në mënyrë që Gjykata e Drejtësisë të vendosë në lidhje me ato kërkesa.

Neni 55

Kancelari i Gjykatës së Përgjithshme bën njoftimin e të gjitha palëve, si dhe të Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit, edhe nëse ato nuk ndërhyjnë në çështjen e ngritur përpara Gjykatës së Përgjithshme, mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës së Përgjithshme, mbi vendimet që zgjidhin pjesërisht çështje lëndore ose që zgjidhin një çështje procedurale në lidhje me një kërkesë për mungesë kompetence ose papranueshmërie.

Neni 56

Vendimet e formës së prerë të Gjykatës së Përgjithshme dhe vendimet e kësaj Gjykate që zgjidhin pjesërisht çështje lëndore ose që zgjidhin një çështje procedurale në lidhje me një kërkesë për mungesë kompetence ose papranueshmëri mund të kundërshtohen përpara Gjykatës së Drejtësisë, brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit që apelohet.

Apelimin mund ta bëjë pala që ka humbur, tërësisht ose pjesërisht, në parashtrimet e veta. Megjithatë, palët ndërhyrëse, përveç Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit mund të apelojnë vetëm nëse preken drejtpërdrejt nga vendimi i Gjykatës së Përgjithshme.

Me përjashtim të çështjeve që lidhen me mosmarrëveshje ndërmjet Bashkimit dhe nëpunësve të tij, apelimi mund të bëhet edhe nga Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit që nuk ndërhyjnë në procese përpara Gjykatës së Përgjithshme. Këto Shtete Anëtare dhe institucione janë në të njëjtin pozicion si Shtetet Anëtare ose institucionet që ndërhyjnë në shkallë të parë.

Neni 57

Çdo person, të cilit i është refuzuar nga Gjykata e Përgjithshme kërkesa për të ndërhyrë në proces, mund të apelojë në Gjykatën e Drejtësisë brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit që refuzon kërkesën.

Palët e procesit, brenda dy muajve nga njoftimi i tyre, mund të apelojnë para Gjykatës së Drejtësisë, kundër çdo vendimi të Gjykatës së Përgjithshme të dhënë sipas nenit 278, nenit 279 ose paragrafit të katërt të nenit 299 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, sipas nenit 157, ose paragrafit të tretë të nenit 164 të traktatit EURATOM,.

Apelimi i përmendur në dy paragrafët e parë të këtij neni dëgjohet dhe vendoset sipas procedurës së përmendur në nenin 39.

Neni 58

Apelimi në Gjykatën e Drejtësisë bëhet vetëm për çështje të interpretimit ligjor. Ai bëhet për mungesë të kompetencës së Gjykatës së Përgjithshme, për shkelje procedure përpara saj që prek negativisht interesat e apeluesit si dhe për shkelje të së drejtës së Bashkimit nga Gjykata e Përgjithshme.

Apelimi nuk bëhet në lidhje me shumën e shpenzimeve apo palën që është urdhëruar t'i paguajë ato.

Neni 59

Nëse apelimi bëhet kundër një vendimi të Gjykatës së Përgjithshme, procedura përpara Gjykatës së Drejtësisë përbëhet nga pjesa me shkrim dhe pjesa me gojë. Në përputhje me kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, Gjykata e Drejtësisë, pasi ka dëgjuar Avokatin e Përgjithshëm dhe palët, mund të lërë mënjanë procedurën verbale.

Neni 60

Pa cenuar nenet 278 dhe 279 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, ose nenin 157 të Traktatit EUROATOM, apelimi nuk ka efekt pezullues.

Duke u shmangur nga neni 280 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, vendimet e Gjykatës së Përgjithshme që shpallin pavlefshmërinë e një rregulloreje, hyjnë në fuqi vetëm duke filluar nga data e mbarimit të periudhës së përmendur në paragrafin e parë të nenit 56 të këtij Statuti, ose, nëse apelimi bëhet brenda kësaj periudhe, duke filluar nga data e rrëzimit të apelimit, megjithatë, pa cenuar të drejtën e një pale për të kërkuar, përpara Gjykatës së Drejtësisë, sipas neneve 278 dhe 279 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian ose nenit 157 të Traktatit EUROATOM, pezullimin e pasojave të rregullores që është shpallur e pavlefshme ose caktimin e ndonjë mase tjetër të ndërmjetme.

Neni 61

Nëse apelimi është i argumentuar plotësisht, Gjykata e Drejtësisë e rrëzon vendimin e Gjykatës së Përgjithshme. Ajo vetë mund të japë vendimin përfundimtar për atë çështje, nëse e lejon gjendja e procedimit, ose mund t'ia kthejë çështjen Gjykatës së Përgjithshme për vendim.

Nëse një çështje i kthehet Gjykatës së Përgjithshme, vendimi i Gjykatës së Drejtësisë për çështje interpretimi ligjor është i detyrueshëm për atë Gjykatë.

Nëse apelimi i bërë nga një Shtet Anëtar ose institucion i Bashkimit që nuk ka ndërhyrë në procedimet përpara Gjykatës së Përgjithshme, është i argumentuar mirë, Gjykata e Drejtësisë, nëse e konsideron të nevojshme, mund të përcaktojë se cilat nga pasojat e vendimit të Gjykatës së Përgjithshme që është rrëzuar do të konsiderohen si vendimtare në lidhje me palët në proces.

Neni 62

Në rastet e parashikuara në nenin 256(2) dhe(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, kur Avokati i Parë i Përgjithshëm gjykon se ekziston një rrezik serioz që të preket uniteti apo njëtrajtshmëria e të drejtës së Bashkimit, ai mund të propozojë që Gjykata e Drejtësisë të rishikojë vendimin e Gjykatës së Përgjithshme.

Propozimi duhet bërë me shkrim brenda një muaji nga dalja e vendimit nga Gjykata e Përgjithshme. Gjykata e Drejtësisë, brenda një muaji nga marrja e propozimit të bërë nga Avokati i Parë i Përgjithshëm, vendos nëse vendimi duhet të rishikohet apo jo.

Neni 62a

Gjykata e Drejtësisë vendos për pikat që i nënshtrohen rishikimit me anë të një procedure urgjente bazuar në dosjen që i është dërguar nga Gjykata e Përgjithshme.

Ato që përmenden në nenin 23 të këtij Statuti dhe, në rastet e parashikuara në nenin 256(2) të traktatit KE, palët pjesëmarrëse në procedimet përpara Gjykatës së Përgjithshme, kanë të drejtë të depozitojnë deklarata ose konstatime me shkrim para Gjykatës së Drejtësisë në lidhje me çështjet që i nënshtrohen rishikimit brenda një periudhe të caktuar për këtë qëllim.

Gjykata e Drejtësisë mund të vendosë të fillojë procedurën verbale përpara se të nxjerrë një vendim.

Neni 62b

Në çështjet e parashikuara në nenin 256(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, pa cenuar nenet 278 dhe 279 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, propozimet për rishikim dhe vendimet për të filluar procedurën e rishikimit nuk kanë efekt pezullues. Nëse Gjykata e Drejtësisë vëren që vendimi i Gjykatës së Përgjithshme prek unitetin ose njëtrajtshmërinë e së drejtës së Bashkimit, ia kthen çështjen Gjykatës së Përgjithshme, për të cilën, çështja e interpretimit ligjor të vendosur nga Gjykata e Drejtësisë është e detyrueshme; Gjykata e Drejtësisë mund të shprehet se cilat pasoja të vendimit të Gjykatës së Përgjithshme duhet të konsiderohen si vendimtare në lidhje me palët në proces. Megjithatë, duke pasur parasysh rezultatet e rishikimit, nëse rezultati i procesit gjyqësor rrjedh nga konstatime të fakteve mbi të cilat është bazuar vendimi i Gjykatës së Përgjithshme, Gjykata e Drejtësisë nxjerr vendim të formës së prerë.

Në çështjet e parashikuara në nenin 256(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, në mungesë të propozimeve për rishikim ose vendimeve për të filluar procedurë rishikimi, përgjigja/përgjigjet e dhëna nga Gjykata e Përgjithshme për çështjet që i paraqiten, hyjnë në fuqi pas mbarimit të periudhave të caktuara për atë qëllim në paragrafin e dytë të nenit 62. Nëse fillon një procedurë rishikimi, përgjigja/përgjigjet që i nënshtrohen rishikimit hyjnë në fuqi pas kësaj procedure, nëse Gjykata e Drejtësisë nuk vendos ndryshe. Nëse Gjykata e Drejtësisë vëren që vendimi i Gjykatës së Përgjithshme prek unitetin ose njëtrajtshmërinë e të drejtës së Bashkimit, përgjigja e dhënë nga Gjykata e Drejtësisë për çështjet që i nënshtrohen rishikimit, zëvendësohet me atë që jep Gjykata e Përgjithshme.

TITULLI IVa

GJYKATAT E SPECIALIZUARA

Neni 62c

Dispozitat në lidhje me juridiksionin, përbërjen, organizimin dhe procedurën e gjykatave të specializuara të krijuara sipas nenit 257 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian parashikohen në një shtojcë të këtij Statuti.

TITULLI V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 63

Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Drejtësisë dhe e Gjykatës së Përgjithshme përmbajnë dispozitat e nevojshme për ta zbatuar dhe, kur është e nevojshme, për ta plotësuar këtë Statut.

Neni 64

Rregullat që përcaktojnë çështjet gjuhësore, të zbatueshme për Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Europian, përcaktohen me një rregullore të Këshillit me unanimitet. Kjo rregullore miratohet ose me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë dhe pas konsultimit me Komisionin dhe Parlamentin Europian, ose me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Gjykatën e Drejtësisë dhe Parlamentin Europian.

Dispozitat e Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Drejtësisë dhe Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Përgjithshme që parashikojnë masa organizative gjuhësore, do të vazhdojnë të zbatohen, deri në miratimin e këtyre rregullave. Duke u shmangur nga neni 253 dhe 254 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, këto dispozita mund të ndryshohen ose shfuqizohen vetëm me pëlqimin unanim të Këshillit.

———

SHTOJCA I

GJYKATA E SHËRBIMIT CIVIL E BASHKIMIT EUROPIAN

Neni 1

Gjykata e Shërbimit Civil e Bashkimit Europian (në vijim "Gjykata e Shërbimit Civil") ka juridiksion fillestar për mosmarrëveshjet ndërmjet Bashkimit dhe nëpunësve të tij të përmendur në nenin 270 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, duke përfshirë mosmarrëveshjet ndërmjet gjithë organeve ose agjencive dhe nëpunësve të tyre në lidhje me të cilat kompetenca i është dhënë Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian.

Neni 2

Gjykata e Shërbimit Civil përbëhet nga shtatë gjyqtarë. Nëse e kërkon Gjykata e Drejtësisë, Këshilli, më shumicë të cilësuar, mund ta rrisë numrin e gjyqtarëve.

Gjyqtarët mund të emërohen për një periudhë gjashtëvjeçare. Gjyqtarët, të cilëve u ka mbaruar mandati, mund të riemërohen.

Çdo vend vakant plotësohet me emërimin e një gjyqtari të ri për një periudhë gjashtëvjeçare.

Neni 3

1. Gjyqtarët emërohen nga Këshilli, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 257 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, pas konsultimit me komitetin e parashikuar në këtë nen. Këshilli, kur emëron gjyqtarët, siguron përbërje të drejtpeshuar të Gjykatës së Shërbimit Civil me përhapjen më të gjerë të mundshme gjeografike nga radhët e shtetasve të Shteteve Anëtare dhe duke pasur parasysh sistemet juridike kombëtare të përfaqësuara.

2. Çdo person që është qytetari Bashkimit dhe që përmbush kushtet e përcaktuara në paragrafin e katërt të nenit 257 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian mund të paraqesë një kërkesë. Këshilli, bazuar në një rekomandim të Gjykatës së Drejtësisë, përcakton kushtet dhe masat organizative për paraqitjen dhe shqyrtimin e këtyre kërkesave.

3. Krijohet një komitet i përbërë nga shtatë persona të zgjedhur mes ish-anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme dhe juristëve me zotësi të njohura. Anëtarësia në komitet dhe rregullat funksionale përcaktohen nga Këshilli bazuar në rekomandimin e Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë.

4. Komiteti jep opinion mbi përshtatshmërinë e kandidatëve për të kryer detyrat e gjyqtarit në Gjykatën e Shërbimit Civil. Komiteti i bashkëngjit opinionit të vet listën e kandidatëve që kanë eksperiencën më të përshtatshme të nivelit të lartë. Numri i kandidatëve emrat e të cilëve përmban kjo listë është, të paktën, dy herë më i madh se numri i gjyqtarëve që do të emërojë Këshilli.

Neni 4

1. Gjyqtarët zgjedhin Kryetarin e Gjykatës së Shërbimit Civil mes radhëve të tyre për një mandat trevjeçar. Ai mund të rizgjidhet.

2. Gjykata e Shërbimit Civil mblidhet në dhoma me tre gjyqtarë. Në disa prej rasteve të përcaktuara në rregulloren e saj të brendshme, ajo mund të mblidhet në seancë plenare ose në një dhomë me pesë gjyqtarë ose me një gjyqtar të vetëm.

3. Kryetari i Gjykatës së Shërbimit Civil kryeson seancën plenare dhe dhomën me pesë gjyqtarë. Kryetarët e dhomave me tre gjyqtarë, përcaktohen siç e parashikon paragrafi 1. Nëse Kryetari i Gjykatës së Shërbimit Civil caktohet në një dhomë me tre gjyqtarë, ai kryeson atë dhomë.

4. Juridiksioni dhe kuorumi për seancën plenare si dhe përbërja e dhomave dhe caktimi i çështjeve në to rregullohet me rregulloren e brendshme.

Neni 5

Nenet 2 deri në 6, 14, 15, paragrafi i parë, i dytë dhe i pestë i nenit 17 dhe neni 18 i Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian zbatohen për Gjykatën e Shërbimit Civil dhe anëtarët e saj.

Betimi i përmendur në nenin 2 të Statutit bëhet përpara Gjykatës së Drejtësisë dhe vendimet e përmendura në nenet 3, 4 dhe 6 të tij miratohen nga Gjykata e Drejtësisë pas konsultimit me Gjykatën e Shërbimit Civil.

Neni 6

1. Gjykata e Shërbimit Civil mbështetet nga departamentet e Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme. Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë ose, sipas rastit, Kryetari i Gjykatës së Përgjithshme, vendosin me marrëveshje të përbashkët me Kryetarin e Gjykatës së Shërbimit Civil, kushtet sipas të cilave zyrtarët dhe nëpunës të tjerë pranë Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Përgjithshme ofrojnë shërbimet e tyre për Gjykatën e Shërbimit Civil, me qëllim që të mundësohet funksionimi i saj. Disa zyrtarë ose nëpunës të tjerë përgjigjen përpara Kancelarit të Gjykatës së Shërbimit Civil nën autoritetin e Kryetarit të kësaj Gjykate.

2. Gjykata e Shërbimit Civil emëron Kancelarin e vet dhe përcakton rregullat që rregullojnë shërbimin e tij. Paragrafi i katërt i nenit 3 dhe nenet 10, 11 dhe 14 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian zbatohen për Kancelarin e Gjykatës.

Neni 7

1. Procedura përpara Gjykatës të Shërbimit Civil rregullohet me Titullin III të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, me përjashtim të neneve 22 dhe 23. Dispozitat e tjera të mëtejshme dhe më të hollësishme që janë të nevojshme përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të saj.

2. Dispozitat në lidhje me masat organizative gjuhësore të Gjykatës së Përgjithshme zbatohen edhe për Gjykatën e Shërbimit Civil.

3. Faza me shkrim e procedurës përbëhet nga paraqitja e kërkesës dhe deklaratave të mbrojtjes, përveç rasteve kur Gjykata e Shërbimit Civil vendos që një shkëmbim i dytë i kërkesave me shkrim është i nevojshëm. Nëse bëhet një shkëmbim i dytë, Gjykata e Shërbimit Civil mundet, me miratimin e palëve, të vendosë të procedojë me marrjen e vendimit pa procedurën me shkrim.

4. Gjykata e Shërbimit Civil, në të gjitha fazat e procedurës, duke përfshirë edhe kohën e depozitimit të kërkesës, mund të shqyrtojë mundësitë e një zgjidhjeje miqësore të mosmarrëveshjes dhe mund të përpiqet të lehtësojë këtë zgjidhje.

5. Gjykata e Shërbimit Civil vendos për shpenzimet gjyqësore të çështjes. Sipas dispozitave specifike të Rregullores së Brendshme, pala që humbet urdhërohet të paguajë shpenzimet gjyqësore, nëse këtë e vendos gjykata.

Neni 8

1. Nëse një kërkesë ose dokument tjetër procedural drejtuar Gjykatës së Shërbimit Civil depozitohet gabimisht tek Kancelari i Gjykatës së Drejtësisë ose Kancelari i Gjykatës së Përgjithshme, Kancelari i këtyre të fundit ia kalon menjëherë Kancelarit të Gjykatës së Shërbimit Civil. Po kështu, nëse një kërkesë ose dokument tjetër procedural, drejtuar Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Përgjithshme, depozitohet gabimisht tek Kancelari i Gjykatës së Shërbimit Civil, ky Kancelar ia kalon menjëherë Kancelarit të Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Përgjithshme.

2. Nëse Gjykata e Shërbimit Civil konstaton që nuk ka kompetencë të dëgjojë dhe vendosë për padi që janë kompetencë e Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Përgjithshme, ia kalon padinë Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Përgjithshme. Po kështu, nëse Gjykata e Drejtësisë ose Gjykata e Përgjithshme konstaton që padia është në kompetencë të Gjykatës së Shërbimit Civil, sipas rastit, Gjykata ku është ngritur padia, ia kalojnë padinë Gjykatës së Shërbimit Civil, që në këtë rast nuk mund të tërhiqet nga kompetenca që ka.

3. Nëse në Gjykatën e Shërbimit Civil dhe në Gjykatën e Përgjithshme janë ngritur çështje ku gjendet e njëjta çështje interpretimi ose është vënë në diskutim vlefshmëria e të njëjtit akt, Gjykata e Shërbimit Civil, pas dëgjimit të palëve, mund të pezullojë çështjen deri në nxjerrjen e vendimit të Gjykatës së Përgjithshme.

Nëse në Gjykatën e Shërbimit Civil dhe në Gjykatën e Drejtësisë janë paraqitur çështje ku kërkohet e njëjta zgjidhje, Gjykata e Shërbimit Civil tërhiqet nga kompetenca në mënyrë që Gjykata e Përgjithshme të vendosë për këto çështje.

Neni 9

Vendimet e formës së prerë të Gjykatës së Shërbimit Civil dhe vendimet e kësaj Gjykate që zgjidhin pjesërisht çështje lëndore ose që zgjidhin një çështje procedurale në lidhje me një kërkesë për mungesë kompetence ose papranueshmëri mund të apelohen përpara Gjykatës së Përgjithshme, brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit që apelohet.

Apelimi mund të bëhet nga çdo palë që ka qenë e pasuksesshme, tërësisht ose pjesërisht, në parashtrimet e veta. Megjithatë, palët ndërhyrëse përveç Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit mund të apelojnë vetëm nëse preken drejtpërdrejt nga vendimi i Gjykatës së Shërbimit Civil.

Neni 10

1. Çdo person të cilit i është refuzuar nga Gjykata e Shërbimit Civil kërkesa për të ndërhyrë, mund të apelojë brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit që refuzon kërkesën.

2. Palët në procedim mund të apelojnë para Gjykatës së Përgjithshme, brenda dy muajve nga njoftimi i tyre, çdo vendim të Gjykatës së Shërbimit Civil të marrë sipas nenit 278, nenit 279 ose paragrafit të katërt të nenit 299 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, sipas nenit 157, ose paragrafit të tretë të nenit 164 të traktatit EURATOM,

3. Kryetari i Gjykatës së Përgjithshme me anë të një procedure të shkurtuar e cila, përsa është e nevojshme, mund të ndryshojë nga disa rregulla që përmban kjo Shtojcë dhe që përcaktohen në rregulloren e brendshme të Gjykatës së Përgjithshme, të gjykojë apelimet e bëra sipas pikës 1 dhe 2.

Neni 11

1. Apelimi në Gjykatën e Përgjithshme përfshin vetëm çështje të interpretimit ligjor. Apelimi bëhet për mungesë kompetence të Gjykatës së Shërbimit Civil, për shkelje të procedurës përpara saj që prek interesat e apeluesit si dhe për shkeljen e të drejtës së Bashkimit nga Gjykata.

2. Nuk bëhet ankim në lidhje me shumën e shpenzimeve apo palën që është urdhëruar t'i paguajë ato.

Neni 12

1. Pa cenuar nenin 278 dhe 279 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, ose nenin 157 të Traktatit EUROATOM, apelimi i bërë përpara Gjykatës së Përgjithshme, nuk ka efekt pezullues.

2. Nëse apelimi bëhet kundër një vendimi të Gjykatës së Shërbimit Civil, procedura përpara Gjykatës së Përgjithshme përbëhet nga pjesa me shkrim dhe pjesa me gojë. Në përputhje me kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, Gjykata e Përgjithshme, pasi ka dëgjuar palët, mund të lërë mënjanë procedurën verbale.

Neni 13

1. Nëse ankimi është i argumentuar, Gjykata e Përgjithshme e rrëzon vendimin e Gjykatës së Shërbimit Civil dhe jep vendim për çështjen vetë. Nëse situata e procedimit nuk lejon një vendim nga Gjykata e Përgjithshme, kjo ia kthen çështjen Gjykatës së Shërbimit Civil.

2. Nëse çështja i kthehet Gjykatës së Shërbimit Civil, vendimi i Gjykatës së Përgjithshme, për çështje interpretimi ligjor, është i detyrueshëm për këtë Gjykatë.

———

PROTOKOLLI (nr. 4)

PËR STATUTIN E SISTEMIT EUROPIAN TË BANKAVE QENDRORE DHE TË BANKËS QENDRORE EUROPIANE

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të përcaktuar Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 129 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit të Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

KREU I

SISTEMI EUROPIAN I BANKAVE QENDRORE

Neni 1

Sistemi Europian i Bankave Qendrore

Banka Qendrore Europiane (BQE) dhe bankat qendrore kombëtare, në përputhje me nenin 282(1) të Traktatit për Bashkimin Europian, përbëjnë Sistemin Europian të Bankave Qendrore (SEBQ). BQE dhe bankat qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare, monedha e të cilave është euroja, përbëjnë Eurosistemin.

SEBQ dhe BQE kryejnë detyrat e tyre dhe realizojnë aktivitetet e tyre në përputhje me dispozitat e Traktateve dhe të këtij Statuti.

KREU II

OBJEKTIVAT DHE DETYRAT E SEBQ-SË

Neni 2

Objektivat

Në përputhje me nenin 127(1) dhe nenin 282(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, objektivi parësor i SEBQ-së është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Pa cenuar objektivin e qëndrueshmërisë së çmimeve, SEBQ mbështet politikat e përgjithshme ekonomike në Bashkim në mënyrë të atillë që të kontribuojë në arritjen e objektivave të Bashkimit, siç parashikohen në nenin 3 të Traktatit për Bashkimin Europian. SEBQ-ja vepron në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar një shpërndarje efikase të burimeve dhe në përputhje me parimet e parashikuara në nenin 119 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 3

Detyrat

3.1. Në përputhje me nenin 127(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, detyrat kryesore që duhet të kryhen nëpërmjet SEBQ-së janë:

– përcaktimi dhe zbatimi i politikës monetare të Bashkimit;

– kryerja e operacioneve të këmbimit valutor në përputhje me dispozitat e nenit 219 të atij Traktati;

– mbajtja dhe administrimi i rezervave zyrtare në valutë të huaj të Shteteve Anëtare;

– nxitja e funksionimit pa probleme të sistemit të pagesave.

3.2. Në përputhje me nenin 127(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nënpika e tretë e nenit 3.1 nuk cenon mbajtjen dhe administrimin nga qeveritë e Shteteve Anëtare të tepricave qarkulluese të monedhës së huaj.

3.3. Në përputhje me nenin 127(5) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, SEBQ kontribuon në realizimin pa pengesa të politikave që ndjekin autoritetet kompetente në lidhje me mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe qëndrueshmërinë e sistemin financiar.

Neni 4

Funksionet këshillimore

Në përputhje me nenin 127(4) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

(a) BQE konsultohet:

– për çdo akt të propozuar të Bashkimit në fushat e kompetencës së vet,

– nga autoritetet kombëtare, në lidhje me çdo projekt-dispozitë ligjore në fushat e saj të kompetencës, por brenda kufijve dhe sipas kushteve që ka parashikuar Këshilli në përputhje me procedurën e përcaktuara në nenin 41;

(b) Banka Qendrore Europiane mund t'u paraqesë opinione institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të duhura të Bashkimit ose autoriteteve kombëtare, për çështje që janë kompetencë e saj.

Neni 5

Mbledhja e informacionit statistikor

5.1. Për të marrë përsipër detyrat e SEBQ-së, BQE, e mbështetur nga bankat qendrore kombëtare, mbledh informacionin e nevojshëm statistikor ose nga autoritetet kompetente kombëtare ose direkt nga operatorët ekonomikë. Për këto qëllime, ajo bashkëpunon me institucione, organe, zyra ose agjenci të Bashkimit dhe me autoritete kompetente të Shteteve Anëtare ose vendeve të treta dhe me organizata ndërkombëtare.

5.2. Bankat qendrore kombëtare kryejnë, në masën më të madhe të mundshme, detyrat e përshkruara në nenin 5.1.

5.3. BQE kontribuon, kur është e nevojshme, në harmonizimin e rregullave dhe praktikave për mbledhjen, hartimin dhe shpërndarjen e statistikave në fushat brenda kompetencës së saj.

5.4. Këshilli, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 41, përcakton personat fizikë dhe juridikë si subjekte që u nënshtrohen kërkesave për raportim, rregullave të konfidencialitetit dhe dispozitave të duhura për ekzekutimin.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërkombëtar

6.1. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, që përfshin detyrat që i janë ngarkuar SEBQ-së, BQE vendos mënyrën e përfaqësimit të SEBQ-së.

6.2. BQE dhe, me miratimin e saj, bankat qendrore kombëtare mund të marrin pjesë në institucione ndërkombëtare monetare.

6.3. Nenet 6.1 dhe 6.2 nuk cenojnë nenin 138 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

KREU III

ORGANIZIMI I SEBQ-SË

Neni 7

Pavarësia

Në përputhje me nenin 130 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, gjatë ushtrimit të kompetencave dhe kryerjes së detyrave dhe angazhimeve që u ngarkojnë Traktatet dhe ky Statut, as BQE, as ndonjë bankë qendrore kombëtare si dhe as ndonjë anëtar i organeve të tyre të vendimmarrjes nuk kërkon apo merr udhëzime nga institucionet, organet, zyrat ose agjencitë e Bashkimit, nga ndonjë qeveri e një Shteti Anëtar apo organ tjetër. Institucionet, organet, zyrat ose agjencitë e Bashkimit dhe qeveritë e Shteteve Anëtare marrin përsipër ta respektojnë këtë parim dhe të mos kërkojnë të ndikojnë tek anëtarët e organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore Europiane ose të bankave qendrore kombëtare në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 8

Parime të përgjithshme

SEBQ drejtohet nga organet vendimmarrëse të BQE.

Neni 9

Banka Qendrore Europiane

9.1. BQE, e cila, në përputhje me nenin 282(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, ka personalitet juridik, gëzon në çdo Shtet Anëtar zotësinë juridike më të gjerë që u njihet personave juridikë, sipas legjislacionit të tyre; në veçanti, mund të fitojë ose të disponojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mund të jetë palë në procedimet ligjore.

9.2. BQE siguron që detyrat që i janë adeleguar SEBQ-së sipas nenit 127(2), (3) dhe (5) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian të kryhen ose nëpërmjet aktiviteteve të veta sipas këtij Statuti ose nëpërmjet bankave qendrore kombëtare sipas neneve 12.1 dhe 14.

9.3. Në përputhje me nenin 129 (1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, organet vendimmarrëse të BQE-së janë Këshilli Drejtues dhe Bordi Ekzekutiv.

Neni 10

Këshilli Drejtues

10.1. Në përputhje me nenin 283(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Këshilli Drejtues përbëhet nga anëtarët e Bordit Ekzekutiv të BQE-së dhe guvernatorët e bankave qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja.

10.2. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtën e një vote. Çdo anëtar i Bordit Ekzekutiv, që nga data kur numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues kalon shifrën 21, ka një votë dhe numri i guvernatorëve me të drejtë vote është 15. E drejta e këtyre të fundit për të votuar caktohet dhe ndryshon me rotacion si më poshtë:

– që nga data kur numri i guvernatorëve kalon shifrën 15, deri kur arrin 22, guvernatorët caktohen në dy grupe, sipas një renditjeje të pjesës që zë Shteti Anëtar i bankës kombëtare qendrore të tyre në produktin e brendshëm bruto agregat me çmimin e tregut dhe në bilancin gjithsej agregat të institucioneve financiare monetare të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja. Pjesët në produktin e brendshëm bruto agregat me çmim tregu dhe në bilancin total agregat të institucioneve financiare monetare marrin, përkatësisht, një koeficient ponderimi prej 5/6 dhe 1/6. Grupi i parë përbëhet nga pesë guvernatorë dhe grupi i dytë nga guvernatorët që mbeten. Shpeshtësia e të drejtës së guvernatorëve në grupin e parë për të votuar nuk është më e ulët sesa shpeshtësia e të drejtës së atyre të grupit të dytë për të votuar. Sipas fjalisë së mësipërme, grupit të parë i jepet e drejta për katër vota dhe grupit të dytë e drejta për njëmbëdhjetë vota,

– që nga data kur numri i guvernatorëve arrin shifrën 22 , ata caktohen në tre grupe sipas një renditjeje bazuar në kriteret e mësipërme. Grupi i parë përbëhet nga pesë guvernatorë dhe i jepet e drejta për katër vota. Grupi i dytë përbëhet nga gjysma e numrit gjithsej të guvernatorëve, shifër e cila rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt, dhe i jepet e drejta për tetë vota. Grupi i tretë përbëhet nga guvernatorët që mbeten dhe i jepet e drejta për tri vota,

– brenda çdo grupi guvernatorët kanë të drejtën e votës për periudha kohore të barabarta,

– për llogaritjen e pjesëve në produktin e brendshëm bruto agregat me çmime tregu zbatohet neni

29.2. Bilanci gjithsej agregat i institucioneve financiare monetare llogaritet në përputhje me kuadrin statistikor të zbatueshëm në Bashkim në kohën e llogaritjes,

– sa herë që produkti i brendshëm bruto agregat me çmime tregu rregullohet në përputhje me nenin 29.3, ose sa herë që rritet numri i guvernatorëve, madhësia dhe/ose përbërja e grupeve rregullohet në përputhje me parimet e mësipërme,
– Këshilli Drejtues, me dy të tretat e shumicës së gjithë anëtarëve të tij, me dhe pa të drejtë vote, merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e parimeve të mësipërme dhe mund të vendosë të shtyjë në kohë fillimin e sistemit me rotacion deri në datën kur numri i guvernatorëve kalon shifrën 18.

E drejta për të votuar është një e drejtë vetjake. Duke u shmangur nga ky rregull, Rregullorja e Brendshme e përmendur në nenin 12.3 mund të përcaktojë që anëtarët e Këshillit Drejtues mund ta hedhin votën e tyre nëpërmjet telekonferencës. Këto rregulla parashikojnë gjithashtu që një anëtar i Këshillit Drejtues që nuk mund të marrë pjesë në takime të Këshillit Drejtues për një kohë të gjatë, mund të emërojë një zëvendësues si anëtar në Këshillin Drejtues.

Dispozitat e paragrafëve të mësipërm nuk cenojnë të drejtën e votës së të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues, me apo pa të drejtë vote, sipas neneve 10.3, 40.2 dhe 40.3.

Përveç rasteve kur ky Statut parashikon ndryshe, Këshilli Drejtues vendos me shumicë të thjeshtë të anëtarëve me të drejtë vote. Në rast balotazhi, Kryetari ka votën vendimtare.

Që Këshilli Drejtues të votojë, nevojitet kuorumi i dy të tretave të anëtarëve me të drejtë vote. Nëse nuk arrihet kuorumi, Kryetari mund të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme ku vendimet mund të merren pa kuorumin e nevojshëm.

10.3. Për çdo vendim që do të merret sipas neneve 28, 29, 30, 32 dhe 33, votat e Këshillit Drejtues ponderohen sipas përqindjes që kanë bankat qendrore kombëtare në kapitalin e nënshkruar të BQE-së. Koeficienti i ponderimit për votat e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv është zero. Vendimi që kërkon shumicë të cilësuar miratohet nëse votat e hedhura në favor përfaqësojnë dy të tretat e kapitalit të nënshkruar të BQE-së dhe të paktën gjysmën e aksionarëve. Nëse një Guvernator nuk ka mundësi të jetë i pranishëm, ai mund të emërojë një zëvendësues të hedhë votën e tij të ponderuar.

10.4. Punimet e mbledhjeve janë konfidenciale. Këshilli Drejtues mund të vendosë të bëjë publik rezultatin e diskutimeve të tij.

10.5. Këshilli Drejtues mblidhet të paktën 10 herë në vit.

Neni 11

Bordi Ekzekutiv

11.1. Bordi Ekzekutiv, në përputhje me nënparagrafin e parë të nenit 283(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe katër anëtarë të tjerë.

Anëtarët i kryejnë detyrat e tyre me kohë të plotë. Asnjë anëtar nuk mund të angazhohet në ndonjë veprimtari, fitimprurëse apo jo, nëse Këshilli Drejtues nuk bën ndonjë përjashtim të veçantë.

11.2. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe anëtarët e tjerë të Bordit Ekzekutiv, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 283(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, emërohen nga Këshilli Europian me shumicë të cilësuar, mes personave me reputacion të njohur dhe përvojë profesionale në çështje monetare dhe bankare, me rekomandim të Këshillit pas konsultimit të këtij të fundit me Parlamentin Europian dhe Këshillin Drejtues.

Mandati i tyre në detyrë është tetëvjeçar dhe nuk përtërihet.
Anëtarë të Bordit Ekzekutiv mund të jenë vetëm shtetasit e Shteteve Anëtare.

11.3. Afatet dhe kushtet e punësimit të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv, sidomos pagat, pensionet dhe përfitimet e tjera të sigurimeve shoqërore, u nënshtrohen kontratave me BQE-në dhe caktohen nga Këshilli Drejtues me propozim të një Komiteti të përbërë nga tre anëtarë të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues dhe tre anëtarë të cilët emërohen nga Këshilli. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv nuk kanë të drejtë vote për çështjet e përmendura në këtë paragraf.

11.4. Gjykata e Drejtësisë, me kërkesë të Këshillit Drejtues ose të Bordit Ekzekutiv mund të largojë me detyrim një anëtar të Bordit Ekzekutiv nëse ai nuk përmbush më tej kushtet e kërkuara për kryerjen e detyrave të tij, ose nëse ka qenë fajtor për shkelje të rënda.

11.5. Çdo anëtar i Bordit Ekzekutiv i pranishëm ka të drejtën për të votuar dhe ka një votë për këtë qëllim. Përveçse kur parashikohet ndryshe, Bordi Ekzekutiv vendos me shumicën e thjeshtë të votave të hedhura. Në rast balotazhi, Kryetari ka votën vendimtare. Rregullat e votimit specifikohen në Rregulloren e Brendshme të përmendur në nenin 12.3.

11.6. Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për funksionimin aktual të BQE-së.

11.7. Çdo vend i lirë në Bordin Ekzekutiv plotësohet me emërimin e një anëtari të ri, në përputhje me nenin 11.2.

Neni 12

Përgjegjësitë e organeve vendimmarrëse

12.1. Këshilli Drejtues miraton orientimet dhe merr vendimet e nevojshme për të siguruar kryerjen e detyrave që i janë ngarkuar SEBQ-së sipas këtyre Traktateve dhe këtij Statuti. Këshilli Drejtues formulon politikat monetare të Bashkimit duke përfshirë, sipas rastit, vendimet në lidhje me objektivat monetare të ndërmjetme, skemën e normave të interesit dhe sigurimin e rezervave në SEBQ dhe përcakton orientimet e nevojshme për zbatimin e tyre.

Bordi Ekzekutiv zbaton politikën monetare në përputhje me orientimet dhe vendimet e përcaktuara nga Këshilli Drejtues. Në këtë kuadër, Bordi Ekzekutiv u jep bankave qendrore kombëtare udhëzimet e nevojshme. Bordi Ekzekutiv mund të ketë edhe kompetenca të caktuara që i janë deleguar nëse këtë e vendos Këshilli Drejtues.

BQE, në masën e gjykuar të mundshme dhe të përshtatshme dhe pa cenuar dispozitat e këtij neni, u drejtohet bankave qendrore kombëtare për të kryer veprime të cilat janë pjesë e detyrave të SEBQ-së.

12.2. Bordi Ekzekutiv ka përgjegjësi për përgatitjen e takimeve të Këshillit Drejtues.

12.3. Këshilli Drejtues miraton Rregulloren e Brendshme e cila përcakton organizimin e brendshëm të BQE-së dhe organeve vendimmarrëse të kësaj.

12.4. Këshilli Drejtues ushtron funksionet e këshillimit të përmendura në nenin 4.

12.5. Këshilli Drejtues merr vendimet e përmendura në nenin 6.

Neni 13

Kryetari

13.1. Kryetari, ose në mungesë të tij, Zëvendëskryetari, kryeson Këshillin Drejtues dhe Bordin Ekzekutiv të BQE-së.

13.2. Kryetari ose i emëruari i tij, pa cenuar nenin 38, përfaqëson BQE-në në marrëdhëniet e jashtme.

Neni 14

Bankat qendrore kombëtare

14.1. Çdo Shtet Anëtar, në përputhje me nenin 131 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, siguron përputhshmërinë e legjislacionit të tij kombëtar, përfshirë këtu statutet e bankës së tij qendrore, me këto Traktate dhe këtë Statut.

14.2. Statutet e bankave qendrore kombëtare, parashikojnë sidomos që mandati në detyrë i një Guvernatori të një banke qendrore kombëtare të mos jetë më pak se pesë vjet.

Guvernatori mund të lirohet nga detyra vetëm nëse nuk plotëson më kushtet e kërkuara për kryerjen e detyrave të tij ose nëse është fajtor për shkelje të rëndë. Guvernatori në fjalë ose Këshilli Drejtues mund t'i drejtohet Gjykatës së Drejtësisë për një vendim të tillë për shkaqe që lidhen me shkelje të këtyre Traktateve apo të ndonjë norme ligjore në lidhje me zbatimin e tyre. Ky proces fillon brenda dy muajve nga botimi i vendimit ose njoftimi i tij tek paditësi, ose, në mungesë të kësaj, nga dita kur ky i fundit ka marrë dijeni, sipas rrethanave të rastit.

14.3. Bankat qendrore kombëtare janë pjesë përbërëse e SEBQ-së dhe veprojnë në përputhje me orientimet dhe udhëzimet e BQE-së. Këshilli Drejtues merr masat e nevojshme për të siguruar respektimin e orientimeve dhe udhëzimeve të BQE-së dhe kërkon që t'i jepet çdo informacion i nevojshëm.

14.4. Bankat qendrore kombëtare mund të kryejnë funksione të tjera, krahas atyre të specifikuara në këtë Statut, nëse Këshilli Drejtues nuk vendos me shumicën e dy të tretave të votave të hedhura që këto funksione ndërhyjnë tek objektivat dhe detyrat e SEBQ-së. Këto funksione kryhen me përgjegjësinë e plotë të bankave qendrore kombëtare dhe nuk konsiderohen si pjesë e funksioneve të SEBQ-së.

Neni 15

Detyrimi për raportim

15.1. BQE harton dhe boton raporte për aktivitetet e SEBQ-së të paktën çdo katër muaj.

15.2. Pasqyra financiare e konsoliduar e SEBQ-së botohet çdo javë.

15.3. BQE, në përputhje me nenin 284(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, i drejton Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit si edhe Këshillit Europian një raport vjetor për aktivitetet e SEBQ-së dhe për politikën monetare të vitit të mëparshëm dhe vitit aktual.

15.4. Raportet dhe pasqyrat e përmendura në këtë nen u vihen falas në dispozicion palëve të interesuara.

Neni 16

Kartëmonedhat

Këshilli Drejtues, në përputhje me nenin 128(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, ka të drejtën ekskluzive për të autorizuar emetimin e kartëmonedhave në euro brenda Bashkimit. Këto kartëmonedha mund t'i emetojnë BQE-ja dhe bankat qendrore kombëtare. Kartëmonedhat e emetuara nga Banka Qendrore Europiane dhe bankat qendrore kombëtare janë të vetmet kartëmonedha me kurs ligjor brenda Bashkimit.

BQE respekton në masën më të madhe të mundshme praktikat në lidhje me emetimin dhe pamjen e kartëmonedhave.

KREU IV

FUNKSIONE DHE VEPRIME MONETARE TË SEBQ

Neni 17

Llogaritë në BQE dhe bankat qendrore kombëtare

Për të kryer veprimet e tyre, BQE dhe bankat qendrore kombëtare mund të hapin llogari për institucione kreditimi, ente publike dhe pjesëmarrës të tjerë në treg dhe të pranojnë si kolateral aktivet, duke përfshirë letra me vlerë të regjistruara elektronikisht.

Neni 18

Operacionet në tëkreditimit

18.1. Për të përmbushur objektivat e SEBQ-së dhe për të kryer detyrat e veta, BQE dhe bankat qendrore kombëtare mund:

– të operojnë në tregjet financiare nëpërmjet blerjes dhe shitjes me para në dorë (me kontratë spot dhe forward) ose me marrëveshje riblerjeje dhe nëpërmjet kërkesave dhe instrumenteve të tregtueshme, qofshin këto në euro apo valutë tjetër, si dhe metale të çmuara;

– të kryejnë operacione krediti me institucione kreditimi dhe pjesëmarrës të tjerë në treg, duke bazuar dhënien e huasënë kolateral të mjaftueshëm.

18.2. BQE vendos parimet e përgjithshme për operacionet e kreditit dhe të tregut të hapur që i kryen vetë ose bankat qendrore kombëtare, përfshirë këtu njoftimin e kushteve sipas të cilave këto janë të gatshme për të hyrë në këto transaksione.

Neni 19

Rezervat minimale

19.1. BQE, sipas nenit 2, mund t'u kërkojë institucioneve të kreditimit të krijuara në Shtetet Anëtare, që, në zbatim të objektivave të politikës monetare të mbajnë rezerva minimale në llogaritë pranë BQE-së dhe bankave qendrore kombëtare. Rregullat në lidhje me përllogaritjen dhe përcaktimin e rezervave minimale mund të vendosen nga Këshilli Drejtues. BQE, në rast mosrespektimi të tyre, ka të drejtën të vendosë kamatëvonesa dhe sanksione të tjera me efekt të ngjashëm.

19.2. Këshilli, për zbatimin e këtij neni dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 41, përcakton bazën për rezervat minimale dhe raportin maksimal të lejueshëm ndërmjet këtyre rezervave dhe bazës të tyre si dhe sanksione të duhura në rast mosrespektimi.

Neni 20

Instrumente të tjera të kontrollit monetar

Këshilli Drejtues, me shumicën e dy të tretave të votave të hedhura, mund të vendosë për përdorimin e metodave të tjera operacionale të kontrollit monetar që i gjykon të përshtatshme, në përputhje me nenin 2.

Këshilli, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 41, përcakton fushën e zbatimit të këtyre metodave nëse këto vendosin detyrime mbi palët e treta.

Neni 21

Veprimet me ente publike

21.1. Në përputhje me nenin 123 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, ndalohen kreditë në formën e llogarisë së zbuluar ose çdo lloj tjetër instrument kreditimi me Bankën Qendrore Europiane ose me bankat qendrore kombëtare në favor të institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit, qeverive qendrore, autoriteteve rajonale, vendore ose të tjera, të cilat rregullohen nga normat e së drejtës publike, ose në favor të ndërmarrjeve publike të

Shteteve Anëtare, sikurse ndalohet edhe blerja drejtpërdrejt prej tyre nga BQE ose bankat qendrore kombëtare, të instrumenteve të borxhit .

21.2. BQE dhe bankat qendrore kombëtare mund të veprojnë si agjentë fiskalë për entet e përmendura në nenin 21.1.

21.3. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për institucionet shtetërore kredidhënëse të cilave, në kuadër të furnizimit me rezerva nga bankat qendrore, u bëhet i njëjti trajtim nga bankat qendrore kombëtare dhe nga Banka Qendrore Europiane sikur të ishin institucione private kredidhënëse ..

Neni 22

Sistemet e kleringut dhe pagesave

BQE dhe bankat qendrore kombëtare mund të ofrojnë instrumente dhe BQE mund të miratojë rregullore për të siguruar sisteme të qëndrueshme dhe efikase kleringu dhe pagesash brenda Bashkimit si dhe me vende të tjera.

Neni 23

Veprime të jashtme

BQE dhe bankat qendrore kombëtare mund:

– të krijojnë marrëdhënie me bankat qendrore dhe institucionet financiare në vende të tjera dhe sipas rastit, me organizata ndërkombëtare;

– të kryejnë shitblerje të formës spot dhe forward për të të gjitha llojet e aktiveve në monedhë të huaj dhe të metale të çmuara; termi "aktive në monedhë të huaj" përfshijnë letra me vlerë dhe të gjitha aktivet e tjera në monedhë të çdo vendi ose njësie llogarie dhe në çdo formë që është mbajtur;

– të mbajnë dhe administrojnë aktivet e përmendura në këtë nen;

– të kryejnë të gjitha llojet e transaksioneve bankare në lidhje me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë veprime huadhënieje dhe huamarrjeje.

Neni 24

Veprime të tjera

BQE dhe bankat qendrore kombëtare përveç veprimeve që rrjedhin nga detyrat e tyre, mund të kryejnë veprime për qëllimet administrative të tyre ose për stafin e tyre.

KREU V

MBIKËQYRJA E MATUR

Neni 25

Mbikëqyrja e matur

25.1. BQE mund të ofrojë këshillim dhe të konsultohet nga Këshilli, Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare mbi qëllimin dhe zbatimin e legjislacionit të Bashkimit në lidhje me mbikëqyrjen e matur të institucioneve të kreditit dhe me stabilitetin e sistemit financiar.

25.2. BQE, në përputhje me çdo rregullore të Këshillit që del sipas nenit 127(6) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, mund të kryejë detyra specifike në lidhje me politikat për mbikëqyrjen e matur të institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare me përjashtim të ndërmarrjeve të sigurimit.

KREU IV

DISPOZITA FINANCIARE TË SEBQ-SË

Neni 26

Llogaritë financiare

26.1. Viti financiar i BQE-së dhe bankave qendrore kombëtare fillon ditën e parë të janarit dhe përfundon ditën e fundit të dhjetorit.

26.2. Llogaritë e përvitshme të BQE-së hartohen nga Bordi Ekzekutiv në përputhje me parimet e vendosura nga Këshilli Drejtues. Llogaritë miratohen nga Këshilli Drejtues dhe më pas botohen.

26.3. Bordi Ekzekutiv, për qëllime analitike dhe operacionale, harton një bilanc të konsoliduar të SEBQ-së, që përmban ato aktive dhe pasive të bankave qendrore kombëtare të cilat përfshihen në SEBQ-së.

26.4. Këshilli Drejtues, për zbatimin e këtij neni, duhet të vendosë rregullat e nevojshme për standardizimin e kontabilitetit dhe të raportimit të veprimeve që kryejnë bankat qendrore kombëtare.

Neni 27

Auditimi

27.1. Llogaritë e BQE-së dhe bankave qendrore kombëtare, auditohen nga auditues të jashtëm të pavarur të cilët janë rekomanduar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Këshilli. Audituesit kanë kompetencë të plotë për të shqyrtuar të gjitha librat dhe llogaritë e BQE-së dhe bankave qendrore kombëtare si dhe të marrin informacion të plotë mbi transaksionet e tyre.

27.2. Dispozitat e nenit 287 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian zbatohen vetëm për shqyrtimin e efikasitetit operacional të administrimit të BQE-së.

Neni 28

Kapitali i BQE-së

28.1. Kapitali i BQE-së është 5 000 milion euro. Kapitali mund të zmadhohet me shuma aq sa mund të vendosen nga Këshilli Drejtues me shumicë të cilësuar të parashikuar në nenin 10.3, brenda kufijve dhe sipas kushteve të vendosura nga Këshilli sipas procedurës të përcaktuar në nenin 41.

28.2. Bankat qendrore kombëtare janë të vetmet nënshkruese dhe mbajtëse të kapitalit të BQE-së. Nënshkrimi i kapitalit bëhet sipas skemës së vendosur në përputhje me nenin 29.

28.3. Këshilli Drejtues, me shumicë të cilësuar të parashikuar në nenin 10.3, përcakton se deri në çfarë mase do të shlyhet kapitali si dhe formën me të cilën ai do të shlyhet. .

28.4. Sipas nenit 28.5, aksionet e bankave qendrore kombëtare në kapitalin e nënshkruar të BQE-së nuk mund të transferohen, të lihen peng ose të sekuestrohen.

28.5. Nëse ndryshohet skema e përmendur në nenin 29, bankat qendrore kombëtare transferojnë mes tyre aksione të kapitalit në masën e nevojshme për të siguruar që shpërndarja e aksioneve të kapitalit të përputhet me skemën e ndryshuar. Këshilli Drejtues përcakton afatet dhe kushtet e këtyre transferimeve.

Neni 29

Skema për nënshkrimin e kapitalit

29.1. Skema për nënshkrimin e kapitalit të BQE-së, e caktuar për herë të parë në vitin 1998 me krijimin e SEBQ-së, përcaktohet duke i dhënë në këtë skemë çdo banke qendrore kombëtare një koeficient të barabartë me shumën e:

– 50% të pjesës që zë Shteti Anëtar përkatës në popullsinë e Bashkimit në vitin e parafundit që i paraprin krijimit të SEBQ-së;

– 50% të pjesës që zë Shteti Anëtar përkatës në produktin e brendshëm bruto me çmime tregu të Bashkimit, siç ka qenë në pesë vitet e fundit përpara vitit të parafundit përpara krijimit të SEBQ-së.

Përqindjet rrumbullakoset në shumëfishin apo nënfishin më të përafërt të 0,0001 pikë përqindjeje.

29.2. Të dhënat statistikore që duhen përdorur për zbatimin e këtij neni sigurohen nga Komisioni në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli sipas procedurës së parashikuar për këtë në nenin 41.

29.3. Koeficientët që u caktohen bankave qendrore kombëtare rregullohen çdo pesë vjet pas krijimit të SEBQ-së në analogji me dispozitat e përcaktuara në nenin 29.1. Skema e ndryshuar hyn në fuqi duke filluar nga dita e parë e vitit pasues.

29.4. Këshilli Drejtues merr të gjitha masat e tjera të nevojshme për zbatimin e këtij neni.

Neni 30

Transferimi i aktiveve të rezervës valutore në BQE

30.1. Pa cenuar nenin 28, bankat qendrore kombëtare sigurojnë për BQE-në aktive të rezervës valutore, në monedhë tjetër nga ajo e Shteteve Anëtare, euro, pozicionet rezervë në FMN dhe SDR, deri në shumën e barabartë me 50 000 milion euro. Këshilli Drejtues vendos për pjesën që mund të kërkohet nga BQE pas krijimit të saj dhe shumat që mund të kërkohen në data të mëvonshme. BQE ka të drejtën e plotë që të mbajë dhe administrojë rezerva të huaja që i transferohen asaj dhe t'i përdorë ato për qëllimet e parashikuara në këtë Statut.

30.2. Kontributet e çdo banke qendrore kombëtare caktohen në raport me aksionet e tyre në kapitalin e nënshkruar të BQE-së.

30.3. Çdo bankë qendrore kombëtare kreditohet nga BQE-ja me të drejtë të barabartë me kontributin e saj. Këshilli Drejtues përcakton emërtimin dhe shpërblimin e këtyre të drejtave.

30.4. Kërkesa të mëtejshme për aktive të rezervës valutore përtej cakut të vendosur në nenin 30.1 mund të bëhen nga BQE-ja në përputhje me nenin 30.2, brenda kufijve dhe sipas kushteve të caktuara nga Këshilli në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 41.

30.5. BQE mund të mbajë dhe administrojë pozicione rezervë të FMN-së dhe SDR si dhe mund të sigurojë mbledhjen e këtyre aktiveve.

30.6. Këshilli Drejtues merr të gjitha masat e tjera të nevojshme për zbatimin e këtij neni.

Neni 31

Aktivet e rezervave valutore të mbajtura nga bankat qendrore kombëtare

31.1. Bankat qendrore kombëtare lejohen të kryejnë veprime në përmbushje të detyrimeve të tyre ndaj organizatave ndërkombëtare në përputhje me nenin 23.

31.2. Të gjitha veprimet e tjera në aktivet e rezervës valutore që u ndodhen bankave qendrore kombëtare pas transferimeve të përmendura në nenin 30, dhe transaksionet e Shteteve Anëtare me tepricat e tyre qarkulluese në monedhë të huaj, përtej një kufiri të caktuar që duhet vendosur në kuadër të nenit 31.3, kërkojnë miratim nga BQE-ja, me qëllim që të sigurohet përputhshmëri me kursin e këmbimit dhe politikat monetare të Bashkimit.

31,3. Këshilli Drejtues nxjerr orientime me qëllim lehtësimin e këtyre veprimeve.

Neni 32

Shpërndarja e të ardhurave monetare të bankave qendrore kombëtare

32.1. Të ardhurat që u lindin bankave qendrore kombëtare gjatë kryerjes së funksionit të politikës monetare të SEBQ-së (në vijim do të quhen "të ardhurave monetare") shpërndahen në fund të vitit financiar në përputhje me dispozitat e këtij neni.

32.2. Shuma e të ardhurave monetare të çdo banke qendrore kombëtare është e barabartë me të ardhurat vjetore që rrjedhin nga aktivet e mbajtura kundrejt kartëmonedhave në qarkullim dhe pasiveve në formë depozite kundrejt institucioneve të kreditit. Këto aktive identifikohen nga bankat qendrore kombëtare në përputhje me orientimet që duhet të vendosen nga Këshilli Drejtues.

32.3. Nëse pas futjes në përdorim të euros, strukturat e bilancit të bankave qendrore kombëtare, sipas gjykimit të Këshillit Drejtues, nuk lejojnë zbatimin e nenit 32.2, Këshilli Drejtues me shumicë të cilësuar, mund të vendosë që, duke u shmangur nga neni 32.2, të ardhurat monetare të maten sipas metodës alternative për një periudhë jo më shumë se pesë vjet.

32.4. Shuma e të ardhurave monetare të çdo banke qendrore kombëtare reduktohet me një shumë ekuivalente të çdo interesi që kjo bankë qendrore u paguan nga institucioneve të kreditit mbi pasivet në formë depozite, sipas nenit 19.

Këshillit Drejtues mund të vendosë që bankat qendrore kombëtare të dëmshpërblehen kundrejt shpenzimeve të kryera në lidhje me emetimin e kartëmonedhave ose në rrethana të jashtëzakonshme për humbje specifike që rrjedhin prej veprimeve të politikave monetare të ndërmarra për SEBQ-në. Shpërblimi është në formën e konsideruar të duhur në gjykimin e Këshillit Drejtues; këto shuma mund të kompensohen kundrejt të ardhurave monetare të bankave qendrore kombëtare.

32.5. Shuma e të ardhurave monetare të bankave qendrore kombëtare u shpërndahet bankave qendrore kombëtare në raport me aksionet e tyre të shlyera në kapitalin e BQE-së, sipas një vendimi të marrë nga Këshilli Drejtues në përputhje me nenin 33.2.

32.6. Kompensimi dhe shlyerja e tepricave të krijuara nga shpërndarja e të ardhurave monetare kryhet nga BQE-ja në përputhje me orientimet e vendosura nga Këshilli Drejtues.

32.7. Këshilli Drejtues merr të gjitha masat e tjera të nevojshme për zbatimin e këtij neni.

Neni 33

Shpërndarja e fitimit dhe humbjes neto të BQE-së

33.1. Fitimi neto i BQE-së transferohet si më poshtë:

– (a) shuma që do të përcaktohet nga Këshilli Drejtues, e cila nuk mund të kalojë 20% të fitimit neto, transferohet në fondin e rezervës së përgjithshme, duke iu nënshtruar një kufiri të barabartë me 100% të kapitalit;

– (b) fitimi i mbetur neto u shpërndahet aksionarëve të BQE-së në raport me aksionet e tyre të shlyera.

33.2. Nëse BQE pëson humbje, kjo mund të kompensohet kundrejt fondit të rezervës së përgjithshme të BQE-së dhe nëse është e nevojshme, pas një vendimi të Këshillit Drejtues, kundrejt të ardhurave monetare të vitit përkatës financiar në raport dhe deri në shumën që u shpërndahet bankave qendrore kombëtare në përputhje me nenin 32.5.

KREU VII

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 34

Akte juridike

34.1. Në përputhje me nenin 132 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, BQE:

– Përgatit rregullore në masën e nevojshme për zbatimin e detyrave të përcaktuara në nenin 3.1, nënpika e parë, në nenet 19.1, 22 ose 25.2 dhe në rastet që përcaktohen në aktet e Këshillit të përmendura në nenin 41;

– merr vendimet e nevojshme për kryerjen e detyrave që i ngarkohen SEBQ-së sipas Traktateve dhe këtij Statuti;

– jep rekomandime dhe opinione.

34.2. Banka Qendrore Europiane mund të vendosë t'i botojë vendimet, rekomandimet dhe opinionet e veta.

34.3. Banka Qendrore Europiane, brenda kufijve dhe sipas kushteve të miratuara nga Këshilli sipas procedurës të parashikuar në nenin 41, ka të drejtën të vendosë gjoba ose sanksione periodike për sipërmarrjet që nuk i përmbushin detyrimet që rrjedhin nga rregulloret dhe vendimet e saj.

Neni 35

Kontrolli gjyqësor dhe çështje që lidhen me të

35.1. Veprimet dhe mosveprimet e BQE janë të hapura për shqyrtim ose interpretim nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian. BQE mund të fillojë procedim në çështje dhe sipas kushteve të përcaktuara në Traktate.

35.2. Mosmarrëveshjet ndërmjet BQE-së nga njëra anë dhe kreditorëve, debitorëve ose personave të tjerë, nga ana tjetër, zgjidhen nga gjykatat kombëtare kompetente, përveç rasteve kur juridiksioni i jepet Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

35.3. BQE i nënshtrohet regjimit të përgjegjësisë të parashikuar në nenin 340 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Bankat qendrore kombëtare japin llogari sipas legjislacionit përkatës të tyre.

35.4. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka juridiksion të japë vendime sipas çdo klauzole arbitrazhi që gjendet në një kontratë të lidhur nga BQE-ja ose në emër të saj, pavarësisht nëse kjo kontratë rregullohet nga e drejta private apo nga ajo publike.

35.5. Vendimin e BQE-së për të ngritur padi përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian e merr Këshilli Drejtues.

35.6. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka juridiksion për mosmarrëveshjet në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të një banke qendrore kombëtare sipas Traktateve dhe këtij Statuti. Nëse BQE-ja konsideron që një bankë qendrore kombëtare nuk e ka përmbushur një detyrim sipas Traktateve dhe këtij Statuti, ajo nxjerr një opinion të arsyetuar për këtë çështje pasi t'i ketë dhënë bankës qendrore kombëtare përkatëse mundësinë për të paraqitur konstatimet e saj. Nëse banka qendrore kombëtare përkatëse nuk e respekton opinionin brenda periudhës së përcaktuar nga BQE-ja, kjo e fundit mund ta çojë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian.

Neni 36

Personeli

36.1. Këshilli Drejtues, me propozim të Bordit Ekzekutiv, përcakton kushtet e punësimit të personelit të BQE.

36.2. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka juridiksion për çdo mosmarrëveshje ndërmjet BQE-së dhe nëpunësve të saj brenda kufijve dhe sipas kushteve të përcaktuara në kushtet e punësimit.

Neni 37 (ish-neni 38)

Sekreti profesional

37.1. Anëtarëve të organeve drejtuese dhe stafit të BQE dhe bankave qendrore kombëtare u kërkohet, edhe pas mbarimit të detyrës së tyre, të mos nxjerrin informacion që i nënshtrohet detyrimit për sekret profesional.

37.2. Personat që kanë akses në të dhënat për të cilat legjislacioni i Bashkimit vendos detyrimin për fshehtësi, i nënshtrohen këtij legjislacioni.

Neni 38 (ish Neni 39)

Nënshkruesit

BQE-ja angazhohet juridikisht ndaj palëve të treta nëpërmjet Presidentit ose dy anëtarëve të Bordit Ekzekutiv ose nëpërmjet nënshkrimeve të dy punonjësve të BQE-së të cilët janë autorizuar rregullisht nga Presidenti për të nënshkruar në emër të BQE-së.

Neni 39 (ish-neni 40)

Privilegjet dhe imunitetet

BQE-ja gëzon në territorin e Shteteve Anëtare ato privilegje dhe imunitete të cilat janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, sipas kushteve të përcaktuara në Protokollin për privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Europian.

KREU VIII

NDRYSHIME TË STATUTIT DHE LEGJISLACIONIT PLOTËSUES

Neni 40 (ish-neni 41)

Procedura e thjeshtuar e ndryshimit

40.1. Në përputhje me nenin 129(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nga Parlamenti Europian dhe Këshilli mund të ndryshohen nenet 5.1, 5.2, 5.3, 17, 18, 19.1, 22, 23, 24, 26, 32.2, 32.3, 32.4, 32.6, 33.1(a) dhe 36 të këtij Statuti, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative ose me rekomandim të BQE-së dhe pas konsultimit me Komisionin, ose me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me BQE-në.

40.2. Neni 10.2 mund të ndryshohet me vendim të Këshillit Europian me unanimitet, ose me rekomandim të Bankës Qendrore Europiane dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian dhe me Komisionin, ose me rekomandim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian dhe Bankën Qendrore Europiane. Këto ndryshime nuk hyjnë në fuqi derisa të miratohen nga Shtetet Anëtare, në përputhje me kërkesat kushtetuese përkatëse.

40.3. Rekomandimi i bërë nga BQE-ja sipas këtij neni kërkon vendim unanim nga Këshilli Drejtues.

Neni 41 (ish-neni 42)

Legjislacioni plotësues

Këshilli, ose me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian dhe BQE-në, ose me rekomandim të BQE-së dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian dhe Komisionin, në përputhje me nenin 129(4) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. miraton dispozitat e përmendura në nenet 4, 5.4, 19.2, 20, 28.1, 29.2, 30.4 dhe 34.3 të këti``j Statuti.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË TJERA PËR SEBQ-NË

Neni 42 (ish-neni 43)

Dispozita të përgjithshme

42.1. Shmangia e përmendur në nenin 139 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian bën që nenet e mëposhtme të këtij Statuti të mos japin të drejta apo të mos vendosin detyrime mbi Shtetet Anëtare përkatëse: 3, 6, 9.2, 12.1, 14.3, 16, 18, 19, 20, 22, 23, 26.2, 27, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 49.

42.2. Bankat qendrore të Shteteve Anëtare me një shmangie që parashikohen në nenin 139(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian i ruajnë kompetencat e tyre në fushën e politikave monetare sipas legjislacionit të brendshëm.

42,3. “Shtete Anëtare”, në përputhje me nenin 139 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nënkupton “Shtetet Anëtare monedha e të cilave është euroja “ në nenet e mëposhtme të këtij Statuti. 3, 11.2 dhe 19.

42.4. “Bankat qendrore kombëtare” nënkupton “bankat qendrore të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja “ në nenet e mëposhtme të këtij Statuti: 9.2, 10.2, 10.3, 12.1, 16, 17, 18, 22, 23, 27, 30, 31, 32, 33.2 dhe 49.

42.5. “Aksionarët” nënkupton “bankat qendrore të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja “ në nenet 10.3 dhe 33.1.

42.6. “Kapital i nënshkruar i BQE” nënkupton “kapitalin e BQE-së të nënshkruar nga bankat qendrore të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja “ në nenet 10.3 dhe 30.2.

Neni 43 (ish-neni 44)

Detyra kalimtare të BQE-së

BQE merr përsipër detyra të mëparshme të IME-së, të përmendur në nenin 141(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, të cilat, për shkak të shmangies së një ose disa Shteteve Anëtare, duhet t’i kryejë akoma pas futjes në përdorim të euros.

BQE ofron këshillim në përgatitjet për shfuqizimin e shmangieve të specifikuara në nenin 140 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 44 (ish-neni 45)

Këshilli i Përgjithshëmi BQE-së

44.1. Këshilli i Përgjithshëm, pa cenuar nenin 129(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, krijohet si organi i tretë i vendimmarrjes të BQE.

44.2. Këshilli i Përgjithshme përbëhet nga Presidenti dhe Zëvendëspresidenti i BQE-së dhe Guvernatorët e bankave qendrore kombëtare. Anëtarët e tjerë të Bordit Ekzekutiv mund të marrin pjesë në takimet e Këshillit pa të drejtë vote.

44.3. Përgjegjësitë e Këshillit të Përgjithshëm renditen të plota në nenin 46 të këtij Statuti.

Neni 45 (ish neni 46)

Rregullorja e Brendshme e Këshillit të Përgjithshëm

45.1. Presidenti, ose në mungesë të tij, Zëvendëspresidenti i BQE-së kryesojnë Këshillin e Përgjithshëm të BQE-së.

45.2. Presidenti i Këshillit dhe një Anëtar i Komisionit mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm pa të drejtë vote.

45.3. Presidenti përgatit takimet e Këshillit të Përgjithshëm.

45.4. Këshilli i Përgjithshëm, duke u shmangur nga nenin 12.3, miraton Rregullore e Brendshme.

45.5. Sekretariati i Këshillit të Përgjithshëm sigurohet nga BQE-ja.

Neni 46 (ish-neni 47)

Përgjegjësitë e Këshillit të Përgjithshëm

46.1. Këshilli i Përgjithshëm:

– kryen detyrat e përmendura në nenin 43;

– kontribuon në funksione këshillimi të përmendura në nenin 4 dhe 25.1.

46.2. Këshilli i Përgjithshëm kontribuon:

– në mbledhjen e informacionit statistikor, të përmendur në nenin 5;

– në raportimin për aktivitetet e BQE-së, siç përmendet në nenin 15;

– në krijimin e rregullave të nevojshme për zbatimin e nenit 26, siç përmendet në nenin 26.4;

– në marrjen e të gjitha masave të tjera të nevojshme për zbatimin e nenit 29, siç përmendet në nenin 29.4;

– në përcaktimin e kushteve të punësimit të personelit të BQE-së, siç përmendet në nenin 36.

46.3. Këshilli i Përgjithshëm kontribuon në përgatitjen e nevojshme për caktimin në mënyrë të pakthyeshme të kursit të këmbimit të valutave të Shtete Anëtare me një shmangie kundrejt euros, siç përmendet në nenin 140(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

46.4. Vendimet e Këshillit Drejtues i vihen në dijeni Këshillit të Përgjithshëm nga Presidenti i BQE-së.

Neni 47 (ish neni 48)

Dispozita kalimtare për kapitalin e BQE-së

Çdo banke qendrore kombëtare, në përputhje me nenin 29.1 i jepet një koeficient ponderimi në skemën për nënshkrimin e kapitalit të BQE-së. Duke u shmangur nga neni 28.3, bankat qendrore të Shteteve Anëtare me një shmangie nuk e shlyejnë kapitalin e tyre të nënshkruar nëse Këshilli i Përgjithshëm me shumicën që përfaqëson të paktën dy të tretat e kapitalit të nënshkruar të BQE-së dhe të paktën gjysmën e aksionarëve të tij, nuk vendos që duhet paguar një përqindje minimale si kontribut për shpenzimet operative të BQE-së.

Neni 48 (ish-neni 49)

Pagesa e shtyrë e kapitalit, rezervave dhe provigjoneve të e BQE-së

48.1. Banka qendrore e një Shteti Anëtar shmangia e të cilit është shfuqizuar e paguan kuotën e nënshkruar që zotëron në kapitalit e BQE-së në të njëjtën masë me bankat qendrore të Shteteve të tjera Anëtare monedha e të cilave është euroja, dhe i kalon BQE-së aktivet e rezervës valutore në përputhje me nenin 30.1 Shuma që duhet transferuar, përcaktohet duke shumëzuar vlerën e euros që del nga kurset aktuale të këmbimit të aktiveve të rezervës valutore, të cilat i janë kaluar më parë BQE-së sipas nenit 30.1 me raportin ndërmjet numrit të aksioneve të nënshkruara nga banka qendrore kombëtare në fjalë dhe numrit të aksioneve të paguara tashmë nga bankat e tjera qendrore kombëtare.
48.2. Përveç pagesës që duhet bërë sipas nenit 48.1, banka qendrore në fjalë kontribuon në rezervat e BQE-së, në provigjonet ekuivalente me rezervat, dhe në shumat që duhet t'u caktohen rezervave dhe provigjioneve të cilat përputhen me tepricën e llogarisë së fitimeve dhe humbjeve që nga 31 dhjetori i vitit përpara shfuqizimit të shmangies. Shuma që duhet të kontribuohet përcaktohet duke shumëzuar shumën e rezervave, siç përcaktohet më sipër dhe siç shprehet në bilancin e BQE-së, me raportin ndërmjet numrit të aksioneve të nënshkruara nga banka qendrore në fjalë dhe numrit të aksioneve të paguara tashmë nga bankat e tjera qendrore kombëtare.

48.3. Kapitali i nënshkruar i BQE-së dhe kufiri i shumës së aktivit të rezervës valutore që mund t'i kalohet BQE-së zmadhohet automatikisht, kur, një ose më shumë vende bëhen Shtete Anëtare dhe kur bankat qendrore kombëtare përkatëse bëhen pjesë e SEBQ-së. Zmadhimi përcaktohet duke shumëzuar shumat përkatëse me raportin, brenda skemës së zgjeruar të kapitalit, ndërmjet koeficienteve të ponderimit të bankave qendrore kombëtare në fjalë dhe koeficienteve të ponderimit të bankave qendrore kombëtare që janë anëtare të SEBQ-së qysh më parë. Koeficienti i ponderimit që i caktohet çdo banke qendrore kombëtare në skemën e kapitalit llogaritet në analogji me nenin 29.1 dhe në përputhje me nenin 29.2. Periudhat e referencës që duhen përdorur për të dhënat statistikore janë njësoj si ato që përdoren për ndryshimin më të fundit pesëvjeçar të koeficienteve sipas nenit 29.3.

Neni 49 (ish-neni 52)

Shkëmbimi i kartëmonedhave në valutën e Shteteve Anëtare

Pas caktimit të pakthyeshëm të kursit të shkëmbimit në përputhje me nenin 140 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Këshilli Drejtues merr masat e nevojshme për të siguruar që kartëmonedhat e emërtuara në valutat me kurs të shkëmbimit valutor të fiksuar në mënyrë të pakthyeshme, të shkëmbehen nga bankat qendrore kombëtare me vlerat e tyre nominale përkatëse.

Neni 50 (ish-neni 53)

Zbatueshmëria e dispozitave kalimtare

Nenet 42 deri në 47 zbatohen nëse dhe për sa kohë që ka Shtete Anëtare me një shmangie.

———

PROTOKOLLI (NR. 5)

PËR STATUTIN E BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të krijuar Statutin e Bankës Europiane të Investimeve të parashikuar në nenin 308 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme të cilat i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Banka Europiane e Investimeve e krijuar me nenin 308 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian (në vijim "Banka"), krijohet dhe kryen funksionet dhe aktivitetet e saj në përputhje me dispozitat e Traktateve dhe të këtij Statuti.

Neni 2

Detyra e Bankës përcaktohet në nenin 309 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 3

Në përputhje me nenin 308 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, anëtarë të Bankës janë Shtetet Anëtare.

Neni 4

1. Kapitali i Bankës është 232 392 989 000 euro, nënshkruar nga Shtetet Anëtare si më poshtë:

Gjermania	37 578 019 000
Franca	37 578 019 000
Italia	37 578 019 000
Mbretëria e Bashkuar	37 578 019 000
Spanja	22 546 811 500
Belgjika	10 416 365 500
Hollanda	10 416 365 500
Suedia	6 910 226 000

Danimarka	5 274 105 000
Austria	5 170 732 500
Polonia	4 810 160 500
Finlanda	2 970 783 000
Greqia	2 825 416 500
Portugalia	1 820 820 000
Republika Çeke	1 774 990 500
Hungaria	1 679 222 000
Irlanda	1 318 525 000
Rumania	1 217 626 000
Sllovakia	604 206 500
Sllovenia	560 951 500
Bullgaria	410 217 500
Lituania	351 981 000
Luksemburgu	263 707 000
Qiproja	258 583 500
Letonia	214 805 000
Estonia	165 882 000
Malta	98 429 500

Shtetet Anëtare janë përgjegjëse vetëm për shumën e pjesës së tyre në kapitalin e nënshkruar dhe jo të shlyer.

2. Pranimi i një anëtari të ri çon në zmadhimin e kapitalit të nënshkruar që i korrespondon kapitalit të futur nga anëtari i ri.

3. Bordi i Guvernatorëve, me unanimitet, mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e nënshkruar.

4. Pjesa e një anëtari në kapitalin e nënshkruar mund të mos transferohet, të mos lihet peng apo të mos sekuestrohet.

Neni 5

1. Kapitali i nënshkruar paguhet nga Shtetet Anëtare në masën 5% mbi mesataren e shumave të përcaktuara në nenin 4 pika 1.

2. Bordi i Guvernatorëve, në rastin e një zmadhimi të kapitalit të nënshkruar, vendos me unanimitet përqindjen që duhet shlyer dhe masat organizative për të bërë pagesën. Pagesat në të holla bëhen vetëm në euro.

3. Këshilli i Administrimit mund të kërkojë shlyerjen e tepricës së kapitalit të nënshkruar, deri në masën që mund t'i duhet Bankës për të plotësuar detyrimet e saj.

Çdo Shtet Anëtar e bën këtë pagesë në raport me pjesën e tij të kapitalit të nënshkruar.

Neni 6
(ish-neni 8)

Banka drejtohet dhe administrohet nga një Bord Guvernatorësh, një Këshill Administrimi dhe një Komitet Menaxhimi.

Neni 7
(ish-neni 9)

1. Bordi i Guvernatorëve përbëhet nga ministrat e caktuar nga Shtetet Anëtare.

2. Bordi i Guvernatorëve jep orientimet e përgjithshme për politikat e kreditit të Bankës, në përputhje me objektivat e Bashkimit. Bordi i Guvernatorëve kujdeset që këto orientime të zbatohen.

3. Gjithashtu, Bordi i Guvernatorëve:

(a) vendos nëse do ta zmadhojë kapitalin e nënshkruar në përputhje me nenin 4(3) dhe nenin 5(2);

(b) përcakton, për qëllimet e nenit 9(1), parimet e zbatueshme për veprimet e financimit të ndërmarra brenda kuadrit të detyrës së Bankës;

(c) ushtron kompetencat e parashikuara në nenet 9 dhe 11 në lidhje me emërimin dhe lirimin e detyruar të anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe Komitetit të Menaxhimit, dhe ushtron ato kompetenca që janë parashikuar në nënparagrafin e dytë të nenit 11(1);

(d) merr vendime në lidhje me dhënien e fondeve për investime që duhet të kryhen, tërësisht ose pjesërisht, jashtë territoreve të Shteteve Anëtare, në përputhje me nenin 16(1);

(e) miraton raportin vjetor të Këshillit të Administrimit;

(f) miraton bilancin vjetor dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;

(g) ushtron kompetenca dhe funksione të tjera që i jepen me këtë Statut;

(h) miraton rregulloren e brendshme të Bankës.

4. Brenda kuadrit të Traktatit dhe të këtij Statuti, Bordi i Guvernatorëve është kompetent të marrë, me unanimitet, vendime në lidhje me pezullimin e veprimeve të Bankës dhe, nëse krijohet rasti, në lidhje me likuidimin e saj.

Neni 8
(ish- neni 10)

Vendimet e Bordit të Guvernatorëve, përveçse kur ky Statut parashikon ndryshe, merren me shumicën e anëtarëve të tij. Kjo shumicë duhet të përfaqësojë të paktën 50% të kapitalit të nënshkruar.

Shumica e cilësuar kërkon tetëmbëdhjetë vota në favor dhe 68% të kapitalit të nënshkruar.

Abstenimet e bëra prej anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar, nuk e pengojnë miratimin e vendimeve që duhet të merren me me unanimitet.

Neni 9
(ish-neni 11)

1. Këshilli i Administrimit merr vendime në lidhje me dhënien e financimit, sidomos në formën e huave dhe dorëzanive dhe në lidhje me marrjen e kredive; ai cakton normat e interesit për kreditë e dhëna dhe komisionet dhe pagesat e tjera. Bazuar në vendimin e marrë me shumicë të cilësuar, ai, i delegon Komitetit të Menaxhimit disa nga funksionet e veta. Ai përcakton afatet dhe kushtet për këtë delegim dhe mbikëqyr ekzekutimin.

Këshilli i Administrimit kujdeset që Banka të funksionojë si duhet; siguron që Banka të administrohet në përputhje me dispozitat e Traktateve dhe të këtij Statuti dhe me orientimet e përgjithshme të vendosura nga Bordi i Guvernatorëve.

Këshilli i Administrimit, në fund të vitit fiskal, i paraqet një raport Bordit të Guvernatorëve dhe e boton atë pas miratimit.

2. Këshilli i Administrimit përbëhet nga njëzetetetë anëtarë dhe tetëmbëdhjetë anëtarë zëvendësues.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit i emëron Bordi i Guvernatorëve për pesë vjet, ku secili Shtet Anëtar propozon nga një anëtar, ndërsa një anëtar propozohet nga Komisioni.

Anëtarët zëvendësues i emëron Bordi i Guvernatorëve për pesë vjet, siç tregohet më poshtë:

– dy zëvendës të propozuar nga Republika Federale e Gjermanisë,

– dy zëvendës të propozuar nga Republika Franceze,

– dy zëvendës të propozuar nga Republika Italiane,

– dy zëvendës të propozuar nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut,

– një zëvendës i propozuar me marrëveshje të përbashkët të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës Portugeze,

– një zëvendës i propozuar me marrëveshje të përbashkët të Mbretërisë së Belgjikës, Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Mbretërisë së Hollandës

– dy zëvendës të propozuar me marrëveshje të përbashkët të Mbretërisë së Danimarkës, Republikës Greke, Irlandës dhe Rumanisë,

– dy zëvendës të propozuar me marrëveshje të përbashkët të Republikës së Estonisë, Republikës së Letonisë, Republikës së Lituanisë, Republikës së Austrisë, Republikës së Finlandës dhe Mbretërisë së Suedisë,

– tre zëvendës të propozuar me marrëveshje të përbashkët të Republikës së Bullgarisë, Republikës Çeke, Republikës së Qipros, Republikës së Hungarisë, Republikës së Maltës, Republikës së Polonisë, Republikës së Sllovenisë dhe Republikës Sllovake,

– një zëvendës i propozuar nga Komisioni.

Këshilli i Administrimit zgjedh bashkërisht gjashtë ekspertë pa të drejtë vote: tre si anëtarë dhe tre si zëvendës.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit të Administrimit mund të riemërohen.

Rregullorja e Brendshme përcakton masat organizative për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe dispozitat e zbatueshme për zëvendësit dhe ekspertët e zgjedhur bashkërisht.

Presidenti i Komitetit të Menaxhimit, ose në mungesë të tij, një nga Zëvendëspresidentët, drejton mbledhjet e Këshillit të Administrimit, por nuk voton.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit zgjidhen mes personave pavarësia dhe kompetenca e të cilëve është e padiskutueshme; ata përgjigjen vetëm përpara Bankës.

3. Anëtarin e Këshillit të Administrimit e shkarkon nga detyra Bordi i Guvernatorëve vetëm nëse nuk plotëson më kushtet e nevojshme për kryerjen e detyrave të tij; Bordi duhet të vendosë me shumicë të cilësuar.

Këshilli i Administrimit jep dorëheqjen nëse nuk miratohet raporti vjetor.

4. Çdo vend vakant që krijohet për shkak të vdekjes, largimit vullnetar, lirimit të detyruar ose dorëheqjes kolektive, plotësohet në përputhje me paragrafin 2. Anëtari zëvendësohet për pjesën e mbetur të mandatit, përveçse kur zëvendësohet i gjithë Këshilli i Administrimit.

5. Bordi i Guvernatorëve përcakton shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Bordi i Guvernatorëve përcakton cilat aktivitete nuk janë në pajtueshmëri me detyrat e një anëtari ose anëtari zëvendësues të Këshillit të Administrimit.

Neni 10
(ish-neni 12)

1. Çdo anëtar i Këshillit të Administrimit ka një votë. Ai mund ta delegojë votën e vet në të gjitha rastet sipas procedurës që duhet përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bankës.

2. Vendimet e Këshillit të Administrimit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, merren me të paktën një të tretën e anëtarëve me të drejtë vote, që përfaqësojnë të paktën pesëdhjetë për qind të kapitalit të nënshkruar. Shumica e cilësuar kërkon tetëmbëdhjetë vota në favor dhe gjashtëdhjetë e tetë për qind të kapitalit të nënshkruar. Rregullorja e Brendshme e Bankës përcakton kuorumin e nevojshëm që vendimet e Këshillit të Administrimit të jenë të vlefshme.

Neni 11
(ish-neni 13)

1. Komiteti i Menaxhimit përbëhet nga një President dhe tetë Zëvendëspresidentë të emëruar për një periudhë gjashtëvjeçare nga Bordi i Guvernatorëve me propozim të Këshillit të Administrimit.

Ata mund të rizgjidhen. Bordi i Guvernatorëve, me unanimitet, mund të ndryshojë numrin e anëtarëve të Komitetit të Menaxhimit.

2. Me propozim të miratuar me shumicë të cilësuar nga Këshilli i Administrimit, Bordi i Guvernatorëve, me shumicë të cilësuar, mund të shkarkojë nga detyra një anëtar të Komitetit të Menaxhimit.

3. Komiteti i Menaxhimit është përgjegjës për funksionimin normal të Bankës, nën drejtimin e Presidentit dhe mbikëqyrjen e Këshillit të Administrimit.

Ai përgatit vendimet e Këshillit të Administrimit, në veçanti vendimet për marrjen e kredive dhe dhënien e financimit, sidomos në formën e huave dhe dorëzanive; ai garanton zbatimin e këtyre vendimeve.

4. Komiteti i Menaxhimit vendos me shumicë kur jep opinione mbi propozime për marrjen e huave ose dhënien e financimit, sidomos në formën e kredive dhe dorëzanive.

5. Bordi i Guvernatorëve përcakton shpërblimin e anëtarëve të Komitetit të Menaxhimit dhe përcakton cilat aktivitete janë të papajtueshme me funksionet e tyre.

6. Në çështje gjyqësore dhe të tjera, Bankën e përfaqëson Presidenti, ose në pamundësi të tij njëri nga Zëvendëspresidentët.

7. Personeli i Bankës është nën drejtimin e Presidentit. Personelin e merr në punë dhe e largon nga puna Presidenti. Në përzgjedhjen e personelit, merret parasysh jo vetëm aftësia dhe kualifikimet, por dhe një përfaqësim i barabartë i shtetasve të Shteteve Anëtare. Rregullorja e Brendshme përcakton se cili organ është kompetent për të miratuar dispozitat që zbatohen për personelin.

8. Komiteti i Menaxhimit dhe personeli i Bankës japin llogari vetëm përpara Bankës dhe janë tërësisht në pavarur në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 12
(ish-neni 14)

1. Një Komitet i cili përbëhet nga gjashtë anëtarë të emëruar në bazë të aftësisë së tyre nga Bordi i Guvernatorëve, verifikon që aktivitetet e Bankës të jenë në përputhje me praktikat më të mira bankare dhe është përgjegjës për auditimin e llogarive të saj.

2. Komiteti i përmendur në paragrafin 1, siguron çdo vit që të jenë kryer operacionet e Bankës dhe të jenë mbajtur në mënyrën e duhur regjistrat e saj. Për këtë qëllim, ky verifikon që operacionet e Bankës të jenë kryer në përputhje me formalitetet dhe procedurat e përcaktuara në këtë Statut dhe Rregulloren e Brendshme.

3. Komiteti i përmendur në paragrafin1 konfirmon që pasqyrat financiare si dhe çdo informacion tjetër financiar që gjendet në llogaritë vjetore të përgatitura nga Këshilli i Administrimit , të japin një pasqyrim të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare të Bankës në lidhje me aktivet dhe pasivet e saj, si dhe të rezultateve të operacioneve të saj dhe të qarkullimit të parasë gjatë vitit financiar në shqyrtim.

4. Rregullorja e Brendshme specifikon kualifikimet e nevojshme të anëtarëve të Komitetit dhe përcakton afatet dhe kushtet e veprimtarisë së Komitetit.

Neni 13
(ish-neni 15)

Banka komunikon me çdo Shtet Anëtar nëpërmjet autoritetit që cakton çdo Shtet. Banka, në kryerjen e operacioneve financiare bashkëpunon me bankën qendrore kombëtare të Shtetit Anëtar ose institucione të tjera financiare të miratuara nga ai Shtet.

Neni 14
(ish-neni 16)

1. Banka bashkëpunon me të gjitha organizatat ndërkombëtare aktive në fushat e ngjashme me të sajat.

2. Banka përpiqet të vendosë kontaktet e duhura në interes të bashkëpunimit me institucionet bankare dhe financiare në vendet ku shtrihet veprimtaria e saj.

Neni 15
(ish-neni 17)

Bordi i Guvernatorëve, me kërkesë të një Shteti Anëtar ose të Komisionit, ose me nismën e vet, në përputhje me të njëjtat dispozita që rregullojnë miratimin e tyre, interpreton ose plotëson direktivat e përcaktuara prej tij sipas nenit 7 të këtij Statuti.

Neni 16
(ish-neni 18)

1. Brenda kuadrit të detyrave të parashikuara në nenin 309 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Banka u jep financime anëtarëve të saj ose ndërmarrjeve publike apo private, sidomos në formën e huave dhe dorëzanive, për investime që bëhen në territoret e Shteteve Anëtare, nëse këto fonde nuk mund të gjenden nga burime të tjera sipas kushteve të arsyeshme.

Megjithatë, me vendim të marrë me shumicë të cilësuar nga Bordi i Guvernatorëve me propozim të Këshillit të Administrimit, Banka mund të japë financim për investime që do të realizohen, tërësisht ose pjesërisht, jashtë territoreve të Shteteve Anëtare.

2. Aq sa është e mundur, kreditë jepen, , vetëm me kushtin që të përdoren gjithashtu burime të tjera financimi.

3. Banka, kur i jep hua një ndërmarrjeje ose një organi që nuk është Shtet Anëtar, e kushtëzon kredinë ose me dorëzani të lëshuar nga një Shtet Anëtar në territorin e të cilit realizohet investimi ose me dorëzani të tjera të përshtatshme ose me aftësinë financiare të debitorit.

Për më tepër, në përputhje me parimet e vendosura nga Bordi i Guvernatorëve, sipas nenit 7(3)(b), dhe, kur e kërkon zbatimi i projekteve të parashikuara në nenin 309 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Këshilli i Administrimit, duke marrë vendim me shumicë të cilësuar, përcakton afatet dhe kushtet e çdo operacioni financimi që përfaqëson një raport specifik të riskut dhe që konsiderohet në këtë mënyrë si aktivitet i veçantë.

4. Banka mund të dalë dorëzanë për hua të marra nga ndërmarrjes publike ose private apo organe të tjera, me qëllim realizimin e projekteve të parashikuara në nenin 309 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

5. Shuma agregate e papaguar në çdo kohë e huave dhe dorëzanive të dhëna nga Banka nuk kalon 250% të kapitalit të saj të nënshkruar, rezervave, provigjoneve të pashpërndara dhe të tepricës pozitive të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Kjo shumë e fundit agregate zbritet nga një shumë e barabartë me vlerën e nënshkruar (e shlyer ose jo) për çdo pjesëmarrje në kapitalin neto të Bankës.

Vlera e pjesëmarrjeve të disbursuara në kapitalin neto të Bankës nuk e kalon në asnjë rast shumën që i korrespondon vlerës gjithsej të kapitalit të saj të nënshkruar e të shlyer, rezervave, provigjoneve të pashpërndara dhe tepricës pozitive të pasqyrës së ardhurave dhe shpenzimeve.

Në raste përjashtimore, aktivitetet e veçanta të Bankës, të përcaktuara nga Bordi i Guvernatorëve dhe Këshilli i Administrimit në përputhje me paragrafin3, mbulohen me kapitalin rezervë.

Ky paragaf zbatohet edhe për llogaritë e konsoliduara të Bankës.

6. Banka mbron veten kundër riskut të këmbimit valutor, duke përfshirë në kontratat e saj për huat dhe dorëzanitëklauzola të cilat i konsideron të përshtatshme.

Neni 17
(ish-neni 19)

1. Normat e interesit për huatë që jep Banka, komisionet dhe detyrimet e tjera rregullohen sipas kushteve që mbizotërojnë në tregun e kapitalit dhe llogariten në mënyrë të tillë që të ardhurat prej tyre të bëjnë të mundur që Banka të përmbushë detyrimet e saj, të mbulojë shpenzimet dhe riskun dhe të krijojë një fonde rezerve siç parashikohet në nenin 22.

2. Banka nuk bën ulje të normave të interesit. Nëse ulja e normës së interesit është e nevojshme nisur nga natyra e investimeve që do të financohen, Shteti Anëtar i interesuar ose disa

agjenci të tjera mund të japin ndihmë për shlyerjen e interesit në masën që kjo është në përputhje me nenin 107 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 18
(ish-neni 20)

Banka në operacionet e saj të financimit, respekton parimet e mëposhtme:

1. Siguron që fondet e saj përdoren në mënyrën më racionale të mundshme në interes të Bashkimit.

Mund të japë hua ose dorëzani vetëm:

(a) nëse, në rast të investimeve nga ndërmarrjet në sektorin e prodhimit, pagesa e interesit dhe amortizimit mbulohet nga fitimet e veprimtarisë , ose në rastin e investimeve të tjera, ajo mbulohet ose nga angazhimi financiar i marrë nga Shteti ku është bërë investimi ose nga disa mjete të tjera; dhe

(b) nëse realizimi i investimit kontribuon në rritjen e rendimenti ekonomik në përgjithësi dhe nxit arritjen e tregut të brendshëm.

2. Nuk blen aksione në asnjë ndërmarrje dhe nuk merr ndonjë përgjegjësi në administrimin e saj, përveçse kur kjo kërkohet për të ruajtur të drejtat e Bankës për të siguruar rikuperimin e fondeve të dhëna hua.

Megjithatë, në përputhje me parimet e përcaktuara nga Bordi i Guvernatorëve sipas nenit 7 (3)(b) dhe kur e kërkon zbatimi i operacioneve të parashikuara në nenin 309 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Këshilli i Administrimit përcakton, me shumicë të cilësuar, afatet dhe kushtet për pjesëmarrje në kapitalin neto të një ndërmarrjeje tregtare, normalisht si plotësues të një kredie osedorëzanie, për sa kohë që kjo është e nevojshme për të financuar një investim ose program.

3. Mund të heqë dorë nga të drejtat e veta në tregun e kapitalit dhe për këtë qëllim mund t'u kërkojë debitorëve të emetojnë obligacione ose letra të tjera me vlerë.

4. As Banka e as Shtetet Anëtare nuk duhet të imponojnë kushte mbi përdorimin e fondeve të dhëna nga Banka për t'u shpenzuar në një Shtet Anëtar.

5. Banka mund të vendosë kushtëzime të kredive që jep qysh në organizimin e ftesës për tender ndërkombëtar.

6. Banka nuk financon, plotësisht ose pjesërisht, investime të kundërshtuara nga Shteti Anëtar në territorin e të cilit këto do të realizohen.

7. Banka, në plotësim të aktivitetit të saj të huadhënies, mund të ofrojë shërbime për mbështetje teknike në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara nga Bordi i Guvernatorëve i cili vendos me shumicë të cilësuar dhe në përputhje me këtë Statut.

Neni 19
(ish-neni 21)

1. Çdo ndërmarrje ose entitet privat apo publik mund të paraqesë kërkesë për financim drejtpërdrejt pranë Bankës. Kërkesat Bankës mund t'i bëhen edhe nëpërmjet Komisionit ose nëpërmjet Shtetit Anëtar në territorin e të cilit do të realizohet investimi.

2. Kërkesat e bëra nëpërmjet Komisionit i paraqiten për opinion Shtetit Anëtar në territorin e të cilit do të kryhet investimi. Kërkesat e bëra nëpërmjet një Shteti Anëtar i paraqiten Komisionit për opinion. Kërkesat e bëra drejtpërdrejt nga një ndërmarrje i paraqiten Shtetit Anëtar të interesuar dhe Komisionit.

Shteti Anëtar i interesuar dhe Komisioni japin opinionet e tyre brenda dy muajve. Nëse nuk merret përgjigje brenda kësaj periudhe, Banka mund të prezumojë që për investimin në fjalë nuk ka kundërshtim.

3. Këshilli i Administrimit vendos për operacionet e financimit që i paraqiten nga Komiteti i Menaxhimit.

4. Komiteti i Menaxhimit shqyrton nëse operacionet e financimit që i paraqiten, i respektojnë dispozitat e këtij Statuti, sidomos nenin 16 dhe 18. Nëse Komiteti i Menaxhimit është në favor të operacionit të financimit, i paraqet Këshillit të Administrimit propozimin përkatës; Komiteti mund t'ia nënshtrojë opinionin e tij favorizues kushteve që i konsideron thelbësore. Nëse Komiteti i Menaxhimit është kundër dhënies së financimit, i paraqet Këshillit të Administrimit dokumentet e duhura së bashku me opinionin e tij.

5. Nëse Komiteti i Menaxhimit jep një opinion jo favorizues, atëherë Këshilli i Administrimit, nuk mund ta japë financimin në fjalë përveçse kur kjo vendoset me unanimitet.

6. Këshilli i Administrimit, nëse Komisioni jep një opinion jo favorizues, nuk mund ta japë financimin në fjalë, përveçse kur vendoset me unanimitet dhe abstenon vetëm anëtari i Këshillit të Administrimit i cili është propozuar nga Komisioni,.

7. Këshilli i Administrimit nuk mund ta japë financimin nëse Komiteti i Menaxhimit dhe Komisioni japin opinion jo favorizues.

8. Në rast se operacioni i financimit për një investim të miratuar duhet të ristrukturohet për të ruajtur të drejtat dhe interesat e Bankës, Komiteti i Administratorëve merr pa vonesë masat e menjëhershme që i konsideron të nevojshme, për të cilat i raporton menjëhershëm Këshillit të Administrimit.

Neni 20
(ish-neni 22)

1. Banka, për kryerjen e detyrave të saj, merr hua fondet e nevojshme në tregjet e kapitalit.

2. Banka mund të marrë hua në tregjet e kapitalit të Shteteve Anëtare në përputhje me dispozitat ligjore që zbatohen për këto tregje.

Autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar me një shmangie sipas kuptimit të nenit 139(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, mund ta kundërshtojnë këtë, vetëm nëse tregu i kapitalit i atij Shteti rrezikon të preket ndjeshëm.

Neni 21
(ish-neni 23)

1. Banka mund të përdorë, sipas mënyrave të mëposhtme, çdo fond në dispozicion i cili nuk i nevojitet për përmbushjen e detyrimeve të saj:

(a) mund të investojë në tregjet monetare;

(b) mund të blejë dhe shesë letra me vlerë sipas dispozitave të nenit 18 pika 2;

(c) mund të kryejë veprime të tjera financiare që lidhen me objektivat e saj.

2. Banka, pa cenuar dispozitat e nenit 23, gjatë administrimit të investimeve të saj nuk përfshihet në asnjë arbitrazh valutor i cili nuk është menjëherë i nevojshëm për të kryer operacionet e huadhënies, apo për të përmbushur angazhimet financiare që rrjedhin nga kreditë e marra ose dorëzanitëe dhëna prej saj.

3. Banka, në fushat që mbulon ky nen, vepron në marrëveshje me autoritetet kompetente ose me bankën qendrore kombëtare të Shtetit Anëtar përkatës.

Neni 22
(ish-neni 24)

1. Një fond rezervë deri në 10% të kapitalit të nënshkruar krijohet në mënyrë progresive. Këshilli i Administrimit mund të vendosë të lërë mënjanë rezervat shtesë, nëse këtë e justifikon gjendja e pasiveve të Bankës. Deri në kohën e krijimit të plotë të këtij fondi rezerve, ai pasurohet nga:

(a) interesat e arkëtuara për kreditë që ka dhënë Banka, nga shumat që duhen paguar nga Shtetet Anëtare sipas nenit 5;

(b) interesat e arkëtuara për kreditë që ka dhënë Banka, nga fondet që rrjedhin nga shlyerja e kredive të përmendur në germën (a):

për aq sa këto të ardhura nuk janë të nevojshme për të plotësuar detyrimet e Bankës ose për të mbuluar shpenzimet e saj.

2. Burimet e fondit rezervë investohen në mënyrë të tillë që të jenë në çdo kohë të gatshme për të plotësuar qëllimin e fondit.

Neni 23
(ish-neni 25)

1. Banka ka të drejtë në çdo kohë t'i transferojë aktivet që ka në monedhën e një Shteti Anëtar monedha e të cilit nuk është euroja, me qëllim që të kryejë operacione financuese të cilat i korrespondojnë detyrës së parashikuar në nenin 309 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 21 të këtij Statuti. Banka shmang, sa më shumë të jetë e mundur, transferime të tilla, nëse ka aktive në mjete monetare ose aktive likuide në valutën e kërkuar.

2. Banka nuk mund të konvertojë aktivet e saj në monedhën e një Shteti Anëtar valuta e të cilit nuk është euro, në monedhën e një vendi të tretë pa miratimin e Shtetit Anëtar të interesuar.

3. Banka mund të heqë lirshëm atë pjesë të kapitalit që është paguar dhe që është në çfarëdo monedhe, të marrë hua në tregjet jashtë Bashkimit.

4. Shtetet Anëtare marrin përsipër t'u vënë në dispozicion debitorëve të Bankës monedhën që nevojitet për të shlyer kapitalin dhe për të paguar interesin mbi kredinë ose komisionin mbi dorëzanitëe dhëna nga Banka për investime që duhet të kryhen në territorin e tyre.

Neni 24
(ish-neni 26)

Nëse një Shtet Anëtar nuk plotëson detyrimet e anëtarësimit që lindin nga ky Statut, në veçanti detyrimin për të shlyer aksionet e veta në kapitalin e nënshkruar, ose për të shlyer huanë, dhënia e kredive ose dorëzanive për atë Shtet Anëtar ose shtetasit e tij mund të pezullohet me vendim të marrë me shumicë të cilësuar nga Bordi i Guvernatorëve.

Ky vendim nuk çliron as Shtetin, as shtetasit nga detyrimet e tyre ndaj Bankës.

Neni 25
(ish-neni 27)

1. Nëse Bordi i Guvernatorëve vendos të pezullojë operacionet e Bankës, të gjitha aktivitetet e saj pushojnë menjëherë, përveç atyre që janë të nevojshme për të siguruar realizimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e duhur të aktiveve dhe shlyerjen e pasiveve të saj.

2. Në rastin e likuidimit, Bordi i Guvernatorëve emëron likuiduesit dhe u jep udhëzime për të kryer likuidimin. Ai siguron ruajtjen e të drejtave të punonjësve.

Neni 26
(ish-neni 28)

1. Banka, në çdo Shtet Anëtar, gëzon zotësinë më të gjerë juridike që u jepet personave juridikë sipas legjislacioneve të tyre; në veçanti, Banka mund të fitojë ose disponojë prona të luajtshme ose të paluajtshme dhe mund të jetë palë në procese ligjore.

2. Prona e Bankës përjashtohet nga të gjitha format e rekuizimit ose shpronësimit.

Neni 27
(ish-neni 29)

Mosmarrëveshjet ndërmjet Bankës nga njëra anë dhe kreditorëve, debitorëve ose çdo personi tjetër nga ana tjetër, zgjidhen nga gjykatat kombëtare kompetente, përveç rasteve kur kompetenca për to

i është dhënë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian. Banka mund të parashikojë zgjidhjen me arbitrazh në çdo kontratë.

Banka ka një adresë shërbimi në çdo Shtet Anëtar. Megjithatë, në çdo kontratë, Banka mund të specifikojë një adresë të veçantë shërbimi.

Prona dhe aktivet e Bankës nuk mund të preken ose të sekuestrohen përveçse me vendim gjykate.

Neni 28
(ish-neni 30)

1. Bordi i Guvernatorëve, me unanimitet, mund të vendosë të krijojë filiale ose njësi të tjera që kanë personalitet juridik dhe autonomi financiare.

2. Bordi i Guvernatorëve vendos Statutet e organeve të përmendura në paragrafin 1. Statutet përcaktojnë, në veçanti, objektivat, strukturën, kapitalin, anëtarësinë e tyre, vendndodhjen e selive të tyre, burimet e tyre financiare, mjetet e ndërhyrjes dhe masat organizative për auditimin, si dhe marrëdhënien e tyre me organet e Bankës.

3. Banka ka të drejtë të marrë pjesë në administrimin e këtyre organeve dhe të kontribuojë në kapitalin e tyre të nënshkruar në shumën e përcaktuar me vendim unanim të Bordit të Guvernatorëve.

4. Protokolli mbi privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Europian zbatohet, me të njëjtat afate dhe kushte që zbatohet edhe për Bankën, edhe për organet e përmendura në paragrafin 1, për aq sa ato janë subjekt i së drejtës së Bashkimit, për anëtarët e organeve të tyre në kryerjen e detyrave të tyre si të tillë dhe për personelin e tyre
Sidoqoftë, dividendi, fitimet kapitale dhe forma të tjera të ardhurash që burojnë nga këto organe, për të cilat anëtarët, që nuk janë Bashkimi Europian dhe Banka, janë titullarë, u nënshtrohen dispozitave fiskale të legjislacionit të zbatueshëm.

5. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, brenda kufijve të përcaktuar në vijim, ka juridiksion në mosmarrëveshjet në lidhje me masat e miratuara nga njësitë e një organi të themeluar sipas të drejtës së Bashkimit. Procedimet kundër këtyre masave mund të fillojnë nga çdo anëtar i këtij organi në cilësinë e tij si i tillë ose nga Shtete Anëtare, sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

6. Bordi i Guvernatorëve mund të vendosë me unanimitet ta pranojë personelin e organeve të themeluara sipas të drejtës së Bashkimit në skemat e përbashkëta me Bankën, në përputhje me procedurën e brendshme përkatëse.

———

PROTOKOLLI (nr. 6)

PËR VENDNDODHJEN E SELIVE TË INSTITUCIONEVE DHE DISA ORGANIZMAVE, ZYRAVE, AGJENCIVE DHE DEPARTAMENTEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN

PËRFAQËSUESIT E QEVERIVE TË SHTETEVE ANËTARE,

DUKE PASUR PARASYSH nenin 341 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe nenin 189 të Traktati Themelues i Komunitetit Europian të Energjisë Bërthamore,

DUKE KUJTUAR DHE DUKE KONFIRMUAR Vendimin e 8 prillit 1965 dhe pa cenuar vendimet në lidhje me vendndodhjen e institucioneve, organizmave, zyrave, agjencive dhe departamenteve të ardhshme,

KANË RËNË DAKORD PËR dispozitat e mëposhtme që do i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Traktatit Themelues për Komunitetin Europian të Energjisë Bërthamore:

Nen i vetëm

(a) Parlamenti Europian e ka selinë në Strasburg, ku zhvillohen 12 seancat plenare mujore, përfshirë këtu seancën për buxhetin. Seancat e tjera plenare shtesë zhvillohen në Bruksel. Komisionet e Parlamentit Europian mblidhen në Bruksel. Sekretariati i Përgjithshëm i Parlamentit Europian dhe departamentet e tij ndodhen në Luksemburg.

(b) Këshilli e ka selinë në Bruksel. Gjatë muajve prill, qershor dhe tetor, Këshilli i zhvillon mbledhjet në Luksemburg.

(c) Komisioni e ka selinë në Bruksel. Departamentet e renditura në nenet 7, 8 dhe 9 të Vendimit të 8 prillit 1965 ndodhen në Luksemburg.

(d) Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian e ka selinë në Luksemburg.

(e) Gjykata e Audituesve e ka selinë në Luksemburg.

(f) Komiteti Ekonomik dhe Social e ka selinë në Bruksel.

(g) Komiteti i Rajoneve e ka selinë në Bruksel.

(h) Banka Europiane e Investimeve e ka selinë në Luksemburg.

(i) Banka Qendrore Europiane e ka selinë në Frankfurt.

(j) Zyra Europiane e Policisë (Europol) e ka selinë në Hagë.

———

PROTOKOLLI (nr. 7)

PËR PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E BASHKIMIT EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH që, në përputhje me nenin 343 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe nenin 191 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Bërthamore ("EUROATOM"), Bashkimi Europian dhe EUROATOM-i gëzojnë privilegje dhe imunitetet që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre në territoret e Shteteve Anëtare,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që do i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Traktatit Themelues të Komunitetin Europian të Energjisë Bërthamore:

KREU I

PRONAT, FONDET, AKTIVET DHE OPERACIONET E BASHKIMIT EUROPIAN

Neni 1

Ambientet dhe ndërtesat e Bashkimit janë të paprekshme. Ato nuk i nënshtrohen kontrollit, rekuizimit, konfiskimit apo shpronësimit. Pronat dhe aktivet e Bashkimit nuk u nënshtrohen masave administrative apo ligjore të kufizimit pa autorizim nga Gjykata e Drejtësisë.

Neni 2

Arkiva e Bashkimit nuk cenohet.

Neni 3

Bashkimi, aktivet e tij, të ardhurat dhe prona të tjera të tij përjashtohen nga të gjitha tatimet e drejtpërdrejta.

Qeveritë e Shteteve Anëtare, kur është e mundur, marrin masat e nevojshme për të kthyer ose rimbursuar shumën e tatimeve të tërthorta ose tatimeve të tjera mbi shitjen të përfshira në çmimin e pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, kur Bashkimi, për përdorimin e tij zyrtar, bën blerje të konsiderueshme çmimi i të cilave përfshin tatime të këtij lloji. Megjithatë zbatimi i këtyre dispozitave nuk duhet të çojë në shtrembërimin e konkurrencës brenda Bashkimit.

Në lidhje me tatime dhe taksa që janë thjesht pagesa për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, energjisë elektrike dhe gazit.

Neni 4

Bashkimi përjashtohet nga të gjitha taksat doganore, ndalimet dhe kufizimet për import-eksportin e sendeve për përdorim zyrtar prej tij: sendet e importuara nuk shiten, qoftë edhe për të bërë një pagesë, në territorin e Shtetit ku janë importuar, përveçse sipas kushteve të miratuara nga qeveria e atij Shteti. Bashkimi përjashtohet gjithashtu nga të gjitha taksat doganore, ndalimet dhe kufizimet për import eksportin e botimeve të tij.

KREU II

KOMUNIKIMET DHE LEJEKALIMET

Neni 5
(ish neni 6)

Institucionet e Bashkimit për komunikimet e tyre zyrtare dhe dërgimin e të gjitha dokumenteve, në territorin e çdo Shteti Anëtar kanë të drejtë për të njëjtin trajtim që ai Shtet u jep misioneve diplomatike.

Korrespondenca zyrtare dhe komunikimet e tjera zyrtare të institucioneve të Bashkimit nuk i nënshtrohen censurës.

Neni 6
(ish-neni 7)

Presidentët e institucioneve të Bashkimit mund t'u japin anëtarëve dhe nëpunësve të këtyre institucioneve lejekalimi në formën që përcakton Këshilli me shumicë të thjeshtë, e cila njihet si dokument i vlefshëm udhëtimi nga autoritetet e Shteteve Anëtare. Këto lejekalimi u jepen zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë sipas kushteve të parashtruara në Rregulloren e Personelit të Zyrtarëve dhe Kushteve të Punësimit të nëpunësve të tjerë të Bashkimit.

Komisioni mund të lidhë marrëveshje për këto lejekalimi me qëllim njohjen e tyre si dokumente të vlefshme udhëtimi brenda territorit të vendeve të treta.

KREU III

DEPUTETËT E PARLAMENTIT EUROPIAN

Neni 7
(ish-Neni 8)

Asnjë kufizim administrativ apo kufizim tjetër nuk vihet mbi lëvizjen e lirë të deputetëve të Parlamentit Europian që udhëtojnë drejt vendit ose nga vendi ku mblidhet Parlamenti Europian.

Deputetëve të Parlamentit Europian në lidhje me kontrollin doganor dhe valutor, u ofrohen:

(a) nga qeveritë e tyre, të njëjtat lehtësira që u ofrohen zyrtarëve e lartë që udhëtojnë me misione të përkohshme zyrtare;

(b) nga qeveritë e Shteteve të tjera Anëtare, të njëjtat lehtësira që u ofrohen përfaqësuesve të qeverive të huaja me misione të përkohshme zyrtare.

Neni 8
(ish-neni 9)

Deputetët e Parlamentit Europian nuk i nënshtrohen hetimit, ndalimit apo ndjekjes penale në lidhje me opinionet e shprehura ose votat e hedhura prej tyre në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 9
(ish-neni 10)

Gjatë seancave të Parlamentit Europian, deputetët e tij gëzojnë:

(a) në territorin e shtetit të tyre, imunitetin që u jepet deputetëve të parlamentit të tyre;

(b) në territorin e çdo Shteti tjetër Anëtar, imunitet nga masa e ndalimit dhe nga procesi ligjor.

Imuniteti vlen njësoj për deputetët kur udhëtojnë drejt venit ose nga vendi ku mblidhet Parlamenti Europian.

Nuk mund të kërkohet imunitet nëse deputeti kapet në shkelje dhe imuniteti nuk e pengon Parlamentin Europian të ushtrojë të drejtën e tij për t'ia hequr imunitetin njërit prej deputetëve të tij.

KREU IV

PËRFAQËSUESIT E SHTETEVE ANËTARE QË MARRIN PJESË NË PUNËN E INSTITUCIONEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN

Neni 10
(ish-neni 11)

Përfaqësuesit e Shteteve Anëtare që marrin pjesë në punën e institucioneve të Bashkimit, këshilltarët dhe ekspertët e tyre teknikë, në kryerjen e detyrave të tyre dhe gjatë udhëtimit drejt vendit të takimit dhe nga vendi i takimit, gëzojnë privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat e zakonshme.

Ky nen vlen edhe për anëtarët e organeve këshillimore të Bashkimit.

KREU V

ZYRTARËT DHE NËPUNËSIT E TJERË TË BASHKIMIT EUROPIAN

Neni 11
(ish-neni 12)

Zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të Bashkimit, në territorin e çdo Shteti Anëtar dhe cilado qoftë shtetësia e tyre:

(a) sipas dispozitave të Traktateve nga njëra anë në lidhje me rregullat për përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë ndaj Bashkimit dhe nga ana tjetër me kompetencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian në mosmarrëveshje ndërmjet Bashkimit dhe zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë, janë imunë nga procesi ligjor në lidhje me akte të kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare, duke përfshirë fjalë të shkruara ose të thëna. Ata vazhdojnë ta gëzojnë këtë imunitet dhe pasi kanë pushuar që mbajturi detyrën;

(b) së bashku me bashkëshortët dhe familjarët në varësi të tyre, nuk u nënshtrohen kufizimeve të imigracionit, ose formaliteteve për regjistrimin e të huajve;

(c) në lidhje me rregullat valutore ose të këmbimit valutor, u ofrohen lehtësi njësoj si ato që u ofrohen zakonisht zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare;

(d) gëzojnë të drejtën të importojnë pa doganë mobiliet dhe sendet e tyre në momentin e marrjes së detyrës për herë të parë në vendin në fjalë, dhe të drejtës për të rieksportuar pa doganë mobiliet dhe sendet e tyre, me përfundimin e detyrës së tyre në atë vend, në secilin rast sipas kushteve që konsiderohen të nevojshme nga qeveria e vendit ku ushtrohet kjo e drejtë;

(e) kanë të drejtë të importojnë pa doganë një automjet për përdorim personal, të blerë ose në vendin e qëndrimit të tyre të fundit ose në vendin ku janë shtetas sipas kushteve të tregun në atë vend dhe të drejtë ta rieksportojnë atë pa doganë, në secilin rast sipas kushteve që konsiderohen të nevojshme nga qeveria e vendit në fjalë.

Neni 12
(ish-neni 13)

Sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, me anë të rregulloreve në përputhje me procedurë e zakonshme legjislative dhe pas konsultimit me institucionet e duhura, zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të Bashkimit për përfitimin e këtij të fundit janë subjekt i tatimit mbi pagat, rrogat dhe shpërblimeve që paguhen nga Bashkimi.

Zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të Bashkimit përjashtohen nga tatimet kombëtare mbi pagat, rrogat dhe shpërblimet që paguhen nga Bashkimi.

Neni 13
(ish-neni 14)

Në zbatim të tatimit mbi të ardhurat, pasurinë dhe trashëgiminë dhe në zbatim të konventave mbi shmangien e tatimit të dyfishtë të nënshkruara ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit, zyrtarët

dhe nëpunësit e tjerë të Bashkimit që vetëm për arsye të kryerjes së detyrave të tyre në shërbim të Bashkimit kanë banimin e tyre në territorin e një Shteti Anëtar që nuk është Shteti i tyre i vendbanimit, për qëllime tatimore në kohën e kryerjes së shërbimit për Bashkimin, konsiderohen, në Shtetin ku banojnë dhe në shtetin e vendbanimit për qëllimet tatimore, se e kanë mbajtur vendbanimin e tyre në Shtetin e fundit me kusht që ky të jetë anëtar i Bashkimit. Kjo dispozitë zbatohet edhe për bashkëshortin/en, me kusht që të mos jetë përfshirë në një aktivitet fitimprurës dhe për fëmijët nën varësinë dhe kujdesin e personave të përmendur në këtë nen.

Prona e luajtshme, që u përket personave të përmendur në paragrafin e mësipërm dhe që ndodhet në territorin e shtetit ku ata qëndrojnë, përjashtohet nga taksa mbi trashëgiminë në atë shtet. Kjo pronë, për vlerësimin e këtij detyrimi, konsiderohet se ndodhet në shtetin e vendbanimit për qëllime tatimore, në varësi të të drejtave të shteteve të treta dhe zbatimit të mundshëm të dispozitave të konventave ndërkombëtare mbi tatimin e dyfishtë.

Asnjë vendbanim i fituar vetëm për arsye të kryerjes së detyrave në shërbim të organizatave të tjera ndërkombëtare nuk merret parasysh në zbatimin e dispozitave të këtij neni.

Neni 14
(ish-neni 15)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, me anë të rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pas konsultimit me institucionet përkatëse, përcaktojnë skemën e përfitimeve të sigurimeve shoqërore për zyrtarët dhe nëpunësit e Bashkimit.

Neni 15
(ish-neni 16)

Parlamenti Europian dhe Këshilli, me anë të rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pas konsultimit me institucionet e tjera përkatëse, përcaktojnë kategoritë e zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë të Bashkimit për të cilët zbatohet, pjesërisht ose plotësisht, neni 11, neni 12 paragrafi 2 dhe neni 13.

Emrat, gradat dhe adresat e zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë të përfshirë në këto kategori u komunikohen rregullisht qeverive të Shteteve Anëtare.

KREU VI

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E MISIONEVE TË VENDEVE TË TRETA TË AKREDITUARA NË BASHKIMIN EUROPIAN

Neni 16
(ish-neni 17)

Shteti Anëtar në territorin e të cilit Bashkimi ka selinë e vet u jep privilegjet dhe imunitetet diplomatike të zakonshme misioneve të vendeve të treta të akredituara në Bashkimin.

KREU VII

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 17
(ish-neni 18)

Privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat u jepen zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë të Bashkimit vetëm për interes të Bashkimit.

Çdo institucioni të Bashkimit i kërkohet t'ia heqë imunitetin një zyrtari ose nëpunësi tjetër kurdoherë që institucioni e gjykon që heqja e këtij imuniteti nuk është në kundërshtim me interesat e Bashkimit.

Neni 18
(ish-neni 19)

Institucionet e Bashkimit, për qëllim të zbatimit të këtij Protokolli, bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të interesuara.

Neni 19
(ish-neni 20)

Neni nga 11 deri në 14 dhe Neni 17 zbatohen për Presidentin e Këshillit Europian.

Ato zbatohen gjithashtu për Anëtarët e Komisionit.

Neni 20
(ish-neni 21)

Nenet nga 11 deri në 14 dhe neni 17 zbatohen për gjyqtarët, Avokatët e Përgjithshëm, Kancelarët dhe Asistent-Relatorët e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, pa cenuar dispozitat e nenit 3 të Protokollit mbi Statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian në lidhje me imunitetin nga procesi ligjor të Gjyqtarëve dhe Avokatëve të përgjithshëm.

Neni 21
(ish-neni 22)

Ky protokoll zbatohet gjithashtu për Bankën Europiane të Investimeve, anëtarët e organeve të saj, personelin dhe përfaqësuesit e Shteteve Anëtare që marrin pjesë në aktivitetet e saj pa cenuar Protokollin mbi Statutin e Bankës.

Krahas kësaj, Banka Europiane e Investimeve përjashtohet nga çdo lloj forme tatimi apo detyrimi të ngjashëm në rastin e zmadhimit të kapitalit të saj dhe nga formalitete të ndryshme që mund të lidhen me të në Shtetin ku Banka ka selinë e saj. Po kështu, shpërbërja ose likuidimi i saj nuk çojnë

në lindjen e asnjë detyrimi. Në përfundim, aktivitetet e Bankës dhe organeve të saj të kryera në përputhje me Statutin e saj nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat.

Neni 22
(ish-neni 23)

Ky nen zbatohet gjithashtu për Bankën Qendrore Europiane, për anëtarët e organeve të saj dhe personelin e saj, pa cenuar Protokollin mbi Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane.

Banka Qendrore Europiane gjithashtu përjashtohet nga çdo lloj forme tatimi apo detyrimi të ngjashëm në rastin e zmadhimit të kapitalit të saj dhe nga formalitete të ndryshme që mund të lidhen me të në Shtetin ku Banka ka selinë e saj. Aktivitetet e Bankës dhe organeve të saj të kryera në përputhje me Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat.

———

PROTOKOLL (nr. 8)

NË LIDHJE ME NENI 6 PIKA 2 TË TRAKTATIT PËR BASHKIMIN EUROPIAN PËR ADERIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN NË KONVENTËN EUROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Marrëveshja në lidhje me aderimin e Bashkimit në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në vijim "Konventa Europiane" e parashikuar në Nenin 6 pika 2 të Traktatit për Bashkimin Europian parashikon ruajtjen e karakteristikave specifike të Bashkimit dhe të drejtës së Bashkimit, në veçanti në lidhje me:

(a) masat specifike për pjesëmarrjen e mundshme të Bashkimit në organet e kontrollit të Konventës Europiane;

(b) mekanizmat e nevojshme për të siguruar që procedimet nga Shtetet jo Anëtare dhe kërkesat e veçanta t'u adresohen saktësisht Shteteve Anëtare dhe/ose Bashkimit sipas rastit.

Neni 2

Marrëveshja e përmendur në nenin 1 siguron që aderimi i Bashkimit të mos prekë kompetencat e Bashkimit ose të institucioneve. Ajo siguron që asnjë parashikim i saj të mos ndikojë tek situata e Shteteve Anëtare në lidhje me Konventën Europiane, sidomos në lidhje me Protokollet e saj, masat e marra nga Shtetet Anëtare me shmangie nga Konventa Europiane në përputhje me nenin 15 të saj dhe rezervat e formuluara nga Shtetet Anëtare për Konventën Europiane në përputhje me nenin 57 të saj.

Neni 3

Asnjë dispozitë e marrëveshjes së përmendur në nenin 1 nuk prek nenin 344 të Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian.

———

PROTOKOLL (nr. 9)

PËR VENDIMIN E KËSHILLIT NË LIDHJE ME ZBATIMIN E NENIT 16 PIKA 4 TË TRAKTATIT PËR BASHKIMIN EUROPIAN DHE NENIN 238 PIKA 2 TË TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN NDËRMJET 1 NËNTORIT 2014 DHE 31 MARSIT 2017 NGA NJËRA ANË DHE QË NGA 1 PRILLI 2017 NGA ANA TJETËR

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH rëndësinë thelbësore që kishte në miratimin e Traktatit të Lisbonës marrëveshja për Vendimin e Këshillit në lidhje me zbatimin e nenit 16 pika 4 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenit 238 pika 2 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian ndërmjet 1 nëntorit 2014 dhe 31 marsit 2017 nga njëra anë dhe që nga 01 prilli 2017 nga ana tjetër (në vijim "Vendimi"),

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Nen i vetëm

Këshilli Europian, përpara se Këshilli të shqyrtojë çdo projekt që mund të synojë ndryshimin ose shfuqizimin e Vendimit apo të ndonjë dispozite të tij, ose ndryshimin tërthorazi të fushës së tij të zbatimit apo kuptimin e tij nëpërmjet ndryshimit të një akti tjetër juridik të Bashkimit, zhvillon me konsensus në përputhje me nenin 15 pika 4 të Traktatit për Bashkimin Europian një diskutim paraprak mbi projektin në fjalë.

———

PROTOKOLL (nr. 10)

PËR BASHKËPUNIMIN E PËRHERSHËM TË STRUKTURUAR KRIJUAR ME NENIN 42 TË TRAKTATIT PËR BASHKIMIN EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH nenin 42 pika 6 dhe nenin 46 të Traktatit për Bashkimin Europian,

DUKE KUJTUAR që Bashkimi ndjek një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të bazuar në arritjen e konvergjencës në rritje të veprimeve të Shteteve Anëtare,

DUKE KUJTUAR që politika e përbashkët e mbrojtjes dhe e sigurisë është pjesë e pandarë e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë; që i siguron Bashkimit kapacitet funksional me mbështetjen e mjeteve civile dhe ushtarake; që Bashkimi mund t'i përdorë këto mjete për detyrat e përmendura në nenin 43 të Traktatit për Bashkimin Europian jashtë Bashkimit për të ruajtur paqen, parandaluar konfliktin dhe forcuar sigurinë ndërkombëtare në përputhje me parimet e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara; që kryerja e këtyre detyrave duhet të bëhet duke përdorur kapacitetet e vëna në dispozicion nëpërmjet aftësive të siguruara nga Shtetet Anëtare në përputhje me parimin e një tërësie të vetme forcash,

DUKE KUJTUAR që politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes e Bashkimit nuk prek natyrën specifike të politikës së mbrojtjes dhe sigurisë të disa Shteteve Anëtare,

DUKE KUJTUAR që politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes e Bashkimit përmbush detyrimet sipas Traktatit të Atlantikut të Veriut të Shteteve Anëtare, që e shohin mbrojtjen e tyre të përbashkët të realizuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, i cili mbetet themeli i mbrojtjes kolektive të anëtarëve të tij, dhe është në përputhje me politikën e përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes të krijuar brenda atij kuadri,

TE BINDUR që një rol më i fuqishëm i Bashkimit në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë do të kontribuojë në vitalitetin e një Aleance të Atlantikut të përtërirë në përputhje me kuadrin "Berlin Plus",

TE VENDOSUR për të siguruar që Bashkimi të jetë i aftë të marrë plotësisht përgjegjësitë e tij brenda komunitetit ndërkombëtar,

DUKE PRANUAR që Organizata e Kombeve të Bashkuara mund të kërkojë mbështetjen e Bashkimit për realizimin e ngutshëm të misioneve të ndërmarra sipas Kreut VI dhe VII të Kartës së OKB-së,

DUKE PRANUAR që forcimi i politikës së sigurisë dhe mbrojtjes kërkon përpjekje nga Shtetet Anëtare në fushën e aftësive,

TE NDËRGJEGJSHËM që fillimi i një fazë të re në zhvillimin e politikës europiane të sigurisë dhe mbrojtjes kërkon përpjekje të vendosura nga Shtetet Anëtare të përfshira,

DUKE KUJTUAR rëndësinë e përfshirjes së plotë të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë në proceset që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar i përmendur në Nenin 42 pika 6 të Traktatit për Bashkimin Europian është i hapur për çdo Shtet Anëtar i cili nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, merr përsipër:

(a) të vazhdojë të zhvillojë më intensivisht aftësitë mbrojtëse nëpërmjet zhvillimit të kontributit dhe pjesëmarrjes kombëtare, sipas rastit, në forcat shumëkombëshe, në programet kryesore Europiane të pajimit dhe në aktivitetin e Agjencisë në fushën e zhvillimit të aftësive mbrojtëse, kërkimit, blerjes dhe armatimit (Agjencia Europiane e Mbrojtjes), dhe

(b) të ketë kapacitetin të sigurojë, jo më vonë se viti 2010, në nivel kombëtar ose si komponent i forcave shumëkombëshe, njësi speciale të luftimit për misionet e planifikuara, që në nivel taktik strukturohen si grup luftimi, me elemente mbështetëse që përfshijnë transportin dhe logjistikën, për të kryer detyrat e përmendura në nenin 43 të Traktatit për Bashkimin Europian, brenda një periudhe 5 deri në 30 ditë, sidomos në përgjigje të kërkesave nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe që mund të mbështeten për një periudhë fillestare 30-ditore dhe të shtyhen të paktën deri në 120 ditë.

Neni 2

Për të arritur objektivat e përcaktuar në nenin 1, Shtetet Anëtare pjesëmarrëse në bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar marrin përsipër:

(a) të bashkëpunojnë, që me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, me synim realizimin e objektivave të miratuara në lidhje me nivelin e shpenzimeve për investime në pajime mbrojtjeje, dhe t'i rishikojnë rregullisht këta objektiva, nisur nga situata e sigurisë dhe përgjegjësitë ndërkombëtare të Bashkimit;

(b) t'i përputhin sa më shumë aparatet e tyre të mbrojtjes me njëri-tjetrin, sidomos duke harmonizuar identifikimin e nevojave të tyre ushtarake, duke i bashkuar, dhe sipas rastit, duke i specializuar mjetet e tyre të mbrojtjes dhe aftësitë, dhe duke inkurajuar bashkëpunimin në fushat e trajnimit dhe logjistikës;

(c) të marrin masa konkrete për të rritur disponueshmërinë, ndërshfrytëzueshmërinë, fleksibilitetin dhe dislokueshmërinë e forcave të tyre sidomos duke identifikuar objektiva konkrete në lidhje me angazhimin e forcave, përfshirë këtu rishikimin e mundshëm të procedurave të tyre të vendimmarrjes;

(d) të punojnë së bashku që të marrin masat e nevojshme për të pakësuar, nëpërmjet metodave shumëkombëshe dhe pa cenuar sipërmarrjet në këtë drejtim në kuadër të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, mangësitë e konceptuara në kuadër të "Mekanizmit të Zhvillimit të Aftësive";

(e) të marrin pjesë, sipas rastit, në zhvillimin e programeve të rëndësishme të përbashkëta ose Europiane për pajimet në kuadër të Agjencisë Europiane të Mbrojtjes.

Neni 3

Agjencia Europiane e Mbrojtjes kontribuon në vlerësimin e rregullt të kontributit të Shteteve Anëtare pjesëmarrëse në lidhje me aftësitë, në veçanti kontributin e dhënë në përputhje me kriteret që duhet të caktohen, ndër të tjerash, në bazë të nenit 2, dhe raporton në lidhje me to të paktën një herë në vit. Vlerësimi mund të shërbejë si bazë për rekomandimet e Këshillit dhe vendimet e miratuara në përputhje me nenin 46 të Traktatit për Bashkimin Europian.

———

PROTOKOLLI (nr. 11)

PËR NENIN 42 TË TRAKTATIT PËR BASHKIMIN EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE KUJTUAR nevojën për të zbatuar plotësisht dispozitat e nenit 42 pika 2 të Traktatit për Bashkimin Europian,

DUKE KUJTUAR që Politika e Bashkimit në përputhje me nenin 42 nuk cenon karakterin e veçantë të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes të Shtete të caktuara Anëtare dhe respekton detyrimet e Shteteve të caktuara Anëtare, të cilat mbrojtjen e tyre të përbashkët e shohin të realizuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), sipas Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe është përputhje me politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të vendosur brenda atij kuadri,

KANË RËNË DAKORD për dispozitën e mëposhtme që i shtohet Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Bashkimi Europian së bashku me Bashkimin Europian Perëndimor hartojnë marrëveshje për bashkëpunim të përforcuar e t ndërmjet tyre.

———

PROTOKOLLI (nr. 12)

PËR PROCEDURËN E DEFICITIT TË TEPËRT

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të përcaktuar hollësitë e procedurës së deficitit të tepërt të përmendur në nenin 126 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Vlerat krahasuese të përmendura në nenin 126 pika 2 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian janë:

– 3 % për raportin e deficitit të planifikuar ose faktik publik mbi produktin e brendshëm bruto me çmime tregu;

– 60 % për raportin e borxhit publik mbi produktin e brendshëm bruto me çmime tregu.

Neni 2

Në nenin 126 të Traktatit në fjalë dhe në këtë Protokoll:

– "publik' nënkupton qeverinë në përgjithësi njësitë e pushtetit qendror, rajonal apo vendor, dhe fondet e sigurimeve shoqërore me përjashtim të operacioneve tregtare siç përkufizohet në Sistemin Europian të Llogarive Ekonomike të Integruara;

– "deficit" nënkupton huamarrjen neto siç përkufizohet në Sistemin Europian të Llogarive Ekonomike të Integruara;

– "investime" nënkupton krijimin bruto të kapitalit fiks siç përkufizohet në Sistemin Europian të Llogarive Ekonomike të Integruara;

– "borxh" nënkupton borxhin gjithsej bruto në vlerë nominale i papaguar në fund të vitit dhe i konsoliduar ndërmjet dhe midis sektorëve të administrimit publik, siç e përkufizon paragrafi i parë.

Neni 3

Për të siguruar efikasitetin e procedurës së deficitit të tepërt, qeveritë e Shteteve Anëtare janë përgjegjëse sipas kësaj procedure për deficitet buxhetore, siç përkufizohen në paragrafin e parë të nenit 2. Shtetet Anëtare sigurohen që procedurat kombëtare në çështje buxhetore të bëjnë të mundur përmbushjen e detyrimeve të tyre në këtë fushë që rrjedhin nga këto Traktate. Shtetet Anëtare i raportojnë Komisionit deficitet e planifikuara dhe faktike dhe nivelet e borxhit të tyre menjëherë dhe rregullisht.

Neni 4

Komisioni siguron të dhënat statistikore të nevojshme për zbatimin e këtij Protokolli.

PROTOKOLL (nr. 13)

PËR KRITERET E KONVERGJENCËS

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të përcaktuar me hollësi kriteret e konvergjencës që orientojnë Bashkimin në marrjen e vendimeve për t'i dhënë fund shmangieve të Shteteve Anëtare me një shmangie, të përmendur në nenin 140 të Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Kriteri për stabilitetin e çmimeve i përmendur në nënpikën e parë të nenit 140 pika 1 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian nënkupton që një Shtet Anëtar ka performancë të qëndrueshme çmimesh dhe normë mesatare inflacioni, të vëzhguara gjatë një periudhe njëvjeçare përpara shqyrtimit, që nuk e kalon me më shumë se 1 ½ pikë përqindjeje atë të të paktën tre nga Shteteve Anëtare me performancën më të mirë përsa i përket stabilitetit të çmimeve. Inflacioni matet nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit mbi bazë krahasuese duke marrë parasysh dallimet në përkufizimet kombëtare.

Neni 2

Kriteri për pozicionin buxhetor të përmendur në nenin 140 pika 1 të Traktatit në fjalë nënkupton që në të njëjtën kohë të shqyrtimit, Shteti Anëtar nuk është objekt i një vendimi të Këshillit sipas nenin 126 pika 6 të Traktatit në fjalë për ekzistencën e deficitit të tepërt.

Neni 3

Kriteri për pjesëmarrje në mekanizmin e kursit të këmbimit të Sistemit Monetar Europian të përmendur në nenin 140 pika 1 të Traktatit në fjalë nënkupton që një Shtet Anëtar ka respektuar kufijtë normalë të luhatjes të parashikuara në mekanizmin e kursit të këmbimit të Sistemit Monetar Europian pa tronditje të ashpra për të paktën dy vitet e fundit përpara shqyrtimit. Në veçanti, Shteti Anëtar në të njëjtën periudhë nuk e zhvlerëson me nismën e vet kursin qendror bilateral të këmbimit të monedhës kundrejt euros.

Neni 4

Kriteri për konvergjencën e normave të interesit i përmendur në nënpikën e katërt të nenit 140 pika 1 të Traktatit në fjalë nënkupton që, i vëzhguar për një periudhë njëvjeçare përpara shqyrtimit, një Shtet Anëtar ka pasur norma nominale interesi afatgjatë, që nuk kalojnë me më shumë se 2 pikë përqindjeje ato të të paktën tre Shteteve Anëtare me performancën më të mirë përsa i përket stabilitetit të çmimeve. Normat e interesit maten në bazë të obligacioneve qeveritare afatgjata ose letrave me vlerë të krahasueshme duke pasur parasysh dallimet në përkufizimet kombëtare.

Neni 5

Komisioni siguron të dhënat statistikore të nevojshme për zbatimin e këtij Protokolli.

Neni 6

Këshilli miraton me unanimitet me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian, BQE-në dhe Komitetin Ekonomik dhe Financiar, dispozitat e duhura për të përcaktuar hollësitë e kritereve të konvergjencës të përmendur në Nenin 140 pika 1 të Traktatit në fjalë, të cilat më pas do të zëvendësojnë këtë Protokoll.

———

PROTOKOLL (nr. 14)

PËR EURO GRUPIN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të krijuar kushtet për rritje më të madhe ekonomike në Bashkimin Europian dhe, për këtë qëllim, për të zhvilluar bashkërendim gjithnjë e më të ngushtë të politikave ekonomike brenda zonës së euros,

TË NDËRGJEGJSHËM për nevojën për të përcaktuar dispozita të veçanta për dialog të rritur ndërmjet Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja, në pritje që euroja të bëhet monedha e të gjitha Shteteve Anëtare të Bashkimit,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Ministrat e Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja mblidhen në takime jo zyrtare. Këto takime, kur nevojitet, zhvillohen për të diskutuar çështje që lidhen me përgjegjësitë specifike që ndajnë në lidhje me monedhën e vetme. Komisioni merr pjesë në takime. Banka Qendrore Europiane ftohet të marrë pjesë në këto takime, që përgatiten nga përfaqësuesit e Ministrave përgjegjës për financat të Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja dhe përfaqësuesit e Komisionit.

Neni 2

Ministrat e Shteteve Anëtare monedha e të cilave është euroja, me shumicën e tyre, zgjedhin një kryetar për 2 vjet e gjysmë.

PROTOKOLL (nr. 15)

PËR DISA DISPOZITA NË LIDHJE ME MBRETËRINË E BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PRANUAR që Mbretëria e Bashkuar nuk detyrohet apo angazhohet për ta përdorur euron pa një vendim të veçantë në lidhje me këtë nga qeveria dhe parlamenti i saj,

MEQENËSE, më 16 tetor 1996 dhe 30 tetor 1997, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e njoftoi Këshillin për synimin e saj që të mos marrë pjesë në fazën e tretë të bashkimit ekonomik dhe monetar,

DUKE VËNË NË DUKJE praktikën e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për të financuar kërkesën e saj për huamarrje me shitje borxhi tek sektori privat,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

1. Nëse Mbretëria e Bashkuar nuk e njofton Këshillin për synimin e saj për të përdorur euron, nuk është e detyruar ta bëjë këtë gjë.

2. Nisur nga njoftimi që Mbretëria e Bashkuar i bëri Këshillit me 16 tetor 1996 dhe 30 tetor 1997, paragrafëtnga 3 deri në 8 dhe 10 zbatohen për Mbretërinë e Bashkuar.

3. Mbretëria e Bashkuar ruan kompetencat e veta në fushën e politikës monetare sipas legjislacionit vendas.

4. Neni 119 paragrafi i dytë, neni 126(1), 9 dhe 11, neni 127(1) deri në (5), neni 128, 130, 131, 132, 133, 138, 140(3), 219, 282(2), me përjashtim të fjalisë së parë dhe të fundit të saj, dhe neni 283 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian nuk zbatohen për Mbretërinë e Bashkuar. E njëjta gjë vlen për nenin 121(2) të këtij Traktati për sa i takon miratimit të pjesëve të orientimeve të politikave të përgjithshme ekonomike që lidhen përgjithësisht me zonën e euros. Në këto dispozita, referimet që bëhen për Bashkimin apo për Shtetet Anëtare, nuk e përfshijnë Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa referencat lidhur me bankat qendrore kombëtare nuk e përfshijnë Bankën e Anglisë.

5. Mbretëria e Bashkuar përpiqet të shmangë deficitin e tepërt buxhetor.

Neni 143 dhe 144 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian vazhdon të zbatohet për Mbretërinë e Bashkuar. Neni 134(4) dhe neni 142 zbatohen për Mbretërinë e Bashkuar sikur ajo të kishte një shmangie.

6. E drejta e votës së Mbretërisë së Bashkuar pezullohet në lidhje me aktet e Këshillit të përmendura në paragrafin 4 dhe në rastet e përmendura në nënparagrafin e parë të nenit 139(4) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Për këtë qëllim zbatohet nënparagrafi i dytë i nenit 139(4) të Traktatit.

Mbretëria e Bashkuar nuk ka gjithashtu të drejtë të marrë pjesë në emërimin e Presidentit, të -Zëvendëspresidentit dhe anëtarëve të tjerë të Bordi Ekzekutiv të Bankës Qendrore Europiane, sipas nënparagrafit të dytë të nenit 283(2) të Traktatit në fjalë.

7. Nenet 3, 4, 6, 7, 9.2, 10.1, 10.3, 11.2, 12.1, 14, 16, 18 deri në 20, 22, 23, 26, 27, 30 deri në 34 dhe 49 të Protokollit për Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane ("Statuti") nuk zbatohen për Mbretërinë e Bashkuar.

Në këto nene, referimet që bëhen për Bashkimin apo për Shtetet Anëtare, nuk e përfshijnë Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa referimet që bëhen për bankat qendrore kombëtare apo aksionarët nuk e përfshijnë Bankën e Anglisë.

Përmendja në nenet 10.3 dhe 30.2 të Statutit e "kapitalit të nënshkruar të Bankës Qendrore Europiane" nuk e përfshin kapitalin e nënshkruar nga Banka e Anglisë.

8. Neni 141(1) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe nenet 43 deri 47 të Statutit zbatohen, ka apo jo ndonjë Shtet Anëtar me një shmangie, sipas ndryshimeve të mëposhtme:

(a) Referencat në nenin 43 të Statutit për detyrat e BQE-së dhe IME-së përfshijnë ato detyra që ende duhet të kryhen në fazën e tretë për shkak të vendimit të Mbretërisë së Bashkuar për të mos përdorur euron.

(b) Përveç detyrave të përmendura në nenin 46, BQE gjithashtu këshillon dhe kontribuon për përgatitjen e çdo vendimi të Këshillit në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, të marrë në përputhje me paragrafin 9(a) dhe 9(c).

(c) Banka e Anglisë e shlyen kapitalin e saj të nënshkruar të BQE-së si kontribut për kostot operative njësoj si bankat qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare me një shmangie.

9. Mbretëria e Bashkuar mund ta njoftojë Këshillin në çdo kohë për synimin e saj për të përdorur euron. Në këtë rast:

(a) Mbretëria e Bashkuar ka të drejtë ta përdorë euron vetëm nëse plotëson kushtet e nevojshme. Këshilli, me kërkesë të Mbretërisë së Bashkuar dhe sipas kushteve dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 140 pika 1 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, vendos nëse ajo i plotëson apo jo këto kushte.

(b) Banka e Anglisë e shlyen kapitalin e nënshkruar, transferon në BQE aktivet e rezervës valutore dhe kontribuon në rezervat e saj njësoj si bankat qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare, shmangia e të cilave është shfuqizuar.

(c) Këshilli, sipas kushteve dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 140(3) të Traktatit në fjalë, merr çdo vendim tjetër të nevojshëm që të bëjë të mundur përdorimin e euros nga Mbretëria e Bashkuar.

Nëse Mbretëria e Bashkuar e përdor euron sipas dispozitave të këtij Protokolli, paragrafët nga 3 deri në 8 pushojnë së vepruari.

10. Pavarësisht nenit 123 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe nenit 21.1 të Statutit, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar mund ta mbajë "lehtësi kreditimi" me Bankën e Anglisë, nëse dhe për sa kohë që Mbretëria e Bashkuar nuk hyn në sistemin e euros.

———

PROTOKOLLI (nr. 16)

PËR DISA DISPOZITA NË LIDHJE ME DANIMARKËN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH që Kushtetuta e Danimarkës përmban dispozita që mund të kërkojnë referendum në Danimarkë përpara se Danimarka të heqë dorë nga përjashtimi,

MEQENËSE, më 3 nëntor 1993, Qeveria Daneze e njoftoi Këshillin për synimin e saj që të mos marrë pjesë në fazën e tretë të bashkimit ekonomik dhe monetar,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

1. Nisur nga njoftimi që Qeveria Daneze i ka dhënë Këshillit, më 3 nëntor 1993, Danimarka ka një përjashtim. Efekti i përjashtimit është që, të zbatohen për Danimarkën të gjitha nenet dhe dispozitat e Traktateve dhe Statutit të SEBQ-së në lidhje me një shmangie.

2. Ndërsa për shfuqizimin e përjashtimit, procedura e përmendur në nenin 140 fillon vetëm me kërkesë të Danimarkës.

3. Në rast të shfuqizimit të gjendjes së përjashtimit, dispozitat e këtij Protokolli pushojnë së vepruari.

PROTOKOLLI (nr. 17)

PËR DANIMARKËN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të zgjidhur probleme të veçanta në lidhje me Danimarkën,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Dispozitat e nenit 14 të Protokollit për Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane nuk prekin të drejtën e Bankës Kombëtare të Danimarkës për të kryer detyrat e saj ekzistuese në lidhje me ato pjesë të Mbretërisë së Danimarkës që nuk janë pjesë e Bashkimit.

PROTOKOLLI (nr. 18)

PËR FRANCËN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të pasur parasysh një çështje të veçantë në lidhje me Francën,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Franca mban privilegjin e emetimit monetar në Kaledoninë e Re, Polinezinë Franceze dhe Uallis dhe Futuna sipas kushteve të caktuara në legjislacionin e saj kombëtar dhe ka të drejtë vetëm të përcaktojë barazinë e frangës CFP.

PROTOKOLLI (nr. 19)

PËR TËRËSINË E *LEGJISLACIONIT* TË SHENGENIT TË INTEGRUAR NË KUADRIN E BASHKIMIT EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE VËREJTUR që Marrëveshjet mbi heqjen graduale të kontrolleve në kufijtë e përbashkët, të nënshkruara nga disa Shtete Anëtare të Bashkimit Europian në Shengen, më 14 qershor 1985 dhe 19 qershor 1990, si edhe marrëveshje dhe rregulla të tjera në lidhje me to, të miratuara në bazë të këtyre marrëveshjeve, janë përfshirë në kuadrin e Bashkimit Europian me Traktatin e Amsterdamit të 2 tetorit 1997;

ME DËSHIRËN për të ruajtur tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit siç është zhvilluar pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdamit dhe për ta zhvilluar këtë tërësi të legjislacionit me qëllim që të kontribuohet drejt arritjes së objektivit për t'u ofruar shtetasve të Bashkimit një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie pa kufij të brendshëm,

DUKE PASUR PARASYSH qëndrimin e veçantë të Danimarkës;

DUKE PASUR PARASYSH faktin që Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut nuk marrin pjesë në të gjitha dispozitat e tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit; dhe që sidoqoftë dispozitat duhet të jenë të tilla që t'ju lejojnë Shteteve Anëtare të pranojnë, plotësisht ose pjesërisht, dispozita të tjera të kësaj tërësie të *legjislacionit*,

DUKE PRANUAR që, për rrjedhojë, është i nevojshëm përdorimi i dispozitave të Traktateve në lidhje me bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet disa Shteteve Anëtare,

DUKE PASUR PARASYSH nevojën për të mbajtur një marrëdhënie të veçantë me Republikën e Islandës dhe Mbretërinë e Norvegjisë, si dy shtete për të cilat janë të detyrueshme dispozitat e Bashkimit Nordik të Pasaportave, së bashku me Shtetet Nordike që janë anëtare të Bashkimit Europian,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Mbretëria e Belgjikës, Republika e Bullgarisë, Republika Çeke, Mbretëria e Danimarkës, Republika Federale e Gjermanisë, Republika e Estonisë, Republika Helene, Mbretëria e Spanjës, Republika Franceze, Republika e Italisë, Republika e Qipros, Republika e Letonisë, Republika e Lituanisë, Dukati i Madh i Luksemburgut, Republika e Hungarisë, Malta, Mbretëria e Vendeve të Ulëta, Republika e Austrisë, Republika e Polonisë, Republika Portugeze, Rumania, Republika e Sllovenisë, Republika Sllovake, Republika e Finlandës dhe Mbretëria e Suedisë autorizohen të arrijnë bashkëpunim më të ngushtë mes tyre në fushat që mbulojnë dispozitat e përcaktuara nga Këshilli të cilat formojnë tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit. Ky bashkëpunim zhvillohet brenda kuadrit institucional dhe ligjor të Bashkimit Europian dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktateve.

Neni 2

Tërësia e *legjislacionit* të Shengenit zbatohet për Shtetet Anëtare të përmendura në nenin 1, pa cenuar nenin 3 të Aktit të Anëtarësimit të 16 prillit 2003 ose nenin 4 të Aktit të Anëtarësimit të 25 prillit 2005. Këshilli kryen detyrat e Komitetit Ekzekutiv të krijuar me marrëveshjet e Shengenit.

Neni 3

Pjesëmarrja e Danimarkës në miratimin e masave që përbëjnë një zhvillim të tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit, si edhe zbatimi i këtyre masave dhe zbatimin e tyre për Danimarkën, rregullohen me dispozitat përkatëse të Protokollit për qëndrimin e Danimarkës.

Neni 4

Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në çdo kohë mund të kërkojnë të marrin pjesë në disa ose në të gjitha dispozitat e tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit.

Këshilli vendos për kërkesën me unanimitetin e anëtarëve të përmendur në nenin 1 dhe të përfaqësuesve të Qeverisë së Shtetit në fjalë.

Neni 5

1. Propozimet dhe nismat bazuar në tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit, u nënshtrohen dispozitave përkatëse të Traktateve.

Në këtë kuadër, për sa as Irlanda as Mbretëria e Bashkuar nuk e kanë vënë në dijeni me shkrim Këshillin brenda një afati të arsyeshëm për dëshirën e tyre për të marrë pjesë, autorizimi i përmendur në nenin 329 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian konsiderohet i mirëqenë për Shtetet Anëtare të përmendura në Nenin 1 dhe për Irlandën ose Mbretërinë e Bashkuar nëse secila prej tyre, dëshiron të marrë pjesë në fushat e bashkëpunimit në fjalë.

2. Edhe nëse konsiderohet se ose Irlanda ose Mbretëria e Bashkuar kanë njoftuar përmes një vendimi sipas nenit 4, pavarësisht kësaj, secila mund ta njoftojë me shkrim Këshillin, brenda tre muajve, që nuk dëshiron të marrë pjesë në atë propozim apo nismë. Në këtë rast, Irlanda ose Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë në miratimin e saj. Pas njoftimit të fundit, procedura për miratimin e masës të bazuar në tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit, pezullohet deri në përfundim të procedurës së parashikuar në paragrafët 3 ose 4 ose deri në tërheqjen e njoftimit në çdo moment gjatë asaj procedure.

3. Për Shtetin Anëtar që ka bërë njoftimin e përmendur në paragrafin 2, çdo vendim i marrë nga Këshilli sipas nenit 4, që nga data e hyrjes në fuqi të masës së propozuar, pushon së vepruari në masën që Këshilli e gjykon të nevojshme dhe sipas kushteve që duhen përcaktuar në një vendim të Këshillit, i cili vendos me shumicë të cilësuar për një propozim nga Komisioni. Ky vendim merret në përputhje me kriteret e mëposhtme: Këshilli synon të mbajë masën më të gjerë të mundshme të pjesëmarrjes së Shtetit Anëtar në fjalë pa prekur rëndë funksionimin praktik të pjesëve të ndryshme të tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit, duke respektuar koherencën e tyre. Komisioni e paraqet

propozimin e tij sa më shpejt të jetë e mundur pas njoftimit të përmendur në paragrafin 2. Këshilli, nëse nevojitet pasi janë thirrur dy mbledhje të njëpasnjëshme, vendos brenda katër muajve nga paraqitja e propozimit nga Komisioni.

4. Nëse, në fund të periudhës katërmujore, Këshilli nuk ka marrë një vendim, një Shtet Anëtar, pa vonesë mund të kërkoje që çështja t'i paraqitet Këshillit Europian. Në këtë rast, Këshilli Europian, në takimin e tij të radhës, me shumicë të cilësuar e me propozim të Komisionit, merr vendimin në përputhje me kriteret e përmendura në paragrafin 3.

5. Nëse Këshilli ose, sipas rastit, Këshilli Europian, në përfundim të procedurës së parashikuar në paragrafët 3 ose 4, nuk e ka marrë vendimin, ko sjell përfundimin e pezullimit të procedurës për miratimin e masës të marrë në bazë të tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit. Nëse masa në fjalë miratohet më pas, çdo vendim i marrë nga Këshilli sipas nenit 4 që nga data e hyrjes në fuqi të asaj mase, pushon së vepruari për Shtetin Anëtar përkatës në masën dhe sipas kushteve që vendos Komisioni, përveçse kur Shteti Anëtar përkatës e ka tërhequr njoftimin e tij të përmendur në paragrafin 2, përpara miratimit të masës. Komisioni vepron nga data e këtij miratimi. Komisioni, kur merr vendim, respekton kriteret e përmendura në paragrafin 3.

Neni 6

Republika e Islandës dhe Mbretëria e Norvegjisë lidhen me zbatimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit dhe zhvillimin e tij të mëtejshëm. Procedurat e duhura miratohen për këtë qëllim, në një Marrëveshje që përfundohet me këto Shtete nga Këshilli, i cili vendos me unanimitetin e Anëtarëve të tij të përmendur në nenin 1. Kjo Marrëveshje përfshin dispozita për kontributin e Islandës dhe Norvegjisë në çdo pasojë financiare që rezulton nga zbatimi i këtij Protokolli.

Këshilli, me unanimitet, lidh një Marrëveshje të veçantë me Islandën dhe Norvegjinë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut nga njëra anë, dhe Islandës dhe Norvegjisë nga ana tjetër, në fushat e tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit që zbatohen për këto Shtete.

Neni 7

Për qëllime të negociimit për anëtarësimin e Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin Europian, tërësia e *legjislacionit* të Shengenit dhe masat e mëtejshme të marra nga institucionet në fushën e saj të veprimit, konsiderohen si tërësi e *legjislacionit* që duhet të pranohen plotësisht nga të gjitha Shtetet kandidate për anëtarësim.

———

PROTOKOLLI (nr. 20)

PËR ZBATIMIN E DISA ASPEKTEVE TË NENIT 26 TË TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN NË MBRETËRINË E BASHKUAR DHE NË IRLANDË

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të zgjidhur disa çështje në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën,

DUKE PASUR PARASYSH marrëveshjet e veçanta të udhëtimit që ekzistojnë prej shumë vjetësh ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Mbretëria e Bashkuar, pavarësisht neneve 26 dhe 77 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të këtij Traktati apo të Traktatit për Bashkimin Europian, pavarësisht ndonjë mase të marrë sipas këtyre Traktateve apo ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur nga Bashkimi ose nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij me një ose më shumë Shtete të treta, gëzon të drejtën të ushtrojëkontroll në kufijtë e vet me Shtetet e tjera Anëtare mbi personat që kërkojnë të hyjnë në Mbretërinë e Bashkuar, nëse këtë e konsideron të nevojshme:

(a) për të verifikuar të drejtën për të hyrë në Mbretërinë e Bashkuar të shtetasve të Shteteve Anëtare dhe personave në varësi të tyre të cilët ushtrojnë të drejta që u jep e drejta e Bashkimit, si edhe të shtetasve të Shteteve të tjera të cilëve u janë dhënë këto të drejta nëpërmjet një marrëveshjeje të detyrueshme për Mbretërinë e Bashkuar; dhe

(b) për të vendosur lejimin apo moslejimin e personave të tjerë për të hyrë në Mbretërinë e Bashkuar.

Asnjë dispozitë e nenit 26 dhe 27 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian apo ndonjë dispozitë tjetër e këtij Traktati apo e Traktatit për Bashkimin Europian apo ndonjë masë e marrë në bazë të tyre, nuk cenon të drejtën e Mbretërisë së Bashkuar për të miratuar ose ushtruar këtë kontroll. Kur përmendet Mbretëria e Bashkuar në këtë nen, këtu do të përfshihen territoret për marrëdhëniet e jashtme, të të cilëve është përgjegjëse Mbretëria e Bashkuar.

Neni 2

Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda mund të vazhdojnë të bëjnë marrëveshje ndërmjet tyre në lidhje me lëvizjen e personave ndërmjet territoreve të tyre ("Zona e Përbashkët e Udhëtimit"), duke respektuar plotësisht të drejtat e personave të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pika(a) e këtij Protokolli. Po kështu, për sa kohë që ato i kanë këto marrëveshje, dispozitat e nenit 1 të këtij Protokolli zbatohen për Irlandën me të njëjtat kushte dhe afate si për Mbretërinë e Bashkuar. Këto

lloj marrëveshjesh nuk preken nga asnjë parashikim i nenit 26 dhe 27 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, asnjë dispozitë tjetër e atij Traktati apo e Traktatit për Bashkimin Europian apo ndonjë masë e marrë në bazë të tyre.

Neni 3

Shtetet e tjera Anëtare kanë të drejtë të kryejnë në kufijtë e tyre ose në pikat e hyrjes në territoret e tyre kontrolle të tilla mbi personat që kërkojnë të hyjnë në territorin e tyre nga Mbretëria e Bashkuar ose nga territore të tjera marrëdhëniet e jashtme të të cilave janë përgjegjësi e kësaj të fundit për të njëjtat qëllime të shprehura në nenin 1 të këtij Protokolli, ose që kërkojnë të hyjnë nga Irlanda në masën që dispozitat e nenit 1 të këtij Protokolli zbatohen për Irlandën.

Asnjë rregullim i nenit 26 dhe 77 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian apo asnjë dispozitë tjetër e këtij Traktati apo e Traktatit për Bashkimin Europian, apo ndonjë masë e marrë në bazë të tyre, nuk cenon të drejtën Shteteve të tjera Anëtare për të miratuar ose ushtruar këtë kontroll.

———

PROTOKOLLI (nr. 21)

PËR QËNDRIMIN E MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE IRLANDËS NË LIDHJE ME ZONËN E LIRISË, SIGURISË DHE DREJTËSISË

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të zgjidhur disa çështje në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën,

DUKE PASUR PARASYSH Protokollin mbi zbatimin e disa aspekteve të nenit 26 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Irlandë,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Sipas nenit 3, Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk marrin pjesë në miratimin nga Këshilli të masave të propozuara sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Unanimiteti i anëtarëve të Këshillit, me përjashtim të përfaqësuesve të qeverive të Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës është i nevojshëm për vendimet e Këshillit që duhet të miratohen me unanimitet.

Për qëllimet e këtij neni, shumica e cilësuar përcaktohet sipas nenit 238(3) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 2

Në vijim të nenit 1 dhe sipas neneve 3, 4 dhe 6 asnjë nga dispozitat e Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, asnjë masë e marrë sipas atij Titull, asnjë dispozitë e marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura nga Bashkimi sipas atij Titulli dhe asnjë vendim i Gjykatës së Drejtësisë, që interpreton një dispozitë apo masë të tillë, nuk është i detyrueshëm për Mbretërinë e Bashkuar ose Irlandën ose i zbatueshëm në to; madje asnjë dispozitë, masë apo vendim nuk prek në asnjë mënyrë kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e këtyre Shteteve; dhe asnjë dispozitë, masë apo vendim nuk prek tërësinë e *legjislacionit* të Komunitetit ose të Bashkimit dhe nuk bën pjesë në të drejtën e Bashkimit ashtu si zbatohen në Mbretërinë e Bashkuar ose në Irlandë.

Neni 3

1. Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda mund të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Këshillit, brenda tre muajve pas paraqitjes së propozimit ose nismës, te Këshilli sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, që dëshirojnë të marrin pjesë në miratimin dhe zbatimin e një mase të tillë të propozuar, për të cilën ai Shtet ka të drejtë të veprojë kështu.

Unanimiteti i anëtarëve të Këshillit, me përjashtim të një anëtarit që nuk e ka bërë një njoftim të tillë, është i nevojshëm për vendimet e Këshillit të cilat duhet të merren me unanimitet. Një masë e miratuar sipas këtij paragrafi është e detyrueshme për të gjitha Shtetet Anëtare që morën pjesë në miratimin e saj.

Masat e marra, sipas nenit 70 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, përcaktojnë kushtet për pjesëmarrjen e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës në vlerësimet në lidhje me fushat që mbulon Titulli V i Pjesës së Tretë të këtij Traktati.

Për qëllimet e këtij neni, shumica e cilësuar përcaktohet sipas nenit 238(3) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

2. Nëse pas një afati kohor të arsyeshëm një masë e përmendur në paragrafin 1 nuk mund të miratohet me pjesëmarrjen e Mbretërisë së Bashkuar ose Irlandës, Këshilli mund ta miratojë këtë masë në përputhje me nenin 1 pa pjesëmarrjen e Mbretërisë së Bashkuar ose Irlandës. Në këtë rast zbatohet neni 2.

Neni 4

Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda, në çdo kohë pas miratimit të një mase nga Këshilli sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian vë në dijeni Këshillin dhe Komisionin për dëshirën që të pranojnë këtë masë. Në këtë rast, procedura e parashikuar në nenin 331(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 4a

1. Dispozitat e këtij Protokolli zbatohen për Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën si edhe për masat e propozuara ose të marra sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian që ndryshon një masë ekzistuese të detyrueshme për ato.

2. Megjithatë, në rastet kur Këshilli, me propozim të Komisionit, vendos që mospjesëmarrja e Mbretërisë së Bashkuar ose Irlandës në variantin e ndryshuar të një mase ekzistuese e bën atë masë të pazbatueshme për Shtetet e tjera Anëtare ose për Bashkimin, mund t'i nxisë ato të njoftojnë sipas nenit 3 ose 4. Për qëllime të nenit 3, një periudhë e mëtejshme dymujore fillon që nga data e marrjes së këtij vendimi nga Këshilli.

Nëse Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda, në mbarim të periudhës dymujore nga marrja e vendimit nga Këshilli, nuk kanë njoftuar sipas nenit 3 ose nenit 4, masa ekzistuese nuk është më e detyrueshme apo e zbatueshme për to, përveçse kur Shteti Anëtar në fjalë ka njoftuar sipas nenit 4 përpara hyrjes në fuqi të masës ndryshuese. Kjo që nga data e hyrjes në fuqi të masës ndryshuese ose mbarimit të periudhës dymujore, cilado qoftë më e vonë.

Për qëllim të këtij paragrafi, Këshilli, pas një diskutimi të plotë të çështjes, vendos me shumicë të cilësuar të anëtarëve të tij që përfaqësojnë Shtetet Anëtare që marrin ose kanë marrë pjesë në miratimin e masës ndryshuese. Shumica e cilësuar e Këshillit përcaktohet sipas nenit 238(3)(a) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

3. Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, mund të vendosë me propozim të Komisionit që Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda të marrin përsipër pasojat e drejtpërdrejta financiare, nëse ka,

të shkaktuara domosdoshmërisht dhe pashmangshmërisht si rezultat i ndërprerjes së pjesëmarrjes së tyre në masën ekzistuese.

4. Ky nen nuk cenon nenin 4.

Neni 5

Një Shtet Anëtar, për të cilin nuk është e detyrueshme një masë e marrë sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nuk mbart pasoja financiare të asaj mase që nuk janë kosto administrative që lindin për institucionet, nëse nuk vendosin ndryshe të gjithë anëtarët e Këshillit, me unanimitet, pas konsultimit me Parlamentin Europian.

Neni 6

Nëse, në rastet e përmendura në këtë Protokoll, një masë e marrë nga Këshilli sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian është e detyrueshme për Mbretërinë e Bashkuar ose Irlandën, dispozitat përkatëse të Traktateve zbatohen për atë Shtet në lidhje me masën në fjalë.

Neni 6a

Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk detyrohen nga rregullat e përcaktuara në bazë të nenit 16 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare gjatë kryerjes së aktiviteteve që përfshihen në fushën e veprimit të Kreut 4 ose Kreut 5 të Titullit V të Pjesës së Tretë të këtij Traktati ku Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk detyrohen nga rregullat që rregullojnë format e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale ose të bashkëpunimit policor që kërkojnë respektimin e dispozitave të përcaktuara në bazë të nenit 16.

Neni 7

Nenet 3, 4 dhe 4*a*, pa cenuar Protokollin për tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit, përfshihen në kuadrin e Bashkimit Europian.

Neni 8

Irlanda mund të njoftojë me shkrim Këshillin që nuk dëshiron më tej të përfshihet në kushtet e këtij Protokolli. Në këtë rast, për Irlandën zbatohen dispozitat e zakonshme të traktatit.

Neni 9

Në lidhje me Irlandën, ky Protokoll nuk zbatohet për nenin 75 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

———

PROTOKOLLI (nr. 22)

PËR QËNDRIMIN E DANIMARKËS

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE KUJTUAR Vendimin e Krerëve të Shteteve ose Qeverive të mbledhur në Këshillin Europian në Edinburg, më 12 dhjetor 1992, në lidhje me disa probleme të ngritura nga Danimarka mbi Traktatin për Bashkimin Europian,

DUKE VËREJTUR qëndrimin e Danimarkës në lidhje me Nënshtetësinë, Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, Politikën e Mbrojtjes dhe Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshëm, siç parashikohen në Vendimin e Edinburgut,

TË NDËRGJEGJSHËM për faktin që një vazhdim sipas Traktateve i regjimit juridik që rrjedh në vendimin e Edinburgut do të kufizojë ndjeshëm pjesëmarrjen e Danimarkës në fushat e rëndësishme të bashkëpunimit të Bashkimit dhe që është interesi më i mirë i Bashkimit sigurimi i integritetit të *legjislacionit* të BE-sënë zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë,

ME DËSHIRËN për të krijuar një kuadër ligjor që do të sigurojë një mundësi që Danimarka të marrë pjesë në miratimin e masave të propozuara në bazë të Titullit V të Pjesës së Tretë Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe duke mirëpritur synimin e Danimarkës për të përfituar nga kjo mundësi kur është e mundur në përputhje me kërkesat e saj kushtetuese,

DUKE VËREJTUR që Danimarka nuk do t'i pengojë Shtetet e tjera Anëtare të zhvillojnë më tej bashkëpunimin e tyre në lidhje me masat që nuk janë të detyrueshme për Danimarkën,

DUKE KUJTUAR nenin 3 të Protokollit për tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit të përfshirë në kuadrin e Bashkimit Europian,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme të cilat i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

PJESA I

Neni 1

Danimarka nuk merr pjesë në miratimin nga Këshilli të masave të propozuara sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Unanimiteti i anëtarëve të Këshillit, me përjashtim të përfaqësuesit të qeverisë së Danimarkës, është i nevojshëm për vendimet e Këshillit që duhet të merren me unanimitet.

Për qëllimet e këtij neni, shumica e cilësuar përcaktohet sipas nenit 238(3) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 2

Asnjë nga dispozitat e Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, asnjë masë e marrë sipas këtij Titull, asnjë dispozitë e ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur nga Bashkimi sipas këtij Titulli dhe asnjë vendim i Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian që interpreton një dispozitë apo masë të tillë apo ndonjë masë të ndryshuar apo të ndryshueshme sipas këtij Titulli nuk është i detyrueshëm për Danimarkën ose i zbatueshëm në Danimarke; madje asnjë dispozitë, masë apo vendim nuk prekin në asnjë mënyrë kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Danimarkës; dhe asnjë dispozitë, masë apo vendim nuk prek në asnjë mënyrë tërësinë e *legjislacionit*të Komunitetit ose të Bashkimit dhe as nuk bën pjesë në të drejtën e Bashkimit ashtu si zbatohen në Danimarkë. Në veçanti, aktet e Bashkimit në fushën e bashkëpunimit policor dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, që ndryshohen, vazhdojnë të jenë të detyrueshme dhe të zbatueshme për Danimarkën në formën e tyre të pandryshuar.

Neni 2a

Neni 2 i këtij Protokolli zbatohet gjithashtu për rregullat e përcaktuara në bazë të nenit 16 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare gjatë kryerjes së aktiviteteve që përfshihen në fushën e veprimit të Kreut 4 ose Kreut 5 të Titullit V të Pjesës së Tretë të këtij Traktati.

Neni 3

Danimarka nuk mbart pasoja financiare të masave të përmendura në Nenin 1, përveç kostove administrative që lindin për institucionet.

Neni 4

1. Danimarka vendos, brenda një periudhë gjashtëmujore pas vendimit të Këshillit për propozimin ose nismën bazuar në tërësinë e*legjislacionit* të Shengenit të trajtuar në këtë pjesë, nëse do ta zbatojë këtë masë në të drejtën e saj kombëtare. Nëse vendos kështu, kjo masë krijon një detyrim sipas të drejtës ndërkombëtare ndërmjet Danimarkës dhe Shteteve të tjera Anëtare për të cilat është e detyrueshme masa.

2. Nëse Danimarka vendos të mos e zbatojë një masë të Këshillit siç përmendet në paragrafin 1, Shtetet Anëtare për të cilat kjo masë është e detyrueshme dhe Danimarka shqyrtojnë marrjen e masave të duhura.

PJESA II

Neni 5

Në lidhje me masat e miratuara nga Këshilli sipas nenit 26(1), nenit 42 dhe neneve 43 deri në 46 të Traktatit për Bashkimin Europian, Danimarka nuk merr pjesë në shtjellimin dhe zbatimin e

vendimeve dhe veprimeve të Bashkimit që kanë rrjedhoja për mbrojtjen. Për këtë arsye, Danimarka nuk merr pjesë në miratimin e tyre. Danimarka nuk i pengon Shtetet e tjera Anëtare ta zhvillojnë bashkëpunimin e tyre të mëtejshëm në këtë fushë. Danimarka nuk detyrohet as të kontribuojë në financimin e shpenzimeve operative që dalin nga këto masa, as të vërë në dispozicion të Bashkimit aftësitë ushtarake.

Unanimiteti i anëtarëve të Këshillit, me përjashtim të përfaqësuesit të qeverisë së Danimarkës, është i nevojshëm për aktet e Këshillit që duhet të merren me unanimitet.

Për qëllimet e këtij neni, shumica e cilësuar përcaktohet sipas nenit 238(3) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

PJESA III

Neni 6

Nenet 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen për masat që përcaktojnë vendet e treta shtetasit e të cilëve duhet të pajisen me vizë për të kaluar kufijtë e jashtëm të Shteteve Anëtare ose për masa në lidhje me një format standard të vizave.

PJESA IV

Neni 7

Danimarka në çdo kohë në përputhje me kërkesat e saj kushtetuese, mund të njoftojë Shtetet e tjera Anëtare që nuk dëshiron të përfitojë nga ky Protokoll plotësisht ose pjesërisht. Në këtë rast, Danimarka zbaton plotësisht të gjitha masat e duhura që janë në fuqi në atë kohë, të marra në kuadër të Bashkimit Europian.

Neni 8

1. Danimarka në çdo kohë dhe pa cenuar nenin 7, në përputhje me kërkesat e veta kushtetuese, mund t'i njoftojë Shtetet e tjera Anëtarë që, nisur nga dita e parë e muajit pasardhës pas njoftimit, Pjesa I do të përbëhet nga dispozitat në Shtojcë. Në këtë rast, për rrjedhojë ndryshon numri për nenet nga 5 deri në 8.

2. Gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të njoftimit të përmendur në paragrafin 1, tërësia e *legjislacionit* të Shengenit dhe masat e miratuara bazuar në këtë tërësi të *legjislacionit* , të cilat deri atëherë kanë qenë të detyrueshme për Danimarkën si detyrime në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, janë të detyrueshme për Danimarkës si e drejtë e Bashkimit.

———

SHTOJCË

Neni 1

Sipas nenit 3, Danimarka nuk merr pjesë në miratimin nga Këshilli të masave të propozuar sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Unanimiteti i anëtarëve të Këshillit, me përjashtim të përfaqësuesit të qeverisë së Danimarkës, është i nevojshëm për aktet e Këshillit që duhet të merren me unanimitet.

Për qëllimet e këtij neni, shumica e cilësuar përcaktohet sipas nenit 238(3) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 2

Sipas nenit 1 dhe neneve 3, 4 dhe 8, asnjë nga dispozitat e Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, asnjë masë e marrë sipas atij Titull, asnjë dispozitë e ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur nga Bashkimi sipas atij Titulli, asnjë vendim i Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian që interpreton një dispozitë apo masë të tillë nuk është i detyrueshëm për Danimarkën ose i zbatueshëm në Danimarkë; madje asnjë dispozitë, masë apo vendim nuk prekin në asnjë mënyrë kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Danimarkës; dhe asnjë dispozitë, masë apo vendim i tillë nuk prek tërësinë e *legjislacionit* të Komunitetit ose të Bashkimit dhe as nuk bën pjesë në të drejtën e Bashkimit ashtu si zbatohen në Danimarkë.

Neni 3

1. Danimarka mund të njoftojë me shkrim Kryetarin e Këshillit, brenda tre muajve pas paraqitjes së një propozimi ose një nisme të paraqitur tek Këshilli sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, që dëshiron të marrë pjesë në miratimin dhe zbatimin e një mase të tillë të propozuar, për të cilën Danimarka ka të drejtë të veprojë kështu.

2. Nëse pas një periudhe kohore të arsyeshme një masë e përmendur në paragrafin 1 nuk mund të miratohet me pjesëmarrjen e Danimarkës, Këshilli mund ta miratojë masën e përmendur në paragrafin 1 në përputhje me nenin 1 pa pjesëmarrjen e Danimarkës. Në këtë rast zbatohet neni 2.

Neni 4

Danimarka, në çdo kohë pas miratimit të një masë sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian e vë në dijeni Këshillin dhe Komisionin se dëshiron ta pranojë këtë masë. Në këtë rast, procedura e parashikuar në nenin 331(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 5

1. Dispozitat e këtij Protokolli zbatohen për Danimarkën si edhe për masat e propozuara ose të marra sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian që ndryshon një masë ekzistuese të detyrueshme për atë.

2. Megjithatë, në rastet kur Këshilli, me propozim të Komisionit, vendos që mospjesëmarrja e Danimarkës në variantin e ndryshuar të një mase ekzistuese e bën atë masë të pazbatueshme për Shtetet e tjera Anëtare ose për Bashkimin, mund ta nxisë atë të njoftojë sipas nenit 3 ose 4. Për qëllime të nenit 3, një periudhë e mëtejshme dymujore fillon që nga data e marrjes së këtij vendimi nga Këshilli.

Nëse Danimarka, në mbarim të periudhës dy mujore nga marrja e vendimit nga Këshilli, nuk ka njoftuar sipas nenit 3 ose nenit 4, masa ekzistuese nuk është më e detyrueshme apo e zbatueshme për të, përveçse kur ajo ka njoftuar sipas nenit 4 përpara hyrjes në fuqi të masës ndryshuese. Kjo hyn në fuqi që nga data e hyrjes në fuqi të masës ndryshuese ose mbarimit të periudhës dymujore, cilado qoftë më e vonë.

Për qëllim të këtij paragrafi, Këshilli, pas një diskutimi të plotë të çështjes, vendos me shumicë të cilësuar të anëtarëve të tij që përfaqësojnë Shtetet Anëtare që marrin ose kanë marrë pjesë në miratimin e masës ndryshuese. Shumica e cilësuar përcaktohet sipas nenit 238(3)(a) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

3. Këshilli që vendos me shumicë të cilësuar për një propozim të Komisionit, mund të vendosë që Danimarka të marrë ë përsipër pasojat e drejtpërdrejta financiare, nëse ka, të shkaktuara domosdoshmërisht dhe pashmangshmërisht si rezultat i pushimit të pjesëmarrjes së saj në masën ekzistuese.

4. Ky nen nuk cenon nenin 4.

Neni 6

1. Njoftimi sipas nenit 4 paraqitet jo më vonë se 6 muaj pas miratimit përfundimtar të kësaj masë nëse kjo e fundit është marrë duke u bazuar në tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit.

Nëse Danimarka nuk paraqet një njoftim në përputhje me nenet 3 ose 4 në lidhje me një masë të marrë bazuar në tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit, Shtetet Anëtare për të cilat është e detyrueshme kjo masë si dhe Danimarka e konsiderojnë marrjen e masave të duhura.

2. Njoftimi sipas nenit 3 në lidhje me një masë të marrë bazuar në tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit konsiderohet në mënyrë të pakthyeshme njoftim i paraqitur sipas nenit 3 në lidhje me një propozim apo nismë të mëtejshme për ta zhvilluar atë masë aq sa propozimi apo nisma është bërë për të zhvilluar tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit.

Neni 7

Danimarka nuk detyrohet nga rregullat e përcaktuara në bazë të nenit 16 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare gjatë

kryerjes së aktiviteteve që përfshihen në fushën e veprimit të Kreut 4 ose Kreut 5 të Titullit V të Pjesës së Tretë të këtij Traktati ku Danimarka nuk detyrohet nga rregullat që rregullojnë format e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale ose të bashkëpunimit policor që kërkojnë respektimin e dispozitave të përcaktuara në bazë të nenit 16.

Neni 8

Nëse, në rastet e përmendura në këtë Pjesë, një masë e marrë nga Këshilli sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian është e detyrueshme për Danimarkën, dispozitat përkatëse të Traktateve zbatohen për Danimarkën në lidhje me masën në fjalë.

Neni 9

Nëse masa e marrë sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian nuk është e detyrueshme për Danimarkën, ajo nuk mbart pasoja financiare të asaj mase përveç kostove administrative që lindin për institucionet, nëse nuk vendos ndryshe Këshilli me të gjithë anëtarët e tijme unanimitet, pas konsultimit me Parlamentin Europian.

———

PROTOKOLLI (nr. 23)

PËR MARRËDHËNIET E JASHTME TË SHTETEVE ANËTARE NË LIDHJE ME KALIMIN E KUFIJVE TË JASHTËM

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH, nevojën e Shteteve Anëtare për të siguruar një kontroll të efektshëm të kufijve të tyre të jashtëm, në bashkëpunim me vendet e treta kur është e nevojshme,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Dispozitat për masat mbi kalimin e kufijve të jashtëm të përfshira në nenin 77(2) (b) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian nuk cenojnë kompetencën e Shteteve Anëtare për të negociuar ose lidhur marrëveshje me vendet e treta me kusht që të respektohet e drejta e Bashkimit dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare përkatëse.

———

PROTOKOLLI (nr. 24)

PËR AZILIN PËR SHTETASIT E VENDEVE ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH, që në përputhje me nenin 6(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore,

DUKE PASUR PARASYSH, që sipas nenit 6(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, të drejtat themelore të garantuara nga Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, janë pjesë e së drejtës së Bashkimit si parime të përgjithshme,

DUKE PASUR PARASYSH, që Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka juridiksion që të sigurojë që, në interpretimin dhe zbatimin e nenit 6, paragrafët (1) dhe (3) të Traktatit për Bashkimin Europian, të zbatohet e drejta nga Bashkimi Europian,

DUKE PASUR PARASYSH, që sipas nenit 49 të Traktatit për Bashkimin Europian, çdo Shtet Europian kur aplikon për t'u bërë anëtar i Bashkimit duhet të respektojë vlerat e parashikuara në nenin 2 të Traktatit për Bashkimin Europian,

DUKE KUJTUAR që neni 7 i Traktatit për Bashkimin Europian krijon një mekanizëm për pezullimin e disa të drejtave në rast të shkeljes së rëndë dhe të përsëritur të këtyre vlerave nga një Shtet Anëtar,

DUKE KUJTUAR që çdo shtetas i një Shteti Anëtar, si qytetar i Bashkimit gëzon status dhe mbrojtje të veçantë që garantohet nga Shtetet Anëtare në përputhje me dispozitat e Pjesës së Dytë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian,

DUKE KUJTUAR që Traktatet krijojnë një zonë pa kufij të brendshëm dhe i japin çdo qytetari të Bashkimit të drejtën për të lëvizur dhe qëndruar lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare,

ME DËSHIRËN për të mos lejuar që institucioni i azilit të përdoret për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është synuar,

DUKE PASUR PARASYSH, që ky Protokoll respekton përfundimin dhe objektivat e Konventës së Gjenevës së 28 korrikut 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Nen i vetëm

, Nisur nga niveli i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian, Shtetet Anëtare konsiderohen si vende të sigurta të origjinës në lidhje me njëri-tjetrin për

të gjitha qëllimet ligjore dhe praktike në lidhje me çështjet e azilit. Në këtë mënyrë, çdo kërkesë për azil e paraqitur nga një shtetas i një Shteti Anëtar mund të shqyrtohet ose të shpallet e pranueshme për shqyrtim nga një Shtet tjetër Anëtar vetëm në rastet e mëposhtme:

(a) nëse Shteti Anëtar, shtetas i të cilit është kërkuesi, pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdamit, duke përfituar nga dispozitat e nenit 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, vazhdon të marrë masa që shmangin në territorin e tij detyrimet sipas kësaj Konvente;

(b) nëse ka filluar procedura e përmendur në nenin 7 pika 1 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe deri kur Këshilli, ose sipas rastit, Këshilli Europian, të marrë një vendim përkatës në lidhje me Shtetin Anëtar, shtetas i të cilit është kërkuesi;

(c) nëse Këshilli ka miratuar një vendim në përputhje me nenin 7 pika 1 të Traktatit për Bashkimin Europian në lidhje me Shtetin Anëtar, shtetas i të cilit është kërkuesi, ose nëse Këshilli Europian ka miratuar një vendim në përputhje me nenin 7 pika 2 të këtij Traktati në lidhje me Shtetin Anëtar, shtetas i të cilit është kërkuesi;

(d) nëse një Shtet Anëtar vendos njëanshmërisht në lidhje me kërkesën e një shtetasi të një Shteti tjetër Anëtar; në këtë rast Këshilli vihet menjëherë në dijeni; kërkesa trajtohet në bazë të prezumimit që është dukshëm e pabazuar, pa prekur në asnjë mënyrë, në çfarëdo rasti, fuqinë vendimmarrëse të Shtetit Anëtar.

———

PROTOKOLLI (nr. 25)

PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Nen i vetëm

Duke pasur parasysh nenin 2 pika 2 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian për kompetencat e përbashkëta, kur Bashkimi vepron në një fushë të caktuar, fusha e veprimit të këtij ushtrimi kompetencash mbulon vetëm ato elemente që rregullohen me aktin në fjalë të Bashkimit dhe prandaj nuk mbulon të gjithë fushën.

———

PROTOKOLLI (nr. 26)

PËR SHËRBIMET ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të theksuar rëndësinë e shërbimeve me interes të përgjithshëm,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Vlerat e përbashkëta të Bashkimit në lidhje me shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik sipas kuptimit të nenit 14 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian përfshijnë në veçanti:

– rolin thelbësor dhe vendimmarrjen e gjerë të autoriteteve vendore, rajonale dhe kombëtare për të siguruar, porositur dhe organizuar shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik sa më pranë nevojave të përdoruesve;

– larminë ndërmjet shërbimeve të ndryshme me interes të përgjithshëm ekonomik dhe dallimet në nevoja dhe preferenca të përdoruesve që mund të rezultojnë nga situata të ndryshme gjeografike, sociale ose kulturore;

– nivelin e lartë të cilësisë, sigurisë dhe mundësisë ekonomike, trajtimin e barabartë dhe promovimin e përdorimit nga të gjithë përdoruesit dhe të të drejtave të tyre.

Neni 2

Dispozitat e Traktateve nuk prekin në asnjë mënyrë kompetencat e Shteteve Anëtare për të ofruar, porositur dhe organizuar shërbime me interes të përgjithshëm jo ekonomik.

———

PROTOKOLLI (nr. 27)

PËR TREGUN E BRENDSHËM DHE KONKURRENCËN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH që tregu i brendshëm siç është parashikuar në nenin 3 të Traktatit për Bashkimin Europian përfshin një sistem që siguron mosshtrembërimin e konkurrencës,

KANË RËNË DAKORD që:

Për këtë qëllim, Bashkimi, nëse është e nevojshme, merr masa sipas dispozitave të Traktateve, përfshirë nenin 352 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Ky protokoll i shtohet Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

———

PROTOKOLLI (nr. 28)

PËR KOHEZIONIN EKONOMIK, SOCIAL DHE TERRITORIAL

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE, ,

DUKE KUJTUAR që neni 3 i Traktatit për Bashkimin Europian përfshin objektivin e nxitjes së kohezionit ekonomik, social dhe territorial dhe solidaritetit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe që ky kohezion shfaqet në fushat me kompetencë të përbashkët të Bashkimit të përmendura në nenin (4) 2 (c) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian;

DUKE KUJTUAR që dispozitat e Pjesës së Tretë të Titullit XVIII për kohezionin ekonomik, social dhe territorial të marra të bashku sigurojnë bazën ligjore për konsolidim dhe zhvillimin e mëtejshëm të veprimit të Bashkimit në fushën e kohezionit ekonomik, social dhe territorial, përfshirë krijimin e një fondi të ri,

DUKE KUJTUAR që neni 177 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian parashikon krijimin e një Fondi Kohezioni,

DUKE VËNË NË DUKJE që Banka Europiane e Investimeve jep hua shuma gjithnjë e më të mëdha për rajonet më të varfra,

DUKE VËNË NË DUKJE dëshirën për fleksibilitet më të madh në marrëveshjet për alokimet nga Fondet Strukturore,

DUKE VËNË NË DUKJE dëshirën për përshtatjen e niveleve të pjesëmarrjes së Bashkimit në programe dhe projekte në vende të caktuara,

DUKE VËNË NË DUKJE propozimin për të marrë më shumë parasysh mirëqenien përkatëse të Shteteve Anëtare në sistemin e burimeve të veta,

THEKSOJNË që nxitja e kohezionit ekonomik, social dhe territorial është jetike për zhvillimin e plotë dhe suksesin jetëgjatë të Bashkimit,

THEKSOJNË bindjen tyre se Fondet Strukturore duhet të vazhdojnë të luajnë një rol të konsiderueshëm në arritjen e objektivave të Bashkimit në fushën e kohezionit,

THEKSOJNË bindjen e tyre që Banka Europiane e Investimeve duhet të vazhdojë t'i kushtojë shumicën e burimeve të veta nxitjes së kohezionit ekonomik, social dhe territorial dhe shpallin gatishmërinë për t'i rishikuar nevojat për kapital të Bankës Europiane të Investimeve sapo kjo është e nevojshme për këtë qëllim,

BIEN DAKORD që Fondi i Kohezionit siguron kontributet financiare të Bashkimit për projekte në fushën e mjedisit dhe rrjeteve trans-europiane në Shtetet Anëtare me PKB-në për frymë më pak se 90% të mesatares së Bashkimit që kanë një program i cili çon në plotësimin e kushteve të konvergjencës ekonomike siç parashikohen në nenin 126,

DEKLAROJNË qëllimin e tyre për të lejuar një kufi më të madh fleksibiliteti në shpërndarjen e

financimit nga Fondet Strukturore për nevojat specifike që nuk mbulohen nga rregulloret ekzistuese të Fondeve Strukturore,

DEKLAROJNË gatishmërinë e tyre për të përshtatur nivelet e pjesëmarrjes së Bashkimit në kuadër të programeve dhe projekteve të Fondeve Strukturore me synim shmangien e rritjeve të tepërta të shpenzimeve buxhetore në Shtetet Anëtare me mirëqenie më të ulët,

PRANOJNË nevojën për të vëzhguar rregullisht përparimin drejt arritjes së kohezionit ekonomik, social dhe territorial dhe pohojnë gatishmërinë e tyre për të shqyrtuar të gjitha masat e nevojshme në lidhje me të,

DEKLAROJNË qëllimin e tyre për të marrë më shumë parasysh kapacitetin kontribues të Shteteve të veçanta Anëtare në sistemin e burimeve të veta, dhe për të shqyrtuar mënyrat e korrigjimit, në Shtetet Anëtare me mirëqenie më të ulët, të elementëve regresive që ekzistojnë në sistemin e burimeve të veta ekzistuese,

BIEN DAKORD për t'ia shtuar këtë Protokoll Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

———

PROTOKOLLI (nr. 29)

PËR SISTEMIN E TRANSMETIMIT PUBLIK NË SHTETET ANËTARE

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH që sistemi i transmetimit publik në Shtetet Anëtare lidhet drejtpërdrejt me nevojat demokratike, sociale dhe kulturore të secilës shoqëri dhe me nevojën për të ruajtur pluralizmin e medias,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Dispozitat e Traktateve nuk prekin kompetencën e Shteteve Anëtare për të siguruar financimin e shërbimit publik të transmetimit për aq sa ky financim u jepet organizatave të transmetimit për përmbushjen e kompetencës së shërbimit publik, siç realizohet, përcaktohet dhe organizohet nga çdo Shtet Anëtar dhe për aq sa ky financim të mos ndikojë në kushtet e tregtisë dhe konkurrencën në Bashkim aq sa do të ishte në kundërshtim me interesin e përbashkët, por duke pasur parasysh realizimin e misionit të këtij shërbimi publik.

———

PROTOKOLLI (nr. 30)

PËR ZBATIMIN E KARTËS SË TË DREJTAVE THEMELORE TË BASHKIMIT EUROPIAN NË POLONI DHE NË MBRETËRINË E BASHKUAR

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

NDËRSA në nenin 6 të Traktatit për Bashkimin Europian, Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian,

NDËRSA Karta duhet zbatuar në përputhje të rreptë me dispozitat e nenit 6 të sipërpërmendur dhe Titullit VII të vetë Kartës,

NDËRSA neni 6 i sipërpërmendur kërkon që Karta të zbatohet dhe interpretohet nga gjykatat e Polonisë dhe të Mbretërisë së Bashkuar rreptësisht në përputhje me shpjegimet e përmendura në atë nen,

NDËRSA Karta përmban si të drejta ashtu edhe parime,

NDËRSA Karta përmban si dispozita me natyrë civile dhe politike, ashtu dhe dispozita me natyrë ekonomike dhe sociale,

NDËRSA Karta ripohon të drejtat, liritë dhe parimet e njohura në Bashkim dhe i bënë këto të drejta më të dukshme, por nuk krijon të drejta ose parime të reja,

DUKE KUJTUAR detyrimet që lindin mbi Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar sipas Traktatit për Bashkimin Europian, Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe të drejtës së Bashkimit në përgjithësi,

DUKE KUJTUAR dëshirën e Polonisë dhe Mbretërisë së Bashkuar për të qartësuar disa aspekte të zbatimit të Kartës,

ME DËSHIRËN për të qartësuar zbatimin e Kartës në lidhje me legjislacionin dhe veprimin administrativ të Polonisë dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe gjykueshmërinë e Kartës brenda Polonisë dhe brenda Mbretërisë së Bashkuar,

DUKE RIPOHUAR që referencat në këtë Protokoll për veprimin e dispozitave specifike të Kartës nuk cenojnë veprimin e dispozitave të tjera të Kartës,

DUKE RIPOHUAR që ky Protokoll nuk cenon zbatimin e Kartës në Shtete të tjera Anëtare,

DUKE RIPOHUAR që ky Protokoll nuk cenon detyrimet që lindin mbi Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar sipas Traktatit për Bashkimin Europian, Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe të drejtës së Bashkimit në përgjithësi,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

1. Karta nuk e zgjeron aftësinë e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian ose të ndonjë gjykate tjetër të Polonisë ose të Mbretërisë së Bashkuar, për të konstatuar që ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative, praktikat ose veprimet e Polonisë ose të Mbretërisë së Bashkuar nuk janë në përputhje me të drejtat, liritë dhe parimet themelore që konfirmon ajo.

2. Në veçanti dhe për të shmangur dyshimin, asnjë dispozitë në Titullin IV të Kartës nuk krijon të drejta të gjykueshme të zbatueshme në Poloni ose në Mbretërinë e Bashkuar për aq sa këto të drejta janë të parashikuara në legjislacionin kombëtar të Polonisë ose të Mbretërisë së Bashkuar.

Neni 2

Kur një dispozitë e Kartës përmend legjislacionet dhe praktikat kombëtare, ajo zbatohet për Poloninë ose Mbretërinë e Bashkuar vetëm aq sa të drejtat ose parimet që përmban njihen në legjislacionin ose praktikat e Polonisë ose të Mbretërisë së Bashkuar.

———

PROTOKOLLI (nr. 31)

NË LIDHJE ME IMPORTET NË BASHKIMIN EUROPIAN TË PRODUKTEVE TË NAFTËS SË RAFINUAR NË ANTILET HOLANDEZE

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

Më DËSHIRËN për të dhënë hollësi më të plota për sistemin e tregtisë të zbatueshëm për importet në Bashkimin Europian të produkteve të naftës së rafinuar në Antilet Holandeze,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

Ky Protokoll zbatohet për produktet e naftës nën nomenklaturën e Brukselit me numrat 27.10, 27.11, 27.12, ex 27.13 (dyllë parafine, dyllë mikrokristaline prej nafte dhe mbetje parafine) dhe 27.14 të importuara për përdorim në Shtetet Anëtare.

Neni 2

Shtetet Anëtare marrin përsipër të vendosin për produktet e naftës të rafinuara në Antilet Holandeze preferencat tarifore që rezultojnë nga asociimi i kësaj të fundit me Bashkimin, sipas kushteve të parashikuara në këtë Protokoll. Këto dispozita janë të vlefshme cilado qofshin rregullat e origjinës që zbatohen nga Shtetet Anëtare.

Neni 3

1. Komisioni, me kërkesë të një Shteti Anëtar ose me nismën e vet, kur vëren që importet drejt Bashkimit të produkteve të naftës të rafinuar në Antilet Holandeze, sipas sistemit të parashikuar në nenin 2 më sipër, çojnë në vështirësi reale për tregun e njërit apo më shumë Shteteve Anëtare, merr vendim që për importet në fjalë të vendosen, të rriten ose rivendosen taksa doganore nga Shtetet Anëtare në fjalë, në masë të tillë dhe për një periudhë aq sa mund të jenë të nevojshme për këtë situatë. Shkallët e taksave doganore të vendosura në këtë mënyrë, të rritura ose të rivendosura nuk mund të tejkalojnë taksat doganore të zbatueshme për vendet e treta për të njëjtat produkte.

2. Dispozitat e paragrafit 1, në çdo rast, mund të zbatohen kur importet drejt Bashkimit të produkteve të naftës të rafinuar në Antilet Holandeze arrin 2 milion tonelata metrik në vit.

3. Këshilli duhet të vihet në dijeni për vendimet e marra nga Komisioni në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, përfshirë këtu vendimet për refuzimin e kërkesës së një Shteti Anëtar. Këshilli, me kërkesë të cilitdo Shteti Anëtar, merr përgjegjësi për çështjen dhe në çdo kohë i ndryshon ose i revokon ato.

Neni 4

1. Nëse një Shtet Anëtar gjykon që importet e produkteve të naftës së rafinuar në Antilet Holandeze, të realizuara drejtpërdrejt ose nëpërmjet një Shteti tjetër Anëtar sipas sistemit të parashikuar në nenin 2 të mësipërm, çojnë në vështirësi reale në tregun e tij dhe që nevojitet veprim i menjëhershëm për t'u përballur me to, mund të vendosë me iniciativën e vet të zbatojë për këto importe taksa doganore, të cilat nuk mund të jenë më shumë se taksat doganore të zbatueshme për vende të treta për të njëjtat produkte. Ky vendim i njoftohet Komisionit i cili vendos brenda një muaji nëse masat e marra nga Shteti duhet të qëndrojnë, të ndryshohen ose të shfuqizohen. Dispozitat e nenit 3(3) zbatohen për këtë vendim të Komisionit.

2. Nëse sasitë e produkteve të naftës së rafinuar në Antilet Holandeze, të importuara në një ose disa Shtet të Bashkinit Europian direkt ose nëpërmjet një Shteti Anëtar tjetër sipas sistemit të parashikuar në nenin 2 të mësipërm , kapërcejnë, gjatë një viti kalendarik, tonazhin e treguar në shtojcën e këtij protokolli, masat e marra në zbatim të paragrafit 1 nga ai apo ato Shtete Anëtare për vitin aktual, konsiderohen të justifikuara; Komisioni, pasi sigurohet që është arritur tonazhi i caktuar, mban shënim masat e marra. Në këtë rast, Shtetet e tjera Anëtare abstenojnë nga dërgimi formalisht të çështjes përpara Këshillit.

Neni 5

Nëse Bashkimi vendos të zbatojë kufizime sasiore për produktet e naftës, pavarësisht nga janë importuar, këto kufizime mund të zbatohen gjithashtu për importet e këtyre produkteve nga Antilet Holandeze. Në këtë rast, ofrohet trajtim preferencial për Antilet Holandeze krahasuar me vendet e treta.

Neni 6

1. Dispozitat e neneve 2 deri në 5 rishikohen nga Këshilli, me vendim unanim, pas konsultimit të Parlamentit Europian dhe Komisionit, kur miratohet një përkufizim i përbashkët i origjinës për produktet e naftës nga vende të treta dhe vende të asociuara, ose kur merren vendime brenda kuadrit të një politike të përbashkët tregtare për produktet në fjalë ose kur krijohet një politikë e përbashkët për energjinë.

2. Megjithatë, kur bëhet një rishikim i tillë, duhen mbajtur në çdo rast preferenca ekuivalente në favor të Antileve Holandeze në formën e përshtatshme dhe për sasi minimale prej 21½ milionë tonë metrik produkte nafte.

3. Angazhimi i Bashkimit në lidhje me preferencat ekuivalente të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, nëse është e nevojshme mund të zbërthehen vend pas vendi duke pasur parasysh tonazhin e treguar në shtojcën e këtij protokolli.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Protokolli, Komisioni është përgjegjës për të ndjekur modelin e importimit në Shtetet Anëtare të produkteve të naftës të rafinuar në Antilet Holandeze. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit, i cili kujdeset për qarkullimin e këtij komunikimi,të gjithë informacionin e nevojshëm për këtë qëllim në përputhje me kushtet administrative që rekomandon ai.

———

SHTOJCA E PROTOKOLLIT

Për zbatimin e nenit 4 (2) të Protokollit në lidhje me importet në Bashkimin Europian të produkteve të naftës të rafinuar në Antilet Holandeze, Palët e Larta Kontraktuese kanë vendosur që sasia prej 2 milion tonë metrik e produkteve të naftës nga Antilet, të shpërndahet mes Shteteve Anëtare si më poshtë:

Gjermani	625 000 tonë metrik
Bashkimi Ekonomik Belgjikë-Luksemburg	200 000 tonë metrik
Francë	75 000 tonë metrik
Itali	100 000 tonë metrik
Holanda	1 000 000 tonë metrik

PROTOKOLLI (nr. 32)

PËR BLERJEN E PRONAVE NË DANIMARKË

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të zgjidhur probleme të veçanta në lidhje me Danimarkën,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Pavarësisht dispozitave të Traktateve, Danimarka mund të mbajë legjislacionin ekzistues për blerjen e shtëpive të dyta.

———

PROTOKOLLI (nr. 33)

NË LIDHJE ME NENIN 157 TË TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Për qëllimet e nenit 157 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, pagesat nga skema e sigurimeve shoqërore profesionale nuk konsiderohen si të ardhura nga puna nëse dhe në masën që u takojnë periudhave të punësimit përpara datës 17 maj 1990, përveç rastit të punonjësve ose personave që përfitojnë përmes tyre të cilët përpara kësaj date kanë nisur një procedim gjyqësor ose një procedim të ngjashëm me këtë sipas të drejtës kombëtare të zbatueshme.

———

PROTOKOLLI (nr. 34)

PËR RREGULLA TË POSAÇME PËR GROENLANDËN

Nen i vetëm

1. Trajtimi i importit në Bashkim i produkteve që i nënshtrohen organizimit të përbashkët të tregut të produkteve të peshkimit, me origjinë nga Groenlanda, në përputhje me mekanizmin e organizmit të tregut të brendshëm, përmban përjashtime nga tarifat dhe detyrimet doganore që kanë pasoja të barasvlershme dhe mungesën e kufizimeve sasiore ose masave me pasoja të barasvlershme nëse për Bashkimin janë të mjaftueshme mundësitë që i jepen Bashkimit sipas një marrëveshjeje ndërmjet Bashkimit dhe autoritetit përgjegjës për Groenlandën për përdorimin e zonave të peshkimit të Groenlandës.

2. Të gjitha masat në lidhje me marrëveshjet për importimin e këtyre produkteve, si edhe të atyre që lidhen me miratimin e këtyre masave, miratohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 43 të Traktatit Themelues të Bashkimit Europian.

———

PROTOKOLLI (nr. 35)

PËR NENIN 40.3.3 TË KUSHTETUTËS SË IRLANDËS

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

KANË RËNË DAKORD PËR dispozitën e mëposhtme që i shtohet Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Traktatit Themelues për Komunitetin Europian të Energjisë Bërthamore:

Asnjë parashikim në Traktate ose në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Atomike ose në Traktate ose Akte që i ndryshojnë apo i plotësojnë këto Traktate nuk ndikon në zbatimin në Irlandë të nenit 40.3.3 të Kushtetutës së Irlandës.

———

PROTOKOLLI (nr. 36)

PËR DISPOZITAT KALIMTARE

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE PASUR PARASYSH që për të organizuar kalimin nga dispozitat institucionale të Traktateve të zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, në dispozitat që përmban ky Traktat, është e nevojshme të përcaktohen dispozita kalimtare,

KANË RËNË DAKORD PËR dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Traktatit Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Atomike:

Neni 1

Në këtë Protokoll, fjala "Traktate" nënkupton Traktatin për Bashkimin Europian, Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Traktatin Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Bërthamore.

TITULLI I

DISPOZITA NË LIDHJE ME PARLAMENTIN EUROPIAN

Neni 2

Këshilli Europian, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 14(2) të Traktatit për Bashkimin Europian, miraton një vendim që përcakton përbërjen e Parlamentit Europian në kohën e mjaftueshme, përpara zgjedhjeve të Parlamentit Europian në 2009.

Deri në fund të mandatit parlamentar 2004-2009, përbërja dhe numri i përfaqësuesve të zgjedhur në Parlamentin Europian mbetet i njëjtë që nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

TITULLI II

DISPOZITA NË LIDHJE ME SHUMICËN E CILËSUAR

Neni 3

1. Në përputhje me nenin 16( ) të Traktatit për Bashkimin Europian, dispozitat e atij paragrafi dhe të nenit 238(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në lidhje me

përkufizimin e shumicës së cilësuar në Këshillin Europian dhe në Këshill, hyjnë në fuqi më, 1 nëntor 2014.

2. Gjatë periudhës nga 1 nëntor 2014 deri më 31 mars 2017, kur një akt duhet të miratohet me shumicë të cilësuar, një anëtar i Këshillit mund të kërkojë që të miratohet në përputhje me shumicën e cilësuar të përkufizuar në paragrafin 3. Në këtë rast, zbatohen paragrafët 3 dhe 4.

3. Deri në 31 tetor 2014, dispozitat e mëposhtme mbeten në fuqi, pa cenuar nënparagrafin e dytë të nenit 235(1) të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Europian.

Për aktet e Këshillit Europian dhe të Këshillit që kërkojnë shumicë të cilësuar, votat e anëtarëve ponderohen si vijon:

Belgjika	12	Luksemburgu	4
Bullgaria	10	Hungaria	12
Republika Çeke	12	Malta	3
Danimarka	7	Holanda	13
Gjermania	29	Austria	10
Estonia	4	Polonia	27
Irlanda	7	Portugalia	12
Greqia	12	Rumania	14
Spanja	27	Sllovenia	4
Franca	29	Sllovakia	7
Italia	29	Finlanda	7
Qiproja	4	Suedia	10
Letonia	4	Mbretëria e Bashkuar	29
Lituania	7		

Aktet miratohen nëse ka të paktën 255 vota në favor që përfaqësojnë shumicën e anëtarëve kur, sipas Traktateve, ato duhet të miratohen bazuar në një propozim të Komisionit. Në raste të tjera, vendimet miratohen nëse ka të paktën 255 vota në favor që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e anëtarëve.

Një anëtar i Këshillit Europian ose Këshillit mund të kërkojë që, kur një akt miratohet nga Këshilli Europian ose Këshilli me shumicë të cilësuar, të bëhet një kontroll për të siguruar që Shtetet Anëtare të cilat përbëjnë shumicën e cilësuar përfaqësojnë të paktën 62 % të gjithë popullsisë së Bashkimit. Akti nuk miratohet, nëse nuk plotësohet ky kusht.

4. Deri më 31 tetor 2014, shumica e cilësuar, në rastet kur sipas Traktateve jo të gjithë anëtarët e Këshillit marrin pjesë në votim, përkatësisht në çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar siç e përkufizon neni 238 (3) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, përkufizohet si i njëjti raport i votave të ponderuara dhe i njëjti raport i numrit të anëtarëve të Këshillit dhe, sipas

rastit, e njëjta përqindje e popullsisë së Shteteve Anëtare të përfshira, siç e përcakton paragrafi 3 e këtij neni.

TITULLI III

DISPOZITA NË LIDHJE ME KONFIGURIMET E KËSHILLIT

Neni 4

Këshilli, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të përmendur në nëparagrafin e parë të nenit 16(6) të Traktatit për Bashkimin Europian, mund të mblidhet në konfigurimet e përcaktuara në nënparagrafin e dytë dhe të tretë të atij paragrafi dhe në konfigurime të tjera sipas listës të përcaktuar me vendim të marrë me shumicë të thjeshtë nga Këshilli i Punëve të Përgjithshme.

TITULLI IV

DISPOZITA NË LIDHJE ME KOMISIONIN, PËRFSHIRË PËRFAQËSUESIN E LARTË TË BASHKIMIT PËR POLITIKËN E JASHTME DHE TË SIGURISË

Neni 5

Anëtarët e Komisionit në detyrë datën e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës qëndrojnë në detyrë deri në përfundim të mandatit të tyre. Megjithatë, ditën e emërimit të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit, përfundon mandati i anëtarit që ka të njëjtën shtetësi si ajo e Përfaqësuesit të Lartë.

TITULLI V

DISPOZITA NË LIDHJE ME SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË KËSHILLIT, PËRFAQËSUESIN E LARTË PËR POLITIKËN E PËRBASHKËT TË JASHTME DHE TË SIGURISË
DHE ZËVENDËSSEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË KËSHILLIT

Neni 6

Mandatet në detyrë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, Përfaqësuesit të Lartë për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm të Këshillit përfundojnë datën e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Këshilli miraton një Sekretar të Përgjithshëm në përputhje me nenin 240(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

TITULLI VI

DISPOZITA NË LIDHJE ME ORGANET KËSHILLIMORE

Neni 7

Deri në hyrjen në fuqi të vendimit të përmendur në nenin 301 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, shpërndarja e anëtarëve të Komitetit Ekonomik dhe Social është si më poshtë:

Belgjika	12	Luksemburgu	6
Bullgaria	12	Hungaria	12
Republika Çeke	12	Malta	5
Danimarka	9	Holanda	12
Gjermania	24	Austria	12
Estonia	7	Polonia	21
Irlanda	9	Portugalia	12
Greqia	12	Rumania	15
Spanja	21	Sllovenia	7
Franca	24	Sllovakia	9
Italia	24	Finlanda	9
Qiproja	6	Suedia	12
Letonia	7	Mbretëria e Bashkuar	24
Lituania	9		

Neni 8

Deri në hyrjen në fuqi të vendimit të përmendur në nenin 305 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, shpërndarja e anëtarëve të Komitetit të Rajoneve është si më poshtë:

Belgjika	12	Luksemburgu	6
Bullgaria	12	Hungaria	12
Republika Çeke	12	Malta	5
Danimarka	9	Holanda	12
Gjermania	24	Austria	12
Estonia	7	Polonia	21
Irlanda	9	Portugalia	12
Greqia	12	Rumania	15
Spanja	21	Sllovenia	7
Franca	24	Sllovakia	9
Italia	24	Finlanda	9
Qiproja	6	Suedia	12
Letonia	7	Mbretëria e Bashkuar	24
Lituania	9		

TITULLI VII

DISPOZITA KALIMTARE NË LIDHJE ME AKTET E MIRATUARA NË BAZË TË TITULLIT V DHE VI TË TRAKTATIT PËR BASHKIMIN EUROPIAN PËRPARA HYRJES NË FUQI TË TRAKTATIT TË LISBONËS

Neni 9

Fuqia ligjore e akteve të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit të miratuara në bazë të Traktatit për Bashkimin Europian, përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, ruhet deri në shfuqizimin, anulimin ose ndryshimin e atyre akteve, në zbatim të Traktateve. E njëjta vlen edhe për marrëveshjet e lidhura ndërmjet Shteteve Anëtare në bazë të Traktatit për Bashkimin Europian.

Neni 10

1. Si masë kalimtare, dhe në lidhje me aktet e Bashkimit në fushën e bashkëpunimit policor dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale të cilat janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, kompetencat e institucioneve do të jenë si më poshtë në datën e hyrjes në fuqi të atij Traktati: kompetencat e Komisionit sipas nenit 258 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian nuk zbatohen dhe kompetencat e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian sipas Titullit VI të Traktatit për Bashkimin Europian, në variantin në fuqi përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, mbeten njësoj, duke përfshirë edhe rastin kur ato janë pranuar sipas nenit 35, (2) të Traktatit të përmendur për Bashkimin Europian.

2. Ndryshimi i një akti të përmendur në paragrafin 1 përfshin ushtrimin e kompetencave të institucioneve të përmendura në atë paragraf të parashikuar në Traktate, në lidhje me aktin e ndryshuar për ato Shtete Anëtare për të cilat zbatohet ai akt i ndryshuar.

3. Në çdo rast, masat kalimtare të përmendura në paragrafin 1 pushojnë së vepruari pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

4. Të paktën gjashtë muajt e fundit përpara mbarimit të periudhës kalimtare të përmendur në paragrafin 3, Mbretëria e Bashkuar mund të njoftojë Këshillin që nuk i pranon, në lidhje me aktet e përmendura në paragrafin 1, kompetencat e institucioneve të përmendura në paragrafin 1 të parashikuar në Traktate. Në rastin kur Mbretëria e Bashkuar e ka bërë atë njoftim, të gjitha aktet e përmendura në paragrafin 1 nuk zbatohen më për të, që nga data e mbarimit të periudhës kalimtare të përmendur në paragrafin 3. Ky nënparagraf nuk zbatohet në lidhje me aktet e ndryshuara që zbatohen për Mbretërinë e Bashkuar, siç janë përmendur në paragrafin 2.

Këshilli , me shumicë të cilësuar, me propozim të Komisionit, përcakton rregullimet e nevojshme kalimtare dhe që janë të rëndësishme. Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë në miratimin e këtij vendimi. Shumica e cilësuar e Këshillit përcaktohet sipas nenit 238(3) (a) e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Këshilli, me shumicë të cilësuar, me propozim të Komisionit mund të miratojë gjithashtu një vendim që përcakton se Mbretëria e Bashkuar mbart pasojat e drejtpërdrejta financiare, nëse ka, që rrjedhin domosdoshmërisht dhe pashmangshmërisht si rezultat i pushimit të pjesëmarrjes së saj në këto akte.

5. Mbretëria e Bashkuar, në çdo kohë më pas, mund të njoftojë Këshillin për dëshirën e saj që të marrë pjesë në akte që nuk zbatohen për atë sipas paragrafit 4, nënparagrafi i parë. Në këtë rast, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nevojshme të Protokollit për tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian ose të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Kompetencat e institucioneve në lidhje me këto akte do të jenë ato që parashikohen në Traktate. Institucionet e Bashkimit dhe Mbretëria e Bashkuar, kur veprojnë sipas Protokolleve përkatëse, kërkojnë të -rivendosin masën më të gjerë të mundshme të pjesëmarrjes së Mbretërisë së Bashkuar në tërësinë e legjislacionit të Bashkimit në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, pa cenuar rëndë zbatimin praktik të pjesëve të ndryshme të saj duke respektuar koherencën e tyre.

———

PROTOKOLLI (nr. 37)

MBI PASOJAT FINANCIARE TË MBARIMIT TË TRAKTATIT TË KEQÇ-SË DHE PËR FONDIN E KËRKIMEVE PËR QYMYRGURIN DHE ÇELIKUN

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

DUKE KUJTUAR që të gjitha aktivet dhe pasivet e Qymyrgurit dhe Çelikut të Komunitetit Europian, në gjendjen e tyre më 23 Korrik 2002 u transferuan në Komunitetin Europian, më 24 Korrik 2002,

DUKE PASUR PARASYSH dëshirën për t'i përdorur këto fonde për kërkime në sektorët që lidhen me industrinë e qymyrgurit dhe çelikut dhe nevojën për të parashikuar disa rregulla të veçanta në këtë drejtim,

KANË RËNË DAKORD për dispozitat e mëposhtme që i shtohen Traktatit për Bashkimin Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian:

Neni 1

1. Vlera neto e aktivit dhe pasivit e Qymyrgurit dhe Çelikut të Komunitetit Europian që rezulton në bilancin e KEQÇ-së të 23 Korrikut 2002, e cila mund të rritet apo të ulet si rezultat i veprimeve të likuidimit, konsiderohet si aktive për qëllime kërkimi në sektorët që lidhen me industrinë e qymyrgurit dhe çelikut, e njihet si "KEQÇ në likuidim". Me përfundim të likuidimit ajo njihet si "aktive të Fondit të Kërkimit për Qymyrgurin dhe Çelikun".

2. Të ardhurat nga këto aktive, të njohura si "Fondi i Kërkimit për Qymyrgurin dhe Çelikun" përdoren vetëm për kërkime, jashtë programit kuadër të kërkimeve në sektorët q kanw lidhje me industrinë e qymyrgurit dhe çelikut në përputhje me këtë Protokoll dhe aktet e miratuara sipas tij.

Neni 2

Këshilli, në përputhje me procedurën e veçantë legjislative, dhe pas marrjes së pëlqimit nga Parlamenti Europian, miraton të gjitha dispozitat e nevojshme për zbatimin e këtij Protokolli, duke përfshirë parimet thelbësore.

Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin Europian, miraton masat që përcaktojnë orientime financiare shumëvjeçare për menaxhimin e aktiveve të Fondit të Kërkimit për Qymyrgurin dhe Çelikun dhe orientime teknike për programin e kërkimit të Fondit të Kërkimit për Qymyrgurin dhe Çelikun.

Neni 3

Dispozitat e Traktateve zbatohen, përveç rasteve, kur ky Protokoll dhe aktet e miratuara bazuar në të parashikojnë ndryshe.

———

SHTOJCA

SHTOJCA I

LISTA E PËRMENDUR NË NENIN 38
TË TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN

(1) Nr. në nomenklaturën e Brukselit	(2) Përshkrimi i produkteve
KREU 1	Kafshë të gjalla
KREU 2	Mish dhe të brendshme të ngrënshme
KREU 3	Peshq, guaskorë dhe molusqe
KREU 4	Produkte bulmeti; vezë zogjsh; mjaltë natyral
KREU 5	
05.04	Zorrë, fshikëz dhe stomak kafshësh (jo peshqish), në tërësi ose në pjesë
05.15	Prodhime me origjinë shtazore të papërcaktuara dhe të papërfshira tjetërkund; kafshë të ngordhura të parashikuara në Kreun 1 ose Kreun 3 jo për konsum nga njeriu
KREU 6	Pemë të gjalla dhe bimë të tjera; zhardhokë, rrënjë, dhe të ngjashme me to; lule te prera dhe gjethnaja zbukuruese
KREU 7	Zarzavate, rrënjë dhe tubera të ngrënshme
KREU 8	Fruta dhe arra të ngrënshme; lëkura agrumesh dhe pjeprash
KREU 9	Kafe, çaj dhe erëza me përjashtim të çajit të maté (zëri nr 09.03)
KREU 10	Drithëra
KREU 11	Prodhime të industrisë të bluarjes; elb dhe niseshte; gluten; insulinë
KREU 12	Farëra dhe fruta vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimë industriale dhe mjekësore; kashta dhe foragjere
KREU 13	
ex 13.03	Pektinë
KREU 15	
15.01	Dhjamë dhe yndyrna të tjera derri të shkrira; yndyrna shpendësh të shkrira
15.02	Dhjamërat e pashkrira të gjedhëve, deleve ose dhive; sallo (përfshirë "lëngjet e para") të prodhuara nga këto dhjamëra
15.03	Stearin dhjamore, dyllë vajor; vaj dhjami dhe margarinë vajore e patundur, e papërzier dhe e papërgatitur në ndonjë mënyrë tjetër
15.04	Dhjamëra dhe vajra peshku dhe gjitarësh detarë të rafinuara ose jo

(1) Nr. në nomenklaturën e Brukselit	(2) Përshkrimi i produkteve
15.07	Vajra të caktuara vegjetale, të lëngshme ose të ngurta, bruto, të pastruara ose të rafinuara
15.12	Dhjamëra ose vajra shtazore ose vegjetale të hidrogjenuara, qoftë edhe të rafinuara, por jo të përgatitura
15.13	Margarinë, imitime të dhjamit dhe yndyrna të tjera ushqimore të përgatitura
15.17	Mbetje që dalin nga trajtimi i substancave të yndyrshme, ose të dyllërave shtazore ose vegjetale
KREU 16	Përgatitje të mishit, peshkut, guaskorëve ose molusqeve
KREU 17	
17.01	Sheqer panxhari dhe sheqer kallami në gjendje të ngurtë
17.02	Sheqerna të tjera; shurup sheqeri; mjaltë artificial (i përzierë ose jo me mjaltë natyral); karamel
17.03	Melasë pa ose me ngjyrë
17.05 (*)	Sheqerna me aromë apo ngjyrë, shurupra dhe melasë (përfshirë sheqer pluhurin ose vaniljen), me përjashtim të lëngjeve të frutave me sheqer të shtuar në çfarëdo mase
KREU 18	
18.01	Kakao në kokërr edhe të grirë, bruto ose të pjekur
18.02	Lëvozhga, lëkura, thërrimet dhe mbetjet e kakaos
KREU 20	Përgatitjet e zarzavateve, të frutave ose bimëve të ngrënshme
KREU 22	
22.04	Musht rrushi, në fermentim ose me fermentim të ndërprerë pa shtim alkooli
22.05	Verë rrushi të freskët; musht rrushi të freskët me fermentim të ndërprerë me shtim alkooli
KREU 22 (vazhdon)	
22.07	Pije të tjera të fermentuara (psh., musht molle, musht dardhe dhe hidromel)
ex 22.08 (*)	
ex 22.09 (*)	Alkool etilik ose pije neutrale, të denatyruara apo jo, me çfarëdo force alkooli, të prodhuar nga produkte bujqësore të renditur në Shtojcën I, duke përjashtuar likeret dhe pije të tjera alkoolike të distiluara dhe përgatitje alkoolike të përbëra (të njohur si "ekstrakte të përqendruara") për prodhimin e pijeve

(1) Nr. në nomenklaturën e Brukselit	(2) Përshkrimi i produkteve
22.10 (*)	Uthull dhe zëvendësuesit e saj
KREU 23	Mbetje dhe mbeturina të industrive ushqimore; ushqime të përgatitura për kafshët
KREU 24	
24.01	Duhan i pafabrikuar, mbetje të duhanit
KREU 45	
45.01	Dru tape natyral, bruto, i dërrmuar, i kokrrizuar ose i bluar; mbeturina tape
KREU 54	
54.01	Li natyror, i papërpunuar ose i përpunuar por jo i thurur; shtupë dhe mbetje (përfshirë këtu edhe fijet e tërhequra ose të thurura)
KREU 57	
57.01	Kërp (Cannabis sativa) i papërpunuar ose i përpunuar por jo i thurur, shtupë dhe mbetje (përfshirë këtu edhe fijet ose litarët të tërhequr ose të thurur)

(*) E shtuar me nenin 1 të Rregullores nr. 7a të Këshillit të Komuniteti Ekonomik Europian të 18 dhjetorit 1959 (GZ7, 30.1.1961, fq. 71/61)

SHTOJCA II

VENDET DHE TERRITORET JASHTË EUROPËS PËR TË CILAT ZBATOHEN DISPOZITAT E PJESËS SË KATËRT TË TRAKTATIT PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EUROPIAN

- Groenlanda,
- Kaledonia e Re dhe territoret në varësi të saj,
- Polinezia Franceze,
- Territoret Jugore dhe Antarktike Franceze,
- Ishujt Uallis dhe Futuna,
- Majota,
- Shën Pietri dhe Mikeloni,
- Aruba,
- Antilet Holandeze:
  - Bonera,
  - Kuraçaoja,
  - Saba,
  - Shën Eustatiusi,
  - Shën Marteni,
- Angilla,
- Ishujt Kajman,
- Ishujt Folkland,
- Gjeorgjia e Jugut dhe Ishujt Sanduiç të Jugut,
- Montserrati,
- Pitkairni,
- Shën Helena dhe territoret në varësi të saj,,
- Territoret e Antarktikut Britanik,
- Territori Britanik i Oqeanit Indian,
- Ishujt Turks dhe Kaikos,
- Ishujt Virgjinë Britanikë,
- Bermuda.

DEKLARATA

BASHKËLIDHUR AKTIT FINAL TË KONFERENCËS NDËRQEVERITARE QË MIRATOI TRAKTATIN E LISBONËS,

nënshkruar më 13 dhjetor 2007

A. DEKLARATA NË LIDHJE ME DISPOZITAT E TRAKTATEVE

1. Deklaratë në lidhje me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian, e cila ka fuqi ligjore të detyrueshme, konfirmon të drejtat themelore të garantuara nga Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të drejtat që rrjedhin nga traditat kushtetuese të përbashkëta për Shtetet Anëtare.

Karta as nuk e zgjeron fushën e zbatimit të së drejtës së Bashkimit përtej kompetencave të Bashkimit, as nuk përcakton ndonjë kompetencë apo detyrë të re për Bashkimin dhe as nuk ndryshon kompetencat dhe detyrat e përcaktuara në Traktate.

2. Deklaratë për nenin 6 (2) të Traktatit për Bashkimin Europian

Konferenca pranon që anëtarësimi i Bashkimit në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që të ruajë veçoritë specifike të së drejtës së Bashkimit. Në këtë drejtim, Konferenca vëren ekzistencën e dialogut të rregullt ndërmjet Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian dhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut; ky dialog mund të përforcohet me aderimin e Bashkimit në këtë Konventë.

3. Deklaratë për nenin 8 të Traktatit për Bashkimin Europian

Bashkimi merr parasysh situatën e veçantë të vendeve të vogla që ruajnë me atë marrëdhënie specifike afërsie.

4. Deklaratë për përbërjen e Parlamentit Europian

Vendet shtesë në Parlamentin Europian i jepen Italisë.

5. Deklaratë për miratimin politik nga Këshilli Europian në lidhje me projekt-Vendimin për përbërjen e Parlamentit Europian

Këshilli Europian jep miratimin e tij politik për projektvendimin e rishikuar në lidhje me përbërjen e Parlamentit Europian për periudhën legjislative 2009-2014, bazuar në propozimin e Parlamentit Europian.

6. Deklaratë për nenin 15 (5) dhe (6), nenin 17(6) dhe (7) dhe nenin 18 të Traktatit për Bashkimin Europian

Në përzgjedhjen e personave që do të mbajnë postin e Presidentit të Këshillit Europian, Presidentit të Komisionit dhe Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën Jashtme dhe të Sigurimit, i kushtohet vëmendja e duhur nevojës për të respektuar larminë gjeografike dhe demografike të Bashkimit dhe Shteteve të tij Anëtare.

7. Deklaratë për nenin 16(4) të Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 238(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian

Konferenca deklaron që vendimi në lidhje me zbatimin e nenit 16(4) të Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenit 238(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian miratohet nga Këshilli më datën e nënshkrimit të Traktatit të Lisbonës dhe hyn në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Traktati. Projektvendimi është parashikuar më poshtë:

Projektvendim i Këshillit
në lidhje me zbatimin e nenit 16(4) të Traktatit për Bashkimin Europian
dhe nenit 238 (2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian nga data 1 nëntor 2014
deri më 31 marsit 2017 nga njëra anë, dhe prej
datës 1 prill 2017 nga ana tjetër

KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN

Duke pasur parasysh:

(1) Dispozitat që duhet të miratohen për të lejuar një tranzicion gradual nga sistemi i vendimmarrjes në Këshill me shumicë të cilësuar siç e përcakton nenin 3(3) i Protokollit mbi dispozitat kalimtare, i cili do të vazhdojë të zbatohet deri më 31 tetor 2014, në sistemin e votimit të parashikuar në nenin 16(4) të Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 238(2) 2 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, që do të zbatohet prej datës 1 nëntor 2014, duke përfshirë, gjatë një periudhe kalimtare deri më 31 mars 2017, dispozita specifike të përcaktuara në nenin 3(2) të atij Protokolli.

(2) Praktikën e Këshillit që i përkushton çdo përpjekje forcimit të legjitimitetit demokratik të vendimeve të marra me shumicë të cilësuar,

KA VENDOSUR SI MË POSHTË:

Seksioni 1

Dispozitat të zbatohen që nga 1 nëntor 2014 deri më 31 mars 2017

Neni 1

Nga 1 nëntor 2014 deri më 31 mars 2017, nëse anëtarët e Këshillit që përfaqësojnë:

(a) të paktën tre të katërtat e popullatës, ose

(b) të paktën tre të katërtat e numrit të Shteteve Anëtare

sa është e nevojshme për të formuar pakicën bllokuese që rezulton nga zbatimi i nenit 16(4), nënparagrafi i parë të Traktatit për Bashkimin Europian ose nenit 238(2) të Traktatit për

Funksionimin e Bashkimit Europian, janë kundër miratimit nga Këshilli të një akti me shumicë të cilësuar, Këshilli e diskuton çështjen.

Neni 2

Këshilli, gjatë këtyre diskutimeve, bën gjithçka në kompetencë të tij për të arritur brenda një kohe të arsyeshme dhe pa cenuar afatet e detyrueshme të përcaktuara në të drejtën e Bashkimit, një zgjidhje të kënaqshme për të trajtuar shqetësimet e ngritura nga anëtarët e Këshillit të përmendur në nenin 1.

Neni 3

Për këtë qëllim, Presidenti i Këshillit, me mbështetjen e Komisionit dhe në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Këshillit, ndërmerr çdo nismë të nevojshme për të lehtësuar një miratim me bazë më të gjerë në Këshill. Për këtë ai ose ajo mbështetet nga anëtarët e Këshillit.

Seksioni 2

Dispozitat që zbatohen duke filluar nga data 1 prill 2017

Neni 4

Duke filluar nga data 1 prill 2017, nëse anëtarët e Këshillit që përfaqësojnë:

(a) të paktën 55 % të popullsisë, ose

(b) të paktën 55 % të numrit të Shteteve Anëtare

sa është e nevojshme për të formuar pakicën bllokuese që rezulton nga zbatimi i nenit 16(4), nënparagrafi i parë të Traktatit për Bashkimin Europian ose nenit 238(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, janë kundër miratimit nga Këshilli të një akti me shumicë të cilësuar, Këshilli e diskuton çështjen.

Neni 5

Këshilli, gjatë këtyre diskutimeve, bën gjithçka në kompetencë të tij për të arritur brenda një kohe të arsyeshme dhe pa cenuar afatet e detyrueshme të përcaktuara në të drejtën e Bashkimit, një zgjidhje të kënaqshme për të trajtuar shqetësimet e ngritura nga anëtarët e Këshillit të përmendur në nenin 4.

Neni 6

Për këtë qëllim, Presidenti i Këshillit, me mbështetjen e Komisionit dhe në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Këshillit, ndërmerr çdo nismë të nevojshme për të lehtësuar një miratim me bazë më të gjerë në Këshill. Për këtë ai ose ajo mbështetet nga anëtarët e Këshillit.

Seksioni 3

Hyrja në fuqi

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi më datën e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

8. **Deklaratë për masat praktike që duhet të merren me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës në lidhje me Presidencën e Këshillit Europian dhe Këshillin e Punëve të Jashtme**

Nëse Traktati i Lisbonës hyn në fuqi më vonë se data 1 janar 2009, Konferenca u kërkon, nga njëra anë, autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar që ka presidencën 6-mujore të Këshillit në atë kohë, dhe personit të zgjedhur si President i Këshillit Europian dhe personit të emëruar si Përfaqësues i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit nga ana tjetër, të marrin masat e nevojshme specifike në konsultim me Presidencën e ardhshme 6 mujore për të mundësuar dorëzimin efikas të aspekteve materiale dhe organizative të Presidencës së Këshillit Europian dhe Këshillit të Punëve të Jashtme.

9. **Deklaratë për nenin 16(9)9 të Traktatit për Bashkimin Europian në lidhje me vendimin e Këshillit Europian për ushtrimin e Presidencës së Këshillit**

Konferenca deklaron që Këshillit duhet të fillojë të përgatisë vendimin që përcakton procedurën për zbatimin e vendimit mbi ushtrimin e Presidencës së Këshillit sapo të nënshkruhet Traktati i Lisbonës dhe duhet të japë miratimin e tij politik brenda gjashtë muajve. Projektvendimi i Këshillit Europian që do të miratohet më datën e hyrjes në fuqi të Traktatit në fjalë është parashikuar më poshtë:

Projektvendim i Këshillit Europian
mbi ushtrimin e Presidencës së Këshillit

Neni 1

1. Presidenca e Këshillit, me përjashtim të konfigurimit të Punëve të Jashtme mbahet nga grupe të parapërcaktuara me tre Shtete Anëtare për një periudhë 18-mujore. Grupet krijohen në bazë të një rotacioni të barabartë mes Shteteve Anëtare, duke pasur parasysh larminë dhe ekuilibrin gjeografik brenda Bashkimit.

2. Çdo anëtar i grupit sipas radhës kryeson për një periudhë gjashtëmujore në të gjitha konfigurimet e Këshillit, me përjashtim të konfigurimit të Punëve të Jashtme. Anëtarët e tjerë të grupit e mbështetin Kryetarin në të gjitha detyrat e veta në bazë të një programi të përbashkët. Anëtarët e grupit mund të vendosin organizime alternative mes tyre.

Neni 2

Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm të Qeverive të Shteteve Anëtare kryesohet nga një përfaqësues i Shtetit Anëtar që kryeson Këshillin për Çështjet e Përgjithshme.

Kryesia në Komitetin Politik dhe të Sigurimit mbahet nga një përfaqësues i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën Jashtme dhe të Sigurimit.

Kryesia e organeve përgatitore të konfigurimeve të ndryshme të Këshillit me përjashtim të konfigurimit të Punëve të Jashtme, i takon anëtarit të grupit që kryeson konfigurimin përkatëse, përveçse kur vendoset ndryshe në përputhje me nenin 4.

Neni 3

Këshilli për çështjet e përgjithshme siguron konsekuencën dhe vijimësinë e punës së konfigurimeve të ndryshme të Këshillit në kuadër të programeve shumëvjeçare në bashkëpunim me Komisionin. Shtetet Anëtare që mbajnë presidencën, marrin të gjitha masat e nevojshme për organizimin dhe funksionimin pa probleme të punës së Këshillit, me mbështetjen e Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit.

Neni 4

Këshilli miraton një vendim që përcakton masat për zbatimin e këtij vendimi.

10. **Deklaratë për nenin 17 të Traktatit për Bashkimin Europian**

Konferenca konsideron që kur Komisioni nuk përfshin më shtetas nga të gjitha Shtetet Anëtare, Komisioni duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nevojës për të siguruar transparencë të plotë në marrëdhëniet me të gjitha Shtetet Anëtare. Në këtë mënyrë, Komisioni duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me të gjitha Shtetet Anëtare, pavarësisht faktit nëse kanë ose jo shtetas të tyre si anëtarë të Komisionit dhe, në këtë kontekst, duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nevojës për të ndarë informacion dhe për t'u konsultuar me të gjitha Shtetet Anëtare.

Konferenca, gjithashtu, konsideron që Komisioni duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që realitetet politike, sociale dhe ekonomike në të gjitha Shtetet Anëtare, duke përfshirë ato Shtete Anëtare që nuk kanë shtetas të tyre si anëtarë të Komisionit, të merren plotësisht parasysh. Këto masa përfshijnë edhe ato që sigurojnë që qëndrimet e këtyre Shteteve Anëtare do të trajtohen me rregullimet e duhura organizative.

11. **Deklaratë për nenin 17(6) dhe (7) të Traktatit për Bashkimin Europian**

Konferenca konsideron që, në përputhje me dispozitat e Traktateve, Parlamenti Europian dhe Këshilli Europian janë bashkërisht përgjegjës për zhvillimin pa probleme të procesit që çon në zgjedhjen e Presidentit të Komisionit Europian. Përpara vendimit të Këshillit Europian, përfaqësuesit e Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian zhvillojnë konsultimet e nevojshme në kuadrin që e konsiderojnë më të përshtatshëm. Këto konsultime fokusohen në formimin e kandidatëve për President të Komisionit, duke pasur parasysh zgjedhjet për në Parlamentin Europian, në përputhje me nënparagrafin e parë të nenit 17 (7). Rregullimet për këto konsultime mund të përcaktohen, në rrjedhën e duhur, me marrëveshje të përbashkët ndërmjet Parlamentit Europian dhe Këshillit Europian.

12. Deklaratë për nenin 18 të Traktatit për Bashkimin Europian

1. Konferenca deklaron që, gjatë punës përgatitore që i paraprin emërimit të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit, do të bëhet datën e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës në përputhje me nenin 18 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenin 5 të Protokollit për dispozitat kalimtare, dhe mandati i të cilit fillon më këtë datë dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Komisionit në detyrë në atë datë, do të mbahen kontaktet e duhura me Parlamentin Europian.

2. Gjithashtu, Konferenca rikujton që në lidhje me Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit mandati i të cilit do të fillojë më nëntor 2009, në të njëjtën kohë dhe për të njëjtën kohëzgjatje si Komisioni i radhës, ai /ajo do të emërohet në përputhje me dispozitat e nenit 17 dhe 18 të Traktatit për Bashkimin Europian.

13. Deklaratë në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë

Konferenca thekson që dispozitat në Traktatin për Bashkimin Europian që kanë të bëjnë me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurimit, përfshirë edhe krijimin e pozicionit të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit dhe krijimin e Shërbimit për Veprim të Jashtëm, nuk prekin as përgjegjësitë e Shteteve Anëtare, në formën e tyre ekzistuese për të formuluar dhe zhvilluar politikat e tyre të jashtme, dhe as përgjegjësitë e përfaqësuesve të tyre kombëtarë në vende të treta dhe organizata ndërkombëtare.

Konferenca gjithashtu rikujton që dispozitat që rregullojnë Politikën e Përbashkët të Sigurimit dhe Mbrojtjes nuk cenojnë karakterin specifik të politikës së sigurimit dhe të mbrojtjes të Shteteve Anëtare.

Konferenca thekson se dispozitat e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe, në veçanti , përgjegjësia parësore e Këshillit të Sigurimit dhe të Anëtarëve të tij për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare vazhdojnë të jenë të detyrueshme për Bashkimin Europian dhe Shtetet e tij Anëtare.

14. Deklaratë në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë

Përveç rregullave dhe procedurave specifike të përmendura në paragrafin 1 të nenit 24 të Traktatit për Bashkimin Europian, Konferenca nënvizon që dispozitat për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurimit, duke përfshirë ato në lidhje me Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit dhe Shërbimin për Veprim të Jashtëm, nuk prekin bazën ligjore, përgjegjësitë dhe kompetencat ekzistuese të asnjë Shteti Anëtar për të formuluar dhe zhvilluar politikën e tij të jashtme, shërbimin e tij diplomatik kombëtar, marrëdhëniet me vendet e treta dhe pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare, duke përfshirë anëtarësimin e Shtetit Anëtar në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Konferenca vëren gjithashtu që dispozitat për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurimit nuk i japin Komisionit kompetenca të reja për të iniciuar vendime dhe as nuk rrisin rolin e Parlamentit Europian.

Konferenca gjithashtu rikujton që dispozitat që rregullojnë Politikën e Përbashkët të Sigurimit dhe Mbrojtjes nuk cenojnë karakterin specifik të politikës së sigurimit dhe të mbrojtjes të Shteteve Anëtare.

15. **Deklaratë për nenin 27 të Traktatit për Bashkimin Europian**

Konferenca deklaron që, me nënshkrimin e Traktatit të Lisbonës, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, Përfaqësuesi i Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit, Komisioni dhe Shtetet Anëtare duhet të fillojnë punën përgatitore për Shërbimin Europian për Veprim të Jashtëm.

16. **Deklaratë për nenin 55(2) të Traktatit për Bashkimin Europian**

Konferenca konsideron që mundësia e realizimit të përkthimeve të Traktateve në gjuhët e përmendura në nenin 55(2) kontribuon në arritjen e objektivit të respektimit të larmisë së pasur gjuhësore dhe kulturore të Bashkimit siç është përcaktuar në nënparagrafin e katërt të nenit 3(3). Në këtë kontekst, Konferenca konfirmon respektimin nga ana e Bashkimit, të larmisë kulturore të Europës dhe vëmendjen e veçantë që do të vazhdojë t'i kushtojë këtyre dhe gjuhëve të tjera.

Konferenca rekomandon që ato Shtete Anëtare që dëshirojnë të përfitojnë nga mundësia që ofrohet me nenin 55 pika 2, t'i komunikojnë Këshillit, brenda gjashtë muajve nga data e nënshkrimit të Traktatit të Lisbonës, gjuhën ose gjuhët në të cilat do të bëhen përkthimet e Traktateve.

17. **Deklaratë në lidhje me epërsinë**

Konferenca kujton që, në përputhje me praktikën gjyqësore të mirë përcaktuar të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, Traktatet dhe legjislacioni i miratuar nga Bashkimi në bazë të Traktateve kanë epërsi mbi të drejtën e Shteteve Anëtare, sipas kushteve të përcaktuara nga praktika gjyqësore e përmendur.

Konferenca gjithashtu vendosi të bashkëlidhë si shtojcë të këtij Akti Final, Opinionin e Shërbimit Juridik të Këshillit për epërsinë e së drejtës së KE-së të parashikuar në 11197/07 (JUR 260):

"Opinion i Shërbimit Juridik të Këshillit
datë 22 qershor 2007

Nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë rezulton që epërsia e së drejtës së KE-së është një parim themelor i së drejtës Komunitare. Sipas Gjykatës, ky parim buron nga natyra specifike e Komunitetit Europian. Kjo epërsi nuk përmendej në traktat në kohën që u mor vendimi i parë i kësaj praktike gjyqësore (Costa/ENEL, 15 korrik 1964, Çështja 6/641[1]). Kjo vlen edhe sot. Fakti që parimi i epërsisë nuk do të përfshihet në traktatin e ardhshëm në asnjë mënyrë nuk do të ndryshojë ekzistencën e parimit dhe praktikën gjyqësore ekzistuese të Gjykatës së Drejtësisë.

---

[1] *"Sipas kësaj (...) e drejta që buron nga traktati, një burim i pavarur i së drejtës për shkak të natyrës së vet të veçantë dhe fillestare, nuk mund të kufizohet nga dispozitat ligjore të brendshme, pavarësisht kornizave të tyre, pa humbur karakterin e saj si e drejtë komunitare dhe pa vënë në diskutim bazën ligjore të vetë Komunitetit."*

18. **Deklaratë në lidhje me ndarjen e kompetencave**

Konferenca nënvizon që, në përputhje me sistemin e ndarjes së kompetencave ndërmjet Bashkimit dhe Shteteve Anëtare siç parashikon Traktati për Bashkimin Europian dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian, kompetencat të cilat në Traktate nuk i delegohen Bashkimit vazhdojnë të mbahen nga Shtetet Anëtare.

Nëse Traktatet i delegojnë Bashkimit një kompetencë të përbashkët me Shtetet Anëtare në një fushë specifike, Shtetet Anëtare ushtrojnë kompetencën e tyre në masën që Bashkimi nuk e ushtron atë, ose nëse Bashkimi ka vendosur të pushojë së ushtruari kompetencën e tij. Kjo situatë e fundit krijohet kur institucionet përkatëse të BE-së vendosin të shfuqizojnë një akt legjislativ, në veçanti për të siguruar më mirë respektimin e vazhdueshëm të parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Këshilli, me nismën e një ose të disa anëtarëve të tij (përfaqësues të Shteteve Anëtare) dhe në përputhje me nenin 241 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, mund t'i kërkojë Komisionit të paraqesë propozime për të shfuqizuar një akt legjislativ. Konferenca mirëpret deklaratën e Komisionit që ky do ti kushtojë vëmendje të veçantë këtyre kërkesave.

Po kështu, përfaqësuesit e qeverive të Shteteve Anëtare, të mbledhur në një Konferencë Ndërqeveritare, në përputhje me procedurën e zakonshme të rishikimit të parashikuar në nenin 48 (2) deri (5) të Traktatit për Bashkimin Europian, mund të vendosin të ndryshojnë Traktatet që janë themeli i Bashkimi, ose të rrisin apo të pakësojnë kompetencat që i janë dhënë Bashkimit në Traktatet në fjalë.

19. **Deklaratë për nenin 8 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca pranon që, në përpjekjet e saj të përgjithshme për të eliminuar pabarazitë ndërmjet grave dhe burrave, Bashkimi në politikat e tij të ndryshme synon të luftojë të gjitha format e dhunës në familje. Shtetet Anëtare duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i parandaluar dhe ndëshkuar këto vepra penale dhe për t'i mbështetur dhe mbrojtur viktimat.

20. **Deklaratë për nenin 16 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca deklaron që, sa herë që rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat duhen miratuar në bazë të nenit 16 mund të kenë rrjedhoja të drejtpërdrejta për sigurinë kombëtare, do të mbahen parasysh veçoritë specifike të çështjes. Ajo rikujton që legjislacioni aktualisht i zbatueshëm (shihni në veçanti Direktivën 95/46/KE) përmban shmangie të caktuara në këtë drejtim.

21. **Deklaratë për mbrojtjen e të dhënave personale në fushat e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale dhe bashkëpunimit policor**

Konferenca pranon që mund të lindë nevoja për rregulla specifike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave në fushat e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale dhe bashkëpunimit policor bazuar në nenin 16 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, për shkak të natyrës specifike të këtyre fushave.

22. **Deklaratë për nenin 48 dhe 79 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca konsideron që në rastin kur një projektakt legjislativ bazuar në nenin 79(2) prek aspekte të rëndësishme të sistemit të sigurimeve shoqërore të një Shteti Anëtar, duke përfshirë fushën e tij të veprimit, koston ose strukturën financiare ose prek ekuilibrin financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 48, mbahen parasysh siç duhet interesat e Shtetit Anëtar në fjalë.

23. **Deklaratë për paragrafin e dytë të nenit 48 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca rikujton që në këtë rast, në përputhje me nenin 15 (4) të Traktatit për Bashkimin Europian, Këshilli Europian vepron me konsensus.

24. **Deklaratë në lidhje me personalitetin juridik të Bashkimit Europian**

Konferenca konfirmon që fakti se Bashkimi Europian ka personalitet juridik në asnjë mënyrë nuk e autorizon Bashkimin të bëjë ligje ose veprime të cilat shkojnë përtej kompetencave që i janë dhënë atij nga Shtetet Anëtare në Traktate.

25. **Deklaratë për nenin 75 dhe 215 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca rikujton që respektimi i të drejtave dhe lirive themelore në veçanti nënkupton që t'i kushtohet vëmendja e duhur mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të individëve ose subjekteve për proces të rregullt ligjor. Për këtë qëllim dhe për të garantuar një shqyrtim gjyqësor të plotë të vendimeve që vendosin masa kufizuese mbi një individ ose entitet, këto vendime duhet të bazohen në kritere të qarta dhe të dallueshme. Këto kritere duhet të vendosen sipas veçantive të çdo mase kufizuese.

26. **Deklaratë për mospjesëmarrjen e një Shteti Anëtar në një masë bazuar në Titullin V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca deklaron që, në rast se një Shtet Anëtar zgjedh të mos marrë pjesë në një masë bazuar në Titullin V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, Këshilli zhvillon një diskutim të plotë për rrjedhojat e mundshme dhe pasojat e -mospjesëmarrjes së atij Shteti Anëtar në atë masë.

Gjithashtu, çdo Shtet Anëtar mund t'i kërkojë Komisionit të shqyrtojë situatën në bazë të nenit 116 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Paragrafët e mësipërm nuk prekin të drejtën e një Shteti Anëtar për t'ia kaluar çështjen Këshillit Europian.

27. **Deklaratë për nenin 85(1), nënparagrafi i dytë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca konsideron që rregullat e përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 85(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian duhet të marrin parasysh rregullat dhe praktikat kombëtare në lidhje me fillimin e hetimeve penale.

28. **Deklaratë për nenin 98 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca vë në dukje që dispozitat e nenit 98 zbatohen në përputhje me praktikën aktuale. Termat "masa të tilla janë të nevojshme për të kompensuar disavantazhet ekonomike që ka shkaktuar ndarja e Gjermanisë për ekonominë në disa zona të caktuara të Republikës Federale të prekura nga kjo ndarje", interpretohen në përputhje me praktikën gjyqësore ekzistuese të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian.

29. **Deklaratë për nenin 107(2) (c) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca vë në dukje që neni 107 (2) (c) interpretohet në përputhje me praktikën gjyqësore ekzistuese të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian në lidhje me zbatueshmërinë e dispozitave për ndihmën që u jepet disa zonave të Republikës Federale të Gjermanisë të prekura nga ish-ndarja e Gjermanisë.

30. **Deklaratë për nenin 126 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca, në lidhje me nenin 126, konfirmon që rritja e potencialit të zhvillimit dhe sigurimi i pozicioneve të qëndrueshme buxhetore janë dy shtyllat e politikave ekonomike dhe fiskale të Bashkimit dhe Shteteve Anëtare. Pakti i Rritjes dhe Stabilitetit është një mjet i rëndësishëm për të arritur këto qëllime.

Konferenca përforcon angazhimin e saj ndaj dispozitave në lidhje me Paktin e Rritjes dhe Stabilitetit si kuadri për koordinimin e politikave buxhetore në Shtetet Anëtare.

Konferenca konfirmon që një sistem i bazuar në rregulla është garancia më e mirë për forcimin e angazhimeve dhe për trajtimin e barabartë të të gjitha Shteteve Anëtare.

Konferenca, brenda këtij kuadri, gjithashtu përforcon angazhimin e saj për objektivat e Strategjisë së Lisbonës: krijimi i vendeve të punës, reformat strukturore dhe kohezioni social.

Bashkimi synon të arrijë rritje të ekuilibruar ekonomike dhe stabilitet të çmimeve. Politikat ekonomike dhe buxhetore duhet të përcaktojnë përparësitë e duhura në lidhje me reformat ekonomike, risinë, konkurrueshmërinë dhe forcimin e investimit privat dhe konsumit në fazat e rritjes së dobët ekonomike. Kjo duhet të pasqyrohet në orientimet e vendimeve buxhetore në nivel kombëtar dhe të Bashkimit në veçanti nëpërmjet ristrukturimit të të ardhurave dhe shpenzimeve

publike, duke respektuar disiplinën buxhetore në përputhje me Traktatet dhe Paktin e Rritjes dhe Stabilitetit.

Sfidat buxhetore dhe ekonomike me të cilat përballen Shtetet Anëtare nënvizojnë rëndësinë e politikave të qëndrueshme buxhetore gjatë gjithë ciklit ekonomik.

Konferenca pranon që Shtetet Anëtare duhet të përdorin në mënyrë aktive periudhat e rimëkëmbjes ekonomike me qëllim që të konsolidojnë financat publike dhe të përmirësojnë pozicionet buxhetore. Objektivi është të arrihet gradualisht në ditë të mira një teprice buxhetore që krijon hapësirën e nevojshme për të përballuar rënien ekonomike dhe për të kontribuuar në këtë mënyrë në qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike.

Shtetet Anëtare presin propozime të mundshme të Komisionit si dhe kontribute të mëtejshme të Shteteve Anëtare në lidhje me forcimin dhe qartësimin e zbatimit të Paktit të Rritjes dhe Stabilitetit. Shtetet Anëtare do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të ngritur potencialin e zhvillimit të ekonomive të tyre. Këtë objektiv mund ta mbështesë koordinimi më i mirë i politikave ekonomike. Deklarata nuk prek debatin e ardhshëm për Paktin e Rritjes dhe Stabilitetit.

31. **Deklaratë për nenin 156 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca konfirmon që politikat e përshkruara në nenin 156 përfshihen në thelb brenda kompetencës së Shteteve Anëtare. Masat që duhet të merren në nivel të Bashkimit në përputhje me këtë nen për të inkurajuar dhe nxitur koordinimin kanë natyre plotësuese. Ato shërbejnë për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe jo për të harmonizuar sistemet kombëtare. Garancitë dhe praktikat ekzistuese në çdo Shtet Anëtar në lidhje me përgjegjësinë e partnerëve socialë nuk do të preken.

Kjo Deklaratë nuk cenon dispozitat e Traktateve që i japin kompetencë Bashkimit, duke përfshirë çështjet sociale.

32. **Deklaratë për nenin 168(4) (c) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca deklaron që masat të cilat do të merren sipas nenit 168 (4) (c) duhet t'u përgjigjen shqetësimeve të zakonshme për sigurinë dhe të synojnë vendosjen e standardeve të larta të cilësisë dhe të sigurisë atje ku standardet kombëtare që prekin tregun e brendshëm do të pengonin arritjen e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut

33. **Deklaratë për nenin 174 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca konsideron që rajonet ishullore të përmendura në nenin 174 mund të përfshijë Shtete ishullore në tërësinë e tyre, në varësi të plotësimit të kritereve të nevojshme.

34. **Deklaratë për nenin 179 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca pranon që veprimi i Bashkimit në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik u kushton rëndësinë e duhur orientimeve dhe zgjidhjeve themelore të politikave kërkimore të Shteteve Anëtare.

35. **Deklaratë për nenin 194 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca beson që neni 194 nuk prek të drejtën e Shteteve Anëtare të marrin masat e nevojshme për të siguruar furnizimin e tyre me energji sipas kushteve të parashikuara në nenin 347.

36. **Deklaratë për nenin 218 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian në lidhje me negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare nga Shtetet Anëtare në lidhje me zonën e lirisë, sigurimit dhe drejtësisë**

Konferenca konfirmon që Shtetet Anëtare mund të negociojnë dhe lidhin marrëveshje me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare në fushat që mbulojnë Krerët 3, 4 dhe 5 të Titullit V të Pjesës së Tretë në masën që këto marrëveshje përputhen me të drejtën e Bashkimit.

37. **Deklaratë për nenin 222 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Pa cenuar masat e miratuara nga Bashkimi në përmbushje të detyrimit të tij të solidaritetit ndaj një Shteti Anëtar i cili bëhet objekt i një sulmi terrorist ose viktimë e katastrofave të shkaktuara nga -natyra ose nga njeriu, asnjë nga dispozitat e nenit 222 nuk synon të prekë të drejtën e një Shteti tjetër Anëtar për të zgjedhur mjetet më të përshtatshme për të përmbushur detyrimin e tij të solidaritetit ndaj atij Shteti Anëtar.

38. **Deklaratë për nenin 252 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit në lidhje me numrin e Avokatëve të Përgjithshëm në Gjykatën e Drejtësisë**

Konferenca deklaron që nëse Gjykata e Drejtësisë, në përputhje me nenin 252, paragrafi i parë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, kërkon që numri i Avokatëve të -Përgjithshëm të rritet me tre (pra, njëmbëdhjetë në vend të tetë), Këshilli vendos me unanimitet për këtë rritje.

Konferenca, në këtë rast pranon që Polonia ashtu si Gjermania, Franca, Italia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar, të ketë një Avokat të Përgjithshëm të përhershëm dhe të mos marrë më pjesë në sistemin me rotacion, ndërsa sistemi ekzistues i rotacionit të përfshijë rotacionin e pesë dhe jo të tre Avokatëve të Përgjithshëm.

39. **Deklaratë për nenin 290 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca mban parasysh qëllimin e Komisionit për të vazhduar konsultimin me ekspertët e emëruar nga Shtetet Anëtare në përgatitjen e projektakteve të deleguara në fushën e shërbimeve financiare, në përputhje me praktikën e saj.

40. **Deklaratë për nenin 329 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca deklaron që Shtetet Anëtare mund të bëjnë të ditur, në rast se bëjnë një kërkesë për vendosjen e bashkëpunimit të përforcuar nëse synojnë në atë fazë të përdorin nenin 333 që parashikon shtrirjen e votimit me shumicë të cilësuar ose të përdorin procedurën e zakonshme legjislative.

41. **Deklaratë për nenin 352 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca deklaron që objektivat e Bashkimit të përmendura në nenin 352 pika 1 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian janë objektivat e parashikuara në nenin 3 pika 2 dhe 3 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe objektivat e nenit 3 pika 5 të Traktatit në fjalë në lidhje me veprimin e jashtëm sipas Pjesës së Pestë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian. Prandaj përjashtohet që një veprim bazuar në nenin 352 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit të ndjekë vetëm objektivat e parashikuara në nenin 3 (1) të Traktatit për Bashkimin Europian. Në këtë drejtim, Konferenca vëren që, në përputhje me nenin 31(1) të Traktatit për Bashkimin Europian, nuk mund të miratohen akte legjislative në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurimit.

42. **Deklaratë për nenin 352 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Konferenca thekson që në përputhje me praktikën gjyqësore të krijuar të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian, neni 352 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, si pjesë e pandarë e sistemit institucional bazuar në parimin e kompetencave të deleguara, nuk mund të shërbejë si bazë për zgjerimin e fushës së veprimit të kompetencave të Bashkimit përtej kuadrit të përgjithshëm të krijuar nga dispozitat e Traktateve në tërësi dhe në veçanti nga ato që përcaktojnë detyrat dhe aktivitetet e Bashkimit. Ky nen, në këtë rast, nuk mund të përdoret si bazë për miratimin e dispozitave ndikimi i të cilave në thelb do të ishte ndryshimi i Traktateve pa ndjekur procedurën që parashikohet në to për këtë qëllim.

43. **Deklaratë për nenin 355 pika 6 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Palët e Larta Kontraktuese bien dakord që Këshilli Europian sipas Nenit 355(6) të marrë një vendim që çon në ndryshimin e statusit të Majotës në lidhje me Bashkimin me qëllim që ta bëjë këtë territor një rajon të largët sipas kuptimit të nenit 355(1) dhe nenit 349, kur autoritetet franceze njoftojnë Këshillin Europian dhe Komisionin që kjo gjë lejohet nga evolucioni aktualisht në proces në statusin e brendshëm të ishullit.

B. DEKLARATA NË LIDHJE ME PROTOKOLLET BASHKËLIDHUR TRAKTATEVE

44. Deklaratë për nenin 5 të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian

Konferenca vëren që nëse një Shtet Anëtar ka njoftuar sipas nenit 5 (2) të Protokollit për tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian se nuk dëshiron të marrë pjesë në një propozim ose nismë, ky njoftim mund të tërhiqet në çdo kohë përpara miratimit të masës aë marrë sipas tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit.

45. Deklaratë për nenin 5(2) të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian

Konferenca deklaron që nëse Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda i bëjnë të ditur Këshillit synimin për të mos marrë pjesë në një masë të bazuar në një pjesë të tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit në të cilin ato marrin pjesë, Këshilli zhvillon diskutim të plotë për rrjedhojat e mundshme të -mospjesëmarrjes së atij Shteti Anëtar në atë masë. Ky diskutim brenda Këshillit duhet të zhvillohet nisur nga të dhënat që jep Komisioni në lidhje me marrëdhënien ndërmjet propozimit dhe tërësisë së *legjislacionit* të Shengenit.

46. Deklaratë për nenin 5(3) të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian

Konferenca rikujton që nëse Këshilli nuk merr vendim pas diskutimit të parë në themel të çështjes, Komisioni mund të paraqesë një propozim të ndryshuar për rishqyrtim të mëtejshëm thelbësor nga Këshilli brenda afatit 4mujor.

47. Deklaratë për nenin 5 (3), 4 dhe 5 të Protokollit për tërësinë e legjislacionit të Shengenit të integruar në kuadrin e Bashkimit Europian

Konferenca vëren që kushtet që duhen përcaktuar në vendimin e përmendur në paragrafët 3, 4 ose 5 të nenit 5 të Protokollit për tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit të integruar në kuadër të Bashkimit Europian, mund të përcaktojnë që Shteti Anëtar i interesuar të mbajë pasojat e drejtpërdrejta financiare, nëse ka, të shkaktuara domosdoshmërisht dhe pashmangshmërisht si rezultat i pushimit të pjesëmarrjes së tij në një pjesë ose në të gjithë tërësinë e *legjislacionit* të Shengenit të përmendur në vendimin e Këshillit të marrë sipas nenit 4 të Protokollit në fjalë.

48. Deklaratë në lidhje me Protokollin mbi qëndrimin e Danimarkës

Konferenca vëren që në lidhje me aktet juridike që duhet të miratohen nga Këshilli vetëm ose bashkërisht me Parlamentin Europian dhe që përmbajnë dispozitat e zbatueshme për Danimarkën si dhe dispozita që nuk zbatohen për Danimarkën për shkak se kanë bazë ligjore për të cilën zbatohet Pjesa I e Protokollit mbi qëndrimin e Danimarkës, Danimarka deklaron që nuk do të përdorë të drejtën e saj për të votuar që të pengojë miratimin e dispozitave që nuk janë të zbatueshme për Danimarkën.

Për më tepër, Konferenca vëren që në bazë të Deklaratës së Konferencës për nenin 222, Danimarka deklaron që pjesëmarrja daneze në veprime ose akte juridike sipas nenit 222 të bëhet në përputhje me Pjesën I dhe Pjesën II të Protokollit mbi qëndrimin e Danimarkës.

49. **Deklaratë në lidhje me Italinë**

Konferenca vëren që Protokolli për Italinë shtuar në 1957 në Traktatin Themelues të Komunitetit Ekonomik Europian, ndryshuar me miratimin e Traktatit për Bashkimin Europian, thoshte:

"PALËT E LARTA KONTRAKTUESE,

ME DËSHIRËN për të zgjidhur disa probleme të veçanta në lidhje me Italinë,

KANË RËNË DAKORD PËR dispozitat e mëposhtme që i shtohen këtij Traktati:

SHTETET ANËTARE TË KOMUNITETIT

DUKE PASUR PARASYSH faktin që qeveria italiane është e angazhuar në një program dhjetëvjeçar të zgjerimit ekonomik të përgatitur për të korrigjuar çekuilibrin në strukturën e ekonomisë italiane, sidomos duke siguruar infrastrukturë për zonat më pak të zhvilluara në Italinë e jugut dhe në ishujt italianë dhe duke krijuar vende të reja pune për të eliminuar papunësinë;

KUJTOJNË që parimet dhe objektivat e këtij programi të qeverisë italiane janë konsideruar dhe miratuar nga organizatat për bashkëpunim ndërkombëtar ku Shtetet Anëtare janë anëtare;

PRANOJNË që arritja e objektivave të programit italian është në interesin e tyre të përbashkët;

BIEN DAKORD që për të lehtësuar realizimin e kësaj detyre nga qeveria italiane, t'u rekomandojnë institucioneve të Komunitetit përdorimin e të gjitha metodave dhe procedurave të parashikuara në këtë Traktat dhe, sidomos, përdorimin e duhur të burimeve të Bankës Europiane të Investimeve dhe Fondit Social Europian;

JANË TË MENDIMIT që institucionet e Komunitetit, në zbatim të këtij Traktati, duhet të marrin parasysh përpjekjet e vazhdueshme që duhet të bëhen nga ekonomia italiane në vitet e ardhshme dhe dëshirën për të shmangur tensionin e rrezikshëm sidomos brenda bilancit të pagesave ose nivelit të punësimit, që mund të rrezikojë zbatimin e këtij Traktati në Itali;

PRANOJNË që në rastin e zbatimit të neneve 109 H dhe 109 I, të mbahet parasysh që çdo masë që i kërkohet qeverisë italiane të mos cenojë realizmin e programit të saj për zgjerimin ekonomik dhe për rritjen e standardit të jetesës të popullsisë".

50. **Deklaratë për nenin 10 të Protokollit për dispozitat kalimtare**

Konferenca fton Parlamentin Europian, Këshillin dhe Komisionin, që brenda kompetencave të tyre përkatëse, të kërkojnë, në çështjet e duhura dhe në masën e mundur, brenda periudhës pesë vjeçare të përmendur në nenin 10 (3) të Protokollit për dispozita kalimtare, miratimin e akteve juridike që ndryshojnë ose zëvendësojnë aktet e përmendura në nenin 10(1) të këtij Protokolli.

C. DEKLARATA NGA SHTETET ANËTARE

51. Deklaratë nga Mbretëria e Belgjikës për parlamentet kombëtare

Belgjika dëshiron të bëjë të qartë që, në përputhje me të drejtën e saj kushtetuese, jo vetëm Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati i Parlamentit Federal, por dhe asambletë parlamentare të Komuniteteve dhe Rajoneve të veprojnë, për sa u përket kompetencave të ushtruara nga Bashkimi, si elemente përbërëse të sistemit parlamentar kombëtar ose dhoma të Parlamentit kombëtar.

52. Deklaratë nga Mbretëria e Belgjikës, Republika e Bullgarisë, Republika Federale e Gjermanisë, Republika Helene , Mbretëria e Spanjës, Republika Italiane, Republika e Qipros, Republika e Lituanisë, Dukati i Madh i Luksemburgut, Republika e Hungarisë, Republika e Maltës, Republika e Austrisë, Republika Portugeze, Rumania, Republika e Sllovenisë dhe Republika Sllovake për simbolet e Bashkimit Europian

Belgjika, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Spanja, Italia, Qiproja, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Malta, Austria, Portugalia, Rumania, Sllovenia dhe Republika Sllovake deklarojnë që flamuri me një rreth me dymbëdhjetë yje në një sfond blu, himni bazuar në "Odën e Gëzimit" nga Simfonia e nëntë e Ludwig van Beethoven-it, motoja "Të bashkuar, por të ndryshëm", euroja si monedhë e Bashkimit Europian dhe Dita e Europës më 9 maj do të vazhdojnë të jenë për këto vende simbolet që shprehin ndjenjën e komunitetit të popujve në Bashkimin Europian dhe besnikërinë e tyre ndaj tij.

53. Deklaratë nga Republika Çeke për Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian

1. Republika Çeke rikujton që dispozitat e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian u drejtohen institucioneve dhe organeve të Bashkimit Europian duke respektuar parimin e subsidiaritetit dhe ndarjes së kompetencave ndërmjet Bashkimit Europian dhe Shteteve të tij Anëtare, siç shprehet dhe në Deklaratën (nr. 18) në lidhje me ndarjen e kompetencave. Republika Çeke thekson që dispozitat e saj u drejtohen Shteteve Anëtare vetëm kur zbatojnë të drejtën e Bashkimit, dhe jo kur miratojnë ose zbatojnë të drejtën kombëtare në mënyrë të pavarur nga e drejta e Bashkimit.

2. Republika Çeke thekson gjithashtu që Karta nuk shtrihet në fushën e zbatimit të së drejtës së Bashkimit dhe nuk krijon kompetenca të reja për Bashkimin. Ajo nuk zvogëlon fushën e zbatimit të së drejtës kombëtare dhe nuk kufizon kompetencat ekzistuese të autoriteteve kombëtare në këtë fushë.

3. Republika Çeke thekson që, në masën që Karta pranon të drejta themelore dhe parime që rrjedhin nga tradita kushtetuese e përbashkët për Shtetet Anëtare, këto të drejta dhe parime interpretohen në harmoni me këto tradita.

4. Republika Çeke më tej thekson që asnjë dispozitë në Kartë nuk mund të interpretohet se kufizon ose ndikon negativisht tek të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në formën që njihen këto të drejta, në fushën e tyre përkatëse të zbatimit, nga e drejta e Bashkimit dhe nga marrëveshjet

ndërkombëtare ku Bashkimi ose të gjitha Shtetet Anëtare janë palë, përfshirë dhe Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut si edhe nga Kushtetutat e Shteteve Anëtare.

54. Deklaratë nga Republika Federale e Gjermanisë Irlanda, Republika e Hungarisë Republika e Austrisë dhe Mbretëria e Suedisë

Gjermania, Irlanda, Hungaria, Austria dhe Suedia vënë në dukje që dispozitat bazë të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Bërthamore nuk janë ndryshuar në thelb që me hyrjen e tij në fuqi dhe duhet që të përditësohen. Prandaj ato mbështesin idenë e një Konference të Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare që duhet të thirret sa më shpejt që të jetë e mundur.

55. Deklaratë nga Mbretëria e Spanjës dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

Traktatet zbatohen për Gjibraltarin si një territor europian për marrëdhëniet e jashtme të të cilit është përgjegjës një Shtet Anëtar. Kjo nuk nënkupton ndryshime në qëndrimet përkatëse të Shteteve Anëtare të përfshira.

56. Deklaratë nga Irlanda për nenin 3 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës në lidhje me zonën e lirisë sigurisë dhe drejtësisë

Irlanda shpreh angazhimin e saj ndaj Bashkimit si një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie duke respektuar të drejtat themelore dhe sistemet e traditat e ndryshme ligjore të Shteteve Anëtare brenda të cilave shtetasve u ofrohet nivel i lartë sigurie.

Në këtë mënyrë, Irlanda deklaron synimin e saj të qëndrueshëm për të ushtruar të drejtën e saj sipas nenit 3 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë për të marrë pjesë në miratimin e masave sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit për Funksionim e Bashkimit Europian në masën më të madhe që e gjykon të mundur.

Irlanda, në veçanti merr pjesë në masën më të madhe të mundshme, në masat në fushën e bashkëpunimit policor.

Për më tepër, Irlanda rikujton që në përputhje me nenin 8 të Protokollit mund të informojë Këshillin me shkrim nëse nuk dëshiron më t'u nënshtrohet kushteve të Protokollit. Irlanda synon të rishikojë funksionimin e këtyre masave brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës.

57. Deklaratë nga Republika Italiane për përbërjen e Parlamentit Europian

Italia vëren që sipas nenit 10 dhe 14 të Traktatit për Bashkimin Europian, Parlamenti Europian përbëhet nga përfaqësues të shtetasve të Bashkimit; ky përfaqësim duhet të jetë proporcional në zbritje.

Italia, po kështu merr parasysh që në bazë të nenit 9 të Traktatit për Bashkimin Europian dhe nenit 20 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, çdo shtetas i një Shteti Anëtar është shtetas i Bashkimit.

Prandaj, Italia konsideron që, pa cenuar vendimin për periudhën legjislative 2009-2014, çdo vendim i miratuar nga Këshilli Europian, me nismën e Parlamentit Europian dhe me pëlqimin e tij, që përcakton përbërjen e Parlamentit Europian, duhet të respektojë parimet e përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 14.

58. **Deklaratë nga Republika e Letonisë, Republika e Hungarisë Republika e Maltës për mënyrën se si shkruhet emri i monedhës së vetme në Traktate**

Letonia, Hungaria dhe Malta, pa cenuar mënyrën se si shkruhet emri i monedhës së vetme të Bashkimit Europian të përmendur në Traktate siç paraqitet në kartëmonedha dhe në monedha, deklarojnë që mënyra si shkruhet emri i monedhës së vetme, duke përfshirë derivatet e saj të përdorur në tekstin letonez, hungarez dhe maltez të Traktateve nuk ndikon në rregullat ekzistuese të gjuhëve letoneze, hungareze ose malteze.

59. **Deklaratë nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta për nenin 312 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Mbretëria e Vendeve të Ulëta bie dakord për një vendim si ai i përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 312(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nëse rishikimi i vendimit të përmendur në paragrafin e tretë të nenit 311 të atij Traktati u ofron Vendeve të Ulëta një zgjidhje të kënaqshme për pozicionin e saj negativ të tepërt të pagesave neto *kundrejt* buxhetit të Bashkimit.

60. **Deklaratë nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta për nenin 355 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian**

Mbretëria e Vendeve të Ulëta deklaron që nisma për një vendim të përmendur në nenin 355(6) që synon ndryshimin e statusit të Antileve Holandeze dhe/ose Arubës në lidhje me Bashkimin, paraqitet vetëm në bazë të një vendimi të marrë në përputhje me Kartën për Mbretërinë e Vendeve të Ulëta.

61. **Deklaratë nga Republika e Polonisë për Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian**

Karta nuk prek në asnjë mënyrë të drejtën e Shteteve Anëtare për të nxjerrë ligje në sferën e moralit publik, të drejtës familjare si dhe mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe respektimit të paprekshmërisë morale dhe fizike të njeriut.

62. Deklaratë nga Republika e Polonisë në lidhje me Protokollin për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian në lidhje me Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar

Polonia deklaron që duke pasur parasysh traditën e lëvizjes sociale të "Solidaritetit" dhe kontributin e saj domethënës në përpjekjen për të drejta sociale dhe të punës, respekton plotësisht të drejtat sociale dhe të punës, siç janë përcaktuar nga e drejta e Bashkimit Europian dhe në veçanti ato të drejta të riafirmuara në Titullin IV të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

63. Deklaratë nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për përkufizimin e termit "shtetas"

Në lidhje me Traktatet dhe Traktatin Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Bërthamore dhe çdo akt që rrjedh nga ato Traktate ose i lënë në fuqi nga ato Traktate, Mbretëria e Bashkuar përsërit Deklaratën që ka bërë më 31 dhjetor 1982 për përkufizimin e termit "shtetas" me përjashtimin që fraza "Shtetas nga Territoret në Varësi Britanike" të interpretohet si "shtetasit e territoreve britanike jashtë Europës".

64. Deklaratë nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për të drejtën e votës për zgjedhjet në Parlamentin Europian

Mbretëria e Bashkuar vëren që neni 14 i Traktatit për Bashkimin Europian dhe dispozitat e tjera të Traktateve nuk synojnë të ndryshojnë bazën për të drejtën e votës për zgjedhjet në Parlamentin Europian.

65. Deklaratë nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për nenin 75 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian

Mbretëria e Bashkuar mbështet plotësisht veprimin në lidhje me miratimin e sanksioneve financiare të krijuara për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin dhe aktivitetet që lidhen me të. Prandaj, Mbretëria e Bashkuar deklaron që synon të ushtrojë të drejtën e saj sipas nenit 3 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Irlandës në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë për të marrë pjesë në miratimin e të gjitha propozimeve të bëra sipas nenit 75 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

———

TABELAT E BARASVLERSHMËRISË(*)

Traktati për Bashkimin Europian

Numërtimi i vjetër në Traktatin për Bashkimin Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Bashkimin Europian
TITULLI I – DISPOZITA TË PËRBASHKËTA	TITULLI I – DISPOZITA TË PËRBASHKËTA
Neni 1	Neni 1
	Neni 2
Neni 2	Neni 3
Neni 3 (shfuqizuar) (1)	
	Neni 4
	Neni 5 (2)
Neni 4 (shfuqizuar) (3)	
Neni 5 (shfuqizuar) (4)	
Neni 6	Neni 6
Neni 7	Neni 7
	Neni 8
TITULLI II – DISPOZITA NË NDRYSHIM TË TRAKTATIT THEMELUES TË KOMUNITETIT EKONOMIK EUROPIAN ME SYNIM KRIJIMIN E KOMUNITETIT EUROPIAN	TITULLI II – DISPOZITA PËR PARIMET DEMOKRATIKE
Neni 8 (shfuqizuar) (5)	Neni 9
	Neni 10 (6)

(1) Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 7 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian ("TFBE") dhe nenet 13(1) dhe 21 paragrafi 3, nënparagrafi i dytë i Traktatit për Bashkimin Europian ("TBE").

(2) Zëvendëson nenin 5 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian ("TKE").

(3) Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 15.

(4) Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 13, paragrafi 2.

(5) Neni 8 TBE që ishte në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës (në vijim "ekzistues"), ndryshoi TKE-në. Këto ndryshime janë përfshirë në Traktatin e mëvonshëm dhe neni 8 është shfuqizuar. Numri i tij është përdorur për të futur një dispozitë të re.

(6) Paragrafi 4 zëvendëson në përmbajtje nënparagrafin e parë të nenit 191 TKE.

(*) Tabelat e barasvlershmërisë të përmendura në nenin 5 të Traktatit të Lisbonës. Kolona fillestare në qendër, që paraqiste vendosjen e numrave të ndërmjetëm siç janë përdorur në atë Traktat, është hequr.

Numërtimi i vjetër në Traktatin për Bashkimin Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Bashkimin Europian
	Neni 11
	Neni 12
TITULLI III – DISPOZITA NË NDRYSHIM TË TRAKTATIT THEMELUES TË KOMUNITETIT TË QYMYRGURIT DHE ÇELIKUT	TITULLI III – DISPOZITA PËR INSTITUCIONET
Neni 9 (shfuqizuar) [7]	Neni 13
	Neni 14 [8]
	Neni 15 [9]
	Neni 16 [10]
	Neni 17 [11]
	Neni 18
	Neni 19 [12]
TITULLI IV – DISPOZITA NË NDRYSHIM TË TRAKTATIT THEMELUES TË KOMUNITETIT EUROPIAN TË ENERGJISË ATOMIKE	TITULLI IV – DISPOZITA PËR BASHKËPUNIMIN E PËRFORCUAR
Neni 10 (shfuqizuar) [13] *Nenet 27a deri në 27e (zëvendësuar)* *Nenet 40 deri në 40b (zëvendësuar)* *Nenet 43 deri në 45 (zëvendësuar)*	Neni 20 [14]

[7] Neni ekzistues 9 TBE ndryshoi Traktatin Themelues të Komunitetit Europian të Qymyrgurit dhe Çelikut. Ky i fundit pushoi së vepruari më 23 korrik 2002. Neni 9 është shfuqizuar dhe numri i tij është përdorur për të futur një dispozitë tjetër.

[8] – Paragrafët 1 dhe 2 zëvendësojnë në përmbajtje nenin 189 TKE;
– paragrafët 1 deri në 3 zëvendësojnë në përmbajtje paragrafët 1 deri në 3 të nenit 190 TKE;
– paragrafi 1 zëvendëson në përmbajtje nënparagrafin e parë të nenit 192 TKE;
– paragrafi 4 zëvendëson në përmbajtje nënparagrafin e parë të nenit 197 TKE.

[9] Zëvendëson në përmbajtje nenin 4.

[10] – Paragrafi 1 zëvendëson në përmbajtje nënpikën e parë dhe të dytë të nenit 202 TKE;
– paragrafët 2 dhe 9 zëvendësojnë në përmbajtje nenin 203 TKE;
– paragrafët 4 dhe 5 zëvendësojnë në përmbajtje paragrafët 2 dhe 4 të nenit 205 TKE

[11] – Zëvendëson në përmbajtje nenin 220 TKE.
– nënparagrafi i parë i paragrafit 2 zëvendëson në përmbajtje nënparagrafin e parë të nenit 221 TKE

[12] Zëvendëson gjithashtu nenin 11 dhe 11*a* TKE.

[13] Neni ekzistues 10 TBE ndryshoi Traktatin Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Atomike. Këto ndryshime janë përfshirë në Traktatin e Lisbonës. Neni 10 është shfuqizuar dhe numri i tij është përdorur për të futur një dispozitë tjetër.

[14] Zëvendëson gjithashtu nenin 11 dhe 11*a* TKE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin për Bashkimin Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Bashkimin Europian
TITULLI V – DISPOZITA PËR NJË POLITIKË TË PËRBASHKËT TË JASHTME DHE TË SIGURISË	TITULLI V – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR VEPRIMIN E JASHTËM TË BASHKIMIT DHE DISPOZITA TË VEÇANTA PËR POLITIKËN E PËRBASHKËT TË JASHTME DHE TË SIGURIMIT
	Kreu 1 – Dispozita të përgjithshme për veprimin e jashtëm të Bashkimit
	Neni 21
	Neni 22
	Kreu 2 - Dispozita të veçanta për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit
	Seksioni 1 – Dispozita të përbashkëta
	Neni 23
Neni 11	Neni 24
Neni 12	Neni 25
Neni 13	Neni 26
	Neni 27
Neni 14	Neni 28
Neni 15	Neni 29
Neni 22 (lëvizur)	Neni 30
Neni 23 (lëvizur)	Neni 31
Neni 16	Neni 32
Neni 17 (lëvizur)	Neni 42
Neni 18	Neni 33
Neni 19	Neni 34
Neni 20	Neni 35
Neni 21	Neni 36
Neni 22 (lëvizur)	Neni 30
Neni 23 (lëvizur)	Neni 31
Neni 24	Neni 37

Numërtimi i vjetër në Traktatin për Bashkimin Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Bashkimin Europian
Neni 25	Neni 38
	Neni 49
Neni 47 (lëvizur)	Neni 40
Neni 26 (shfuqizuar)	
Neni 27 (shfuqizuar)	
Neni 27a (zëvendësuar) [15]	Neni 20
Neni 27b (zëvendësuar) [15]	Neni 20
Neni 27c (zëvendësuar) [15]	Neni 20
Neni 27d (zëvendësuar) [15]	Neni 20
Neni 27e (zëvendësuar) [15]	Neni 20
Neni 28	Neni 41
	Seksioni 2 - Dispozita për politikën e përbashkët për sigurimin dhe mbrojtjen
Neni 17 (lëvizur)	Neni 42
	Neni 43
	Neni 44
	Neni 45
	Neni 46
TITULLI VI – DISPOZITA PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR DHE GJYQËSOR NË ÇËSHTJE PENALE (shfuqizuar) [16]	
Neni 29 (zëvendësuar) [17]	
Neni 30 (zëvendësuar) [18]	
Neni 31 (zëvendësuar) [19]	

[15] Nenet ekzistuese 27*a* deri në 27*e* për bashkëpunimin e përforcuar janë zëvendësuar gjithashtu nga nenet 326 deri 334 TFBE.

[16] Dispozitat ekzistuese të Titullit VI të TBE për bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështje penale zëvendësohen nga dispozitat e Kapitujve 1, 4 dhe 5 të titullit IV (rinumëruar V) të Pjesës Tre të TFBE.

[17] Zëvendësuar nga neni 67 TFBE.

[18] Zëvendësuar nga neni 87 dhe 88 TFBE.

[19] Zëvendësuar nga neni 82, 83 dhe 85 TFBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin për Bashkimin Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Bashkimin Europian
Neni 32 (zëvendësuar) [20]	
Neni 33 (zëvendësuar) [21]	
Neni 34 (shfuqizuar	
Neni 35 (shfuqizuar)	
Neni 36 (zëvendësuar) [22]	
Neni 37 (shfuqizuar)	
Neni 38 (shfuqizuar)	
Neni 39 (shfuqizuar)	
Neni 40 (zëvendësuar) [23]	*Neni 20*
Neni 40 A (zëvendësuar) [23]	*Neni 20*
Neni 40 B (zëvendësuar) [23]	*Neni 20*
Neni 41 (shfuqizuar)	
Neni 42 (shfuqizuar)	
TITULLI VII – DISPOZITA PËR BASHKËPUNIMIN E PËRFOCUAR (zëvendësuar)	*TITULLI IV – DISPOZITA PËR BASHKËPUNIMIN E PËRFORCUAR*
Neni 43 (zëvendësuar) [24]	*Neni 20*
Neni 43 A (zëvendësuar) [24]	*Neni 20*
Neni 43 B (zëvendësuar) [24]	*Neni 20*
Neni 44 (zëvendësuar) [24]	*Neni 20*
Neni 44 A (zëvendësuar) [24]	*Neni 20*
Neni 45 (zëvendësuar) [24]	*Neni 20*
TITULLI VIII – DISPOZITA TË FUNDIT	TITULLI VI – DISPOZITA TË FUNDIT
Neni 46 (shfuqizuar)	
	Neni 47

[20] Zëvendësuar nga neni 89 TFBE

[21] Zëvendësuar nga neni 72 TFBE

[22] Zëvendësuar nga neni 71 TFBE.

[23] Nenet ekzistuese 40 deri në 40 për bashkëpunimin e përforcuar janë zëvendësuar gjithashtu nga nenet 326 deri 334 TFBE.

[24] Nenet ekzistuese 43 deri në 45 dhe Titulli VII i TBE për bashkëpunimin e përforcuar janë zëvendësuar gjithashtu nga nenet 326 deri 334 TFBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin për Bashkimin Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Bashkimin Europian
Neni 47 (zëvendësuar)	Neni 40
Neni 48	Neni 48
Neni 49	Neni 49
	Neni 50
	Neni 51
	Neni 52
Neni 50 (shfuqizuar)	
Neni 51	Neni 53
Neni 52	Neni 54
Neni 53	Neni 55

Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
PJESA NJË – PARIMET	PJESA E PARË – PARIMET
Neni 1 (shfuqizuar)	
	Neni 1
Neni 2 (shfuqizuar) [25]	
	Titulli I – Kategoritë dhe fushat e kompetencës së Bashkimit
	Neni 2
	Neni 3
	Neni 4
	Neni 5
	Neni 6
	Titulli II – Dispozita me zbatim të përgjithshëm

[25] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 3 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
	Neni 7
Neni 3, paragrafi 1 (shfuqizuar) [26]	
Neni 3, paragrafi 2	Neni 8
Neni 4 (lëvizur)	Neni 119
Neni 5 (zëvendësuar) [27]	
	Neni 9
	Neni 10
Neni 6	Neni 11
Neni 153, paragrafi 2 (lëvizur)	Neni 12
	Neni 13[28]
Neni 7 (shfuqizuar) [29]	
Neni 8 (shfuqizuar) [30]	
Neni 9 (shfuqizuar)	
Neni 10 (shfuqizuar) [31]	
Neni 11 (zëvendësuar) [32]	Nenet 326 deri në 334
Neni 11*a* (zëvendësuar) [32]	Nenet 326 deri në 334
Neni 12 (lëvizur)	Neni 18
Neni 13 (lëvizur)	Neni 19
Neni 14 (lëvizur)	Neni 26
Neni 15 (lëvizur)	Neni 27
Neni 16	Neni 14
Neni 255 (lëvizur)	Neni 15
Neni 286 (lëvizur)	Neni 16

[26] Zëvendësuar në përmbajtje nga nenet 3 deri në 6 TFBE.

[27] Zëvendësuar nga neni 5 TBE.

[28] Futja e një pjesë operative të protokollit për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve.

[29] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 13 TBE.

[30] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 13 TBE dhe neni 282 paragrafi 1 TFBE.

[31] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 4, paragrafi 3.

[32] Zëvendësuar gjithashtu nga neni 20 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
	Neni 17
PJESA E DYTË – QYTETARIA E BASHKIMIT	PJESA E DYTË – MOSDISKRIMINIMI DHE QYTETARIA E BASHKIMIT
Neni 12 (lëvizur)	Neni 18
Neni 13 (lëvizur)	Neni 19
Neni 17	Neni 20
Neni 18	Neni 21
Neni 19	Neni 22
Neni 20	Neni 23
Neni 21	Neni 24
Neni 22	Neni 25
PJESA E TRETË – POLITIKAT KOMUNITARE	PJESA E TRETË – POLITIKAT DHE VEPRIMET E BRENDSHME TË BASHKIMIT
	Titulli I – Tregu i brendshëm
Neni 14 (lëvizur)	Neni 26
Neni 15 (lëvizur)	Neni 27
Titulli I – Lëvizja e lirë e mallrave	Titulli II – Lëvizja e lirë e mallrave
Neni 23	Neni 28
Neni 24	Neni 29
Kreu 1 – Bashkimi doganor	Kreu 1 – Bashkimi doganor
Neni 25	Neni 30
Neni 26	Neni 31
Neni 27	Neni 32
Pjesa e Tretë, Titulli X, Bashkëpunimi doganor (lëvizur)	Kreu 2– Bashkëpunimi doganor
Neni 135 (lëvizur)	Neni 33
Kreu 2 – Ndalimi i kufizimeve sasiore ndërmjet Shteteve Anëtare	Kreu 3 – Ndalimi i kufizimeve sasiore ndërmjet Shteteve Anëtare
Neni 28	Neni 34

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 29	Neni 35
Neni 30	Neni 36
Neni 31	Neni 37
Titulli II – Bujqësia	Titulli III – Bujqësia dhe peshkimi
Neni 32	Neni 38
Neni 33	Neni 39
Neni 34	Neni 40
Neni 35	Neni 41
Neni 36	Neni 42
Neni 37	Neni 43
Neni 38	Neni 44
Titulli III – Lëvizja e lirë e personave, shërbimeve dhe kapitaleve	Titulli IV – Lëvizja e lirë e personave, shërbimeve dhe kapitaleve
Kreu 1 – Punonjësit	Kreu 1 – Punonjësit
Neni 39	Neni 45
Neni 40	Neni 46
Neni 41	Neni 47
Neni 42	Neni 48
Kreu 2 – E drejta e vendosjes	Kreu 2 – E drejta e vendosjes
Neni 43	Neni 49
Neni 44	Neni 50
Neni 45	Neni 51
Neni 46	Neni 52
Neni 47	Neni 53
Neni 48	Neni 54
Neni 294 (lëvizur)	Neni 55
Kreu 3 – Shërbimet	Kreu 3 – Shërbimet
Neni 49	Neni 56

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
Neni 50	Neni 57
Neni 51	Neni 58
Neni 52	Neni 59
Neni 53	Neni 60
Neni 54	Neni 61
Neni 55	Neni 62
Kreu 4 – Kapitali dhe pagesat	Kreu 4 – Kapitali dhe pagesat
Neni 56	Neni 63
Neni 57	Neni 64
Neni 58	Neni 65
Neni 59	Neni 66
Neni 60 (lëvizur)	*Neni 75*
Titulli IV – Vizat, azili, imigracioni dhe politika të tjera në lidhje me lëvizjen e lirë të personave	Titulli V – Zona e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë
	Kreu 1 – Dispozita të përgjithshme
Neni 61	Neni 67 [33]
	Neni 68
	Neni 69
	Neni 70
	Neni 71[34]
Neni 64, paragrafi 1 (zëvendësuar)	Neni 72[35]
	Neni 73
Neni 66 (zëvendësuar)	Neni 74
Neni 60 (lëvizur)	Neni 75
	Neni 76

[33] Zëvendëson gjithashtu nenin ekzistues 29 TBE.

[34] Zëvendëson nenin ekzistues 36 TBE.

[35] Zëvendëson gjithashtu nenin ekzistues 33 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
	Kreu 2 – Politika për kontrollet kufitare, azilin dhe imigrimin
Neni 62	Neni 77
Neni 63, pikat 1 dhe2 dhe neni 64, paragrafi 2[36]	Neni 78
Neni 63, pikat 3 dhe 4	Neni 79
	Neni 80
Neni 64, paragrafi 1 (zëvendësuar)	*Neni 72*
	Kreu 3 – Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile
Neni 65	Neni 81
Neni 66 (zëvendësuar)	*Neni 74*
Neni 67 (shfuqizuar)	
Neni 68 (shfuqizuar)	
Neni 69 (shfuqizuar)	
	Kreu 4 – Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale
	Neni 82 [37]
	Neni 83 [37]
	Neni 84
	Neni 85 [37]
	Neni 86
	Kreu 5 – Bashkëpunimi policor
	Neni 87 [38]
	Neni 88 [38]
	Neni 89 [39]

[36] Pikat 1 dhe 2 të nenit 63 KE zëvendësohen nga paragrafët 1 dhe 2 të nenit 78 TFBE dhe paragrafët 2 të nenit 64 zëvendësohet nga paragrafi 3 i nenit 78 TFBE.

[37] Zëvendëson nenin ekzistues 31 TBE.

[38] Zëvendëson nenin ekzistues 30 TBE.

[39] Zëvendëson nenin ekzistues 32 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
Titulli V – Transporti	Titulli VI – Transporti
Neni 70	Neni 90
Neni 71	Neni 91
Neni 72	Neni 92
Neni 73	Neni 93
Neni 74	Neni 94
Neni 75	Neni 95
Neni 76	Neni 96
Neni 77	Neni 97
Neni 78	Neni 98
Neni 79	Neni 99
Neni 80	Neni 100
Titulli VI – Rregullat e përbashkëta për konkurrencën, tatimet dhe përafrimin e legjislacionit	Titulli VII – Rregullat e përbashkëta për konkurrencën, tatimet dhe përafrimin e legjislacionit
Kreu 1 – Rregullat për konkurrencën	Kreu 1 – Rregullat për konkurrencën
Seksioni 1 – Rregullat që zbatohen për ndërmarrjet	Seksioni 1 – Rregullat që zbatohen për ndërmarrjet
Neni 81	Neni 101
Neni 82	Neni 102
Neni 83	Neni 103
Neni 84	Neni 104
Neni 85	Neni 105
Neni 86	Neni 106
Seksioni 2 – Ndihmat që japin Shtetet	Seksioni 2 – Ndihmat që japin Shtetet
Neni 87	Neni 107
Neni 88	Neni 108
Neni 89	Neni 109
Kreu 2 – Dispozitat tatimore	*Kreu 2 – Dispozitat tatimore*

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
Neni 90	Neni 110
Neni 91	Neni 111
Neni 92	Neni 112
Neni 93	Neni 113
Kreu 3 – Përafrimi i *legjislacionit*	*Kreu 3 – Përafrimi i legjislacionit*
Neni 95 (lëvizur)	Neni 114
Neni 94 (lëvizur)	Neni 115
Neni 96	Neni 116
Neni 97	Neni 117
	Neni 118
Titulli VII – Politika ekonomike dhe monetare	*Titulli VIII – Politika ekonomike dhe monetare*
Neni 4 (lëvizur)	Neni 119
Kreu 1 – Politika ekonomike	*Kreu 1 – Politika ekonomike*
Neni 98	Neni 120
Neni 99	Neni 121
Neni 100	Neni 122
Neni 101	Neni 123
Neni 102	Neni 124
Neni 103	Neni 125
Neni 104	Neni 126
Kreu 2 – politika monetare	*Kreu 2 – politika monetare*
Neni 105	Neni 127
Neni 106	Neni 128
Neni 107	Neni 129
Neni 108	Neni 130
Neni 109	Neni 131
Neni 110	Neni 132

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 111, paragrafët 1 deri në 3 dhe 5 (lëvizur)	Neni 219
Neni 111, paragrafi 4 (lëvizur)	Neni 138
	Neni 133
Kreu 3 – Dispozita institucionale	Kreu 3 – Dispozita institucionale
Neni 112 (lëvizur)	Neni 283
Neni 113 (lëvizur)	Neni 284
Neni 114	Neni 134
Neni 115	Neni 135
	Kreu 4 – Dispozita specifike për ato Shtete Anëtare monedha e të cilave është euroja
	Neni 136
	Neni 137
Neni 111, paragrafi 4 (lëvizur)	Neni 138
Kreu 4 – Dispozita kalimtare	Kreu 5 – Dispozita kalimtare
Neni 116 (shfuqizuar)	
	Neni 139
Neni 117, paragrafët 1, 2, nënpika e gjashtë dhe 3 deri në 9 (shfuqizuar)	
Neni 117, paragrafi 2, pesë nënpikat e para (lëvizur)	Neni 141, paragrafi 2
Neni 121, paragrafi 1 (lëvizur) *Neni 122, paragrafi 2, fjalia e dytë (lëvizur)* *Neni 123, paragrafi 5 (lëvizur)*	Neni 140 [40]
Neni 118 (shfuqizuar)	
Neni 123, paragrafi 3 (lëvizur) *Neni 117, paragrafi 2, pesë nënpikat e para (lëvizur)*	Neni 141 [41]

[40] – Neni 140, paragrafi 1 merr formulimin e paragrafit 1 të nenit 121.
– Neni 140, paragrafi 2 merr formulimin e fjalisë së dytë të paragrafit 2 të nenit 122.
– Neni 140, paragrafi 3 merr formulimin e paragrafit 5 të nenit 123.

[41] – Neni 141, paragrafi 1 merr formulimin e paragrafit 3 të nenit 123.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
Neni 124, paragrafi 1 (lëvizur)	Neni 142
Neni 119	Neni 143
Neni 120	Neni 144
Neni 121, paragrafi 1 (lëvizur)	*Neni 140, paragrafi 1*
Neni 121, paragrafët 2 deri në 4 (shfuqizuar)	
Neni 122, paragrafët 1, 2, fjalia e parë, 3, 4, 5 dhe 6 (shfuqizuar)	
Neni 122, paragrafi 2, fjalia e dytë (lëvizur)	*Neni 140, paragrafi 2, nënparagrafi i parë*
Neni 123, paragrafët 1, 2 dhe 4 (shfuqizuar)	
Neni 123, paragrafi 3 (lëvizur)	*Neni 141, paragrafi 1*
Neni 123, paragrafi 5 (lëvizur)	*Neni 140, paragrafi 3*
Neni 124, paragrafi 1 (lëvizur)	*Neni 142*
Neni 124, paragrafi 2 (shfuqizuar)	
Titulli VIII – Punësimi	*Titulli IX – Punësimi*
Neni 125	Neni 145
Neni 126	Neni 146
Neni 127	Neni 147
Neni 128	Neni 148
Neni 129	Neni 149
Neni 130	Neni 150
Titulli IX – Politika e përbashkët tregtare (lëvizur)	*Pjesa e Pestë, Titulli II, politika e përbashkët tregtare*
Neni 131 (lëvizur)	*Neni 206*
Neni 132 (shfuqizuar)	
Neni 133 (lëvizur)	*Neni 207*
Neni 134 (shfuqizuar)	
Titulli X – Bashkëpunimi doganor (lëvizur)	*Pjesa e Tretë, Titulli II, Kreu 2, Bashkëpunimi doganor*

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 135 (lëvizur)	Neni 33
Titulli XI – Politika sociale, arsimi, formimi profesional dhe rinia	Titulli XI– Politika Sociale
Kreu 1 – Dispozita sociale (shfuqizuar)	
Neni 136	Neni 151
	Neni 152
Neni 137	Neni 153
Neni 138	Neni 154
Neni 139	Neni 155
Neni 140	Neni 156
Neni 141	Neni 157
Neni 142	Neni 158
Neni 143	Neni 159
Neni 144	Neni 160
Neni 145	Neni 161
Kreu 2 – Fondi Social Europian	Titulli XI – Fondi Social Europian
Neni 146	Neni 162
Neni 147	Neni 163
Neni 148	Neni 164
Kreu 3 – Arsimi, formimi profesional dhe rinia	Titulli XII – Arsimi, formimi profesional, rinia dhe sporti
Neni 149	Neni 165
Neni 150	Neni 166
Titulli XII – Kultura	Titulli XIII – Kultura
Neni 151	Neni 167
Titulli XIII – Shëndeti publik	Titulli XIV – Shëndeti publik
Neni 152	Neni 168
Titulli XIV – Mbrojtja e konsumatorit	Titulli XV – Mbrojtja e konsumatorit

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 153, paragrafët 1, 3, 4 dhe 5	Neni 169
Neni 153, paragrafi 2 (lëvizur)	*Neni 12*
Titulli XV – Rrjetet trans-europiane	Titulli XVI – Rrjetet trans-europiane
Neni 154	Neni 170
Neni 155	Neni 171
Neni 156	Neni 172
Titulli XVI – Industria	Titulli XVII – Industria
Neni 157	Neni 173
Titulli XVII – Kohezioni ekonomik dhe social	Titulli XVIII – Kohezioni ekonomik social dhe territorial
Neni 158	Neni 174
Neni 159	Neni 175
Neni 160	Neni 176
Neni 161	Neni 177
Neni 162	Neni 178
Titulli XVIII – Kërkimi dhe zhvillimi teknologjik	Titulli XIX – Kërkimi dhe zhvillimi teknologjik dhe hapësira
Neni 163	Neni 179
Neni 164	Neni 180
Neni 165	Neni 181
Neni 166	Neni 182
Neni 167	Neni 183
Neni 168	Neni 184
Neni 169	Neni 185
Neni 170	Neni 186
Neni 171	Neni 187
Neni 172	Neni 188
	Neni 189

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
Neni 173	Neni 190
Titulli XIX – Mjedisi	Titulli XX – Mjedisi
Neni 174	Neni 191
Neni 175	Neni 192
Neni 176	Neni 193
	Titulli XXI – Energjetika
	Neni 194
	Titulli XXII – Turizmi
	Neni 195
	Titulli XXIII – Mbrojtja civile
	Neni 196
	Titulli XXI – Bashkëpunimi administrativ
	Neni 197
Titulli XX – Bashkëpunimi për zhvillim (lëvizur)	*Pjesa e Pestë, Titulli III, Kreu 1, Bashkëpunimi për zhvillim*
Neni 177 (lëvizur)	*Neni 208*
Neni 178 (shfuqizuar) [42]	
Neni 179 (lëvizur)	*Neni 209*
Neni 180 (lëvizur)	*Neni 210*
Neni 181 (lëvizur)	*Neni 211*
Titulli XXI – Bashkëpunimi ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta (lëvizur)	*Pjesa e Pestë, Titulli III, Kreu 2, Bashkëpunimi ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta*
Neni 181 *a* (lëvizur)	*Neni 212*
PJESA KATËR – ASOCIIMI I VENDEVE DHE TERRITOREVE JASHTË EUROPËS	PJESA KATËR – ASOCIIMI I VENDEVE DHE TERRITOREVE JASHTË EUROPËS
Neni 182	Neni 198
Neni 183	Neni 199

[42] Zëvendësuar në përmbajtje nga fjalia e dytë e nënparagrafit të dytë të paragrafit 1 të nenit 208 TFEU.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 184	Neni 200
Neni 185	Neni 201
Neni 186	Neni 201
Neni 187	Neni 203
Neni 188	Neni 204
	PJESA PESË – VEPRIMI I JASHTËM I BASHKIMIT
	Titulli 1 – Dispozita të përgjithshme për veprimin e jashtëm të Bashkimit
	Neni 205
Pjesa e Tretë, Titulli IX, Politika e përbashkët tregtare (lëvizur)	Titulli II – Politika e përbashkët tregtare
Neni 131 (lëvizur)	Neni 206
Neni 133 (lëvizur)	Neni 207
	Titulli III – Bashkëpunimi me vendet e treta dhe ndihma humanitare
Pjesa Tre, Titulli XX, Bashkëpunimi për zhvillim (lëvizur)	Kreu 1 – Bashkëpunimi për zhvillim
Neni 177 (lëvizur)	Neni 208[43]
Neni 179 (lëvizur)	Neni 209
Neni 180 (lëvizur)	Neni 210
Neni 181 (lëvizur)	Neni 211
Pjesa Tre, Titulli XXI Bashkëpunimi ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta (lëvizur)	Kreu 2 – Bashkëpunimi ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta
Neni 181a (lëvizur)	Neni 212
	Neni 213
	Kreu 3 – Ndihma humanitare
	Neni 214
	Titulli IV – Masat kufizuese

[43] Fjalia e dytë e nënparagrafit të dytë të paragrafit 1 zëvendëson në përmbajtje nenin 178 TKE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 301 (zëvendësuar)	Neni 215
	Titulli V – Marrëveshjet ndërkombëtare
	Neni 216
Neni 310 (lëvizur)	Neni 217
Neni 300 (zëvendësuar)	Neni 218
Neni 111, paragrafët 1 deri në 3 dhe 5 (lëvizur)	Neni 219
	Titulli VI – Marrëdhëniet e Bashkimit me organizatat ndërkombëtare dhe vendet e treta dhe delegacionet e Bashkimit
Nenet 302 deri në 304 (zëvendësuar)	Neni 220
	Neni 221
	Titulli VII – Klauzola e solidaritetit
	Neni 222
PJESA E PESTË – INSTITUCIONET E KOMUNITETIT	PJESA E GJASHTË – DISPOZITA INSTITUCIONALE DHE FINANCIARE
Titulli I – Dispozita institucionale	Titulli I – Dispozita institucionale
Kreu 1 – Institucionet	Kreu 1 – Institucionet
Seksioni 1 – Parlamenti Europian	Seksioni 1 – Parlamenti Europian
Neni 189 (shfuqizuar) [44]	
Neni 190, paragrafët 1 deri në 3 (shfuqizuar) [45]	
Neni 190, paragrafët 4 dhe 5	Neni 223
Neni 191, paragrafi i parë (shfuqizuar) [46]	
Neni 191, paragrafi i dytë	Neni 224
Neni 192, paragrafi i parë (shfuqizuar) [47]	
Neni 192, paragrafi i dytë	Neni 225
Neni 193	Neni 226

[44] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 14, paragrafët 1 dhe 2 TBE.

[45] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 14, paragrafët 1 deri në 3 TBE.

[46] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 11, paragrafi 4 TBE.

[47] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 14, paragrafi 1 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 194	Neni 227
Neni 195	Neni 228
Neni 196	Neni 229
Neni 197, paragrafi i parë (shfuqizuar) [48]	
Neni 197, paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt	Neni 230
Neni 198	Neni 231
Neni 199	Neni 232
Neni 200	Neni 233
Neni 201	Neni 234
	Seksioni 2 – Këshilli Europian
	Neni 235
	Neni 236
Seksioni 2 – Këshilli	Seksioni 3 – Këshilli
Neni 202 (shfuqizuar) [49]	
Neni 203 (shfuqizuar) [50]	
Neni 204	Neni 237
Neni 205, paragrafët2 dhe 4 (shfuqizuar) [51]	
Neni 205, paragrafët 1 dhe 3	Neni 238
Neni 206	Neni 239
Neni 207	Neni 240
Neni 208	Neni 241
Neni 209	Neni 242
Neni 210	Neni 243
Seksioni 3 – Komisioni	Seksioni 4 – Komisioni

[48] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 14, paragrafi 4 TBE.

[49] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 16 paragrafi 1 i TBE dhe neni 290 dhe 291 TFBE.

[50] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 16, paragrafët 2 dhe 9 TBE.

[51] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 16, paragrafët4 dhe 5 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
Neni 211 (shfuqizuar) [52]	
	Neni 244
Neni 212 (lëvizur)	*Neni 249, paragrafi 2*
Neni 213	Neni 245
Neni 214 (shfuqizuar) [53]	
Neni 215	Neni 246
Neni 216	Neni 247
Neni 217, paragrafët 1, 3 dhe 4 (shfuqizuar) [54]	
Neni 217, paragrafi 2	Neni 248
Neni 218, paragrafi 1 (shfuqizuar) [55]	
Neni 218, paragrafi 2	Neni 249
Neni 219	Neni 250
Seksioni 4 – Gjykata e Drejtësisë	Seksioni 5 – Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian
Neni 220 (shfuqizuar) [56]	
Neni 221, paragrafi i parë (shfuqizuar) [57]	
Neni 221, paragrafi i dytë dhe i tretë	Neni 251
Neni 222	Neni 252
Neni 223	Neni 253
Neni 224 [58]	Neni 254
	Neni 255
Neni 225	Neni 256
Neni 225a	Neni 257

[52] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 17, paragrafi 1 TBE.

[53] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 17, paragrafët 3 dhe 7 TBE.

[54] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 17, paragrafi 6 TBE.

[55] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 295 TFBE.

[56] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 19 TBE.

[57] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 19, paragrafi 2, nënparagrafi i parë i TBE.

[58] Fjalia e parë e nënparagrafit të parë zëvendësohet në përmbajtje nga neni 19, paragrafi 2, paragrafi i dytë i TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 226	Neni 258
Neni 227	Neni 259
Neni 228	Neni 260
	Neni 261
Neni 229a	Neni 262
Neni 230	Neni 263
Neni 231	Neni 264
Neni 232	Neni 265
Neni 233	Neni 266
Neni 234	Neni 267
Neni 235	Neni 268
	Neni 269
Neni 236	Neni 270
Neni 237	Neni 271
Neni 238	Neni 272
Neni 239	Neni 273
Neni 240	Neni 274
	Neni 275
	Neni 276
Neni 241	Neni 277
Neni 242	Neni 278
Neni 243	Neni 279
Neni 244	Neni 280
Neni 245	Neni 281
	Seksioni 6 – Banka Qendrore Europiane
	Neni 282
Neni 112 (lëvizur)	Neni 283

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 113 (lëvizur)	Neni 284
Seksioni 5 – Gjykata e Audituesve	Seksioni 7 – Gjykata e Audituesve
Neni 246	Neni 285
Neni 247	Neni 286
Neni 248	Neni 287
Kreu 2 – Dispozita të përbashkëta për disa institucione	Kreu 2 – Aktet juridike të Bashkimit, procedurat e miratimit dhe dispozita të tjera
	Seksioni 1 – Aktet juridike të Bashkimit
Neni 249	Neni 288
	Neni 289
	Neni 290 [59]
	Neni 291[59]
	Neni 292
	Seksioni 2 – Procedura për miratimin e akteve dhe dispozitave të tjera
Neni 250	Neni 293
Neni 251	Neni 294
Neni 252 (shfuqizuar)	
	Neni 295
Neni 253	Neni 296
Neni 254	Neni 297
	Neni 298
Neni 255 (lëvizur)	*Neni 15*
Neni 256	Neni 299
	Kreu 3 – Organet këshillimore të Bashkimit
	Neni 300
Kreu 3 – Komiteti Ekonomik dhe Social	Seksioni 1 – Komiteti Ekonomik dhe Social

[59] Zëvendëson në thelb nënpikën e tretë të nenit 202 TKE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 257 (shfuqizuar) [60]	
Neni 258, paragrafi i parë, i dytë dhe i katërt	Neni 301
Neni 258, paragrafi i tretë (shfuqizuar) [61]	
Neni 259	Neni 302
Neni 260	Neni 303
Neni 261 (shfuqizuar)	
Neni 262	Neni 304
Kreu 4 – Komiteti i Rajoneve	Seksioni 2 – Komiteti i Rajoneve
Neni 263, paragrafi i parë dhe i pestë (shfuqizuar) [62]	
Neni 263, paragrafi nga i dytë deri në të katërtin	Neni 305
Neni 264	Neni 306
Neni 265	Neni 307
Kreu 5 – Banka Europiane e Investimeve	Kreu 4 – Banka Europiane e Investimeve
Neni 266	Neni 308
Neni 267	Neni 309
Titulli II – Dispozita financiare	Titulli II – Dispozita financiare
Neni 268	Neni 310
	Kreu 1 – Burimet e veta të Bashkimit
Neni 269	Neni 311
Neni 270 (shfuqizuar) [63]	
	Kreu 2 – Kuadri financiar shumëvjeçar
	Neni 312
	Kreu 3 – Buxheti vjetor i Bashkimit

[60] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 300, paragrafi 2 i TFBE.

[61] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 300, paragrafi 4 i TFBE.

[62] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 300, paragrafët 3 dhe 4 TBE.

[63] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 310, paragrafi 4 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 272, paragrafi 1 (lëvizur)	Neni 313
Neni 271 (lëvizur)	*Neni 316*
Neni 272, paragrafi 1 (lëvizur)	*Neni 313*
Neni 272, paragrafët 2 deri në 10	Neni 314
Neni 273	Neni 315
Neni 271 (lëvizur)	Neni 316
	Kreu 4 – Zbatimi i buxhetit dhe aprovimi i realizimit
Neni 274	Neni 317
Neni 275	Neni 318
Neni 276	Neni 319
	Kreu 5 – Dispozita të përbashkëta
Neni 277	Neni 320
Neni 278	Neni 321
Neni 279	Neni 322
	Neni 323
	Neni 324
	Kreu 6 – Lufta kundër krimit ekonomik
Neni 280	Neni 325
	Titulli III – Bashkëpunimi i përforcuar
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 326 [64]
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 327 [64]
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 328 [64]
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 329 [64]
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 330 [64]
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 331 [64]
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 332 [64]

[64] Zëvendëson gjithashtu nenet ekzistuese 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b*, dhe 43 deri në 45 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	**Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian**
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 333[64]
Nenet 11 dhe 11a (zëvendësuar)	Neni 334[64]
PJESA E GJASHTË – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE TË FUNDIT	PJESA SHTATË – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE TË FUNDIT
Neni 281 (shfuqizuar)[65]	
Neni 282	Neni 335
Neni 283	Neni 336
Neni 284	Neni 337
Neni 285	Neni 338
Neni 286 (zëvendësuar)	*Neni 1*
Neni 287	Neni 339
Neni 288	Neni 340
Neni 289	Neni 341
Neni 290	Neni 342
Neni 291	Neni 343
Neni 292	Neni 344
Neni 293 (shfuqizuar)	
Neni 294 (lëvizur)	*Neni 55*
Neni 295	Neni 345
Neni 296	Neni 346
Neni 297	Neni 347
Neni 298	Neni 348
Neni 299, paragrafi 1 (shfuqizuar)[66]	
Neni 299, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, i tretë dhe i katërt	Neni 349
Neni 299, paragrafi 2, nënparagrafi i parë, si dhe paragrafët nga 3 deri në 6 (lëvizur)	*Neni 355*

[64] Zëvendëson gjithashtu nenet ekzistuese 27*a* deri në 27*e*, 40 deri në 40*b*, dhe 43 deri në 45 TBE.

[65] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 47 TBE.

[66] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 52 TBE.

Numërtimi i vjetër në Traktatin Themelues të Komunitetit Europian	Numërtimi i ri në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian
Neni 300 (zëvendësuar)	*Neni 218*
Neni 301 (zëvendësuar)	*Neni 215*
Neni 302 (zëvendësuar)	*Neni 220*
Neni 303 (zëvendësuar)	*Neni 220*
Neni 304 (zëvendësuar)	*Neni 220*
Neni 305 (shfuqizuar)	
Neni 306	Neni 350
Neni 307	Neni 351
Neni 308	Neni 352
	Neni 353
Neni 309	Neni 354
Neni 310 (lëvizur)	*Neni 217*
Neni 311 (shfuqizuar) [67]	
Neni 299, paragrafi 2, nënparagrafi i parë, si dhe paragrafët 3 deri në 6 (lëvizur)	Neni 355
Neni 312	Neni 356
Dispozita të fundit	
Neni 313	Neni 357
	Neni 358
Neni 314 (shfuqizuar) [68]	

[67] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 51 TBE.

[68] Zëvendësuar në përmbajtje nga neni 55 TBE.

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE E BASHKIMIT EUROPIAN

Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni e shpallin solemnisht tekstin e mëposhtëm si Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian.

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE E BASHKIMIT EUROPIAN

PREAMBULA

Popujt e Europës, për krijimin e një bashkimi gjithnjë e më të afërt mes tyre, janë të vendosur që të ndajnë së bashku një të ardhme në paqe, bazuar në vlera të përbashkëta.

I vetëdijshëm për trashëgiminë e tij shpirtërore dhe morale, Bashkimi i ka rrënjët tek vlerat e pandashme dhe universale të dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë dhe solidaritetit; ai bazohet në parimet e demokracisë dhe të sundimit të së drejtës. Bashkimi e vendos individin në qendër të veprimtarive të veta përmes krijimit të shtetësisë së Bashkimit dhe të një zone lirie, sigurie dhe drejtësie.

Bashkimi kontribuon për ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave të përbashkëta duke respektuar njëkohësisht larminë e kulturave dhe traditave të popujve të Europës, identitetet kombëtare të Shteteve Anëtare si edhe organizimin e autoriteteve të tyre publike në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor; ai përpiqet të nxisë një zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm si edhe të garantojë lëvizjen e lirë të personave, shërbimeve, mallrave dhe kapitalit, si edhe lirinë e vendosjes.

Për këtë qëllim, është e nevojshme që të forcohet mbrojtja e të drejtave themelore duke marrë parasysh ndryshimet në shoqëri, përparimin shoqëror si edhe zhvillimet shkencore dhe teknologjike duke i bërë këto të drejta më të dukshme në një Kartë.

Duke mbajtur parasysh kompetencat dhe detyrat e Bashkimit si edhe parimin e subsidaritetit, kjo Kartë ripohon të drejtat që rrjedhin sidomos prej traditave kushtetuese dhe detyrimeve ndërkombëtare që janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare prej Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kartave Sociale të miratuara nga Bashkimi dhe nga Këshilli i Europës si edhenga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Karta interpretohet, në këtë kontekst, prej gjykatave të Bashkimit dhe të Shteteve Anëtare duke pasur parasysh shpjegimet e përgatitura nën autoritetin e Presidiumit të Konventës që e hartoi këtë Kartë dhe të përditësuara nën përgjegjësinë e Presidiumit të Konventës Europiane.

Gëzimi i këtyre të drejtave mbart përgjegjësi dhe detyra kundrejt personave të tjerë, bashkësisë njerëzore dhe brezave të ardhshëm.

Prandaj, Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e parashtruara si më poshtë vijon.

TITULLI I

DINJITETI

Neni 1

Dinjiteti njerëzor

Dinjiteti njerëzor është i padhunueshëm. Ai duhet të respektohet dhe të mbrohet.

Neni 2

E drejta e jetës

1. Kushdo ka të drejtën për jetën.

2. Askush nuk mund të dënohet me vdekje apo të ekzekutohet.

Neni 3

E drejta për integritetin e njeriut

1. Kushdo ka të drejtën e integritetit të tij ose saj fizik dhe mendor.

2. Në fushën e mjekësisë dhe të biologjisë respektohet në veçanti:

(a) pëlqimi i lirë dhe me dijeni të plotë i personit të interesuar, sipas procedurave të parashikuara me ligj

(b) ndalimi i praktikave eugjenike, në veçanti ato që kanë për qëllim përzgjedhjen e personave;

(c) ndalimi i përdorimit të trupit të njeriut dhe pjesëve të tij përbërëse në burim përfitimi financiar;

(d) ndalimi i klonimit riprodhues të qenieve njerëzore.

Neni 4

Ndalimi i torturës dhe i trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose degradues

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, trajtimit apo dënimit çnjerëzor dhe degradues.

Neni 5

Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar

1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri apo robëri.

2. Askush nuk mund të shtrëngohet që të kryejë punë të detyruar apo të detyrueshme.

3. Ndalohet trafikimi i qenieve njerëzore.

TITULLI II

LIRITË

Neni 6

E drejta për liri dhe siguri

Kushdo ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale.

Neni 7

Respektimi i jetës private dhe familjare

Kushdo ka të drejtën e respektimit të jetës së tij ose të saj private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Kushdo ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të tij ose të saj.

2. Është e detyrueshme që të dhënat personale të përpunohen në mënyrë të ndershme, për qëllime të caktuara dhe mbi bazën e pëlqimit të personit të interesuar apo mbi baza të tjera legjitime të parashikuara në ligj. Kushdo ka të drejtën e aksesit në të dhënat , të cilat janë mbledhur për të,dhe të drejtën t‘i korrigjojë ato.

3. Respektimi i këtyre rregullave i nënshtrohet kontrollit nga një autoritet i pavarur.

Neni 9

E drejta për t‘u martuar dhe për të krijuar familje

E drejta për t’u martuar dhe për të krijuar familje garantohet në përputhje me ligjet kombëtare që rregullojnë ushtrimin e këtyre të drejtave.

Neni 10

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

1. Kushdo ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë nënkupton lirinë për ta ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë për t'i manifestuar ato në mënyrë individuale ose kolektive, publike ose private nëpërmjet kultit, mësimit, praktikimit dhe kryerjes së riteve.

2. E drejta e mospranimit, për arsye ndërgjegjeje, për të kryer shërbimin ushtarak njihet në përputhje me ligjet kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.

Neni 11

Liria e shprehjes dhe e informimit

1. Kushdo ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit si edhe për të marrë e për të dhënë informacion dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë.

2. Liria dhe pluralizmi i medias respektohen.

Neni 12

E drejta e tubimit dhe e bashkimit

1. Kushdo ka të drejtën e lirisë për tubim paqësor dhe për t'u bashkuar në të gjitha nivelet, sidomos për çështjet politike, sindikale dhe qytetare, çka nënkupton të drejtën e secilit për të krijuar dhe për t'u anëtarësuar në sindikata për mbrojtjen e interesave të tij ose saj.

2. Partitë politike në nivel të Bashkimit kontribuojnë për shprehjen e vullnetit politik të shtetasve të tij.

Neni 13

Liria për artin dhe shkencën

Arti dhe kërkimi shkencor janë të pakufizuara. Liria akademike respektohet.

Neni 14

E drejta për arsimim

1. Kushdo ka të drejtë të arsimohet dhe të ketë akses tek trajnimi apo formimi profesional dhe i vazhdueshëm.

2. Kjo e drejtë përfshin mundësinë për të kryer falas arsimin e detyrueshëm.

3. Liria për të themeluar institucione arsimore që respektojnë parimet demokratike si dhe e drejta e prindërve për t'u garantuar fëmijëve të tyre arsimimin dhe mësimdhënien në përputhje me besimin e tyre fetar, filozofik dhe pedagogjik, respektohet në përputhje me ligjet kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj lirie dhe të drejte.

Neni 15

E drejta për të zgjedhur profesionin dhe e drejta për punën

1. Kushdo ka të drejtë që të punojë dhe të ushtrojë një profesion që e ka zgjedhur ose pranuar lirisht.

2. Çdo qytetar i Bashkimit është i lirë të kërkojë punë, të punojë, të ushtrojë lirinë e vendosjes dhe të ofrojë shërbime në cilindo Shtet Anëtar.

3. Shtetasit e vendeve të treta të cilët kanë leje të punojnë në territorret e Shteteve Anëtare gëzojnë të njëjtat kushte pune si edhe shtetasit e Bashkimit.

Neni 16

Liria e sipërmarrjes

Liria e sipërmarrjes njihet në përputhje me të drejtën e Bashkimit, të ligjeve dhe praktikavekombëtare.

Neni 17

E drejta e pronës

1. Kushdo ka të drejtën të zotërojë, të përdorë, të disponojë ose të lërë trashëgimi pronën e tij të fituar në mënyrë të ligjshme. Askush nuk mund të shpronësohet përveçse në rastet e interesit publik dhe, sipas kushteve të parashikuara me ligj, përkundrejt një kompensimi të drejtë për humbjen që duhet të paguhet brenda një kohe të arsyeshme. Përdorimi i pronës mund të rregullohet me ligj për aq sa kjo është e nevojshme për interesin e përgjithshëm.

2. Prona intelektuale mbrohet.

Neni 18

E drejta për të kërkuar strehim

E drejta për strehim] garantohet në përputhje me rregullat e Konventës së Gjenevës datë 28.07.1951 dhe Protokollit datë 31.01.1967 për statusin e refugjatëve dhe në përputhje me Traktatin për Bashkimin Europian dhe Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian (të quajtura më poshtë,Traktatet')

Neni 19

Mbrojtja në rast largimi, dëbimi apo ekstradimi

1. Ndalohen dëbimet kolektive.

2. Askush nuk mund të largohet, të dëbohet apo të ekstradohet në një shtet ku ka rrezik t'i nënshtrohet dënimit me vdekje, torturës apo trajtimeve dhe dënimeve të tjera çnjerëzore ose degraduese.

TITULLI III

BARAZIA

Neni 20

Barazia para ligjit

Të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Neni 21

Mosdiskriminimi

1. Ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, mosha apo orientimi seksual.

2. Brenda fushës së zbatimit të Traktateve dhe pa cenuar asnjë prej dispozitave të caktuara të tyre, ndalohet çdo diskriminim për shkak të shtetësisë.

Neni 22

Larmia kulturore, fetare dhe gjuhësore

Bashkimi respekton larminë kulturore, fetare dhe gjuhësore.

Neni 23

Barazia midis grave dhe burrave

Barazia midis grave dhe burrave garantohet në të gjitha fushat, përfshirë marrjen në punë, punën dhe shpërblimin për punën.

Parimi i barazisë nuk e pengon respektimin apo miratimin e masave që parashikojnë avantazhe të veçanta për atë gjini që është më pak e përfaqësuar.

Neni 24

Të drejtat e fëmijëve

1. Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e tyre. Ata mund t'i shprehin lirisht pikëpamjet e tyre. Pikëpamje të tilla merren në konsideratë për çështje me interes për ta, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre.

2. Në të gjitha veprimet që ndërmerren në lidhje me fëmijët si nga autoritetet publike qoftë dhe nga institucionet private, interesat më të larta të fëmijës gëzojnë vëmendje parësore.

3. Çdo fëmijë ka të drejtën që të ketë një marrëdhënie personale sistematike dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit e tij ose të saj, përveçse kur kjo bie ndesh me interesat e tij ose të saj.

Neni 25

Të drejtat e të moshuarve

Bashkimi njeh dhe respekton të drejtat e të moshuarve për të jetuar me dinjitet dhe pavarësi dhe për t'u përfshirë në jetën sociale dhe kulturore.

Neni 26

Integrimi i personave me aftësi të kufizuara

Bashkimi njeh dhe respekton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara që të përfitojnë nga masat që synojnë të sigurojnë pavarësinë e tyre, integrimin social dhe në punë si dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit.

TITULLI IV

SOLIDARITETI

Neni 27

E drejta e punonjësve për t'u informuar dhe për t'u këshilluar brenda ndërmarrjes

Punonjësve apo përfaqësuesve të tyre, sipas niveleve të përshtatshme, u garantohet informimi dhe këshillimi në kohën e duhur për çështjet dhe sipas kushteve të parashikuara në të drejtën e Bashkimit dhe në ligjet dhe praktikat kombëtare.

Neni 28

E drejta për bisedime kolektive dhe veprim kolektiv

Në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe me ligjet dhe praktikat kombëtare, punonjësit dhe punëdhënësit apo organizatat e tyre përkatëse kanë të drejtën e bisedimeve kolektive dhe të drejtën për të nënshkruar marrëveshje kolektive sipas niveleve të përshtatshme dhe, në rastet e konflikeve të interesit, të ndërmarrin veprime kolektive për mbrojtjen e interesave të tyre përfshirë grevën.

Neni 29

E drejta për të përdorur shërbimet e punësimit

Kushdo ka të drejtën e përdorimit pa pagesë të shërbimeve të punësimit.

Neni 30

Mbrojtja në rast pushimi të pajustifikuar nga puna

Çdo punonjës ka të drejtën e mbrojtjes kundër pushimit të pajustifikuar nga puna, në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe praktikat dhe ligjet kombëtare.

Neni 31

Kushte pune të ndershme dhe të drejta.

1. Çdo punonjës ka të drejtën e kushteve të punës që respektojnë shëndetin, sigurinë dhe dinjitetin e tij ose të saj.

2. Çdo punonjës ka të drejtën për kufizimin e kohëzgjatjes maksimale të punës, për pushim ditor dhe javor si edhe për leje vjetore të paguar.

Neni 32

Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mbrojtja e të rinjve në vendin e punës

Ndalohet marrja në punë e fëmijëve. Mosha minimale për t'u punësuar nuk mund të jetë më e ulët se sa mosha më e ulët në të cilën mund të lihet shkolla, pa cenuar rregullat që mund të jenë më të favorshme për të rinjtë dhe përveç përjashtimeve të kufizuara.

Të rinjtë që merren në punë duhet të kenë kushte punë të përshtatshme për moshën e tyre dhe të jenë të mbrojtur prej shfrytëzimit ekonomik dhe prej çdo pune që mund të dëmtojë sigurinë, shëndetin ose zhvillimin e tyre fizik, mendor, moral ose social apo që mund të pengojë arsimimin e tyre.

Neni 33

Jeta familjare dhe profesionale

1. Familja gëzon mbrojtje ligjore, ekonomike dhe sociale.

2. Me qëllim bashkërendimin e jetës familjare dhe profesionale, kushdo ka të drejtën e mbrojtjes prej pushimi nga puna për arsye që lidhen me amësinë, të drejtën e lejes së paguar të lindjes si edhe të drejtën e lejes prindërore pas lindjes apo birësimit të një fëmije.

Neni 34

Sigurimet shoqërore dhe ndihma sociale

1. Bashkimi njeh dhe respekton të drejtën për të përfituar prej sigurimeve shoqërore dhe shërbimeve sociale që ofrojnë mbrojtje në rastet e shtatzënisë dhe lehonisë, sëmundjes, aksidenteve në punë, personave në ngarkim apo në moshë të thyer dhe në rast të humbjes së punës, në përputhje me rregullat e parashikuara nga e drejta e Bashkimit si edhe ligjet dhe praktikat kombëtare.

2. Kushdo që banon dhe lëviz në mënyrë të ligjshme brenda Bashkimit Europian, ka të drejtë të përfitojë pagesa të sigurimeve shoqërore dhe avantazhe sociale në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe ligjet dhe praktikat kombëtare.

3. Për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë Bashkimi njeh dhe respekton të drejtën e asistencës sociale dhe të strehimitme qëllim sigurimin e një niveli të pranueshëm jetese për të gjithë ata të cilëve u mungojnë burimet e mjaftueshme në përputhje me rregullat e parashikuara nga e drejta e Bashkimit si edhe ligjet dhe praktikat kombëtare.

Neni 35

Kujdesi shëndetësor

Kushdo ka të drejtë për kujdesin shëndetësor profilaktik dhe për të përfituar prej trajtimit mjekësor sipas kushteve të përcaktuara në ligjet dhe praktikat kombëtare. Gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave dhe veprimtarive të Bashkimit sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

Neni 36

E drejta për shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik

Bashkimi njeh dhe respekton të drejtën për të përdorur shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik ashtu siç është parashikuar në ligjet dhe praktikat kombëtare, në përputhje me Traktatet në mënyrë që të nxitet kohezioni social dhe territorial i Bashkimit.

Neni 37

Mbrojtja mjedisore

Një nivel i lartë i mbrojtjes mjedisore si edhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit duhet të integrohen në politikat e Bashkimit si dhe të garantohen në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 38

Mbrojtja e konsumatorit

Politikat e Bashkimit garantojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit.

TITULLI V

TË DREJTAT E SHTETASVE

Neni 39

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet e Parlamentit Europian.

1. Çdo qytetar i Bashkimit ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet për Parlamentin Europian në Shtetin Anëtar në të cilin banon, sipas të njëjtave kushte që zbatohen për shtetasit e atij Shteti.

2. Deputetët e Parlamentit Europian zgjidhen me ushtrim të drejtpërdrejtë dhe të përgjithshëm të votës së lirë dhe të fshehtë.

Neni 40

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet vendore

Çdo qytetar i Bashkimit ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në zgjedhjet vendore të Shtetit Anëtar në të cilin banon, sipas të njëjtave kushteve që zbatohen për shtetasit e atij Shteti.

Neni 41

E drejta e miradministrimit

1. Çdo person ka të drejtë që çështjet e tij ose të saj të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda afateve kohore të arsyeshme nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit.

2. Kjo e drejtë përfshin:

(a) të drejtën e çdo personi që të dëgjohet përpara se kundër tij të merren masa që do ta cenonin atë;

(b) të drejtën e çdo personi për të parë dosjen e vet, duke respektuar interesat legjitime të ruajtjes së fshehtësisë së informacionit si edhe të sekretit profesional dhe tregtar;

(c) detyrimin e administratës që të argumentojë vendimet e marra.

3. Çdo person ka të drejtën që t'i kërkojë Bashkimit zhdëmtim për dëmet që mund të jenë shkaktuar prej institucioneve apo prej nëpunësve të tij gjatë ushtrimit të detyrave, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për legjislacionet e Shteteve Anëtare.

4. Çdo person mund t'u drejtohet me shkrim institucioneve të Bashkimit në një prej gjuhëve të Traktateve dhe është e detyrueshme që të marrë përgjigje në po atë gjuhë.

Neni 42

E drejta për t'u njohur me dokumentet

Çdo qytetar i Bashkimit dhe çdo person fizik ose juridik që ka vendbanimin ose selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar ka të drejtën aksesit tek dokumentet që mbahen nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit, në çfarëdo forme të jenë ato.

Neni 43

Avokati Europian i Popullit

Çdo shtetas i Bashkimit dhe çdo person fizik ose juridik me vendbanim apo selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar ka të drejtën që të paraqesë tek Avokati Europian i Popullit raste të keqadministrimit gjatë veprimtarive të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit, me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian kur vepron sipas rolit të saj gjyqësor.

Neni 44

E drejta për peticion

Çdo shtetas i Bashkimit dhe çdo person fizik apo juridik me vendbanim apo seli të regjistruar në një Shtet Anëtar ka të drejtën t'i dërgojë peticion Parlamentit Europian.

Neni 45

Liria e lëvizjes dhe e vendbanimit

1. Çdo shtetas i Bashkimit ka të drejtën të lëvizë dhe banojë lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare.

2. Liria e lëvizjes dhe e vendbanimit mund t'u jepet, në përputhje me Traktatet, shtetasve të vendeve të treta me vendbanim të ligjshëm në territorin e një Shteti Anëtar.

Neni 46

Mbrojtja diplomatike dhe konsullore

Çdo shtetas i Bashkimit ka të drejtën të gëzojë në territorin e një vendi të tretë, në të cilin nuk përfaqësohet Shteti Anëtar shtetas i të cilit është, mbrojtjen e autoriteteve diplomatike dhe konsullore të çdo Shteti Anëtar sipas të njëjtave kushteve që zbatohen për shtetasit e atij Shteti.

TITULLI VI

DREJTËSIA

Neni 47

E drejta për zgjidhje ligjore të efektshme dhe gjykim të drejtë.

Kushdo , të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit, ka të drejtën për të marrë zgjidhje ligjore të efektshme para gjykatës në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen.

Kushdo ka të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati kohor të arsyeshëm para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar më parë me ligj. Çdokujt i jepet mundësia që të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet.

Është e detyrueshme që ndihma juridike t'u ofrohet atyre të cilëve u mungojnë burimet e mjaftueshme deri në masën që kërkohet për të siguruar mundësi të efektshme përdorimi të sistemit të drejtësisë.

Neni 48

Prezumimi i pafajësisë dhe e drejta për mbrojtje

1. Kushdo ndaj të cilit është ngritur akuzë, prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet se është fajtor sipas ligjit.

2. Garantohet respektimi i të drejtave të mbrojtjes të kujtdo ndaj të cilit është ngritur një akuzë.

Neni 49

Parimet e legjitimitetit dhe proporcionalitetit për veprat penale dhe dënimet

1. Askush nuk mund shpallet fajtor për një vepër penale, në bazë të veprimeve apo mosveprimeve të cilat në çastin kur janë kryer, nuk përbënin vepër penale sipas ligjeve kombëtare apo të drejtës ndërkombëtare. Nuk vendoset as një dënim më i rëndë se sa ai që ishte i zbatueshëm në çastin kur u krye vepra penale. Nëse, pas kryerjes së një vepre penale, ligji parashikon një dënim më të lehtë atëherë zbatohet ky dënim.

2. Ky nen nuk cenon gjykimin dhe ndëshkimin e çdo personi për një veprim ose mosveprim, që në çastin kur është kryer konsiderohej vepër penale, sipas parimeve të përgjithshme të njohura nga bashkësia e kombeve.

3. Nuk lejohet që ashpërsia e dënimit të jetë në shpërpjesëtim me veprën penale.

Neni 50

E drejta për të mos u gjykuar apo ndëshkuar dy herë në proces penal për të njëjtën vepër penale

Askush nuk mund të gjykohet apo të dënohet rishtazi në proces penal për një vepër për të cilën është shpallur i pafajshëm apo është dënuar brenda Bashkimit në përputhje me ligjin.

TITULLI VII

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË INTERPRETIMIN DHE ZBATIMIN E KARTËS

Neni 51

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj Karte u drejtohen institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit duke mbajtur parasysh parimin e subsidaritetit dhe Shteteve Anëtare vetëm kur zbatojnë legjislacionin e Bashkimit. Prandaj ato janë të detyruara të respektojnë të drejtat, mbikqyrin parimet dhe promovojnë zbatimin e tyre në përputhje me kompetencat përkatëse dhe të respektojnë kufizimet e kompetencave të Bashkimit ashtu siç ia kanë deleguar Traktatet.

2. Karta nuk e zgjeron fushën e zbatimit të së drejtës së Bashkimit përtej kompetencave të Bashkimit, nuk përcakton asnjë kompetencë a detyrë të re për Bashkimin dhe as nuk modifikon kompetenca dhe detyra siç janë përcaktuar në Traktatet.

Neni 52

Fusha e veprimit dhe interpretimi i të drejtave dhe parimeve

1. Çdo kufizim për ushtrimin e të drejtave dhe lirive që njihen nga kjo Kartë mund të vendoset vetëm me ligj dhe të respektojë thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Mund të bëhen kufizime, në përputhje me parimin e propocionalitetit, vetëm nëse ato janë të nevojshme dhe nëse në të vërtetë i përmbushin objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga Bashkimi apo nevojën për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e të tjerëve.

2. Të drejtat që njihen nga kjo Kartë e që janë parashikuar në Traktatet, ushtrohen sipas kushteve dhe brenda kufizimeve të përcaktuara nga Traktatet.

3. Për aq sa të drejtat që përmban kjo Kartë përputhen me të drejtat që garantohen nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, kuptimi dhe fusha e veprimit të këtyre të drejtave është e njëjtë me ato të të drejtave që parashikon kjo Konventë. Kjo dispozitë nuk e pengon të drejtën e Bashkimit që të parashikojë një mbrojtje më të gjerë.

4. Për aq sa të drejtat themelore njihen nga kjo Kartë siç ato burojnë prej traditave të përbashkëta kushtetuese të Shteteve Anëtare, këto të drejta interpretohen në harmoni me këto tradita.

5. Dispozitat e kësaj Karte, që përmbajnë parime, mund të zbatohen nga aktet legjislative dhe ekzekutive që ndërmerren nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit dhe prej akteve të Shteteve Anëtare kur ato zbatojnë të drejtën e Bashkimit në ushtrimin e kompetencave përkatëse. Ato bëhen objekt gjykimi në gjykatë vetëm në interpretimin e akteve të tilla dhe në vendimet për ligjshmërinë e tyre.

6. Ashtu siç parashikohet në këtë Kartë, merren plotësisht parasysh ligjet dhe praktikat kombëtare.

7. Shpjegimet e hartuara si një mënyrë për dhënien e udhëzimeve në interpretimin e kësaj Karte merren siç duhet në konsideratë prej gjykatave të Bashkimit dhe të Shteteve Anëtare.

Neni 53

Niveli i mbrojtjes

Në këtë Kartë asgjë nuk interpretohet si kufizuese apo cenuese për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ashtu siç njihen, në fushat përkatëse të zbatimit nga e drejta e Bashkimit dhe e drejta ndërkombëtare si dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bashkimi dhe Shtetet Anëtare janë palë, përfshirë Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe nga kushtetutat e Shteteve Anëtare.

Neni 54

Ndalimi i abuzimit me të drejtat

Në këtë Kartë asgjë nuk interpretohet se nënkupton të drejtën për t'u angazhuar në veprimtari apo për të kryer ndonjë veprim që synon shkatërrimin e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo Kartë apo kufizimin e tyre në një masë më të madhe nga ç'parashikohet këtu.

*

* *

Teksti i mësipërm përshtat formulimin e Kartës së shpallur më 7 dhjetor 2000, duke e zëvendësuar atë që prej datës së hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

VERSIONI I KONSOLIDUAR I

TRAKTATEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN

DHE

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE E BASHKIMIT EUROPIAN

Botuar nga:
Ministria e Integrimit
Rruga Papa Gjon Pali II, Nr. 3, Tiranë, Shqipëri.

Ky botim u mbështet nga Projekti: "Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)". Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.